NIKOS KAZANZAQIS

Letër El - Grekos

BIBLIOTEKA GANESHA
AKROPOLI I IRI
NUMRI :
QYTETI : TIRANË

Titulli në origjinal: ΑΝΑΦΟΡΑ ΣΤΟΝ ΓΚΡΕΚΟ

Shënim: - Përkthimi letrar i titullit të kësaj vepre do të ishte: *Raport Grekos*. Këto terma mund të merren në sensin ushtarak; autori thotë shprehimisht se ai rri ndaj Grekos si ushtari para komandantit, për t'i dhënë llogari rreth jetës së tij shpirtërore. Në shqip këtë stil letrar e ruan fort mirë edhe titulli *Letër El - Grekos*.

Dorëshkrimi mban shënimin: "Redaktimi i parë; do të ketë tre të tillë."

Vdekja nuk e lejoi autorin ta përfundonte veprën. Shënimet si kryetituj janë vënë anash veprës dhe në shumë gjuhë të tjera janë përdorur po kështu siç po e japim në variantin shqip.

Përkthyesi

Tre lloje shpirtrash, tri lutje:

a - Unë jam një hark në duart e tua o Zot; më tendos, përndryshe do të kalbem;
b - Mos më tendos shumë o Perëndi; do të thyhem;
c - Më tendos sa të duash Zot e Perëndi; aq më keq për mua nëse thyhem.

1956

Shpirti im është një klithmë dhe gjithë vepra ime është interpretimi i kësaj klithme.

NIKOS KAZANZAQIS

Letër El - Grekos

Bilanci i nje jete

Roman

E përktheu:
Miço Gubera

SHTEPIA BOTUESE
UEGEN

Redaktor: Xhevair Lleshi
Kopertina: P&P
Në kopertinë: Portret

Botues: Arian Lleshi
Shtëpia Botuese UEGEN; Tiranë, 2001
Tel. 04 233596, 04 246619
Mob. 038 2033959; 038 21 42 683

Copyright: Shtëpia Botuese "UEGEN"

Design:Alma Lleshi (Metushi)

Letër El - Grekos *nuk është autobiografi: Jeta ime nuk ka ndonjë vlerë të veçantë, sidoqë ajo vlen për mua e ndoshta për ndonjë tjetër. E vetmja vlerë që unë i njoh asaj është lufta për t'u ngjitur shkallë-shkallë e për të arritur lart, aq lart sa mund ta çonte forca dhe këmbëngulja - në majën që unë vetë e kam quajtur shikimi kretan.*

Ti, lexues, kushdoqofsh, do të gjesh në këto fjalë vijën e kuqe të bërë nga pikat e gjakut tim që piketon rrugën time midis njerëzve, pasioneve dhe ideve. Çdo njeri i denjë që t'u quajtur bir njeriu, ngarkon kryqin mbi supe dhe ngjitet në Golgotën e tij. Shumë, më të shumtit bile, arrijnë shkallën e parë, të dytën, të tretën, gulçojnë, shëmben në mes të rrugës dhe nuk arrijnë dot në majë të Golgotës, të kryqëzohen, të ringjallen, të shpëtojnë shpirtin e tyre. Ata thyhen, qullosen, kryqi i tremb, por nuk e dinë se vetëm kryqëzimi është rruga e vetme e ringjalljes, nuk ka tjetër.

Tashmë, që dielli po perëndon, unë po përpiqem të ravijëzoj me anën e këtyre shënimeve sesi një njeri ngjit i raskapitur malin e thepisur të fatit të tij, duke treguar një emër të shenjtë e duke qëndruar te secili prej shpirtrave të mëdhenj: Krishti, Buda, Lenini *dhe* Uliksi. *Shpirti im është një klithmë dhe gjithë vepra ime është interpretim i kësaj klithme.*

Gjithmonë, gjatë gjithë jetës sime, një fjalë më ka tiranizuar e fshikulluar: fjala ngjitje. *Këtë* ngjitje *unë dëshiroj ta përshkruaj këtu, duke e gërshetuar fantazinë me realitetin, gjithashtu të tregoj edhe gjurmët e kuqe që ka lënë* ngjitja *ime. Unë, shpejtohem për këtë, përpara se të vesh "kaskën e zezë" e të zbres në pluhur, sepse kjo vijë e përgjakshme do të jetë e vetmja gjurmë që do të lërë kalimi im mbi tokë, pra kjo që kam shkruar, sepse ajo që kam bërë është gdhendur mbi ujë dhe është zhdukur.*

Unë u thërras kujtimeve, mbledh jetën time të pehatur në erë. Duke qëndruar në këmbë si një ushtar përpara gjeneralit, unë i raportoj El - Grekos; *sepse ai është mbrujtur nga e njëjta tokë kretane, si unë, sepse më mirë nga gjithë luftëtarët që jetojnë ose kanë jetuar, vetëm ai mund të më kuptojë. A nuk ka lënë edhe ai po ashtu të njëjtën gjurmë të kuqe mbi gurë?*

LETËR EL - GREKOS

Unë po i mbledh pajisjet e mia: shikimin, dëgjimin, shijen, nuhatjen, prekjen, shpirtin. Nata ka rënë. Dita e punës ka mbaruar e unë futem në shtëpi si urithi në tokë. Jo se jam i lodhur nga puna, jo! Nuk jam i lodhur, por dielli po perëndon...

Dielli ka perënduar, malet janë zhytur në mjegull, veç vargmalet e shpirtit tim kanë akoma pak dritë në majat e tyre, por nata e shenjtë po bie; ajo ngjitet nga toka, zbret nga qielli, ndërsa drita është betuar të mos e lejojë. Sigurisht ajo e di, nuk ka shpëtim: nata, nata do të bjerë.

Po ku mund ta jap lamtumirën, duke hedhur vështrimin përreth? Mbi malet në det, mbi pjergullat në vreshta, mbi virtytin, apo mbi peshqit, në ujin e freskët? Kjo nuk shërben më për asgjë, asgjë! Të gjitha këto do të zbresin në tokë së bashku me mua.

Kujt i duhen gëzimet dhe mundimet e mia, pasionet e fshehta donkishoteske të rinisë sime? Përplasja e ashpër më vonë, me Zotin dhe njerëzit, dhe më në fund krenaria e egër e pleqërisë që digjet por s'e pranon deri në vdekje se do të bëhet hi? Kujt mund t'ia thosha se sa herë, duke ngjitur me këmbë e me duar të tatëpjetën e thepisur të Zotit, unë kam rrëshqitur e jam rrëzuar, sa herë jam çuar mbuluar me gjak për të filluar përsëri ngjitjen? Ku ta gjej një shpirt të shpuar nga mijëra goditje, por të paepur, si i imi, për t'iu rrëfyer?

Mes duarve shtrëngoj lehtësisht, me dhimbsuri, një copë tokë kretiane. Gjithmonë e kam mbajtur me vete këtë, gjatë shtegtimeve, në brengat e mëdha, e shtrëngoja mes duarve e duart merrnin forcë, një forcë të madhe sikur mbaja midis pëllëmbëve dorën e një miku të dashur.

Por tashmë që dielli ka perënduar dhe dita e punës ka mbaruar, çfarë mund të bëj me forcë? Unë nuk kam më nevojë për të. Mbaj

këtë copë tokë të Kretës në duar duke e shtrënguar me ëmbëlsi, me dashuri dhe mirënjohje të patreguar; ashtu si do të shtrëngoja gushën e gruas së dashur nga e cila do të ndahesha. Ja çfarë kam qenë unë përjetësisht! Ja ç'do të jem gjithmonë!

Çasti kur ti nise rrugën, tokë e egër e Kretës dhe u bëre një njeri luftëtar, kaloi si një vetëtimë, si një dritë.

Çfarë lufte, çfarë brenge, çfarë forcash të rrezikshme qiellore e satanike, e mbanin këtë copë toke? Mbrujtja me gjak, me djersë e me lotë. Ajo ishte bërë njeri, dhe mori rrugën për të arritur, për të arritur ku?

Ky njeri ngjitej, duke gulçuar, midis errësirës, për te Zoti, shtrinte duart, kërkonte, kërkonte, i pashpresë, kuptoi se kjo masë e errët nuk kishte fytyrë, filloi një luftë të re gjithë shqetësim e tmerr, për të gdhendur majën e paformë e për t'i dhënë asaj një fytyrë, fytyrën e tij!

Por tashmë dita e punës ka përfunduar e unë po i mbledh pajisjet e mia. Çfarë copa të tjera toke do të vazhdojnë luftën? Jemi ne, ne të vdekshmit e tjerë, ushtria e të pavdekshmëve, gjaku ynë me ngjyrën e koralit të kuq, që ngremë një ishull mbi greminë.

Zot i mëshirshëm, në rrugën time unë e kam vendosur një zall të kuq, një pikë gjaku për ta ngurtësuar e për të mos humbur; unë e kam bërë detyrën time.

Lamtumirë!

Shtrij dorën, kap shulin e tokës, për të hapur portën e të shkoj, por hezitoj akoma mbi pragun e shndritshëm. Është e vështirë, shumë e vështirë të heqësh sytë e mi, veshët e mi, zemrën time nga gurët e barërat e kësaj bote. Mund të them: unë jam i ngopur, i qetë, unë nuk dua më asgjë, unë e kam realizuar vizatimin tim e po shkoj. Po zemra e kapur pas gurëve, e barërave, reziston e lutet: - Prit edhe pak.

Unë përpiqem të ngushëlloj zemrën time, ta nxis të thotë lirisht atë po-në, që ne të mos e lëmë tokën si skllevër, të mposhtur, të mbytur në lot, por si mbretër që kanë ngrënë e kanë pirë e pasi janë ngopur e nuk duan më çohen nga tavolina. Por zemra rreh akoma në gjoks, reziston e thërret: - Prit akoma!

Në këmbë, i hedh një shikim të fundit dritës, që edhe ajo nuk jepet ende, si zemra e njeriut që lufton. Retë kanë mbuluar qiellin,

një shi i butë bie mbi buzët e mia, e nga toka vjen një erë. Një zë i ëmbël, magjepsës ngrihet prej andej. Eja...Eja...Eja...

Pikat e shiut bëhen më të dëndura; zogu i parë i natës ka psherëtirë e ankimi i tij ka rënë, i butë, mbi gjethet e fjetura nën ajrin e lagët. Qetësi, një dashuri e madhe, në shtëpi s'ka njeri. Jashtë fushat e etura pijnë me mirënjohje, me një lumturi të heshtur, shiun e parë; toka ngrihet si një i porsalindur për të pirë.

Mbyll sytë drejt qiellit. Në duart e mia mbaj gjithmonë copën e tokës së Kretës, ndërsa më ka kapur gjumi. Më kap gjumi e unë shoh një ëndërr. M'u duk se kish rënë dita dhe ylli i mëngjesit qëndronte mbi kokën time. Dridhesha e thosha: tani ai do të bjerë. Unë vrapoja, vrapoja i vetëm midis maleve të shkretë e të vetmuar. Larg në lindje duket dielli. Por nuk ishte dielli, ishte një platformë bronxi plot me thëngjij të ndezur.

Ajri ziente herë pas here, një thëllëzë ngjyrë hiri fluturonte nga shkëmbi në shkëmb, përplaste krahët, kakariste, qeshte me shpërthime e tallej me mua. Nga një anë e malit një korb ngrihet fluturim me të shpejtë sapo më pa. Sigurisht ai më priste. Filloi të më ndiqte duke ia plasur gazit. I inatosur unë u ula dhe mora një gur për ta goditur. Po korbi u shndërrua: ai u bë një plak i vogël që më buzëqeshte.

Më pushtoi tmerri dhe fillova të vrapoja. Malet rrotulloheshin dhe bashkë me ta rrotulloheshin dhe unë. Rrathët vazhdonin të shtrëngoheshin e m'u morën mendtë. Malet kërcenin rreth meje, por unë kuptova menjëherë se nuk ishin male; ishte një trup tepër i vjetëruar, i fosilizuar. Një kryq gjigand i zi ishte ngulur në të djathtë shumë lart mbi një shkëmb, e mbi të një gjarpër i bronxtë me trup të përbindshëm gjendej i kryqëzuar. Një vetëtimë përshkon shpirtin tim e ndriçon malet përreth, unë e pashë; kisha hyrë në grykën e tmerrshme spirale ku kishin kaluar mijëra vjet më parë, hebrejtë me në krye Jehovain, kur u arratisën nga toka e lumturisë e faraonit. Kjo grykë ishte furra ku midis urisë, etjes e blasfemisë u farkëtua raca izraelite.

Më kapi frika, frika dhe një gëzim i madh. Mbështetem mbi një shkëmb për të qetësuar vorbullën e shpirtit. Mbylla sytë e menjëherë gjithçka rreth meje u zhduk. Një breg grek shtrihet para meje dhe një det me ngjyrë blu të errët, shkëmbinj të kuq e midis shkëmbi-

njve hyrja e ulët e një shpelle të errët. Një dorë u tund në ajër dhe vendosi në dorën time një pishtar të ndezur. Unë kuptova urdhërin: Bëra kryqin dhe hyra në shpellë. Bridhja, bridhja, duke pllaquritur në pellgjet e ujit të zi e të ngrirë. Stalaktite kaltëroshe, të lagura, vareshin mbi kokën time, stola gjigandë të gurtë ndriçonin dhe qeshnin nën dritën e pishtarit. Kjo shpellë ishte shtrati i një lumi të madh që kishte ngelur e zbrazët sepse gjatë shekujve lumi kishte ndërruar rrugë. Gjarpëri i bronxtë, i irrituar filloi të vërshëllejë. Hapa sytë e pashë malet, grykën, humnerat. Hutimi im mori fund. Gjithçka u bë e palëvizshme dhe ndriçoi. Më në fund e kuptova: vargmalet që më rrethonin, ishin ata ku kishte gërmuar Jehovai, për të hapur rrugën ku do të kalonte. Unë kisha hyrë në shtratin e tmerrshëm të Zotit; vazhdoja ta ndiqja në çdo hap rrugën e kalimit të tij.

- Ja rruga, thirra ashtu në ëndërr, ja rruga e njeriut, nuk ka tjetër!

Sapo kjo fjalë e guximshme doli nga buzët e mia, më mbështolli një vorbull e re, krahë të fuqishëm më ngritën e unë u gjenda menjëherë në majë të Sinait, shtëpia e Zotit. Ajri mbante erë squfuri, buzët më digjnin sikur ishin shpuar nga shkëndija të panumërta e të padukshme. Ngrita qepallat; kurrë ndonjëherë sytë dhe qënia ime nuk ishte kënaqur me një shfaqje aq jonjerëzore, aq të përshtatur me zemrën time, pa ujë, pa një pemë, pa një njeri, pa shpresë. Pikërisht atje shpirti i një njeriu krenar ose të pashpresë gjen lumturinë supreme.

Pashë shkëmbin mbi të cilin qëndroja në këmbë. Dy vrima të thella të bëra mbi granit duhej të ishin gjurmët e hapave të profetit me brirë që priste të dilte luani i uritur. A nuk i kishte dhënë urdhër të priste këtu në majë të Sinait? Ai priste.

Unë gjithashtu prisja, mbaja vesh. Përnjëherë, shumë larg, kumbojnë mbytur ca hapa. Dikush që trondiste malet, afrohej; hundët e mija regëtinë. Gjithë ajri kishte erën e cjapit që udhëheq kopenë: Ai erdhi! Ai erdhi! Pështpërisja duke shtrënguar fort rripin. Unë përgatitesha të luftoja.

Ah! Sa i djegur isha të shihja të vinte ky çast, ta takoja ballë për ballë, bishën e uritur të xhunglës së qiellit, të padukshmin, të pangopshmin, krijuesin që ha fëmijtë e tij, buzët e të cilit, goja e thonjtë pikojnë gjak, në mënyrë që bota e dukshme të mos futej midis nesh

e të më shqetësonte.

- Unë do t'i flisja me guxim, do t'i tregoja brengën e njeriut, brengën e zogjve, të pemëve e të gurëve; ne e kishim vendosur, nuk donim të vdisnim. Unë mbaja në duar një raport, të cilin e kishin nënshkruar gjithë pemët, zogjtë, bishat e njerëzit... Nuk do të trembesha t'ia jepja, por, ne nuk duam At, që ti të na hash.

Unë flisja, lutesha, shtrëngoja rripin tim e dridhesha. Ndërsa prisja, m'u duk se gurët u ngjallën dhe dëgjoj të fështërijë një erë e lehtë.

- Ja!... Ja! Ai është këtu, - pështpërita dhe kthehem duke u dridhur.

Por nuk ishte ai, nuk ishte Jehovai, ishe ti, Gjysh, ardhur nga toka e dashur e Kretës, që qëndroje në këmbë para meje, plot vrull e krahë, zot i rëndë, me mjekrën tënde të bardhë, me majë, me buzët e thara e të shtrënguara, syrin mahnitës, flokët të përzier me rrënjë trumëze.

Ti më pe e unë nga shikimi yt kuptova se kjo botë është një re e ngarkuar me vetëtima e erëra, se shpirti i njeriut është i ngarkuar me vetëtima e erëra, se Zoti fryn mbi të e ai nuk ka shpëtim.

Ngrita sytë e të pashë. Doja të të thosha:

"Gjysh, është e vërtetë se nuk ka shpëtim?' - Por gjuha m'u lidh në gykë. Doja të të afrohesha por gjunjët m'u thyen. Atëherë ti shtrive dorën, sikur doje të më shpëtoje, se unë po mbytesha.

U kapa te dora jote me një dëshirë tepër të madhe; ajo ishte e zhgarravitur me piktura shumëngjyrëshe, ajo digjej. Preka dorën tënde, ajo më dha forcë, më dha shtytje dhe unë munda të flas.

"Gjysh i dashur, më jep një urdhër".

Ti buzëqeshe, vure dorën mbi kokën time. Ajo nuk ishte dorë por një zjarr shumëngjyrësh. Ai zjarr u shpërnda deri në thellësi të shpirtit tim.

- Shko deri ku të mundësh, fëmija im. Zëri yt ishte i rëndë, i paqartë, sikur dilte nga gryka e thellë e tokës.

Ai preku rrënjët e trurit tim por zemra nuk u drodh.

- Gjysh, - thirra unë atëherë me zë të lartë, - më jep një urdhër më të vështirë, më kretas.

Fare papritur, sapo unë fola, një fjalë çau ajrin duke fërshëllyer. Stërgjyshi u zhduk nga shikimi im: Mbi Sinai qëndronte vetëm zëri

i lartë që jepte urdhërin dhe që bënte të dridhej ajri.

- Shko deri atje, ku ti nuk do të mundesh më.

U zgjova duke buzëqeshur. Ishte gdhirë. U çova dhe u afrova te dritarja, dola në ballkon te pjergulla e mbushur me fruta. Shiu kishte pushuar, gurët shkëlqenin, qeshnin.

Gjethet e pemëve ishin mbuluar me lot.

Shko deri ku nuk mundesh më.

Ishte zëri yt. Askush tjetër në botë nuk mund të shqiptonte një fjalë aq burrërore, atë mund ta shqiptoje vetëm ti, *Gjysh i pangopur!* A nuk je ti udhëheqësi i pamposhtur dhe i dëshpëruar i fisit tim luftëtar? A nuk jemi ne të dërrmuarit, të uriturit, njerëzit kokëfortë, me kokë të hekurt, që i kemi kthyer shpinën mirëqënies dhe bindjes - kështu ti na udhëheq e ne hidhemi në sulm për të thyer kufijtë? Fytyra më e shkëlqyer e dëshpërimit është Zoti; fytyra më e shkëlqyer e shpresës është Zoti. Mbi shpresën e dëshpërimin, mbi kufijtë e vjetër, ti Gjysh më tërheq. Për ku më tërheq? Unë shikoj rreth meje, shikoj te vetja: Virtyti është pa vlerë, gjeometria, materia janë-pa vlerë.

Duhet të vijë shpirti ligjvënës për të themeluar një rend të ri, ligje të reja, që bota të bëhet një harmoni e tërë.

Është kjo që ti do, drejt kësaj ti më shtyn e që më ke shtyrë gjithmonë. Unë prisja ditë e natë urdhërin tënd. Unë jam përpjekur aq shumë që të mund të arrija atje ku nuk mund të arrija. Në qoftë se unë kam arritur atje ose jo je ti që do të më thuash. Unë po qëndroj në këmbë para teje e pres.

Gjeneral, beteja mbaroi, e unë po ju raportoj. Ja ku kam luftuar unë; jam plagosur, kam patur frikë por nuk kam dezertuar. Dhëmbët më kërcisnin nga frika por unë e shtrëngoja fort ballin me një shami të kuqe që të mos dukej gjaku, e hidhesha në sulm.

Një nga një përpara teje unë do t'i shkul pendët e shpirtit tim, të mbrujtur me lot, me gjak e me djersë, korba funebre, derisa mos të ketë më. Do të tregoj luftën time, për t'u çliruar, do ta lë mënjanë virtytin, turpin, të vërtetën, për të qënë i shpenguar. I tillë si Toledo në shtrëngatë, si e ke krijuar ti, me re të rënda, të zeza, rrethuar nga një ndriçim i verdhë, duke luftuar pa shpresë e pa dobësi me dritën dhe errësirat - kështu është shpirti im. Ti do ta shikosh, do ta peshosh

ndërmjet qerpikëve të tu të hollë si shigjeta, dhe do ta gjykosh. Të kujtohet fjala e tmerrshme që ne u themi kretanëve të tjerë? - Atje ku ti ke dështuar, kthehu, atje ku ti ke fituar largohu. Në qoftë se unë kam dështuar dhe po qe se më ka ngelur akoma edhe një orë për të jetuar, unë do të nisem në detyrë; në qoftë se unë kam arritur t'ia dal në krye, do ta hap tokën për të ardhur të shtrihem pranë teje.

Dëgjo pra raportin tim, gjeneral dhe gjyko.

Dëgjo, Gjysh, tregimin e jetës time, dhe në qoftë se me të vërtetë unë kam luftuar bashkë me ty, në qoftë se unë jam plagosur dhe askush nuk e ka mësuar se unë vuaja, në qoftë se unë nuk i kam kthyer shpinën armikut, - atëherë më jep bekimin.

STËRGJYSHËRIT

Përkulem e shoh në thellësi të ekzistencës sime dhe dridhem. Stërgjyshërit nga ana e babait: në det, piratë gjakatarë; në tokë, udhëheqës luftrash, që nuk i trembeshin as Zotit, as njerëzve. Nga ana e nënës: fshatarë të mirë, të zymtë, që përkulur gjithë ditën mbi tokë plot besim, duke pritur të sigurt shiun dhe diellin, korrnin, pastaj uleshin mbrëmjeve në stolat e gurtë të shtëpisë e kryqëzonin krahët duke iu lutur Zotit.

Si mund të bëj, të përputh këta dy stërgjyshër që luftojnë brenda meje, zjarrin dhe tokën?

Unë e dija që ishte detyra ime, detyra ime e vetme: të pajtoja të papajtueshmit, të nxirrja nga fundi i ekzistencës sime errësirën e trashë stërgjyshore dhe ta ktheja sa të mundja në dritë. A nuk është kjo mënyra e Zotit? A nuk është detyra jonë ta bëjmë këtë duke ndjekur rrugët e tij? Jeta jonë është një dritë shumë e shkurtër por ne do të kemi kohë.

Gjithë universi, pa e ditur, ndjek këtë metodë. Çdo qënie e gjallë është një atelie ku Zoti fshehtas përpunon baltën dhe e transformon atë. Ja përse pemët lulëzojnë e ngarkohen me fruta, po ashtu kafshët riprodhohen, ja përse majmuni mundi të kapërcejë fatin e tij dhe të çohet mbi dy këmbë. Dhe tani, për herë të parë që kur ekziston bota, ai i ka lejuar njeriut të hyjë në atelienë e Zotit e të punojë bashkë me të, e sa më shumë ai transformon mishin në dashuri, në burrëri e në liri aq më shumë ai bëhet bir i Zotit.

Kjo është një detyrë dërrmuese, e pafundme. Gjithë jetën time unë kam luftuar, madje luftoj akoma, por një vend në fund të zemrës ngelet gjithmonë në errësirë, dhe lufta vazhdon pa pushim. Duke u zhytur më thellë në ekzistencën time, stërgjyshërit e mi të lashtë atëror përzihen dhe unë nuk arrij veç me mundim të madh, në skutat e thella, të dalloj njërën pas tjetrës të fshehtat e shpirtit tim - indivi-

din, racën, qënien njerëzore - për të gjetur stërgjyshin e parë të tmerrshëm, qënien time e pushton më shumë lemeria. Në fillim këto fytyra i përfytyroj si të vëllait, të babait, por sa më shumë eci përpara drejt rrënjëve në thellësi të ekzistencës sime duket një stërgjysh mbuluar me leshra e nofulla të trasha. Ai ka uri dhe etje, ulërin e sytë i ka plot me gjak. Ky stërgjysh është kafsha e trashë, e ashpër, që duhet ta transformoj në njeri, e në qoftë se mundem dhe kam kohë për këtë, ta çoj më lart se njeriu. Çfarë shndërrim i tmerrshëm nga majmuni te njeriu e nga njeriu tek Zoti.

Një natë udhëtoja me një mik mbi një mal të lartë të mbuluar me borë. Kishim humbur rrugën e na zuri nata. Sipër nesh qëndronte hëna e heshtur, e rrumbullaktë, qielli pa një re, e që prej qafës së malit ku ishim ne e deri poshtë në fushë shkëlqenin barërat kaltërc shë. Një qetësi e rëndë, shqetësuese, e padurueshme zotëronte hapë sirën. Kështu duhet të kenë qenë netët e lara me hënë, mijëra sheku përpara se Zoti, vetë, i cili nuk mund ta duronte një qetësi të tillë, të merrte baltën për të bërë njerëzit.

Unë ecja disa hapa përpara mikut tim. Një dalldi e çuditshmë mbështillte shpirtin tim. Ecja duke u kolovitur si i dehur. Më duke se ecja mbi hënë ose mbi një tokë shumë të vjetër, të pabanueshme, shumë kohë më parë se të vinte njeriu, por ama shumë e afërt. Fare papritur pas bërrylit të malit, dallova shumë larg në fund të luginës ca drita të zbehta. Ndonjë fshat i vogël, që është akoma zgjuar, mendova. Ndalova, shtrëngova grushtat e thirra, pa u përmbajtur e duke treguar fshatin me grusht:

- Do t'ju ther të gjithëve! - Ishte një zë i çjerrë, që nuk ishte imi. Aq shumë më kishte kapur tmerri sa mezi e dëgjova. Gjithë trupi po më dridhej, miku im u ndal i shqetësuar dhe më kapi nga krahu:
- Ç'pate? Ç'të kapi? Kë do të therësh?

Gjunjët m'u këputën; menjëherë ndjeva një lodhje të papërshkrueshme, por duke parë mikun tim përpara, e mora veten.

- Nuk isha unë, - pëshpërita, - nuk isha unë. Ishte një tjetër. Cili? Kurrë qënia ime nuk qe shfaqur aq hapur, në mënyrë aq të qartë. Prej vitesh dyshoja për këtë gjë, por që prej asaj nate isha i sigurt për këtë: brenda nesh qëndrojnë errësira, hone e skuta të shumta, thirrje të lemerishme, kafshë të mbuluara me leshra, uri të shumë-

llojshme. Uri? Pra asgjë nuk vdes? Asgjë nuk vdes në këtë botë? Aq sa do të jetojmë, gjithë netët e paranjeriut, gjithë hënat e paranjeriut, uritë, etjet, vuajtjet e shumë shekujve më parë do të vazhdojnë të jetojnë, të kenë uri e etje e të torturohen me ne. Më pushtoi frika kur dëgjova të ulërijë brenda qënies sime ajo ngarkesë e tmerrshme që unë kam brenda vetes, pra, nuk do të shpëtoj kurrë, fundi i qënies sime nuk do të qënkej kurrë i pastër?

Kohë pas kohe, sidoqë rrallë, një zë i ngrohtë ngrihej në thellësi të zemrës sime.

- Mos ki frikë, unë do t'i bëj ligjet, unë do ta vendos rregullin, unë jam Zoti, ki besim. Por përnjëherë, ngrihet një ulërimë e fuqishme, dhe zëri i ngrohtë nuk u dëgjua më.

- Mos u mburr, unë do t'i shpërbëj ligjet e tua, do ta shkatërroj rendin tënd, do të zhduk edhe ty. Unë jam kaosi!

Thonë, se dielli u ndal njëherë, për të dëgjuar një vajzë të re që këndonte. Sikur kjo të ishte e vërtetë! Sikur nevoja të mund të ndryshonte rrugë, e joshur nga një shpirt që këndon poshtë mbi tokë. Në qoftë se ne mundim, duke qarë, duke qeshur, duke kënduar, të krijojmë një ligj që vendos rregull në kaos! Sikur zëri i ngrohtë që qëndron brenda nesh të mundej që të mbulonte ulërimat! Kur jam i dehur ose i nxehur, kur afroj gruan që dua, kur padrejtësia më shtyp e unë ngre kokën rebele kundër Zotit, ose kundër djallit, ose kundër përfaqësuesve të Zotit apo të demonit mbi tokë, unë dëgjoj këto monstra që qëndrojnë brenda meje që ulërijnë e përpiqen të thyejnë kafazin, të dalin në dritë e të marrin armët. Duke qenë unë pinjolli i fundit i tyre, ata nuk kanë shpresë tjetër, nuk kanë strehë tjetër veç meje. Ajo çfarë iu ngelet atyre për t'u hakmarrë, nga gëzimi ose nga vuajtja, do ta marrin vetëm nëpërmjet meje.

Në qoftë se unë zhdukem, ato do të zhduken së bashku me mua. Një ushtri e tërë monstrash e njerëzish që vuajnë do të kenë mbaruar së bashku me mua në varr. Ndoshta për këtë ato më tiranizojnë aq fort e shpejtohen shumë. Ja pse, ndofta, rinia ime ka qenë aq e padurueshme, e pabindur dhe e vuajtur.

Ata vrasin e vriten me njëri tjetrin pa respektuar as jetën e tyre as atë të të tjerëve. Ata duan dhe përçmojnë me të njëjtën mospërfillje. Hanë si gogolë e pijnë si kuçedra përpara se të nisen për luftë,

nuk fëlliqen me gra. Në verë kanë gjoksin zbuluar, në dimër e mbulojnë me lëkurë kafshësh. Dimër, verë, kanë një erë të rëndë kafshësh.

Stërgjyshin e fundit, unë e kam akoma të gjallë në gjakun tim, bile unë besoj se ai me gjithçka është në gjakun tim më i gjalli. Ai i mbante flokët gërshetë ndërsa në pjesën e përparme mbi ballë kokën e kishte të rruar. Ishte i lidhur me piratët e Algjerisë dhe iu binte deteve kryq e tërthor. Strofullën e kishin në ishujt e shkretë të Grambusas në pjesën perëndimore të Kretës. Prej këtej duke hapur velat e zeza, nisnin anijet e tyre për të kapur anijet që kalonin andej. Disa lundronin drejt Mekës, ngarkuar me pelerina myslimane, që shkonin atje për t'u bërë haxhinj, të tjerat drejt varrit të shenjtë, ngarkuar me të krishterë. Piratët lëshonin një klithmë, lidhnin çengelat, hidheshin mbi kuvertë me sopata dhe nuk kursenin as Krishtin e as Muhametin. Thernin të vjetrit, kthenin të rinjtë në skllevër. Shkatërronin gratë dhe zhdukeshin në Grambusa, me mustaqet plot gjak dhe plot erë nga e grave. Herë të tjera ata vërsuleshin mbi anijet e lehta me dy direkë, të pasura, që vinin nga Orienti ngarkuar me erëza. Pleqve iu kujtohet akoma që gjithë Kreta ndjeu erën e kanellës e të arrave të mykura. Ishte stërgjyshi im, ai që mbante gërshetë, që kishte grabitur një anije me erëza, e, ngaqë nuk dinte ç'të bënte me to, i shpërndau në gjithë fshatrat e Kretës, falas, duke iu dhënë gjithë bashkëfshatarëve e të njohurve. Kur e mësova këtë, ka disa vjet, nga goja e një kretiani njëqindvjeçar unë u trondita: Në të gjitha udhëtimet e mia, në tavolinën ku shkruaja unë dëshiroja gjithmonë të kisha, pa e ditur përse, një tub kanelle e dy arra të mykura.

Sa herë kam mundur, duke dëgjuar zërat e fshehtë që gjenden brenda meje, duke ndjekur, jo shpirtin por gjakun tim, kam arritur, me një siguri të fshehtë në origjinën më të largët të stërgjyshërve të mi. Më vonë, i ndihmuar nga koha, këtë siguri të fshehtë, faktet tronditëse e të dukshme të jetës sime të përditshme e kanë përforcuar. Në fillim mendoja se ishin të rastësishme dhe nuk duhej t'u kushtoja vëmendje. Por në fund, duke përzier zërin e botës së dukshme me zërat e fshehtë që ruaja brenda meje, unë munda të kapërceja errësirat primitive që shtriheshin në shpirtin tim, të ngrija perden e të shihja.

Dhe nga çasti kur unë e pashë, shpirti filloi të forcohet, ai nuk

rridhte më si uji midis ndryshimeve të vazhdueshme. Rreth një bërthame të ndritshme, tani po formohej dhe ngurtësohej një fytyrë, fytyra e tokës. Unë nuk ecja më në rrugë të paqëndrueshme, herë nga e majta e herë nga e djathta, për të gjetur nga cila bishë rridhja. Unë ecja me siguri sepse e njihja fytyrën time të vërtetë dhe detyrën time të vetme: ta përpunoja atë fytyrë me shumë durim, dashuri e zotësi. Ç'do të thotë ta përpunosh atë? Ta transformoja në zjarr e në qoftë se do të kem kohë për këtë, përpara se të vijë vdekja, të bëjë me këtë zjarr një dritë të fortë që vdekja të mos gjejë gjë për të marrë prej meje. Kjo ka qenë dhe ambicja ime më e madhe. Të mos ngelet asgjë nga unë që vdekja mos të ketë ç'të marrë; vetëm disa eshtra.

Qysh në fillim ajo që më ka ndihmuar të pres me këtë siguri është toka ku janë vendosur e ku janë ushqyer stërgjyshërit e mi nga babai. Familja e babait tim vjen nga një fshat, rreth dy orë larg Megalo Kastros, që quhet ndryshe *Barbarët*. Kur perandori i Bizantit Niqifor Fokas, në shekullin X mori Kretën, arabët u vendosën në disa fshatra që u quajtën Barbarët. Në një nga këto fshatra kanë hedhur rrënjë stërgjyshërit e mi atërorë dhe ata kanë gjithë cilësitë e karakterit arab: krenarë, kokëfortë, flasin pak, shkruajnë pak. Ata akumuluan gjatë viteve zemërimin dhe dashurinë, dhe fare papritur, në qetësi, i pushton demoni dhe ata shpërthejnë të papërmbajtur. E mira supreme, për ta, nuk është jeta, por pasioni.

Ata nuk janë të mirë, as të shoqërueshëm, prania e tyre është e rëndë; kërkojnë shumë, jo nga të tjerët por nga vetja. Tek ata gjendet një demon që i mbyt dhe u zë frymën. Bëhen piratë dhe dehen, çajnë krahun me një goditje thike për të rrjedhur gjaku që të lirohen, vrasin gruan që duan për të mos u bërë skllave. Atëherë, si, përpiqen si unë, pinjolli i tyre i degjeneruar, që të kthejnë në shpirt atë forcë të errët? Ç'do të thotë të transformosh stërgjyshërit e mi barbarë në shpirt? Kjo do të thotë t'i çosh deri në martirizim suprem dhe pastaj t'i asgjësosh.

Zëra të tjerë piketojnë akoma fshehtas rrugën që më çon drejt stërgjyshërve të mi: duke parë një hurmë, zemra ime mbushet me

gëzim, sikur futet në atdheun e saj, në fshatin e beduinëve, të thatë, mbuluar me pluhur, stolia e vetme dhe e çmuar e të cilëve është një hurmë. Dhe kur një ditë unë hyra në shkretëtirën e Arabisë, hipur mbi një gamile dhe pashë hapësirën e pafund, me rërë të verdhë, të kuqe e blu gjatë mbrëmjeve, që valëzonte përpara meje pa patur as gjurmën më të vogël të njeriut që të ngjallte dëshpërim, një dalldi e çuditshme më pushtoi dhe zemra nxori një klithmë, si petriti që kthehet, pas shumë vitesh, pas mijëra vjetësh në folenë e tij.

Për një farë periudhe unë jetoja në një kasolle të vetmuar pranë një fshati grek, fare i vetëm që sipas fjalës së një asketi bizantin unë degdisja erërat që do të thotë shkruaja vjersha. Kjo kasolle ishte e fshehur midis ullinjve dhe pishave nga ku, midis degëve të tyre dallohej, shumë poshtë i kredhur në një blu të pafund deti Egje. Vetëm Floros, një bari me mjekër të bardhë, një i paditur, mbuluar me zhul, kalonte me kopenë e tij çdo mëngjes, e më sillte një shishe qumësht, tetë vezë e duke tundur kokën e tij të madhe: - O Zot, o Zot, po çfarë bën me gjithë këto letra, zotëri? Nuk të mjaftojnë? Dhe shpërthente në gaz. Një ditë kaloi me nxitim, i zemëruar dhe nuk ishte në qejf për të më thënë mirëmëngjes. Atëherë unë i thirra: - Floros, çfarë ke? Ai tundi dorën e tij të madhe: - Mos më fol më, zotëri, gjithë natën nuk mbylla sy. Por zotëria juaj nuk ka dëgjuar. Ti nuk ke veshë? Nuk e dëgjove borien në malin përballë? Dreqi ta marrë! Ai nuk ka rregulluar mirë zilet e kopesë së tij, si mund të flija, pra. E pra, unë po shkoj. Ku po shkon Floros? - T'ia rregulloj, sigurisht, për të qënë i qetë.

Një ditë në drekë, u ngrita për të marrë enën e kripës në musëndër, për vezët. Pak kripë më ra në tokë. M'u shtrëngua zemra; u shtriva rrafsh me tokën dhe fillova të mbledh kripën kokërr për kokërr. Atëherë u kujtova menjëherë për atë që po bëja e u tmerrova: përse gjithë ai mundim për disa kokra kripë që ranë në tokë? Çfarë vlere kishte?

Asgjë.

Më vonë unë zbulova gjurmë të tjera mbi rërë, që do të më lejonin duke i ndjekur ato, të arrija te paraardhësit e mi: zjarri dhe uji.

Kur unë shoh një zjarr që digjet më kot, ngrihem me një kërcim, i shqetësuar, nuk dua ta shoh të digjet kot; kur shoh një rubinet të

rrjedhë pa patur enë për t'u mbushur, as njeri për të pirë, as kopsht për të vaditur, vrapoj ta mbyll.

Unë i jetoja këto gjëra të çuditshme por nuk arrija t'i bashkoja qartë në shpirtin tim për të gjetur lidhjen e tyre të fshehtë. Zemra nuk mund ta pranonte të shihte të harxhohej kot, uji, zjarri, kripa. Unë mbushesha me gëzim duke parë një hurmë, hyja në shkretëtirë e nuk doja të dilja prej andej, por arsyetimi nuk shkonte më larg. Kjo zgjati disa vjet. Por duhet besuar se në mënyrë të fshehtë në honet e errëta që flinin brenda meje, ky preokupim punonte, gjithë këto gjëra të pashpjegueshme afroheshin e merrnin pak nga pak një kuptim, njëri pas tjetrit e fare papritur një ditë, kur nuk e mendoja, ndërsa ecja duke u endur nëpër një qytet të madh e gjeta! Kripa, zjarri, uji, tre elemenmtët më të çmuar të shkretëtirës! Sigurisht ishte ndonjë stërgjysh beduin brenda meje që lëvizte duke parë kripën, zjarrin e ujin të humbisnin, e që hidhej t'i shpëtonte.

Më kujtohet, atë ditë në qytet binte një shi i madh dhe i qetë. Një vajzë e vogël qëndronte nën strehën e një porte dhe shiste buqeta të vogla manushaqesh të lagura. Unë ndalova dhe e pashë, por shpirti im, tani endej i zbutur, gjithë gëzim, shumë larg, në shkretëtirë.

Gjithë kjo mund të mos jetë veç imagjinatë ose autosugjestion.

Një pasion romantik për gjithçka përrallore e të largët, dhe të gjitha gjërat e çuditshme që unë i lidh me njëra-tjetrën, mund të mos jenë të çuditshme ose mund të mos kenë atë kuptim që u jap unë. Edhe kjo është e mundur. Megjithatë ndikimi i gabimit sistematik në qoftë se është gabim më bën të besoj se një rrymë e dyfishtë rrjedh në venat e mia, rryma greke ardhur nga nëna dhe rryma arabe ardhur nga babai është pozitive dhe pjellore. Ajo më jep forcë, gëzim e pasuri. Përpjekja për të bërë sintezën e këtyre vrulleve të kundërta, i jep jetës sime një qëllim dhe një tërësi. Duke u nisur nga çasti ku parandjenja e turbullt u bë tek unë realitet, bota e dukshme që më rrethon është vënë në rregull, jeta ime e brendshme dhe e jashtme, duke gjetur rrënjët e dyfishta stërgjyshore, janë pajtuar. Kështu pas shumë vitesh, armiqësia e fshehtë që unë ndjeja ndaj babait tim pas vdekjes së tij, u kthye në dashuri.

BABAI

Babai im fliste pak, nuk qeshte, nuk grindej. Ndonjëherë, vetëm kërciste dhëmbët ose shtrëngonte grushtat, e përdridhte gishtat, sikur shtrëngonte e mbante një bajame të fortë dhe e bënte thërrime. Një ditë pa një aga t'i shalonte një të krishteri një samar dhe ta ngarkonte si gomar: U tërbua nga zemërimi dhe u vërsul mbi Turkun. Donte ta shante, por buzët e tij u mbyllën e ai nuk mundi të shqiptonte asnjë fjalë. Filloi të hingëllinte si kalë. Unë isha atje, përpara tij, dhe e shikoja. Isha akoma fëmijë dhe më kapi tmerri. Një ditë në drekë, kur kthehej në shtëpi për të ngrënë, dëgjoi, në një rrugicë ku po kalonte, gra që ulërinin, porta që mbylleshin: Një turk i dehur kishte nxjerrë jataganin dhe gjuante mbi të krishterët. Sapo pa babanë tim u hodh mbi të. Bënte shumë vapë dhe babai i lodhur nga puna, nuk kishte qejf të grindej. Pati një mendim të kthehej në një rrugicë e të largohej, askush nuk do ta shihte por pati turp. Hoqi përparësen, shtrëngoi grushtin dhe në momentin kur turku ngriti jataganin mbi kokën e tij, ai i dha një grusht në bark dhe e hodhi për tokë. U përkul, i mori atij jataganin dhe u nis për në shtëpi. Nëna i dha një këmishë për t'u ndërruar, sepse ajo që kishte ishte me djersë. Unë qëndroja ulur në kanape, duhet të kem qenë tre vjeç, dhe shikoja trupin e tij të mbuluar me qime tek rrinte e pinte duhan. Pasi u ndërrua e u freskua, hodhi jataganin mbi kanape pranë meje. Pastaj u kthye nga e shoqja: Kur djali të jetë rritur, i thotë asaj, e të shkojë në shkollë do t'ia japësh për të mprehur lapsat.

Nuk më kujtohet të më ketë thënë ndonjëherë një fjalë të dhembshur. Vetëm një herë, në kohën e revolucionit, kur ne ishim në Naksos e unë shkoja në shkollën franceze, tek etërit katolikë. Na bënë provim e unë mora një çmim me shumë libra me lidhje të praruara. Unë nuk mund t'i mbaja vetëm të gjitha ato. Gjysmat i mori babai dhe ne u kthyem në shtëpi. Gjatë gjithë rrugës nuk i shtrëngoi dhëm-

bët. Përpiqej ta fshihte gëzimin që shihte fëmijën që nuk i ngjante atij. Vetëm duke hyrë në shtëpi më tha me një farë dhimshurie pa më parë:

- Ti nuk e turpërove Kretën.

Por përnjëherë u nxeh me vetvehten, sepse e kishte tradhëtuar, dhe tregoi se ishte prekur. Gjatë gjithë mbrëmjes qëndroi i ngrysur dhe nuk m'i hodhi sytë asnjëherë.

Prania e tij ishte e rëndë, e padurueshme kur ndodhte që ne të kishim vizitorë në shtëpi, të afërm apo gjitonë e ata të ishin duke bërë muhabet apo duke qeshur, në qoftë se hapej porta e hynte ai, biseda apo të qeshurit ndërpriteshin menjëherë dhe shtëpinë e mbulonte hija. Ai përshëndeste me gjysmë zëri, ulej në vendin e tij të zakonshëm, në qoshe të kanapesë, te dritarja nga ana e oborrit, ulte sytë, nxirrte kutinë e duhanit dhe dridhte një cigare në qetësi.

Vizitorët kolliteshin, shikonin njëri - tjetrin fshehtas të shqetësuar, pastaj pa zhurmë ngriheshin, ecnin në majë të gishtave dhe iknin.

Ai i urrente priftërinjtë. Kur takonte ndonjë në rrugë, bënte kryq për të shmangur fatin e keq që ta takonte, dhe kur prifti i tmerruar e përshëndeste:

- Tungjatjeta kapedan Mihal! - Ai i përgjigjej: - Më mirë më jep mallkimin tënd!

Nuk kishte shkuar kurrë në meshë për të mos parë priftërinjtë. Vetëm pas meshës, çdo të diel, kur të gjithë kishin ikur, ai futej në kishë dhe ndizte një qiri përpara ikonës mrekulluese të shën Minait. E adhuronte shën Minanë më shumë se Krishtin e shën Marinë sepse ishte kapedan i Megalo Kastros. Zemra e tij ishte e ngurtë, e pangushëllueshme. Përse? Ai ishte i fuqishëm, punët i shkonin mirë dhe s'kishte arsye të ankohej as për gruan e as për fëmijët. Njerëzit e respektonin. Disa, më të këqinjtë, ngriheshin në këmbë kur kalonte, vendosnin dorën në gjoks dhe shqiptonin emrin e tij. Kapedan Mihalin, për pashkë, e ftoi mitropoliti në kryepeshkopatë, ndërkohë kishte ftuar dhe njerëz të tjerë të shquar, e u shërben kafe, një copë ëmbëlsirë pashke dhe një vezë të kuqe. Për festën e shën Minait, më 11 Nëntor, kur procesioni kalonte përpara shtëpisë së tij, ai qëndronte në këmbë mbi prag dhe lutej. Megjithatë zemra e tij nuk ishte e qetë. - Përse nuk të qesh buza kurrë kapedan Mihal? - pyeti një ditë kapedan

Elie nga Mesara. - Sepse korbi është i zi, kapedan Elie - iu përgjigj babai. Pështyu bishtin e cigares që po e kafshonte. Një ditë tjetër unë e dëgjova t'i thotë ikonës së shën Minait: - Babanë tim duhet të shikosh, jo mua, një gogol të vërtetë. Ç'jam unë përpara tij? Një mbeturinë. Në revolucionin e 1878, megjithëse shumë i plakur, i verbër, ai mori armën dhe doli malit për të luftuar. Por turqit e rrethuan, e kapën me lak dhe e therën në portën e manastirit, ku e ruanin murgjit, në mënyrë të shkëlqyer, duke e lyer me vaj kandili, të bekuar. Koka e tij kishte të çara të thella të goditjeve me shpatë.

- Si ishte gjyshi im? - pyeta një ditë nënën. - Si babai yt, m'u përgjigj, bile më i zymtë.

- Ç'bënte ai?

- Luftë.

- E kur nuk kishte luftë?

- Thithte çibukun e madh duke shikuar malet.

Ndërsa unë, që isha i ri dhe shumë këmbëngulës e pyeta përsëri: A shkonte në kishë?

- Jo! Por çdo ditë të parë të muajit ai merrte një prift në shtëpi dhe i thoshte atij të lutej që Kreta të merrte armët. Pa punë, atij i prishej gjaku. Një ditë që mori në dorë më shumë armë se herët e tjera unë e pyeta. - Nuk ke frikë nga vdekja, baba? Por ai nuk m'u përgjigj e as u kthye të më shihte.

Kur isha më i madh, unë doja ta pyesja përsëri nënën: - I donte gratë? Por më erdhi turp e unë nuk e mësova kurrë të vërtetën. Po duhet t'i ketë dashur sepse kur vdiq e hapën baulen e tij, gjetën një jastëk plot me gërsheta ngjyrë gështenje e të zeza.

NËNA

Nëna ime ishte një grua e shenjtë. Si ka mundur vallë, gjatë pesëdhjetë vjetëve të ndjejë aq pranë frymëmarrjen dhe erën e luaniť, pa i plasur zemra? Ajo kishte durimin, qëndresën dhe ngrohtësinë e tokës. Gjithë stërgjyshërit e mi nga ana e nënës kanë qenë fshatarë, të përkulur mbi tokë e të lidhur fort me të.

Këmbët, duart, shpirti i tyre ishin plot e përplotë me tokë. Ata e donin dheun dhe mbi të ngrinin gjithë shpresat. Brez pas brezi kishin të bënin vetëm me të. Gjatë periudhës së thatësirës vuanin së bashku nga etja, si korbat. Kur binin shirat e parë, kockat e tyre kërcisnin dhe fryheshin si burimet. Kur çanin thellë me plorë barkun e tokës, përjetonin në gjoks dhe në kofshë, natën e parë kur kishin fjetur me gratë e tyre.

Dy herë në vit, për pashkë e për vitin e ri, gjyshi im nga nëna, e linte fshatin e tij të largët, e vinte në Megalo Kastro për të parë vajzën e fëmijët e saj. Para se të trokiste në portë ai rregullohej dhe çtendosej kur mësonte se dhëndri i tij bishë nuk gjendej në shtëpi. Ishte një plak krenar, me flokë të bardhë që nuk i priste kurrë, me sy blu e të qeshur, me duart e mëdha e të rënda gjithë kallo. Më hidhte dorën me përkëdheli dhe mua prej saj më gërvishtej lëkura. Për të dielat, mbante pantallona të gjera blu të çelëta, çizme të zeza dhe një shami të bardhë me pika blu. Sillte mbështjellë me gjethe limoni, po të njëjtën dhuratë: një derrkuc të pjekur në furrë. Qeshte, zbulonte dhuratën dhe shtëpia mbushej me aromë.

Që kur këto dy erëra u bënë një, unë nuk mund të ndieja më erën e mishit të derrit të pjekur dhe as të hyja më në një kopsht me limona, pa ndjerë në shpirtin tim kujtimin e gjyshit, të qeshur, me derrkucin e tij të pjekur në dorë. Për këtë jam i gëzuar, sepse aq sa do të jetoj unë edhe ai do të jetojë tek unë; se e di që askush tjetër në botë nuk kujtohet më për të. Ne do të vdesim së bashku. Ky

gjysh qe i pari që më bëri të mos dua të vdes dhe që të vdekurit e mi të mos vdesin. Edhe pse shumë nga të dashurit e mi kanë vdekur, ata nuk janë futur në tokë por në kujtesën time dhe unë e di sesa të jetojë unë do të jetojnë edhe ata.

Më kujtohet ai dhe zemra ime forcohet duke i bërë sfidë vdekjes. Unë nuk kam takuar ndonjë burrë fytyra e të cilit të rrezatojë një shkëlqim të tillë, të qetë e të këndshëm si drita e një llampe. Herën e parë që e pashë kur hyri në shtëpi lëshova një klithmë: ashtu me pantallonat e tij të gjera, rripin e kuq, fytyrën e çelur, ai ishte si një gjysh triton (qënie mitologjike me fytyrë njeriu e me trup peshku) si një shpirt i tokës që sapo ka dalë me mundim në kopshte dhe ndjen barin e lagur.

Nxirrte nga këmisha një qeskë duhani prej lëkure, dridhte një cigare, merrte strallin dhe eshkën, ndizte cigaren qetësisht dhe e pinte duke parë gjithë gëzim, vajzën, fëmijët e saj të vegjël, shtëpinë. Kohë pas kohe shtrëngonte dhëmbët, fliste për pelën që e kishte lënë poshtë shtëpisë, për shirat, për breshërin, për lepujt që shtoheshin e që i prishnin perimet. Unë, ulur në prehërin e tij, i hidhja një dorë rreth qafës dhe e dëgjoja. Një botë e panjohur shpalosej në shpirtin tim, një botë e madhe, dhe unë kthehesha vetë në një lepur e dilja fshehuraz në oborrin e gjyshit për të ngrënë lakra.

Nëna e pyeste për njërin e për tjetrin në fshat. Si shkonte, a jetonte akoma, dhe gjyshi i përgjigjej se ai ishte i fortë si një shkozë e vazhdonte të bënte fëmijë, një tjetër kishte vdekur, njëri kishte ikur, se Zoti gjithnjë të shikonte. Ai fliste për vdekjen si për fëmijërinë, qetë, me të njëjtin zë që fliste për lakrat dhe për lepujt. Thoshte: kaq e kishte, vajzë, ne e varrosëm.

I vendosëm një portokalle në dorë për t'ia dhënë vdekjes. I dhamë porosi për njerëzit tanë në botën tjetër; gjithçka kaloi mirë, lavdi Zotit.

Vazhdonte të pinte duhan duke e nxjerrë tymin nga hundët dhe qeshte.

Kishte disa vite që i kishte vdekur e shoqja, dhe sa herë që gjyshi vinte në shtëpi e fillonte të fliste për të, sytë i mbusheshin me lot. E donte më shumë se fushat, më shumë se pelën dhe e respektonte. Ishte i varfër kur qe martuar por ai thoshte me kujdes: - Nuk është

ndonjë problem të jesh i varfër, mjafton të kesh grua të mirë. Atëherë në Kretë kishte një zakon që, kur burri kthehej nga fusha në mbrëmje, gruaja i vinte një legen me ujë të ngrohtë dhe i lante këmbët. Një mbrëmje gjyshi kthehet i lodhur nga puna, ulet në oborr. Gruaja vjen me një legen me ujë të ngrohtë, ulet në gjunjë përpara tij dhe afron duart për t'i larë këmbët mbuluar me pluhur. Gjyshi e shikon me dhimbshuri. Pa duart e saj të brejtura e gjithë plasaritje nga punët e përditshme të shtëpisë, flokët që kishin filluar t'i zbardheshin. E plakën hallet - mendoi. Flokët e saj u zbardhën midis duarve të mia dhe ndjej keqardhje për të. I jep një shqelm legenit dhe e përmbysi.

Duke filluar që sot, i thotë gruas, ti nuk do të më lash më këmbët. Ti nuk je shërbëtorja ime; por je gruaja dhe zonja ime.

Një ditë unë e dëgjova të thotë: - Zot fale shpirtin e saj; ajo asnjëherë nuk më ka bërë të vuaj. Vetëm një herë... heshti për pak, psherëtiu, e pas një çasti tha: çdo mbrëmje, ajo dilte te pragu e priste që të kthehesha unë nga fushat; vraponte, më hiqte veglat nga supi për të më lehtësuar... Por një mbrëmje harroi, nuk vrapoi; mua m'u thye zemra.

Ai bëri kryq. - Zoti është i madh, - pëshpëriti, - tek ai janë shpresat e mia. Ai do të jetë i mëshirshëm.

Sytë filluan t'i ndriçojnë, shikoi nënën time dhe buzëqeshi.

- Nuk të vjen keq, gjysh, i thashë një ditë tjetër, që vret gicat dhe na i sjell ne për të ngrënë?

- Më vjen bir, dhe zoti e di këtë, por këto kafshë janë aq të mira sa... - m'u përgjigj duke shpërthyer në të qeshurën e zakonshme.

Sa herë kujtoj atë plak me buzë ngjyrë trëndafili, më shtohet besimi te toka dhe te përpjekjet e njerëzve mbi tokë. Ai ishte një nga kolonat që mbajnë tokën mbi supe dhe nuk e lënë të bjerë.

Vetëm im atë nuk donte të kishte të bënte me të. Atij nuk i pëlqente ta shihte që të vinte në shtëpi e të fliste me djalin e tij. Trembej se mos më bënte si veten. Për pashkë e për vitin e ri, në tavolinë, ai nuk e zgjaste dorën për të prekur mishin e gicit të pjekur dhe nga era e tij i vinte për të vjellë. Ngrihej nga tavolina me nxitim dhe shkonte të pinte duhan për të larguar erën e keqe e nuk fliste. Vetëm një herë, pasi u nis gjyshi, rrudhi vetullat:

- Pff, sy blu! - Pëshpëriti me përbuzje.

Më vonë mësova se sytë blu, babait nuk i pëlqenin më shumë se çdo gjë tjetër në botë.

- Djalli, - thoshte, - ka sy blu e flokë të kuq.

Kur babai nuk ishte në shtëpi, çfarë qetësie, sa shpejt kalonin orët, sa lumturi kishte në kopshtin e vogël e të mbyllur të oborrit tonë! Pjergulla mbi pus, në cep të oborrit një mimozë e madhe që kundërmonte erë, rreth e rreth vazo me borzilok, karafila Indie, jasemin Arabie; ndërsa nëna ulur përpara dritares thurte çorape, pastronte zarzavate, krihte motrën time të vogël, ose e mësonte atë të ecte... Unë, i ulur mbi një stol e shikoja, dëgjoja njerëzit që kalonin përpara portës së mbyllur, thithja parfumin e jaseminit e të tokës së lagur. Bota hynte në trupin tim. Kockat e kokës kërcisnin, hapeshin që të mund t'i nxinin të gjitha.

Orët që kaloja me nënën ishin të mbushura me mister. Ne rrinim ulur përballë njëri-tjetrit, ajo mbi një karrige pranë dritares, unë mbi stolin tim. Në atë qetësi ndjeja se si mbushej gjoksi dhe rëndohej nga pesha sikur ajri midis nesh të ishte qumështi që unë pija.

Mimoza qëndronte mbi kokat tona dhe kur ajo ishte në lulëzim, oborri kundërmonte. I doja shumë lulet e saj gjithë erë, ndërsa nëna i vendoste në baule dhe këmishët tona, çarçafët tanë, gjithë fëmijëria ime mbante aromë mimoze. Ne bisedonim për probleme të ndryshme me fjalë të qeta. Shpesh herë nëna më fliste për babanë e saj, për fshatin ku unë kisha lindur, nganjëherë unë i tregoja për jetën e shenjtorëve që kisha lexuar dhe që e zbukuroja me imagjinatën time. Vuajtjet e tyre nuk më mjaftonin por shtoja edhe të tjera, aq sa nëna fillonte të qante; Më vinte keq për të, i ulesha te gjunjët, i përkëdhelja flokët dhe e ngushëlloja.

- Ata kanë shkuar në parajsë moj nënë, mos u hidhëro, shëtisin nën pemë, bisedojnë me engjëjt dhe i kanë harruar torturat. Çdo të diel ata vishen me rroba të arta, kapuçë të kuq me xhufka dhe shkojnë te Zoti. Nëna fshinte lotët, më shihte sikur donte të më thoshte: Me të vërtetë? Dhe buzëqeshte.

Nga kafazi, kanarina, frynte pak grykën dhe fillonte të këndonte gjithë gëzim sikur kishte zbritur nga Parajsa, kishte lënë për pak kohë shenjtorët dhe kishte zbritur në tokë për të lumturuar pak njerëzit.

Nëna, mimoza e kanarina ishin bërë një e të pandara, të ndezuara

në shpirtin tim. Unë nuk mund t'i vija erë një mimoze, të dëgjoja një kanarinë, pa m'u ringjallur në kujtesën time në thellësinë e shpirtit tim, nëna e përzier me këtë parfum dhe e shkrirë në këtë këngë.

Nuk e kisha parë asnjëherë nënën time të qeshte. Ajo i shikonte dhe u buzëqeshte njerëzve vetëm me sytë e zinj, pak të futur, plot kujdes e mirësi. Shkonte e vinte nëpër shtëpi si një shpirt i mirë, bënte të gjitha punët pa zhurmë, sikur duart e saj kishin një forcë magjike e mirëbërëse që sundonte me dashamirësi mbi nevojat e përditshme, ndofta ishte nimfa për të cilën flasin tregimet, dhe imagjinata fillon të punojë në mendjen time prej fëmije: Një natë, babai, duke kaluar pranë lumit, e kishte parë te kërcente nën dritën e hënës, i ishte hedhur, i kishte hequr shaminë nga koka, e kishte çuar në shtëpi dhe e mori për grua. Tani, gjatë gjithë ditës, nëna rrotullohej nëpër shtëpi dhe kërkonte shaminë e saj të kokës për ta vendosur mbi flokë, të bëhej përsëri nimfë e të ikte. E shihja tek ecte, duke hapur dollapët dhe sëndukët, duke zbuluar qypat, tek ulej për të parë nën krevat e që dridhej se s'po gjente shaminë magjike të kokës e nuk mund të bëhej më e padukshme. Kjo frikë zgjati disa vite dhe e plagosi rëndë shpirtin tim të ri: Akoma edhe sot ka ngelur tek unë diçka nga ajo frikë, por më pak e dukshme. Akoma shikoj me shqetësim e ankth çdo krijesë të dashur, dhe çdo gjë të dashur, sepse unë e di që ato kërkojnë shaminë e tyre të kokës për t'u larguar.

Më kujtohet se vetëm një herë e kam parë nënën, me sytë që shkëlqenin nga një dritë e pazakontë, të qeshur e të gëzuar, si para martesës kur ishte e fejuar. Një një Maj ne kishim shkuar në një fshat, Fodele, plot me burime e me pemishte portokallesh; babai duhej të ishte kumbarë në një pagëzim. Përnjëherë shpërtheu një stuhi. Qielli kthehet në një masë uji që zbrazej mbi tokën që gurgullonte dhe hapej duke futur ujërat mashkullore të qiellit në thellësi të gjirit të saj.

Të parët e fshatit ishin mbledhur me gratë e vajzat e tyre në dhomën e madhe të miqve. Shiu dhe drita e fortë e vetëtimave hynin nga të çarat e portës e të dritareve. Ajri dhe toka mbante erë portokalle... Pjatat, rakia, verërat dhe ushqimet dridheshin mbi tavolina, filloi të binte nata. U ndezën qirinjtë. Burrat u gëzuan, gratë që gjatë gjithë kohës i mbanin sytë poshtë filluan t'i ngrinin e të kakaris-

nin si thëllëza. Jashtë, Zoti vazhdonte të gjëmonte, vetëtimat shtoheshin, rrugicat e ngushta të fshatit ishin kthyer në përrenj, gurët rrokulliseshin duke shpërthyer me të qeshura, vetë Zoti ishte bërë rrebesh dhe përqafonte, ujiste, fekondonte tokën.

Babai u kthye nga nëna; ishte hera e parë që e pashë ta shohë me dhimbshuri, për herë të parë zëri i tij ishte i butë: - Marie, i thotë, këndo!

Ai i jepte leje kështu, të këndonte përpara aq shumë burrave. Ajo u çua e tronditur. Nuk e di përse isha mjaft i nxehur. U bëra gati të vrapoja për ta mbrojtur. Por babai më preku supin me gisht dhe më uli. Nëna m'u duk tjetër njeri. Fytyra i shkëlqente sikur e rrethonin gjithë shirat dhe vetëtimat. Ngriti kokën dhe m'u duk se flokët e saj pis të zinj menjëherë u zgjidhën duke i mbuluar supet e zbritën deri në ije. Ajo filloi të këndojë... Çfarë zëri! I trashë, i ngrohtë, pak i vrarë e plot pasion. Mbyllte sytë përgjysmë, shikonte babanë dhe këndonte në distik dyvargësh që nuk do ta harroj kurrë. Atëherë nuk e kuptova përse këndoi, për cilin këndoi; më vonë kur u rrita, unë e kuptova. Ajo këndonte me zërin e saj të ngrohtë, plot pasion të përmbajtur dhe shikonte babanë:

"Unë marrosem kur shkon ti
Rrugët pa mbuluar me lule janë,
Do bëhesh shqiponjë e madhe ti
Me krahët e tu të artë."

Ktheva sytë e nuk doja të shikoja më as babanë e as nënën. Shkova te dritarja e mbështeta ballin në xham. Shikoja shiun që binte e gërryente tokën.

Rrebeshi zgjati gjithë ditën. Erdhi nata dhe bota jashtë shtëpisë u errësua. Toka dhe qielli u ngatërruan dhe u bënë të baltët si njëri dhe tjetri. U ndezën qirinj të tjerë e të gjithë u ngjeshën pas murit. U hoqën tryezat dhe stolat për të krijuar një vend të lirë. Do të kërcenin të gjithë, të rinj, të reja, pleq. Violinisti u ul mbi një stol të lartë, në mes të dhomës. Nxori harkun si shpatë, pështëriti nëpër dhëmbë një dyvargësh dhe filloi të luajë. Këmbët u elektrizuan dhe trupat u drodhën. Gra e burra u panë me njëri tjetrin e u sulën. Ajo

që udhëhiqte vallen ishte një grua e zbehtë, e hollë, rreth të dyzetave, me buzët ngjyrë portokalli të bëra nga fërkimi me gjethe arre, flokët pis të zesë që vaji i dafinës i bënte të shkëlqenin. Unë u ktheva, e pashë dhe u tremba. Sytë e saj me rrathë blu të errët dhe të futur thellë midis rrathëve, ndriçonin - ose më mirë jo. Ata dy sy të errët nuk ndriçonin: ata digjnin. Në një moment m'u duk se ajo po më shihte. U kapa pas përparëses së nënës. Më dukej se ajo grua donte të më merrte me vete e të ikte...

- Bravo, Surmelina! - Thirri një plak shumë i fortë, që mbante mjekër të vogël. U hodh përpara saj, i hoqi shaminë nga koka e zezë, duke i dhënë njërin cep të saj gruas që kërcente, ndërsa cepin tjetër e mbante vetë, e kështu të dy, në ekstazë, me kokën lart, me trup të tendosur u lëshuan në valle.

Gruaja mbante këpucë druri me të cilat godiste fort mbi dysheme. I përplaste me njëra-tjetrën, aq sa gjithë shtëpia tronditej.

Shamia e bardhë iu zgjidh dhe varëset e rruazat që mbante në gushë iu zbuluan. Hundët i fërgëllonin, thithnin ajrin me forcë, nuhasnin erën e burrave përreth. Ajo përkulej, rrotullohej rreth vetes, bënte sikur do të binte mbi burrin që gjendej përpara saj, por me shpejtësi përdridhte belin e ijet e befas nuk gjendej më përpara tij. Valltari hingëllinte si kalë, e kapte në fluturim, e shtrëngonte pranë vetes, ajo i shpëtonte. Ata luanin, ndiqnin njëri-tjetrin. Shiu dhe vetëtimat mbaruan. Bota qe vithisur dhe prej saj nuk kishte ngelur asgjë pas kaosit, veç asaj gruaje, Surmelina, që vallëzonte. Violinisti nuk mund të qëndronte më ulur mbi stol. U çua me një kërcim të beftë. Harku shpërtheu. Ai nuk mund ta komandonte më, veç të ndiqte hapat e Surmelinës, violina, rënkonte e ulërinte si një qënie njerëzore.

Fytyra e plakut ishte skuqur dhe egërsuar. Ai shikonte gruan. Buzët i dridheshin dhe mua më dukej sikur do të hidhej me tërsëllimë mbi të e do ta bënte thërrime. Violinisti sikur e kuptoi këtë dhe harku i tij u ndal menjëherë. Vallja pushoi. Të dy valltarët ngelën me njërën këmbë në ajër pa lëvizur. Djersa u rridhte çurg. Burrat u çuan, muarën plakun dhe e fërkuan me raki. Gratë rrethuan Surmelinën, që të mos e shihnin burrat. Unë u futa midis tyre sepse akoma s'isha bërë burrë e ato nuk më penguan.

I hapën jelekun, i spërkatën gushën, gjoksin e tëmthat me ujin e luleve të portokalleve. Ajo kishte mbyllur sytë dhe buzëqeshte.

Pas vallëzimit, Surmelina dhe frika ishin bashkuar tek unë e qenë bërë një: vallja, gruaja dhe vdekja. Dyzet vjet më vonë, në Tiflis, mbi tarracën e lartë të hotelit *Orjeu*, një indiane u çua për të vallëzuar. Yjet vezullonin mbi të. As tarraca dhe as dhjetë burrat që gjendeshin atje nuk ndriçoheshin dhe indiania nuk shikonte veç zjarret e vegjël të kuq të cigareve të tyre. Mbushur me byzylykë, me vathë, me gurë të çmuar, me unaza të florinjta, gruaja vallëzonte ngadalë, me një tmerr mistik, sikur vallëzonte buzë një gremine ku gjendej Zoti dhe luante me të, i afrohej, i largohej, e provokonte duke dredhur gjithë trupin, sikur të kishte frikë. Nganjëherë qëndronte e palëvizur dhe vetëm dy krahët e saj, si dy gjarpërinj, rrotulloheshin e ngatërroheshin këndshëm në ajër. Zjarret e vegjël të kuq u shuan. Në thellësinë e natës nuk ngeli tjetër veç asaj gruaje që vallëzonte dhe yjet sipër saj. Ata vallëzonin së bashku me të, ashtu të palëvizur. Ne mbajtëm frymën. Përnjëherë frika u largua nga unë: Nuk ishte një grua që vallëzonte buzë greminës, ishte shpirti ynë që luante me vdekjen lojën e dashurisë.

DJALI

Gjithçka që ka rënë në shpirtin tim prej fëmije është stampuar fort e thellë në të, sepse unë i kam pranuar me lakmi e pangopësi dhe tani që jam plak më ringjallen në shpirt e unë i jetoj përsëri. Më kujtohen me një saktësi të pagabueshme kontaktet e mia të para me detin, zjarrin, gruan, parfumet e botës.

Kujtimi i parë që kam nga jeta ime është ky: ecja këmbadoras te pragu; nuk rrija dot në këmbë akoma; plot pasion, plot frikë nxora kokën delikate në ajrin e lirë të oborrit. Deri atë çast kisha shikuar prapa xhamave të dritares, por nuk kisha parë gjë. Në këtë çast, unë pashë botën për herë të parë. Pamje trullosëse. Kopshti i vogël i oborrit m'u duk i pafund; një zukamë e mijëra bletëve të padukshme, një parfum që të dehte, një diell i ngrohtë, i trashë si mjaltë; ajri shkëlqente sikur ishte mbushur me shpata dhe midis shpatave lëviznin duke ardhur drejt meje insekte me krahë shumëngjyrësh e të palëvizshëm, që rrinin pezull si engjëj. Unë u tremba, lëshova një klithmë, sytë m'u mbushën me lot dhe bota u zhduk.

Më kujtohet se një ditë tjetër, një burrë me një mjekër të shprishur më mori në krahë dhe më çoi deri te porta duke më ngritur lart. Sa më tepër i afroheshim asaj, dëgjoja një kafshë që hungërinte e rënkonte, sikur kërcënonte, sikur ishte e plagosur. Kisha frikë e përpëlitesha në krahët e atij burri, doja të zbrisja nga ai e çuçurisja si zog. Përnjëherë u ndie një aromë çiçibanozi, që të digjte fytin, si erë zifti e qitroje të kalbur. Gjithë qënia ime thithte këtë erë e dridhej. Unë përpiqesha duke hedhur shqelma në krahët leshtorë që më mbanin, dhe atje në kthesën e rrugës, çfarë përbindëshi, çfarë freskie, çfarë psherëtime e pafund - deti, me blunë e tij të thellë, që uturinte, plot zëra e parfume, hyri në qënien time shkumëzues. Têmthat e mi të brishtë u shkallmuan e koka m'u mbush me të qeshura, me kripë, me frikë.

Më kujtohet, më vonë fqinja jonë Anika; një nënë e re e bardhë e topolake, një nuse. Ajo kishte flokë të gjatë, të verdhë e sy të mëdhenj. Duhet të kem qenë tre vjeç. Një mbrëmje po luaja në oborr. Kopshti i vogël përhapte erën e luleve të verës. Gruaja u përkul, më mori, më uli mbi gjunjë dhe më përqafoi me krahët e saj. Mbylla sytë e iu hodha te gusha e zbuluar. Kur merrja frymë thithja erën e trupit të saj. Një aromë e ngrohtë, e ngjeshur e dendur, një erë e lehtë qumështi e djerse, një avull që dilte nga ky trup i porsamartuar të cilin e thithja i tronditur, qëndronte pezull mbi gojën time të mbyllur. U trullosa, më ra zalia. Fqinja u tremb, më zbriti fare papritur e më vendosi ndërmjet dy vazove me borzilok. Më vonë ajo nuk më mori më në gjunjët e saj; më shikonte me sytë e mëdhenj e të zinj, me shumë dhimbshuri e qeshte.

Një mbrëmje vere, isha ulur përsëri në oborr, mbi stolin tim të vogël. Më kujtohet, kisha ngritur sytë e pashë për herë të parë yjet. Kërceva, klitha plot frikë: - Shkëndija! Shkëndija! Qielli m'u duk si zjarr i pafund ndërsa trupi im i vogël digjte.

Ja si ka qenë kontakti im i parë me tokën, detin, gruan, e qiellin plot yje. Edhe sot akoma, në çastet më të thella të jetës sime, unë i përjetoj me të njëjtin pasion si atëherë kur isha fëmijë, kur u futën për herë të parë në jetën time, këto katër elementë të tmerrshëm e sot sigurisht unë e kuptoj se nuk i jetoj më me thellësi - sa do të kishin dashur shpirti e trupi im, - që të përjetojnë të njëjtën habi, të njëjtën frikë dhe të njëjtin gëzim që më kanë dhënë këto katër elementë, kur isha fëmijë i vogël. Duke qenë forcat e para që kanë zotëruar shpirtin tim në mënyrë të vetëdijëshme, ato janë bashkuar tek unë në mënyrë të pazgjidhshme e janë bërë një. Duket sikur është e njëjta fytyrë që ndryshon vetëm pamjen kur unë shikoj qiellin me yje, ndonjëherë më duket si kopsht me lule, ndonjëherë si det i zymtë e si fytyrë e qetë, mbuluar me lot.

Më shumë akoma: çdo emocion, secila nga idetë e mia, bile edhe më abstraktja, është formuar nga këto katër elementë kryesorë. Problemi më metafizik merr tek unë trajta fizike, nxehtësia që merr deti, toka dhe djersa njerëzore. Fjala, për të ndikuar tek unë, duhet të bëhet mish i ngrohtë. Unë nuk kuptoj veç kur nuhas, shoh e prek.

Jashtë këtyre kontakteve të para, një detaj i rastit ka ndikuar

thellësisht në shpirtin tim. Rastësisht? Shpirti frikacak, i çiltër e i kujdesshëm dridhet kur shqipton me zë të lartë një marrëzi gjithçka që nuk është në gjendje ta zgjidhë e që do ta dërrmonte dinjitetin e tij. Duhej të isha katër vjeç e babai më kishte sjellë për vitin e ri si një mall *të dorës së parë* siç i thonë ne Kretë, një glob që rrotullohej dhe një kanarinë. Unë mbyllja dyert e dritaret e dhomës sime, hapja kafazin dhe e lija kanarinën të lirë. Ajo ishte mësuar të hipte mbi glob e të këndonte. Kjo zgjaste disa orë; mbaja frymën e dëgjoja.

Më duket se ky detaj shumë i thjeshtë ka ndikuar në jetën time më shumë se gjithë librat dhe gjithë njerëzit që kam njohur. Gjatë viteve, duke shëtitur me një dëshirë e pasion të veçantë tokën, duke përshëndetur gjithçka, duke parë gjithçka, mua më dukej se koka ime ishte një glob e se një kanarinë ishte vendosur në majë të kokës sime e këndonte.

Në qoftë se unë tregoj me hollësi vitet e mia të fëmijërisë, këtë nuk e bëj ngaqë magjia e kujtimeve të para është e madhe, por se në këtë moshë, si në ëndrra, një detaj, në dukje i zakonshëm, tregon pa zbukurime, si do të bëjë më vonë një analizë psikologjike, fytyrën e vërtetë të shpirtit. Ngaqë mënyrat e të shprehurit, në moshën fëmijërore, po ashtu si në ëndrra janë shumë të thjeshta, pasuria e brendshme edhe ajo më kompleksja, është e shkarkuar nga veprimet: Ngelet vetëm thelbi.

Shpirti i fëmijës është i njomë, mishi është delikat: Dielli, hëna, shiu, era, qetësia, bien mbi të; ai është një brumë i butë dhe ato e mbrujnë. Fëmija thith me etje të madhe botën, e bën pjesë të qënies së tij, dhe e transformon në fëmijë.

Më kujtohet: Unë rrija shpesh ulur mbi pragun e shtëpisë sonë. Dielli shkëlqente. Në një shtëpi aty pranë shtypnin rrushin për verë e kudo ndjehej aroma e mushtit. Unë mbyllja sytë, i lumtur, shtrija duart e hapura dhe prisja. Zoti do të vijë. Edhe pse unë isha fëmijë, ai asnjëherë s'më ka gënjyer. Ai do të vijë në formën e fëmijës, si unë, dhe do të më vendosë në dorë lodrat e vogla, diellin, hënën dhe erën, - t'i kam bërë dhuratë, - do të më thotë, luaj me to; sigurisht unë kam dhe të tjera.

Hapja sytë. Zoti nuk ishte aty, por unë kisha akoma në duar lodrat e tij.

Pa e ditur as vetë, pa e ditur se pse e jetoja, unë kisha fuqinë e Zotit: Unë e bëja botën sipas mendjes sime, si të doja. Në atë kohë isha një brumë i butë, po ashtu edhe ai ishte një brumë i butë. Nga gjithë frutat, unë pëlqeja qershitë; i hidhja në një kovë me ujë, përkulesha dhe i godisja - të zeza, të kuqe, të forta, zmadhoheshin sapo futeshin në ujë; por kur i nxirrja shihja i zhgënjyer se ato zvogëloheshin përsëri; atëherë mbyllja sytë, për të mos i parë më të vogla dhe i fusja në gojë, të mëdha ashtu si më dukeshin në ujë.

Ky detaj i parëndësishëm tregon përfytyrimin tim për realitetin, bile edhe tani në pleqëri: Unë e riprodhoj atë më me shumë dritë, më të bukur, më në përputhje me idenë time. Shpirti krijon, shpjegon, tregon, proteston, por brenda meje dëgjohet një zë: - Hesht, shpirt, lëre zemrën të lirë - i thotë atij. Çfarë zemre? Substancën e jetës, delirin. E zemra fillon të këndojë. - Ne nuk mund ta ndryshojmë realitetin, - thotë një besimtar bizantin, që unë e pëlqej shumë - ne ndryshojmë vetëm syrin që shikon realitetin. Këtë bëja kur isha fëmijë, këtë bëj edhe sot në çastet më të mira krijuese të jetës sime.

Çfarë mrekullie janë në të vërtetë, syri, veshi, shpirti i fëmijës. Sa me etje e thithin botën për t'u mbushur me të! Bota është një zog me krahë të kuq, të gjelbër, të verdhë, e fëmija bredh për ta kapur!

Me të vërtetë asgjë nuk ngjan aq shumë me syrin e Zotit sa syri i një fëmije, i cili për herë të parë shikon e krijon botën. Bota shumë kohë më parë ishte një kaos. Gjithë krijesat, pemët, njerëzit, gurët, rrjedhin ashtu të përzier e në mënyrë konfuze përpara syrit të fëmijës. Jo përpara tij: brenda tij, gjithë format, ngjyrat, zërat, aromat kalojnë si drita të shumta, e ai nuk mund t'i fiksojë e t'i rregullojë. Bota e fëmijës nuk është bërë nga baltë që mund të rezistojë, por nga ré. Një fllad i freskët fryn në tëmthat e fëmijës dhe bota kondensohet, rrallohet e zhduket. Kështu duhet të ketë kaluar bota përpara syve të Zotit përpara krijimit.

Kur isha fëmijë, unë bëhesha njësh me atë që shihja e prekja; me qiellin, insektin, detin, erën; era atëherë kishte një gjoks, kishte duar që më përkëdhelnin. Ndonjëherë ajo nxehej, më pengonte e nuk më linte të ecja. Ndonjëherë, më hidhte përtokë. Këpuste gjethet

lnqie shamine nga koka fqinjit tonë Dimitri dhe i ngrinte fustanet gruas së tij.

Unë akoma nuk jam ndarë nga bota; por pak nga pak unë do të shkëputem prej saj: Nga njëra anë bota, nga ana tjetër unë; lufta ka filluar.

Një ditë, fëmija, i ulur në pragun e shtëpisë, e shikonte botën turbull, të ngjeshur, si një rrebesh, papritur shikon: të pestë shqisat i janë forcuar, secila përcaktonte rrugën ato po ndanin mbretërinë e botës. Gjëja e parë që m'u forcua ishte shqisa e nuhatjes; Ajo filloi e para të vërë rregull në kaos.

Çdo qënie njerëzore, kur unë isha dy-tre vjeç, kishte një erë, e përpara se të ngrija sytë e ta shihja, unë e njihja nga era që lëshonte. Nëna kishte erën e saj, babai kishte erën e tij, secili nga xhaxhallarët kishte të tijën dhe secili nga fqinjët gjithashtu kishte të tijën. Nga era e secilit varej në më pëlqente të më merrte në krahë ose nuk më pëlqente. Me kalimin e kohës kjo aftësi u dobësua. Erërat u përzjenë. Gjithë burrat u mbytën në të njëjtin kutërbim - të djersës, të duhanit e të rakisë.

Më mirë nga të gjitha, unë dalloja mirë erën e një të krishteri nga ajo e një turku. Përballë shtëpisë sonë banonte një familje turke e mirë. Kur gruaja turke vinte për vizitë në shtëpi, ngaqë era e saj më shkaktonte të vjella, këpusja një degë borziloku, i mbaja erë ose më mirë fusja nga një lëmsh mimoze në secilën hundë. Por turkja Fatime kishte një vajzë të vogël katër vjeçe - unë atëherë duhej të isha tre vjeç - Eminenë: ajo lëshonte një erë të çuditshme, as turke, as greke që më pëlqente shumë. Emineja ishte e bardhë, topolake, me flokë të ndarë në gërsheta të holla dhe në secilën gërshetë varej, për të prishur syrin e keq, një guaskë ose një gur i vogël, blu; pëllëmbët e duarve të saj dhe shputat ishin ngjyer me këna; ajo kishte erën e lëvozhgave të arrës. E dija që nëna e saj nuk ishte në shtëpi; dola atëherë te porta e madhe në rrugë, dhe e pashë të ulur mbi pragun e shtëpisë duke u përtypur. I bëra shenjë se do të shkoja atje, por porta kishte tre shkallë që më dukeshin shumë të larta; si do t'i ngjisja? Ujë në djersë e i gjakosur, pas një lufte pa shpresë arrita të ngjisja të parën, pastaj duhej një luftë tjetër për të arritur të dytën; ndalova

një çast e ligjëta sytë për ta parë, ajo qëndronte e ulur, indiferente, mbi prag e nuk e shtrinte dorën për të më ndihmuar, më shihte pa lëvizur e priste. Dukej sikur më thoshte: - Në qoftë se do të mundesh të kalosh pengesat shumë mirë; ti do të arrish tek unë e ne do të luajmë; në qoftë se ti nuk mundesh, ik! Më në fund, pas një lufte të madhe, unë e arrita pragun ku ajo ishte ulur; atëherë u çua më mori për dore dhe më futi brenda. Gjithë mëngjesin e ëma nuk erdhi, merrej me punët e ditës. Menjëherë hoqëm çorapet, u shtrimë me shpinë për tokë dhe bashkuam shputat e këmbëve të zbathura. Nuk thoshim asnjë fjalë; unë mbylla sytë dhe ndjeja ngrohtësinë e Eminesë të kalonte nga këmbët e saj tek të miat, duke u ngjitur ëmbëlsisht te gjunjët, në bark, në gjoks në të gjithë trupin; provoja një kënaqësi aq të thellë sa më dukej se do të më binte zali... kurrë unë nuk e kam ndjerë aq thellë misterin e ngrohtësisë së trupit femëror. Edhe tani akoma, Pas shtatëdhjetë vjetësh, mbyll sytë dhe ndjej të më ngjitet nga këmbët e të shpërndahet në gjithë trupin, në gjithë shpirtin, ngrohtësia e Eminesë. Pak nga pak unë nuk kisha më frikë të ecja e të ngjisja shkallët; hyja në shtëpitë përreth, luaja me fëmijët e fqinjëve; dhe bota bëhej më e madhe.

Kur isha pesë vjeç më çuan te një mësuese që të më mësonte të bëja mbi rrasa rrathë dhe grepa, për të mësuar gishtat, që kur të rritesha edhe ca të mund të bëja gërmat e alfabetit. Ishte një grua mjaft e shkurtër, pak gungaçe që e thërrisnin zonja Areti: Topolake e vogël, me një *kokërr* në anën e djathtë të mjekrës. Ajo mbante dorën time, fryma i mbante era kafe, dhe më shpjegonte si duhej të mbaja shkumësin duke më drejtuar gishtat.

Në fillim unë nuk e doja fare atë, fryma e saj nuk më pëlqente, as gunga e saj, por pak nga pak, nuk e di se si ajo u transformua përpara syve të mi, kokrra nga mjekra iu zhduk, shpina iu drejtua, trupi i saj i qullët u tendos.

Pas disa javësh ajo u bë një engjëll i hollë, veshur me *tunikë* të bardhë që mbante një trompetë të madhe bronzi. Këtë engjëll, unë doja ta shihja në ikonat e kishës së shën Minait, e syri i fëmijës e bëri mrekullinë e tij: Engjëlli dhe zonja mësuese u bënë një.

Vitet kaluan. Unë lëviza nëpër vende të ndryshme të botës dhe u ktheva përsëri në Kretë. Kalova përpara shtëpisë së mësueses si-

me; një plakë e imët qëndronte ulur mbi pragun e shtëpisë dhe ngrohej në diell; unë e njoha nga *kokrra* që kishte në mjekër. Iu afrova dhe ajo më njohu. Filloi të qajë nga gëzimi. I dhurova kafe, sheqer dhe një kuti me llokume. Hezitova një çast. Nuk guxoja ta pyesja; por imazhi i engjëllit me trompetë ishte kaq i gjallë tek unë sa nuk mund të rrija pa e pyetur.

- Zonja Areti, i thashë, ke mbajtur ndonjëherë një tunike të bardhë e një trompetë të madhe bronzi?

- Zot i Madh! thirri, plaka e gjorë, duke bërë kryqin, unë të mbaj tunike të bardhë biri im? Një trompetë, unë? O zot! Unë zonjë e madhe? dhe filloi të qajë.

Në trurin tim fëmijëror, çdo gjë rimodelohej si një fenomen i magjishëm, larg logjikës e më pranë kllapisë e ëndërrimit. Ky delir është kokrra e kripës që e ruan gjykimin nga kalbja. Unë jetoja, flisja, lëvizja, midis një legjende që krijoja çdo çast, duke hapur midis saj rrugën ku do të kaloja. Unë nuk shikoja kurrë dy herë të njëjtën gjë, sepse po aq herë do t'i jepja një fytyrë të re që do ta bënte të panjohur. Virgjëria e botës përtërihej çdo çast.

Disa fruta ushtronin mbi mua një magji të pashpjegueshme, por mbi të gjitha qershitë dhe fiqtë. Jo frutat e fikut, por gjethet dhe era e tyre. Unë mbyllja sytë dhe zbehesha nën efektin e një kënaqësie të madhe fizike. Ose më shumë se një kënaqësi ishte një turbullim, një frikë, një dridhje, sikur hyja në një pyll te errët e të rrezikshëm.

Një ditë nëna më mori me vete dhe më shpuri në një kënd të gjerë në bregdet, jashtë Megalo Kastros, ku laheshin gratë. Koka m'u mbush me një det të pafund që gufonte; midis asaj bluje, dukeshin trupa të përqafuar shumë të zbehtë, të hollë, të çuditshëm, sa më dukeshin si të sëmurë. Ata lëshonin klithma të shkurtra dhe zhyteshin me krahë në ujë. Shpesh u shihja edhe trupin. I imagjinoja se duhej të ishin ato që quheshin sirena. Më kujtohej legjenda që më tregonte gjyshja që fliste për sirenën, motrën e Aleksandrit të Madh: ajo bridhte nëpër dete duke kërkuar të vëllanë dhe pyeste anijet që kalonin: - A jeton mbreti Aleksandër? Padroni i anijes përkulej mbi bord dhe i thërriste: - Ai jeton zonjë, jeton dhe është shumë mirë me shëndet! Por mbi atë që thoshte ka vdekur binte fatkeqësia: sirena godiste detin me bisht dhe ngrihej një stuhi e fuqishme

që shkatërronte anijet.

Njëra nga sirenat që notonte para meje u çua nga uji e më bëri shenjë. Më foli diçka por s'e dëgjova, sepse s'e linte zhurma e detit. Unë jetoja legjendën dhe besoja se ajo më pyeti për të vëllanë dhe thirra i tronditur: - Ai është gjallë e mirë me shëndet! Papritur sirenat shpërthyen në të qeshura e mua më erdhi aq turp sa u mërzita dhe ika me vrap; E marrtë dreqi, pështpërisja, ato ishin gra, nuk ishin sirena! U ula, gjithë turp, mbi një gur të vogël me shpinën kthyer nga deti.

Falë Zotit ky përfytyrim fëminor, i freskët, plot tinguj dhe ngjyra jeton akoma tek unë. Është ky që e ruan shpirtin tim nga shkatërrimi, që nuk e lë të thahet e të shterojë. Është pika e shënjtë e ujit të Juvensës që nuk më lë të vdes. Tani që unë jam shkrimtar e duhet të flas për detin, për gruan, për Zotin, përkulem mbi gjoksin tim dhe dëgjoj seç thotë aty brenda meje fëmija; Ai më dikton fjalët, dhe në qoftë se arrij të përshkruaj me fjalë e të vizatoj këto forca të mëdha, detin, gruan, Zotin, është fëmija që jeton akoma brenda meje. Më duhet të kthehem në fëmijë që të mund të hedh një shikim të virgjër mbi botën e ta shoh gjithmonë për herë të parë.

Në gjakun tim qarkullojnë prindërit e mi, njëri i ashpër, i fortë, që nuk di të qeshë, tjetra e butë, e mirë, e shenjtë. Unë i kam patur me vete gjatë gjithë jetës. Asnjëri prej tyre nuk ka vdekur. Aq sa do të jetoj unë do të jetojnë edhe ata, e do të luftojnë përballë njëri-tjetrit për të qeverisur mendimet e veprimet e mia. Gjithë jetën jam përpjekur për këtë: t'i këshilloj, t'i bëj që njëri të më japë forcën e tij, tjetri dhimbshurinë e tij dhe armiqësia që ekziston ndërmjet tyre e që nuk arrin të shpërthejë tek unë, të kthehet në zemrën e djalit të tyre, në harmoni.

Tek unë ndodh diçka e pabesueshme: prania e prindërve manifestohet në mënyrë të shkëlqyer te duart e mia. Dora ime e djathtë është shumë e fortë, pa ndjeshmëri, shumë burrërore. Dora e majtë është shumë e ndjeshme dhe e pafuqishme. Kur më kujtohet gjoksi i një femre që kam dashur, ndjej të më kalojnë në shputën e dorës së majtë miza, dhe një dhimbje e lehtë. Kur jam vetëm, e shoh ndonjë zog që fluturon nëpër erë, ndjej në dorën e majtë ngrohtësinë e barkut të tij. Pikërisht në duart e mia, prindërit e mi qëndrojnë të

ndarë e të vetmuar. Ata janë vendosur veç e veç, babai në dorën e djathtë, nëna në dorën e majtë.

Duhet të shtoj një detaj që ka ndikuar thellësisht në jetën time: plagosja e parë e shpirtit tim. Edhe pse kanë kaluar shumë vjet e unë jam plakur, ajo nuk është mbyllur akoma. Isha rreth gjashtë vjeç kur një xhaxhai im më mori për dore e shkuam në qimitiron e vogël të shën Mateut, që ishte në qytet, për të parë një fqinj siç më tha ai.

Ishte pranverë. Qimitirua zverdhte nga kamomili. Një kënd i vogël ishte plot me trëndafila prilli. Duhet të ketë qenë mesditë. Dielli kishte ngrohur tokën e prej saj ngrihej një aromë e këndshme bari. Porta e kishës ishte e hapur. Prifti kishte hedhur temjanin në temjatua dhe po vendoste petrailin. Kapërceu pragun dhe u drejtua për nga varret.

- Përse temjatis? - pyeta xhaxhanë dhe duke marrë frymë thellë, ndjeva fort erën e temjanit dhe të tokës. Ishte e ngrohtë, pak e neveritshme si era e hamamit ku më kishte çuar nëna të premten e kaluar.

- Përse temjatis? - pyeta përsëri xhaxhanë që ecte i qetë midis varreve.

- Hesht, vetëm shiko e më ndiq mua.

Shkuam prapa kishës ku dëgjuam se bisedohej. Pesë gjashtë gra veshur me të zeza qëndronin në këmbë rreth një varri. Dy burra ngritën gurin e varrit, ndërsa njëri prej tyre hipi mbi varr dhe filloi të gërmojë. Ne u afruam dhe qëndruam pranë varrit të hapur.

- Çfarë po bëjnë? - pyeta

- Po nxjerrin eshtrat.

- Çfarë eshtrash?

- Do t'i shohësh.

Prifti qëndronte në këmbë sipër varrit. Tundte temjatuan lart e poshtë, ndërsa nën mjekrën e gjatë përshpëriste lutjet.

U përkula mbi varrin e sapohapur. Nga era e mykut dhe e kalbësirës, i mbylla hundët me dorë. Më vinte për të vjellë por nuk largohesha, prisja - kockat, çfarë kockash? - pyesja veten, ndërsa prisja t'i shihja.

Papritur burri që rrinte përkulur dhe gërmonte u çua. Gjysma e

trupit i dilte sipër gropës. Në dorë mbante një kafkë. I nxirrte dheun, fuste gishtat në zgavrat e syve për të nxjerrë baltën; e vendosi në buzë të varrit, u përkul përsëri dhe filloi të gërmojë përsëri.

- Ç'është kjo? - pyeta i trembur xhaxhanë.

- Nuk e shikon? Është koka e të vdekurit, një kafkë.

- E kujt?

- Nuk të kujtohet ajo? - E fqinjës sonë, Anikës.

- E Anikës!

Më mbuluan lotët e nisa të ulërij. E Anikës! E Anikës! - thërrisja. U shtriva përtokë, mblidhja gurë e qëlloja varrmihësin, vajtoja, thërrisja - sa e bukur ishte, sa e mirë ishte! Ajo vinte në shtëpi, më merrte në gjunjë, hiqte krëhërin nga flokët e saj e më krihte. Më gudulisteë nën sqetulla e unë filloja të qeshja, pastaj cicërija si zog...

Xhaxhai më mori në krahë, më nxori mënjanë dhe më foli i nxehur: - Pse qan? Çfarë mendoje? Ajo ka vdekur. Ne të gjithë do të vdesim.

Por mua më kujtoheshin flokët e saj të verdhë, buzët e kuqe që më puthnin, sytë e mëdhenj, ndërsa tani...

- Po flokët e saj, - thërrsija. Sytë e saj të mëdhenj, buzët e saj?...

Nuk i ka më, nuk i ka më... i ka ngrënë dheu.

- Pse? Pse? Jo!

Xhaxhai mblodhi supet:

- Kur të rritesh ti do ta mësosh përse.

Unë nuk e mësova kurrë. U rrita, u plaka, e nuk e mësova kurrë.

SHKOLLA E KOMUNËS

Me sytë e mi të mëdhenj, gjithmonë plot magji, me mendjen që gumëzhinte, e mbushur me mjaltë e bletë, me një kësulë të leshtë e të kuqe mbi kokë, me sandale të vogla me xhufka të kuqe, një mëngjes u nisa; gjysmë i kënaqur, gjysmë i frikësuar; babai më mbante përdore. Nëna më kishte dhënë një fije borziloku duke më thënë që t'i merrja erë sepse do të më jepte guxim, ndërsa në qafë më kishte varur kryqin e artë të pagëzimit tim.

- Zoti të bëkoftë ashtu siç të bekoi... mërmëriti ajo, dhe më kundroi me krenari.

Isha si një viktimë e vogël e mbuluar me stoli dhe brenda meje ndjeja krenari dhe frikë njëherësh, por dora ime ishte vendosur fort në atë të babait e unë kështu merrja zemër. Ne ecëm, ecëm, kaluam rrugicat e ngushta, arritëm në kishën e Shën Minait, morëm kthesën dhe hymë në një ndërtesë të vjetër me një oborrr të madh. Katër dhoma të mëdha në qoshe, e në mes të oborrit një rrap i mbuluar me pluhur.

Hezitova pak; isha i frikësuar; dora ime në dorën e madhe e të ngrohtë të babait, filloi të dridhej.

Babai u përkul e më preku flokët; u drodha; nuk më kujtohej të më kishte përkëdhelur ndonjëherë. Ngrita sytë dhe e pashë i lemerisur. Ai e pa frikën time dhe hoqi dorën.

- Këtu ti do të mësosh që të bëhesh burrë. Bëj kryqin - më tha.

Mësuesi u shfaq në prag. Në dorë mbante një kamzhik të gjatë dhe mua m'u duk i egër, kishte dhëmbë të mëdhenj e unë e fiksova shikimin mbi kokën e tij për të parë nëse kishte brirë por nuk pashë asgjë sepse ai mbante kapele.

- Është djali im - i tha babai. Ai shkëputi dorën time nga e tija dhe ma vuri te dora e mësuesit.

- Lëkura është e jotja - i tha. - Kockat janë të miat. Mos e kurse.

Godite që të bëhet burrë.

- Mos u shqetëso, kapedan Mihal, ja ku e kam mjetin që shërben për këtë.

Duke thënë këtë, mësuesi tregoi thuprën.

Nga shkolla e komunës ruaj ende kujtimin e një grumbulli koka fëmijësh, të ngjitura me njëra tjetrën, të ngjashme si kafka. Shumica e tyre më vonë u bënë me të vërtetë kafka. Por, mbi këto koka, të pashlyeshëm do të ngelen katër mësuesit; Pateropulus në klasën e parë, plak i vogël, i shkurtër, me vështrim të egër, mustaqe të rëna, me thuprën që nuk e ndante nga dora. Ai na kapte, na mblidhte e na vendoste në rresht, sikur të ishim rosakë të cilët do t'i çonte në treg për t'i shitur. Lëkura është e jotja zoti mësues, kockat janë të miat - i thoshte çdo baba duke i besuar dhinë e egër që e kishte djalë; bjeri, bjeri që të bëhet burrë. Dhe ai na godiste pa mëshirë. E ne prisnim të gjithë mësues e nxënës çastin që nga goditjet e shkopinjve të bëheshim burra. Kur u rrita dhe teoritë filantropike më prishnin mendjen, unë e quajta barbare këtë metodë të mësuesit tim të parë. Por kur mësova ta njoh akoma më mirë natyrën njerëzore e bekova kamzhikun e Pateropolusit. Pikërisht ajo na mësoi se vuajtja është rruga më e rëndësishme që shndërron kafshën në njeri.

Baba Djathi, mbretëronte në klasën e dytë. Ai mbretëronte fatkeq e nuk qeveriste. Ishte i zbehtë, me syze të vogla, këmishë të kollarisur, këpucë të lyera, me majë e me taka të ngrëna, me hundë të madhe leshtore, gishta të hollë e të zverdhur nga duhani. Baba Djathi, në fakt quhej Papadokis. Vetëm se një ditë babai i tij që ishte prift, i kishte sjellë si dhuratë, nga fshati një top të madh me djathë:

- Oh! Po qënka një goxha baba djathë - kishte thënë i biri.

Një fqinjë e cila kishte qenë në shtëpinë e tyre, e kishte dëgjuar dhe e kishte përsëritur këtë nëpër lagje, kështu kishin filluar të talleshin me mësuesin e gjorë, e i kishin vënë këtë nofkë. Kështu pra, baba Djathi nuk godiste, lutej. Ai na lexonte *Robinson Kruzo-në*, na shpjegonte çdo fjalë, pastaj na shihte me dhembshuri e ankth sikur na lutej ta kuptonim. Ndërsa shfletonim Robinson Kruzonë,

shikonim të mahnitur mbi figurat e shtypura keq yjet tropikale, pemët me gjethe të dendura, Robinsonin me kapele të madhe me barishte dhe detin i cili shihej kudo në atë vend të pabanuar.

I shkreti baba Djathi, nxirrte kutinë e duhanit, dridhte një cigare për ta pirë gjatë pushimit, ndërsa ne na shikonte me një vështrim lutës e pritës.

Një ditë kur po bënim historinë e shenjtë, mbërritëm tek Isaj, i cili ia kishte shitur "të drejtën" e më të madhit, Jakobit, për një pjatë me thjerëza. Në mesditë duke u kthyer në shtëpi e pyeta babanë se ç'do të thotë "e drejta e më të madhit". Ai u kollit dhe kruajti kokën.

- Shko thirr dajë Nikolakin.

Ai dajë kishte kryer shkollën e komunës dhe ishte më i shkolluari i familjes. Ishte njëri nga vëllezërit e nënës sime, i shëndoshë, dorështrënguar dhe tullac. Kishte sy të mëdhenj, të frikësuar dhe duar shumë të mëdha leshtore. Ishte martuar me një grua nga një familje shumë e mirë. Ajo kishte një çehre verdhacuke, ishte gjuhë nepërkë, xheloze dhe e përbuzte dajën. Çdo mbrëmje i lidhte një këmbë me këmbën e krevatit, nga frika se mos ai çohej natën për të zbritur në katin përdhes ku flinte shërbëtorja e shëndoshë e me gjoks të madh. Kur vinte mëngjesi e zgjidhte.

Vuajtja e dajës së gjorë zgjati pesë vjet, pas kësaj Zoti - jo më kot e quajnë "i madhërishëm" - bëri që të vdiste gjuhënepërka dhe dajua im u martua me një fshatare të fuqishme që bërtiste shumë por kishte zemër të mirë dhe nuk e lidhte. Ai vinte shumë i lumtur tek ne të takonte nënën time.

- Si ia çon, Nikolaki, me nusen e re! - e pyeste ajo.

- Mos më fol, Marie, - përgjigjej daja. - Jam i kënaqur se ajo nuk më lidh.

Babai i fuste frikën dhe ai nuk i ngrinte sytë për ta parë. Fërkonte duart leshtore e shikonte vazhdimisht derën. Atë ditë që im atë e ftoi, ai u çua nga tavolina me gojën plot dhe vrapoi në shtëpinë tonë.

Kushedi për çfarë më do, - mendonte nervoz duke gëlltitur kafshatën e fundit. - Si ia bën motra ime e shkretë që e duron?

Atij iu kujtua gruaja e tij e parë dhe qeshi i kënaqur:

- Unë - murmuriti, lavdi Zotit, e kam hequr qafe.

- Eja pak këtu - i tha im at duke e parë - ti që ke studiuar eja na shpjego diçka!

Ata u përkulën të dy mbi libër dhe u përqendruan.

- "E drejta e më të madhit do të thotë leje për gjueti", - tha babai pasi u mendua gjatë. Daja tundi kokën.

Unë besoj se kjo do të thotë e drejta për të mbajtur një pushkë, - kundërshtoi ai por me zë të dridhur.

Leje gjuetie!

Babai u skuq. Ai ngrysi vetullat dhe daja heshti.

Të nesërmen mësuesi pyeti:

- "Çdo të thotë e drejta e më të madhit"?

unë i thashë: - Leje gjuetie!

- Ç'është kjo marrëzi? Kush është ai injorant që ta ka thënë?

- Babai.

Mësuesin gati e përpiu toka. Ja dhe një tjetër që kishte frikë prej tij, por ai nuk rrezikonte ta kundërshtonte.

- Po. - belbëzoi ai. -Ndonjëherë, por shumë rrallë, do të thotë leje gjuetie; po këtu...

Historia e shenjtë ishte lënda që më pëlqente më shumë nga të gjitha. Ishin ngjarje të çuditshme me breshka, me gjarpërinj që flisnin, me përmbytje dhe ylbere, me vjedhje e vrasje, një vëlla që vriste vëllanë tjetër, një baba që donte të vriste me thikë djalin e tij të vetëm e në çdo moment ndërhynte Zoti, njerëzit kalonin detin pa lagur as këmbët...

Ne nuk kuptonim; i drejtonim pyetje mësuesit, ai ngrinte kamzhikun, kollitej, zemërohej:

- Të pacipë! - thërriste. Sa herë duhet t'jua them? Nuk dua dërdëllisje.

- Po ne nuk e kuptuam, zotëri - qaraviteshim ne.

- Është Zoti që e bën këtë, - përgjigjej mësuesi, - nuk ka nevojë që ne ta kuptojmë, është mëkat. Është mëkat!

Ne dëgjonim fjalën e tmerrshme dhe ngeleshim pa folur. Nuk ishte një fjalë, ishte një gjarpër, gjarpëri që kishte gënjyer Evën, e që mishërohej tek mësuesi që hapte gojën për të na gëlltitur. Ne shtangnim mbi banka, nuk flisnim asnjë fjalë. Një tjetër fjalë që më

ka bërë të dridhem kur e kam dëgjuar për herë të parë është fjala Abraham. Tre A-të e këtij emri tingëllonin tek unë sikur të vinin prej së largu, nga një pus i thellë, i errët, i rrezikshëm, mërmërisja me veten time:

- Abra-ham, Abra-ham. - Pas meje ndjeja një zhurmë hapash dhe një frymëmarrje të shkurtër, dikë që më ndiqte, duke vrapuar me këmbë të mëdha të zbathura e kur mora vesh një ditë se ai kishte marrë djalin e tij për ta therur më pushtoi tmerri.

Ky duhet të ishte patjetër ai që therte fëmijët; dhe unë fshihesha pas bankës nga frika se mos më shihte dhe më merrte me vete.

Kur mësuesi na tha se ai që ndjek urdhërat e Zotit do të shkojë në gjirin e Abrahamit unë u betova me vete se do t'i shkelja të gjitha për të shpëtuar nga gjiri i tij.

Kam provuar të njëjtin shqetësim kur dëgjova për herë të parë në të njëjtin mësim fjalën Habacuc, ky emër m'u duk i zymtë, ishte si ujku që rrinte në përgjim në oborrin e shtëpisë sonë sapo binte nata; dhe unë e dija ku fshihej, pas pusit. Një herë kur unë dola vetëm në oborr natën, ai u vërsul nga pusi, zgjati dorën dhe më thirri:
- Habacuc! Dëgjomë ç'të them: prit pak, se do të të ha!

Tingulli i disa fjalëve zgjonte tek unë një shqetësim të madh; jo gëzim por shumë dendur frikë - dhe mbi të gjitha, fjalët hebraike. Sepse unë e dija nga legjendat që më tregonte gjyshja, se të Premten e zezë, çifutët merrnin të krishterët e vegjël, i hidhnin në një govatë të mbushur me gozhdë dhe u pinin gjakun. Shpesh një fjalë hebraike e Testamentit të Lashtë dhe mbi të gjitha, fjala Jehova - më dukej si një govatë e mbushur me gozhdë ku donin të më hidhnin.

Në klasën e tretë ishte perëndia Krasakis. Cili kumbarë i pamëshirshëm i kishte vënë emrin e tiranit të egër të Korinthit, këtij burri të vogël shtrembaluq që mbante një jakë të lartë të ngrirë, për të fshehur gjendrat e qafës, këtij burri të vogël me këmbë të dobëta si karkalec, me shami të bardhë që e mbante gjithmonë përpara gojës, që kollitej e kollitej sa ngelej pa frymë?

Ai kishte maninë e pastërtisë. Çdo ditë na kontrollonte duart, veshët, hundët, dhëmbët, thonjtë. Ai nuk na godiste, nuk na lutej shumë, tundte kokën e madhe të mbushur me puçrra:

- Tufë kafshësh, - na bërtiste, - tufë derrash, në qoftë se nuk lahe-

ni përditë me ujë e sapun, ju nuk do të bëheni kurrë burra. Çdo të thotë burrë? Është ai që lahet me ujë e sapun. Shpirti nuk mjafton, miqtë e mi të shkretë, duhet dhe sapuni. Si do të guxoni ju të paraqiteni te Zoti, me duar të tilla? Dilni në oborr dhe shkoni lahuni!

Gjatë orëve të mësimit, na çante veshët duke na shpjeguar cilat zanore ishin të gjata, cilat ishin të shkurtëra dhe theksin që duhej vendosur, i mprehtë ose lakor. Ne dëgjonim zhurmat e rrugës, shitësit e perimeve, të bukës, pëllitjet e gomerëve të vegjël, fqinjët që qeshnin dhe mezi prisnim të binte zilja e të ishim të lirë. Shikonim mësuesin që djersitej në katedër, përsëriste papushim të njëjtat gjëra duke dashur të na fuste gramatikën në kokë, por mendja jonë ishte jashtë, tek dielli dhe tek beteja e gurëve.

Ne e pëlqenim shumë betejën me gurë dhe shpesh shkonim në shkollë me kokë të gjakosur.

Ishte një ditë e mrekullueshme pranverore dhe dritaret e hapura lejonin që nga shtëpia përballë të hynte brenda era e mandarinave të çelura, mendja jonë ishte bërë si mandarinë e lulëzuar dhe ne nuk mund të dëgjonim më të flitej për thekset e mprehtë ose lakorë. Një zog u ul pikërisht mbi rrapin e oborrit dhe filloi të këndonte. Atëherë një nxënës kuqalash, i zbehtë, i cili sapo kishte ardhur atë vit nga fshati e që quhej Nikolla, duke mos duruar më ngriti gishtin:

- Pushoni, zotëri, - thirri, - pushoni. Na lini të dëgjojmë zogun!

I shkreti Periandre Krasakis! Më kujtohet, një ditë, ai mbështeti qetësisht kokën mbi katedër; u përpëlit një çast si peshk dhe pastaj dha shpirt. Duke parë vdekjen me sy ne u tmerruam e u lëshuam në oborr duke bërtitur. Të nesërmen u veshëm me rrobat e së dielës dhe lamë me kujdes duart. Për të mos e hidhëruar, e çuam në varrezën e vjetër në breg të detit. Ishte pranverë, qielli shkëlqente, toka vinte era kamomil. Arkivoli ishte i zbuluar, fytyra e të vdekurit ishte e verdhë në jeshile, e mbuluar me puçrra; dhe kur nxënësit u përkulën një nga një për t'i dhënë puthjen e fundit, pranvera nuk vinte më era kamomil por era mish i prishur.

Në klasën e katërt mbretëronte drejtori i shkollës së komunës. I shkurtër dhe shulak si qyp, me një mjekër të vogël të hollë, me sytë gri gjithmonë të zemëruar e me këmbë të shkurtra. "E shikon si i ka këmbët" - i thoshim ne njëri tjetrit me zë të ulët që ai të mos na

dëgjonte, nuk e shikon, e marrtë dreqi si i thur këmbët kur ecën?

Dhe si kollitet? Ai nuk ishte Kretian. Kishte ardhur tek ne pasi kishte kryer studimet në Athinë dhe kishte sjellë me vete pedagogjinë e re. Ne mendonim se pedagogjia ishte një grua e re, por kur e pamë për herë të parë ai ishte krejt i vetëm. Pedagogjia nuk ishte me të. Asaj i ishte dashur të rrinte në shtëpi. Na vuri në rresht dhe filloi një diskutim.

- Kini kujdes! Nuk dua fjalë të pista; as të qeshura, as thirrje gjatë pushimit. Krahët të kryqëzuar. Kur në rrugë shikoni një prift puthini dorën. Kini kujdes miqtë e mi të shkretë, përndryshe shikoni mirë këtu, dhe duke thënë këtë na tregonte kamzhikun.

Kur ne bënim ndonjë marrëzi çfarëdo ose kur nuk ishte në humor, na shkopsiste pantallonat, na i ulte, pastaj na qëllonte me kamzhik. Kur nuk kishte durim të na ulte pantallonat na godiste me kamzhik tek veshët deri sa na dilte gjak. Një ditë unë mora guximin dhe ngrita gishtin:

- Zotëri, - e pyeta. - Ku është pedagogjia e re? Pse nuk vjen në shkollë? Ai u hodh nga katedra dhe hoqi nga muri kamzhikun.

- Eja këtu, i pacipë, - thirri, - zbërtheji pantallonat. Nuk i vinte për mbarë të m'i zbërthente vetë. - Na, na, na!

Nisi të më godiste duke ulëritur. U bë qull në djersë dhe ndaloi.

- Ja ku është pedagogjia e re, - tha, - dhe herë tjetër duhet ta mbyllësh gojën.

Bashkëshorti i pedagogjisë së re në të njëjtën kohë ishte dhe shumë i keq. Një ditë na tha: - Nesër do t'ju flas për Kristofor Kolombin, dhe do t'ju tregoj se si zbuloi Amerikën. Por për ta kuptuar më mirë duhet që secili prej jush të sjellë nga një vezë. Në qoftë se ndonjëri nuk ka vezë le të sjellë gjalpë!

Ai kishte një vajzë në moshë për t'u martuar që quhej Terpsikone. E vogël por mjaft e bukur. Shumë i kërkonin dorën e vajzës, por ai nuk pranonte.

- Nuk dua njerëz të poshtër në familjen time - thoshte.

Kur në janar, macet mjaullinin në ulluk ai merrte një shkallë, hipte në çati dhe i përzinte.

- Mallkuar qoftë natyra, - mërmëriste, - mallkuar qoftë, ajo nuk ka moral!

Të premten e zezë na çoi në kishë për të adhuruar të kryqëzuarin. Pastaj na mblodhi në shkollë për të na shpjeguar atë që kishim parë, atë që kishim adhuruar dhe ç'do të thoshte kryqëzim. Ne u radhitëm pas bankave, të lodhur, të mërzitur, sepse atë ditë kishim ngrënë vetëm limona të thartë dhe kishim pirë uthull për të provuar vetë vuajtjet e Krishtit. Burri i pedagogjisë së re, me një zë të rëndë e zyrtar, nisi të na shpjegonte se Zoti kishte zbritur mbi tokë, nëpërmjet Krishtit, dhe sesi ishte kryqëzuar Krishti për të na shpëtuar nga mëkati. Çfarë mëkati? Ne nuk e kuptonim mirë por ajo që kuptonim ishte se ai kishte dymbëdhjetë dishepuj dhe se njëri prej tyre, Juda, e kishte tradhëtuar.

- Dhe Juda ishte si kush? Si kush? Mësuesi u ngrit nga katedra dhe nisi të ecë ngadalë midis rreshtave të bankave; ai na vështronte një nga një.

Juda ishte si...

Dhe zhvendoste gishtin tregues nga njëri tek tjetri, duke kërkuar se kush prej nesh i ngjante Judës. Ne mblidheshim kruspull e dridheshim duke parë gishtin e tmerrshëm të ndalonte mbi ne. papritur mësuesi thirri dhe gishti i tij ndaloi mbi Nikollën e vogël, fëmijën e zbehtë e të veshur keq me flokë të bukur bjondë.

- Ja si Nikolla! - thirri mësuesi. Tamam si ai! I zbehtë si ai, i veshur si ai, dhe flokët i ka të kuq, të kuq, të kuq si flakët e ferrit.

Kishte qënë pikërisht ky, Nikolla, që kishte dashur të dëgjonte zogun.

Duke dëgjuar, Nikolla i shkretë shpërtheu në dënesë dhe të gjithë ne që kishim shpëtuar nga rreziku i hidhnim vështrime të egra dhe plot urrejtje dhe ramë dakort të gjithë që ta shqepnim në dru kur të dilte jashtë, sepse ai kishte tradhëtuar Krishtin.

Mësuesi i kënaqur që na kishte treguar dukshëm se si ishte pedagogjia e re, se si ishte Juda, na la të lirë. Ne rrethuam Nikollën dhe meqë ndodheshim në rrugë nisëm të pështynim mbi të dhe ta qëllonim; ai ia mbathi me të katra dhe me lot në sy, por ne e ndoqëm duke e goditur me gurë, duke bërtitur dhe duke i thirrur: Juda! Juda! Derisa mbërriti në shtëpi e u tulat brënda.

Nikolla nuk u duk më në klasë dhe nuk vuri më këmbë në shkollë.

Tridhjetë vjet më vonë, kur kthehesha nga Europa dhe isha në

shtëpinë e babait, atë ditë ishte e premte e zezë, ra dera dhe unë pashë të shfaqej te pragu një burrë i zbehtë, i imët, me flokë të kuq e mjekër të kuqe. Në një shami me ngjyrë, ai mbante, këpucët e reja që babai im kishte porositur për të gjithë ne për pashkë. Ndaloi i ndrojtur tek pragu, më shikoi dhe tundi kokën.

Nuk po më njeh? - më tha. - Nuk po të kujtohem?

Me zor i thashë se e kisha njohur.

- Nikolla! - thirra dhe e përqafova.

- Juda! - tha ai dhe buzëqeshi hidhur.

Sjell ndërmend shpesh komshinjtë e mi dhe tmerrohem. Pjesa më e madhe e tyre ishin gjysmë të çmendur. Ata kishin një dërrasë mangut dhe unë kaloja me shpejtësi para derës së tyre sepse kisha frikë. Truri i tyre ishte i turbulluar, ndoshta sepse ata rrinin gjithë vitin brenda katër mureve të shtëpisë; ndoshta edhe për shkak të frikës nga turqit dhe nga meraku që kishin për nderin dhe të mirat e tyre që ishin vazhdimisht në rrezik. Për këtë, dëgjonin më tepër nga pleqtë, që tregonin masakrat, luftërat, dëshmorin e të krishterëve dhe u ngriheshin flokët përpjetë. Në qoftë se dikush kalonte dhe ndalonte para derës së tyre ata çoheshin me hov në pikë të hallit. Natën pothuajse nuk flinin; një sy hapur, veshët përpjetë, prisnin çastin fatal i cili nuk mund të vononte.

Në të vërtetë trishtohesha kur kujtoja fqinjët e mi.

Zonja Viktoria, pak më poshtë shtëpisë sonë; herë na përshëndeste me mirësjellje me një llomotitje përkëdhelëse pafund, herë na mbyllte derën në fytyrë dhe niste të shante pas portës. Përballë shtëpisë së saj zonja Penelopë, e shëndoshë, e lerosur, e moshuar, gjithë kohën duke përtypur karafil sepse siç thoshte ajo, donte ta kishte frymën të parfumosur; ajo qeshte papushim sikur ta gudulisnin. Burri i saj, Dimitri, i qetë, e veseli, merrte një e dy çadrën e ikte në male, Pas dy ose tre muajve, kthehej i veshur me zhele, pantallonat që mezi i mbaheshin në trup, i vdekur për bukë e me çadrën e hapur. Zonja Penelopë e shihte për së largu kur vinte dhe ia kriste të qeshurit.

Më poshtë z. Manusos, tregtar serioz, i çuditshëm, sa herë dilte nga shtëpia në mëngjes, merrte një shkumës dhe vizatonte një kryq mbi portën e tij; në mesditë kur kthehej, rregullisht në të njëjtën

orë për të ngrënë ai rrihte të motrën; ne dëgjonim thirrrjet e saj dhe kujtonim që ishte mesditë dhe uleshim në tavolinë. Zoti Manusos nuk e hapte gojën për të përshëndetur. Të shikonte me një pamje të egër e të tmerrshme. Pak më lart, në fillim të rrugës, në një shtëpi të madhe jetonte zoti Andre Paspatulis, i pasur, me një fytyrë të vrarë lie, me hundë të madhe, me flegrat si viç; sa herë mbyllte derën, qëndronte një orë në këmbë duke e prekur, nga frika se mos kishte mbetur e hapur dhe mërmëriste formula yshtjeje për t'i dëbuar hajdutët, zjarrin dhe sëmundjet; Në fund bënte tri herë kryqin, kungohej duke parë papushim nga prapa. Fëmijët e lagjes kishin vënë re, se ai ecte gjithmonë mbi të njëjtët gurë dhe për ta ngacmuar grumbullonin mbi këta gurë baltë e dhe; por ai me shkopin e tij i largonte dhe ecte po mbi ata gurë.

Ne kishim gjithashtu edhe një komshi tjetër, krenarinë e lagjes sonë, Perikles, mjek i sapoardhur nga Parisi, bjond, simpatik, me syze me skelet të artë.

Motra e tij ishte një vajzë e vjetër, e cila kishte përdorur pajën e saj të qëndisur për studimet e të vëllait. Ai ishte mjeku i familjes sonë. Unë përkulesha, sodisja trëndafilat e qëndisur mbi mëndafsh dhe gjethe të gjelbërta përreth.

Një ditë kur kisha ethe, dhe ai erdhi për të më vizituar, iu luta se, në qoftë se dëshironte që të shërohesha, duhej të më jepte pantoflat. Ai me seriozitetin më të madh, sepse nuk qeshte kurrë, m'i vuri në këmbë për të parë se si më rrinin; por ato ishin shumë të mëdha. Për t'u ngushëlluar vura hundën tek trëndafilat e qëndisur për të parë nëse vini erë. Në fakt ata vinin erë, por një aromë krejt tjetër nga ajo e trëndafilit.

Unë nuk mund të mos kujtohem për fqinjët e mi pa më ardhur njëkohësisht për të qeshur e për të qarë. Njerëzit në atë kohë nuk ishin të gjithë të një kallëpi, por secili prej tyre ishte botë më vete, kishte ekstravagancën e tij, mënyrën e vet të të qethurit, të të folurit, mbyllej në shtëpinë e tij, mbante të fshehur nga turpi ose nga frika dëshirat më sekrete dhe ato shpërthenin brenda tij, i merrnin frymën, por ai nuk fliste dhe kështu jeta e tij merrte një rrjedhë tragjike. Pastaj ai kishte varfërinë e cila nuk I largohej kurrë, kishte gjithashtu krenarinë që nuk e linte të shikonte njeri; ata hanin bukë me ullinj,

në mënyrë që të mos dilnin me rroba të arnuara. Dëgjova një ditë një prej komshinjve tanë të thoshte: " Është i varfër ai që ka frikë nga varfëria; unë nuk e kam frikë..."

VDEKJA E GJYSHIT

Duhet të kem qenë ende në shkollën e komunës, kur erdhi duke vrapuar me të katra një bari nga fshati, dhe më çoi tek gjyshi i cili ishte në agoni; që, siç thoshte bariu dëshironte të më jepte bekimin. Më kujtohet që ishte zheg, ishte gusht, unë kisha hipur mbi një gomar të vogël ndërsa bariu nga prapa, me një shkop të bigëzuar e me një gozhdë në majë e ngacmonte kafshën herë pas here. Gomari hidhte vickla dhe vraponte. U ktheva nga bariu dhe i thashë me lutje: - Nuk ke mëshirë për të? Mos e ngacmo! Ai vuan!

- Vetëm njerëzit vuajnë, - m'u përgjigj bariu. - Gomerët gomerë janë.

Por unë shpejt e harrova vuajtjen e kafshës sepse ne po kalonim nëpër vreshta e ullishta dhe gjinkallat po më shurdhonin. Gratë e vilnin dhe e hapnin rrushin mbi trinë për ta tharë. Gjithçka kundërmonte. Një vjelëse na pa dhe nisi të qeshte.

- Përse qesh ajo, Qiriako? - pyeta kafsharin, emrin e të cilit ndërkohë e kisha mësuar.

- Ajo qesh sepse ka guduli, - u përgjigj Qiriakua. Pastaj pështyu.

- Kush e gudulis Qiriako?

- Demonët.

Nuk e kuptova se përse u tmerrova, mbylla sytë dhe nisa ta godisja me grusht gomarin e vogël që ne të kalonim shpejt dhe unë të mos i shikoja demonët. Në një fshat ku kaluam, pamë njerëz të mëdhenj, gjysmë të zhveshur, leshtorë, që shtypnin rrush brenda nëpër shtypëse; unë dëgjoja të qeshurat dhe thirrjet e tyre të gëzueshme. Toka vinte era musht, gratë nxirrnin bukën nga furra, qentë lehnin, dëgjohej një zukamë bletësh e grerëzash, dielli po ulej drejt perëndimit, i kuq, i dehur sikur të kishte shtypur rrush. Nisa të qeshja e të vërshëlleja; mora shkopin e bigëzuar nga duart e bariut dhe nisa të drejtoja gomarin e vogël, ta shpoja me gozhdë tek ijet.

Nga lodhja, nga dielli dhe gjinkallat, po më vinte mendja vërdallë

dhe kur arrita në shtëpinë e gjyshit dhe e pashë të shtrirë në mes të oborrit të rrethuar nga fëmijët e nipërit e tij u ngazëlleva. Meqënëse kishte rënë mbrëmja dhe ishte freskuar, gjyshi im i mbante sytë të mbyllur. Ai nuk e kishte dalluar praninë time. Kështu unë i kisha shpëtuar dorës së tij të madhe që kur më prekte më skuqej lëkura. Më vjen gjumë, - i thashë një gruaje që më zbriti nga gomari dhe më mori në krahë.

- Ki durim! Ki durim! - m'u përgjigj ajo. - Gjyshi yt nuk do të vonojë të vdesë. Shko pranë tij që të të japë bekimin. Unë e imagjinoja bekimin, të cilin kisha ardhur ta merrja prej aq larg, si një dhuratë të jashtëzakonshme, si një lodër të çmuar. Ky duhet të ishte floku i gogolit për të cilin flisnin përrallat; e ruan vetë dhe në rast nevoje të domosdoshme e djeg dhe gogoli vjen e të shpëton. Unë prisja që gjyshi të hapte sytë e të më jepte ata flokë.

Në atë çast, gjyshi lëshoi një klithmë dhe u mblodh kruspull mbi lëkurën e deles ku e kishin shtrirë.

- Ai pa ëngjëllin e tij mbrojtës, - tha një plakë - dhe nuk do të vonojë të japë fruymën e fundit.

Ajo mori një copë dyll dhe nisi ta ngrohë me frymë, ta modelojë mes gishtave me formën e kryqit për të vulosur buzët e të vdekurit. Njëri prej djemve që kishte një mjekër të dendur, pis të zezë, u ngrit, hyri në shtëpi dhe mori një shegë e ia vuri në dorë që ai ta çonte te të vdekurit.

Ne të gjithë u afruam e zumë të shikonim. Një grua nisi vajin, por djali me mjekër të dendur i mbylli gojën.

- Pusho!

Gjyshi hapi sytë dhe bëri një shenjë; të gjithë u afruan më tepër; në qendër djemtë, pas tij nipërit meshkuj, më pas akoma vajzat dhe nuset. Plaku shtriu duart; një plak i vuri një jastëk nën zverk. Gjyshi ngriti zërin:

- Lamtumirë fëmijët e mi, - tha; - Unë e hëngra bukën time, tani po shkoj. E kam mbushur oborrin me fëmijë nipër e mbesa, i kam mbushur qypat e mi me vaj e mjaltë, i kam mbushur fuçitë me verë dhe nuk kam pse ankohem. Lamtumirë!

Ai tundte duart duke na lënë shëndenë. Shëtiti sytë mbi ne duke na parë një nga një. Unë e kisha harruar bekimin, isha fshehur pas

dy tre kushurinjve të mi dhe ai nuk më pa. Askush nuk fliste; plaku nisi të fliste prapë:

- Mbani vesh, dëgjoni dëshirat e mia të fundit; mendoni për kafshët, qetë, deshët, gomerët; mos i lini pas dore, edhe ata kanë një shpirt, janë qënie të gjalla, vetëm se janë të veshura me lëkura kafshësh e nuk flasin; ka edhe njerëz pleq, jepuni atyre të hanë. Mendoni për ullinjtë, vreshtat, plehërojini, ujitini, krasitini, në qoftë se doni t'ju japin fruta. Janë qënie të gjalla edhe ato, por shumë të vjetra dhe nuk kujtohen më. Por njerëzit kujtohen prandaj janë njerëz. Më dëgjoni? Apo flas në vesh të shurdhët?

- Të dëgjojmë, të dëgjojmë... - pëshpëritën disa zëra.

Plaku shtriu dorën e tij të madhe dhe thirri djalin e madh.

- Kostandin!

Kostandini, një burrë i madh me mjekër gri, flokë të dredhura, sy të mëdhenj, mori dorën e të atit:

- Ja ku jam baba, për çfarë më do?

- Në qypin e vogël, ka nga gruri më i mirë, ka shumë kohë që e kam hequr mënjanë për këtë ditë; zjejeni për meshën e të nëntave, por futini shumë bajame. Lavdi zotit ne kemi, pra mos e kurse sheqerin siç e ke zakon ti, më dëgjon? Ti je koprac dhe unë s'kam shumë besim tek ti.

- Do të bëhet ashtu siç dëshiron ti u përgjigj djali duke tundur kokën e madhe. Do të bëhet siç dëshiron ti, por të gjithë do të marrin pjesë në shpenzime. Ai u kthye nga vëllezërit e tij majtas dhe djathtas:

- Dëgjoni! Secili pjesën e tij, sepse ka shumë shpenzime.

Vëllezërit mërmëritën nëpër dhëmbë, njëri prej tyre ngriti zërin:

- Në rregull, - tha. - Në rregull Kostandin; nuk do të zihemi për këto gjëra.

Kisha rrëshqitur në rreshtin e parë, vdekja siç e kam thënë, ishte gjithmonë një mister i çuditshëm për mua që më tërhiqte; u afrova më pranë për të parë nga afër babanë e nënës sime në prag të vdekjes.

Ai më vuri re.

- Ej, mirë se erdhe, - më tha, - mirë se erdhe i vogli i Kastros. Përkulu që të të jap bekimin.

Plaka që mbante copën e dyllit dhe e përpunonte më kapi kokën

dhe ma uli. Ndjeva dorën e rëndë që më mbuloi majën e kokës:

- Merre bekimin tim, djali i vogël i Kastros, - më tha dhe u bëfsh burrë.

Ai lëvizi buzët për të thënë akoma edhe diçka, por i shteruan fuqitë dhe mbylli sytë.

- Më thoni nga cila anë perëndon dielli? - pyeti duke mërmëritur; Më ktheni nga ajo anë.

Dy prej djemve e kthyen nga perëndimi.

- Lamtumirë, - mërmëriti, - po shkoj!

Lëshoi një psherëtimë të thellë, tendosi këmbët dhe koka iu rrokullis nga jastëku e iu përplas Pas gurëve të oborrit.

- Vdiq? - pyeta njërin prej kushurinjve të mi.

- Penti! U pa kjo punë - m'u përgjigj, - shkojmë të hamë!

Më shumë se shkollat dhe mësuesit, më shumë se gëzimet dhe ankthet e para që më dha njohja e botës, një emocion me të vërtetë të papërsëritshëm dhe që pati një ndikim të pallogaritshëm në jetën time më dha lufta mes Kretës dhe Turqisë.

Pa këtë luftë, jeta ime do të kishte marrë një tjetër rrugë dhe Zoti një tjetër pamje.

Që prej lindjes sime unë jetoja në këtë klimë të egër lufte, të dukshme dhe të padukshme. Shikoja kretanët dhe turqit që i hidhnin njëri-tjetrit shikime të egra, të shtrembëra, duke dredhur mustaqet me zemërim, shihja xhandarët turq që kalonin e rikalonin nëpër rrugë me pushkë, kretanët që mbyllnin portat duke sharë, dëgjoja pleqtë që flisnin për masakra, për aktet e trimërisë, për luftrat, për lirinë dhe Greqinë dhe unë jetoja thellësisht në një jetë të nemitur, dhe prisja që të rritesha për të kuptuar se çfarë ishin gjithë këto gjëra, që kur të më vinte radha mua, t'i futesha punës e të luftoja. Me kohë e kuptova qartë se Greqia ishte në luftë me Turqinë, se njëra luftonte për lirinë dhe tjetra e kishte pushtuar e s'e linte të lirë. Rreth meje, të gjitha gjërat morën një pamje, pamjen e Kretës ose të Turqisë, dhe u bënë në imagjinatën time, dhe jo vetëm aty por dhe në trup, simbole që më sillnin ndërmend luftën e tmerrshme.

Një ditë vere, në 13 gusht, në kishën më të mirë, mbi fronin e

ulët, për t'u falur kishin ekspozuar një ikonë të shën Mërisë. Nëna e Krishtit kishte shtrirë krahët në kryq, një engjëll në të djathtë, në të majtë djalli, ishin turrur për të marrë shpirtin e tij; engjëlli kishte zhveshur shpatën dhe i kishte prerë të dyja duart djallit, të cilat qëndronin pezull në ajër, të lyera me gjak. Shikoja ikonën dhe zemra më gufonte e gëzuar. "Ja Kreta, - thosha me vete, - ky djall i zi është Turqia, engjëlli i bardhë, mbreti i grekëve... Mbreti i grekëve do t'ia presë një ditë duart Turqisë. Kur? "Kur të jem i rritur... - mendoja" dhe zemra ime ngazëllehej.

Zemra ime e vogël prej fëmije nisi të mbushej me pasion dhe urrejtje, shtrëngoja dhe unë grushtat për t'u hedhur në luftë; unë e dija mirë se nga cila anë e luftëtarëve ishte detyra ime dhe dëshiroja të rritesha sa më shpejt që të hidhesha në betejë ashtu si gjyshi dhe babai im.

Kjo ishte pikënisja. Prej asaj dëshire, shpalosi degë, lulëzoi e bëri fryte pema e jetës sime. Nuk ishin as frika, as vuajtja, as gëzimi dhe as lojërat, ato që tronditën të parat shpirtin tim, por ishte pasioni i lirisë.

Nga çfarë duhej të çlirohesha? Prej kujt? Pak nga pak me kalimin e kohës, unë e kapërceva të tatëpjetën e thepisur të lirisë; çlirimi nga Turqia ishte shkalla e parë, pastaj çlirimi nga gjithçka që Turqia sillte me vete, injoranca, ligësia, lakmia, frika, përtacia, idetë e këqia; e më në fund çlirimi nga idhujt, nga të gjithë idhujt, edhe nga ata më të respektuarit e të dashurit.

Kështu, me kalimin e kohës kur u rrita dhe shpirti im u zgjerua, lufta u shtri në Greqi dhe në Kretë, vërshoi nëpër hapësirë dhe kohë, dhe meqënëse ajo përqafoi të gjithë historinë njerëzore, nuk ishte më Kreta dhe Turqia që ishin në luftë, ishin e E Mira dhe E Keqja, Drita dhe Errësira, Zoti dhe Djalli. Është gjithmonë e njëjta luftë, lufta e përjetshme, dhe gjithmonë pas të mirës, Dritës, Zotit ishte Kreta; dhe pas të keqes, errësirës, djallit ishte Turqia.

Dhe kështu meqënëse fati bëri që të lindja në Kretë, në një moment vendimtar, kur ajo luftonte për liri, unë ndjeva pas fëmijërisë së parë se ekziston në botë diçka më e çmuar se jeta, më e mirë se mirësia; liria.

Ishte një kapedan i vjetër që e quanin Njeriu me shami, sepse ai

mbante gjithmonë me vete disa prej tyre; një mbi kokë, një në krahun e majtë, dy që i vareshin nga rripi prej mëndafshi dhe një tjetër e mbante në dorë e fshinte ballin që e kishte gjithmonë me djersë. Ishte mik i babait dhe vinte gjithmonë në dyqan. Burrat më të rinj mblidheshin rreth tij, im atë i sillte kafe e një nargjile, tjetri hapte kutinë e tabakos, mbushte flegrat e hundës me duhan, teshtinte dhe niste të fliste.

Unë qëndroja në këmbë, i mënjanuar dhe e dëgjoja; lufta, sulmet, masakrat; Megalo Kastro hiqej mënjanë, malet e Kretës ngriheshin përpara meje, ajri mbushej me ulërima. Kretianët ulurinin, turqit ulërinin; sytë e mi xixëllonin nga refleksi i pistoletave të argjendta. Ishte Kreta dhe Turqia, ato luftonin - Liri! - thërriste njëra - Vdekje! - përgjigjej tjetra, dhe shpirti im mbushej me gjak. Një ditë kapedani plak u kthye, puliti sytë dhe më mati me shikim:

- Druri i mollës nuk bën dardha, - më tha. - E kuptove more kokoroç? Unë u skuqa: - Jo kapedan, - u përgjigja.

- Babai yt është njeri i mirë, dhe ti do të bëhesh njeri i mirë, edhe sikur të mos duash.

Edhe sikur të mos duash? Kjo fjalë m'u fut në shpirt, ishte Kreta që fliste nëpërmjet gojës së kapedanit të vjetër. Nuk e kuptova atëherë këtë fjalë të vështirë, por shumë kohë më vonë unë ndjeva në veten time një forcë që nuk më përkiste, një forcë që qëndronte mbi mua dhe ishte pikërisht ajo që më drejtonte. Shumë herë kam qenë gati për t'u përshtatur por kjo forcë nuk më ka lënë ta bëja - pra, Kreta.

Në të vërtetë nga krenaria, nga ideja që isha kretas dhe nga frika e tim eti, unë arrita që në fëmijëri të mposhtja frikën. Natën, nuk guxoja të dilja vetëm në oborr, në errësirë; në çdo cep, pas çdo vazoje, mbi grykën e pusit qëndronte i strukur, i heshtur një demon i vogël leshtor, me sytë që i shkëlqenin. Por im atë më dha një shtysë, më nxori dhe mbylli derën pas meje. Veç një frikë nuk kisha arritur ta mposhtja; atë nga dridhjet e tokës.

Shpesh Megalo Kastro dridhej nga themelet, dëgjohej një oshëtimë nën tokë, korja e tokës kërciste dhe njerëzit e shkretë trembeshin. Kur era pushonte papritur saqë asnjë gjethe nuk lëviste dhe binte një heshtje e rëndë që të bënte të dridheshe, të gjithë banorët e Me-

galo Kastros banonin jashtë shtëpive e dyqaneve, shikonin sa qiellin dhe tokën, ndërsa nuk flisnin asnjë fjalë, nga frika se mos e Keqja i dëgjonte dhe vinte, por me vete thoshin -" Do të ketë tërmet..." dhe bënin kryqin.

Një ditë mësuesi Pateropulus na shpjegoi për të na qetësuar: - Një dridhje toke nuk është problem, fëmijët e mi, mos kini frikë. Nën tokë gjendet një dem i cili ulërin. Ai qëllon tokën me brirë dhe toka lëviz; kretanët e vjetër e quanin minotaur. Nuk është problem. Por pas këtij ngushëllimi të mësuesit, frika jonë u dyfishua; dridhja e tokës prapa ishte një gjë e gjallë, një kafshë me brirë; ai ulërin, lëviz nën këmbët tona dhe përpin njerëz.

- Po atëherë, - tha një djalë i vogël topolak që quhej Sratis, - pse shën Minai nuk e vret?

Mësuesi u zemërua:

- Mos fol gomarllëqe të tilla! - thërriti.

Zbriti nga katedra për t'i shkulur veshin Stratisit që ai të pushonte. Megjithatë një ditë kur po kaloja në lagjen turke, sa më shpejt që të ishte e mundur, sepse turqit lëshonin një erë që më kallte krupë, toka nisi të dridhej, portat e dritaret kërcistën, u dëgjua një zhurmë e madhe, sikur do të shembeshin shtëpitë. Ngela në mes të rrugës, i mpirë nga frika; kisha ngulur sytë mbi tokë dhe prisja që ajo të hapej dhe të dukej demi që do t'më përpinte. Papritur një derë e mbuluar me kube u hap, unë pashë një kopsht dhe tre turkesha të vogla që dolën në rrugë, me fytyrë zbuluar, këmbëzbathur, të pakrehura, që u shpërndanë në të gjitha anët, të lemerisura duke nxjerrë klithma të vogla si dallëndyshe. E gjithë rrugica vinte era myshk. Që nga ai moment dhe për gjithë jetën dridhja e tokës mori një tjetër pamje tek unë; nuk kishte më pamjen e egër të një demi, nuk ulërinte më, por, cicërinte si zog, dridhja e tokës dhe turkeshat e vogla ishin bërë një. Ishte hera e parë që shihja një forcë të errët të ngatërrohej me dritën dhe të ndriçohej.

Shumë herë në jetën time, nganjëherë me dëshirë, nganjëherë i detyruar, unë vura një maskë komode kundër frikës, dashurisë, virtytit, sëmundjes, - kështu munda ta duroja jetën time.

Pasioni im i parë ka qenë liria; i dyti që më ka ngelur akoma e që më mundon është etja për shenjtëri. Hero dhe shenjt në të njëjtën

kohë, ja përfytyrimi im suprem për njeriun; që nga fëmijëria e kisha fiksuar në mendje e në shpirt, këtë gjë. Në ato vite çdo shpirt në Megalo Kastro kishte rrënjë të të thella në tokë, rrënjë të thella në qiell. Pikërisht për këtë kur mësova të lexoja, gjëja e parë që i kërkova nënës sime ishte të më blinte tekstin popullor që e quanin letra e shenjtë: "Pamja e Zotit mrekulli hyjnore! Një gur ra nga qielli..." Ky gur ishte thërmuar dhe kishin gjetur të shkruar në brendësi: gjëmë, gjëmë për atë që përdor vaj dhe pi verë të mërkurën dhe të premten!" E mora letrën e shenjtë, e mbaja lart si flamur dhe shkoja trokisja çdo të mërkurë e të premte në portat e lagjes: në derën e zonjës Penelopë, të zonjës Viktoria, të plakës Katerina, dhe sulesha si i lëshuar nga zinxhiri në brendësi të shtëpisë, vrapoja drejt e në kuzhinë dhe nuhasja gjellën që gatuhej. Sikur të ndjeja erë mishi ose peshku, unë tundja me një pamje kërcënuese letrën e shenjtë dhe thërrisja: Gjëmë! Gjëmë! Komshijet të tmerruara më përkëdhelnin dhe më luteshin të pushoja. Një ditë kur po pyesja nënën, mora vesh se kur isha foshnje pija qumësht edhe të mërkurën, edhe të premten, pra edhe në ditët e shenjta. Kur dëgjova këtë ia plasa të qarit me ngashërim. Unë u shisja shokëve lodrat e mia dhe blija botime popullore që tregonin jetën e shenjtorëve.

Çdo mbrëmje ulesha në stolin tim në oborr mes vazove me borzilok e karafila Indie dhe lexoja me zë të lartë të gjitha vuajtjet që kishin hequr shenjtorët për të shpëtuar shpirtrat e tyre. Komshijet mblidheshin me punët e tyre, me teshat që qepnin, njëra punonte triko ulur, disa pinin kafe e dëgjonin. Pak nga pak një e qarë për vuajtjet e pasionet e shenjtorëve dëgjohej në oborr. Kanarina që qëndronte mbi mimozat, dëgjonte leximin dhe të qarën, frynte gryken dhe këndonte si e dehur. Kopshti i vogël, me bimët aromatike dhe pjergullën sipër, i mbyllur siç ishte, i ngrohtë dhe i parfumuar, në mes të të qarave të grave, dukej sikur ishte savani i shenjtë. Njerëzit që kalonin aty mbanin hapat, thoshin: - Ndonjë njeri ka vdekur! Pastaj shkonin ia çonin lajmin e keq babait tim, por babai tundte kokën: - Nuk është gjë, - thoshte. - Është djali im që i bën katekizëm komshinjve.

Në imagjinatën time fëminore shpaloseshin dete të largët, anije që largoheshin në mënyrë të fshehtë, manastire që shkëlqenin për-

mes shkëmbinjve, luanë që u sillnin ujë asketëve, shpirti im vërshonte mes hurmave dhe gamileve. Të përdalat që përpiqeshin të hynin në kishë, flokë që digjeshin e ngriheshin në qiell, shkretëtirat që bucisnin nga zhurma e sandaleve dhe e të qeshurave të grave. Tunduesi, si plaku i vitit të ri, sillte si dhuratë për eremitët, ushqim, për gratë ar; por këta i mbanin sytë të ngulur te Zoti dhe kështu, tunduesi zhdukej.

Ji i fortë, i duruar, përbuze lumturinë, mos ki frikë nga vdekja, mos e kërko në tokë të mirën; këto thirrje dilnin papushim nga këto tekste popullore dhe ishin pikërisht këto që edukonin zemrën time fëmijërore; dhe në të njëjtën kohë ndjeja një etje të egër për arratisje të fshehtë, për udhëtime të largëta, shtegëtime të mbushura me heroizma.

Lexoja për jetët e shenjtorëve, dëgjoja legjenda, veshët e mi perceptonin biseda dhe të gjitha këto shndërroheshin, deformoheshin brenda meje, bëheshin iluzionet e mia farfuritëse; unë mblidhja komshinjtë e mi të vegjël, ose shokët e klasës dhe ua tregoja atyre si histori që më kishte ndodhur mua. U thosha që sapo vija nga shkretëtirat, se më kishte sjellë një luan, të cilin e kisha ngarkuar me dy shtëmba dhe së bashku kishim shkuar te burimi për të mbushur ujë; se pardje, më ishte shfaqur një ëngjëll para portës sonë, i cili kishte shkulur një pendë nga krahu dhe ma kishte dhënë, madje unë mbaja një pendë në dorë dhe ua tregoja. Një ditë më parë në shtëpi kishin therur një gjel të bardhë dhe unë i kisha shkulur një pendë të gjatë të bardhë. - U thosha se me pendën e gjelit do të bëja një penë shkrimi...

- Penë shkrimi? E ç'do të shkruash?

- Jetën e shenjtorëve. Jetën e gjyshit tim.

- Pse gjyshi yt shenjtor ishte? A nuk na ke thënë që ai luftonte kundër turqve?

- Eh! Është e njëjta gjë, - përgjigjesha unë dhe prisja pendën me brisk që të mund të shkruaja me të.

Një ditë në shkollë, lexuam në librin e këndimit për një fëmijë që kishte rënë në pus dhe ishte gjendur në një qytet të pasur, me kisha të arta, kopshte të lulëzuara, dyqane plot me ëmbëlsira, bombone dhe pushkë të vogla. Shpirti im u ndez. Vrapova për në shtëpi,

hodha çantën në oborr dhe u vara në grykën e pusit, që të bija dhe të hyja në qytetin e pasur. Nëna ishte ulur në dritaren që shikonte në oborr dhe po krihte motrën time; ajo më dalloi, lëshoi një thirrje, vrapoi dhe më kapi nga përparësja në momentin kur unë me kokën përposhtë jepja goditje me këmbë në tokë në mënyrë që të përmbysesha brenda në pus.

Çdo të diel, kur shkoja në kishë, unë shikoja në një ikonë, që gjendej sipër ikonostazit, Krishtin që ngrihej nga varri duke mbajtur një flamur të bardhë që shpalosej në ajër. Poshtë rojet ishin rrëzuar me shpinë dhe shikonin me tmerr. Shpesh kisha dëgjuar të flitej për revoltat e kretasve, për luftrat, më kishin thënë se gjyshi im nga ana e babait kishte qenë një komandant i shquar lufte dhe pak nga pak duke parë Krishtin unë gjithmonë e më tepër bindesha se ai ishte gjyshi im. Atëherë mblodha miqtë përpara ikonës; - Ja gjyshi im, - u thashë atyre, - Ai mban flamurin, shkon në luftë dhe ja, shikoni aty poshtë turqit të rrëzuar. Ajo që thosha nuk ishte as e vërtetë, as gënjeshtër, ajo i kapërcente kufijtë e logjikës e të moralit dhe qëndronte pezull, e lirë në ajër. Në qoftë se do të më thoshin se po rrëfeja një gënjeshtër atëherë do të kisha nisur të qaja nga krenaria. Penda në duart e mia kishte pushuar së qëni një pendë gjeli, atë ma kishte dhënë një ëngjëll, unë nuk gënjeja, kisha besimin e patundur se Krishti me flamur ishte gjyshi im, dhe poshtë ushtarët e tmerruar ishin turqit.

Shumë më vonë, kur nisa të shkruaja poema dhe romane, e kuptova se ky përpunim i fshehtë quhej krijim.

Një ditë kur po lexoja *"Jeta e shën Janit"* u çova me hov dhe mora një vendim: - Do të shkoj në malin Athos për tu shenjtëruar! Dhe pa u kthyer për të parë nënën, - kështu kishte vepruar edhe shën Jani. Kapërceva pragun dhe dola në rrugë. Kalova nëpër rrugicat më të humbura dhe arrita në port; vrapoja, kisha frikë se mos ndonjë nga dajot e mi më shikonte dhe më kthente në shtëpi. Iu afrova kaikes së parë që po bëhej gati për të ngritur spirancën, një marinar po zgjidhte litarin që mbante kaiken të lidhur. Unë dridhesha nga emocioni; iu afrova atij:

- Do t'më marrësh edhe mua në kaiken tënde kapedan?
- Ku do të shkosh?

- Në Malin Athos.
- Ku është mali Athos? E ç'do të bësh atje?
- Do të shenjtërohem.

Pronari i anijes ia plasi të qeshurit; ai nisi të përplaste duart sikur donte të trembte pulat.

- Në shtëpi! Në shtëpi! - më bërtiti.

U nisa me vrap, u ktheva në shtëpi i turpëruar. U mblodha kruspull mbi kanape dhe nuk i tregova njeriu gjë; sot po e tregoj për herë të parë. Tentativa ime e parë për t'u bërë shenjt dështoi.

Zhgënjimi im zgjati për shumë vite; ndoshta vazhdon edhe sot. Duhet thënë se unë kisha lindur ditë të premte më 18 shkurt, ditën e të Vdekurve dhe mamia e vjetër më kishte marrë në duar e më kishte nxjerrë në dritë, më kishte ekzaminuar me kujdes sikur të shihte tek unë shenja të fshehta; ajo më kishte ngritur lart e kishte thënë: - Ky fëmijë, kujtojeni këtë që po ju them, do të bëhet peshkop.

Kur e mësova më vonë këtë profeci të mamisë, kuptova se ajo përputhej me dëshirat e mia më të fshehta dhe e besova. Që atëherë një përgjegjësi e madhe peshonte mbi mua, dhe nuk doja të bëja më asgjë që nuk do ta bënte një peshkop. Shumë më vonë kur e pashë se çfarë bënin peshkopët ndërrova mendje; për të qenë i denjë për shenjtërinë, të cilën e dëshiroja me shumë pasion, nuk doja të veproja më si peshkopët.

DËSHIRË PËR ARRATISJE

Në atë periudhë ditët ishin monotone dhe kalonin ngadalë. Njerëzit nuk lexonin gazeta, radiot, telefoni, kinematë nuk ekzistonin, jeta rridhte shtruar, pa zhurmë, pa fjalë të kota. Çdo njeri ishte një botë e mbyllur, çdo shtëpi ishte e izoluar; brenda tyre, të zotët e shtëpisë plakeshin nga dita në ditë, festonin në heshtje që të mos i dëgjonte njeri, grindeshin në fshehtësi, sëmureshin pa u ankuar dhe vdisnin. Atëherë porta hapej vetëm për të nxjerrë të vdekurin dhe për një çast, katër muret tregonin të fshehtat e tyre; por menjëherë porta mbyllej sërish dhe jeta rimerrte ritmin e saj pa zhurmë. Për festat vjetore, për lindjen e Krishtit, për vdekjen dhe ringjalljen e Tij të gjithë visheshin bukur, stoliseshin, linin shtëpitë dhe nga të gjitha rrugicat njerëzit derdheshin drejt kishës. Ajo i priste me portat e mëdha të hapura. Kisha ndizte shandanet e mëdhenj dhe llampadarët, ndërsa i zoti i shtëpisë, shën Minai, i hipur mbi kalë, qëndronte në prag dhe priste banorët e dashur të Megalo Kastros. Zemrat ngazëlleheshin, zhdukej trishtimi, të gjithë bëheshin një, ata harronin emrin e tyre, nuk ishin më skllevër, nuk kishte më grindje, as turq, nuk kishte më vdekje. Dhe ja, atje në kishë, me në krye kapedanin Mina, kalorësin, ata e ndjenin të gjithë se ishin një armatë e pamposhtur.

Jeta në ato vite ishte e thellë, e palëvizshme. Pak të qeshura, shumë lot e akoma më tepër brenga të fshehura kishte atëherë Megalo Kastroja. Pronarët tregoheshin të kujdesshëm për intresat e tyre, njerëzit nënshtroheshin; ata çoheshin me respekt kur kalonte një i pasur.

Por të gjithë i bashkonte një pasion i përbashkët, që i bënte të harronin vuajtjet dhe privimet dhe i bënte të gjithë vëllezër, të cilin ata nuk e thoshin dot sepse frikësoheshin nga turqit. Dhe ja një ditë ujërat e qetë u trazuan. Një mëngjes të bukur u pa të hynte në port

një vapor i mbuluar me flamur. Të gjithë njerëzit e Megalo Kastros që gjendeshin në port, kishin mbetur gojëhapur. Ç'ishte ajo barkë shumëngjyrëshe që gëlonte, me krahë, e stolisur me flamur, që po futej midis dy kullave veneciane të hyrjes së portit dhe kë sillte? Mirësi hyjnore! Një thoshte se sillte zogj, një tjetër thoshte se ishin njerëz të maskuar për karnavale, një tjetër akoma se ishte kopsht lundrues, nga ata që kishte parë në detet e ngrohtë e të largët të Simbad detarit. Atëherë një zë i egër u dëgjua në kafenenë e portit: Ho! Ho! Përshëndetje pelerina!

Për një çast, të gjithë morën frymë, ata e kishin kuptuar. Anija ndërkohë ishte afruar. Tashmë shihej qartë se ajo ishte ngarkuar me femra të veshura me rroba lara-lara, me kapele me pendë, me pelerina shumëngjyrëshe, faqet i kishin të trukuara me fard të kuq shumë të ndezur. Kretanët e vjetër duke i parë bënin kryqin: prapa, satana! - dhe pështynin.

- Për çfarë vijnë ato këtu? Këtu është Kastro i shquar, palaçollëqe të tilla nuk duam.

Një orë më vonë, afishe të kuqe ishin ngjitur në të gjitha muret dhe të gjithë e kishin marrë vesh: me sa dukej ishte një trupë me komedianë dhe thuhej se kishin ardhur për të argëtuar banorët e Megalo Kastros. Akoma dhe tani nuk kam arritur ta kuptoj sesi u bë mrekullia, sesi im atë mundi të më merrte për dore e të më thoshte: " - Eja shkojmë në teatër, eja të shohim se ku mund të arrijë djalli". Mbrëmja kishe rënë, ai më mbante përdore dhe ne zbritëm drejt portit, në një lagje të varfër të cilën unë nuk e njihja, me shtëpi të rralla dhe oborre të mëdhenj. Një prej këtyre oborreve ishte krejtësisht i ndriçuar, dëgjoheshin klarineta dhe daulle, një vel anijeje ishte varur te hyrja dhe po ta ngrije mund të futeshe brenda. Ne hymë. Banka, stola, karrige; burra dhe gra rrinin ulur, shikonin përpara tyre një perde dhe prisnin që ajo të hapej. Një fllad i lehtë frynte nga deti, ajri vinte erë e mirë, burra e gra flisnin, qeshnin, përtypnin kikirikë dhe fara kungulli.

- Kush është teatri këtu? - pyeti babai im, i cili hynte për herë të parë në një festë të tillë. Dikush i tregoi perden. Atëherë, u ulëm dhe ne, duke i mbajtur sytë të ngulitur te perdja. Mbi beze ishte shkruar me gërma të mëdha: "Hajdutët - nga Shileri, dramë shumë

argëtuese" dhe poshtë: *"Për gjithçka do të shihni mos u shqetësoni, është imagjinare".*

- Çdo të thotë imagjinare? - e pyeta tim atë.

- Pallavra, - u përgjigj ai.

Babai donte ta pyeste fqinjin e tij për hajdutët, por nuk pati kohë; u dëgjuan tre goditje dhe perdja u ngrit. Unë zgurdullova syë; një parajsë ishte hapur para meje, engjëj meshkuj e femra shkonin e vinin me veshje të zbukuruara me krahë, me paruke të arta, faqet e tyre ishin të lyera me fard të bardhë dhe portokalli. Ata flisnin fort por unë nuk i kuptoja, zemëroheshin por unë nuk e dija pse. Pastaj papritur u shfaqën dy kolosë, me sa dukej dy vëllezër, ata nisën të ziheshin, të shaheshin e të ndiqnin njëri-tjetrin për ta vrarë. Babai kishte zgjatur veshët; dëgjonte, mërmëriste dhe nuk ishte i kënaqur. Ai lëviste mbi karrige sikur ishte ulur mbi qymyr të ndezur, nxirrte shaminë dhe fshinte djersën që i rridhte nga balli; por kur e kuptoi se ata të dy që ziheshin ishin vëllezër, u ngrit vrulltas.

- Ç'është ky karagjozllëk? - tha ai me zë të lartë. - ikim që këtej! Më kapi për krahu e në nxitim e sipër, duke përmbysur dy tre karrige dolëm.

Sapo dolëm më shkundi nga shpatullat:

- Që këtej e tutje, miku im, mos vër më këmbë në teatër, dëgjove, dëgjova, thuaj? Në të kundërt ta griva mishin.

Kështu ka qenë përvoja ime e parë me teatrin. Frynte një fllad i vakët, bari i gjelbërt sikur kishte mbirë brenda meje, shpirti më ishte mbushur me lule; stina e pranverës po vinte, e shoqëruar nga i fejuari i saj shën Gjergji, i hipur mbi një kalë të bardhë, pastaj ajo largohej, vinte vera dhe shën Maria shtrihej mbi tokat e mbuluara nga frytet, në mënyrë që ajo të pushonte pasi kishte sjellë në jetë birin e saj.

Shën Dhimitri vinte në mes të shirave, i hipur mbi një kalë të kuq dhe tërhiqte Pas vetes, të kurorëzuar nga gjethe të thara hardhie, vjeshtën. Vinte dimri, ne ndiznim në shtëpi mangallin dhe uleshim të gjithë rreth tij - kur nuk ishte babai aty - nëna, motra, dhe unë, piqnim gështenja dhe bizele mbi hirin e nxehtë. Ne prisnim Krishtlindjet që të na vinte gjyshi me faqet e kuqe dhe me derrkucin e mbështjellë me gjethe limoni. Pikërisht kështu e përfytyroja dimrin,

të ngjashëm me gjyshin tim, me çizme të zeza, mustaqe të bardha, duke mbajtur në duar një derrkuc të pjekur.

Koha kalonte, unë rritesha, borziloku dhe karafilat e Indisë në oborr zvogëloheshin. Tashmë shkallët e Eminesë unë i ngjisja menjëherë pa patur nevojë që ajo të më mbante për dore.

Unë rritesha, e brenda meje rriteshin dëshirat e vjetra; dëshira të ikja lindnin. Jetët e shenjtorëve ishin tashmë shumë të vogla për mua dhe më zinin frymën; jo se kisha rreshtur së pasuri besim, unë besoja, por shenjtorët më dukeshin shumë të nënshtruar, ata ulnin gjithmonë kokën para Zotit dhe i thoshnin gjithmonë "po". Gjaku i Kretës ishte zgjuar tek unë, parashikoja, pa e patur shumë të qartë në shpirtin tim, se burrë i vërtetë është ai që reziston, që lufton dhe nuk ka frikë t'i thotë "jo"-në as Zotit.

Gjithë këtë turbullim të ri nuk mundesha ta shpejgoja qartë me fjalë; por në atë periudhë unë nuk kisha nevojë për fjalë; unë kuptoja pa u gabuar asnjëherë, pa ndihmën bile as të shpirtit, as të fjalëve. Më pushtonte trishtimi kur shihja shenjtorët, me duart e kryqëzuara, të ulur në portën e parajsës, duke thirrur, duke u lutur dhe pritur që ajo të hapej. Ata më kujtonin lebrozët që shihja çdo herë kur shkoja në vreshtën tonë, të ulur përpara portës së fortifikuar të qytetit, me hundën të gërryer, pa gishta, me buzët e kalbura, duke u shtrirë cungjet e tyre kalimtarëve e duke kërkuar mëshirë! Nuk provoja për ta asnjë mëshirë, më neveriteshin, ktheja kokën nga ana tjetër dhe u largohesha nxitimthi, duke patur parasysh ata, në shpirtin tim fëmijëror shenjtorëve u ra vlera.

Nuk ka mënyrë tjetër për të hyrë në parajsë?

Duke i lënë gogolat dhe princeshat e përrallave kisha hyrë në shkretëtirën e Tibetit me shenjtorët lypsarë dhe tashmë e ndjeja se duhej të shkëputesha edhe prej tyre.

Për çdo festë të madhe, nëna bënte sheqerka, ose ëmbëlsira me arra, apo llokume, ndërsa për Pashkë bënte ëmbëlsirën e Pashkës. Unë vishja rrobat e festës dhe shkoja i shpërndaja në shenjë urimi tek dajat dhe hallat e mia. Ata më prisnin me ngrohtësi dhe më jepnin lekë për të blerë, siç thoshin ata, bombone. Por të nesërmen unë vrapoja në librarinë e vogël të zotit Lup dhe blija fletë që flisnin për toka të largëta dhe eksploratorë të mëdhenj. Duhet besuar se

fara e Robinsonit kishte rënë tek unë dhe kishte nisur të jepte frytet e saj.

Nuk kuptoja veçse pak gjëra nga jetët e reja të shenjtorëve, por thelbi i tyre depozitohej në fund të shpirtit tim. Ai hapej dhe mbushej me udhëtime mesjetare, me pejsazhe ekzotike dhe ishuj që kundërmonin erë karafil dhe erë kanellë. Njerëz të egër të mbuluar me pendë të kuqe hynin brenda meje, ndiznin zjarr, piqnin njerëz, kërcenin dhe rreth tyre ishujt qeshnin nën shi. Këta shenjtorë të rinj nuk lypnin, ato që dëshironin, ata i merrnin me forcën e shpatës. Ah! Sikur të mundnin si kalorës, të hynin me kuaj në Parajsë! Hero dhe në të njëjtën kohë shenjt, ja njeriu i përkryer.

Shtëpia e prindërve po bëhej e ngushtë. Megalo Kastro po bëhej i ngushtë. Toka në atë kohë më dukej si një pyll tropikal, me zogj dhe kafshë shumëngjyrëshe, me fruta të ëmbla, dhe në ëndrrën time unë doja të kaloja menjëherë pyllin, duke mbrojtur një grua, të zbehtë nga frika, që ishte në rrezik.

Një ditë, duke kaluar përpara një kafeneje unë pashë fytyrën e saj; ajo quhej Zhënëvievë dë Brabant. Shenjtorët në imagjinatën time ishin njësh me kalorësit e dehur nga entuziazmi, të cilët ishin nisur të shpëtonin botën. Ata ishin njësh me eksploratorët e mëdhenj dhe anijet e Kristofor Kolombit që ishin nisur nga një ishull i vogël i Spanjës, ishin e njëjta gjë, me anijet që deri në atë kohë, kishin lundruar brenda meje të ngarkuar me shenjtorë që lundronin drejt shkretëtirës dhe mbi velat e tyre frynte e njëjta erë.

Më vonë, kur lexova historinë e heroit të Servantesit, Don Kishoti, m'u duk si një shenjtor martir, i cili përtej jetës së varfër të përditshme, ishte nisur përmes fishkëllimave dhe të qeshurave për të gjetur thelbin, pas asaj që dukej. - Çfarë thelbi?

Nuk e dija atëherë dhe e kuptova më vonë. Nuk ka veç një thelb, gjithmonë i njëjti dhe njeriu akoma nuk ka gjetur mënyrë tjetër; shkatërrimi i materies dhe nënshtrimi i individit ka një fund që e kalon iluzionin. Për një zemër që beson dhe do, nuk është iluzion guximi, besimi dhe aksioni e pasurojnë atë.

Vitet kalonin. - U përpoqa të vija rregull në kaosin e imagjinatës sime; por ky thelb ashtu si më ishte shfaqur i turbullt akoma atëherë kur isha fëmijë, më duket gjithmonë zemra e së vërtetës: Ne kemi

si detyrë, përtej preokupimeve tona personale, përtej zakoneve tona, përtej vetes sonë, të përcaktojmë një objektiv dhe ditë e natë, duke shpërfillur të tallurat, urinë e vdekjen, të përpiqemi ta arrijmë.

Jo, kurrë, nuk mbërrin, sepse një shpirt krenar, kur arrin qëllimin, ecën më tutje. Jo, kurrë nuk mbrrin, sepse nuk ndalet asnjëherë së ngjituri. Është e vetmja mënyrë t'i japësh vetes fisnikëri. Në mes të flakëve kalova vitet e fëmijërisë. Gjithë aventurat e shenjtorëve e të heronjve më dukeshin rruga më e thjeshtë dhe më realiste e njeriut. Këto flakë përziheshin me të tjera më të mëdha që digjnin në ato kohë skllavërie Megalo Kastron dhe Kretën.

Në ato kohë të lashta, heroike, Megalo Kastro nuk ishte vetëm një grup shtëpish, dyqanesh dhe rrugësh të ngushta të vendosura mbi një breg të Kretës, përpara një deti vazhdimisht të trazuar. Shpirtrat që e banonin nuk ishin një grup i revoltuar, pa kokë, por me mijëra koka burrash, grash e fëmijësh që harxhonin të gjitha përpjekjet në problemet e përditshme të të ngrënit të fëmijëve, të grave. Një ligj i pashkruar e i rreptë, i qeveriste, askush nuk ngrinte krye kundër ligjit të egër që kishin mbi kokë. Dikush tjetër më i madh se ata i jepte urdhërat. I gjithë qyteti ishte një garnizon, çdo shpirt ishte gjithashtu një garnizon i mbyllur përjetësisht dhe kishte për udhëheqës një shenjtor, shën Minanë, mbrojtësin e Megalo Kastros. Gjatë gjithë ditës ai qëndronte në këmbë pa lëvizur, në ikonën e tij, brenda në kishë, hipur në një kalë gri duke mbajtur në dorë një ushtë të kuqe. Kishte një mjekër të shkurtër, të dredhur, ishte i nxirë nga dielli e me vështrim të egër. Gjatë gjithë ditës ai qëndronte atje, i ngarkuar me stoli të argjenda, me duart, me këmbët, sytë, zemrat që njerëzit i kishin lënë pezull përpara vullnetit të tij duke iu lutur që t'i shëronte. Ai rrinte pa lëvizur dhe dukej sikur s'ishte tjetër perveç se një pikturë, dërrasë dhe bojë. Por sapo binte nata, kur kretasit mbylleshin në shtëpitë e tyre dhe dritat shuheshin një nga një, ai me një goditje shkulte stolitë e argjendta, i binte me mamuze kalit dhe përshkonte lagjet greke. Bënte inspektimin. Mbyllte ato porta që kretasit i kishin harruar hapur, iu fishkëllente të vonuarve të natës që të ktheheshin në shtëpitë e tyre, rrinte në këmbë përpara portave dhe mbante vesh i kënaqur kur dëgjonte këngë; kjo duhet të jetë dasmë, mërmëriste, ata kanë bekimin e tij, paçin shumë fëmijë që të shtohen kre-

tasit. Pastaj i hidhte një sy ledheve që rrethonin Megalo Kastron dhe para se të lindte dielli, sapo dëgjohej gjeli i parë, ai i binte me mamuze kalit, kthehej në kishë dhe hipte në ikonën e tij. Hiqej sërish si indiferent, por kali ishte qull në djersë. Goja dhe kraharori ishin me shkumë. Kur kandilonafti, at Karalambos vinte herët në mëngjes që të pastronte e fërkonte shandanët, shikonte kalin e shën Minait qull në djersë por nuk çuditej; ai e dinte, të gjithë e dinin se shenjtori natën bënte inspektim. Dhe kur turqit mprihnin thikat për të sulmuar kretasit, shën Minai hovte nga ikona për të mbrojtur njerëzit e Megalo Kastros. Turqit nuk e shihnin, por dëgjonin hingëllimën e kalit të tij, shihnin shkëndijat që lëshonin patkonjtë mbi kalldrëm, i njihnin zërin dhe strukeshin të lemerisur nëpër shtëpitë e tyre. Megjithatë, disa vjet më parë ata e kishin parë me sytë e tyre.

Po përgatiteshin sërish për një masakër, dhe shën Minai i hipur mbi kalë, ishte vërsulur drejt lagjes turke. Në momentin kur ai u shfaq në cepin e rrugës, Mustafai gjysmë i çmendur, e kishte parë dhe kishte nisur të vraponte e të thërriste: Allah! Allah! Shën Minai zbriti menjëherë. Turqit kishin hapur pak portat, e kishin përgjuar dhe e kishin parë me mburojën e artë, me mjekrën gri e të dredhur dhe me heshtën e kuqe; u qenë dridhur gjunjët dhe i kishin vënë përsëri thikët në mill.

Shën Minai nuk ishte vetëm një shenjtor për Megalo Kastron, ishte gjithashtu udhëheqesi i tyre; ata e quanin Kapedan Minai dhe i çonin armët që t'ua bekonte. Im atë i ndizte llambadhe dhe zoti e dinte atë që duhej t'i thoshte sesa vuante ai që Kreta po vononte të çlirohej.

Ai ishte udhëheqësi i kretasve. Hasan beu, armiku mizor i kretasve, ishte komshiu i tij; banesa e tij ishte pranë kishës, dhe një natë ai dëgjoi goditje të forta në murin pranë shtratit; ai e kuptoi se ishte shën Minai që e kërcënonte sepse po atë ditë ai kishte rrahur një kretas. Kapedan Minai ishte zemëruar dhe tani i binte murit. Hasan beu ngriti grushtet dhe nisi t'i binte dhe ai murit - Hej! Komshi! - i thirri. - Ti ke të drejtë; po ti ke të drejtë. Pusho së gjithuri murin dhe unë do të të sjell çdo vit dy kacekë me vaj për kandilin tënd dhe njëzet okë dyllë që ti të qetësohesh. Ne jemi fqinj, të mos grindemi.

Që nga ajo ditë, Hasan beu, më 11 nëntor në festën e shën Minait dërgonte shërbëtorin e tij që të çonte në oborrin e kishës dy kacekë me vaj dhe njëzet okë dyllë. Dhe shën Minai nuk i kishte rënë më murit të tij.

Ka një lloj flake në Kretë, le të themi një shpirt, diçka më e fortë se jeta dhe vdekja. Është krenaria, këmbëngulja, guximi dhe në të njëjtën kohë diçka tjetër, e patreguar dhe e pallogaritur, që e bën dikë të jetë në të njëjtën kohë i gëzuar dhe i tmerruar që është njeri.

Kur isha fëmijë, në Kretë ndihej era e kafshës së kuqe, turqve. Mbi kokën e gjithë secilit qëndronte varur një jatagan turk. Vite më vonë, kur pashë *"Toledo në shtrëngatë"* kuptova se çfarë ajri thithja kur isha fëmijë dhe çfarë engjëjsh të ngjashëm me meteorë qëndronin mbi Kretë.

Muaji gusht ka qenë për mua, që kur isha fëmijë akoma dhe tani, muaji më i dashur. Është ai që sjell rrushin, fiqtë, pjeprat, shalqinjtë. Unë e quaja shën gushti. Ai është mbrojtësi im, - thosha. Atij ia drejtoj lutjen time. Kur doja diçka, unë ia kërkoja atij; ai do t'ja kërkonte Zotit dhe Zoti do ma jepte mua. Një ditë mora bojrat dhe i bëra portretin; i ngjante shumë gjyshit tim fshatar. Kishte të njëjtat faqe të kuqe, të njëjtën buzëqeshje, por ishte me këmbët e zhveshura mbi një shtypëse, shtypte rrush dhe këmbët deri te gjunjtë dhe më lart akoma deri te kofshët ia kisha lyer me të kuqe nga mushti e kokën ia kisha zbukuruar me gjethe hardhie. Megjithatë mungonte diçka: Pse?

Sepse shamia që mbante gjyshi im kishte dy nyje, nga një në çdo cep, si brirë; unë e vështrova mirë dhe i vura dy brirë mbi kokë. Që nga ai moment që e pikturova dhe fiksova portretin e tij, besimi që kisha tek ai u forcua tek unë dhe çdo vit prisja që të vinte, të vilte vreshtat e Kretës, të shtypte rrushin dhe të bënte mrekullinë, që nga rrushi të nxirrte verë. Më kujtohet që ky mister më shqetësonte shumë; si bëhej rrushi verë? Vetëm shën Gushti mund ta bënte një mrekulli të tillë. Unë thosha: - Ah! Sikur të mundja ta takoja ndonjë ditë në vreshtën që kemi jashtë Megalo Kastros dhe ta pyesja për sekretin. Se çfarë ishte kjo mrekulli, nuk e kuptoja. Rrushi i gjelbër

piqej, pastaj bëhej verë, verën njerëzit e pinin dhe deheshin. Përse deheshin? Të gjitha këto gjëra më dukeshin mistere të tmerrshme dhe kur një ditë e pyeta tim atë, ai mblodhi vetullat:

- Merru me punët e tua, - m'u përgjigj.

Në gusht gjithashtu hapnin rrushin mbi trina që të thahej në diell. Një vit ne kishim shkuar në vreshtën tonë dhe kishim zbritur në shtëpinë e vogël në fshat; ajri kundërmonte, toka të digjte, gjinkallat digjeshin gjithashtu sikur qëndronin mbi qymyr të ndezur.

Atë ditë ishte festë, 15 gusht. Punëtorët nuk punonin dhe im atë ishte ulur në rrëzë të një ulliri e pinte duhan. Komshinjtë ishin mbledhur rrotull. Edhe ata kishin hapur rrushin në diell e pinin duhan pranë tim eti, pa folur. Dukeshin të hidhëruar. Të gjithë ia kishin ngulur shikimin një reje të zezë që ishte shfaqur në qiell. Isha ulur pranë babait dhe shikoja, ajo më pëlqente. Ishte ngjyrë gri e errët, si push dhe rritej pa mbarim. Pamja e saj ndryshonte, një herë dukej si kacek i fryrë, njëherë ngjante me një zog gjahu me krahë të zinj, një herë me një elefant që e kisha parë në një pikturë; ai lëviste feçkën dhe përpiqej të prekte tokën. U ngrit një fllad i vakët, gjethet e ullinjve fërgëlluan. Një nga fqinjët u ngrit në këmbë dhe shtriu dorën drejt resë që lëvizte.

- E kà sjellë djalli, - mërmëriti. Zoti më thëntë gënjeshtar në qoftë se nuk na sjell përmbytje.

- Kafsho gjuhën, - i tha atij një plak nga ata të devotshmit. - Shën Mëria nuk do ta lejojë. Sot është festa e saj.

Babai im hungëroi por nuk nxori zë; ai besonte tek shën Mëria, por nuk besonte që ajo mund të komandonte retë.

Gjatë kohës që po flisnin ata, qielli u mbulua. Pikat e para të shiut që ranë, ishin të mëdha, të ngrohta. Retë u ulën poshtë, vetëtima të verdha, të heshtura, nisën të grisin qiellin.

- Shën Mëri! - thirrën burrat. - Na shpëto!

Të gjithë u ngritën rrëmbimthi, u shpërndanë, secili vraponte drejt vreshtës së tij ku kishin hapur atë që duhej të ishte rrushi i thatë për vitin; ndërkohë që vraponin, qielli nuk pushonte së nxiri, uji nga retë binte litarë - litarë. Stuhia shpërtheu. Rrëketë u zmadhuan, rrugët u kthyen në përrenj, dhe nga të gjitha vreshtat ngriheshin thirrje dhimbjesh. Disa mallkonin, të tjerët i thërrisnin shën Mërisë

që të kishte mëshirë për ta, të ndërhynte dhe në fund një kuje u ngrit pas ullinjve, në të gjitha vreshtat.

Unë ika nga shtëpia jonë e vogël; vrapoja nëpër rrebesh, një gëzim i çuditshëm më kishte pushtuar si një dehje. Ishte hera e parë që zbuloja këtë gjë mizore; mes katastrofave të mëdha një gëzim i pashpjegueshëm, jo njerëzor më pushtonte të tërin.

Hera e parë që kam parë një zjarr, ka qenë në shtëpinë e hallës sime Kaliopi, që digjej. Unë hidhesha dhe kërceja përpara flakëve, deri në çastin që dikush më mbërtheu nga zverku dhe më nxori përjashta. Kur vdiq mësuesi im Krasaqis unë me zor e mbajta të qeshurën. Sikur shtëpia e hallës dhe mësuesit të ishin një peshë mbi mua dhe unë sikur po lirohesha prej tyre. Zjarri, rrebeshi, vdekja më dukeshin shumë miqësore. Më bëhej sikur isha dhe unë një prej tyre. Sikur ne të gjithë ishim demonë dhe luftonim për të përmbytur tokën, shtëpitë, njerëzit.

Nuk munda ta kaloja rrugën, ishte kthyer në përrua. Ndalova dhe nisa të shikoja: bashkë me ujërat që rridhnin, rridhnin bistakët e rrushit gjysmë të tharë, puna e një viti; ato rrokulliseshin drejt detit dhe humbisnin. E qara dëgjohej akoma më e fortë, gratë ishin kredhur gjer në gjunjë në baltë dhe përpiqeshin të shpëtonin ndonjë bistak rrushi të thatë, të tjerat në këmbë në buzë të rrugës, kishin hequr shamitë e kokës dhe shkulnin flokët. Isha lagur der në palcë; u nisa me vrap drejt shtëpisë dhe përpiqesha të largoja gëzimin; nxitoja të shihja çfarë po bënte babai im. Po qante? Po betohej? Po thërriste? Duke kaluar përpara trinave, pashë që gjithë rrushi ynë ishte hedhur poshtë. Pashë babanë, të ulur në prag, i palëvizshëm duke kafshuar mustaqet. Pas tij nëna qante në këmbë.

- Baba,- thirra unë - Gjithë rrushi shkoi dëm.

- Por nuk kemi humbur ne të tjerët, - u përgjigj ai. - Pusho!

Kurrë nuk e harrova atë çast; besoj se ai ka qenë për mua një mësim i madh për çastet e vështira të ekzistencës sime. Më kujtohej babai, i qetë, i palëvizur, ulur në prag; ai nuk shante, nuk lutej, nuk qante; shikonte i palëvizur gjëmën dhe i vetëm mes gjithë komshinjve, ruante dinjitetin e burrit.

"Mirë se vjen fatkeqësi, në qoftë se vjen vetëm", themi ne në Kretë, sepse një fatkeqësi rrallë vjen vetëm. Të nesërmen qielli ishte shumë i pastër, ai kishte qëndruar zgjuar me mënyrën e vet, kishte hidhëruar njerëzit dhe tani qeshte. Pronarët po i binin kryq e tërthor vreshtave. Gjithë rrushi i thatë kishte humbur, një pjesë dukej akoma e zhytur në baltë. Në mesditë, babai u nis me nxitim për në Megalo Kastro; një prej miqve të tij kishte ardhur herët në mëngjes, i kishte pështëritur diçka në vesh dhe kishte ikur. Kishin marrë vesh se kretasit kishin vrarë një aga të madh në një fshat, se turqit ishin xhindosur dhe kretasit kishin rrëmbyer armët; do të ndodhte një revoltë e re. Turqit u derdhën në Megalo Kastro për t'u fshehur pas mureve veneciane. Unë dhe motra shëtisnim nëpër vreshtë duke mbledhur kokrrat e varura nëpër degët e hardhive. Papritur në rrugë u dëgjua zhurmë, thirrje, pëllitje. Po kalonte një grup me gomarë të vegjël ngarkuar me magje, me kazanë. Në atë grup kishte edhe gra turke, nga prapa vraponin burra, ca të zbathur, ca me këpucë të ngrëna e me çallma në kokë. Ata nuk flisnin, por bërtisnin e vraponin drejt Megalo Kastros. Llapushiteshin nëpër baltë, në mes të zhegut e baltës.

- Turqit, qentë! - ulëriti ime më.

Ajo na kapi nga krahët dhe na futi në shtëpi. Unë e kapa nga gjunjët.

- Nënë, pse vraponin ata? - e pyeta. - Çfarë donin? Po ti pse dridhesh?

Ajo më përkëdheli flokët.

- O Zot! Ç'kanë për të parë sytë e tu biri im! Sa keq që të lindësh në Kretë.

Kishim hapur dritaren përgjysmë dhe zumë të shikonim.

Grumbulli po largohej. Ata humbën pas ullinjve dhe rruga mbeti e heshtur. Në atë çast u duk babai.

- Hajde, shpejt, të ikim para se të bjerë dielli.

Ndërkohë që nëna na mori për dore, babai mori pistoletën poshtë jastëkut, e pa nëse ishte e mbushur, e futi në xhep dhe erdhi pas nesh.

Dielli perëndoi në çastin kur ne kaluam portën e qytetit. Dukej se rrugët po boshatiseshin, njerëzit vraponin, portat kërcisnin, nënat

thërrisnin fëmijët për t'u futur në shtëpi. Fqinja jonë turke, Fatma, nuk na uroi mirëmbrëma. Babai im u ul në vendin e tij, në cep të kanapesë, afër dritares së oborrit, nëna ishte në këmbë përpara tij dhe priste; ajo e dinte se ai do t'i jepte urdhëra.

Babai mori kutinë e duhanit, drodhi një cigare ngadalë pa ngritur sytë.

- Ju nuk do të dilni më prej këtej - tha.

U kthye nga unë dhe ngrysi vetullat:

- Ti ke frikë?

- Jo! - u përgjigja.

- Po sikur turqit të thyejnë derën e të vijnë e të të therin?

Unë u drodha. Ndjeva tehun e thikës në grykë. Do të kisha thirrur: Kam frikë! Kam frikë! Por sytë e tim eti ishin ngulur mbi mua.

Papritur drejtova shpinën:

- Edhe sikur të më therin nuk kam frikë! Unë mora zemër.

- Mirë, - tha ai.

Pastaj ndezi cigaren.

Gjatë verës, kur kisha shkuar në fshat për të parë gjyshin që po vdiste fjeta në një perimore bashkë me një prej dajave të mi. Papritur, kur po më merrte gjumi, dëgjova rreth meje: Crr! Crr! Crr! Diçka kërciste. U afrova i trembur tek daja.

- Çfarë janë këto që kërcasin? - e pyeta. - Kam frikë.

Ai më ktheu kurrizin i bezdisur sepse i kisha prishur gjumin.

- Fli o fëmijë qyteti, fli. Hera e parë është që e dëgjon? Janë shalqinjtë që rriten.

Pikërisht në të njëjtën mënyrë atë ditë duke parë babanë se si m'i kishte ngulur sytë unë ndjeja zemrën të më rritej dhe të më kërciste.

Megalo Kastro kishte katër porta të fortifikuara; çdo mbrëmje, turqit i mbyllnin dhe akush përgjatë natës nuk mund të hynte e të dilte. Kretasit që ishin brenda, binin si në çark; kur dielli lindte sërish ata i hapnin portat. Kështu pra, meqënëse portat e fortifikuara ishin edhe me barrikada, natën turqit mund të bënin një masakër, sepse në brendësi të qytetit turqit ishin më të shumtë dhe për më tepër kishin një garnizon.

Pas disa ditësh, unë pashë për herë të parë një masakër.

Pikërisht atëherë shpirti im fëmijëror, pa për të parën herë, pas maskës së bukur, pas tokës së gjelbëruar, vreshtës së ngarkuar me rrush, pas detit dhe bukës së grurit dhe pas buzëqeshjes së nënës sime - fytyrën e vërtetë të jetës; vdekjen.

Në atë kohë, për herë të parë, brenda meje u hodh fara, që shumë kohë më vonë do të çelte e do të sillte si frut, të kulluar, të hapur ditë e natë, pa frikë, pa shpresë, një sy të tretë në fund të shpirtit tim.

Ne ishim mbyllur në shtëpi, ulur e shtrënguar pas njëri tjetrit, nëna, motra dhe unë. Pas portës dëgjonim të kalonin turqit të shfrenuar, që shanin, kërcënonin, thyenin dyer e thernin kretas. Ne dëgjonim thirrjet dhe grahmat e të burgosurve, qentë që lehin dhe një zhurmë që përhapej në ajër sikur të ishte dridhje toke. Babai priste pas portës me pushkën të mbushur. Më kujtohet që ai mbante në dorë një gur të madh që e quante grihë dhe mprihte një thikë të madhe me dorezë të zezë. Ne prisnim. Ai na tha:

- Në qoftë se turqit shpërthejnë derën e hyjnë, unë do t'ju ther vetë që të mos bini në dorën e tyre. Ne të gjithë ishim dakord, nëna, motra dhe unë dhe prisnim. Gjatë atyre orëve, besoja se në qoftë se gjërat e padukshme do të mund të bëheshin të dukshme, do të kisha parë shpirtin tim të vdiste. Papritur, ndjeva se për pak orë, nga fëmijë isha bërë burrë.

Kështu kaloi nata; erdhi dita, zhurmat u shuan, vdekja u largua. Ne hapëm portën dhe nxorëm kokën përjashta, disa fqinj kishin hapur dritaret përgjysmë dhe shikonin rrugën me druajtje. Atë çast në rrugë po kalonte turku që shiste bukë. Ai e kishte fytyrën pa qime, në kokë mbante një tavë llamarine dhe me zërin e tij të hollë reklamonte bukët e tij me kanellë e sezam. Sa bukur, gjithçka po rilindte. Ne shikonim qiellin, retë dhe një tavë të mbushur me bukë që lëshonte aromë... Nëna më bleu një dhe unë e hëngra me një kënaqësi të papërshkrueshme.

- Mama, mbaroi masakra?

Nëna u tmerrua.

- Pusho - m'u përgjigj. - Pusho bir, mos e përmend atë fjalë. Mund të të dëgjojë dhe kthehet.

Shkruajta fjalën "masakër" dhe flokët m'u ngritën përpjetë, sepse ky emër nuk ishte thjeshtë shtatë gërma të radhitura njëra pas tjetrës,

por përfaqësonin një zhurmë të madhe, këmbë që shqelmonin dyer, fytyra të neveritshme që mbanin mes dhëmbëve një thikë, gra që ulërinin nëpër lagje dhe burra që prapa dyerve mbushnin pushkët. Ka edhe disa fjalë të tjera për ne që kemi jetuar fëmijërinë në atë kohë në Kretë, që pikojnë gjak e lot e për të cilat një popull i tërë është sakrifikuar e këto janë: liri, shën Mina, Krisht, revolucion...

Është shumë e vështirë për dikë që shkruan, sepse natyrisht është i detyruar ta kthejë në palëvizshmëri të gjithë vrullin që ka fjala brenda. Çdo fjalë është një kore e fortë që mban brenda vetes një fuqi shpërthyese për të gjetur kuptimin e saj, ajo duhet lënë të shpërthejë më vete si predhë dhe të çlirojë kështu shpirtin që e mban brenda.

Një rob kur shkonte për t'u lutur në Sinagogë, bënte testamentin dhe i thoshte me lot në sy lamtumirë gruas dhe fëmijëve të tij, sepse nuk e dinte nëse do të dilte gjallë nga lufta. Sepse - thoshte ai - kur shqiptoj fjalën "Zot" kjo fjalë copton zemrën time në mijëra copa, më pushton tmerri dhe nuk e di nëse do të isha në gjendje të vazhdoja me fjalët e tjera: "Ki mëshirë".

Ah! Sikur të gjendej dikush për të lexuar kështu një këngë ose fjalën "masakër", ose letrën e gruas që do, ose letrën e një burri që është munduar aq shumë dhe ka marrë shumë pak nga jeta! Të nesërmen, herët në mëngjes, babai më mori nga dora.

- Nisemi - më tha.

Nëna u tremb.

- Ku do ta çosh djalin? Asnjë kretas nuk ka dalë nga shtëpia.

- Nisemi - përsëriti babai. Ai hapi portën dhe ne dolëm.

- Ku do shkojmë? - e pyeta. Ndërsa dora ime dridhej në të tijën. Pashë rreth e rrotull, gjithçka ishte e shkretë, në cep të rrugës dy turq po laheshin tek burimi; uji skuqte.

- Ke frikë?

- Po.

- S'ke ç'i bën. Do të mësohesh.

Ne u kthyem në cepin e rrugës dhe u drejtuam për nga hyrja e portit. Një shtëpi lëshonte tym, një numër i madh dyersh ishin të shkatërruara dhe nëpër pragje kishte akoma gjak. Arritëm në vendin ku ishte çezma me luanë; pranë saj ndodhej rrapi i vjetër. Babai

ndaloi dhe shtriu krahun:

- Shiko! - më tha.

Unë ngrita sytë drejt rrapit dhe lëshova një klithmë. Tre të varur lëkundeshin njëri pranë tjetrit, të zbathur, të veshur vetëm me një këmishë dhe me gjuhën të nxjerrë jashtë gojës. Gjuha u ishte bërë e gjelbër. Ktheva kokën, nuk mundesha më. E kapa babanë nga gjuri. Por ai ma kapi kokën dhe m'a ktheu nga rrapi.

- Shiko akoma - më urdhëroi. Sytë e mi u mbushën me atë pamje.

- Deri në fund të jetës - më tha, më dëgjon? Deri në fund të jetës nuk do ta harrosh këtë pamje.

- Kush i ka vrarë?

- Liria. Qoftë e bekuar ajo, qoftë e bekuar.

Nuk kisha kuptuar asgjë. Shikoja, shikoja me sy të zgurdulluar tre trupat që lëkundeshin ngadalë mes fletëve të zverdhura të rrapit.

Babai hodhi një shikim rreth e rrotull dhe mbajti vesh; rrugët ishin të shkreta. Ai u kthye nga unë.

- Ti mund t'i prekësh më tha.

- Nuk mundem, - iu përgjigja i tmerruar.

- Po mundesh, mundesh, hajde!

Ne u afruam; babai bëri me shpejtësi kryqin.

- Preku këmbët! - më urdhëroi.

Ai më mori dorën. Në majat e gishtave ndjeva lëkurën e ftohtë. Ngjyra e trëndafiltë e mbrëmjes i mbulonte akoma.

- Përulu! - urdhëroi im atë. Dhe kur pa që përpiqesha të largohesha prej aty, më kapi poshtë krahëve e më ngriti në ajër, më uli kokën dhe më vuri me forcë gojën mbi këmbët e ngrira. Kur më lëshoi përtokë gjunjët më dridheshin. Ai u përkul dhe më pa:

- E bëj të mësohesh, - më tha.

Më mori për dore dhe u kthye në shtëpi. Nëna e shqetësuar rrinte në këmbë pas portës dhe priste.

- Në emër të Zotit ku ishit? - tha ajo - më mori me vrull mes krahëve dhe zuri të më përqafonte.

- Shkuam të falemi - iu përgjigj babai. Pastaj më vështroi me besim. Portat e qytetit mbetën të mbyllura tri ditë, të katërtën u hapën; por turqit endeshin nëpër rrugë, kafenetë ishin plot me ata, mblidheshin nëpër xhami dhe zemërimi i tyre nuk ishte ulur akoma. Sytë e

tyre ishin ende të mbushur me vrasje; një shkëndijë po të binte dhe Kreta merrte flakë. Kretasit, ata që kishin fëmijë, hipnin nëpër vapore, apo nëpër varka dhe niseshin drejt Greqisë së lirë. Ata që nuk kishin fëmijë, dilnin nga Megalo Kastro dhe merrnin malin.

Ne zbritëm në port për të ikur; babai në krye, nëna dhe motra në mes dhe unë në fund. - Ne burrat duhet të mbrojmë gratë, më kishte thënë babai, nuk isha as tetë vjeç, unë do të eci në krye, kurse ti në fund. Përshkuam lagjet e djegura. Akoma nuk i kishin marrë të gjithë të therurit dhe kufomat kishin nisur të merrnin erë. Babai u përkul, mori në pragun e një porte një gur të spërkatur me gjak: - Shiko je! - më tha.

Kisha filluar ta kuptoja këtë sjellje të egër të tij; ai nuk aplikonte Pedagogjinë e re, ndiqte të vjetrën, të pamëshirshmen, e vetmja që mund të shpëtonte racën. Kështu e edukon ujku këlyshin e tij të dashur, birin e vetëm, e mëson të gjuajë, të vrasë dhe t'i shpëtojë grackave me dinakëri ose zotësi. Pikërisht kësaj pedagogjie të egër të tim eti ia dedikoj qëndrueshmërinë dhe këmbënguljen që më ka më shoqëruar në momentet e vështira. Kësaj egërsie ia dedikoj mendimet e paepura që tani, në fund të jetës, më drejtojnë dhe nuk pranojnë ngushëllim as nga Zoti, as nga Djalli.

- Ngjitemi në dhomën tënde, që të marrim një vendim, - më tha ai para se të linim shtëpinë.

Kishte qëndruar në mes të dhomës dhe më tregoi një hartë të madhe të Greqisë që ishte varur në mur.

- Nuk dua të shkojmë në Pire, as në Athinë; aty do të mblidhen të gjithë. Do të fillojnë të qaraviten se nuk kanë për të ngrënë dhe do të kërkojnë lëmoshë. Kjo gjë më pështiroset. Zgjidh një ishull.

- Kë të dua?

- Kë të duash.

Kisha hipur në karrige, i inspektova një nga një të gjithë ishujt e detit Egje, të gjelbër mbi detin blu, shëtisja gishtin nga Santori në Milo, në Sifos, në Mikonos, në Paros, ndalova në Naksos. - Në Naksos - thashë. Forma dhe emri i tij më pëlqenin. Si mund ta parashikoja në atë moment, influencën vendimtare, që do të kishte në jetën time, kjo zgjedhje e rastit, fatale?

- Në Naksos! Përsërita. Pashë nga babai.

- Në rregull, - u përgjigj ai, - shkojmë në Naksos.

NAKSOS

Ky ishull kishte një butësi të madhe, një paqe të madhe, pamja e njerëzve atje ishte e mirë, shiheshin grumbuj me shalqinj, fiq, pjeshkë, e deti ishte i qetë. Shihja njerëzit, ata kurrë nuk kishin patur frikën e dridhjes së tokës, as të Turqisë; sytë e tyre nuk ishin të rrezikshëm. Këtu liria kishte shuar pasionin e lirisë e jeta derdhej si ujë i fjetur, i lumtur; nëse ndonjëherë ajo ishte turbulluar, kurrë s'pati një stuhi. Siguria është e pranishmja e parë që kam hasur duke përshkruar ishullin Naksos; siguria e, në krye të disa ditëve, mërzia. Ne zumë shoqëri me një të pasur naksiot, Qirie Llazarin, që kishte një kopsht të mrekullueshëm në Engarë, një orë larg qytetit. Ai na ftoi dhe ne banuam 2 javë në shtëpinë e tij. Çfarë bollëku, çfarë pemësh të ngarkuara me fruta, çfarë prehje! Kreta u bë legjendë, një re e largët rebele; kurrë frikë, kurrë gjak, kurrë luftë për lirinë; gjithçka bazohej e humbiste në këtë mbarësi të përgjumur të Naksosit.

Në një dollap të shtëpisë fshatare të feudalit, unë gjeta një turrë librash të zverdhur. I mora, u ula nën ulli, e i shfletova me një kuriozitet të pasionuar. Shihja figurat e vjetra të shpëlara - gratë, luftëtarët, kafshët e egra e pyjet e bananeve; në një libër tjetër, akujt, anijet e mbërthyera në akuj, arinj të ngjashëm me jastëkë pambuku, që rrokulliseshin në borë; e në një tjetër qytet të largët me oxhakë të lartë, punëtorë e zjarre të mëdhenj.

Shpirti im zgjerohej, bota zgjerohej me të; imagjinata ime mbushej nga pemë gjigande, kafshë të çuditshme e ca fjalë që lexoja tronditën zemrën time. Në një nga këta libra të zverdhur, kam lexuar: "I lumtur është njeriu, që sheh pjesën më të madhe të deteve e pjesën më të madhe të tokave." E në një tjetër: "Më mirë vlen të jesh një dem gjatë një dite se një ka gjatë një viti." Këtë, unë nuk e kuptoja shumë mirë, por dija një gjë; nuk do të kisha dashur të isha ka. Mbylla librin, fiksova sytë mbi kajsitë e pjeshkët ngarkuar me

kokrra, thitha ajrin e ngrohtë e të parfumuar; isha një insekt me krahë akoma të paformuara, që godet tokën me këmbët e tij të vogla e do të fluturojë, por zemra e tij dridhet: Do të mundet? Nuk do të mundet? Edhe pak durim. Bëra durim, përgatita në fshehtësi vetveten, madje pa dyshuar, për ditën kur do të kisha krahët e do të ikja. Por mbesa e qirie Llazarit, një vajzë që akoma si kish mbushur 12 vjeç, Stela, kishte varur një shilarës në pemën e ullirit fqinjë, lëkundej në ajër e këndonte; lëvizja bënte që t'i ngrihej fustani e gjunjët e saj të rrumbullakët, të bardhë, ndrinin në diell. Nuk mund ta duroja të dëgjoja këngën e saj, as të shihja gjunjtë e saj; një ditë u zemërova, ngrita librat e i hodha në tokë. Por ajo hante çimçakiz, më shihte e shpërtheu në të qeshura. Në të njëjtën kohë ajo më këndoi një këngë tallëse; i kam harruar vargjet të gjitha përveç këtyre:

Më shohin ata sy të zinj.
Uli ata, i dashuri im,
Sepse ata më vrasin,

- Stela, thirra me inat duke u ngritur papritmas, ose ik ti ose të iki unë. Ajo zbriti me nxitim nga shilarësi.

- Do të ikim bashkë, m'u përgjigj. Ajo nuk qeshi më. Uli zërin: - Do të ikim bashkë i trishtuari im i gjorë, sepse të hënën do të mbyllesh në shtëpinë e priftërinjve katolikë; dëgjova babanë tënd të flasë me xhaxhanë tim.

Në Naksos, në kështjellën ku banojnë prej shekujsh pushtuesit francezë, ka një shkollë franceze të priftërinjve katolikë. Ne shkuam atje një ditë, babai e unë, ai e pa për një kohë të gjatë e tundi kokën: - Këtu, mësohen shumë gjëra, - më tha; por mësuesit që i sjell djalli, janë priftërinj katolikë; me ta rrezikohet rënia në katoliçizëm.

Ai nuk më foli më për këtë shkollë; por unë e ndjeja se ajo ide e brente, e ai nuk dinte çfarë vendimi të merrte. E atë natë, natën e të njëjtës ditë kur Stela më kishte paralajmëruar, babai më mori të bënim një shëtitje në kopsht pas darkës. Hëna ndriçonte, bota kundërmonte.

Ai qëndroi për një kohë të gjatë pa folur; më në fund, në çastin kur ne do të ktheheshim në shtëpi, ai ndali;

- Revolucioni në Kretë, - tha, - do të zgjasë shumë kohë; unë do kthehem në ishull; S'mund t'i lë të krishterët të luftojnë, ndërsa unë të shëtis në kopshte. Çdo natë në gjumë shoh gjyshin tim që më qorton; duhet të shkoj. Gjatë kësaj kohe, unë nuk dua që ti të humbësh kohë, e pra, unë nuk dua që ti të humbasësh kohën tënde; duhet të bëhesh burrë.

Heshti; bëri dy hapa, u ndal përsëri;

- Kuptove? - më tha. Burrë, që do të thotë, të bëhesh dikushi, i vlefshëm për vendin tënd. Është gjynah që ti nuk je bërë për ushtri, ti je bërë për studim. Çfarë do të bësh atje? Është rruga jote, ndiqe atë. Kuptove? Bëj studimet, nuk dua që të bëhesh as mësues, as harabel, as i shenjti Salomon. Vëre mirë në kokë, unë e kam marrë vendimin tim, tani ti merr tëndin. - E nëse ti nuk je i mirë as për ushtri, as për studim, s'ia vlen të jetosh.

- Kam frikë nga etërit katolikë, - i thashë.

- Unë gjithashtu kam frikë prej tyre. Burri i vërtetë ka frikë por triumfon mbi frikën. Kam besim tek ti.

Ai reflektoi një çast, dhe korigjoi: - S'kam besim te ti, kam besim në gjakun që rrjedh në venat e tua, në gjakun e Kretës. Shko, bëj kryq, shtrëngo grushtat e të hënën, nëse Zoti do, vemi të regjistrohesh tek etërit katolikë.

Ditën që unë e babai morëm të përpjetën që të çonte te kështjella ku ishte shkolla franceze, binte shi. Një shi i mrekullueshëm vjeshte, rrugicat ishin zbërdhylur, deti pas nesh rënkonte, një puhi e lehtë frynte e gjethet e pemëve ngjyrë kafe e papjekur shkëputeshin nga pemët, binin një nga një e stolisnin rrugicën e lagur.

Retë vraponin sipër nesh, të përzëna nga një erë e fortë që vinte prej lartësive; ngrita kokën, i pashë, nuk ngopesha duke i parë tek rendnin, bashkoheshin, ndaheshin, vareshin si thekë të gjatë e kërkonin të preknin tokën. Që prej moshës time më të re, adhuroja të shtrihesha me kurriz në oborrin tonë e të shihja retë; në çast kaloi një zog, një korb, një dallëndyshe ose një pëllumb dhe krijova me ta një kontakt sa ndieja në dorën e hapur ngrohtësinë e barkut të tij.

- Më duket se do të bëhet i fandaksur, djali yt, Marie, - i tha një ditë nënës, fqinja, zonja Penelopi; - ai shikon gjithë kohën retë. - Mos u shqetëso, zonja Penelopë, - iu përgjigj nëna; - jeta do ta bëjë të shohë

në tokë: Por ajo nuk kishte ardhur akoma e unë po ngjitesha për te kështjella, duke soditur retë e në çdo hap pengohesha e rrëshqisja. Babai më kapte për shpatulle, sikur donte të më forconte - Lëri retë të qeta e shiko gurët, mund të biesh e të vritesh. Një vajzë e fishkur u shfaq te dera e një shtëpie të madhe gjysmë të rrënuar e pa retë rreth saj. Ajo ishte e vogël e shumë e zbehtë, fytyra e saj kishte shumë fisnikëri: ishte mbërthyer fort në një shall e fërgëllonte. Ishte një vajzë nga fisnikët e shkatërruar të Naksosit, këtë e mësova më vonë; ishte një nga familjet më të shquara katolike, me kontesha e dukesha, që disa shekuj më parë kishin pushtuar Naksosin e kishin ndërtuar në majë të qytetit atë kështjellë, për të banuar atje e për ta parë nga lart, rreth portit dhe larg në fushë, skllavërinë ortodokse të punojë për ta. Por tani ato kishin rënë nga vakti, pallatet e tyre s'kishin asgjë për të ngrënë, po zverdheshin e s'mund të martoheshin më sepse raca e burrave të rangut të tyre ishte fikur ose ata që kishin mbetur nuk donin të martoheshin, sepse nuk mund të ushqenin dot grua e fëmijë; ndërsa për t'u martuar në një familje të varfër ortodokse, ato nuk pranonin; e vrisnin akoma shumë lart dhe fryheshin me krenarinë e tyre, sepse nuk u kishte mbetur asgjë tjetër e mirë. Vajza pa një çast qiellin, tundi kokën, pastaj u kthye në shtëpi.

Më kujtohen gjithë detajet e asaj dite kur unë u ngjita në kështjellë për të shkuar te shtëpia e priftërinjve katolikë. Akoma e shoh macen që rrinte ulur mbi pragun e derës e mjaullinte; ishte e bardhë me njolla të portokallinjta. Një vajzë e vogël, këmbëzbathur, vraponte duke mbajtur një mangall plot me qymyr të ndezur, që i ndriçonte fytyrën me dritën e tij të kuqe.

- Ja ku arritëm, tha babai; ngriti dorën e trokiti në portën e madhe.

Ishte hapi i parë, më vendimtari mundet, i jetës shpirtërore. Një portë magjike u hap në shpirtin tim, që më bëri të hyja në një botë trullosëse. Deri atëherë Kreta e Greqia kishin qenë një fole ku shpirti im rrinte shtrënguar dhe luftonte; atëherë bota u zgjerua, njerëzit u shumëfishuan; kraharori im adoleshent pëlciste për t'i mbajtur. Deri atë çast unë parashikoja por nuk e dija aq mirë se bota ishte shumë e madhe; e se vuajtja e përpjekjet janë shoqëruese të jetës e të luftës jo vetëm të Kretasit, por të çdo njeriu; e më shumë se gjithë gjërat e tjera, atë çast nisa të zbuloja sekretin e madh: që poezia mund të

shndërrojë gjithë luftën në ëndërr, mund të bëjë të pavdekshëm gjithë sa mund të arrijë kalimthi, duke e tjetërsuar në këngë.

Deri atëherë më udhëhiqnin vetëm dy ose tre pasione; frika, përpjekja për të fituar mbi të, dhe pasioni i lirisë. Por atje u ndriçuan dy pasione të reja brenda meje; bukuria dhe etja për mësim. Të lexosh, të mësosh, të shohësh vende të largëta, të vuash si të tjerët e të jesh i lumtur. Bota është më e madhe se Greqia, vuajtja e botës është më e madhe se vuajtja jonë, pasioni i lirisë nuk është vetëm privilegj i kretasit, ajo është përpjekje e përjetshme e njeriut. Kreta nuk u zhduk nga shpirti im, por bota e tërë u vendos tek unë si një Kretë gjigande që u shtyp nga gjithë llojet e turqve, por që u ngrit pa pushim e kërkoi lirinë.

Kështu, duke krijuar prej botës përreth, Kretën, munda të kem, në vitet e para të adoleshencës sime, ndjenjën e luftës e të vuajtjes njerëzore. Në atë shkollë franceze, që mblidhte fëmijët e ardhur nga gjithë Greqia, meqë isha kretas e ngaqë Kreta atëherë luftonte kundër turqve, besoj se e kisha detyrë të mos turpëroja Kretën e të isha i pari i klasës; kisha një përgjegjësi. Kjo bindje, burimi i së cilës nuk ishte tamam dashuria personale, por një domosdoshmëri kombëtare, shumëfishonte forcat e mia e nuk vonoi që unë të kaloja shokët e mi të klasës; unë, ose më mirë jo, Kreta! Kështu kalonin muajt, në mes të një dalldie që më ishte akoma e panjohur, mësoja, përparoja, gjuaja zogun blu, që siç mësova më vonë e quanin shpirt. E shpirti im u mbush me trimëri aq sa një ditë mora vendimin e guximshëm - atë të shkrimit në anë të çdo fjale franceze të fjalorit, emrin grek korespondues. Kjo përpjekje zgjati disa muaj, e kur më në fund e kreva punën time e gjithë fjalori u përkthye, krenar për veten, ia çova drejtorit të shkollës, At Laurentit. Ishte një at katolik i ditur, i kursyer në fjalë; kishte sy gri, një mjekër të bardhë, qeshje të hidhur. Mori fjalorin, e shfletoi, më pa me admirim e vuri dorën e tij mbi kokën time, sikur donte të më bekonte:

- Kjo që bëre, kretas i vogël, më tha ai, tregon se një ditë do të bëhesh personazh i madh. Të jesh i lumtur që gjete rrugën tënde kaq i ri. Kjo është rruga jote: është studimi. Ke bekimin tim.

Shumë krenar për vete, vrapova te nëndrejtori, At Lelievre, një murg që e donte jetën, i ushqyer mirë e sygazmor; qeshte, bënte

shaka e luante me ne. Çdo fundjavë, na çonte ekskursion në fshat, në një kopsht të shkollës e atje, të çliruar nga At Laurenti, luftonim me njëri tjetrin, qeshnim, hanim fruta, rrokulliseshim në bar, lehtësoheshim nga pesha e javës. Renda pra të gjeja At Lelievre për t'i treguar kryeveprën time. E gjeta në oborr, duke ujitur një trung lisi. Mori fjalorin, nisi të kalojë lehtësisht faqet e tij; e shikonte, e sa më tepër e shikonte aq më tepër i skuqej fytyra. Papritur ngriti fjalorin e ma hodhi në fytyrë:

- Nuk ke frikë? - thirri, ti je fëmijë apo plak? Ç'është kjo punë plaku me të cilën humbet kohën? Në vend që të luash, të qeshësh, të shohësh nga dritarja vajzat kur kalojnë, ti qëndron ulur si një matuf e përkthen fjalorë! Ik, nuk dua të të shoh! Nëse ndjek këtë rrugë, kurrë, ta them unë, kurrë nuk do të bëhesh dikush; do të bëhesh një mësues i shkretë, një kurrizo me syze të vogla. Nëse ti je një kretas i vërtetë digje këtë fjalor të mallkuar e më sill prej tij hirin. Atëherë do të të jap bekimin tim. Reflekto mirë për atë që do të bësh. Ik! U largova krejtësisht i hutuar. Ç'ishte e drejtë të bëja, kush nga dy rrugët ishte më e mirë? Gjatë viteve kjo më ka shqetësuar; e kur e gjeta cila ishte rruga e drejtë, flokët e mi ishin bërë gri. Mendoja etërit e mi dhe shihja fjalorin, fjalët greke ishin shkruar me bojë të kuqe, me shkronja të vogla në anën e librit, kujtoja fjalët e At Lelievrit e zemra ime thyhej; jo, jo nuk e kisha guximin për ta djegur e për t'i çuar atij hirin. Më vonë, shumë vite më pas, kur nisa të kuptoj, e hodha në zjarr. Por nuk mblodha hi prej tij, At Lelievre kishte vdekur prej kohësh.

Sapo më shpuri në shkollë e u sistemova, babai u nis fshehtësisht me një kaike, në Kretë për të luftuar. Ndonjëherë më dërgonte një letër të shkurtër që më bënte me turp:

"Këtu unë luftoj kundër Turqisë, unë bëj detyrën time; lufto si unë, rezisto që francezët mos të të ngrenë mendjen, edhe ata qenër janë, si turqit. Mos harro që ti je kretas e që shpirti yt nuk është i yti, është i Kretës, nxite atë aq sa të mundësh për të ndihmuar veten dhe gjithashtu Kretën, që të çlirohet. Meqë ti nuk mund ta bësh me armë, bëje me shpirtin tënd: është një pushkë si të tjerat. E dëgjon këtë që të urdhëroj? Më thuaj: e dëgjoj.

"Shiko për sot, për nesër e përgjithmonë." Mos më turpëro!"

Ndieja të rëndonte mbi shpatullat e mia gjithë Kreta; e nëse nuk e dija mirë një mësim, nëse nuk e kuptoja një problem matematike, nëse nuk isha i pari në hartim, Kreta ishte e turpëruar. Unë nuk kisha pakujdesinë, freskinë, e moskokëçarjen e një fëmije; shihja shokët e mi të qeshnin e të luanin dhe i admiroja; edhe unë do të kisha dashur të qeshja e luaja por Kreta luftonte, ajo ishte në rrezik. Dhe më e tmerrshmja ishte se mësues e nxënës kishin arritur të mos më flisnin më me emrin tim, por më thërrisnin: kretasi e kjo me kujtonte akoma më fuqishëm, në çdo çast, detyrën time.

Nuk kisha frikë të kaloja në katoliçizëm; jo sepse unë e kuptoja cila fe ishte më e mirë, po për një tjetër arsye që mund të duket pa kuptim, që, megjithatë, në shpirtin tim prej fëmije ka patur një ndikim shumë më të thellë se gjithë idetë teologjike. Çdo mëngjes ne shikonim, detyrimisht në meshë në kishën katolike që ishte në mes të shkollës; e vogël, e shurdhët, shumë e ftohtë në dimër, shumë e nxehtë në verë, me dy statuja të vogla allçie, Krishti e Virgjëresha, ndërsa mbi tavolinën e shenjtë, në vazo të mëdha qelqi, degë lisash të bardhë. Nuk i ndërronin shpesh, qëndronin ditë të tëra në ujë, kalbeshin, e kur hyja në kishëz çdo mëngjes era e tyre më bënte gati të villja, e një ditë, më kujtohet, më ra të fikët. Kështu, pak nga pak, kishëza katolike e lisat e saj të kalbur janë mpleksur pazgjidhmërisht tek unë; ndërsa ideja për t'u bërë katolik më bënte për të vjellë.

Megjithatë kam parë çastin; akoma sot kur e kujtoj kam turp, ku për pak nuk tradhëtova besën time. Pse? Çfarë demoni? Çfarë durimi, çfarë djallëzie duhet të ketë tek ne ky demon për t'u tallur pas virtytit, duke marrë tamam fytyrën e virtytit, veçse herët ose vonë por patjetër, ora e tij do të vijë!

E ja një ditë ora e tij erdhi; një mëngjes erdhi nga Roma kardinali që inspektonte shkollat katolike të Lindjes. Ishte veshur me të zeza, kombinuar me ngjyrë vjollcë, një kapele vjollcë, me konture të gjera, çorape po vjollcë, të tejdukshme, e në gisht kishte një unazë me gur gjithashtu, vjollcë. Në çastin që u shfaq ose që u ndal para nesh, na u duk si një lule ekzotike që sapo kishte dalë nga Parajsa, e ajri balsamosej e rrezatonte rreth tij. Ngriti dorën, një dorë e bardhë topolake, e na bekoi me shkopin e tij; të gjithë ndjemë të zbriste nga maja

e kokës deri te thembrat një forcë urdhëruese, sikur të kishim pirë verë të vjetër e truri na kishte marrë një ngjyrim vjollcë. At Laurenti donte të fliste me mua, sepse në çastin kur po largohej, ai më bëri shenjë ta ndiqja. U ngjitëm në dhomën e tij, e më uli përpara këmbëve mbi një stol.

- Do të vish me mua? - më pyeti kardinali; zëri i tij m'u duk i butë si mjaltë.

- Ku pra? Thashë i tronditur; unë jam kretas. Kardinali nisi të qeshë; hapi një kuti, mori një bombone, dhe e hodhi në gojë. Goja e tij ishte e vogël, e rrumbullakët, buzët i kishte të holla e shumë të kuqe. Sa herë që tundte dorën, ai përhapte parfum.

- E di, e di - tha ai, unë di gjithçka. Ti je kretas, që do të thotë një dhi e egër, por bëj durim e më dëgjo: ne do shkojmë në Romë, në Qytetin e shenjtë, ti do të hysh në Shkollën e madhe, për të studiuar, për t'u bërë njeri i madh e kush e di, mbase një ditë ti do të vendosësh këtë kapele kardinali që mbaj unë - e mos harro që dikur, dikush nga ishulli juaj, është bërë papë, Kryetar i kristianizmit. Më i fuqishëm se një perandor. Atëherë mund të reagosh, mund të çlirosh Kretën. E dëgjon ç'të them?

- E dëgjoj, e dëgjoj, - mërmërita; kisha ngritur kokën dhe e dëgjoja me pasion.

- Në këtë çast, biri im, jeta jote është në lojë; nëse thua po, ti do të shpëtosh, nëse thua jo, ti do të humbasësh... Po qëndrove këtu, çfarë do të bëhesh? Cili është zanati i babait tënd?

- Tregtar.

- Atëherë. Kur të të vijë rradha, ti do të jesh tregtar; shumë shumë avokat ose mjek, që do të thotë: asgjë nga këto! Greqia është provincë; dil nga provinca, më kanë folur shumë për ty, biri im, do të hidhërohesha të të shihja të humbisje.

Zemra ime rrihte me forcë. Atje përpara meje ishin akoma dy rrugë, cilën të zgjidhja? Kë të pyesja që të më vinte në ndihmë? At Laurenti, më shtynte drejt një rruge, At Lelievre drejt një tjetre, cila ishte e drejta? Sikur të pyesja babanë? U kujtova për babanë e më kapi frika. E drejtë ishte të ktheheshe nga Kreta, duke ndier përsëri turpin, me një plagosje të rëndë në krahë.

Pushka vrau veten; pas kaq shekujsh, pas kaq shumë gjak, liria

kishte nëpërkëmbur me këmbët e saj e gjakosura, diellin e Kretës. Princi Gjergj i Greqisë ra herët nga froni, me unazën e fejesës në dorë, para se të bashkoheshin për gjithmonë Kreta e Greqia. Kur u kthye në Kretë, babai im erdhi të më shihte; për një çast nuk e njoha; ishte bërë më brun e buzët e tij për herë të parë i shihja të qeshnin.

- Si je? Je katolik? - më tha; Shpërtheu së qeshuri.

U skuqa i tëri. Më vuri dorën e tij të madhe mbi kokë: - Kam besim tek ti, bëj shaka.

M'u kujtua ai tjetri; u zbeha, sepse kardinali mbështeti rëndë dorën e tij të shëndoshë mbi flokët e mi e më pyeti: - Për çfarë mendon? - Çfarë do të më thotë babai, - pëshpërita.

Ai nuk duhet ta dijë, askush nuk duhet ta dijë, ne do të nisemi fshehtësisht, natën.

- Po nëna? Ajo do shpërthejë në të qara...

- Ai që nuk mohon babanë e nënën e tij, nuk mund të më ndjekë, ka thënë Krishti. U vrava, gjatë gjithë viteve të mia të fëmijërisë, fytyra e Krishtit ka ushtruar mbi mua një bukuri të papërshkrueshme. E ndiqja jetën e tij nga ikonat, ai lindi, ishte 12 vjeç, ishte më këmbë në një varkë, ngrinte dorën e deti qetësohej; pastaj e goditën, e kryqëzuan, ai thërriste mbi kryq: "Baba, baba, përse më braktise!" Pastaj, një mëngjes të bukur, doli nga varri e u ngjit në qiell, një flamur i bardhë në dorë... E shihja dhe isha i goditur së bashku me të, isha i kryqëzuar, u ngjalla me të. Kur lexova ungjillin, legjendat e vjetra nisën të jetonin e shpirti i njeriut më shfaqej si një kafshë e egër që flinte e gërhiste në gjumë, papritur qielli u hap dhe Krishti zbriti, e përqafoi e ajo mori frymë lehtësisht, u zgjua e u rikthye princeshë e bukur e legjendave.

- Mirë, thashë duke shtrënguar dorën e kardinalit; do ta lë babanë e nënën...

- Në këtë çast pashë shpirtin e shenjtë të zbresë mbi kokën tënde, biri im, ti shpëtove, - tha kardinali; më drejtoi gurin e çmuar vjollcë që mbante në gisht, që ta puthja.

Ne duhej të niseshim tri ditë më vonë; Unë doja të shihja prindërit, për t'u thënë lamtumirë nga thellësia e zemrës, pa ua rrëfyer sekretin, por kardinali nuk më lejoi: - Një burrë i vërtetë, - më tha, i lë

ata që do pa u thënë: lamtumirë! E unë që doja të isha një burrë i vërtetë, e bëra zemrën gur e u vrava. Prej kohësh kisha lexuar në jetët e shenjtorëve, se kështu kishin bërë *asketët* që ishin nisur në shkretëtirë!

Ata nuk ktheheshin për të parë nënat e tyre, nuk ngrinin dorën për t'u thënë lamtumirë. Kështu bëra edhe unë.

Më dhanë libra të mëdhenj, me lidhje ari, lexoja tekste për Romën, qytetin e përjetshëm, për atin e shenjtë, Papën, e u deha duke parë figurat, Shën Pjetrin, Vatikanin, pikturat, statujat...

Gjithçka shkonte mirë; në imagjinatën time unë tashmë isha nisur, kisha përshkuar detin, kisha arritur në qytetin e shenjtë, kisha mbaruar studimet në kohë, mbaja një kapele vjollcë, me copë mëndafshi; shihja dorën time të djathtë e në errësirë, në gishtin e tretë, shquaja unazën misterioze me gur që shkëlqente... Atëherë, rreptësisht, fati u vu në lëvizje, shtriu dorën e më pengoi rrugën. Dikush, i pëshpëriti në vesh babait tim: "Priftërinjtë katolikë po marrin djalin tënd!" Kretasi i egër mori hov; ishte natë, mori me vete ca miq, luftëtarë e peshkatarë, ndezën pishtarët, morën bidona me benzinë e u ngjitën në rrugën e kështjellës. Ata kishin marrë kazma e shufra hekuri, nisën të shkallmonin portën e shkollës e të ulërijnë se do t'i vinin zjarrin. Priftërinjtë u tromaksën, At Laurenti doli në dritare me kapuçin e natës, thërriste, lutej, gjysmë frëngjisht e gjysmë anglisht.

- Djalin tim, - thërriste babai, duke lëvizur pishtarin e ndezur, djalin tim, përndryshe zjarr e sëpatë, qenër katolikë!

Më zgjuan, u vesha me shpejtësi, u hodha nga dritarja e rashë në krahët e babait. Ai më mbërtheu për zverku e më hodhi përtokë tre herë, pastaj u kthye nga shokët: - Fikini pishtarët, ikim!

Babai qëndroi tri ditë pa më folur; urdhëroi të më lanin e të më lyenin me vajin e plakës së Virgjëreshës, që të më vishnin rroba të pastra, solli priftin të më spërkaste, të përgjëronte fatin e të zbonte nga unë aromën katolike. Atëherë u kthye nga unë: - Judë! - mërmëriti mes dhëmbëve, e pështyu tri herë në ajër.

Tri javë më vonë Zoti e desh që të arrinte e mbara: princi Gjergj i Greqisë shkoi në Kretë të merrte në zotërim ishullin.

Babai im u ngrit me vrap, u përkul tri herë derisa preku tokën,

bëri kryqin e shkoi drejt shtëpisë së berberit; ai kurrë nuk kishte afruar një brisk në faqet e tij dhe e linte mjekrën të dridhej si lumë mbi kraharor, sepse ai ishte në zi: zija e të parit të Kretës në skllavëri. Për këtë arsye ai nuk qeshte, zemërohej kur shihte të qeshte një kretas. Sipas tij e qeshura ishte akt antipatriotik. Por tani, falë Zotit, Kreta u çlirua, e babai im shkoi drejt e te berberi, e kur u kthye në shtëpi, fytyra e tij rrezëllinte, e rruajtur, e rinuar, e gjithë shtëpia u mbush me erën e livandos që berberi i kishte hedhur mbi flokë.

U kthye drejt nënës e qeshi.

- Kreta u çlirua, e kaluara u harrua, falim edhe Judën.

Duke thënë këtë, ai më tërhoqi vëmendjen. Disa ditë më vonë ne u transferuam në Kretë. Çfarë udhëtimi triumfal që ishte dhe sa vononte barka të përshkonte detin Egje, e si depërtonte dielli deri në thellësinë e fundit të zemrës atë ditë vjeshte. Babai lundronte ditë e natë përkulur mbi bashin e anijes, shikonte drejt Jugut e ashtu si sytë e njeriut mund të zhvendosin malet, ne shihnim Kretën të vinte drejt nesh si një fregatë.

LIRIA

Kur kujtoj pas kaq vitesh, ditën kur princi Gjergj i Greqisë, domethënë, Liria, shkeli tokën e Kretës, sytë e mi u veshën përsëri e u mbushën me lot. Cili mister është më i padepërtueshëm sesa përpjekja e njeriut! Ç'është kjo lëvore e tokës, e hollë, e paqëndrueshme, e plasaritur, mbi të cilën zvarriten këta parazitë mbuluar nga gjaku, mbuluar nga balta, njerëzit që kërkojnë lirinë? Sa mallëngjyese është t'i shohësh duke kapërcyer ngjitjen pa fund, duke ecur në krye e duke hapur rrugën të tjerëve, herë me ushtë e sëpatë, herë me fustanellë e karabinën e gjatë, e herë me pantallona të shkurtëra greke!

Më kujtohet një kapedan kretas, bari, që nuhaste plehun e cjapit, sapo u kthye nga lufta.

Gjendesha në stanin e tij, një pasdite, kur atij i erdhi nga "Shoqata kretase" e Athinës, një diplomë mbi pargamenë me gërma të mëdha të kuqe e të zeza; e falënderonin për aktet e tij të trimërisë, e shpallnin hero. - Ç'është kjo letër? - pyeti, i padurueshëm postierin e Shoqatës... Kanë hyrë përsëri delet e mia në një fushë të mbjellë? Duhet të paguaj gjobë? I dërguari, i lumtur, shpalosi letrën dhe ia lexoi me zë të lartë.

- Hë, shpjegohu, ç'domethënë kjo?

- Që ti je një hero e atdheu ta dërgon këtë letër që ti ta vësh në kornizë e ta shikojnë fëmijët e tu.

Kapedani zgjati dorën e tij të madhe: - Ma jep mua atë! E mori, e coptoi në mijëra copa, e hodhi në zjarr, ku ishte gati për të valuar kazani me qumësht. - U thuaj atyre që unë nuk e bëra luftën për të marrë një letër, e bëra luftën për të bërë historinë! Për të bërë historinë! E dinte mirë atë që donte të thoshte, bariu i sertë, por nuk dinte ta shprehte.

U ngrit, mbushi një tas me qumësht, preu gjysmën e një cope djathi, mori dy bukë të rrumbullakta elbi, u kthye nga i dërguari, që

ishte hidhëruar kur pa letrën e copëtuar në zjarr.

- Shkojmë, shkojmë, miku im, mos e vrit mendjen, ha, pi e në djall letrat; dëgjon? U thuaj atyre që nuk dua dëmshpërblim; bëj atë që më pëlqen, ja ç'duhet t'u thuash. Ha, të them! Dy ditët më të rëndësishme të jetës sime ishin pikërisht këto: dita kur princi Gjergj zbarkoi në Kretë, e disa vite më vonë, dita kur Revolucioni festoi 10 vitet e tij në Moskë. Në këto dy ditë ndjeva se ndarjet mund të shkallmojnë trupat, shpirtrat - e se njerëzit mund të rikthehen pas telasheve të tmerrshme e të përgjakshme në bashkësinë origjinale të shkëlqyer.

S'ka më përtej meje, përtej teje, përtej tij, gjithçka nuk është më shumë se një e kjo është një dehje mistike, vdekja e humb gabimin e saj, s'ka tej vdekjes, ne vdesim një nga një të ndarë nga njëri-tjetri, por të gjithë së bashku jemi të pavdekshëm, hapim krahët e përqafo-më, pas aq urie, aq etjeje e aq revolte, si fëmijët plangprishës, prindërit tanë, qiellin e tokën.

Kretasit hidhnin në ajër shamitë e kokës, lotët e tyre rridhnin e lagnin mjekrat e bardha të kapedanëve, nënat ngrinin fëmijët e tyre lart, që të shihnin gjigandin bjond, princin e legjendave, që kishte dëgjuar ankimin e Kretës e që ishte nisur, prej shekujsh hipur mbi një kalë të bardhë, si shenjti Gjergj, për ta çliruar. Gjatë shumë shekujsh sytë e kretasve ishin shtangur nga përqendrimi për të parë detin; e shihnin, s'e shihnin, së shpejti do ta shihnin... Herë ishte një re e vogël e pranverës që i gënjente, herë një mjegull e bardhë, herë një ëndërr në mesnatë. Por reja shpërndahej, mjegulla zhdukej larg, ëndrra fshihej e kretasit rinisnin të përqendronin sytë drejt veriut, drejt Greqisë, drejt Moskovit, drejt Zotit të pamëshirshëm me ecje të ngadaltë.

E në fakt Kreta ishte tronditur, varret ishin hapur, një thirrje u ngrit nga maja e Psilorit: Arriti! Është atje! Ja! E kapedanët e vjetër kishin zbritur nga malet me plagët e tyre të thella e pistoletat e argjendta, djemtë e rinj kishin ardhur me kamat e tyre në këllëfët e zinj e zërat kumbues, këmbanat binin, këmbanaret dridheshin, qyteti ishte i gjithë i zbukuruar me palma e dafina, bjondi shën Gjergj ishte në këmbë mbi molin e mbuluar me degë ulliri, ndërsa deti kretas shkëlqente pas shpatullave të tij.

Kretasit pinin në taverna, këndonin, vallëzonin, luanin në violinë, por s'ishin të qetë. Trupat e tyre nuk mbanin më, ata rrëmbenin kamat, çanin krahët që të rridhte gjaku e i qepnin, për t'u qetësuar. Në kishë, plaku Metropolit ngriti duart drejt kupolës e pa të gjithëfuqishmin; donte të bënte një diskutim por gryka i ishte mbërthyer dhe buzët vetëm sa pëshpëritën: - Krishti u ngjall, fëmijët e mi! - thirri, - dhe nuk foli dot asgjë tjetër. - Ai u ngjall vërtetë! Thirrja gufoi nga gjithë kraharorët si një gjëmim bubullime e shandanët e kishës u tundën sikur toka u drodh.

Isha i ri atëherë e pa përvojë dhe dehja e shenjtë zgjati për një kohë të gjatë tek unë; ndoshta vazhdon akoma. Në gëzimet e mia më të thella, edhe sot përsëri kur shoh qiellin me yje, ose detin, ose një bajame të lulëzuar, ose kur rijetoj dashurinë time të parë, 9 dhjetor i 1898 shndrit tek unë i pavdekshëm: dita kur princi i ri i Greqisë, i fejuari i Kretës, shkeli tokën kretiane; e zemra ime thellë-thellë u zbukurua, siç ishte gjithë Kreta atë ditë, plot dafina e mërsina.

Ishte mesditë, Megalo Kastro gufonte nga gëzimi; babai më kapi nga dora, përshkuam, duke ecur mbi dafina e mërsina, rrugën e madhe, dolëm nga qyteti dhe hymë në fusha. Ishte dimër, por kishte një ngrohtësi të ëmbël e një bajame pas një gardhi kishte çelur lulet e para. Fushat e gënjyera nga ngrohtësia e kohës, kishin nisur të mbuloheshin me blerim e larg në të majtën tonë, shndritnin malet e Selenës, mbuluar me borë. Vreshtat ishin akoma trungje të vdekura, por lulet trimëresha e të hershme të bajames dëshmonin tashmë pranverën, e trungjet e vreshtave shumë shpejt do të çlironin veriget e bardha e të zeza që mbanin brenda vetes. Kaloi një trupmadh, ngarkuar me degë dafine; ai pa babanë tim e ndaloi:

- Krishti ia doli, kapedan Mihal! - thirri. - Kreta ia doli! - u përgjigj babai duke vënë dorën në zemër.

Ne vazhduam; babai im nxitoi e unë vrapova pas tij që ta arrija.

- Ku po shkojmë, baba? - e pyeta, duke m'u marrë fryma.

- Të shohim gjyshin tënd, ec!

Arritëm në varreza, babai me një shtyrje të fuqishme hapi derën prej hekuri; një kafkë ishte vizatuar mbi parvaz, e poshtë dy kocka të kryqëzuara, simboli i Krishtit të rilindur. U kthyem në të djathtë, nën qiparisa, duke kapërcyer varret e shkretë e duke mbajtur në dorë një kryq të thyer, pa qirinj. Përpara njërit prej këtyre varreve, ba-

bai ndaloi; një fryrje e vogël e tokës, një kryq druri e mbi të një emër, fshirë nga koha. Babai hoqi shaminë nga koka, e u përkul me fytyrë nga toka; gërreu tokën me thonj, bëri një vrimë të vogël si një hinkë, vuri gojën, e thirri tre herë: - Baba, ai u kthye! Baba, ai u kthye! Baba, ai u kthye! Zëri i tij nuk rreshtte së ngrituri, ai u skuq. Nxori nga xhepi një shishe të vogël me verë, e derdhi gllënjka-gllënjka në gropë duke pritur që ta pinte toka. Pastaj u drejtua me hov, bëri kyqin e më pa. Syri i tij shkëlqeu. - Më dëgjove? - më tha, e zëri i tij ishte i çjerrë nga emocioni, dëgjove?

Unë nuk flisja, nuk kisha dëgjuar asgjë.

- Nuk dëgjove? Tha babai, i mërzitur. Kockat e tij kërcitën.

Kur kujtoj atë ditë, bekoj qiellin që më bëri të lind kretan, në një kohë që munda të shoh me sytë e mi duke ecur mbi degë dafine e pastaj të ngjitet derë më derë, deri në strehën e shenjt Minait, Lirinë. Çfarë fatkeqësie që sytë e argjiltë të njeriut nuk mund t'i shohin gjërat e padukshme! Do të kisha parë atë ditë Shën Minanë të vërsulej jashtë ikonës së tij, të qëndronte me guxim mbi kalë para portës së kishës e të priste princin e vogël të Greqisë me lotët që rridhnin mbi faqet e tij, të nxira nga dielli e mbi mjekrën e tij bojëhiri.

Kur gëzimi u qetësua, e me sa më kujtohet, disa ditë më vonë, një erë e fuqishme fryu nga jugu, zhduku gjethet e dafinës nga rrugët, nisi të bjerë shi e trotuaret u lanë nga vera e derdhur, jeta u bë esëll e shpirti u kthye në kufijtë e tij.

Fytyrat e të krishterëve, të saporruara, shkëlqenin si monedha të reja; berberët kishin fshirë mjekrat, në taverna dëgjohej akoma ndonjë zë i çjerrë i vonuar, unë endesha në rrugë, i lagur i tërë nga shiu, e kur shihja që rruga ishte e zbrazët, bërtisja e skuqesha, për t'u lehtësuar. Kurrë s'e kam ndier aq fuqishëm se të vdekurit tanë nuk janë të vdekur e se në çaste vendimtare, ata lëshojnë një klithmë, kthehen me hov e marrin në zotërim sytë tanë, duart e shpirtin tonë. Gjithë obobotë e mia që turqit kishin vrarë, skuqeshin e ulërinin nga gëzimi atë ditë kur rruga ishte e zbrazët e asnjë nuk na shihte. Unë ringjallesha, sepse, pa mundur akoma të mendoja qartësisht, ndieja që do jetoja radhën time, do mendoja e do shikoja përsëri pas vdekjes, mjaft që të kishte akoma zemra që të kujtoheshin për mua.

Pikërisht nga kjo portë, zbukuruar me degë dafine e kocka stërgjyshërish, unë hyra në adoleshencë. Pushova së qëni fëmijë.

SHQETËSIMET E ADOLESHENCËS

Adoleshencën e kalova me zakonet e kleçkat e rinisë. Dy bisha të mëdha u zgjuan tek unë, leopardi mishngrënës e shqiponja e pangopur që gllabëron stomakun e njeriut e që sa më shumë që ajo i gllabëronte, aq më shumë shpirti kishte uri.

Kur isha akoma i vogël, tre-katër vjeç, më pushtoi një kuriozitet i fuqishëm, për të zbuluar misterin e lindjes. Pyesja nënën, hallat: - Si lindin fëmijët? Si hyjnë papritur në shtëpi? Nga vijnë ata? Duhet të ketë një vend të gjelbër, mendoja, mbase Parajsa; atje ndoshta mbijnë fëmijët si lulëkuqe. E pak nga pak një baba hyn në Parajsë, rrëmben një dhe e sjell në shtëpi. E mendoja,e rimendoja në shpirt, por nuk i besoja aq shumë. Nëna dhe hallat e mia ose nuk më përgjigjeshin fare ose më tregonin histori. Por unë, kuptoja më tepër se ato mund ta mendonin, madje edhe më tepër se mund ta mendoja vetë, ndaj nuk i besoja më ato. E kur një ditë, në të njëjtën periudhë, fqinja jonë, zonja Katina, vdiq në kulmin e rinisë, ndjeva frikë kur e pashë që e nxorën nga shtëpia shtrirë me shpinë, kur u kthyen në qoshe të rrugës e ajo humbi nga sytë e mi e shoqëruar nga shumë njerëz.

- Pse e morën? - pyeta, ku po e çojnë?

- Ajo vdiq, ajo vdiq, më përgjigjeshin.

Ajo vdiq? Ç'do të thotë që ajo vdiq? Por asnjë nuk ma shpjegonte. U kruspullova në një cep të shtëpisë pas kanapesë, mora një jastëk, mbulova fytyrën e po qaja; jo nga hidhërimi, as nga frika, por sepse nuk kuptoja. Megjithatë, disa vite më vonë, kur vdiq mësuesi im Krasakis, vdekja nuk më befasonte më; sikur të kisha kuptuar atë që ndodhte, nuk bëja më pyetje.

Këto dy gjëra, lindja e vdekja, ishin gjithë misteret e para që tronditën shpirtin tim të fëmijës. Unë qëlloja me grushtin e brishtë këto dy porta të mbyllura që ato të hapeshin; pashë që nuk mund të

prisja ndihmën e askujt. Atë që do të mësoja, do ta mësoja krejtësisht vetë.

Pak nga pak trupi u zgjua, mbretëria ime përbëhej nga parandjenja e re, filloi të forcohej, dëgjoja zërat e rrugës, nuk e dija saktë çfarë kuptimi kishin, por më dukej se disa prej tyre ishin mbushur me një substancë misterioze të ndaluar. Unë i zgjidhja këto fjalë, i ngjeshja në shpirtin tim e i përsëritja me vete për të mos i harruar. Por një ditë një prej tyre më shpëtoi e unë e thashë me zë të lartë; mamaja ime e dëgjoi e u hodh përpjetë e zemëruar.

- Kush ta tha këtë fjalë të poshtër? - më bërtiti ajo. Mos e përsërit më!

Ajo shkoi në kuzhinë, mori piper të bluar e ma hodhi me kujdes në gojë. Unë klitha, goja më përvëlonte e u betova, në kokëfortësinë time, t'i përsëritja, por vetëm me vete. Sepse gëzimi që provoja duke i thënë ishte i madh.

Por pas çdo fjale të ndaluar më digjnin buzët, e kisha një shije piperi; Madje edhe tani pas kaq vitesh e gabimesh.

Atë kohë të shkuar, në vendin tim, puberteti zgjohej shumë ngadalë, i tërë i kuq nga ndrojtja, e përpiqej të fshihej pas maskave të të gjitha llojeve. Maska e parë për mua ishte miqësia, pasioni për një nga shokët e mi, më i shpëlari nga të gjithë. Ishte i shkurtër e shulak, me trup të rëndë e sportiv, pa asnjë kureshtje shpirtërore. Ne shkëmbenim çdo ditë letra të zjarrta e unë ankohesha, madje, shpesh qaja ditët kur nuk merrja letra prej tij. Endesha rreth shtëpisë, vëzhgoja në fshehtësi, kur e shihja të shfaqej më ndalej fryma.

Trupi u zgjua e nuk dija akoma çfarë fytyre t'i jepja dëshirës së tij; ai akoma nuk kishte kuptuar mirë atë që e dallonte një burrë nga një grua. Megjithatë të bredhurit e një djali ishte më pak me rrezik, se ai i një vajze; kur takoja një grua, provoja një antipati të jashtëzakonshme e në të njëjtën kohë frikë, kur era frynte e ngrinte pak frutullën e fustanit të saj, unë ktheja kokën me vrull, flakë i kuq nga turpi e pezmatimi.

Një ditë, duhej të ishte mbasdite, dielli përvëlonte, unë po kaloja nëpër një rrugë të ngushtë e me hije, për t'u kthyer në shtëpi; papritur në cepin tjetër të rrugës, u shfaq një turke, hapi pak pelerinën e më tregoi gjoksin e saj të zhveshur. Gjunjët m'u drodhën; arrita në shtëpi duke m'u marrë këmbët, u përkula mbi legen e volla.

Kur, shumë vite më vonë gjeta në një sirtar korrespondencën, me mikun tim, u frikësova. Çfarë zjarri, Zoti im, e çfarë pafajësie! Pa e dashur, pa e ditur, ai shok i klasës ishte shndërruar në një maskë për të më fshehur, për shumë vite, femrën. Sigurisht, edhe unë, kam qenë për të një maskë, që i fshihte atij femrën; me qëllim që të vonohej pak çasti fatal kur ai do të binte në grackën e tmerrshme. Ai ra më vonë, unë e dija, dhe humbi.

EDHE NJË MASKË TJETËR

Me këtë mik dhe një shok tjetër të klasës, me gjymtyrë delikate, me sy të gjelbër në të kaltër, që fliste pak, formuam gjatë pushimeve të verës një "shoqëri miqësore" një "Shoqatë" të re. U mblodhëm në fshehtësi; bëmë betime, nënshkruam statutet dhe vendosëm si qëllim të jetës sonë, të luftonim pa kompromis gjatë gjithë kohës kundër gënjeshtrave, skllavërisë, padrejtësisë. Kjo botë na dukej gënjeshtare, e padrejtë, e poshtër, dhe ne të tre morëm përsipër ta shpëtonim. U izoluam nga të gjithë shokët, rrinim gjithmonë bashkë dhe thurnim plane për të arritur qëllimin tonë; secilit i caktuam fushën ku do të luftonte; unë duhej të shkruaja pjesë teatri, miku im duhej të bënte aktorin që të luante pjesët, ndërsa i treti i cili ishte i apasionuar pas matematikës, do të bëhej inxhinier për të arritur një zbulim të madh, i cili do të mbushte arkën e shoqërisë sonë e në këtë mënyrë ne do t'u vinim në ndihmë të varfërve dhe të shtypurve.

Duke pritur që të vinte çasti i madh, ne bënim ç'ishte e mundur për t'i qëndruar besnik betimit tonë; nuk thoshim gënjeshtra, luftonim gjithë turqit e vegjël që na binin në dorë në rrugicat e izoluara, i kishim zhdukur jakat dhe kravatat dhe mbanim fanella me vija bardhë e blu si ngjyrat e flamurit grek.

Një mbrëmje dimri, pamë në port një hamall të vjetër turk, të mbledhur në një cep; nata kishte rënë dhe askush nuk na shihte, njëri hoqi fanellën, tjetri këmishën, tjetri jelekun dhe ia dhamë atij; ne donim ta merrnim në krahë, por nuk guxuam; u nisëm të mërzitur sepse nuk kishim kryer detyrën. – Kthehemi ta gjejmë, - propozoi miku im. – Shkojmë!

U kthyem andej nga kishim ardhur duke vrapuar, kërkuam hamallin e vjetër, për ta ngritur në krahë, por nuk e gjetëm, ai kishte ikur.

Një ditë mësuam se një avokat i rëndësishëm i Megalo Kastros, ishte fejuar me një vajzë të pasur dhe se martesa do të bëhej të die-

lën. Por, ndërkohë, kishte ardhur nga Athina, një vajzë e varfër, shumë e bukur, dikur mike e avokatit kur ai studionte atje, të cilës i pat premtuar martesën. Sapo mësova këtë skandal, thirra në takim gjithë anëtarët e shoqatës. U mblodhëm të tre në dhomën time, në shtëpinë prindërore, mbushur me indinjatë. Statuti i Shoqatës nuk na lejonte të falnim një krim të tillë! Diskutuam gjatë për të vepruar dhe më në fund morëm një vendim: të tre do të shkonim te Mitropoliti për të denoncuar atë veprim të pamoralshëm. Në të njëjtën kohë i shkruajtëm avokatit me nënshkrimin "Shoqata" dhe ndërkohë e kërcënonim se po të mos martohej me Dorothenë – emri i vajzës nga Athina, - ai do t'i jepte llogari Zotit dhe neve.

U veshëm me rrobat e së dielës dhe u paraqitëm te Mitropoliti. Ishte një plakush i dobët, tuberkuloz, i keq si djall. Duke folur, i mbahej fryma, ndërsa sytë i shkëlqenin si thëngjij të ndezur. Mbi tavolinë mbante një ikonë të Krishtit, me buzët ngjyrë trëndafili, i shëndetshëm, flokët të ndara me vijë në mes; ndërsa përballë tij ishte një gravurë të madhe të shën Sofisë. Na pa i habitur:

- Çfarë ka ndodhur, fëmijë? – na pyeti.

- Një krim i rëndë, Zotëri, iu lëshuam të tre, duke na u marrë fryma, por ama thërrisnim që të kishim guxim; - ai po përgatit një krim të madh!

Mitropoliti u koll, pështyu në shami:

- Një krim të madh? – foli me ironi. - E ç'ju duhet juve? Jeni shkollarë apo jo, duhet të mendoni më shumë për mësimet.

- Zotëri... filloi miku im që ishte edhe më oratori... dhe i tregoi gjithë skandalin shoqëror. - Ne nuk mund të flemë gjumin e madh, Zotëri, - përfundoi miku im, - nuk mund të mendojmë më për mësimet, në qoftë se nuk ndalohet një krim. Duhet medoemos që avokati të martohet me Dorothenë.

- Mitropoliti u kollit përsëri, vuri syzet dhe na pa për një kohë të gjatë. Na u duk se mbi fytyrë i ra një trishtim i madh. Të tre prisnim me ankth; pastaj duke shtrënguar dhëmbët ai vazhdoi

- Ju jeni të rinj, akoma jeni fëmijë. Sikur të më jepte Zoti edhe nja pesëmbëdhjetë apo njëzet vjet për t'ju parë se me çfarë syri do ta shikonit ju padrejtësinë! - Pas pak heshti dhe pëshpëriti me vete: - Të gjithë kështu fillojnë.

- Zotëri, - i thashë unë atë çast, sepse e pashë që Mitropoliti e ndryshoi bisedën, ç'mund të bëjmë për të ndalur krimin? Në qoftë se ju do të na thoni që të hidhemi në zjarr, ne do të hidhemi të tre, vetëm që të triumfojë drejtësia.

Mitropoliti u çua: - Shkoni të qetë, - na tha dhe na shtriu dorën për të na përqafuar, - ju e bëtë detyrën tuaj, ç'mbetet është puna ime.

U nisëm të gëzuar. – Punë e mirë për Shoqatën, - tha miku im e na përqafoi të dyve. Të dielën që erdhi, avokati u martua me vajzën e pasur.

Më vonë mësuam se Mitropoliti u tregonte miqve të tij për vizitën që i kishim bërë si dhe për indinjatën tonë, me të cilat ai ishte tallur.

DY PLAGOSJET E MËDHA

Ne lexojmë gjithë romanet që na bien në dorë, shpirti ynë përflaket, kufijtë ndeshen mes imagjinatës e realitetit, mes poezisë e të vërtetës e na duket se shpirti i njeriut mund të ndërrmarë e të arrijë gjithçka.

Por sa më shumë ndieja shpirtin tim të hapej e të zhvendosë kufijtë e së vërtetës, aq më shumë zemra ime mbushej, nxirrte jashtë trishtimin. Jeta më shfaqej shumë e ngushtë, ajo s'mund të më mbante më, e dëshiroja fort vdekjen. Vetëm ajo më shfaqej e pafund e mund të më mbante. Më kujtohet, një ditë dielli shkëlqente, e unë e ndieja trupin të fortë e të lumtur, i propozova mikut tim të vrisnim veten; kisha shkruar tashmë një letër të gjatë të dëshpëruar, një lloj testamenti, ku unë i thoshja lamtumirë botës. Por miku im refuzoi e unë doja të vdisja i vetëm.

Isha zhytur aq thellë në një trishtim të papërcaktuar, e të pakuptueshëm, sa erdhi çasti që edhe miku im, m'u bë i padurueshëm; dilja vetëm, kur binte nata e shëtisja mbi muret e lartë veneciane, që gjendeshin në bregdet.

Çfarë mrekullie, ai ajër i freskët që frynte nga deti, vajzat me kordele të mëndafshta në flokët e tyre të shpupurisur që shëtisnin, turqit e vegjël këmbëzbathur, që thërrisnin me zë delikat, me zë femëror, për të shitur jasemin e fara kungulli. Pronarët e lokaleve vendosnin karriget e tavolinat e vogla të kafenesë përballë detit, që të pasurit të venin me zonjat e tyre, të fejuarit me të fejuarat e tyre të porositnin kafe, ëmbëlsira e të shikonin të kënaqur, të ushqyer mirë, diellin tek perëndonte. Por unë nuk shihja asgjë; as detin krejt të qetë, e të pafund e as nga larg Kepin e mrekullueshëm të shën Pelezhit, as Strumbulabin, malin piramidal që mban në majë, si një vezë të vogël, statujën e Krishtit në Kryq, as të fejuarit e të fejuarat e tyre. Sytë e mi u veshën nga lotët që nuk u derdhën mbi mua.

Sepse dy të fshehta të tmerrshme, që profesori ynë i fizikës na kishte zbuluar atë vit, kishin tronditur shpirtin tim. Kurrë, që atëherë, besoj, dy plagët që ato hapën tek unë nuk janë mbyllur plotësisht.

E fshehta e parë, mizore ishte kjo: Toka nuk është si e besojmë ne, qëndra e universit; dielli e hapësira yjore nuk rrotullohen të bindur rreth Tokës sonë, planeti ynë nuk është veç një yll i parëndësishëm, hedhur në një kënd të galaktikës e rrotullohet me besnikëri rreth diellit. Kurora mbretërore rrotullohej poshtë kokës së nënës sonë Tokë. Më pushtuan hidhërimi dhe indinjata; në të njëjtën kohë, si Nëna jonë dhe ne, u dëbuam nga vendi i nderit në qiell. Toka jonë pra nuk është fiksuar si një zonjë e palëvizur në mes të qiellit, duke parë yjet të kthehen respektivisht rreth saj; ajo kthehet e poshtëruar, pa mbarim e ndjekur nga pas, në mes të flakëve të mëdha, në kaos. Për ku shkon? Ku e shpien? E lidhur me Zotin e saj, ajo ndjek diellin. Dhe ne robër gjithashtu të lidhur, ndjekim atë. Edhe dielli,po ashtu, i lidhur, ndjek dikë tjetër. Kë ndjek ai?

Çfarë ishin pra ato përralla zanash me të cilat mësuesit deri atëherë na kishin çarë veshët, pa pikë turpi, se Zoti kishte bërë sipas tyre, diellin e hënën për të qenë stolitë e tokës, i kishte varur sipër nesh për të na ndriçuar si llampadar, qiellin me yje? Ja kush ishte plagosja e parë; e tjetra: që njeriu nuk është krijesa e dashur, e privilegjuar e Zotit, se Zoti nuk kishte fryrë mbi të, nuk i ka dhënë një shpirt të pavdekshëm; ai është si të tjerët një hallkë e zinxhirit të pafund të kafshëve, nip, stërnip i majmunit. E nëse gërryejmë pak lëkurën tonë, nëse gërryejmë pak shpirtin tonë, do të gjejmë kudo gjyshen tonë majmunkë. Hidhërimi e indinjata ime ishin të padurueshme. Endesha krejt i vetëm në rrugët buzë detit, ose në fushat, ecja shpejt, për t'u lodhur, për të harruar; por aspak nuk përbënte rrezik të harroja. Ecja, ecja, e me kokën e ngritur në qiell e këmishën hapur, pyesja veten përse po mbytesha. Pse na gënjejnë, gjatë këtyre viteve kaq të gjatë? Flisja me vete dhe ecja. Përse na ngrenë frone mbretërore ne njerëzve e nënës sonë Tokë, nëse na rrëzojnë përsëri? Atëherë Toka qënka pra pa rëndësi, ne njerëzit jemi pa rëndësi e një ditë do të vdesim? Jo, jo, thërrisja në vetvete, jo, nuk e pranoja. Duhet t'i biem. T'i biem, fatit tonë deri sa të hapim një portë, për të fituar lirinë.

Nuk duroja dot më. Një mbrëmje shkova të shihja në shtëpinë e tij profesorin e fizikës që na kishte zbuluar këto të fshehta të tmerrshme. Ishte një burrë me çehre të verdhë, fjalëpak, e i thartë në fjalë; sytë e tij ishin të ftohtë, buzët të holla, plot ironi. Shumë inteligjent, shumë i keq, ballin e ngushtë, flokët i takonin pothuaj vetullat; dukej tamam një majmun i sëmurë. E gjeta të rehatuar në një kolltuk të shkatërruar duke lexuar. Më pa, si duket kuptoi shqetësimin tim, sepse qeshi me dinakëri.

- Me ç'rast? - tha. Ti duhet të kesh diçka të rëndësishme për të më thënë?

- Më fal që ju shqetësoj, - i thashë duke m'u marrë fryma, por dua të di të vërtetën.

- Të vërtetën! - tha profesori duke u tallur, vetëm atë! Ti pyet shumë, djalosh.

- Çfarë të vërtete?

- Kush e mori tokën, shfryva... - Kush pra? Zoti. Një e qeshur e keqe, e thatë, prerëse, doli si thikë nga buzët e tij të holla.

Prisja. Por profesori hapi një vazo të vogël qelqi, mori një bombone e nisi ta përtypë ngadalë. - Ju nuk do të më përgjigjeni, zoti profesor? - rrezikova ta pyes unë.

- Do të përgjigjem, tha ai duke vazhduar të përtypë bombonën. Kaloi një kohë e gjatë.

- Kur? Guxova përsëri.

- Për 10 vjet, mbase 20, kur truri yt i vogël të jetë bërë një tru i vërtetë. Tani për tani është herët. Ik!

Doja të thërrisja: Ki mëshirë për mua, Zoti profesor, më thuaj të vërtetën! Por gryka m'u zu.

- Shko, - përsëriti profesori, e më tregoi derën. - Duke dalë, takova në cep të rrugës *arkimandritin* që na jepte mësimin fetar. I padjallëzuar, topolak, i shurdhër, një burrë i shenjtë. Ai e donte marrëzisht nënën e tij plakë që jetonte në një fshat të vogël, të largët e shpesh na thoshte se e shihte në gjumë e se sytë i mbusheshin me lot. Kishte pak zgjuarësi, virgjëria e tepërt duhej ta plogështonte. Sa herë binte zilja e ai mbaronte orën e mësimit, ndalej një çast te pragu i derës,

kthehej e na rekomandonte me një zë lutës e të butë: - E mbi të gjitha, fëmijët e mi, përjetësoni racën tuaj!

- E ne duke shpërthyer në të qeshura, bërtisnim, që ai të dëgjonte: - Mos ki frikë, mos ki frikë, zoti profesor, mos ki frikë! Ky mësues nuk më pëlqente dhe aq shumë; shpirti i tij ishte një dash që blegërinte e nuk mund të lehtësonte shqetësimet tona. Një ditë kur na shpjegoi *Credo*, ngriti gishtin triumfalisht: Ka një zot, mmmm! Sepse *Credo* thotë: - besoj në njëëëë Zot! Nëse do të kishte dy ai do të thoshte: - Besoj në dyyyy zotër! Ne kishim mëshirë për të e asnjë nuk pati mizorinë ta kundërshtonte. Megjithatë një ditë tjetër, nuk u përmbajta dot. Ai na mësonte se Zoti është i gjithëpushtetshëm. Ngrita shishen me bojë:

- Zoti profesor, - e pyeta, - a mundet Zoti të bëjë që kjo shishe bojë të mos ekzistojë...

I shkreti arkimandrit reflektoi një çast, fytyra iu skuq; u përpoq të gjente një përgjigje: në fund, duke mos arritur zgjodhi një shishe e ma hodhi në fytyrë! U ngrita: - Nuk është përgjigje kjo, - i thashë, me një pamje të rëndë prej mëndjemadhi.

Më dëboi nga shkolla për tri ditë; po atë natë shkoi të takojë babanë tim. - Djali yt është i paedukatë e i padisiplinuar, - i tha, nuk do të përfundojë mirë ky fëmijë, duhet t'ia shtrëngosh rripat. - Çfarë ka bërë? - Këtë e këtë, *arkimandriti* ia tregoi gjithçka. Babai ngriti supet: - Më intereson nëse thotë gënjeshtra ose mposhtet. Për të tjerat, është burrë e le të bëjë ç'të dojë.

Ky është arkimandriti që takova në rrugë. Kur e pashë ktheva kokën për të mos e përshëndetur; tani e dija se ai e gjithë njerëzit e llojit të tij talleshin me ne prej shumë vitesh, në atë që brenga e njeriut ka më të shenjtë.

Çfarë ditësh, ato, kur dy shkëndija përshkuan shpirtin tim, çfarë netësh! S'mund të flija: në mesnatë u hodha nga krevati, zbrita shkallën pa zhurmë, me frikë se mos kërcisnin e më dëgjonin, hapa portën si hajdut e u vërsula jashtë. Përshkoja rrugët e ngushta të Megalo Kastros. Qyteti i shkretë, portat të mbyllura, dritat të fikura, mbaja vesh frymëmarrjen e qetë të qytetit që flinte. Vetëm nganjëherë, nën ndonjë dritare të mbyllur, ndonjë i dashuruar, me kitarë këndonte një serenatë e vajtimet e tij të dashurisë, që nuk ishin veç ankime e

lutje, ngjiteshin drejt çatisë së shtëpisë. Qentë e fqinjëve i dëgjonin, zgjoheshin e nisnin të lehnin. Por unë i përbuzja dashuritë dhe gratë; si mund të këndojnë njerëzit, mendoja, si mundet që zemra e tyre të mos gërryhet nga dëshira e vjetër për të mësuar nga vijmë, ku shkojmë e atë seç është vetë Zoti? Kalova me shumë nxitim, arrita kangjellat dhe mora frymë; deti i errët gjëmonte, i papërmbajtur; vërsulej i tërbuar mbi bedena e aty shkërrmoqej, valët kapërcenin pengesat, spërkatnin ballin, buzët, duart e mia e unë freskohesha. Ndenja shumë orë atje, sipër detit, e ndieja se ishte ai e jo toka, nëna ime, se vetëm ai mund të kuptonte ankthin tim, sepse ai kishte të njëjtin ankth e s'mund të flinte; ai lufton, lufton me vetveten, godet gjoksin e kërkon lirinë; ai përpiqet t'u vërë mina pengesave që ngrihen para tij, për të bërë një shëtitje. Toka është e qetë, e sigurtë në vetvete, naive, punëtore; ajo lulëzon, jep fruta të admirueshme, por nuk pushtohet prej frikës. Është e sigurtë se, me dashje ose pa dashje, pranvera do të rishfaqet mbi të. Por deti, nëna ime, nuk është i sigurtë në vetvete, nuk lulëzon, nuk jep fruta; ai psherëtin e lufton ditë e natë. Unë e dëgjoja, ai më dëgjonte, ne ngushëllonim njëri-tjetrin, inkurajonim njëri-tjetrin. Dita gati po zbardhte, njerëzit pas pak do të zgjoheshin e unë do të kthehesha në shtëpi.

I shtrirë mbi krevat, një fatbardhësi e hidhur, e kripur, mbyste gjithë trupin tim, do të isha i lumtur të mos isha i bërë nga toka, por nga uji i detit.

Një fqinjë afër shtëpisë sonë, kishte një majmun të paturp, me prapanicë të kuqe, me sy njerëzorë. Një bej i Aleksandrisë, mik i fqinjit, ia kishte dhënë dhuratë. Çdo ditë, duke kaluar e shihja të mbledhur galiç te pragu i derës, mbi një stol, gati për të hequr pleshtat, për t'u kruar, për t'u zhveshur e për të përtypur me ngadalë kikirikët. Në fillim ndaloja, vëzhgoja atë çfarë bënte majmuni e qeshja; më dukej se ishte një karikaturë e njeriut, një krijesë e gëzuar, e paturp, pa mister, që njeriu mund ta shohë pa shqetësim, duke qeshur. Por në çast më pushtoi një ndjenjë tmerri, ndërrova rrugë, nuk mund ta shihja më; ai poshtëronte njeriun. Ai atje është pra gjyshi im? Kisha turp, mërzitesha, ndieja në vetvete të zhdukej një mbretëri. Ai

atje është pra gjyshi im? Atje, thua, ishin rrënjët e mia? Pra, nuk ishte Zoti që më kishte pjellë, që më kishte përpunuar me duart e tij, ai nuk kishte fryrë mbi mua frymën e tij? Ishte majmuni që më kishte pjellë, duke transformuar nga majmuni në njeri farën e tij. Unë, s'isha djalë i zotit por djalë i majmunit? Zhgënjimi e hidhërimi im zgjatën për muaj të tërë. Kush e di, mbase vazhdojnë akoma. Nga një anë majmuni, nga ana tjetër *arkimandriti*.

Një litar ishte tendosur midis atyre të dyve; sipër kaosit unë kërkoja ekuilibrin tim, që ecte me tmerr mbi atë fije të hollë. Ishin orë të dhimbshme, pushimet arritën e unë u mbylla në shtëpi; kisha marrë hua libra për kafshët, bimët, yjet e qëndroja ditë e natë përkulur mbi to, si i eturi që zhyt kokën e pi në rrëkenë e parë që gjen, miqtë e mi vinin për të më marrë shëtitje, por dilja në dritare e u tregoja kokën time gjysmë të rruar:

- Shikoni - u thoshja, - s'mund të dal në këtë gjendje, e zhytesha përsëri në lexim... Dëgjoja me qetësi të qeshurat e shokëve të mi që largoheshin e talleshin me mua. Sa më shumë mbushesha me dije, aq më shumë zemra ime shpërthente jashtë pengesave. Ngrita kokën e dëgjova fqinjin tim të thërriste majmunin. Një ditë ai u lirua nga litari, u fut me shkathtësi në shtëpinë tonë, u ngjit te mimoza dhe papritur, duke ngritur sytë e pashë që më përgjonte mes degëve. U tmerrova; nuk kisha parë kurrë sy aq njerëzor; sy aq dinakë, plot çamarrokësi, që ishin ngulur mbi mua, sy të rrumbullaktë, të zinj, të palëvizshëm. U ngrita, hodha librat; s'është atje rruga, - thirra, është kundër natyrës së njeriut, unë lashë gjahun për hijen... Gjahu është jeta, kam uri! U përkula jashtë nga dritarja, i hodha një arrë majmunit: ai e kapi shpejt, e theu me dhëmbë, hodhi lëvozhgën e nisi ta përtypë si i pangopur, duke më parë me sy tallës e duke nxjerrë tinguj. Njerëzit e kishin mësuar të pinte verë. Zbrita në qilar, mbusha një tas dhe e vendosa mbi dritare; flegrat e hundës iu hapën e iu mbyllën me lakmi të madhe, bëri një kërcim, u ul mbi parvazin e dritares, zhyti turirin në tas e nisi të pijë, të pijë e të përplasë gjuhën nga kënaqësia; pastaj hodhi krahët e tij mbi shpatullat e mia e më përqafoi; ai nuk donte të shkëputej nga unë. Ndieja ngrohtësinë e tij mbi gushë; ai kutërbonte erë verë e trupi të palarë, qimet e mustaqeve të tij më hynin në hundë, më gudulisnin, unë qeshja; ai

psherëtinte mbi mua, si njeri. Dy ngrohtësitë tona u përzien, fryma e majmunit ndiqte lehtësisht frymën time, ne ishim bashkuar. E kur erdhi nata, ai iku për t'u kthyer te litari i tij; m'u duk se ky përqafim ishte një Paralajmërim i errët, m'u duk se një engjëll i zi, i dërguari i një Zoti katërkëmbësh e leshtor, la dritaren time.

Të nesërmen, aty nga mbrëmja, pa e vendosur plotësisht në shpirtin tim, zbrita në port, në një tavernë të peshkatarëve; porosita verë, një peshk të fërguar për ta shoqëruar e nisa të pi. Nuk e dija nëse isha i hidhëruar, i mërzitur, apo i lumtur, gjithçka përzihej tek unë, majmuni, Zoti, qielli me yje, krenaria e njeriut ishte njëlloj sikur tani t'i kisha vendosur shpresat te vera që të më qartësonte. Disa peshkatarë e hamenj, pirës të shquar, që ngrinin dolli në një cep, më panë e nisën të qeshin: - është akoma qumështor dhe do të na hiqet terjaqi - tha njëri. Imiton të atin, u përgjigj në tjetër, por duhet t'ia bëjmë jetën të vështirë!

Duke i dëgjuar, unë mora zjarr: - Hë, bashkëatdhetarë, - thirra, ejani dhe do ta shihni se do t'ju deh!

Ata u afruan duke qeshur me të madhe. Mbushja gotat deri në grykë pa ndalur, pinim me një gllënjkë, pa ngrënë asgjë, thatë. Ata më shihnin, kokëfortë. Nuk flisnim, nuk këndonim, kapërdinim gotat plot, duke parë njëri-tjetrin, duke mos patur durim të shihnim kush do të fitonte.

Krenaria kretase ishte pezmatuar, ato mustaqe të egra kishin turp nga ideja e të vënit poshtë nga një adoleshent mustaqe padirsur.

Por ata ranë në tokë njëri pas tjetrit; vetëm unë nuk u deha. Kaq e madhe duhet të ishte dhimbja ime sa triumfoi mbi verën. Të nesërmen në mbrëmje, e njëjta gjë e të pasnesërmen e ditën më pas; në qytet kisha fituar reputacionin e një pijaneci, dhe të shoqëruesit të pandarë të figurave të këqia e të hamenjve të portit. Miqtë e mi lumturoheshin, duke parë shkatërrimin e dinjitetit tim; kohë më parë ata më urrenin sepse nuk e doja shoqërinë e tyre; sepse qëndroja mbyllur në shtëpi duke lexuar ose sepse, kohët e fundit, shëtisja vetëm, me një libër në xhep. Nuk luaja, nuk bëja thashetheme me ta, nuk i vardisesha asnjë vajze.

- Ai do të përplasë kokën me yjet e ajo do t'i ndahet në mijëra copa... thoshnin ata duke u tallur, e më shihnin me neveri. Por ta-

shmë që më shihnin me këmbëzbathurit e Megalo Kastros e që poshtërohesha, gëzoheshin. Ata u afruan me mua, madje mund të kishin filluar të më donin e një të shtunë në darkë, më futën me tradhëti në kafe-koncertin më të mirë të Megalo Kastros, që paturpësisht quhej *"Luftëtarët e 1821"*.

Atje, vinin shpesh artiste të reja - rumune, franceze - që kishin çmendur burra të shquar. Çdo të shtunë në darkë ata futeshin në fshehtësi te *Parajsa* e ndaluar, uleshin me ndroje në tavolinat më të largëta, hidhnin shikime rreth tyre për të parë nëse dikush nga të njohurit i shihte, rrihnin duart dhe këngëtaret, stolisur e lyer me parfum, uleshin mbi gjunjët e tyre. Kështu të shkretët, të nderuarit, borgjezë, harronin për disa çaste, ankimet e debatet e virtytit.

Miqtë e mi më ulën në mes, porositën pije, erdhi një rumune e shëndoshë që shkëlqente, moshë e mesme, që s'kishte ç'të mësonte; gjinjtë e saj të djersitur shpërthenin nga korseja e zbërthyer. Më mbushën gotën, piva, nuhatja aromën e thartë të gruas, ndieja në vetvete të zgjohej majmuni, humori m'u largua, mora skarpinën e këngëtares dhe nisa ta mbush me shampanjë e ta pi. Të nesërmen, në gjithë Megalo Kastron zhurmë e madhe: shenjti, i urti Salomon, njeriu mendjemadh, kishte kaluar natën në kafe. - O perëndi! - u deh e piu në këpucën e këngëtares. Fundi i botës! Një nga xhaxhallarët e mi, shumë i turpëruar të shohë nipin e tij në atë gjendje, nxitoi e i raportoi të rejat e freskëta babait tim. Por ai ngriti shpatullat: - Kjo do të thotë që ai është burrë, u përgjigj babai, që ai ka nisur të bëhet burrë; e vetmja gjë, është se tani, ai duhet t'i blejë një palë këpucë këngëtares.

Në vetvete isha i lumtur, sepse kisha thyer ligjet, sepse u lirova plotësisht nga *arkimandritët* e gogolët, e ndoqa gjurmët e forta e të sigurta të stërgjyshit leshtor.

I isha ngjitur të tatëpjetës së keqe, kjo më pëlqente. Ishte viti i fundit i liceut, unë shihja me urrejtje arkimandritin që qeshte, i fshehur në virtytin e tij; ishte i sigurtë për këtë jetë e për tjetrën; ky dash blegërues na shihte me keqardhje ne ujqërit. Këtë nuk mund ta duroja; duhej ta turbulloja qetësinë e tij, të bëja të ziente gjaku i tij, të zhdukja të qeshurën idiote që ishte derdhur mbi fytyrën e tij. Kështu, një mëngjes, bëra një veprim të gabuar; i dërgova atij një letër

të vogël: "Nëna jote është e sëmurë rëndë, po vdes; nxito ta shohësh, që të të japë bekimin e saj." Ia dërgova e shkova në klasë, prisja i qetë. Atë ditë arkimandriti nuk erdhi në mësim as të nesërmen, as të pasnesërmen. Ai erdhi 5 ditë më vonë, i transformuar; fytyra e tij ishte fryrë, një ekzemë, kishte deformuar fytyrën e tij; i ishte shfaqur nga gryka deri te sqetullat; s'pushonte së kruajturi, së acaruari, s'mund të fliste e iku para se të binte zilja. Ai qëndroi tre muaj në shtrat. Erdhi një mëngjes, me kokën të zbathur, i mbaruar, fytyrën akoma mbuluar me shenja. Na pa me dhimbshuri, e qeshura kishte shpërthyer përsëri në fytyrën e tij e fjalët e para të tij ishin: "Qoftë lëvduar Zoti, fëmijët e mi, është ai që vuri dorë e më shkroi letrën ku lexova se nëna ime ishte sëmurë: kështu m'u dha rasti të paguaj dhe unë haraçin e të qënit burrë-vuajtjen." U turbullova: pra kaq e vështirë është të fitosh mę virtytin? Një çast u ngrita e thirra: "Është gabimi im!" por një tjetër zë u ngrit brenda meje, sarkastik, i keq: "Ti je një qen, qen i arkamandritit, të shtyjnë e ti lëpin dorën që të shtyn. Jo! Bëra mirë që s'u pendova!

ILUMINIZMI

Të nesërmen mblodha anëtarët e *Shoqatës*. Tani që shpirti ynë u ndriçua,u thashë atyre, - kemi detyrë të ndriçojmë shpirtin e botës. Ky duhet të jetë misioni i madh i *Shoqatës*. Kudo ku shkojmë, kudo ku ndalojmë, çdo fjalë jona, çdo veprim yni duhet të ketë një qëllim të vetëm: të ndriçojë!

Iluminizmi filloi. Studimet në lice mbaruan, ne ishim të lirë. Babai, që donte të më bënte njeri politik, më dërgoi nun, në një pagëzim në fshat. Mora me vete dy miqtë e mi: rast i mirë për të ndriçuar një fshat. Nga fundi i ceremonisë, kur u ulëm në tavolinë e filloi festa, miku im i ngushtë u hodh e nisi t'u predikojë fshatarëve e t'i "ndriçojë". Ai nisi të flasë për origjinën e njeriut; stërgjyshi ynë është majmun e nuk duhet të mburremi që jemi krijesa të privilegjuara të Zotit... Gjatë gjithë kohës që miku im diskutonte, papui, e shihte, me sytë e zgurdulluar e nuk fliste; por kur predikimi mbaroi, prifti tundi kokën me dhimbshuri: - Më fal, biri im, - tha, gjatë gjithë kohës që fole unë të shihja. A është e mundur që gjithë njerëzit, si thua ti, të vijnë nga majmuni, por ti, më fal, ti, rrjedh nga gomari. U rrënqetha. Pashë mikun tim, më dukej se e shihja për herë të parë. Me nofullën e tij të gjatë, veshët e mëdhenj të ulur, sytë e qetë, të ëmbël - me të vërtetë i ngjante një gomari dhe çudi si nuk e kisha dalluar më parë. Një fill u këput brenda meje; që prej asaj dite nuk i dërgova më letra mikut tim e pushova së qeni ziliqar për të. Ditët që pasuan, duke përshkuar fshatrat e madje dhe në Megalo-Kastro, ne patëm shumë zhgënjime duke dashur të "ndriçojmë": njerëzit. Na quanin ateistë, *frankmasonë* të shitur. Pak nga pak nisën të na dëbonin aty ku kalonim, në mes të fyerjeve e domateve, ne kapardiseshim, të lumtur që bënim heroin për të vërtetën. Nuk është gjithmonë kështu - i thoshim njëri-tjetrit për t'u ngushëlluar, çfarë fati të vdesësh për një ide të madhe! Një ditë tjetër ne shkuam te tre në

ekskursion në një qytet të vogël, të shquar për verërat e tij, dy orë larg nga Megalo Kastro. Ai gjendej në këmbë të malit të shenjtë Ida, ku thonë se është varrosur babai i Zotave e i njerëzve, Zeusi. Por, edhe poshtë gurëve ku pushonte, Zoti i vdekur, kishte patur akoma forcën për të transformuar malin sipër tij, kishte zhvendosur shkëmbinjtë e i kishte grumbulluar për të krijuar një kokë të madhe të përmbysur. Dallohej qartë balli, hunda dhe mjekra e bardhë që zbriste deri në fushë.

- Zotat gjithashtu vdesin, tha miku im, ai që donte të bëhej shpikës e të pasuronte shoqërinë.

- Zotat vdesin, - iu përgjigja, por hyjnia është e pavdekshme.

- Ne nuk e kuptojmë, - thanë miqtë e mi, çfarë do të thuash?

- Edhe unë nuk kuptoj mirë tani, u përgjigja e nisa të qesh. Ndjej që kisha të drejtë por nuk mund ta tërhiqja idenë time fare hapur preferova të qeshja. E qeshura ka qenë për mua, gjithmonë port nga ku largohesha në momente të rrezikshme.

Arritëm në fshat, ajri kutërbonte erë raki e musht. Fshatarët ki shin vjelë rrushin, kishin hedhur mushtin në fuçi, kishin nxjerrë raki nga bërsia e tani ishin ulur në kafe, mbi stolat me dru pylli, në një plep, pinin raki, luanin letra; po shlodheshin.

Dikush u ngrit, na uroi mirëseardhjen, na ulën në tavolinat e tyre e porositën për të tre ne shurupe. Ne filluam diskutimin; të tre kishim rënë dakort që më përpara e pak nga pak e çuam bisedën rreth mrekullive të shkencës.

- E imagjinoni - u thoshim ne, si prodhohet letra për t'u bërë gazeta? Është një mrekulli. Priten dru, sillet druri në makineri, e copëtojnë e shndërrojnë në përshesh, përsheshi bëhet letër, letra hyn në shtypshkronjë e nga një derë tjetër del gazeta.

Fshatarët mbanin veshët ngritur e dëgjonin. Ata ishin ngritur nga tavolinat fqinje e ishin ulur tek e jona. Po i kënaqim shumë - thoshim, - shpirti i tyre pothuaj u ndriçua. Në këtë çast, një djal i madh kaloi me gomarin e vogël ngarkuar me dru, ndaloi për të dëgjuar bisedën.

- Hë Dimitro, - i thirri dikush. - Ku i çon këto dru?

- Do bëj gazetë, - u përgjigj tjetri e menjëherë gjithë fshatarët, që deri atë çast ishin sjellë mirë, shpërthyen me të qeshura; fshati u

trondit.

- Shkojmë - u thashë unë fare qetë miqve të mi, edhe këtu do te na hedhin domate.

- Ku po shkoni, fëmijë? - thirrën fshatarët duke qëndruar afër njëri - tjetrit, - prisni, na tregoni gjëra të tjera që të na bëni të qeshim. Ata na ndoqën duke bërtitur:

- Kush lindi e para, na thoni, fëmijë të mirë, veza apo pula?

- Po Zoti, fëmijë, si arriti të mbajë tjegullat pa gozhdë?

- Po shenjti Solom, është burrë apo grua? Atje po të pres, shejtan i madh!

- Po qingji me pesë këmbë, çfarë ha, na thoni?

Por ne ishim nisur me vrap.

Kishim ndaluar së ndriçuari njerëzit me fjalë; kishim marrë vendimin të shtypnim një manifest për popullin, ku do t'i ekspozonim qartë e pa pasion cili ishte qëllimi ynë e cila ishte detyra e njeriut.

Mblodhëm lekët e shkuam tek gazeta Markolis, që e thërrisnin "Mjerim", sepse dhe ai bënte manifeste për të ndezur të varfërit, t'i bashkonte duke i bërë, një forcë të madhe, të cilët duhet të zgjidhnin deputetin e tyre. Shkuam kështu ta takonim. Ishte burrë me moshë mesatare, flokëthinjur, syze të vogla, me trup të gjërë si një barrikadë mbi këmbët e vogla, të shkurtra; mbante një shami të kuqe të lerosur rreth qafës.

Ai mori dorëshkrimin tonë e nisi ta lexojë me zë të lartë, me patos; sa më tepër e lexonte, aq më shumë rritej entuziazmi ynë - Sa bukur ishte shkruar, sa ndriçues, me çfarë force!

Të tre mbanim qafën drejt, fitimtarë si gjelat e rinj që sapo kanë filluar të këndojnë.

- Bravo djema, - tha Markolis duke mbështjellë dorëshkrimin. - Kujtoni këtë që po ju them. Një ditë, ju do të bëheni deputetë për të shpëtuar Greqinë. Ejani të bashkohemi, unë gjithashtu bëj manifeste. Të japim besën!

- Po ti, - kundërshtova unë - ti nuk merresh veç se me të varfërit; ne të tjerët kujdesemi për të gjithë, qëllimi ynë është më i madh.

- Po truri juaj është më i vogël - replikoi pronari i shtypshkronjës, i prekur në sedër.- Ju doni t'u predikoj të pasurve? Mundim i humbur; është sikur të duash të fitosh një grosh nga një gomar i ngordhur.

I pasuri, më dëgjoni çfarë ju them, nuk do të ndryshojë asgjë, as Zotin, as atdheun, as jetën e bukur, ai është i rregulluar mirë; shurdhi më i keq është ai që nuk do të dëgjojë. Filloni, pra, qingjat e mi të vegjël nga më të varfrit, nga ata që janë ngushtë, nga ata që vuajnë. Ndryshe, shkoni të gjeni një botues tjetër. Mua më quajnë "Mjerim". Që të tre u tërhoqëm te porta për t'u marrë vesh; nuk vonuam dhe ramë në një marrëveshje, morëm vendimin tonë; miku im u kthye drejt botuesit.

- Ne, nuk pranojmë; nuk bëjmë asnjë lëshim. Ne, veç të tjerash nuk bëjmë diskriminime mes të varfërit e të pasurit, gjithë bota duhet ndriçuar!

- Atëherë shkoni në djall, buzëqumësht, - thirri Markolis dhe hodhi në fytyrë dorëshkrimin.

IRLANDEZJA

Megjithatë nuk isha i kënaqur. Rruga që kisha zgjedhur më pëlqente, duhej t'i shkoja deri në fund. Një irlandeze arriti atë vit në Megalo Kastro e jepte mësime anglishteje. Etja për të studiuar më digjte gjithmonë, e mora si profesore për të më mësuar gjuhën e saj, që manifestet të mund t'i shkruaja në anglisht, për të ndriçuar njerëzit jashtë Greqisë.

Përse t'i lë njerëzit në errësirë? U zhyta me kokë të studioja anglishten. Nisa të shëtisja me këtë irlandeze në një botë të huaj, magjike, - në poezinë lirike angleze. Çfarë gëzimi ishte; gjuha, zanoret, bashktingëlloret, ishin shndërruar në zogj e këndonin. Qëndroja në shtëpinë e saj deri vonë, flisnim për muzikën, lexonim poema. Ajri mes nesh përcëllonte kur ulesha mbi shpatullën e saj e kur ndiqja poezitë e Keatsit e të Bajronit, ndieja aromën e ngrohtë, të thartë të sqetullave të saj. Shpirti im turbullohej, Keatsi e Bajroni zhdukeshin e në dhomën e vogël nuk ngelej, jo njëri i veshur me pantallona e tjetri me fustan, por dy kafshë të shqetësuara.

Tani, liceu mbaroi, përgatitesha të shkoja në Athinë e të regjistrohesha në Universitet. Ku i dihej nëse do ta shihja më këtë vajzë me sy blu, pak të kërrusur, por të freskët si shkumë, këtë vajzë të një pastori irlandez? Sa më shumë afrohej ndarja, aq më shumë shqetësohesha. Një fik të pjekur e të sheqerosur, kur kemi uri e etje, zgjasim dorën si të babëzitur dhe e zhveshim, e sa më shumë e zhveshim, aq më shumë goja na mbushet me ujë. Kështu i hidhja shikime të fshehta asaj Irlandezeje dhe e zhvishja në shpirt si fik.

Një ditë shtatori mora vendimin tim: - Do që të hipim në Psiloriti? Që atje shihet gjithë Kreta. Ka një kishëz të vogël në majë. Do ta kalojmë natën atje e do të të them lamtumirë.

Ajo u skuq deri te veshët dhe pranoi. Çfarë misteri të thellë mbante fshehur ky ekskursion, çfarë padurimi, çfarë butësie! Udhëti-

met e dasmës duhet të jenë të ngjashme. U nisëm natën. Hëna sipër kokave tona derdhte mjaltë. Kurrë në jetën time s'pashë hënë të ngjashme; ajo më shfaqej gjithmonë si një fytyrë e dëshpëruar. Ndërsa atë natë, ajo qeshte, na shihte me sy dinakë e që nga lindja, ecte me ne, dhe duke fjetur zbriste, nga bluzat tona të hapura mbi gushat, në kraharor e deri te barku ynë.

Nuk flisnim; nuk donim të shkatërronim me fjalë, mirëkuptimin perfekt, të heshtur, që realizonin trupat tanë, njëri pranë tjetrit.

Për një çast, në një shteg të ngushtë ijet tona u takuan, por shpejt u larguam nga njëri-tjetri. Sikur ne nuk donim të shpenzonim në kënaqësi të vogla dëshirën tonë të pakrahasueshme; ne e ruanim të tërën për çastin e madh, përparonim me ngut, me frymëmarrje të shpejtë, jo si dy miq por si dy armiq të papajtueshëm, vraponin drejt liceut ku do të nisnim luftimin, gjoks më gjoks. Deri atë çast nuk kishim shqiptuar asnjë fjalë dashurie, për këtë ekskursion kishim rënë dakort për asgjë, por që të dy sigurisht e dinim arsyen përse shkonim e ku shkonim, shpejtonim e me sa dukej ajo më tepër.

Kur arritëm në fshat, në këmbë të Psiloritit, dita zbardhi; ishim të lodhur, shkuam të pushonim në shtëpinë e priftit. U thashë që shoqja ime ishte gjithashtu vajzë prifti, në një ishull të largët e krejt të gjelbër, e që donte të shihte Kretën, të tërën nga maja e malit Psiloriti. Erdhi gruaja e priftit, shtroi tavolinën, ne hëngrëm, u ulëm në kanape e nisëm një diskutim të gjerë. Folëm në fillim për Fuqitë e Mëdha, Anglinë, Francën, Amerikën, Moskën; më pas për verërat e për ullinjtë; pastaj prifti foli për Krishtin, që ai ishte ortodoks e nuk kthehej katolik, çfarëdo që t'i bëhej - E nëse këtu me ju, do të ishte babai i vajzës, vë bast që brenda një nate do ta ktheja në ortodoks. Por sytë blu kishin gjumë, prifti i bëri shenjë gruas së tij. - Bëj gati krevatin për vajzën që të flejë, është grua e i vjen gjumë. Ai u kthye nga unë. - Kurse ti, ti je burrë, një djalë i fuqishëm kretas, është turp për një kretas të flejë ditën; eja, do të tregoj vreshtën time, gjenden akoma verige, do t'i hamë. Isha i rraskapitur nga lodhja e po rrëzohesha nga pagjumësia, por si t'ia bëja? Isha kretas, nuk duhej ta turpëroja Kretën. Shkuam në vreshta, hëngrëm të mbeturat e rrushit të vjelur, bëmë një xhiro në fshat; Në vazhdim kazanët ishin gati në vlim, po distilohej marka, pimë disa gota raki, akoma

të ngrohtë; Kur erdhi mbrëmja u kthyem në shtëpi, kapur krah për krah, duke na u marrë këmbët të dyve. Irlandezja ishte zgjuar, gruaja e priftit kishte therur një pulë, ne nisëm të hanim. - Këtë mbrëmje, s'ka dikutim tha prifti, flini, e në mesnatë do t'ju zgjoj e do t'ju jap bariun tim të vogël si udhërrëfyes që të mos humbisni rrugën. Ai doli në oborr, vrojtoi qiellin e u kthye i kënaqur: - Keni shans, tha, nesër do të jetë kohë e shkëlqyer. Shkoni! Ju bekoftë Zoti; natën e mirë! Nga mesnata prifti më tundi nga këmba e më zgjoi; zgjoi gjithashtu vajzën duke trokitur në një pjatë bakri sipër kokës së saj. Në oborr na priste një bari i vogël, i fishkur, veshët ngritur e me sy të egër; - ai mbante erë çjap - Shkoni! - tha, duke ngritur shkopin; shpejtuam hapin për të arritur në majë në çastin kur do të lindte dielli. Hëna ishte në mes të qiellit, akoma e qeshur, e ëmbël. Bënte ftohtë, ne u shtrënguam në palltot tona, hunda e vogël e Irlandezes ishte bërë e bardhë, por buzët e saj ishin të kuqe; ktheva kokën për të mos e parë.

Mali ishte i egër, lamë pas vreshtat e ullinjtë pastaj lisat e qitrot; u futëm në udhën me guriçka. Këpucët tona nuk kishin gozhdë, e ne rrëshqisnim; dy-tre herë Irlandezja ra, e u ngrit me forcat e saj. Nuk kishim ftohtë më, djersa na lagte trupat. Kafshonim buzët për të mos gulçuar, e përparonim të heshtur; bariu i vogël përpara, Irlandezja në mes, unë i fundit.

Qielli mori një dritë qumështore, gurët u bënë fosforeshentë, petritat e parë nisën të fluturojnë në qiellin blu të errët; e kur më në fund arritëm majën, Lindja mezi mori një ngjyrë të kuqe të lehtë. Por nga larg, nga të gjitha drejtimet, nuk dalloja asgjë; një mjegull e dendur mbulonte tokën e detin. Trupi i Kretës ishte tërësisht i veshur. Bënte një i ftohtë i tmerrshëm e ne fërgëllinim. Shtymë portën e vogël të kishëzës e hymë brenda. Bariu i vogël ndërkohë kërkonte andej këtej shkarpa të thata për të ndezur zjarrin.

Ne kishim ngelur vetëm, unë e irlandezja, nga lart tek ikonostasi na shikonin Krishti dhe virgjëresha: por ne nuk i shikonim; djajtë, armiq të Krishtit; armiq të virgjërisë ishin zgjuar tek ne; Unë zgjata dorën, shtrëngova Irlandezen për qafe; ajo u përkul, u shtri, sepse këtë priste dhe ashtu u rrokullisëm nëpër pllaka.

Unë isha përmbysur; një grackë e errët ishte hapur dhe më kishte

gëlltitur. Kur hapa sytë, pashë pikërisht Krishtin që më shihte nga ikonostati atje lart, me shikim të ashpër, ndërsa lëmshi i gjelbër që mbante në dorën e majtë filloi t'i dridhej, sikur ai përgatitej të ma hidhte mua; unë u tremba, por krahu i irlandezes më përqafoi dhe unë u zhyta përsëri në kaos.

Kur hapëm portën e ulët për të dalë, na dridheshin gjunjët, më dridhej dora duke tëhequr shulin. Më kishte pushtuar përsëri një frikë e vjetër: Zoti do të lëshontë rrufetë për të na përvëluar të dyve, Irlandezen dhe mua, Adamin dhe Evën. Nuk mund të fëlliqësh shtëpinë e Zotit, nën sytë e virgjëreshës, pa u ndëshkuar... Dola jashtë, sapo u gjenda atje pashë çfarë mrekullie shpalosej përpara meje, çfarë gëzimi! Kishte dalë dielli, mjegulla ishte shpërndarë, gjithë Kreta, nga njëri skaj në tjetrin, shkëlqente e bardhë, e gjelbër, rozë, rrethuar nga katër dete.

Kreta, me tre majat e saj të larta, Malet e Bardhë, Psiloritin, Malin Dikte, i ngjante një anijeje me tre vela që lundronte nëpër shkumë. Ishte një përbindësh detar, një sirenë, me një mori gjiresh e shtrirë përmbys përmbi dallgë, që ngrohej në diell. Unë dallova pikërisht nën diellin mëngjezor, fytyrën e saj, duart, qafën, gjinjtë e saj të ngritur... Në jetën time ka patur shumë gëzime, nuk mund të qahem; por kur pashë gjithë Kretën mbi dallgë, ka qenë një nga më të mëdhenjtë. U ktheva prapa dhe pashë irlandezen; mbështetur tek kishëza, ajo kafshonte një çokollatë dhe e qetë, indiferente, lëpinte buzët mbuluar me copëza të vogla.

Kthimi në Megalo Kastro ka qenë i trishtë. Po mbërrinim; u dukën muret e famshëm venecianë, me luanët e tyre të gurtë. Irlandezja, e lodhur, u afrua pranë meje për t'u mbështetur tek krahu im, por unë nuk mundja të duroja as sytë e saj të veshur e as erën e saj. Molla që më kishte dhënë për të ngrënë më kishte mbushur buzët dhe dhëmbët me copëza. Bëra një lëvizje të shpejtë, nuk e lashë të më afrohej; ajo nuk foli, u tërhoq pak prapa meje dhe unë e dëgjova të qajë. U ktheva prapa, e mora në krahë, dhe i fola fjalë të ëmbla; por nxitova hapat dhe nuk fola më asnjë fjalë derisa arritëm në shtëpinë e saj. Nxori çelësin nga xhepi, hapi portën. Ndaloi tek pragu, priste. Kishte ulur kokën, priste. Do të hyja përsëri apo nuk do të hyja? Shumë fjalë të dhimbshme, një hidhërim, një mëshirë e pa-

durueshme ngjitej dalëngadalë e po më vinte tek gryka. Por unë shtrëngova fort dhëmbët, e nuk thashë asnjë fjalë. I dhashë dorën, u ndamë. Të nesërmen u nisa për Athinë; Nuk kisha çfarë dhurate t'i jepja në shenjë kujtimi, dhe i dërgova me një nga nxënësit e saj një qen, që e doja shumë e që kafshonte, Karmenin.

ATHINA

Një bishë e verbër, e papërqëndruar, që ka uri por nuk ha, që i vjen turp të hajë, që vetëm një shenjë t'i bënte lumturisë që kalon në rrugë e ajo do të ndalonte me dëshirë të madhe, por nuk e bën, që hap rubinetin dhe e lë kohën të rrjedhë e të harxhohet pa përfituar prej saj, sikur të ishte ujë, një bishë që nuk e di se është e tillë, kjo është rinia.

Kujtoj vitet kur jetoja në Athinë, student, e më copëtohet zemra. Shikoja por nuk shihja: Një mjegull e trashë, produkt i imagjinatës, moralit e kotësisë mbulonte botën përreth e më pengonte të shihja. Rinia është e hidhur, shumë e hidhur, mospërfillëse, e nuk kupton; kur fillon të kuptosh, rinia ka ikur. Cili është ai kinezi i ditur që kishte lindur plak, me një mjekër të bardhë, me flokë të bardhë, me sytë mbushur me lot? Por që pak nga pak, me kalimin e viteve flokët i nxiheshin, sytë i qeshnin, zemra i forcohej. Kur po i afrohej vdekja faqet iu bënë të bardha e iu mbuluan me një push të imët djaloshar... Pra në qoftë se Zoti do të kishte mëshirë për njerëzit kështu duhej ta rregullonte jetën.

Një herë në Kretë unë u rebelova për të kundërshtuar fatin tim, dhe u dhashë Pas verës; edhe njëherë tjetër dhe unë do të bëhesha si irlandezja; por kjo nuk ishte rruga ime, u pendova dhe më vinte turp; sikur kisha bërë një mëkat, u ktheva në vetminë time dhe tek librat.

Që prej rinisë e deri në pleqëri, unë e kam quajtur mëkat çdo fjalë apo veprim që më shmangte nga fati im. Po cili qe ky fat? Ku më çonte ai? Shpirti nuk mundej akoma të përcaktonte e unë lija zemrën të vendoste. - bëj kështu, mos bëj kështu, ec, mos ndalo, mos klith, ti ke vetëm një detyrë, të shkosh deri në fund - Cili fund? E pyesja. - Mos bëj pyetje, ec përpara! Midis vetmisë unë dëgjoja udhëzimet e guximshme të zemrës krenare. Dëshira ime ishte e pezmatuar

dhe asgjë nga ajo që shikoja ose dëgjoja rreth meje në atë Athinë të famshme nuk mund të më kënaqte. Mësimet në fakultetin e drejtësisë nuk u përgjigjeshin gjithë nevojave të shpirtit tim, as kureshtjes së mendjes sime. Dëfrimet që organizonin miqtë e mi me studentët e rrobaqepëset nuk më jepnin asnjë gëzim. Unë kisha akoma në dhëmbë mbeturinat e mollës që më kishte dhënë për të ngrënë irlandezja. Shpesh herë shkoja në teatër ose në koncert dhe kjo më gëzonte; por megjithatë ajo ishte një kënaqësi e çastit dhe nuk ndryshonte asgjë brenda meje, kështu që sa dilja prej andej i harroja. Mësoja gjuhë të huaja dhe ndieja se shpirti më bëhej më i gjerë, gëzimet ishin më të mëdha, por përnjëherë fillonte të frynte era e vakët e misterioze e rinisë dhe gjithë gëzimet zhdukeshin.

Por unë dëshiroja diçka tjetër që qëndronte mbi gratë e studimet, mbi bukurinë, po cilën?

Vazhdimisht dy plagët e adoleshencës sime më përtëriheshin. Gjithçka ishte e kotë, asgjë s'ka vlerë sepse është e përkohshme dhe zhduket në humnerë si një mekanizëm i montuar nga një dorë e pamëshirshme. Çdo fytyrë të vajzave të reja e imagjinoja se si do të dukej plakë. Lulja fishkej dhe pas buzëve që qeshnin këndshëm, shihja dy nofulla pa mish të kokës së vdekur. Bota merrte në sytë e mi një ritëm të shpejtë, të nxituar, dhe shëmbej. Rinia kërkon pavdekësinë dhe nuk e gjen dot. Ajo nuk pranon asnjë lëshim dhe kundërshton me krenari. Por jo të gjitha rinitë; vetëm ajo që është plagosur nga e vërteta.

Të dielën, më pëlqente të shkoja në ekskursion fare i vetëm; shokët, bisedat, shakatë, të qeshurat më dukej se e poshtëronin qetësinë e shenjtë. Hyja në një ullishte. Sytë freskoheshin, mali kundërmonte erë pishe e mjalti. Këmbeja disa fjalë me ndonjë fshatar që kalonte andej - një shqiptar me ball të ngushtë, me një kapele të zezë gjithë zhul, që mbante era hudhër e qumësht. Fjalët e tij ishin prozaike, të ngatërruara, që tregonin një kuriozitet të errët. Më shikonte me sytë kureshtarë e zhbirues duke torturuar trurin e tij të mjerë për të gjetur se ç'isha unë e përse bridhja malit. Mos isha spiun, i marrë, tregëtar, mashtrues? Shikonte me kureshtje të madhe çantën që mbaja mbi shpinë, - Çfarë shet or mik? - më tha. Ungjij? Apo je bamirës? Një ditë kur pashë një zog me ngjyrë blu të thellë

që kalonte mbi mua duke fërshëllyer, pyes një fshatar që kalonte aty: - Çfarë zogu është ky? Si quhet? Fshatari ngriti supet: - Përse të duhet or mik? Ai nuk hahet.

Zgjohesha në agim. Ylli i mëngjesit ndrinte mbi tokë. Një mjegull e lehtë mbulonte Himetin. Era e lehtë më freskonte ballin. Laureshat ngriheshin në ajër duke cicërirë e zhdukeshin në pafundësinë e ditës që lindte.

Më kujtohet, një të diel pranvere, në një tokë të punuar gjendeshin dy-tre qershi të mbushura me lule të kuqe. Zemra m'u mbush me gëzim. U lumturova. Në atë kohë po lindte dielli dhe ndriçonte mbi tokë me një dritë të tillë, si ditën e Zotit. Mbi detin në gjirin Sarini, po agonte, i cili, në horizontin e mëngjesit, dukej si i mbuluar me trëndafila. Dy korba fluturuan shumë pranë nga e djathta ime, shenjë fati, krahët e tyre zhurmuan si kordat e një harpe.

Nga njëra anë, dallgët, si kuajt homerikë me jelet e tyre të bardha, ishin vargjet e gjata të Homerit, plot freski, nga ana tjetër ullinjtë e Athinës plot vaj e dritë, dafinat e Apollonit e vreshtat e mrekullueshme të Dionisit, plot verë e këngë. Një tokë e thatë, e pakët; gurë që dielli i kishte ngjyer me ngjyrë trëndafili; malet ngjyrë blu valëzonin në lartësitë e reve e pinin duhan nën dritën që binte. Të zhveshur, ata ngroheshin qetësisht nën diell si atletët kur pushojnë.

Unë ecja, e ndërsa ecja më dukej se së bashku me mua ecnin dhe toka dhe qielli. Gjithë mrekullitë që më rrethonin hynin brenda meje e unë lulëzoja, qeshja, e tingëlloja si kordat e një harku. Shpirti im i humbur këtë të diel, zhdukej nëpër dritën e mëngjesit duke cicërirë si laureshë.

U ngjita në një kodrinë prej nga shikoja detin, brigjet e hollë ngjyrë rozë, ishujt që mezi shquheshin. Bukuria është atje pështëirsia. Trupi i virgjër i Greqisë noton e ngrihet sipër dallgëve. Dielli i qëndron sipër si i fejuari saj. Ai mposht gurin dhe ujin, ndan lëndën e pajetë dhe e pret për të ruajtur substancën.

Akoma i ri unë ndërtova një plan ashtu si gjenerali përpara fillimit të betejës:

1. trupi duhet t'i nënshtrohet shpirtit;
2. shpirti duhet t'i nënshtrohet qëllimit;
3. qëllimi duhet t'i nënshtrohet harmonisë, bashkëpunimit me

individin dhe me universin.

Shëtisja nëpër Atikë për ta njohur - të paktën kështu besoja. Por në fakt unë shëtisja për të njohur shtigjet e shpirtit tim. Te pemët, te malet, në vetmi, unë kërkoja shpirtin tim; kërkoja ta njihja por më kot. Zemrës ime nuk dridhej, shenjë e sigurt që provonte se unë nuk kisha gjetur atë që kërkoja.

Një herë në mesditë kujtoj[illegible]se e gjeta. Kisha shkuar vetëm në kepin Sunio. Dielli digjte. Ishte verë. Nga lëkurët e çara të pishave rridhte rrëshira dhe era e saj kundërmonte. Një gjinkallë u ul mbi supin tim dhe për një kohë të gjatë ne ecëm së bashku. Trupi im mbante erë pishe. Unë isha kthyer në pishë. Menjëherë sapo dola nga pishnaja, pashë kolonat e bardha të tempullit të Poseidonit e ndërmjet tyre, plot shkëlqim, me një ngjyrë blu të errët, detin e shenjtë. Gjunjtë m'u prenë, e ngela ashtu i ngrirë. Ja bukuria, mendoja, ja hyjnesha pa krahë, kulmi i gëzimit. Njeriu nuk mund të arrijë më lartë. Ja Greqia.

Gëzimi ishte aq i madh sa unë besova për një çast, duke soditur bukurinë e Greqisë, se dy plagët që kisha marrë ishin shëruar dhe se kjo botë edhe pse ishte aq jetëshkurtër kishte një vlerë. Pikërisht se ishte aq jetëshkurtër. Unë nuk duhet, mendoja, të përpiqem të imagjinoj prapa fytyrë së vajzës, plakjen e saj të nesërme, por të mundohem të rikrijoj pas rrudhave e zhubrave, freskinë e paepur rinore, që nuk është më e tillë.

Në të vërtetë, peizazhi i Atikës ka një magji të patreguar që të lë pa mend. Duket se këtu në Atikë gjithçka i është nënshtruar një ritmi të thjeshtë, të sigurt, të ekuilibruar. Këtu gjithçka ka një nur e një mirësi prej zotërie; toka e thatë dhe e pakët, takimet e bukura të Himetit dhe të Pantelikut, ullinjtë me fletë të argjendta, qiparizet e hollë, asketikë, loja e reflekseve të gurëve nën rrezet e diellit, e mbi të gjitha drita e tejdukshme, e lehtë, aq shpirtërore, që zbulon e zhvesh gjithçka.

Peizazhi atik duket sikur thotë që kështu duhet të jetë modeli ideal i njeriut: i ndërtuar mirë, i kursyer në fjalë, pa pasuri të tepërta, i fuqishëm e i zoti, megjithatë, të përmbajë forcën e tij dhe të kufizojë imagjinatën. Peizazhi atik shpesh herë arrin në kufijtë e rreptësisë, por nuk e kalon kurrë atë. Bukuria e tij nuk kalon në romantizëm,

as e tepëron duke kthyer forcën në ashpërsi. Gjithçka është e peshuar mirë, e matur mirë dhe virtytet nuk ekzagjerohen, nuk dalin nga përmasat njerëzore. Ato ndalen në pikën ku mund të bëhen njerëzore ose qiellore. Peizazhi atik nuk kapardiset, nuk bën retorikë; nuk iu nënshtrohet melankonive melodramatike, thotë atë që ka për të thënë me forcë e qetësi. Ai shpreh anën thelbësore, me sa më pak mënyra.

Vende - vende, midis këtyre maleve hijerënda, ka një buzëqeshje, dy-tre ullinj me gjethe të argjendta mbi një kodrinë të thatë, freski të disa pishave të gjelbra, dafina ngjyrë trëndafili pranë shtratit të bardhë të një përroi të thatë, një tufë manushaqesh të egra ndërmjet gurëve në blu të errët, që të djegin. Atje gjithë të kundërtat përzihen e ngatërrohen dhe krijojnë mrekullinë supreme, harmoninë.

Si është krijuar gjithë kjo mrekulli? Ku e ka marrë kjo bukuri gjithë këtë seriozitet dhe serioziteti këtë bukuri? Si ka mundur forca të mos abuzojë me përmbajtjen e saj? Kjo është pra mrekullia greke.

Ndonjëherë, duke shëtitur nëpër Atikë, mendoja se kjo tokë mund të bëhet mësimi më i mirë për humanitetin, fisnikërinë dhe forcën.

Pas çdo bredhjeje timen nëpër Atikë, unë ngjitesha, as vetë nuk e di përse, më këmbë në Akropol, shikoja e shikoja vazhdimisht Panteonin. Ky tempull për mua është një mister. Nuk mund ta shihja dy herë dhe të ishte i njëjti. Më dukej se ndryshonte vazhdimisht. Ai merrte jetë, valëzonte duke mos lëvizur, luante me dritën dhe me syrin e njeriut.

Kur u gjenda përballë tij për herë të parë, pas shumë vitesh që më kishte djegur dëshira për ta parë, m'u duk i palëvizshëm si skeleti i një përbindëshi antik dhe në zemër nuk ndjeva ndonjë gëzim, paskëqaj, kjo për mua ishte shenjë që nuk më gënjente më.

Kur gjendesha përballë një lindjeje dielli, një pikture, një gruaje, një ideje dhe zemra më mbushej me gëzim, unë kuptoja se isha përpara lumturisë. Herën e parë kur u gjenda përballë Panteonit zemra nuk m'u mbush me gëzim. Panteoni m'u duk si një zotësi e inteligjencës, e numrit dhe e gjeometrisë. Një arsyetim i shkëlqyer i realizuar në mermer. Një arritje sublime e shpirtit që kishte gjithë virtytet, por që i mungonte vetëm njëri, më i çmuari, më i dashuri: të prekte zemrën e njeriut.

Panteoni m'u duk si një numër çift, si 2-shi e 4-a: numrin çift ze-

mra ime nuk e pranon, nuk e pëlqen. Ai qëndron fort mbi këmbët e tij ose i ulur qetësisht e nuk ka asnjë dëshirë të lëvizë, është konservator, i kënaqur, pa shqetësim. Gjithë problemet i ka zgjidhur, gjithë dëshirat i ka bërë realitet, e është i qetë. Ndërsa numri tek është numri i zemrës sime. Ai nuk është i vendosur në një vend e i palëvizshëm. Kjo botë nuk i pëlqen, e do ta ndryshojë, ta kompletojë, ta shtyjë më tej. Qëndron mbi një këmbë ndërsa këmba tjetër qëndron në ajër e gatshme për t'u nisur; ku? Te numri çift që vjen pas, për.t'u ndalur një çast, të marrë frymë e të niset sërish.

Në zemrën rebele të rinisë, që do të shkatërrojë e bëjë thërrime çdo gjë të vjetër e do të ndërtojë një botë të re, kjo qetësi e ftohtë mermeri nuk kishte vend. Ky ishte një plak i kujdesshëm, që me kështillat e tij donte të pengonte vrullin e zemrës sime. I ktheva shpinën Panteonit e u zhyta në spektaklin e mrekullueshëm që shfaqej deri tej në det. Ishte mesditë, orë kryesore, pa hije, pa lojë drite, e rreptë, vertikale, e përsosur. Unë shikoja qytetin e bardhë që përvëlohej, detin e Shenjtë të Salaminës që shkëlqente e përreth malet e zhveshur, të lumtur, që ngroheshin në diell. I zhytur në këtë spektakël kisha harruar Panteonin.

Me kalimin e kohës, gjatë kthimeve të mia, nga ullishtat atike ose nga gjiri Saroni, harmonia e fshehtë, hiqte dalëngadalë e një nga një mbulesat e saj e zbulohej para shpirtit tim.

Kur ngjitesha në Akropol, më dukej se Panteoni kishte filluar të lëvizte lehtë e lehtë e merrte frymë si në një vallëzim të qetë.

Kjo gjendje zgjati muaj, ndofta edhe vite. Nuk më kujtohet dita kur plotësisht i bindur, unë u ndala përpara Panteonit e m'u mbush zemra. Çfarë trofeje ngrihej përpara meje, çfarë bashkëpunimi midis zemrës sime dhe shpirtit. Çfarë sublimim i frutshëm i përpjekjes njerëzore! Hapësira ishte thyer, nocionet i madh e i vogël ishin zhdukur. Brenda paralelogramit të ngushtë magjik që njeriu kishte vizatuar, pafundësia hynte lirshëm e shlodhej. Koha ishte mposhtur. Çasti plot bukuri e hijeshi ishte bërë I përjetshëm.

E lashë shikimin të endet mbi mermeret e nxehur nga dielli. U ngujova mbi ta e nuk doja të largohesha më. Shikimi im prekte, si me dorë dhe zbulonte sekretet e fshehura. Kurrë një vijë e lakuar nuk mund të krijonte një drejtëz aq të saktë. Pashë kolonat që dukeshin vertikale, të përkulura në mënyrë të paperceptueshme njëra

pas tjetrës: në majat e tyre për t'u mbështetur tek njëra-tjetra e të mbaheshin së toku me forcë e qëndresë, frontonet e shenjta që u jepnin siguri.

Ja cili ka qenë gëzimi im më i madh gjatë katër viteve që unë isha student në Athinë. Asnjë frymëmarrje femre nuk më ka turbulluar ajrin që thithja. Disa miq i kam dashur e me ta shpesh herë ngjitesha në male ndërsa kur vinte vera notonim së bashku në det, bisedonim për gjëra pa rëndësi, ndonjëherë organizonim festa e disa merrnin me vete edhe mikeshat e tyre. Qeshnim pa arsye, siç qeshin të rinjtë, hidhëroheshim pa arsye; ishim si mëzat që akoma nuk janë përdorur e që vuajnë sepse i shtyp forca e tyre.

Çfarë mundësish hapeshin përpara secilit prej nesh! I shihja në sy një nga një e përpiqesha se në ç'drejtim mund të shpenzoheshin forcat e tyre, cila do të ishte rruga e secilit. Njëri prej tyre, kur hapte gojën e donte të thoshte ndonjë mendim ose ndonjë marrëzi që i pëlqente, merrte zjarr menjëherë. Ishte gëzim i madh të dëgjoje sesi i radhiste mendimet në formë përfundimtare, si epigrame të goditur.

E dëgjoja dhe bëhesha xheloz sepse kur hapja gojën për të folur ndjehesha jo mirë. Fjalët më vinin me vështirësi. Në qoftë se sillja një argument për të mbështetur mendimin tim, papritur argumenti i dytë po aq i saktë vinte në shpirtin tim; më vinte turp të thosha gjë tjetër prapa asaj që kisha thënë dhe heshtja. Njeri, që fliste me kujdes të madh, nuk e hapte gojën veç në sallën e fakultetit ku profesori e ne të gjithë e dëgjonim me admirim heshtës, kur shpjegonte me pasion problemet e së drejtës. Një tjetër, organizator shumë i mirë, udhëhiqte masat. Ai merrej me politikë, organizonte mitingje, futej në burg, dilte, vazhdonte luftën; sigurisht, thoshin të gjithë, ai do të bëhet një ditë personalitet politik. Një tjetër, i zbehtë, me fjalë të ngrohta, vegjetarian, kishte dy sy të kaltër të shpëlarë, duar femre. Me mundim kishte themeluar një klub që kishte për emblemë një zambak të bardhë ndërsa për devizë: këmbët janë më të pastra se duart. E donte shumë hënën: "Është e vetmja femër që më pëlqen", - thoshte.

Një tjetër ishte si një zambak i paprekur, i zbehtë, melankolik, me sy të mëdhenj blu, duart me gishtërinj të gjatë; ai shkruante vargje. Nuk më kujtohen shumë nga ato vargje, por kur i pëshpëris ato që më kujtohen, sytë më mbulohen me to. Një natë, këtë djalë, e

gjetën të varur në një ulli përpara manastirit të Qesarianit.

Shumë të tjerë akoma, secili me shpirtin e tij, plot gonxhe të paçelura; kur do të çelin vallë, mendoja, kur do të japin fruta? O Zot, mos më lër të vdes përpara se ti shikoj ato! Nuk dua të vdes përpara se të shoh çfarë gonxhesh do të çelin në shpirtin tim dhe çfarë frutash do të japin. I shihja miqtë e mi, i shqetësuar, me një trishtim të pashprehur, sikur po ju thoshja mirupafshim. Trembesha se mos koha nuk do të ishte një erë e lehtë e se do të bënte që lëngu të ngjitej lart, por një erë e fortë që do të rrëzonte gjethet e shpirtrave.

Duke lënë Athinën, lija prapa meje dy kurora, të vetmet që unë i kam gjykuar të denja në jetën time. Të parën e mora në skermë; ajo ishte e rëndë e mbushur me gurë të çmuar ngjyrë blu e të bardhë, mbuluar me dafinat e famshme të luginës së Delfit. Ishte një iluzion, unë e dija dhe të gjithë e dinin, por pikërisht ky iluzion u jepte shkëlqim gjetheve të dafinës.

Tjetrën e kisha marrë në një konkurs të artit dramatik. Nuk e di pse m'u ndez gjaku një ditë e unë shkrova një dramë dashurie të zjarrtë, plot melankoli e pasion. E kisha titulluar "Dita lind". Besoja se kisha sjellë në botë një moral tjetër, dhe një liri më të madhe. Një dritë të re. Profesori që gjykonte konkursin, serioz, që mbante një jakë fallco, të lartë, i përkulur rrafsh mbi tavolinë gjykoi se nga të gjithë pjesët e paraqitura kjo ishte më e mira.

Por ai ishte i shqetësuar dhe stigmatizoi frazat e saj të guximshme dhe dashurinë e papërmbajtur. "Ne u japim poetëve kurorën me dafina" thotë ai, por jo për këtë shtatzani të turpshme." Unë gjendesha atje, në sallën e nderit të universitetit, akoma pa mustaqe, student i vogël, pa eksperiencë e dëgjoja. U skuqa deri te veshët, u çova, lashë kurorën me dafina mbi tavolinën e jurisë dhe dola.

Me mikun tim, që punonte në ministrinë e punëve të jashtme, kishim bërë projekte për të udhëtuar nëpër Evropë. - Merre me vete kurorën e skermës më thotë ai një ditë, atje lart në klimën veriore nuk do të gjejmë dafina. Atje ato do të na shërbejnë si ragu (lloj gjelle).

Vitet kalonin, unë e ruaja vazhdimisht kurorën të varur në mur. Kur ëndrra u bë realitet dhe ne shkuam në Gjermani unë e mora kurorën me vete. Për dy vjet ne e hëngrëm të gjithë.

KTHEHEM PËRSËRI NË KRETË

Gjatë verës së fundit të studimeve, u ktheva në Kretë. Nëna ishte e ulur në vendin e saj të zakonshëm, pranë dritares që shikonte nga oborri dhe bënte çorape; Ishte mbrëmje, motra ujiste vazot me borzilok e manxuranë; hardhia mbi pus ishte plot veshnik rrushi me kokrra të mëdha akoma të gjelbra.

Asgjë nuk kishte lëvizur në shtëpi; gjithçka ishte në vendin e mëparshëm: kanapeja, dollapi, llambat dhe rreth e rrotull nëpër mure heronjtë e vitit 1821, me mustaqet e mëdha, gjokset leshtorë dhe pistoletat ngjeshur në rripa. Shpirtra të ashpër, udhëhequr nga pasioni, që mund të bënin edhe mirë, edhe keq, sipas rrugës ku i çonte zemërimi i tyre.

Karaiskaqis i shkruante kapedanit Aturnaras: "Trimi i madh, vëlla kapedan Nikolla: e mora letrën tënde dhe lexova çka më shkruaje. Radhët e mia kanë cimbale, por kanë edhe trompeta. Unë me to luaj si të dua!" Cimbalet janë instrumenta të muzikës turke, trompetat janë greke. Nuk ishin njerëz të pastër, ishin njerëz të mëdhenj, dhe njerëzit e mëdhenj janë gjithmonë të rrezikshëm...

Mendohem shpesh: Çfarë misteri ka tek ata, si mundet një pleh i tillë të ushqejë e të besojë pemën blu të lirisë? Urrejtjet, tradhëtitë, mosmarrëveshjet, aktet e trimërisë, dashuria e zjarrtë për atdheun, vallëzimin e grave të Zalongos!

Të nesërmen në mëngjez, shkova të gjej dy miqtë e mi, anëtarë të Shoqatës. Kisha katër vjet pa i parë, gati nuk njiheshin; jeta kishte kaluar mbi ta dhe i kishte dërrmuar. Flisnin për Shoqatën dhe ja plasnin gazit. Njëri nga ata këndonte mirë, e ftonin në të gjitha festat, martesat dhe pagëzimet; hante, pinte dhe këndonte, e admironin për zërin e tij të këndshëm, i pëlqente vetja, kishte marrë të tatëpjetën. Duart kishin filluar t'i dridheshin për shkak të alkoolit. Tjetri kishte mësuar të luante në kitarë; luante pjesë të lehta, pasionante,

ose shoqëronte mikun e tij. I gjeta të dy pasi kishin ngrënë mirë e ishin dendur sa qenë kënaqur, hunda kishte filluar t'u skuqej. Kishin hyrë në punë të dy në një punishte sapuni, ku fitonin bukën, përfitonin ndonjë gjë nga jeta dhe kërkonin femra.

I shikoja, i dëgjoja, më zihej gryka e nuk flisja dot asnjë fjalë. A mundet që flaka të kthehet kaq shpejt në hi? Shpirti a mund të jetë kaq i ngjashëm e i afërt me mishin? Ata e dinin se cila tavernë kishte verën më të mirë, ku mund të hanin pitet më të lehta dhe çfarë paje kishte çdo vajzë.

U largova prej andej. Zemra m'u shtrëngua sikur kthehesha nga një varrim. Virtytet e vogla, mendoja, janë më të rrezikshme se veset e vogla. Në qoftë se ata nuk do të këndonin mirë e nuk do t'i binin kitarës, nuk do t'i ftonte njeri nëpër ahengje, ata nuk do të shpërdoronin kohën kështu, nuk do të deheshin. Duke kënduar mirë dhe duke i rënë kitarës ata morën tatëpjetën.

Të nesërmen i pashë nga larg, ndërrova rrugën. Më vinte turp të shihja që shumë miqësi e dëshira të miat ishin fshirë e nuk ekzistonin më, po ashtu edhe shumë projekte të mëdha për të shpëtuar botën! Kishte fryrë era, e, gjithë pemëve, në lule të rinisë, u kishte rrëzuar gjethet. Kjo rini pra nuk do të jepte asnjë frut? Ja pra sesi nisen skuadrat për të bredhur nëpër oqeane dhe mbyten në vaskën e një shtëpie.

Endesha rrugicave i vetëm, rrija në port, për të ndjerë përsëri erën aq të dashur të qitrove dhe të çiçibanozëve të pjekur, duke mbajtur gjithmonë në dorë një libër, herë Danten, herë Homerin; lexoja vargjet e pavdekshme dhe kuptoja se njeriu mund të bëhet i pavdekshëm; dhe se sipërfaqja e përhimtë e botës, shtëpitë, njerëzit, gëzimet, padrejtësitë, kaosi që ne i themi jetë, mund të bëhet harmoni.

Një ditë kalova përpara shtëpisë së irlandezes; ajo kishte ikur. Kalova përsëri një ditë tjetër. Sa herë kaloja andej provoja një hidhërim e një pendesë të habitshme, për atë që kisha bërë dhe që nuk kisha bërë. Më dukej sikur kisha bërë një krim dhe kthehesha për të parë viktimën.

Më ishte prishur gjumi dhe një natë, duke kaluar nga lagjja turke, dëgjova një zë gruaje që këndonte me një pasion të thekshëm një

aman-aman, këngë orientale. Zëri i vrazhdë, i ngjirur, shumë i rëndë, dilte nga brendësia e gruas dhe mbushte natën me ankth e dëshpërim. Nuk mund të ecja më. Ndalova. Kokën e mbështeta tek muri e dëgjoja edhe pse frynte erë. Shpirti po më mbytej dhe nuk mund të rrinte më mbyllur brenda kafazit prej argjile, varej tek balli e po merrte vrull për të ikur. Jo, nuk ishte dashuria, që çante gjoksin e asaj gruaje, nuk ishte përqafimi plot mister i një burri e një gruaje, nuk ishte gëzimi, shpresa, djali. Ajo ishte një klithmë, një urdhër: të thyente pengesat e burgut tonë, moralin, turpin, shpresën, të na flakte ne e të bëhej një me dashurinë e tmerrshme që përgjon në errësirë, që na magjeps e që ne i themi Zot. Dashuria, vdekja, Zoti, atë natë, duke dëgjuar këngën e turkeshës që të pikëllonte zemën, m'u dukën se ishin një. Sa më shumë shkojnë vitet, aq më fort e ndjej këtë treshe të frikshme që përgjon në kaos, në kaos dhe në zemrën tonë. Ajo nuk ishte një treshe e vetme. Ajo ishte, siç e quante një besimtar bizantin: Një botë e armatosur.

Kënga u vra; unë u shkëputa nga muri. Bota u zhyt përsëri në kaos. Shtëpitë u ngurtësuan, rrugët u shtruan përsëri përpara meje, tani unë mund të ecja. Gjithë natën e kalova duke bredhur, shpirti nuk fliste, asnjë mendim nuk më nxirrte dot nga gjendja dhe të më hiqte turbullimin. Lashë trupin të më udhëhiqte. Shëtisja mbi bedenat veneciane prej nga sundoja detin. Qielli shkëlqente nga zjarret e ndezur. Konstelacionet lëviznin, rrëshqisnin drejt perëndimit e zhdukeshin. Së bashku me to zhdukej edhe shpirti im. Nga malet frynte një erë e freskët, shumë e freskët, hynte nga të çarat e dritareve brenda shtëpive dhe freskonte njerëzit, që flinin të djersitur.

Unë dëgjoja, në qetësinë e thellë, frymëmarrjen e Megalo Kastros.

Atë natë, kalova tek shtëpia e irlandezes, padashur, pa e ditur, duke ecur për orë të tëra, rrotullohesha dhe rrathët vinin duke u ngushtuar e unë afrohesha në qendër pranë shtëpisë së saj. Dukej se një thirrje perandorake kishte ngelur brenda shtëpisë së saj, thirrje që më grishte. Unë nuk mund t'i rezistoja.

Afër agimit kur iu afrova përsëri portave dhe kanatave të mbyllura, një dritë çau shpirtin tim dhe e ndriçoi: ajo nuk ishte thirrje. Ishte kënga e gruas, kënga e çjerrë dhe e zymtë, që unë dëgjova atë

natë duke kaluar nga lagjja turke. Tani, kënga tek unë ishte shndërruar, ishe bërë ulërima e një bishe të lënë mënjanë nga shoqëria, që e kishin lënë vetëm.

Kënga, ulërima e bishës dhe klithma e pashpresë e irlandezes ishin bërë lak rreth qafës e po më merrnin frymën. M'u kujtua një fjalë e rëndë që më kishte thënë një mysliman plak: "Në qoftë se nje femër të thërret të shkosh të flesh me të dhe ti nuk shkon, ti ke humbur, o i mjerë; këtë, Zoti nuk do ta falë e ti do të shkosh thellë në ferr, me Judën." U tremba; më mbuluan djersë të ftohta dhe shpejt, duke m'u marrë këmbët, si një bishë e plagosur, u nisa duke vrapuar drejtë shtëpisë atërore.

Shkallët i ngjita duke ecur në majë të gishtave që të mos bëja zhurmë e të më dëgjonte babai, e u shtriva pa u ndjerë në krevat. Dridhesha, herë digjesha zjarr e herë fërgëlloja; duhej të kisha ethe dhe gjumi më mbështolli si një merimangë helmuese. Të nesërmen, kur u zgjova, rreth mesditës, dridhesha akoma.

Ky ankth zgjati tri ditë; nuk qe ankth, qe një nyje e tmerrshme në zemrën time dhe gojën e kisha të hidhur, plot vrer.

Nga dritarja e dhomës shikoja mimozën në mes të oborrit, pjergullën plot rrush, nënën që vente e vinte, ashtu qetë-qetë duke u marrë me punët e bekuara të shtëpisë dhe motrën që qëndiste; bota ngjitej nga zemra në grykë dhe më zinte frymën. Sikur dikush më kishte ndjekur nga Parajsa, ose më mirë jo, sikur unë kisha kapërcyer nga muret e parajsës: kisha ikur, e tani më vinte keq. Endesha më kot, pa ngushëllim, përpara portës së mbyllur.

Ditën e katërt, pa patur asgjë të qartë në shpirtin tim, shpejt në mëngjes, u çova nga krevati e pa ditur ç'bëja, mora penën dhe nisa të shkruaj.

Ky ishte një çast vendimtar në jetën time; ankthi që më kishte pushtuar, ndoshta zgjodhi mënyrën për të hapur portën e të largohej. Kush e di, ndofta unë kisha dashur të kuptoja pa e formuluar qartë në se ky ankth merrte trajtën e një trupi, apo fjala atij i jepte trajtën e një trupi. Do të shikoja fytyrën e tij dhe duke e parë nuk do ta trembja më. Unë kisha bërë një mëkat të madh; në qoftë se do ta pranoja atë, unë do të lehtësohesha.

Fillova të sistemoj fjalët, të sjell ndërmend jetët e shenjtorëve,

këngët e romanet që kisha lexuar, të vjedh në mënyrë të pavullnetshme duke qëmtuar aty këtu e të shkruaj... Që në fjalët e para që hodha në letër, u befasova. Nuk e kisha gjithçka në shpirt, nuk doja të shkruaja gjëra të tilla, përse t'i shkruaja?

Më dukej se nuk isha shkëputur akoma nga takimi i këndshëm - e megjithatë unë isha i sigurtë se isha shkëputur - Një legjendë plot pasion e imagjinatë filloi të kristalizohej rreth irlandezes. Kurrë nuk i kisha thënë asaj fjalë aq të dashura, kurrë nuk kisha provuar aq gëzim duke e afruar, sa tregoja në letër. Gënjeshtra, asgjë veç gënjeshtrave, e megjithatë duke i hedhur atëherë në letër, kuptoja, me habi, se me të kisha shijuar gëzime të mëdha. A ishin pra gjithë këto gënjeshtra, të vërteta? Pse kur unë i jetoja, nuk i kuptoja? Pse tani që i shkruaj i kuptoj për herë të parë?

Shkruaja dhe mbushesha me krenari: unë isha një Zot, bëja atë që doja, transformoja realitetin, e rikrijoja ashtu si e doja, ashtu si duhej të ishte, ndërthurja dhe ngatërroja të vërtetën me gënjeshtrën, nuk kishte më as të vërtetë e as gënjeshtra. Gjithë kjo ishte një brum i butë që e përpunoja vetë, i jepja formë sipas shtysës së dëshirës sime, lirisht, pa i kërkuar leje askujt.

Duhet të ekzistojë një pasiguri më e sigurt se siguria; por njëra nga të dyja ndodhet një shkallë më lartë se ai, krijimi i njeriut, i vetmi në tokë, që quhet e vërteta.

Irlandezja që s'paraqiste interes fare, pak gungaçe, u bë në këtë vepër, njeri tjetër; dhe unë, gjeli pa pupla, u mbulova me pendë që farfurinin por që s'ishin të miat. Pas disa ditësh unë e mbarova. Mbylla dorëshkrimin, shkrova sipër me gërma bizantine të kuqe, *gjarpri dhe zambaku*, u ngrita, shkova tek dritarja dhe mora frymë thellë. Irlandezja nuk më torturonte më, ajo më kishte lënë, ishte shtrirë mbi letër dhe nuk mund të shqitej prej andej, isha çliruar.

Qielli ishte mbuluar me re, moti i vranët, binte shi; gjethet e mëdha të hardhisë gezullonin, kokrrat e rrushit ndrinin, merrja frymë thellë dhe ndjeja aromën e tokës së lagur. Ajo aromë më kujtonte gjithmonë aromën e varrit të porsahapur. Por atë ditë era e vdekjes më pati shkalur, shpirti m'u balsamos. Erdhi një harabel, i lagur i tërë nga shiu, që kërkonte të strehohej mbi parvazin e dritares, ndërsa mbi kokën time në çati, ujërat, si fluturime pëllumbash, çukisnin e

cicëronin.

Dorëshkrimin e mbaja akoma shtrënguar në dorë, si një insekt të gjallë, që nuk doja të më ikte, ah sikur të mbaja në dorë zogun e lagur... dukej se isha pajtuar me irlandezen: hiri ishte bërë mollë dhe unë e mbaja në dorë.

Zbrita në oborr; veja e vija ndërmjet vazove me lule, provoja gëzimin që provon pema e mbuluar me pluhur dhe e djegur për ujë, kur qielli ka mëshirë për të e nis të bjerë shi. Shiu më jepte gjithmonë një gëzim të pashpjegueshëm, dhe në qoftë se nuk do të kisha turp, do të thosha erotik. Më dukej se unë isha toka, që kisha etje, se një element femëror zgjohej tek unë, një femër e fshehur në thellësi të qenies sime, që e shikonte qiellin si një burrë. Isha lagur, plot gëzim, zemra më qe lehtësuar. Irlandezja më shfaqej, vetëm ashtu si e kisha rikrijuar e fiksuar me fjalë, e tillë siç ishte, shtrirë mbi letër. Nuk ishte e vërteta, veç ajo e vërtetë, që për aq kohë kishte grumbulluar ankthin në zemrën time: e vërteta, ishte krijesa e porsalindur në imagjinatën time. Me këtë imagjinatë unë kisha mohuar realitetin, isha lehtësuar.

Kjo luftë, ndërmjet imagjinatës dhe realitetit, ndërmjet Zotit krijues dhe njeriut krijues, pushtoi për pak çaste zemrën time. Ja rruga ime, thërrisja në oborr, tek ecja i lagur, ja detyra ime. Çdo njeri ka brenda vetes të kundërtën që lufton me të.

Më pëlqen, sikur edhe të humbas, të luftoj kundër Zotit. Ai mori baltën dhe krijoi botën, unë mora fjalët. Ai bëri njerëzit, kështu siç i shohim sot të zvarriten nëpër tokë; unë do të krijoj, me imagjinatë e me erë, nga materiali me të cilin bëhen ëndrrat, të tjerë njerëz, që do të kenë më shumë shpirt, që do t'ju rezistojnë kohëve, e ndërsa njerëzit e Zotit do të vdesin të mitë do të jetojnë.

Më vjen turp të shfaq kaq mendjemadhësi, që është e denjë vetëm për Luçiferrin; por atëherë isha i ri, dhe të jesh i ri do të thotë të tentosh të shkatërrosh botën e të kesh guximin të duash të ndërtosh një botë të re që të jetë më e mirë.

Zemra po më pëlciste, disa shqetësime po mënjanoheshin e të tjera po ngrinin krye, më të ashpra; rruga që shkëlqente para meje,

ishte më e rrezikshme; si u shfaq ajo aq papritur, edhe pse unë nuk kisha ëndërruar ndonjëherë për të? Cili pra kishte hapur portën tek unë dhe më kishte bërë shenjë për të më thënë se ishte ajo rruga e shpëtimit?

Vuajtja, dashuria e munguar, apo ishin shenjtorët vetë ata që më kishin hapur atë portë, jetën e të cilëve e kisha lexuar kur isha fëmijë? Apo Kreta që duke e parë se unë nuk e ndihmoja dot duke luftuar, më kishte dhënë të tjera armë në duar?

Për të ndryshuar drejtimin e ideve të mia, të nesërmen që ishte e diel, kur binin këmbanat dhe kretasit shkonin në meshën e shën Minait, unë u nisa për një pelegrinazh tjetër, për të përshëndetur Kretën e shenjtë, e cila, në ato vite sapo ishte shkëputur nga tokat antike të Knosos-it.

Misteri i Kretës është i thellë. Cilido që vë këmbën në atë ishull ndjen një forcë misterioze, të ngrohtë, plot mirësi, që i shpërndahet në vena dhe shpirti i tij rritet. Por ky mister bëhet akoma më i pasur dhe më i thellë që ditën kur ai zbulon, deri atëherë mbuluar nën tokë, qytetërimin, e larmë e të ndryshëm, plot fisnikëri e gëzim rinor.

Dola nga fshati dhe mora rrugën e këndshme që shkon drejt qimitiros së re. Dëgjova klithma dhe të qara dhe nxitova këmbët. Kishte vdekur një tregtar i ushqyer mirë nga fqinjët tanë, një nga personazhet më të fuqishëm të Megalo Kastros dhe do ta varrosnin në qimitiron e ndërtuar rishtas. Ishte akoma i ri dhe kur miqtë po e ngrinin, gruaja e tij ishte kapur Pas arkivolit dhe nuk donte ta lintë të ikte,. Në atë kohë po kaloja atje dhe ktheva kokën për të mos e parë të vdekurin. Pas asaj dite kur pashë të nxirrnin nga dheu eshtrat e fqinjës sonë Anika, duhet të kem qenë gjashtë vjeç atëherë, unë nuk mund të shikoja dot më të vdekur; më kishte pushtuar tmerri, më shfaqej gjithmonë fqinja pa flokë, pa sy, pa buzë, që ndalonte për të më përqafuar e për të më ulur përsëri mbi gjunjë. E di, sigurisht, që kjo nuk është e vërtetë, por e di gjithashtu se ekziston diçka më e vërtetë se e vërteta dhe për këtë arsye unë kam frikë dhe nxitoj këmbët sa herë shikoj ndonjë të vdekur.

Nga e djathta dhe nga e majta ime ishte plot me ullinj e me rrush që akoma nuk e kishin vjelë dhe veshnikët të rëndë mbështeteshin mbi tokë. Ngado ndihej aroma e gjetheve të fiqve. Një plakë

trupvogël që po kalonte aty, u ndal, hoqi nga shporta që mbante në dorë gjethet e fikut që e mbulonin, zgjodhi disa kokrra e m'i dha.

- Më njeh mua gjyshe? - i thashë.

Më pa e habitur: - Jo bir, mos është e nevojshme të të njoh që të të jap ndonjë gjë? Ti je një qënie njerëzore. Unë po ashtu; kjo mjafton besoj, apo jo?

Qeshi me një të qeshur prej vajze të re dhe u nis ashtu çalë-çalë drejt Megalo Kastros.

Të dy fiqtë pikonin mjaltë; Kurrë nuk kisha ngrënë më të shijshëm. Hëngra fiqtë dhe fjalët e plakës më freskonin: ti je një qënie njerëzore, unë gjithashtu; kjo mjafton!

KNOSOS, ABATI MYNIER

Pranë hijes sime u formua një hije tjetër, u ktheva andej nga u shfaq, ishte një prift katolik. Ai më pa, buzëqeshi: - Abati Mynier, më tha, dhe më zgjati dorën; dëshironi të më shoqëroni? Unë nuk di mirë greqisht, vetëm greqishten e vjetër: "Këndo, hyjneshë, mërinë e Akilit, djalit të Peleut..."

-"... Mërinë e kobshme që u dha grekëve vuajtje të panumërta" vazhdova unë.

Qeshëm të dy. Filluam të ecnim duke recituar vargjet e pavdekshme. Më vonë mësova se abati që qeshte dhe recitonte vargje, ndërsa një tufë flokësh thinjoshë i tundej mbi ballë, ishte i famshëm për shenjtërinë dhe inteligjencën e tij. Në Paris ai kishte çuar në rrugën e Zotit shumë ateistë. Lëviste shumë nëpër botë.

Fliste dhe bënte shaka me zonja të mëdha, shpirti i lëshonte xixa, por prapa asaj sipërfaqeje të lëvizshme e gazmore, ngrihej si një shkëmb i palëvizshëm e i pathyeshëm, Krishti.

Roja, vrapoi për të na pritur dhe për të na shpjeguar. Ishte një kretas i thjeshtë, me pantallona të gjera dhe një shkop të trashë, me pamje gazmore: quhej David. Rojtar e udhëheqës në muzeumin e Knososit prej shumë vitesh, ai kishte mësuar shumë gjëra dhe fliste për pallatin si të ishte në shtëpinë e tij; u soll me ne si zot vendi.

Ecte në krye, shtrinte bastunin e na tregonte;

- Ja oborri i madh mbretëror, 60 metra i gjatë, po aq i gjerë, ja qilari me qypat e mëdhenj të zbukuruar, atje brenda, mbreti mbante ushqimet për të ushqyer njerëzit e tij. Ne kemi gjetur në hambaret depozita me vaj e me verë, bërthama ullinjsh, bathë, bizele, grurë, elb, thjerrëza, të gjitha të karbonizuara nga zjarret.

U ngjitëm në katin e sipërm, kudo kolona të ulta e të forta, të lyera me të zezë e ngjyrë purpuri; nëpër korridore, të pikturuara mbi mure, lule, dema, mburoja. U ngjitëm mbi tarracat e larta dhe pamë

të shpaloset rreth nesh peizazhi i qetë, i gëzuar, ndërsa në sfondin e qiellit, kokën e Zeusit shtrirë në shpinë, malin Ida. Pallati, gjysmë i shkatërruar, e gjysmë i ringritur, shkëlqente pas mijëra vjetësh dhe kënaqej sërish nga dielli mashkullor i Kretës. Në atë pallat nuk shihet ekuilibër, arkitektura gjeometrike greke; atje dominon fantazia, gëzimi, loja e lirë e forcës krijuese të njeriut. Ky pallat rritej e zgjerohej gjatë viteve, si një trup i gjallë, si një pemë. Ai nuk u bë njëherë e përgjithmonë me një plan të paramenduar e të pandryshueshëm, ai plotësohej duke kënaqur dhe duke u përputhur me nevojat gjithmonë në rritje në rrjedhën e viteve.

Njeriu nuk ishte udhëhequr nga një logjikë e pathyeshme dhe e pagabueshme; shpirti ishte i nevojshëm por si shërbëtor, jo si mjeshtër; mjeshtri ishte tjetër. Si e quanin?

U ktheva nga abati dhe ai e kuptoi refleksionin tim, i kërkova mendim.

- Cili është mjeshtri? M'u përgjigj duke buzëqeshur. Çfarë pret nga një prift në qoftë se ai nuk të thotë Zoti?

Mjeshtri është Zoti i kretasve, ai ka udhëhequr dorën dhe shpirtin e tyre dhe i bënte krijues. Ai ishte mjeshtri punëtor. Ai, zoti i kretasve, ishte i shkathët e i lëvizshëm si deti që rrethon ishullin. Ja përse peizazhi, pallati, pikturat dhe deti kanë aq harmoni të sigurt, aq naivitet.

Zbritnim shkallët e gurta, shikonim pa folur pikturat mbi mure, duart, zambakët, peshqit midis detit blu, peshqit fluturues që hapnin krahët e hidheshin mbi ujë, sikur iu zihej fryma në elementin e tyre mëmësor, dhe kërkonin të merrnin frymë lirisht. Ndaluam në teatër; udhërrëfyesi kishte marrë zjarr; fytyra i rrezatonte plot krenari: - Këtu, thotë, zhvilloheshin garat me dema, por ato nuk zhvilloheshin si garat e barbarëve që bëhen, siç thonë, në Spanjë, ku i vrasin demat, ndërsa kuajve iu çajnë barkun; Këtu garat me dema ishin një lojë ku nuk derdhej gjak. Vetëm luhej. Toreadori shtrëngonte demin nga brirët, kafsha nxehej; tundte me forcë kokën duke i dhënë lartë, e kështu toreadori merrte vrull e me shkathtësi hidhej mbi shpinën e demit; bënte një rrotullim dhe binte në këmbë prapa demit; atje shkonte një vajzë dhe e merrte në krahë.

I shpjegoja abatit, atë që thoshte udhërrëfyesi; ai kishte fiksuar

shikimin mbi shkallët e gurta dhe përpiqej të përfytyronte lojën hyjnore.

Më kapi për krahu, dhe ashtu ecëm për ca kohë. - Është shumë e vështirë, pëshpëriti ai, të luash me Zotin dhe të mos përgjakesh.

- Ndaluam përpara një kolone katërkëndëshe prej gipsi të shndritshëm, ku qe gdhendur simboli i shenjtë, sëpata me dy presa; abati bashkoi duart, përkuli njërin gju për një çast dhe buzët mërmërisnin sikur lutej.

U detyrova të ndaloj: - po luteni? - e pyeta.

- Sigurisht, po lutem, miku im i ri, m'u përgjigj. Çdo popull e çdo epokë i ka dhënë Zotit një pamje, por prapa gjithë pamjeve, në të gjitha epokat dhe në të gjithë popujt, gjendet gjithmonë i njëjti Zot. Heshti dhe pas një çasti: - Ne kemi kryqin për emblemë të shenjtë, stërgjyshërit e tu, më të largëtit kishin sëpatën me dy presa; por prapa kryqit dhe sëpatës, unë shoh dhe admiroj, Pasi heq simbolet e përkoshme, të njëjtin Zot.

Atëherë isha shumë i ri dhe atë ditë nuk e kuptova. Vite më vonë, shpirti mundi t'ju jepte kuptim dhe vlerë atyre fjalëve; prapa gjithë simboleve fetare, unë fillova të dalloj fytyrën e përjetshme dhe të pandryshueshme të Zotit. Më vonë akoma, kur shpirti im ishte plotësisht i hapur, e zemra plot mirësi unë fillova të dalloj prapa fytyrës së Zotit, errësirat e tmerrshme, shkretëtirat, kaosin. Pa dashur, atë ditë në Knosos, ai abat i shenjtë më hapi një rrugë. Unë e vazhdova atë por nuk ndalova atje ku do të donte ai të ndaloja. Më pushtoi një kuriozitet i frymëzuar nga Luciferri dhe unë eca më përpara e zbulova greminën.

U ulëm ndërmjet dy kolonave; qielli ishte ndezur dhe ndrinte si të ishte prej çeliku. Rreth pallatit, nëpër ullishta, gjinkallat të shurdhonin. Udhërrëfyesi u mbështet pas kolonës, nxori nga rripi një qese me duhan dhe filloi të dredhë një cigare. Askush nuk fliste; e kuptonim se ai çast ishte i shenjtë, se ai vend ishte i shenjtë, dhe se vetëm qetësia u përshtatej. Mbi ne fluturuan dy pëllumba dhe u ulën mbi një kolonë. Kretasit i adhuronin zogjtë e shenjtë të Hyjneshës së Madhe. Ndonjëherë i shikonim ulur mbi kolona, ndonjëherë Hyjnesha i mbante ndërmjet gjinjve të saj plot me qumësht.

- Pëllumbat... - thashë me zë të ulët, se mos më dëgjonin zërin,

trembeshin dhe iknin nga kolonat. Abati vuri gishtin para buzëve:

- Hesht, - më tha.

Shpirti po më çahej nga pyetjet, por nuk fola. Afresket e mrekullueshme më kalonin sërish para syve - sy të mëdhenj si bajame, kaskada gërshetash të zeza, gra të pamshme, gjokszbuluar, me buzë mishtake e plot epsh, zogj, fazanë, thëllëza, majmunë vjollcë, princesha të vogla me pendë palloi mbi kapele, dema të egër të shenjtë, priftërinj të rinj që mbanin gjarprinj të shenjtë rrotulluar rreth krahëve të tyre, djem të rij të veshur me rroba të kaltra në kopshtet gjithë lule. Një gëzim, një forcë, një pasuri e madhe, një botë plot mister, një Atlantidë, e nxjerrë nga fundi i tokës kretase, duket sikur na sheh me sytë e saj të mëdhenj të zinj, por buzët e saj janë akoma të dyllosura.

Çfarë bote do të zbulohet, mendoja, kur buzët e saj të hapen e ajo të flasë? Çfarë projektesh kanë bërë stërgjyshërit e saj, mbi këtë tokë që ne shkelim?

Kreta ka qenë ura e parë ndërmjet Evropës, Azisë dhe Afrikës. Kreta ka qenë e para që ndriçonte në gjithë Evropën e errët të asaj epoke. Këtu shpirti i Greqisë ka plotësuar misionin që fati i kishte caktuar; të çonte hyjninë në nivelin e njeriut. Statujat e mëdha të palëvizshnme të egjiptianëve dhe të sirianëve janë bërë këtu, në Kretë, të vogla, të hirëshme; trupi filloi të lëvizë, buzët qeshën, fytyra dhe trupi i Zotit u bënë fytyra dhe shtati i njeriut.

Një popull i ri filloi të jetojë e të luajë me tokat e Kretës, origjinale, të ndryshme nga Greqia, e që vinte pas saj, e shkathët, plot hire dhe cilësi orientale...

Shikoja kodrinat e ulta përreth, të buta, ullinjtë me gjethe të rralla, një qitro të hollë që përkulej lehtësisht midis shkëmbënjve, dëgjoja tingëllimën e lehtë dhe harmonike të një kopeje dhish që nuk dukej, thithja ajrin plot aromë që duke kaluar mbi kodrinat arrinte në det dhe më dukej se fshehtësia antike e Kretasve, hynte më thellë tek unë dhe vazhdonte të ndriçohej. Këto nuk janë probleme jashtëtokësore, por probleme të përditshme, vazhdimisht të përsëritura, plot detaje të zjarrtë, probleme të jetës njerëzore mbi tokë.

- Përse po mendon? - më pyeti abati.

- Për Kretën...

- Edhe unë gjithashtu, për Kretën po mendoj, më thotë shoqëruesi im, për Kretën dhe për shpirtin tim... Në qoftë se do të rilindja, doja ta shihja dritën këtu, mbi këtë tokë. Këtu ka një magjepsje të padukshme.

- Ikim prej këtej.

DERVISHËT

U çuam, hodhëm për të fundit herë një shikim të gjatë mbi spektaklin e mrekullueshëm; unë doja t'i shikoja përsëri, por abati pshetiu: - Kurrë më... pëshpëriti. Shtriu dorën në drejtim të kolonave, shesheve, afreskeve. - Lamtumirë, - tha, - një françeskan erdhi për t'ju parë, me sa duket ju admiroi. Lamtumirë!

Morëm rrugën për t'u kthyer; ishte një i nxehtë përvëlues dhe shumë pluhur, abati ishte i lodhur. Ndaluam në një manastir të vogël ku jetonin e vallëzonin çdo të premte dervishët; porta e hapur ishte në ngjyrë të gjelbër, ndërsa në parvaz gjendej një dorë bronzi me ngjyrë të çelët, emblema e shenjtë e Muhamedit. Hymë në oborr; ai ishte shtruar me kalldrëm me gurë të mëdhenj, të bardhë që shkëlqenin nga pastërtia, rreth e rrotull gjendeshin vazo me mushlizë ndërsa në mes një dafinë e madhe ngarkuar me fruta. Ndaluam nën hijen e saj për të marrë frymë; nga një kthinë e manastirit një dervish na pa e u afrua; vendosi dorën në gjoks, mbi buzët, në ballë, për të na përshëndetur. Kishte veshur një dolloma jeshile si zmerald dhe një qylaf të lartë të leshtë. Kishte një mjekër të zezë me majë, ndërsa në vesh i varej një vëth argjendi. Përplasi pëllëmbët dhe menjëherë erdhi një djalosh i shëndetshëm, zbathur. Ai solli disa stola e ne u ulëm. Dervishi fliste për lulet që shihnim përreth, për detin që vezullonte, ndërmjet gjetheve të dafinës. Pastaj nisi të flasë për vallëzimin. - Ai që nuk mund të vallëzojë, tha, nuk mund të lutet. Ëngjëjt kanë gojë, por nuk kanë fjalë; ata flasin me Zotin duke kërcyer.

- Si e quajnë Zotin tuaj, plakush? - pyeti abati.

- Ai nuk ka emër, u përgjigj dervishi. Emrat janë shumë të ngushtë për Zotin. Emri është një burg, Zoti është i lirë.

- Po kur ju doni ta thërrisni, insistoi abati, kur ai ju duhet, me çfarë emri e thërrisni?

Dervishi uli kokën, po mendohej; më në fund i liroi dhëmbët:

- Ah! u përgjigj; patjetër Allah, ah! - kështu do ta thërres.

Abati u turbullua. - Ai ka të drejtë - pëshpëriti.

Dervishi i vogël erdhi përsëri me një tabaka: kafe, ujë të ftohtë dhe dy veshë të mëdhenj rrushi. Sipër nesh, mbi çati dy pëllumba, - mos ishin ata të Knosos-it? Luanin lojën e dashurisë dhe gugisnin. Heshtën për një çast dhe jeta e mbyllur e murgut u mbush me dashurinë e papritur.

U ktheva nga abati; ai shihte pëllumbat, e mbi ta qiellin dhe sytë iu mbushën me lot.

Ai e kuptoi që po e shikoja dhe buzëqeshi.

- Bota është e bukur - tha. - Është e bukur në vendet me diell. Atje ku ka një qiell blu, pëllumba dhe rrush. Dhe një dafinë sipër jush.

Hante rrushin, i lumtur, kokrra kokrra. Dukej se atij i pëlqente që ajo orë të mos mbaronte kurrë.

- Në qoftë se do të isha i sigurt, se do të shkoja në parajsë, do t'i lutesha Zotit të më linte të shkoja nga rruga më e gjatë.

Ishim aq të lumtur në kopshtin e atij manastiri mysliman sa zemra nuk na bënte të iknim.

Dervishë të tjerë u dukën te portat e kamareve, rreth oborrit; më të rinjtë ishin të zbehtë, me sy të zjarrtë, sikur ata ndiqnin Zotin të dëshpëruar. Të vjetrit që kishin dashur ta gjenin, kishin ngjyrë trëndafili dhe sytë plot dritë. U grumbulluan rreth nesh, disa hoqën tespiet nga rripat e lëkurës, i shkoqnin qetësisht, duke shikuar me kuriozitet priftin kristian; të tjerët nxorrën cigarishtet e gjata, mbyllën sytë përgjysmë dhe filluan të pinin duhan, të lumtur, të qetë.

Sa të lumtur janë, pëshpëriti abati dhe këtu gjithashtu prapa atyre fytyrave, rrezaton fytyra e Zotit! Ai më preku supin si një gjest lutjeje:

- Të lutem, pyeti ata, - dervishët janë urdhër fetar, cili është rregulli i tyre?

Më i vjetri vendosi cigarishten mbi gju dhe u përgjigj:

- Varfëria, varfëria, të mos kesh asgjë, kjo na rëndon më shumë, të ecim drejt Zotit nëpër një shteg të lulëzuar; të qeshurit, kërcimi, gëzimi, janë tre kryeëngjëjt që na marrin përdore e na udhëheqin.

- Kërkoju atyre, - më thotë atëherë abati. - Si përgatiten ata për t'u paraqitur para Zotit, duke agjëruar?

- Jo, jo, përgjigjet një dervish i ri duke qeshur; ne hamë e pimë dhe falënderojmë Zotin që i dha njeriut të pirët dhe të ngrënët.

- Atëherë si? - këmbënguli abati.

- Duke kërcyer, - përgjigjet dervishi i vjetër që kishte mjekër të gjatë e të bardhë.

- Duke kërcyer? - thotë abati, - përse?

- Sepse kërcimi, përgjigjet dervishi i vjetër, - më vdes mua; dhe kur unë kam vdekur nuk ka pengesë për të shkuar e për t'u bashkuar me Zotin.

Syri i abatit filloi të ndrijë: - Urdhëri i shën Fransuait! - thirri. Ai i shtrëngoi dorën dervishit të vjetër.

Kështu kalon shën Fransuai mbi tokë, duke kërcyer, ngjitet në qiell. Ç'jemi ne të tjerët? - thoshte, veç marioneta të Zotit? Ne kemi lindur për të bashkuar zemrat e njerëzve.

- E shikon, mik i ri, edhe një herë po ta them, se kudo, absolutisht kudo, gjendet i njëjti Zot.

Unë kundërshtova: - Por përse atëherë, shumë misionarë shkojnë në të katër anët e tokës dhe duan të bindin indianët të braktisin fytyrën e Zotit të tyre dhe t'i japin një fytyrë të huaj, tonën?

Abati u ngrit: - Është e vështirë të përgjigjesh, më thotë, në qoftë se Zoti të ndihmon të vish për studime në Paris, eja tek unë. Një buzëqeshje hileqare u duk mbi buzët e tij: - Me kohë ndofta unë do ta gjej përgjigjen.

Ju kërkuam leje dervishëve për t'u larguar e ata na shoqëruan me nderime e buzëqeshje deri te porta e jashtme. Te pragu abati më tha:

- Thuaju atyre, të lutem, se ne adhurojmë të njëjtin Zot e unë jam një dervish me raso të zezë.

NJË VIT UDHËTIM: GREQIA

Babai më kishte premtuar një vit udhëtim, ku të dëshiroja, në qoftë se diplomën e merrja me vlerësimin shumë mirë. Për këtë çmim ia vlente mundimi, e unë iu futa studimit me të gjitha forcat. Një nga miqtë e mi kretar, që ishte djallëzisht i zgjuar, donte t'i kalonte provimet me mua. Dita vendimtare erdhi, ne u nisëm për në Universitet. Të dy ishim të shqetësuar, unë i dija të gjitha, por edhe i kisha harruar të gjitha, kujtesa m'u frenua dhe kisha shumë frikë.

- Ty nuk të kujtohet asgjë? - më tha miku im.

- Hiç.

- As mua jo. Shkojmë në rostiçeri, të pijmë, kjo do të na sjellë në humor, do të na zbërthehet gjuha, do ta shikosh.

Pimë e pimë e erdhëm në humor.

- Si të duket bota? - më pyeti miku.

- Turbull.

- Edhe mua. Mund të ecësh?

U çova e bëra disa hapa. - Mundem, - u përgjigja.

- Atëherë, shkojmë atje; dridhu E drejtë Romane! U nisëm, në fillim kapur krah për krah, pastaj morëm guxim, secili eci vetë.

- Përshëndetje, Bakus, trimi im, - thirra, - vëri një stërkëmbësh Justinianit dhe shtrije në tokë së bashku me *novelat* e tij.

- Përse thërret për ndihmë Bakusin? - më thotë miku im, ne nuk kemi pirë verë, kemi pirë birrë.

- Je i sigurt?

- Ti nuk më beson? Shkojmë e pyesim. U kthyem. - Birrë, birrë na u përgjigj i zoti i tavernës dhe ia plasi gazit. Ku po shkoni, djema?

- Të japim provim, të drejtën.

- Do të vij me ju, për të qeshur pak. Hoqi futën dhe na ndoqi këmba këmbës. Profesorët ulur në karrige duke na pritur na dukeshin si shkëndia. Me humor të shkëlqyer, me lehtësi pak të tepëruar, du-

ke futur në çdo çast fjalë latine, ne u përgjigjëm, gjuha ecte vetë, të dy morëm vlerësimin shumë mirë.

Gëzimi ynë ishte i madh; miku im bënte projekte; të hapte një zyrë avokatie në Kretë dhe të merrej me politikë; Unë gëzohesha sepse më hapej porta për të më lejuar kalimin. Një nga dëshirat e mia më të zjarrta gjithmonë ka qenë të udhëtoj. Të shoh, të prek toka të panjohura, të hyj e të notoj në dete të panjohur, të shëtis nëpër botë, të shoh, të shoh e të mos ngopem së pari toka, dete, ide, njerëz të rinj, të shoh çdo gjë për herë të parë e të fundit, të hedh mbi të një shikim të gjatë, pastaj të mbyll sytë dhe të ndjej se si pasuria depozitohet qetësisht tek unë, ose si furtunë, si ta duan ato, deri sa koha t'i kaloj në sitën e imët dhe nga gjithë gëzimet e hidhërimet, të ngelet maja e miellit - kjo alkimi e zemrës, besoj se është një kënaqësi e madhe e denjë për njeriun.

Kishte disa vite që kanarina, zogu magjik që më kishte dhuruar babai kur isha i vogël, kishte ngordhur: ose më mirë jo, më vjen turp të shqipotoj këtë fjalë, doja të thosha: kishte vdekur, ose më mirë, kishte shkuar t'ia çonte këngën e saj Zotit. Ne e varrosëm në kopshtin e vogël në oborr, motra qante, por unë isha i qetë, sepse e dija se sa të jetoja unë nuk e lija të vdiste. "Nuk do të le të vdesësh, pështpërisja duke e mbuluar me dhè, ne do të jetojmë e do të udhëtojmë së bashku."

Dhe një herë, kur isha i rritur, kur lashë Kretën dhe fillova të bredh mbi koren e tokës, gjithmonë dëgjoja kanarinën kapur fort mbi kokën time, që këndonte duke përsëritur vazhdimisht të njëjtin refren të këngës së saj: çohu, nisemi, ç'bëjmë që rrimë këtu? Ne nuk jemi guaska, ne jemi zogj; "Çohu, nisemi."

Koka ishte kthyer në glob tokësor, kanarina qëndronte sipër, ngrinte gushën e ngrohtë drejt qiellit dhe këndonte.

Kam dëgjuar, se në kohët e vjetra, femrat turke çdo mbrëmje dilnin me këmishë në kopshtin e haremit, laheshin, parfumoseshin, gjokszbuluar dhe sulltani zgjidhte njërën prej tyre. Ai mbante një shami të vogël, e fërkonte nën sqetullat e tyre pastaj i mbante erë; ai zgjidhte femrën, parfumi i së cilës, i pëlqente më shumë atë mbrë-

mje.

Kështu radhiteshin përpara meje vendet.

I hodha një sy hartës; ku do të shkoja? Çfarë toke, çfarë deti të shoh më parë? Gjithë vendet shtrijnë krahët e më ftojnë. Zoti qoftë i lëvduar, bota është e madhe dhe dembelët kanë thënë, jeta e njeriut është e gjatë, ne kemi kohë të shohim gjithë vendet dhe të kënaqeni me të.

Fillojmë nga Greqia.

Pelegrinazhi im në Greqi zgjati tre muaj. Male, ishuj, fshatra, manastire, lumenj, dhe tani kur i kujtoj më rreh zemra, i lumtur e i shqetësuar; është një gëzim i madh të shëtitësh e të shohësh Greqinë, një gëzim dhe një martirizim.

Shëtisja Greqinë dhe pak nga pak unë shihja me sytë e mi, prekja me duart e mia, atë që mendimi abstrakt, nuk mund ta shohë e ta prek: si është përzier forca me hijeshinë. Kurrë, besoj, në asnjë kënd të tokës, të dy përbërësit e përsosmërisë, Ares dhe Afërdita, nuk janë gërshetuar në mënyrë aq organike sa në Greqinë e ashpër dhe të buzëqeshur. Disa nga këto vende janë të ashpra dhe në të njëjtën kohë gazmore dhe të pritura. Pra fryma ka kaluar mbi të gjitha dhe i ka dhënë secilit njëherësh, bashkë me një tempull edhe një mit, që i përshtatet. Për këtë arsye ai që udhëton në Greqi dhe që ka sy për të parë, një farë zgjuarësie për të reflektuar, udhëton nga fitorja shpirtërore në fitoren shpirtërore, në një unitet magjik të pandërprerë. Shpirti, për këtë bindesh në Greqi, është vazhdimi natyral dhe lulja e lëndës, ndërsa miti është shprehja e thjeshtë, globale e realitetit më pozitiv. Shpirti ka ecur gjatë viteve mbi gurët grek dhe, kudo ku ka qenë, duken gjurmët e tij hyjnore.

Disa peizazhe të Greqisë janë bërë nga një substancë e dyfishtë dhe emocionet që të ngjallin janë të përbërë po nga kjo substancë. Ashpërsia dhe butësia ekzistojnë njëra pranë tjetrës, plotësojnë njëratjetrën, bashkohen si burri me gruan. Njeri nga këto burime të dyfishta të butësisë dhe të ashpërsisë është Sparta.

Përpara meje, ligjvënësi, i fortë e mospërfillës, plot humnera, Taigeti; poshtë, mbushur me fruta, magjepsëse; fusha, shtrirë tek

këmbët e tij si një femër e dashuruar. Nga njëra anë e Taigetit, Mali i Sinait të Greqisë, nga ku, Zoti i plotfuqishëm dikton urdhërat e prerë: Jeta është luftë, toka është fusha e luftës, të fitosh është detyra jote e vetme; mos fli. Mos u stolis, mos qesh, mos fol, ti ke vetëm një qëllim, luftën; lufto! Dhe nga ana tjetër në këmbët e Taigetit, Helena. Kur je i mërzitur e pa shpresë, kur dikush përçmon butësinë e tokës, përnjëherë vjen era e Helenës, si aroma e luleve të limonit e të turbullon shpirtin. Me të vërtetë kjo fushë e Spartës që është kaq e mirë, e dashur dhe joshëse, dhe dafinat e saj rozë kanë atë aromë dehëse, ose më mirë gjithë kjo magjepsje buron nga trupi, njëmijëherë i dashur, njëmijëherë endacak, i Helenës? Sigurisht Erotasi nuk do të kishte atë bukuri joshëse, në qoftë se ai nuk do të bashkohej si një degëzim, me ujrat e mitit të Helenës. Sepse, ne e dimë mirë: tokat, detet, lumenjtë përzihen me emra të mëdhenj shumë të dashur, e, duke u bërë të pandashëm, derdhen së bashku në zemrën tonë. Ecën mbi brigjet e thjeshtë të Erotasit dhe ndjen duart e saj, flokët e saj, mendimet e saj, të përzihen me parfumin e një femre ideale, më reale, më të prekshme se femra që do dhe prek me duart e tua. Sot bota mbytet në gjak, pasionet shpërthejnë fuqishëm në anarkinë e kësaj kohe. Helena qëndron në këmbë, e pavdekëshme, e pacënuar, në botën e vargjeve të mrekullueshme, e palëvizur ndërsa koha rrjedh përpara saj.

Në qoftë se dikush do të ecë mbi brigjet e Erotasit kur është pranverë dhe zambakët e egër kanë filluar të ngrihen mbi tokën e lagësht, sigurisht, në qoftë se shpirti i tij është i denjë për këtë çast e për këtë vend, ai do të shohë të ngrihet nga toka, një pranverë e përjetshme, midis të qeshurave dhe lotëve, Helenën duke dalë nga uji.

Ajo ngre velin qarkuar me lule të egra dhe me një dorë vendosur mbi buzët, e pacënuar në çdo kohë, ecën mbi tokë duke qeshur, - dhe kur ngre kërcirin e bardhë si bora, këmba e saj delikate rrezaton, e gjakosur si ajo e fitores. Toka mbante erë të mirë, nga lulet e limonëve binin pika vese ngjyrë trëndafili mbi të cilat vallëzonin rrezet e diellit. Filloi të fryjë një fllad i lehtë, një lule më goditi në ball dhe më spërkati me ngjyrë trëndafili. U drodha sikur një dorë e padukshme më preku, dhe gjithë toka mori trajtat e Helenës.

Çfarë do të ishte Helena në qoftë se era e Homerit nuk do të kish kaluar mbi të? Një grua e bukur si mijëra të tjera, që kanë kaluar mbi tokë dhe janë zhdukur. Do ta kishin rrëmbyer siç rrëmbejnë shpesh vajzat e bukura në fshatrat tona të maleve. Ky rrëmbim do të kishte ndezur një luftë dhe gjithçka, lufta, gruaja, maskara, gjithçka do të qe zhdukur në qoftë se poeti nuk do të kishte shtrirë dorën për ta shpëtuar. Poetit duhet t'ia japë, Helena, përshëndetjen e saj.

Nga Homeri, kjo rrjedhje e vogël uji, Erotasi, është i pavdekshëm. Buzëqeshja e Helenës është shpërndarë nëpër gjithë Spartën. Për më shumë akoma: Helena ka hyrë në gjakun tonë, gjithë burrat e kanë marrë atë me kungimin, gjithë gratë ndrijnë nga shkëlqimi saj. Helena është bërë një thirrje dashurie që kalon shekujt, zgjuan tek çdo burrë dëshirën mashkullore dhe të vazhdimësisë dhe transformon në Helenë feminitetin real që mban në krahët e tij.

Dëshira, falë kësaj mbretëreshe të Spartës, merr cilësitë më të larta të fisnikërisë, dhe nostalgjia misterioze për një përqafim të zhdukur zbut tek ne kafshën, ne qajmë, thërresim, Helena hedh një filiz magjik në gotën ku ne pimë, dhe ne harrojmë vuajtjen tonë; ajo mban në dorë një lule dhe era e saj largon gjarpërinjtë, prek fëmijët e shëmtuar dhe ata zbukurohen; hipur mbi cjapin e tragjedisë, ajo tund këmbët me sandale të zgjidhura dhe gjithçka kthehet në rrush. Poeti i vjetër Steshior shqiptoi një ditë, në një odë, një fjalë të keqe; përnjëherë humbi shikimin; duke u dredhur i penduar, mori lirën, u ngrit përpara grekërve në një festë të madhe panhelenike dhe këndoi të famshmen këngë:

Jo s'është e vërtetë, Helenë,
Ajo çfarë kam thënë për ty,
Jo s'ke hipur mbi anije të shpejtë,
Në Trojë, nuk ke ardhur ti.

Filloi të qajë i lemerisur duke ngritur duart; përnjëherë, mbi qerpikët e lagur nga lotët ra drita.

Stërgjyshërit tanë bënin konkurse bukurie: "Festa e Helenës". Në të vërtetë toka është një palestër dhe Helena shpërblimi i pa

pranueshëm mbi jetën, ndoshta inekzistente, - apo ndoshta një fantazmë. Ajo u imponon mistrianëve një traditë të fshehtë, që donte të thoshte, se Akenët nuk luftuan me Tojanët për Helenën e vërtetë; Në Trojë gjendej vetëm statuja e saj. Helena e vërtetë ishte larguar në Egjipt në një tempull hyjnor, nën mbrojtjen e frymës së njerëzve. Kush e di, ndofta po ashtu, luftojmë ne, qajmë, rritemi me njëri tjetrin mbi këtë tokë, për të vetmin imazh të Helenës. Po atje, kush ngelet akoma? Hijet e Hadesit ringjallen kur pijnë gjak të gjallësh; ajo, hija e Helenës që ka pirë aq gjak, në kaq shumë vite, nuk mund të ringjallet prapë? Imazhi nuk do të kërkojë kurrë mishin e tij, nuk do të mundemi kurrë të përqafojmë një trup të vërtetë e të ngrohtë, një Helenë të vërtetë.

U vonova duke ecur midis dafinash ngjyrë rozë të Erotasit duke thithur së bashku me frymëmarrjen aromën e Helenës e pa patur turp për këtë. Një mëngjes u nisa për rrugë, për të shkuar në Taiget për të thithur një ajër më burrëror. Bukuria e malit, era e pishave, gurët e ndezur zjarr, gjeraqinat që fluturonin mbi kokën time, dhe ajo vetmi e pamposhtur më forcuan zemrën, vazhdova të ngjitem për orë të tëra, isha i lumtur. Rreth mesditës qielli u mbulua me re të zeza, filluan vetëtima; doja të zbrisja, hidhesha nga njëri shkëmb në tjetrin, e shihja se stuhia vinte pas meje, vrapoja, duke u vënë në garë me të, që të mos më arrinte. Por fare pa pritur pishat gjëmuan, bota u errësua, u gjenda midis vetëtimave. Më kapi shtrëngata. U shtriva përmbys që të mos rrëzohesha, mbylla sytë dhe prisja. Mali dridhej, dy pisha pranë meje u shkulën nga toka dhe ranë me një kërcitje të madhe. Ndieja, duke marrë frymë, një erë squfuri, dhe përnjëherë filloi rrebeshi; pushoi pak era dhe nga qielli filluan të rridhnin kolona të mëdha uji. Trumëzat, sherebeli dhe bimët e tjera të goditur nga rrebeshi lëshonin erërat e tyre, gjithë mali nxirrte avull.

U ngrita dhe fillova të zbres; isha i ngazëllyer që duart, fytyra, flokët më rriheshin nga ujërat. Shumë shpejt qielli u pastrua, ishte një zbritje e shkrutër e shpirtit, ajo kishte përfunduar, qyqja e shpallte. Në atë çast, qielli u fsheh dhe unë pashë atje poshtë, larg, të lara nga shiu mbi majën e kodrinës që dominonte Mistrën, rrënojat e një kështjelle franceze të Vilehardinëve. Qielli ishte bërë i gjithë i gjelbërt e i artë.

MISTRA

Të nesërmen, duke kaluar midis qeparizave dhe kopshteve, shkova për pelegrinazh në Pompein e Greqisë, Mistra. Kjo kodrinë e shenjtë, ku ka lindur Greqia moderne, ka gjithë shkëlqimet e dukshme ose të padukshme që mund të zbutin edhe shpritin më të ashpër. Pemishtet e limonëve e të portokalleve, rrugicat e ngushta gjithë dredha; fëmijë gjysmë lakuriq duke luajtur, gra që shkonin për të mbushur ujë, vajzat ulur nën pemët me lule që qëndisin. Jeta është kapur përsëri mbi këtë tokë dhe kërkon të kapërcejë kodrinën stërgjyshore. Është brezi i parë i jeshil i jetuar në Mistra. Ajo vazhdon akoma ku fillon e tatëpjeta gjithë pluhur e pa pemë. Kapërcen shtëpitë e rrënuara, arrin te kishat e famshme bizantine që digjen në diell, Peribleptosi, Metropoli, Teodorët e shenjtë, Afendiko, Pantanasa; është zona e dytë e zbukuruar e kishave të sotme, të Mistrës.

Kisha etje; hyj në kuvendin e grave të Pantanasës, që fetaret të më jepnin një gotë ujë. Oborri shkëlqente, kamaret të lyera me gëlqere feksnin nga pastërtia, kanapetë mbuluar me kuverta të qëndisura. Fetaret vrapuan për të më uruar mirëseardhjen; disa qenë të shtrembëruara nga reumatizma, të tjerat të reja, tepër të zbehta, sepse punonin shumë për të jetuar, rrinin pa gjumë e luteshin dhe me gjithë urinë nuk kishin ç'të hanin. Kur kishin kohë të lirë, përkuleshin mbi mjeshtërinë e tyre dhe qëndisnin motive tradicionale. Qipariza të vegjël, kryqe, vazo me lule; trëndafila të vegjël me copë të kuqe. Të pushton trishtimi kur hapin para teje qëndisjet e tyre, sikur ju tregojnë pajën, buzëqeshin, nuk flasin, edhe pse e dinë mirë se nuk kanë të fejuar.

Nën dritën e gjelbërt dhe të murrme për shkak të muzgut Pantanasa rrezaton si një baule e fildishtë bizantine punuar me durim e dashuri ku do të banonte fryma kundërmonjëse e virgjëreshës. Çfarë uniteti, çfarë përqendrimi i formave e çfarë bukurie që prej gurëve

shumëqoshësh të bazës deri te harku i kubesë! Gjithë koha e lavdishme jetonte e merrte frymë, e qetë, si një organizëm i ngrohtë e i gjallë. Gjithë gurët, skulpturat e gdhendura, pikturat, vetë fetaret, jetonin si gjithë përbërësit organik të atij kuvendi femrash, sikur gjithë kjo kishte lindur së bashku, nga e njëjta tërsëllimë krijuese një ditë të bukur me diell.

Nuk kisha menduar ndonjëherë të gjeja në pikturat bizantine aq ëmbëlsi, aq mirëkuptim të ngrohtë njerëzor. Nuk kisha parë deri atëherë se figurat e asketeve të egra që mbanin një pergamen mbuluar me gërma të kuqe na bënin thirrje të mohonim natyrën, të niseshin për në shkretëtirë dhe të vdisnim për të shpëtuar. Po ashtu, ngjyrat, figurat shumë të ëmbla, Krishti që hyn në Jeruzalem mbi kafshën e tij të ndrojtur, zemërdlirë, duke qeshur, dhe prapa tij, dishepujt që mbanin palma në duar, dhe, populli që i shikon me sytë plot gëzim, si një re që kalon e shpërndahet... Dhe engjëlli, me ngjyrë të gjelbër, në bronz, që unë pashë në Afendiko, ai adoleshent me flokë kaçurrel, mbështjellë me një shirit të gjerë, me hap të fuqishëm dhe gjurin të fortë. Dukej sikur ishte një i fejuar që shkonte... Ku shkonte ai me aq gëzim e i nxituar? Në atë kohë kambanat filluan të binin më ëmbël, më butë për shërbesën e mbrëmjes të së premtes së shenjtë. Hyra në korridorin e ngohtë të kishës midis portës së madhe dhe korit; në mes, *qefini* i shenjtë mbuluar me lule limoni dhe, mbi lulet e limonit trupi i shtrirë i të vdekurit që jeton, i të ringjallurit të përjetshëm; dikur e quanin Adonis, sot e quajnë Krisht. Rreth e rrotull në gjunjë ishin ulur gratë e zbehta, veshur me të zeza, që vajtonin mbi të. Gjithë kisha gjëmonte si koshere nga klithmat; mua m'u kujtuan priftëreshat e tjera, bletët e tempullit të Artemisës në Efes; m'u kujtua tempulli i Apollonit në Delfi, ndërtuar me dyllë dhe pupla... përnjëherë shpërtheu vajtimi i grave, si dhe kënga funebre e padurueshme. E dija se dhimbja e njerëzve ringjallte Zotin; megjithatë, atje, në mbretërinë e Helenës, zemra ime nuk ishte e gatshme të vajtonte; u çova. Dita ruante akoma dhe pak dritë; fillova t'i ngjitem të përpjetës së ndërtuar nga feudalët tashmë të rrënuar, të përpjetës së kodrinës që mban në majën e saj, si një kurorë të gurtë, fortesën e famshme të *vilharduinëve*. Porta e fortifikuar ishte e hapur, oborret bosh, unë ngjita shkallët e prishura

duke u ruajtur nga gurët e hapur; tufa korbash fluturonin të trembur. Shikoja, poshtë këmbëve të mia fushën e mbjellë dhe tymin që ngrihej mbi shtëpitë e ulta; dëgjoja kërkëllimën e një karroce, një këngë plot pasion, gjithë ajri psherëtinte, i mbushur me fantazma. Rilindnin vajzat bjonde të zotërinjve francezë. Vazhdimisht, kalorësit veshur me hekur që kishin ardhur këtu si triumfatorë, ishin martuar me vajza greke, , kishin shartuar gjakun dhe kishin harruar atdheun. Kështu triumfatorët, u thyen nga vajzat tona ezmere me flokë të zesë, me sy të mëdhenj.

Disa ditë më vonë pata gëzimin të shoh një tjetër peizazh. Kalon një përrua të tharë, mbuluar nga hijet e rrepeve, lulëzuar nga shelgjet, ngjit një mal të thatë që kundërmon aromë trumëze, pa asnjë fshat, pa asnjë njeri, pa dhi e pa dhenë, një shkretëtirë. Dhe fare papritur, atje ku mali kthehet, shfaqet befas përpara jush tempulli i famshëm i Apollonit të Basait në zemër të Peloponisë. Sapo gjendesh përballë tij e sheh se ai është bërë nga të njëjtët gurë gri që është bërë edhe mali, dallon lidhjen e thellë që ekziston ndërmjet peizazhit dhe tempullit. Ai duket si një copë mali, gurë nga gurët e tij, një shkëmb i ngulur fort ndërmjet shkëmbinjve, por një shkëmb mbi të cilin është derdhur shpirti. Të gdhendura dhe të vendosura në atë mënyrë, kolonat e tempullit shprehnin substancën e gjithë kësaj thatësie e vetmie malësorësh; Ajo formon kokën e peizazhit, pamjen e shenjtë, të mbyllur brenda murit të saj, ku jeton shpirti i këtij vendi. Këtu arti antik duke vazhduar dhe shprehur përsosmërisht peizazhin, nuk të habit, i veshur me një nuancë njerëzore familjare, ju grish të ngjiteni, pa ju folur, në majë. Duket se pas kaq shekujsh, brenda masave të tij të errëta, mali ka dëshirë të zjarrtë të shprehet; që kur kishte pranuar të vendosej tempulli i Apolonit ai qe lehtësuar. Ai qe lehtësuar, unë e dëgjoja kudo: ai kishte marrë një kuptim, kuptimin e tij të vërtetë dhe për këtë ishte i gëzuar.

Duke shëtitur mbi tokën greke, unë po kuptoja gjithnjë e më thellësisht se qytetërimi grek nuk kishte rënë nga qielli, si një lule mbinatyrale, por ishte një pemë që kishte hedhur rrënjët fort mbi tokë, ushqehej me atë baltë dhe prej saj lulëzonte. Sa më shumë merrte nga ajo baltë, aq më shumë ndryshohej dhe lulëzohej. Thjeshtësia e famshme antike, ekuilibri, qetësia e një race të thjeshtë e të

ekuilibruar nuk ishin virtyte natyrore të arritura pa mundim; ishin çmimi i luftrave të vështira, shpërblimi i betetjave të dhimbshme e të rrezikshme. Qetësia greke është shumë komplekse, tragjike, është ekuilibri i forcave të egra që luftojnë me njëra-tjetrën që edhe pas një lufte shumë të gjatë, arrijnë të pajtohen. Arrijnë atje ku fetari bizantin e quan "mungesa e përpjekjeve" që do të thotë në majë të përpjekjeve.

Ajo që i bashkon, ende e pa materializuar, malet, fshatrat, tokën greke, është drita; në Itali ajo është e dobët, femërore, ndërsa në ishujt jonianë, është shumë e ngrohtë, plot pasion oriental, në Egjypt ajo është e plotë dhe joshëse; në Greqi, drita është shumë shpirtërore. Pikërisht në këtë dritë njeriu ka parë qartë, të vendosë rregull në kaos dhe prej tij të bëj një univers. Një univers do të thotë një harmoni.

Një plakë doli nga kasollja e rojes; ajo mbante në dorë dy kokrra fiq dhe një vesh rrush. Ishin të parët që ishin pjekur mbi sheshin e kësaj lartësie dhe ajo donte të m'i dhuronte mua. Ishte një plakë trupvogël, e këndshme, e qeshur, që sigurisht në kohën e saj duhet të ketë shkëlqyer.

- Si të quajnë gjyshe? - e pyeta.

- Marie, - por kur pa që unë mora lapsin për të shkruar emrin e saj, shtriu dorën e fishkur për të më ndaluar. - Mariet... - më tha, me një lajkatim rinor, - Mariet... Dukej që ajo donte, meqë emri i saj do të shkruhej, të shpëtonte një emër tjetër të zvogëluar, që zgjonte tek ajo kujtimin e ndonjë çasti të ëmbël të jetës së saj.

- Mariet, - përsëriti edhe njëherë, sikur trembej se mos unë nuk e kisha dëgjuar.

U gëzova që pashë femrën siç kishte qenë edhe në trupin tashmë të rrënuar.

- Çfarë ka këtu? - e pyeta.

- Nuk e sheh? Gurë.

- Po përse vijnë dhe e shohin nga gjithë bota?

Plaka hezitoi për një çast, uli zërin: - Je i huaj?

- Jo, grek.

Mori guximin, tundi supet: - Të huajt janë budallenj! Dhe shpërtheu me të qeshura.

Nuk ishte hera e parë që unë shihja plaka që ruanin tempuj antikë, ose kisha të famshme me ikona mrekulluese, të qeshura, që nuk zinin besë lehtë, që ruanin shenjtorë ose demonë mermeri, antikë. Duke u përpjekur të futesha në ditët e jetës së tyre, ato nuk e linin veten, imponohesha prej tyre. Marieta e vjetër më shikonte, e lumtur, tek hãja kokrra-kokrra rrushin që më kishte dhënë.

- E çfarë mendon ti, - i thashë, për ta ngacmuar, - për politikën?

- Eh! More bir, më përgjigjet me një krenari të papritur, eh! Biro, këtu ne jemi shumë lart, larg botës dhe nuk e dëgjojmë zhurmën e saj.

"Ne", domethënë: "tempulli dhe unë" dhe ajo thoshte "larg botës" me një ton krenar sikur të thoshte "mbi". Isha shumë i gëzuar, më shumë se vetë tempulli, ajo frazë e plakës kishte mbushur zemrën time. Shëtisja midis kolonave ku gjendeshin pellgje uji në gropat e mermerit të thyer. Përkulesha dhe shikoja se si kalonin mbi ujë, si fantazma, re të bardha si push. Kisha lexuar se në Lindjen e Largët kështu e admironin hyjninë, në një vaksë uji mbi të cilën kalonin re të bardha.

Duke zbritur drejt fushës, pashë një plak të ulur në gjunjë mbi gurë, që përkulej mbi një burim për të parë sesi rridhte uji dhe fytyra i ishte zhytur në një ekstazë të patreguar; hunda, goja, buzët, sikur i ishin zhdukur dhe i kishin mbetur vetëm dy sytë që shikonin ujin sesi rridhte midis gurëve. Iu afrova.

- Çfarë shikon ashtu xhaxha? - e pyeta. Ndërsa ai pa ngritur kokën për të mos e shkëputur shikimin nga uji:

- Jetën time, biro, m'u përgjigj, - jetën time që shkoi...

- Të gjitha gjërat në Greqi, malet, lumenjtë, detet, fushat, njerëzohen dhe i flasin njeriut një gjuhë gati njerëzore. Ata nuk e dërrmojnë, nuk e mundojnë; ato bëhen mikeshat dhe bashkëpunëtoret e tij. Klithma e trazuar, e pakulluar e lindjes duke kaluar nëpër dritën e Greqisë, fiksohet, njerëzohet, bëhet fjalë. Greqia është filtri që pastron me mundim kafshën dhe e transformon në njeri, ashtu siç transformon skllavërinë lindore në liri dhe dalldinë barbare në mendim të matur. T'i jepte fytyrë atij që s'kishte fytyrë, masë atij që s'kishte masë, duke realizuar ekuilibrin e forcave të verbëra që përplaseshin; i tillë ka qenë misioni i kësaj toke dhe i këtij deti aq të trazuar që

quhet Greqi.

Është me të vërtetë një gëzim i madh, një pasuri e madhe, të shëtitsësh Greqinë në të gjithë kuptimet dhe në përmbajtjen e saj. Toka greke është e lagur me lot, me djersë e me gjak, malet greke kanë parë përpjekjet e burrave që dridheshin duke menduar se mbi këto male e mbi këto brigje është vendosur fati i racës së bardhë. Pikërisht mbi një nga këto brigje, plot bukuri e lojëra dritash është bërë mrekullia e transformimit të kafshës në njeri. Mbi një breg grek të ngjashëm, donte të zbarkonte një ditë orientali Astarte me shumë sisë si dosë. Grekët e pranuan statujën prej druri të barbarëve me shtat shumë të lartë, e pastruan nga kafshëritë, nuk i lanë vetëm dy gjinj njerëzor dhe atij i dhanë një trup njeriu fisnik. Grekët kanë marrë nga Lindja instinktin primitiv, dehjen erotike, klithmën kafshërore, Astartenë, ata e kthyen instinktin në dashuri, të kafshuarit në puthje, orgjinë në kult fetar dhe klithmën në fjalë dashurie. Astarte u bë Afërditë.

Pozicioni jo vetëm gjeografik, por edhe shpirtëror i Greqisë e ngarkon me një mision dhe përgjegjësi misterioze - dy rryma, zëri i të cilave nuk pushon kurrë së përplasuri mbi tokat dhe detet e saj kanë bërë që Greqia të jetë një pikë gjeografike dhe shpirtërore e ndjekur nga vorbulla të pandërprera. Sa më shumë që Greqia hynte te unë, aq më thellë kuptoja se thelbi misterioz i tokës dhe i detit grek ishte melodioz. Ky pozicion fatal ka patur një ndikim përcaktuese mbi fatin e Greqisë dhe të botës.

Shikoja, zbuloja Greqinë, duke udhëtuar në këmbë i vetëm me një shkop ulliri në dorë e me një trastë në sup. Sa më shumë Greqia hynte brenda meje aq më mirë kuptoja se thelbi misterioz i tokës dhe i detit grek është muzikor. Në çdo çast, edhe pse peizazhi grek ngelet po ai që është, ndryshon ngadalë: bukuria e tij lëkundet valë-valë, përtërihet. Ai ka një ngjashmëri të thellë, por njëkohësisht dhe një ndryshim të vazhdueshëm, një përtëritje. I njëjti ritëm a nuk ka drejtuar artin antik, që lindi duke shikuar, duke dashur, duke ndjerë dhe duke formuluar botën e dukshme që e rrethonte? Shiko një vepër greke të epokës së madhe klasike: ajo nuk është e palëvizshme; e përshkon një dridhje e pandërprerë e jetës, dridhet lehtë si krahët e skifterit kur ndalet lart në ajër e ne na duket i palëvizshëm.

Kështu jeton statuja antike, lëviz vazhdimisht; duke vijuar traditën, duke përgatitur marshimin e ardhshëm të artit, ajo realizon në një çast të pavdekshëm ekuilibrin e trinitetit të kohës. Çfarë lumturie do të ishte për një grek që të mund të shëtiste nëpër Greqi pa dëgjuar klithmat e ashpra që ngrihen nga toka! Por për një grek udhëtimi do të ishte një martirizim magjepsës e i varfër; ju rrini në këmbë mbi një cep të vogël të tokës greke dhe ju pushton ankthi. Është një varr i thellë, i mbushur me shtresa të vdekurish, vendosur njëri mbi tjetrin. Klithma të ndryshme ngrihen nga toka dhe ju thërrasin; sepse ajo që ngelet nga i vdekuri, e që është e pavdekshme, është zëri. Cilin nga këta zëra do të zgjidhni? Çdo zë është një shpirt, çdo shpirt digjet nga dëshira të gjejë një trup dhe zemra juaj dëgjon, tronditet, heziton të marrë një vendim, sepse shpesh shpirtrat edhe më të dashurit, nuk janë dhe më të denjët. Më kujtohet dita kur kisha qëndruar, në mesditë nën një dafinë në breg të Erotasit, ndërmjet Spartës e Mistras; aty u binda për luftën shekullore e të tmerrshme që zhvillohet midis zemrës e shpirtit. Zemra u zhyt në një vrull të papërballueshëm për të ringjallur trupin e verdhë e të shenjuar me vulën fatale të perandorit bizantin Kostandin Paleologut, për ta kthyer prapa rrotën e kohës e për të çuar atë ditë më 6 Janar 1449 ku, në një festë në Mistria, Kostandini mori kurorën e përgjakur të Bizantit.

Psherëtima të panumërta stërgjyshore, dëshira të panumërta të frymëzuara nga rraca ju shtyjnë drejt dobësimit, por shpirti i pathyeshëm reziston, kthehet drejt Spartës, pezmatohet, dëshiron ta fusë perandorin e verdhë në greminën e kohëve, dhe të bashkohet me djelmoshat e pamëshirshëm të Spartës.

Sepse vullneti i shpirtit është ekzigjenca e çastit fatal, ku rastësia bën të lindim: në qoftë se ne duam që jeta jonë të jetë pjellore, duhet të marrim një vendim që të harmonizohet me ritmin e tmerrshëm të epokës sonë.

Kur një grek përshkon Greqinë, udhëtimi i tij transformohet fatalisht në një kërkim të dhimbshëm të detyrës së tij. Si mund të bëhemi të denjë për stërgjyshërit tanë e të vazhdojmë pa i turpëruar ata traditën e racës sonë. Një përgjegjësi e rëndë së cilës nuk mund t'ia mbytim zërin, peshon mbi supet tanë, mbi supet e gjithë grekëve të gjallë. Vetë emri ynë ka një forcë misterioze dhe të pathyeshmë;

ai që lind në Greqi ka detyrën të vazhdojë legjendën shekullore greke.

Një peizazh grek na jep ne grekëve të tjerë, një drithërimë për bukurinë bujare; peizazhi ka një emër, ai quhet Maratonë, Salaminë, Olimp, Termopile, Mistra, ai është i lidhur me një kujtim; këtu ne jemi turpëruar, atje jemi mbulûar me lavdi dhe përnjëherë peizazhi shndërrohet në një histori plot lot e derte. Shpirti me pelerinë greke është I tronditur. Çdo peizazh grek është aq i mbytur në lumturi dhe në fatkeqësi saqë ka patur një tingëllim botëror, kaq i mbushur me përpjekje njerëzore saqë ngrihet përpara jush, i ashpër, dhe që nuk mund t'i shpëtosh dot. Ai shndërrohet në një klithmë, dhe detyra jote është ta dëgjosh.

Pozicioni i Greqisë është me të vërtetë tragjik; përgjegjësia e Greqisë së sotme është dërrmuese; ajo ngarkon mbi supet tona një detyrë të rrezikshme, të vështirë për t'u plotësuar. Forca të reja ngrihen nga Lindja, po ashtu forca të reja ngrihen nga perëndimi dhe Greqia, qëndron gjithmonë midis këtyre dy shtysave që përpiasen e bëhet edhe më shumë vendi i vorbullave. Perëndimi, ndjek traditën e logjikës e të kërkimit, turret për të pushtuar botën; Lindja, shtyrë nga forca të tmerrshme të subkoshiencës, përpiqet edhe ajo të pushtojë botë. Greqia, ndërmjet tyre, kryqëzimi gjeografik e shpirtëror i botës, ka detyrë sërishmi t'i pajtojë këta dy sulmues të mëdhenj, duke arritur sintezën e tyre. A do të mundet?

Fat i shenjtë, tmerrësisht i hidhur. Fundi i udhëtimit tim në Greqi qe mbushur me pyetje që ngelën pa përgjigje. Bukuria ne na çoi në ankthet dhe në detyrën e sotme të Greqisë. Sot një njeri i gjallë që ndjen, do e lufton, nuk mundet të shëtisë më e të luaj me shkujdesjen e bukurisë. Sot ankthi shpërthen si një zjarr dhe asnjë shoqëri zjarrfikësish nuk mund t'ju sigurojë nga ai. Luftohet në ankth dhe digjesh bashkë me gjithë njerëzimin. Më shumë se vendet e tjera lufton e digjet Greqia. Ky është fati i saj.

Rrethi u mbyll; sytë e mi u mbushën me Greqinë; gjatë atyre tre muajve më dukej se shpirti më ishte pjekur. Cilat mund të kenë qenë trofetë më të çmuara të asaj ekspedite shpirtërore? Besoj se janë: Pashë më qartë misionin historik të Greqisë ndërmjet lindjes e perën-

dimit; pashë se trimëria më e madhe nuk ishte bukuria por lufta për liri. Ndjeva më thellë fatin tragjik të Greqisë dhe kuptova mirë se sa e rëndë ishte detyra e grekut.

Besoja se sapo mbarova pelegrinazhin në Greqi, unë isha pjekur për të hyrë në radhën e burrave. Nuk ishte bukuria që ecte përpara meje dhe më fuste në odën e burrave, por ishte përgjegjësia.

Ky ishte fruti i hidhur që unë mbaja në dorë kur u ktheva, pas tre muajsh udhëtimi, në shtëpinë prindërore.

U ktheva në shtëpinë e prindërve; atje, në mes qetësisë e dhembshurisë së nënës, nën syrin e ashpër të babait, unë përjetoja udhëtimin tim dhe e sistemoja në gëzimet dhe vuajtjet e mia. Përgjegjësia kishte ngritur zërin tek unë, e unë nuk mund t'i shpëtoja dot më. Tokat kishin folur, të vdekurit ishin ngritur, Greqia ishte shfaqur tek unë si Kretë e madhe që luftonte nëpër shekuj - ashtu si ishte fati i saj - për liri.

Cila ishte detyra ime? Të bashkëpunoja me të, të hidhja në luftë në anën e saj jetën dhe shpirtin tim.

Nga se, nga cili duhet të çlirohesha? Pyetje e vështirë, unë nuk mund t'i përgjigjesha. Vetëm ndjeja se detyra ime nuk ishte të isha në male, me një pushkë në dorë, për të luftuar turqit. Armët e mia ishin të tjera dhe unë akoma nuk arrija të dalloja armiqtë e mi. shikoja qartë se, çfarëdo vendimi që të merrja, unë do ta plotësoja detyrën time me besnikërinë më të madhe. Për këtë isha i sigurtë, për ndershmërinë dhe këmbënguljen time. Kjo ishte gjithçka.

Më kujtohej dita kur profesori im u ankua te babai se unë nuk i dëgjoja ato që thoshte mësuesi dhe nuk iu nënshtrohesha atyre. Unë isha i pranishëm dhe dëgjoja babanë që iu përgjigj: mësuesi, të mos gënjejë dhe të mos godasë, këto dy gjëra më shqetësojnë, ndërsa për të tjerat, të bëjë ç'të dojë.

Të mos gënjejë dhe të mos godasë, këto dy gjëra më preokupojnë, për të tjerat të bëjë ç'të dojë. Kjo fjali është ngulitur thellë në shpirtin dhe jetën time, dhe unë besoj se nuk do të isha ky që jam sikur të mos e kisha dëgjuar. Duket se një instinkt i errët e i pagabueshëm e ka udhëhequr tim atë për të rritur djalin e tij; instinkti i ujkut që rrit

këlyshin e tij të vetëm.

Nuk dilja më nga shtëpia, nuk kisha më miq. Shoqata ishte një balon të rinjsh e krahët e saj ishin zhdukur në erë. Përpiqesha të largoja shqetësimet e reja që më torturonin pas pelegrinazhit në Greqi dhe ktheva drejtimin e refleksioneve të mia duke studiuar Rilindjen italiane dhe shpirtrat e mëdhenj që e kishin themeluar. Kisha marrë vendim të shëtisja Italinë, duke shfrytëzuar premtimin që më kishte bërë babai.

Një mëngjes, unë u shkëputa përsëri nga shtëpia, ndërsa nëna qante: - Ku do të shkosh, kështu do të vazhdosh duke ikur gjithnjë?

- Rinia është e fortë, - iu përgjigja unë.

Me mendje po thosha : Sa të jem gjallë unë do të udhëtoj, por u përmbajta; shtrëngova fort dorën e nënës dhe ajo mä dha me gjithë shpirt.

ITALIA

Të jesh i ri, të jesh njëzetepesë vjeç, të jesh i fortë, të mos duash ndonjë njeri të përcaktuar, burrë apo grua, që të mund të ndryshojë zemrën dhe t'ju pengojë të doni të gjitha gjërat me çinteresim të njëjtë e me vrull të njëjtë, të udhëtosh në këmbë, i vetëm, me një çantë mbi shpinë, nga njëri skaj i Italisë në tjetrin edhe në pranverë, edhe kur vjen vera, pastaj ngarkuar me fruta e me shira në vjeshtë dhe në dimër - besoj se do të ishe kokëshkretë po të kërkoje lumturi më të madhe.

Nuk më mungonte asgjë; trupi, shpirti dhe mendja, këto tre bisha ishin të gëzuara njëlloj, të lumtura e të ngopura në mënyrë të dukshme. Gjithë kohën që zgjati ky udhëtim i martesës me shpirtin tim, unë kuptova, ashtu si nuk e kisha kuptuar kurrë në jetën time, se trupi, shpirti dhe mendja janë bërë nga e njëjta tokë. Vetëm kur plakesh, kur sëmuresh ose kur bie në fatkeqësi, ata ndahen e hyjnë në luftë njëri kundër tjetrit, trupi do të komandojë, shpirti do të çlirohet e të ikë, e mendja e pafuqishme e miraton shpërbërjen trinjake, por kur je i ri e i fortë, sa shumë duhen të tre vëllezërit që pijnë të njëjtin qumësht.

Mbyll sytë, rinia vjen përsëri, harmonia formohet përsëri tek unë dhe unë shoh të kalojnë brigjet, malet, fshatrat me kambanoret e brishtа, sheshet e vogla plot hije, rrapishtet, ujin që rrjedh, stolat prej guri, pleq të ulur aty mbrëmjeve, mbështetur mbi bastunet e tyre dhe që diskutojnë qetësisht, duke treguar gjithmonë të njëjtat gjëra, prej vitesh, prej shekujsh të thëna - dhe pamja përreth dhe sipër tyre është ę përjetshme.

Kur pashë për herë të parë pikturat e famshme, sa dridhej zemra ime e pangopur! Qëndroja në këmbë te pragu për një kohë të gjatë, me gjunjë të përthyer deri sa të më qetësoheshin të rrahurat e zemrës dhe të mund t'i rezistoja asaj bukurie. Unë e dija mirë, bukuria ësh-

të e pamëshirshme, atë nuk e shikon, është ajo që të sheh dhe nuk të fal.

Vrapoja nga njëri qytet te tjetri, pikturat, statujat, kishat, pallatet - çfarë lakmie kisha, çfarë dëshire të zjarrtë! Kisha uri, kisha etje dhe nuk ngopesha. Një erë dashurie frynte në tëmthat e mi, kurrë ndonjë femër, kurrë ndonjë ide, kurrë kontakti me Zotin për jetën e ardhshme nuk i ka dhënë trupit tim një kënaqësi aq të madhe. Preokupacionet abstrakte nuk ishin fshirë akoma prej meje, gëzohesha të shihja, të dëgjoja, të prekja, brenda ose jashtë botës, nuk bëja gjë tjetër veçse e prekja. Në qoftë se në atë kohë do të krijoja Zotin, do t'i kisha dhënë trupin e një djaloshi, me push në faqe, gjunjë të fortë, trup të hollë, i cili do të kishte mbajtur mbi supe, botën, siç e mban demi.

Molla e jetës këtu ishte e fortë, e shëndetshme; nuk ishte më Greqia. Pelegrinazhi im në tokën greke kishte qenë shpesh herë i dhimbshëm, sepse ajo tokë ishte shumë e afërt me mua, shumë familjare; unë e njihja mirë vuajtjen e saj dhe dalloja qartë prapa fytyrës së saj të bukur, pastaj vuaja së bashku me të. Por atje ishte një tokë e huaj; edhe ajo kishte vuajtjet e saj, por unë nuk i njihja, ose edhe në qoftë se i njihja ato nuk më shkaktonin aq dhimbje. Fytyra e bukurisë, më dukej se nuk mbante asnjë gjurmë plage.

Unë isha një provincial i panjohur, me faqet akoma me push, që shëtisja për herë të parë, i vetëm e i lirë, në dhe të huaj, dhe gëzimi ishte aq i madh sa shpesh, më pushtonte frika. Unë e dija mirë se Zotat janë xhelozë, se i fyen me *tepërimin* e të qënit i lumtur dhe këtë ta dish mirë. Që të thyeja syrin e keq përdora disa artifise qesharake.

Më kujtohet, isha aq i lumtur në Klorenc sa e kuptova që kjo i tejkalonte të drejtat e njerëzve dhe më duhej të gjeja një mënyrë për të vuajtur.

Shkova pra të blej një palë këpucë të ngushta. I vishja në mëngjes, dhe ato më vrisnin aq keq sa nuk mund të ecja dot e kërceja si harabel. Gjithë mëngjesin, deri në mesditë vuaja; por Pasdite, kur ndërroja këpucët e dilja shëtitje, ndieja një kënaqësi të madhe e isha i lumtur. Ecja lehtë, fluturoja. Bota më dukej parajsë, shëtisja në brigjet e Arnos, kaloja urat, ngjitesha në San Miniato; në mbrëmje frynte

një puhizë e freskët dhe njerëzit ecnin nën rrezet e fundit të diellit, të veshur në ar. Por të nesërmen në mëngjes, vishja përsëri këpucët e ngushta e bëhesha përsëri fatkeq, dhe Zotat nuk kishin më arsye të ndërhynin. Unë paguaja haraçin e njeriut...

Gjithçka ishte e thjeshtë, asnjë problem nuk më torturonte, molla e jetës ishte pa asnjë krimb. Ato çfarë dukeshin, më mjaftonin, nuk kërkoja të shihja në ekzistonte diçka tjetër pas tyre. Një piktor i antikitetit kishte pikturuar një perde dhe ftoi një piktor rival për ta parë e gjykuar veprën e tij: - Hiqe pra perden, të shoh tablonë - i tha ai që erdhi. Perdja është tabloja, iu përgjigj piktori. Perdja që shikoja para meje, malet, pemët, detet, njerëzit, kjo ishte tabloja, e unë ngazëllehesha me një gëzim lakmitar e të ndershëm.

Revolta ime e parë, ajo e adoleshencës, kishte humbur forcën, unë kisha përvetësuar idetë poshtëruese, që toka nuk është qendra e universit, që njeriu rrjedh nga kafshët, dhe se ai vetë është një kafshë më inteligjente e më e pamoralshme se paraardhësit e tij. Gruaja që në një moment u shfaq në jetën time për të më trazuar aq keq gjakun, nga momenti kur unë e vendosa mbi letër, nuk kishte ardhur më të prishte harmoninë. Inteligjenca ka shpjeguar dhe treguar bukur se femra ka të njëjtën vlerë si burri, të njëjtin shpirt si burri, por zemra shekullore, tek unë, zemra afrikane, që përçmon e kundërshton mendimin e evropianizuar, e ndjek femrën, nuk ka besim tek ajo e nuk e lejon atë të hyjë thellë brenda meje dhe të më zotërojë; gruaja është vetëm një stoli për burrin, dhe më shpesh, për një sëmundje dhe nevojë.

Më kujtohet Kostandi, një kafshë që ishte pojak në Kretë, që jetonte vetëm dhe nuk lejonte asnjë grua t'i afrohej. Një ditë të bukur u dëgjua se Kostandi u martua.

- "Hë Kostandi ç'mund të na thuash? U martove?"

- "Ç'të bëja zotni? - m'u përgjigj; po mendohesha, në qoftë se unë ftohem, kush do të më hedhë kupa?"

Një tjetër akoma që u martua pesëdhjetë vjeç, më pati thënë si për të më kërkuar falje: - Hë ç'të bëj djalosh? Edhe unë dua të shoh një gërshet mbi jastëkun tim.

Ne e kemi thënë, herë një stoli, herë një nevojë.

I lirë, pa probleme metafizike, pa shqetësime dashurie, gëzimet e mia ngelën të pacënuara gjatë gjithë udhëtimit të *martesës* sime shpirtërore në Itali.

Megjithatë, kur pas kaq shumë vitesh, unë dua të risjell në shpirtin tim gëzimet e atëhershme, befasohem; më shpirtëroret janë vendosur në thellësi të qënies sime, e janë bërë një me mua e nuk dallohen më si kujtime të vetëdijes, ato kanë kaluar në gjakun tim, jetojnë e veprojnë si instinkte natyrore. Shpesh duke marrë një vendim unë më vonë e gjykoja se nuk isha unë që merrja vendime, por ndikimi që kishte patur mbi mua një pikturë, një kështjellë e Rilindjes, disa vargje të Dantes të gdhendura në një rrugë të Firences së vjetër.

Gëzime të tjera, jo shpirtërore, por më trupore, më afër ngrohtësisë së njeriut, ngelen të palëvizura në kujtesën time dhe më shohin jo me dashuri të madhe por edhe me një pikëllim të madh.

Nga gjithë kjo aventurë e rinisë më ka ngelur si një plaçkë e rrallë, shumë e rrallë e shumë e thjeshtë: një trëndafil që e pashë tek fishkej në një gardh në Palermo, një vajzë e vogël këmbëzbathur që qante në një rrugicë të vogël gjithë pluhur në Napoli, një mace e zezë me pulla të bardha që rrinte mbi parvazin e një dritareje gotike në Verona... është një mister sesi kujtesa nga gjithë ato që i afrohen asaj, zgjedh këto për të ruajtur. Cili ishte ai fitimtar i madh që kur po vdiste psherëtiu: Tri gjëra kam dëshiruar në jetën time të cilat nuk kam mundur t'i arrij: një shtëpi të vogël buzë detit, një kafaz me një kanarinë dhe një vazo me borzilok. Më shumë se të gjitha, dy kujtime, shumë të hidhura janë ngulitur tek unë, midis gjithë atyre që kam parë në Itali, që do të më ndjekin deri në vdekje duke më brejtur ndërgjegjjen, megjithëse unë nuk jam fajtor për asgjë.

Ja i pari. Po binte nata, gjithë ditën kishte rënë shi, një përmbytje e vërtetë. Mbërrita i lagur deri në kockë, në një fshat të Kalabrisë. Duhej të gjeja zjarr të thahesha dhe një strehë për të fjetur. Rrugët ishin të shkreta, portat të mbyllura, vetëm qentë që ndjenin një erë të panjohur fillonin të lehnin nëpër oborre. Fshatarët në këtë zonë janë të egër, vetmitarë, nuk i përfillin të huajtë. Ndaloja hapat përpara çdo porte, shtrija dorën por nuk guxoja të trokisja. Ah, gjyshi im në Kretë, që merrte çdo natë fenerin dhe bridhte rrugëve të fshatit se mos kishte ardhur ndonjë i huaj, për ta marrë, t'i jepte për të ngrënë,

t'i jepte një krevat për të fjetur! Në mëngjes vinte me një kupë verë e një copë bukë për ta përcjellë... Këtu në fshatrat e Kalabrisë, nuk kishte gjyshër të tillë.

Në krye të fshatit, pashë një portë të hapur, u përkula dhe pashë: një korridor të zhytur në gjysmë errësirë, në fund një zjarr të ndezur dhe një plakë përkulur përpara zjarrit që dukej se po gatuante. Qetësi, nuk dëgjohej tjetër, veç kërcitjeve të drurëve që digjeshin dhe ndjehej një erë e mirë; duhej të ishin dru pishe. Kapërceva pragun e hyra brenda. U përplasa me një tavolinë të gjatë që gjendej në mes, arrita deri te zjarri; atje gjendej një stol e unë u ula mbi të. Plaka qe ulur mbi një stol tjetër e trazonte gjellën në kusi me një lugë druri. M'u duk se pa u kthyer ajo hodhi një vështrim të shpejtë mbi mua; por nuk tha asgjë. Hoqa xhaketën dhe e vura të thahej. Ndieja që lumturia ngjitej si një ngrohtësi nga këmbët te pulpët, te kofshët, te gjoksi. Kisha uri dhe ndieja erën e gjellës që ngjitej nga kusia; duhej të ishin fasule, ato kundërmonin. Kuptova edhe një herë se lumturia mbi tokë është bërë për trupin e njeriut; ajo nuk është një zog i rrallë që ne e ndjekim herë në qiell e herë në shpirtin tonë. Lumturia është një zog i zbutur që jeton në oborrin tonë.

Plaka u çua, nxori nga një raft që ishte pranë saj dy pjata të thella, i mbushi, dhe koridori u mbush me erën e fasuleve. Ndezi një llampë dhe e vendosi mbi tavolinën e gjatë, solli dy lugë druri, një copë buke të zezë, ne u ulëm përballë njëri-tjetrit. Bëri kryqin, më hodhi një shikim të shpejtë, dhe unë e kuptova; bëra edhe unë kryqin. Filluam të hamë, të dy kishim uri. Nuk thoshim asnjë fjalë. Unë kisha vendosur; nuk do të flisja për të parë se si do të shkonte puna. Ndofta është memece, mendoja, apo ndoshta e marrë, një nga këto dy manitë e padjallëzuara që ngjajnë aq shumë me shenjtërinë.

Sapo mbaruam së ngrëni, ajo më përgatiti vendin për të fjetur mbi një bankë pranë tavolinës, unë u shtriva. Ajo u shtri përballë meje mbi një bankë tjetër. Jashtë, shiu binte çurg; për një kohë të gjatë dëgjoja ujrat që rridhnin mbi çati; dëgjoja frymëmarrjen e qetë të plakës; duhej të ishte e lodhur se sapo u shtri e zuri gjumi. Pak nga pak nën zhurmën e shiut dhe frymëmarrjen e rregullt të plakës unë rrëshqita në gjumë. Kur u zgjova dita hynte nga të çarat e derës.

Plaka tashmë ishte çuar, kishte vënë kusinë në zjarr dhe përgatiste

qumshtin për mëngjes. Tani e shihja nën dritën e dobët të mëngjesit. Ishte një plakë e rrëgjuar, me duar të fishkura, gjithë rrudha, me këmbë të thara, dhe në çdo hap që hidhte ndalej e mbushej me frymë. Vetëm sytë i ndrinin, të mëdhenj, shumë të zinj dhe nuk kishin aspak pleqëri. Sa e bukur do të ketë qenë kur ka qenë e re mendoja, dhe mallkoja fatin e njeriut.

U ulëm përsëri pa folur, përballë njëri-tjetrit, pimë qumshtin dhe unë u çova. Hoqa çantën nga supi dhe nxora portofolin... Por plaka u skuq deri te veshët dhe më shtyu dorën. - Jo, jo, pëshpëriti, jo! Unë pashë i habitur se fytyra e saj gjithë rrudha filloi të gjallërohet: - Lamtumirë, udhë të mbarë, - - thotë. - Zoti ta shpërbleftë të mirën që më bëre; qysh kur më ka vdekur burri, është hera e parë që unë bëra gjumë kaq të ëmbël.

Një kujtim akoma më i hidhur:

Në pranverë kisha arritur në qytetin më të shenjtë të Italisë, Asiz. Ajri, çatitë e shtëpive, kopshtet e vegjël, oborret ishin mbushur me praninë e padukshme të *të varfërit të Assizës*. Një të diel binin kambanat e mëdha të kishës së tij, ndërsa përballë nga një shesh i vogël iu përgjigjeshin kambanat e holla me tinguj argjendi të manastirit të shën Klerit. Shën Françesku dhe shën Kleri, gjithmonë të pandarë, përziheshin në ajër, me zërat e përjetshëm që atyre u kishte dhënë shenjtëria dhe vdekja. - "Kur do të vish ti vëlla Françesko të na shohësh, ne vajzat e gjora në manastirin tonë? - Kur të çelin gjembat e të na japin lule të bardha." Dhe ja prej shekujsh çelin gjembat, prej shekujsh përplasin krahët mbi Asizë, duke u bërë të pandashëm, pëllumbi i egër dhe pëllumbi i Zotit. Shkelja rrugët e ngushta, portat hapeshin, dukeshin femrat, të lara, të krehura mirë që mbanin erë livando. Ecnin drejt kishës me nxitim, të gëzuara për të parë e për t'u parë. Në atë vend me diell, në pranverë, kisha është salloni i Zotit; miqtë dhe mikeshat e tij ulen në radhët e karrigeve dhe bisedojnë herë me Zotin dhe herë me fqinjët e fqinjet. Shërbëtorët e Zotit, hyjnë e dalin, veshur me dantella të bardha dhe një fustan të kuq ose të zi, tundin zilen, psaltin me zë të ëmbël lëvdatat për të zotin e shtëpisë dhe drejtohen për nga dera. Ishte një vizitë që i bënin shenjtit. Qielli buzëqeshi i lumtur dhe aty poshtë në tokë u hapën tavernat.

Unë kisha letra rekomandimi për të ndenjur në banesën feudale të konteshës Eriketa. Ma kishin përshkruar si një plakë aristokrate që jetonte e vetme me një shërbëtore besnike, Ermelinda, dhe se do të ishte shumë e lumtur të kishte shoqërinë time. Kishte qenë zonja më e bukur e Asizës: e ngelur e ve në moshën njëzet e gjashtë vjeçe, nuk kishte njohur burrë tjetër. Kishte prona të mëdha, vreshta dhe ullinj, çdo mëngjes i hipte pelës dhe shkonte të vizitonte tokat e saj. Por tashmë ajo ishte plakur; kishte ftohtë, qëndronte ulur pranë oxhakut, e trishtuar, fjalëpakë, sikur i vinte keq për dëlirësinë e jetës së saj...

"Bëji muhabet, shikoje sikur të ishte njëzet e pesë vjeçe, jepi pak gëzim edhe pse tashmë është shumë vonë.

Ishte një ditë e ngrohtë pranvere, ktheheshin dallëndyshet, fushat ishin mbuluar me luleshqerra të bardha, ajri i ngrohtë kundërmonte. Por në oxhakun e shtëpisë feudale kishte zjarr dhe kontesha plakë qëndronte përpara tij, mbi një kolltuk të ulët, me një shallë të mëndafshtë ngjyrë smeraldi hedhur mbi flokët e bardhë. Vendosi letrën mbi gjunjë, u kthye nga unë e më shikoi. Nga e përpjeta që kisha ngjitur, ashtu i nxehur nga vapa, me gjoksin zbuluar, veshur me pantallona të shkurtëra, nën dritën e flakëve të zjarrit gjunjtë e mi shkëlqenin. Isha njëzet e pesë vjeç.

- Atëherë? thotë kontesha, dhe më buzëqeshi. - Në shtëpinë time ka hyrë gjithë Greqia; mirë se erdhët.

Ermelinda, shërbëtorja e saj, erdhi me një tabaka, ngriti një tavolinë të ulët, vendosi qumshtin, gjalpin, copat e bukës së thekur, frutat.

- Jam i lumtur, - iu përgjigja. - Këtu kuptova ç'është fisnikëria, bukuria dhe dashamirësia.

Buzët e zbehta të konteshës u skuqën por nuk thanë gjë; nën dritën e një gjuhëze flake unë pashë në sytë e saj një zjarr. Ajo sigurisht kishte menduar, me hidhërim: Në djall fisnikëria, bukuria dhe mirësia; asgjë nuk vlen më shumë se rinia, rinia, asgjë tjetër!

Ajo më dha një dhomë të madhe me një krevat gjigand mbuluar me një kuvertë kadifeje; dy dritare të mëdha binin mbi rrugë dhe prej andej, unë shikoja oborrin e manastirit të shën Klerit, ku venin e vinin të qeta, murgeshat me krahët e tyre të bardhë mbi kokë, kambanoren, çatinë, oborrin që ishte plot pëllumba; gjithë kuvendi

i grave psherëtinte, psherëtinte dashurinë si një pëllumb.

- Ç'bëjnë, murgeshat, me pëllumbat? - Ato nuk kanë turp, - më tha një ditë kontesha. - As i shikojnë, as i dëgjojnë, a nuk janë skandaloze? Ato vetëm i kapin, ose më mirë i vrasin dhe i hanë, për t'i hequr qafe, që edhe ne të mos i kemi nëpër këmbë.

Qëndrova tre muaj në Asizë; më mbanin shën Françesku dhe kontesha Eriketa, nuk më linin të ikja. Ku të shkoja? Në qoftë se qëllimi i jetës është lumturia , përse duhej të ikja prej saj? Ku mund të gjeja shokë më të sigurtë, më të dashur se shën Françesku, që shkoja ta shihja çdo ditë në shtëpinë e tij, shoqe më të këndshme se shën Kleri, ose të thuash më mirë gjallë-kontesha? Shëtisja i qeshur gjithë ditën nën hijet midis vreshtave dhe ullinjve, ndiqja gjurmët e shenjtit; pranvera më dukej si një proçesion françeskan me lule të kuqe, të verdha e të bardha. Shën Françesku me kortezhin e tij të luleve ngrohej nga toka e Asizës dhe përshëndeste vëllanë Diell, motrën Erë, motrën tonë të gëzuar Flakë dhe vëllain tonë të vogël Ujin... e pastaj përshëndeste konteshën dhe kretasin e lumtur që qëndronte pranë saj.

Në mbrëmje, i lodhur, i gëzuar, kthehesha në shtëpi. Në vatër kishte zjarr, kontesha qëndronte mbi kolltukun e ulët, e rregulluar, e pudrosur lehtë, me duar të kryqëzuara; ajo më priste. Gjithmonë e trishtuar, fjalëpakë, me sy të shuar; por sapo dëgjonte portën dhe dallonte zhurmën e hapave të mia, sytë i gjallëroheshin, më tregonte kolltukun pranë saj. Zgjaste dorën dhe e vendoste mbi gjurin tim:

- Fol, më thoshte, fol; hape gojën e mos pusho; është gëzimi im i vetëm.

Unë hapja gojën dhe flisja për Kretën, për prindërit e mi, për fqinjët; për luftrat që kishin bërë kretasit për liri, për princin Gjergj, kur kish shkelur në tokën kretase. Herë të tjera i flisja për irlandezen, për ngjitjen tonë në Psiloriti, për atë që kishim bërë kur kishim ngelur vetëm në kishën e vogël, pastaj për ndarjen tonë.

- Po përse? Përse? - pyeste kontesha. - Nuk të jepte gëzim? Të bënte të vuaje - apo një gëzim të madh, - si? - Por, ishte pikërisht kjo, kontesha ime. - Unë s'e kuptoj. - Aq shumë gëzim sa nuk i duhet një burri; isha në rrezik. - Në rrezik, nga se? - Nga dy gjëra: Unë do të isha mësuar me këtë gëzim dhe pas ca kohësh ai do të ishte

zbuluar e poshtëruar; ose më mirë nuk do të mësohesha dhe do ta provoja gjithmonë me të njëjtën forcë, dhe atëherë do të kisha humbur. Një ditë pashë një bletë të mbytur në mjaltë dhe e kuptova.

Kontesha u zhyt për pak çaste në kujtimet e saj.

- Ti je burrë, - thotë ajo më në fund, - e këto mendime ke në kokë, ti mendon të tjera gjëra, kurse ne femrat...

Atë mbrëmje, s'kishim ç'të thoshim më, shikonim zjarrin në heshtje, deri në mesnatë.

Ndonjëherë dërgonte Ermelindën për të më pyetur:

- A mund të vijë kontesha sot pasdite për vizitë? - Unë zbrisja, blija ëmbëlsira, lule dhe e prisja; në orën e caktuar, ajo trokiste lehtë duke hezituar, në portën time. Unë vrapoja për t'ia hapur, ajo hynte, e skuqur nga hutimi, sikur të ishte gjashtëmbëdhjetë vjeçe dhe shkonte në takimin e parë. Për pak kohë i lidhej goja, e nuk mund të fliste; përqendronte shikimin në tokë e përgjigjej shkurt, me një zë të këputur. Zemra më shtrëngohej; si mundet që të ktheheshin përsëri druajtja dhe virgjëria, si ngeleshin ato të pavdekshme tek femrat e vërteta, dhe i japin asaj një shkëlqim pa shpresë, shumë të hidhur, në pleqërinë e thellë.

Ditën kur do të nisesha, ajo m'u hodh në qafë dhe më detyroi të betohesha se do të kaloja në Asizë për ta parë.

- Por shpejt, - më tha dhe u përpoq të qeshë por nuk arriti se sytë iu mbushën me lot, shpejt, se ndoshta do të shkoj... ajo nuk thoshte kurrë do të vdes, por do të shkojë.

Unë e mbajta fjalën; disa vjet më vonë, mora një mesazh nga prifti rrëfyes i saj Don Dionizi; - Eja, kontesha po ikën.

Isha në Spanjë; dërgova një telegram dhe u nisa përnjëherë. Mbaja një buqetë me trëndafila të bardhë. Dridhesha duke trokitur në portën e saj: a jetonte akoma? Mos kishte vdekur? Portën e hapi Ermelinda, unë nuk guxova ta pyesja, i dhashë trëndafilët. - Kontesha po ju pret, më thotë, është në krevat, nuk mundet të ecë.

Gjysmë e shtrirë në krevatin e saj, e kishin krehur, rregulluar, i kishin vënë një të kuq të lehtë mbi faqet e zbehta dhe një shall të kuq, të mbështjellë rreth qafës duke i fshehur rrudhat. Ishte e para herë që unë e shihja me thonjë të lyer. Hapi krahët dhe unë u futa midis tyre. U ula pranë krevatit dhe e shikoja; sa e bukur ishte ako-

ma, edhe tetëdhjetë vjeç, çfarë dashurie dhe ankthi në sytë e saj!

- Unë po shkoj, - më tha ngrohtësisht, - po shkoj...

Hapa gojën për ta kundërshtuar, për ta ngushëlluar, por ajo më kapi dorën, si për të më thënë lamtumirë.

- Unë po iki, - pëshpëriti edhe një herë.

Kishte rënë nata, hyri Ermelinda për të ndezur llambën; - ajo nuk do, mos e ndiz Ermelinda.

Në muzgun e mbrëmjes dalloja dritën e dobët të fytyrës së saj, sytë që ishin kthyer në dy gropa mbushur me natë. Sa më shumë binte errësira, aq më shumë unë shihja se kontesha, e qetë, e pashpresë, po shkonte...

Pas disa orësh, rreth mesnatës ajo iku.

KTHIMI NË GREQI

Është e vështirë, shumë e vështirë, për shpirtin të shkëputet nga trupi i tij, nga bota, malet, nga detet, qytetet, njerëzit; shpirti është një oktapod dhe gjithë këto janë krahët e tij.

Italia zotëroi shpirtin tim, shpirti im zotëroi Italinë, ne nuk ndahemi më, u bëmë një; nuk ka në botë fuqi më grabitqare se shpirti i njeriut. Ai pushton, vazhdimisht pushton dhe perandoria e tij i duket gjithmonë e ngushtë, ai mbytet dhe do të sundojë botën që të mund të marrë frymë lirisht.

I tillë ka qenë udhëtimi im i parë ku unë njoha Evropën. Unë nuk e kuptova atëherë që në fillim, por kufijtë e provincave kishin filluar të ndriçonin tek unë, unë pashë se bota ishte më e pasur dhe më e madhe se Greqia dhe se bukuria, vuajtja dhe forca, mund të merrnin fytyra të tjera nga ato që u kishte dhënë Kreta dhe Greqia. Sa herë, duke parë trupat që shkëlqenin dhe dukeshin të pavdekshëm në pikturat e Rilindjes, unë pushtohesha nga një trishtim dhe zemërim i papërballueshëm, sepse këta trupa hyjnorë, që kishin qenë subjekti i këtyre pikturave, ishin kalbur. Bukuria dhe lavdia e njeriut nuk është gjë tjetër veçse shkreptima e një vetëtime që qëndron në dritën e diellit.

Dy plagët e mëdha kishin filluar të hapeshin përsëri tek unë... pas atij udhëtimi të parë, bukuria linte gjithmonë mbi buzët e mia një shije vdekjeje. Për këtë shkak shpirti im u pasurua duke gjetur një burim të ri rebelimi. Sepse shpirti i zjarrtë i djalit nuk pranon lehtë që bukuria të degradojë, që Zoti nuk shtrin dorën mbi të për ta bërë të pavdekshme. Në qoftë se do të isha unë Zoti, mendon një djalë i ri, do të shpërndaja me shumicë pavdekshëmrinë, nuk do ta lija kurrë të vdiste një trup i bukur, e as një shpirt fisnik. Por çfarë t'i bësh Zotit që i hedh në të njëjtën gropë të bukurit dhe të shëmtuarit, të këqinjtë e të zotët, që shkel me këmbë mbi ta, pa dallim, dhe që i bën të gjithë nga e njëjta baltë?

Mos ai është i padrejtë, i pafuqishëm, apo nuk kupton! Dhe djali, më shpesh pa e ditur, ndërton fshehtas, një Zot që nuk e zhgënjen zemrën e tij.

- Besoni ju në pavdekësinë e shpirtit? - pyetën një ditë Renanin; dhe ai, prestigjitator e finok u thotë: - Unë nuk shoh ndonjë arsye, që bakalli im të jetë i pavdekshëm. As unë. Por unë e shoh të arsyeshme që shpirtrat e mëdhenj të mos vdesin kur ndahen nga trupat.

Kështu, i dërrmuar kthehem në Greqi. Tek unë zienin revoltat intelektuale, tronditjet shpirtërore, konfuze, pa mundur të kthjellohesin; nuk dija ç'të bëja, në fillim doja të gjeja një përgjigje, përgjigjen time, për pyetjen e përhershme dhe më pas të vendosja ç'do të bëja. Në qoftë se unë nuk gjej, mendoja, qëllimin e jetës mbi tokë, si mund të futem në veprim? Dhe nuk pushoja së kërkuari. Mirëpo, e shikoja se ishte e pamundur dhe e kotë. - Cili është objektivisht qëllimi i jetës, i cili është dhe qëllimi im, inisiativa ime, të cilat unë i shikoja në përputhje me shpirtin dhe mendjen time? A do të ishte qëllimi i vërtetë apo jo, kjo s'kishte rëndësi për mua, porse ishte e rëndësishme ta gjeja, të krijoja një qëllim që të jetë në përputhje me mua dhe kështu duke e ndjekur atë, të zhvilloja në shkallë më të lartë pasionet dhe aftësitë e mia. Për këtë më duhej të bashkëpunoja në mënyrë harmonike me universin.

Në qoftë se ky lloj preokupimi metafizik, për një djalë, është sëmundje, unë në atë kohë isha i sëmurë rëndë.

Në Athinë gjendesha si në një shkretëtirë. Miqve të mi, problemet e përditshme të jetës, u kishin dërrmuar shpirtin dhe zemrën.

- Nuk kemi kohë të reflektojmë, më thoshte njeri... - Ne nuk kemi kohë të dashurojmë... - më thoshte tjetri. - Ty të intereson drejtimi i jetës? - më thoshte një tjetër duke qeshur.

Çfarë kërkon, mor i shkretë! Kjo më kujtonte përgjigjen që më kishte dhënë një fshatar kur e pyeta me kuriozitet se si quhej zogu ngjyrë blu që fluturonte sipër nesh; ai më pa plot qesëndi: - Çfarë kërkon mor i shkretë! Ai nuk hahet! Ndërsa një grykës që shoqëronte mikun tim, duke parë me një sy tallës ndërhyn:

- Do të them një këngë plot mirësjellje:

Ha, pi, dhit dhe pirdh ja jeta e njeriut!

Midis intelektualëve, kishte xhelozi të vogla e grindje po të vogla, thashetheme, kapadaillëk. Kisha filluar të shkruaja, për t'u ngopur me frymë, për të orientuar klithmën që fshihej brenda meje. U ngjita në Deksameni, ku gjendej foleja e madhe dhe e rrezikshme e grerëzave letrare, isha ulur në një qoshe, dëgjoja; nuk merresha me llafe, nuk frekuentoja tavernat, nuk luaja letra, isha i padurueshëm. Tri tragjeditë e para që unë ushqeja në vetvete më bënin të vuaja; vargjet që më vinin në kokë ishin akoma muzikë dhe përpiqeshin të kapërcenin zhurmën e rrëmujshme për t'u bërë fjalë.

MIKU IM POET

Tek unë, tri figura të mëdha përpiqeshin të merrnin fytyrë, të shkëputeshin nga brendësia ime, të çliroheshi e të më çlironin edhe mua, Ulisi, Niqifor Fokas, Krishti. Gjatë gjithë jetës unë kam qenë nën perandorinë e shpirtrave të mëdhenj heroikë. Ndofta nga që kur isha i vogël, unë lexoja me shumë pasion jetët e shenjtëve dhe digjesha nga dëshira të bëhesha shenjt. Më vonë, po me të njëjtin pasion, zhytesha në leximin e jetës së heronjve pushtues, eksploratorë, Don Kishotë! Dhe kur tek ndonjë figurë bashkohej heroizmi dhe shenjtëria, atëherë ajo bëhej për mua ideali i njeriut. Dhe në qoftë se nuk gjeja asnjërin e as tjetrin, përpiqesha të shkruaja, të ngushëllohesha për atë që nuk arrita dot.

"Ti je një dhi, - i thosha shpesh shpirtit, dhe përpiqesha të qeshja nga frika se mos mbytesha në lot, - ti je një dhi, shpirti im i shkretë; ti ke uri dhe, në vend që të hash mish dhe bukë e të pish verë, ti merr një fletë letër e shkruan: mish, bukë, verë. Dhe ti ha letër.

Por një ditë, shkëlqeu drita. Gjendesha në Kifisia, në mes të pishave, fare i vetëm në një shtëpi. Unë nuk kisha qenë kurrë mizantrop; i doja njerëzit, por nga larg; dhe kur dikush vinte për të më parë, tek unë zgjohej kretiani, i bëja festë atij që më vinte në shtëpi. Për një farë kohe isha i gëzuar, e dëgjoja, futesha tek ai dhe në qoftë se mund ta ndihmoja, i jepja ndihmë me gëzim; por në qoftë se njohja dhe diskutimi zgjatnin shumë, unë mbyllesha në vetvete dhe dëshiroja të rrija vetëm. Njerëzit e kuptonin se unë nuk kisha nevojë për ta, se unë mund të jetoja pa bisedën e tyre dhe ata kurrë nuk ma kanë falur.

Ka patur shumë pak njerëz me të cilët unë mund të jetoja gjatë pa u mërzitur.

Mirëpo një ditë, shkëlqeu drita. Atë ditë në Kifisia unë takova një djalë të moshës sime, që gjithmonë e kam dashur e çmuar, prania

e të cili ishte e këndshme për mua. Ai ishte shumë i bukur dhe këtë e dinte. Kishte shkruar një poemë të madhe, të pëlqyer për sensin poetik, për vargjet, gjuhën, për një harmoni magjike dhe unë nuk pushoja së lexuari e së gëzuari me të.

Ky poet, ishte i llojit të shqiponjave; me rrahjet e para të krahëve ai arrinte majat. Më vonë, kur filloi të shkruajë prozë, unë pashë se ai ishte me të vërtetë shqiponjë; kur ai nuk donte më të fluturonte por të ecte mbi tokë, ai ecte si shqiponjë, i rëndë e i ngathët; mbretëria e tij ishte ajri, Ai kishte krahë, nuk kishte shpirt të fortë: shikonte larg por turbull.

I mendonte imazhet, dhe krahasimet poetike ishin për të, argumenta logjik të palëvizshëm; kur ngatërrohej në arsyetime dhe nuk arrinte të gjente fundin, një imazh vezullues e përshkonte si dritë, ose më saktë, ai shpërthente me një të qeshur vibrues dhe me të mbaronte.

Po, ai kishte shumë cilësi, një nur e një sjellje të rrallë. Ta shihje kur fliste, syri i tij blu ndriçonte, duhej ta dëgjoje kur recitonte poemat, që i bënte të dridheshin xhamat e dritareve, për të kuptuar se ç'kishin qenë rapsodët e antikitetit të cilët me kurora vjollcash ose degë hardhish, shkonin pallat më pallat dhe zbutnin me këngët e tyre, njerëzit që akoma ishin bisha. Me të vërtetë, që në çastin e parë që e pashë, kuptova se ky djalë nderonte racën njerëzore.

U bëmë menjëherë miq. Ne ishim shumë të ndryshëm nga njëritjetri dhe shpejt kuptuam se secili kishte nevojë për tjetrin dhe se të dy së bashku do të realizonim një njeri të kompletuar. Unë i ashpër, i kursyer në fjalë, në koren time të fortë popullore; plot pyetje, ankth e metafizikë, shkëlqimi i fasadës nuk më gënjente kurrë, prapa fytyrës së bukur shikoja një kokë të mençur. Pa asnjë djallëzi e pa asnjë siguri, unë nuk kisha lindur princ, por përpiqesha të bëhesha. Ai gazmor, madhështor e i sigurt në veten e tij, kishte një trup të bukur, bindjen e thjeshtë dhe të përforcuar se ishte i pavdekshëm; ai ishte i bindur se kishte lindur princ dhe nuk kishte nevojë të vuante e as të përpiqej për t'u bërë i tillë; as të dëshironte majën, ai tashmë gjendej atje, në majë.

Ai mendonte me vetëdije të qartë, se ishte i vetëm dhe i pazëvendësueshëm; nuk pranonte të krahasohej me asnjë krijues të madh,

të vdekur apo të gjallë dhe kjo padjallëzi atij i jepte siguri dhe një forcë të madhe.

Një ditë unë i thashë se mbretëresha e bletëve, ditën e martesës, ngrihet në ajër dhe një ushtri e madhe meshkujsh e ndjekin dhe për piqen të bashkohen me të. Vetëm njëri e arrin, ai bëhet dhe burri i saj, bashkohet me të, ndërsa gjithë të tjerët rrëzohen në tokë dhe ngordhin.

- Të gjithë pretendentët, i thashë, vdesin të lumtur, sepse të gjithë e dinë, se ata nuk bëjnë gjë tjetër, veçse atë gëzimin martesor.

Por miku im shpërtheu me një të qeshur tronditëse: - Ato që më the, nuk i kuptova të gjitha. Unë dua që burri të jem unë dhe vetëm unë.

Edhe unë fillova të qesh: - unë, - ju përgjigja, duke i kujtuar fjalën e një tjetri të shquar, - mendoj se jam unë që kurorëzohem ndërsa të tjerët triumfojnë. Shpirti nuk quhet kurrë unë; ai quhet: ne të gjithë.

Më vonë kur e njoha më mirë, një ditë i thashë:

- Ndryshimi i madh që ekziston ndërmjet nesh Angjelos, është se: ti beson se ke gjetur kënaqësinë, dhe prandaj je i kënaqur; ndërsa unë mendoj se nuk ka kënaqësi dhe, duke e besuar atë, unë jam i kënaqur.

Megjithatë një dobësi shumë simpatike, shumë e ngrohtë, i kishte zënë pusinë brenda tij; ai kishte një nevojë absolute të duhej e të admirohej. Në qoftë se do të depërtoje në fytyrën e tij triumfuese dhe në sigurinë tronditëse, do të kishe parë një zotëri të shqetësuar që u shtrinte dorën kalimtarëve. Njëri nga miqtë e tij të vjetër, shumë cinik, më tha një ditë:

- Ai luan sulltanin, por është një sulltane.

Shumë, nga xhelozia, nga antipatia për fryrjen në jetën e përditshme, e konsideronin komedian; thoshin se ai nuk beson në asgjë dhe gjithçka bënte dhe thoshte ishin gënjeshtra dhe krekosje.

Një pallua femër që vazhdimisht hap krahët farfuritës; por po ta rrjepësh, do të shikosh se është një pulë e zakonshme dhe e parëndësishme...

Jo, ai nuk ishte komedian; jeta e tij e jashtme, fjalët e tij të mëdha, pompoziteti, mburrjet e tij, bindja se ai ishte i vetmi në botë dhe se mund të bënte mrekulli po të donte, buronin nga një sinqeritet abso-

lut nga një siguri e brendshme; ai nuk shtirej duke thënë se ishte i vetëm, ai e kishte bindje të padiskutueshme.

Ishte i aftë të vinte dorën në zjarr duke qenë i sigurt se nuk do të digjej; të futej në luftë me sigurinë se asnjë plumb nuk do ta kapte; ai hante shumë dhe mburrej për këtë se ai ishte i sigurt që e transformonte në shpirt, gjithçka hante. Ndërsa të tjerët... - thoshte, e qeshte me të madhe.

Një ditë ndërsa shëtisnim nëpër rrugët e Athinës së vjetër, ai më tha: - Unë e ndjej se kam Zotin brenda vetes sime, kaq fort ndjej sa sikur ti të prekësh dorën time në këtë çast ajo do të lëshojë shkëndija.

Unë nuk fola.

- Çfarë, ti nuk e beson? - më tha kur më pa se unë heshtja. Provoje preke! Dhe më shtriu dorën.

Nuk doja të tallesha. - Mirë, - i thashë, të besoj; pse duhet ta provoj? Isha shumë i sigurt se nuk do të lëshonte shkëndija. I sigurt? Kush e di... tani më vjen keq që nuk e provova.

Ai komedian? Do të ishte i tillë në qoftë se do të luante thjeshtësinë dhe modestinë. Porse ai ishte njeriu më i sinqertë që në mënyrë aksidentale i kalonte kufijtë e komikes duke hyrë në fushën përvëluese dhe të rrezikshme të delirit.

Ne banonim të dy në një shtëpi fshati, në një pishnajë në breg të detit. Lexonim Danten, Testamentin e vjetër, Homerin, ai më recitonte vargjet e tij, me zë kumbues, shëtisnim gjatë. Ishin ditët e para të njohjes sonë, fejesa jonë. Për mua ishte një gëzim i madh që kisha gjetur një njeri që nuk mund të merrte frymë, veç në lartësinë më të madhe të dëshirave. E shkatërronim dhe e krijonim përsëri botën, të dy ishim tmerrësisht të sigurt se shpirti është i gjithëfuqishëm. Ai këtë e mendonte për shpirtin e tij ndërsa unë për shpirtin e njeriut.

Një mbrëmje, kur po përgatiteshim për shëtitjen tonë të zakonshme, dhe po rrinim akoma në këmbë te pragu duke parë detin, u duk tek vinte duke vrapuar postieri i fshatit. Nxori nga çanta një letër, ia dha mikut tim, pastaj u përkul për t'i thënë diçka në vesh.

- Ka gjithashtu edhe një pako të madhe për ju... - tha ai me një zë si të lemerisur.

- Miku im nuk e dëgjoi, ai lexonte letrën dhe fytyra i skuqej.

Shtriu dorën, më dha letrën:

- Lexo...

E mora dhe lexova: "Buda im i vogël, fqinji ynë i shkretë, rrobaqepësi vdiq. Të lutem ngjalle përsëri", i shkruante gruaja e tij.

Miku im më shikonte i shqetësuar: - A mundem unë? E beson ti?

- Unë ngrita supet: - Nuk e di iu përgjigja; në këtë rast, është e vështirë.

Por postieri e nxitoi.

- Ç'të bëj me pakon? Pyeti dhe u bë gati të nisej.

- Sille! - thotë shpejt miku im. U kthye përsëri nga unë dhe më pa sikur priste që unë ti jepja kurajo, por unë ndjeja një dobësi të madhe dhe heshtja.

Qëndronim të palëvizur dhe prisnim, dielli ulej drejt perëndimit, deti kishte marrë ngjyrë rozë të thellë. Miku im kafshonte buzët dhe priste.

Pak më vonë u dukën dy fshatarë që mbanin një arkivol mizerabël; brenda ishte rrobaqepësi.

- Ngjiteni lart! - urdhëroi miku im, dhe fytyra rrezatuese iu vrenjt.

U kthye edhe një herë e më pa:

- Si mendon ti? - më pyeti përsëri. Shikimi i tij i shqetësuar ishte ngulur te sytë e mi. - Si mendon? Do të mundem vallë?

- Provoje, i thashë; unë do të shëtis.

Shëtita përgjatë bregdetit; thitha erën e pishave dhe të detit.

"Tani do të duket, mendoja, në është një komedian apo një shpirt tmerrësisht i guximshëm, i gatshëm të dëshirojë dhe të ndërrmarrë të pamundurën. Do të përpiqet të ngjallë të vdekurin ose më mirë, plakun finok, do të trembet nga shaka të tilla e do të shkojë i qetë të flerë në krevatin e tij? Sonte do ta shohë. "Unë dridhesha nga ideja se, tashmë, shpirti i mikut tim, kishte përpara meje kaq peshë dhe marshonte me hapa të nxituar, i tronditur."

Dielli ishte futur në det; vaji i parë i kukuvajkave kishte filluar të dëgjohej nëpër pisha, i butë dhe gjithë hidhërim; atje larg, majat e maleve ishin zhytur në errësirë.

Me dëshirë e zgjata shëtitjen, sepse po provoja një ndjenjë të papëlqyeshme të kthehesha në shtëpi. Në fillim prania e të vdekurit më bezdiste, unë asnjëherë nuk kam qenë përballë me një të vdekur

pa u dridhur nga neveria dhe frika; pastaj doja ta zgjasja sa më shumë të ishte e mundur çastin kryesor.

Kur mbërrita në shtëpi, dhoma e mikut tim, që gjendej mbi timen, ishte gjithë dritë. Unë doja të haja, por u shtriva për të fjetur. Por nuk arrita të mbyllja sy. Gjatë gjithë natës dëgjoja ulërimat e shurdhëta dhe krevatet që kërcisnin, pastaj pas hapash të rënda në të gjitha drejtimet, për një kohë të gjatë, përsëri dëgjoja mikun tim që psherëtinte thellë dhe hapte dritaret sikur i zihej fryma dhe donte ajër. Isha i lodhur dhe afër mëngjesit më zuri gjumi, u zgjova vonë dhe dola vonë. Miku im ishte ulur përpara tavolinës, qumështin e kishte përpara; nuk e kishte prekur. Kur e pashë u tremba: dy rrathë ngjyrë blu i rrethonin sytë, ishte i zbehtë dhe buzët i kishte të bardha. Nuk i fola, u ula pranë tij i hidhëruar dhe prita.

- Bëra ç'munda, - thotë më në fund, - sikur kërkonte falje; ty të kujtohet sesi profeti Elize ka ngjallur një të vdekur? Ai shtrihej mbi të, ngjishte gojën e tij pas gojës së të vdekurit, i jepte frymë nga fryma e tij dhe bërtiste; të njëjtën gjë bëra dhe unë...

Pastaj heshti, pas një çasti: - Gjithë natën... gjithë natën... por më kot!

U trullosa nga habia; shikoja mikun tim dhe e admiroja; ishte bërë qesharak por e kishte kaluar, kishte arritur në kufirin tragjik të delirit dhe tani kthehej, qëndronte ulur përpara meje, i divorcuar.

U çua, eci deri afër portës, pa detin përpara tij, fshiu ballin ku nuk pushonin së vezulluari pikla të mëdha djerse. U kthye nga unë:

- Po tani? - më pyeti - ç'të bëj?

- Thirr priftin ta varrosë, iu përgjigja, ne do të shkojmë të shëtisim në breg të detit.

I dhashë krahun, dridhesha i tëri. Hoqëm këpucët, çorapet dhe u futëm në ujë; u freskuam. Ai nuk fliste, por e ndjente se freskia e detit dhe pllaquritjet e lehta e qetësonin.

- Më vjen turp, - pëshpëriti me në fund. - Shpirti pra nuk është i gjithëfuqishëm?

- Akoma nuk është i tillë, ai do të bëhet një ditë. Është shenjë e një trimërie të madhe që kërkon të kalojë kufijtë e njeriut; por ka shumë trimërira të pranueshme që nuk kalojnë këto limite dhe nuk të zhgënjejnë. Ne do të përplasim kokat tek shufrat e hekurit deri

sa ato të jenë bërë thërrime dhe një ditë shufrat e hekurta do të thyhen.

- Unë doja të ishte koka ime që t'i thyente, - thotë, dhe në shenjë dëshpërimi hodhi një gur të madh në det. - Unë, unë, - thirri, - dhe askush tjetër.

Unë qesha; "Unë! Unë!". Ja burgu i tmerrshëm, pa porta, pa dritare ku qe mbyllur miku im.

- Cila është maja më e lartë ku mund të arrij njeriu? - i thashë duke u përpjekur ta ngushëlloja. Të më mundësh mua. Kur ne të arrijmë këtë, Angjello, vetëm atëherë jemi çliruar.

Nuk u përgjigj por vetëm godiste ujin me këmbët e zbathura.

Ajo që na ndante ishte rënduar.

- Kthehemi, - tha, - jam i lodhur.

Ai nuk ishte i lodhur, ishte i nxehur.

Kur arritëm në shtëpi, për të shmangur ndonjë të keqe, unë zgjata dorën drejt bibliotekës së pasur të mikut tim.

- Shiko, i thashë, unë do të mbyll sytë dhe do të marr një libër: ai do të vendosë.

- Çfarë do të vendosë? - thotë miku im i nervozuar.

- Se ç'do të bëjmë nesër.

Mbylla sytë, preka dhe shtrëngova një libër; ai ma hoqi nga dora dhe e hapi; ishte një album i madh fotografish; manastire, kisha këmbanare, qipariza... zgavra mbi gremina dhe poshtë një det i papërmbajtur...

- Mali Athos! - thirra.

Fytyra e mikut tim filloi të çelet. - Këtë doja! - Thirri. - Këtë e dëshiroja prej vitesh e vitesh. Shkojmë atje.

Hapi krahët dhe më shtrëngoi fort.

- Ti gati je? - më tha. - Mbathim çizmet me shtatë lidhëza. A nuk jemi gogola ne? Mbathim çizmet me shtatë lidhëza për të shkelur tokën e malit Athos.

MALI ATHOS

Binte shi. Maja e Athosit, mbuluar me një mjegull të dendur ishte zhdukur. Deti ishte i qetë, i ngjeshur si baltë. Midis një pylli me gështenja, të nxira nga shiu, shkëlqente një manastir krejt i bardhë. Shiu binte qetë, sikur binte për të vaditur, dhe, qielli kishte zbritur aq poshtë sa gati prekte majat e pemëve; pesë gjashtë murgjër qëndronin duke u lagur, drejt, si qipariza.

Pranë nesh, në varkën që na kishte çuar në portin e vogël të Malit Athos, Dafni, dy murgjër diskutonin. Njëri prej tyre, më i riu, që kishte mjekër të zezë të rrallë dhe një çantë të rëndë mbi sup, thoshte: - Kur e dëgjon atë të psaltë, e harron botën: zëri i tij është më i ëmbël se ai i një babai apo i një nëne.

Tjetri përgjigjej: - Çfarë më tregon? Ne në manastir kemi një mëllënjë që kur psalt "Zot unë thërras drejt teje" dhe "Krishti u ngjall" shastiset. Ne e thërresim At Mëllënja; ai vjen në kishë me ne dhe gjatë pashkëve nuk ha - nuk duhet të jetë mëllënjë, At Laurent, - thotë djaloshi, mendueshëm, - ai nuk duhet të jetë mëllënjë.

Shkelëm në tokat e shenjta. Murgjërit që qëndronin në këmbë mbi skelat, shikonin me vëmendje të madhe ata që zbrisnin nga varka, se mos midis pasagjerëve gjendej e fshehur, ndonjë grua, e veshur si burrë. Prej mijëra vjetësh, qysh kur Mali Athos u quajt i virgjër, asnjë grua nuk ka shkelur atje, asnjë frymëmarrje femre nuk ka fëlliqur ajrin, bile asnjë kafshë femër - dele, dhi, pulë, mace. Veç ka disa frymë të këqia që e fëlliqin.

Të dy murgjërit që kishin udhëtuar me ne, ngarkuar si mushka, nxituan hapat për të na arritur.

- Pelegrin? - thotë më i riu dhe na buzëqeshi. Zoti ju ndihmoftë! Eremitët janë të çmendur për biseda. Filluan të flasin për mrekullitë, për shenjtorët, për asketët, që, buzë greminave, ngrenë duart e luten.

- Sa kohë që do të mbajnë duart lart thotë më i riu, mos keni fri-

kë, bota nuk përmbyset; janë ata që e mbajnë dhe e pengojnë të përmbyset.

- Kurrë nuk ka ardhur ndonjë femër në malin Athos? - e pyeta.

- Kurrë, kurrë, - përgjigjet më i vjetri, dhe pështyu në ajër. - Zbythu, satanë! - pështpëriti me zë më të ulët.

- Dikur, thotë më i riu, një grua u përpoq, duke u veshur si burrë, të zbresë, por rojtarët murgjër e dalluan menjëherë dhe e ndoqën.

- Nga se e kuptuan ata? pyeta mikun tim; ai filloi të qeshë.

- Nga era, u përgjigj murgu i ri, qëndroni, kërkojani t'jua shpjegojë, ky plaku që ka qenë dikur roje te skela.

Miku im u kthye nga murgu i vjetër: - gratë kanë erë të ndryshme, at i shenjtë? - e pyeti. - Çfarë ere kanë?

- Një erë të keqe qelbësi, - përgjigjet plaku duke nxituar. Shiu filloi të qetësohet, në shtresat e sipërme të ajrit duhej të frynte, retë u përhapën dhe u duk pak diell. Toka përnjëherë filloi të buzëqeshë, akoma e lagur nga lotët dhe së bashku me diellin u duk një ylber i zbehtë që qëndronte pezull duke bashkuar qiellin me tokën.

- Brezi i virgjëreshës! Thanë dy murgjërit dhe bënë shenjën e brezit.

Me çantën mbi shpinë, duke u mbështetur mbi shkopinjtë prej lisi, vazhdonim të ngjisnim, midis një pylli të dendur gështenjash me kokrra gjysmë të zhveshura, xanash dhe dafinash me gjethe të gjera, rrugën e kalldrëmtë që të çonte në korie. Ajri mbate erë rrëshirë. Na dukej se gjendeshim midis një kishe të madhe: deti, pyjet e gështenjave, malet dhe sipër në vend të kupolës, qielli i hapur.

U ktheva nga miku im: - përse nuk flasim? - i thashë duke dashur të thyej qetësinë që më rëndonte.

- Ne po flasim, - më përgjigjet, duke më prekur lehtë në sup, - ne po flasim, por në gjuhën e engjëjve, qetësisht.

Dhe përnjëherë, sikur e kapi inati.

- Çfarë do ti që të bisedojmë? Që është kaq bukur, që zemra jonë është bërë me krahë dhe kërkon të fluturojë, që ne kemi nisur një rrugë që të çon në parajsë? Fjalë, fjalë! - Dhe heshti përsëri.

Dy mëllenja fluturuan nga një arrë, degët e lagura u tundën dhe pikat e shiut na spërkatën fytyrën.

- Edhe zogjtë kanë murgjit e tyre, - thotë më i moshuari i murgjëve,

janë mëllenjat; Mali Athos është i mbushur plot.

- Po yjet, pyeti murgu i ri, edhe ata kanë murgjit e tyre, At Laurent.

- Gjithë yjet, vëlla, u përgjigj tjetri, ishin dikur murgjër që dëshmuan mbi tokë për besimin te Krishti dhe u ngjitën në gjirin e Abrahamit. Gjiri i Abrahamit, e di ti, është qielli.

Unë i dëgjoja dhe admiroja shpirtin e njeriut që aq fuqishëm, mund të transformohej dhe t'i nënshtrohej ëndrrës së tij. Rreth një figure të pandryshueshme Krishtit, besnikët rrotullojnë qiellin, tokën dhe i detyrojnë të vihen në shërbimin e tyre. Krishti është përgjigja e madhe për gjithë pyetjet e tyre. Gjithçka shpjegohet, ndriçohet, rregullohet dhe shpirti qetësohet. Vetëm ai që nuk e beson pyet, jeton në ankth, humbet rrugën, humbet shpresën.

Disa ditë pasi kishim hyrë në Malin Athos, një asket gjysmë i marrë, që strehohej në një shpellë e cila gjendej në një lartësi që kontrollonte detin, më tha një fjalë që më mbylli gojën.

- Ti ke humbur shpirtin, mor i shkretë, - i thashë për ta ngacmuar.

Ai filloi të qeshë: - Unë e kam dhënë shpirtin, - më tha, - dhe kam marr Zotin; domethënë: unë kam dhënë një sy që edhe ai nuk ishte i mirë dhe bleva parajsën. Si mendon, mor bir, kam bërë pazar të keq?

Heshti për një çast, pastaj: - Do të të tregoj edhe diçka tjetër, që ta dish, - më tha. - Ishte njëherë një mbret i madh, i bukur, ngrënës i madh, gazmor, që kishte 365 femra në haremin e tij. Një ditë shkoi në një manastir dhe pa një asket: "Çfarë sakrifice të madhe bën ti! - i thotë dhe e pa me një farë mëshire." "Sakrifica që bën ti, mbret, është më e madhe, i përgjigjet asketi. - Si është e mundur?" Sepse unë humbas botën e përkohshme, ndërsa ti botën e përjetshme."

Pranë nesh, midis gështenjave, u dëgjua një zile që lajmëronte për shërbimin e mbrëmjes; në të kthyer të rrugës u duk një fshat murgjish. Ne nxituam hapat.

Bukëpjekës, tregtarë zarzavatesh, guzhinierë, tregtarë çimçakizësh, pastrues, të gjithë ishin murgjër. Një fshat i trishtuar e i padurueshëm meshkujsh, pa një grua, pa një fëmijë, pa një qeshje. Asgjë tjetër, veç mjekrave, të zeza, të verdha, brune, gri, të bardha; disa me majë, të tjera të gjera si fshesa, të tjera akoma të dendura, të

përdredhura, të ngatërruara si lulelakra.

Shkuam në qendër, vendi ku qëndrojnë Epitropet e njëzet kuvendeve; të ulur mbi frona, ata na shikonin me sytë dinakë, plot mosbesim, ju thamë kush ishim; dy kristianë, që vinim në peligrinazh me dëshirën e madhe t'i shërbenin Zotit. Ne jemi akoma të rinj, u thamë, dhe përpara se të futemi në vuajtjet e kësaj bote, përpara se të martohemi, erdhëm këtu në kopshtin e virgjëreshës, që vullneti i saj të na ndriçojë dhe të na tregojë rrugën; ne kemi ardhur këtu t'i kushtohemi vullnetit të saj.

Miku im fliste me zërin e tij kumbues, me tingëllim poetik, me pasion, murgjit rrinin gojëhapur, disa shtrëngonin mjekrat, të gjithë dëgjonin. Sa më shumë fliste miku im aq më qartë shikoja dhe kuptoja cila qe arsyeja e vërtetë që ne kishim ardhur në Malin Athos. Miku im sigurisht nuk e dinte, ai e kishte gjetur duke folur.

Murgjit i folën në vesh njëri-tjetrit, pëshpëritën diçka, u çuan të gjithë dhe na dhanë lejen me shkrim për të vizituar, për të kryer përkushtimin tonë në të gjithë manastiret dhe të qëndronim deri sa vullneti i virgjëreshës të na thoshte sę udhëtimin ynë kishte marrë fund.

Pelegrinazhi filloi. Si pelegrin të vjetër flisnim me zë të ulët për Zotin, për fatin, për njeriun dhe për detyrën tonë. Këto tri tema ishin kryesoret në gjithë bredhjet tona, shkonim nga manastiri në manastir, nga mrekullia në mrekulli, në gjendje ekstaze, të lumtur. Unë mbaja ditar ku shkruaja të rejat e ditës. Tani pas dyzet vjetësh, ashtu të zverdhur, unë e shfletoj dhe kujtoj ato ditë hyjnore, të pabesueshme, çdo fjalë, bile më e pakuptimta, ringjall tek unë gëzimet, dëshirat, pasionet, shqetësimet e rinisë sime, projektet e çmendur që bënim, unë e miku im, për të shpëtuar shpirtin tonë.

Manastiri i Ivrionit, 19 nëntor. - Këtë mëngjes, shëtitëm në breg-det. Bekim. Një kishë e vogël me një ikonë të virgjëreshës, gjaku i rrjedh mbi faqe. Dy murgj peshkatar nxjerrin rrjetat, peshqit kërcejnë brenda. Kthehemi në manastir; çfarë mrekullie. Virgjëresha e portretizuar, rojtare e portës; dy sy të mëdhenj, të trishtuar, me një hidhërim të thellë, gjithë gëzimi dhe mundimi i njeriut. Në mbrëmje, çfarë çasti hyjnor kur pamë detin tërësisht të bardhë që psherëtinte, dhe sipër hëna e plotë. Hëna sonte, tregon prirjen e saj të vërtetë,

më tha miku im: Ajo ndriçon përjetësinë. Bisedonim me zë të ulët, mbështetur tek njëri-tjetri, të prerë, thamë: duhet që në çdo çast ne të jetojmë përjetësinë.

Kudo shkojmë, na shoqëron një murg i qetë, i zbehtë, i sëmurë, vazhdimisht kollitet, kruhet, por fytyra i shkëlqen, nga lumturia.

- Duhet të jetë budalla, më thotë miku.

- Duhet të jetë shenjt, i them unë; nuk e sheh si i ndrin fytyra?

Duket, sikur mbi të bie një diell.

Ndalemi, ai afrohet: - Unë jam At Laurenti, na thotë, ju ndoshta bisedoni për mua se jam budalla.

- Ti je i lumtur, i thotë atij miku im; ti ke hyrë i gjallë në parajsë; fytyra jote shkëlqen.

- Lavdi Zotit, përgjigjet murgu, dhe bëri kryq. Atë që të tjerët e quajnë marrëzi unë e quaj Parajsë.

Por unë kam vuajtur shumë që të hap portën. Çfarë porte? - Të parajsës, vëllai im. Në fillim, kur hyra në manastir, unë qaja, dridhesha, kisha frikë; mendoja për parajsën dhe qaja, mendoja për ferrin dhe qaja. Por një mëngjes, kur u çova: - Përse të qaj? - i thashë vetes. Zoti, a nuk është babai im? A nuk jemi ne fëmijët e tij? Atëherë përse të kemi frikë? Prej asaj dite më quajnë budalla.

Nxori nga këmisha një copë bukë të tharë e na i dha.

- Është buka e ëngjëjve, - na tha; - hani; që t'ju japë krahë dhe juve, t'ju lumturoj.

Manastiri Stevronikitë, 21 nëntor. - Lartësi e çuditshme mbi det. Portieri plak, rrënojë antike e ardhur nga Kreta, më shtrëngonte nga dora - Kush je ti? - Kretian? - Hyr! Në një kamare disa murgjër të rinj mësonin muzikë bizantine dhe theksonin notat me zë të lartë. Ata vazhdonin traditën me nga një qiri të ndezur në duart e tyre të holla prej fëmije, sipër kullës së kuvendit dukej deti me hapësirën e tij të pafund.

Më poshtë, bëhet fjalë për të njëjtin manastir. Plot inteligjencë, seriozitet hyjnor i parakohshëm, Krishti në moshën dymbëdhjetë vjeçare! Një ballë të lartë si kala, me gjoks të bardhë si bora, shikim të thellë e të mrekullueshëm. Një ikonë e madhe: Shën Nikolla i përshndritshëm; ai mbante ngulur mbi ballë një guaskë perle të madhe ndërsa duart i dukeshin se rridhnin ujë të kripur.

Bisedoj me portierin kretan: - Si je bërë murg? - Një ditë tezja më lexoi ungjillin dhe unë i thashë: bota është e kotë. Nuk e harroj kurrë, At Filimonin që na shërbente në tavolinë, me një trup të hollë si fletë damasku, si engjëll, gjithë zjarr. Gëzohej shumë të shërbente dhe të urdhërohej, dëshironte shumë t'i jepnin urdhëra dhe gëzimi i tij ishte aq i madh sa nuk e mbante të qeshurin; qeshte gjatë gjithë kohës. - Kur do ta shikoj Zotin edhe unë? - e pyeta. - E thjeshtë, më tha, shumë e thjeshtë. Hap sytë dhe do ta shohësh.

Manastiri i Pantokratorit. - Para se të gdhihej, në oborrin e manastirit, u dëgjuan tinguj shumë të ëmbël, një melodi e magjishme. Dola në dritare dhe ashtu në mugëtirën e mëngjesit pashë një murg me një pelerinë të zezë, që mbante në duar një instrument muzikor druri mjaft të lartë mbi të cilën godiste me kujdes një çekiç. Ai ecte ngadalë, shkonte kamare më kamare, rreth e rrotull oborrit, dhe thërriste vëllezërit për shërbesën e mëngjesit. Ishte zgjuar edhe miku im; ai u mbështet në dritare pranë meje dhe të dy dëgjonim të lumtur. Instrumenti prej druri pushoi, ne u veshëm dhe zbritëm në kishë. Errësirë; vetëm dy kandila digjeshin përpara ikonës së Krishtit dhe nënës së tij, mbi ikonostaz; ajri kundërmonte era dyllë e temjan.

Qetë, ëmbël, si fëshfërimë pemësh, si psherëtima e detit, filluan psalmet e mëngjesit. Igumeni, me një llambadhe të ndezur në dorë afrohej pranë çdo stoli, njëri pas tjetrit, për të parë në qoftë se të gjithë vëllezërit kishin zbritur, pastaj zhyste spërkatësin në ujin e bekuar dhe spërkaste me forcë ballin e çdo murgu. Çfarë ritmi hyjnor, thoshim duke shëtitur nëpër oborr, çfarë guaske e gdhendur në mënyrë të mrekullueshme; nga brezi në brez; por ai që e punoi dhe e zbukuroi ama ka vdekur.

"Duhet, dhe për këtë të betohemi, që ne t'i riorganizojmë këto shërbesa të krishtera, që t'u japim një frymë të re, një frymë krijuese. Jo vetëm duhet, por, për këtë arsye edhe kemi ardhur në Malin Athos."

Një mëngjes parajse, i butë, mbushur me shpirtmadhësinë e Zotit, që na afrohej nga Vatopedi i famshëm. Dukej sikur ishte dita e pestë e krijimit, kur zoti akoma nuk kishte krijuar njeriun për të prishur

botën. Lindja hapej ngadalë si trëndafil, ndërsa në fund të qiellit, dukeshin re të vogla, si engjëj me faqe të lagura nga vesa, që, duke u zmadhuar ngadalë, dukeshin sikur zbrisnin mbi tokë. Një mëllenjë, me krahët e mbushura akoma me vesë, qëndroi në mes të rrugës, na shikonte; ajo sigurisht nuk kishte frikë dhe nuk fluturoi; nuk ishte mëllenjë, por një shpirt dashamirës që na njihte. Një kukuvajkë e vogël, mbi një shkëmb, e tulatur nga dita, qëndronte e palëvizur sipër tij, e qetë, duke pritur natën.

Ne nuk flisnim. E ndjenim të dy se këtu zëri i njeriut, sado i dobët e i qetë që të jetë, do të ketë një rezonancë depërtuese e shungulluese; dhe se velloja magjike që na mbështillte do të grisej. Ne ecnim, duke thyer degët e ulta të pishave, që na spërkatnin fytyrat dhe duart me piklat e vesës së mëngjesit. Ndjeja një lumturi të madhe; u ktheva ngà miku im, hapa gojën për t'i thënë: "Çfarë lumturie!... "Por nuk guxova; e dija se po të flisja, magjia do të humbiste. Më kujtohet një ditë në Taiget, mbi Spartë, se duke rënë nata pashë një dhelpër që ecte si një vegimtar, me qafën të shtrirë, bishtin të kreshpëruar e po ashtu të shtrirë, që bënte një hije të gjatë ngjyrë vjollcë mbi gurë. Mbajta frymën nga frika se mos më dallonte dhe ikte; por nuk arrita të mbaj gëzimin dhe një klithmë e vogël më shpëtoi; dhelpra e dëgjoi dhe pa më lënë kohë ta shoh kur u nis, u bë e padukshme.

Gjatë gjithë jetës sime kështu më është shfaqur lumturia e njeriut.

Papritur dëgjuam zëra dhe të qeshura; Kemi arritur në manastir. Te porta pamë dy murgjër të shëndoshë, ulur mbi një bangë guri, që bënin shaka me portierin.

Ndaluam përnjëherë sikur të kishim parë një gjarpër; miku im më pa dhe tundi kokën.

- Një ëndërr, - më tha, - ne besonim se këtu nuk ekzistonte njeri.

- Sa keq, - përgjigjem. Parajsë e vërtetë, më e shquar se të tjerat; nuk ishte më një burrë e një grua që shëtisnin nën pemët e Zotit, por dy miq. Ja pra, ku u shfaq, jo engjëlli me shpatën me dy presa, por njeriu me zërin e tij që na ndjek pas.

Të dy burrat bërtisnin me zë të lartë, ngacmonim portierin.

Qeshnin me të madhe kush e kush më shumë. Por sa na panë ne, pushuan. Rregulluan barqet dhe u çuan.

- Mirse erdhët, zoti ju bekoftë, - thanë dhe secili shtriu dorën, për t'ua puthur.

- Qënkeni mirë me shëndet, etër të shenjtë, - thotë miku im, duke parë duart dhe faqet e tyre të kuqe.

- Ne kemi hequr dorë nga bota e gënjeshtërt dhe nga gëzimet e saj, - thotë njëri prej tyre, që kishte një mjekër të verdhë.

Ne heshtëm; por tjetri që kishte mjekër të zezë, na u drejtua:

- Çfarë keni që na shikoni me habi? Lutja të ushqeņ më mirë se mishi.

Hyjmë të bëjmë fetarinë tonë. Nxituam që të çliroheshim nga ata dy murgjër që kutërbonin era hudhër.

- Ati, që priste miqtë, erdhi, një burrë me sy të kaltër, me lëkurë ngjyrë trëndafili, i shëndetshëm, shumë i pastër, me mjekër të bardhë, të mëndafshtë. Na uroi mirëseardhjen, na shoqëroi dhe ne e ndoqëm pas. Manastir i pastër, si një vilë, me dhoma të larta, me dyer e dritare të lyera rishtas, me dritë elektrike, me kopshtin që rrinte pezull mbi det. Murgjit kishin dalë nga mencat dhe ishin ulur përpara kamareve të tyre e ngroheshin në diell. Hymë në kishë, u përkulëm përpara ikonave të shenjta. Panaja Paramithia-virgjëresha e Ngushëllimit, Ktitorisa-virgjëresha Themeluese, Vimatorisa-virgjëresha e Absidës, Antifonitris-virgjëresha e Përgjigjes, Esfagmani-Shën Maria e Shtatë Dhimbjeve, Eleobrotida-Shën Maria e Mëshirës. Ai hapi një mbajtëse relikesh të çmuara dhe ne puthëm brezin e shenjtë të virgjëreshës. Mua m'u kujtuan dy murgjërit që e kishin sjellë në Kretë kur unë isha fëmijë; populli vraponte në kishën e shën Minait duke i bërë devocionet. Murgjërit mbanin një çantë të vogël që mbushej me copëza argjendi, dhe ari, me vathë dhe unaza të florinjta, unë nuk kisha asgjë nga këto për t'ia dhënë. Futa dorën në xhep, gjeta një majë pene dhe e hodha në çantën e vogël.

Dolëm në oborr, u ngjitëm në dhomat e sipërme; atje na priste një tavolinë e pasur, me të gjitha dhuratat e Zotit.

- Po e kalojmë kohën për bukuri, thotë miku im, të cilit i pëlqente ushqimi i mirë, si murgjërit e vërtetë të Vatopedit!

- Pijmë, më thotë, për shëndetin e Ptokopodronit, të eturit; me

çfarë xhelozie tregonte atë që hanin igumenët nëpër manastire, çfarë uji pinin dhe si ankoheshin perandorit të tyre! Të kujtohen vargjet?

- Sigurisht.

Princ, për Igumenët kur mendoj
Nuk jam në vete e më shuhet shpirti;
Ata ushqehen me peshk lloj-lloj
E mua më japin ton të qelbur,
Pijnë sa dehen verë Kio
Stomaku im mbushur me qitro.

Ai qeshi, por befas hija i mbuloi fytyrën:

- Është turp të qeshësh, - thotë. - Ky manastir më shtrëngon zemrën. I pe murgjërit? Të gjithë të shëndoshë. Në qoftë se Krishti do të zbriste në tokë dhe do të vinte në Vatopedi, do të kishte vërvitur kamxhikun mbi kokat e tyre! Hajde ikim prej këtej!

- Ku do të shkojmë? Nuk është vetëm ky manastir, por është e gjithë bota, nuk e kupton se kush na e shtrëngon zemrën ne? Kudo ka njerëz që kanë uri, ndërsa të tjerë lëpijnë buzët, të ngopur; kudo ka ujqër dhe qengja: ose do t'i hash ose do të të hanë. Vetëm një ligj ka ngelur i paprekshëm në botë: ligji i xhunglës.

- Pra, nuk paska shpëtim? Nuk ekzistoka asnjë kafshë, qoftë edhe e vetme, e cila me vullnet dhe forcë, të mos i hajë të tjerët, por dhe të mos i lërë ata hanë?

- Tani nuk ka, por një ditë do të ketë se s'bën të tillë. Ka mijëra vjet që një kafshë ka nisur udhëtimin por nuk ka arritur akoma.

- Cila kafshë?

- Majmuni. Ne jemi akoma në mes të rrugës, te pitekantropi. Durim.

- Zoti mund të presë. Ai është i pavdekshëm; po njeriu?

- Edhe ai është i pavdekshëm, u përgjigja, jo i gjithë njeriu: ajo që ai ka të pavdekshme brenda tij, mund të durojë.

U çuam nga tavolina dhe zbritëm buzë detit, dielli ishte duke perënduar, asnjë gjethe nuk lëvizte. Dy pulëbardha, me krahë të mbledhur, shlodheshin duke mbështetur gjoksin e bardhë mbi sipërfaqen e detit.

- Duhet të jetë një burrë e një grua, - më thotë miku im, duke i parë me admirim.

- Ose më mirë dy miq, - i them dhe mora një zall e ua hodha për t'i ndarë.

Tashmë i plakur, lexoj përsëri këtë ditar të vjetër dhe shoh në të, ekspeditat tona donkishoteske, heshtën tonë të thyer, mburojën e rrethuar me vargje, helmetën prej llamarine, shpirtin tonë fisnik, dhe nuk mund të qesh. Sa i lumtur është një djalë që beson se ka detyrë të rikrijojë botën, ta akordojë më mirë me virtytin dhe drejtësinë; ta akordojë më mirë me zemrën e tij. Fatkeqësi për atë që e fillon jetën pa marrëzi.

Ne përshkonim malin Athos dhe sa më shumë thithnim ajrin e tij, aq më shumë na ndizej dhe na çelej zemra. O zot, sa vendime kemi marrë. Çfarë betimesh kemi bërë, sa shumë kemi bredhur nëpër manastire, duke kapërcyer lehtë shkëmbinjtë, dhe si e kemi kuptuar, jo me imagjinatën tonë, por në gjithë trupin, se kanë qenë krahët e engjëjve që na mbanin! Është sigurisht një atmosferë e tillë që lind shpesh herë marrëzinë, shenjtërinë ose heroizmin. Kurrë, në vitet e mëvonshme, nuk kemi biseduar, unë e miku im, për orët e shenjta donkishoteske. Sa turp na vinte, jo pse flakët e shpirtit ishin shuar, jo, ato nuk shuhen kurrë, por, përpjekjet tona ishin të kota, qëndronin nën dëshirën tonë, ne akoma donim ashtu si gjithmonë kemi dashur të krijojmë një botë të re, më të mirë, por pamë se nuk mund ta realizonim dot atë. Unë e shprehja, por miku im e ka fshehur gjatë gjithë jetës; për këtë arsye ai në brendësi ka qenë më i dërrmuar se unë!

Një mbrëmje, disa vite më vonë, kur largoheshim nga manastiri i femrave në Spetse, kur hëna e plotë ngrihej mbi det, e pikëlluar, unë u ktheva nga miku im dhe i thashë:

- Angelo, të kujtohet... Ai u zverdh, e kuptoi se po i flisja për hënën në malin Athos, më vuri dorën te goja:

- Mbylle gojën, - më tha, dhe nxitoi hapat.

Përkulem përsëri duke shfletuar fletoren time të vjetër të udhëtimeve.

Manastiri Karakalou. - Retë kanë mbuluar Athosin nga maja

të këmbët; në mes ishte hapur një brez i gjerë ku zbardhte dëbora. Filluan të bien disa pika të mëdha shiu. Mushkatari vrapon përpara dhe shtie me pushkë. Midis pishave kambana e manastirit bie si për festë dhe igumeni me rrason e lartë priftërore, i shoqëruar nga epitropët, del në prag për të na pritur.

Hymë në sallën e ngrënies, e gjatë dhe e ngushtë, me kolona të pikturuara me blu e të zezë. Igumeni, i rreptë, i heshtur, me mjekrën e tij të zezë qëndronte në krye të tavolinës; mbi të, me vetulla të tendosura, pikturuar me ngjyra të gjelbra dhe të zeza qëndronte Krishti. Shumë lart, lektori, një murg i ri, i zbehtë, fare i pakët në trup, psaltte me një zë monoton jetët e shenjtorëve. Të gjithë janë përkulur mbi pjata, askush nuk flet. Igumeni kap me kujdes bukën dhe gjellën. Papritur ai godet tre herë mbi një zile që ka në anën e djathtë; të gjithë çohen menjëherë, duke e lënë ushqimin përgjysmë, duke u përtypur akoma; madje, edhe ati që shërbente, vrapon, vendos një gju në tokë, bën një përkulje dhe i kërkon ta falë në qoftë se leximi i tij nuk ishte aq i mirë. Mbi një pjatë të vogël vjen buka e shenjtëruar, secili merr një copë prej saj dhe e ha, si gjithmonë.

Natën ne bisedojmë dhe gjumi na kap vonë. Çasti është pjekur, thoshim, madje edhe bota është pjekur për një dashuri të re, për Krishtin. Kur pyetëm një murg, që takuam përpara qimitiros së kuventit, përse gjithmonë në hyrje të qimitiros, e pikturojnë Krishtin të kryqëzuar dhe jo si do ta dëshironte, ai, të ringjallur, murgu, u nxeh: - Krishti ynë! Është Krishti ynë i kryqëzuar, - u përgjigj. Ke parë ti në ungjill të qeshë Krishti!? Ai gjithmonë vuan, atë e gozhdojnë dhe ai qan. Gjithmonë është i kryqëzuar. Ne nuk mundëm të flemë këtë mbrëmje, veç flisnim me njëri-tjetrin.

- Duhet, për ne ka ardhur momenti, që ta bëjmë Krishtin të qeshë; që të mos jetë i gozhduar, që ai të mos qajë më, që të mos e kryqëzojnë më. Ai duhet të shprehë zotët e fuqishëm e të gëzuar të Greqisë. Është pikërisht koha që Krishti çifut të bëhet Krisht grek.

- Jemi ne që do ta bëjmë! - thotë miku im dhe ngriti dorën si për t'u betuar.

- Po, ne jemi! - përgjigjem unë dhe në këtë çast m'u duk se asgjë nuk mund t'i rezistonte shpirtit të njeriut.

- Ne nuk do të ndahemi kurrë! - thirri miku im, do të vendosemi në të njëjtën zgjedhë si dy qe, që punojnë tokën.

Manastiri i Filotheas. - Një shëtitje e mrekullueshme në mjegull! Plepa të hollë që iu zënë frymën shermasheket. Murgu i neveritshëm, eshtak, disi kuqalash dhe llafazan, Janikiosi, nuk pushonte së foluri për motrën e tij Kaliro. Atij i duket se ka dy djaj brenda vetes; njëri quhet Hoxhë, e tjetri Ismail. - Këta të mallkuar janë kundër Zotit, kundër Janikios; gjatë kreshmëve ata duan të hanë mish ndërsa natën, më shtyjnë të zbres qetësisht shkallët, të hyj në kuzhinë për të ngrënë gjith ç'ka ngelur nga ushqimi i natës. Çdo mëngjes, kur dëgjojnë zilen, qofshin të mallkuar, fillojnë të thërrasin: - Unë nuk shkoj! Unë nuk shkoj! Unë nuk shkoj!

Ecim më tej, në oborrin e manastirit, të mbuluar nga bari, n mes të të cilit qëndronte kisha me muret e kamaret të nxira nga lagështia dhe myshku. Ne hyjmë në kishë për t'i bërë shërbesën ikonës së mrekullueshme të Glikofuzës, virgjëreshës së Puthjes së ngrohtë. Ajo mbështet butësisht buzën e saj mbi atë të Jezusit ndërsa sytë e saj, me trishtimin e pashërueshëm, shikojnë larg, shumë larg.

- Shikoni mirë në sytë e virgjëreshës, çfarë vini re? -na tha murgu që po na shihte. Ne u afruam edhe më për të parë. - Asgjë, u përgjigjëm të dy njëherësh. Aty duket Krishti i kryqëzuar, thotë murgu, dhe na pa me qortim. Hapi një mbajtëse të argjendtë relikesh ku gjendej një eshtër e gjatë. - Shikojeni mirë! Është krahu i djathtë i shën Joan Krizostanit. Bëni kryqin.

Na futi në sankristi ku na tregoi me krenari thesarin e manastirit, kafkën e shën Vasilit, të madhe, nofullën e Theodhorit, krahun e majtë të shën Joan Krizostanit dhe shumë eshtra të tjera. Na hapi relikierin e famshëm, I gjithë i veshur me gurë të çmuar dhe perla; brenda kishte një copë të madhe nga kryqi i vërtetë. Zëri i murgut dridhej nga emocioni ndërsa unë mendoja atë çka më kishte thënë një kristian mirëfill: "Gjithë copat e drurit janë nga druri i kryqit të vërtetë, sepse me secilën prej tyre mund të bëhet një kryq." Pastaj më tregoi tunikën e artë të Niqifor Fokas-it, qëndisur me trëndafil e zambakë; kurorën e artë të tij, mbuluar me gurë të mëdhenj të kuq e të gjelbër; - Evangjeli i ka shkruajtur me dorën e tij... Duke treguar disa regjistra të vjetër të brejtur nga krimbat...

Ne i shikonim me admirim, lëshonim thirrje habie, por asgjë nga këto nuk na prekte në zemër. Më shumë nga të gjitha, me një

kënaqësi të veçantë, më kujtohet aroma e dy mushmollave të mbushura me lule, në hyrje të bibliotekës; gjithë trupi më dridhej nga kënaqësia kur ndieja aromën e fortë të mushmollës që më pëlqen shumë, e ëmbël, pikante, më dehëse se vera e se gratë e se të gjitha bukuritë e botës.

Të nesërmen, akoma pa gdhirë, u nisëm për në majën e Athosit. Akoma nuk kishte rënë zilja në oborr, zogjtë ende nuk ishin zgjuar, qielli ishte i pastër, i qumështët, ylli i mëngjesit shkëlqente atje larg, në lindje, si një engjëll me gjashtë krahët e tij.

Atë Luka, i shkurtër, me këmbë të shtrembëra, kontrabandist i vjetër, ecte përpara dhe na tregonte rrugën.

Herë pas here ndalonte dhe fillonte të na fliste për datat, për festat, për grindjet me turqit. Gjithë jeta e tij e kaluar në këtë botë ishte si një legjendë, sikur ai kishte jetuar në një univers tjetër më të egër e më të ashpër, plot klithma, mëkate dhe femra. Ai tregonte legjendën e tij, e përjetonte dhe përsëri ndjente gëzim. Kishte hequr dorë nga jeta e vjetër, por e ruante, mbuluar me dollomanë e vjetër.

Nën një bredh të madh ai ndalon; donte të fliste.

- Ndalojmë, ndalojmë, fëmijë, - na thotë, shlodhemi pak dhe bëjmë ca muhabet. Unë u lodha. Nxori nga brezi një qeskë duhani, drodhi një cigare dhe filloi të flasë.

- Mua, që më shikoni tashmë të mbuluar me këtë dolloma, më quajnë Leonidha. Kapedani Leonidha Kalino, tmerri i turqve. Jeta ime: kontrabandist. Se si u bëra murg do t'ua tregoj një ditë tjetër. Por kontrabandisti nuk ka vdekur tek unë; dhe nuk mund të vdesë: Unë e ushqej dhe i jap ujë, si pasha, pak rëndësi ka nëse ai është i lidhur me mua me zinxhir si qen, mbi një anije. Luka ha në mensë së bashku me murgjit, bukë e ullinj, po kur shkon në kamaren e tij dhe mbyll portën ai përgatit tryezën e Leonidhës dhe ha mish. Ne nuk jemi një, e kuptuat, ne jemi dy. Këtë doja t'ju thosha; mëkati i pranuar-mëkat i falur; unë e thashë dhe u lehtësova, tani nisemi.

- Bravo kapedan Luka! - thotë miku im duke qeshur. - Ti na tregove atë që nuk tregohej. Por, ke menduar ndonjëherë, se kjo mund të jetë vepër e djallit?

- Sigurisht, - dhe sytë i shkëlqenin plot ligësi; - çdo mengjes e mendoj por kur vjen dreka e harroj.

- Lidh shamitë nyje, - i them, - për t'u kujtuar.

Thithi fort cigaren dhe një shtjellë e gjatë tymi i doli nga hundët.

Filluam përsëri të ngjitnim të përpjetën. Pisha, bredha, gremina të tmerrshme, dhe, atje poshtë nën dritën e lehtë të mëngjesit, shtrihej deti i qetë.

Sa më shumë shtohej drita mëngjesore, aq më mirë ne dallonim ishujt hyjnorë, Imbros, Samotrak, që dukeshin se qëndronin pezull në ajër pa prekur detin.

Hymë në një zonë të mbuluar me borë. At Luka ecte ngadalë, i vëmendshëm, ne rrëshqisnim, binim, ecnim me vështirësi në të përpjetën e rrezikshme me borë të ngrirë. Ishte një mal i thiktë, jonjerëzor, dhe përnjëherë miku im që ecte përpara meje ndalon; përkulet pak, shikon poshtë këmbëve të tij: Një humnerë e thellë e pafund. Ju morën mendtë. U kthye nga unë me çehre të zbehtë.

- Kthehemi... - pëshpëriti.

- Është turp! - i thashë dhe e pashë me mëshirë, - unë them se duhet të ngjitemi në majë.

- Po... po, është turp... - pëshpëriti i turpëruar. - Ecim!

Dhe filloi të ngjitet përsëri.

Kur arritëm në majë, dielli ishte ngjitur mjaft lart; të dërrmuar, të dyve na mbahej fryma, por fytyrat na ndriçonin, sepse e kishim arritur qëllimin tonë.

Hymë në kishëzën e shenjtë të shndërrimit të Krishtit, për të bërë ritin. Ndërkohë At Luka kishte ndezur zjarrin me shkarpat që kishte mbledhur rrugës, po bënte kafenë, ndërsa ne u mbështetëm pas një guri, sepse frynte erë dhe kishim ftohtë. Përpara shikonim detin e pafundmë, të heshtur, ishujt e bardhë që lundronin dhe shumë larg, male të panjohur që i jepnin qiellit ngjyrë plumbi.

- Thonë se nga kjo majë e shenjtë mund të shikosh Kostandinopolin! - thotë Luka, dhe zgurdulloi sytë drejt lindjes sikur do të shikonte qytetin mbretëror.

- E ke parë ndonjëherë, At?

Murgu psherëtiu: - Jo, unë nuk kam qenë i denjë për të. Për këtë nuk mjaftojnë sytë e trupit; duhen të tjerë, ata të shpirtit, dhe shpirti im, sa keq, ka shikim të shkurtër.

- Po Zotin e sheh? - i them.

- Eh! - përgjigjet murgu, për të parë atë s'ka nevojë të kesh sy. Zoti është më pranë nesh se sa mëlçia dhe mushkëritë.

Miku im ishte i trishtuar dhe nuk fliste; sigurisht ai nuk mund ta pranonte t'ia falte trupit të tij që në një çast ishte treguar i dobët. Ai nuk mund të përmbahej më; shtriu dorën dhe shtrëngoi fort dorën time.

- Të lutem, - më thotë, - harroje atë, të betohem se nuk do ta bëj më.

Manastiri i vëllezërve Joasaf, 6 dhjetor. - Sot ne e kaluam festën time në atelien e famshme të pikturës së vëllezërve Joasaf. Janë dhjetë murgjër piktorë. Çdo javë secili nga ata bën punët, lan, fshin, gatuan ndërsa të tjerët krehin. Nga kjo atelie, dalin, për të shkuar deri në kufijtë e botës ortodokse, Krishtat të krehur mirë, të ushqyer mirë, virgjëreshat e bukura, të veshura me rroba të shtrenjta, shenjtorët e lumtur me faqet ngjyrë trëndafili, të zhveshur nga çdo shenjtëri. Janë murgjër të mirë, që jetojnë në harmoni, mikpritësa, plot sedër që e duan ushqimin e mirë, verën e mirë, maçokët e tredhur. Ne kalojmë orët, pranë ushqimit të bollshëm, ulur rreth oxhakut me zjarr, duke biseduar. Ne, pjesëtarë të kësaj bote, ata të një bote tjetër. At Akakios, i shkurtër, i trashë, me këmbë të enjtura, kishte pikturuar gjatë gjithë ditës shën Antonin, ndërsa tani, përkëdhelte një mace të madhe të zezë shtrirë mbi gjunjtë e tij dhe na fliste me seriozitet për shenjtin eremit. Një ditë e takoi një vajzë dhe midis të tjerash i tha: unë ndjek gjithë urdhërat e Zotit; te Zoti kam gjithë shpresat e, ai do të ma hapi parajsën. Atëherë shën Antoni e pyeti: - Varëria a kthehet në pasuri? - Jo, at. - As paturpësia në turp? - Jo, at! - As armiqtë e tu në miqtë e tu? - Jo, at. E po mirë atëherë, shko puno, fatkeqe sepse ti nuk je për asgjë.

Unë shikoja Akakiosin e zjarrtë, që ushqimi i tepërt, nxehtësia e oxhakut dhe kujtimi i asketit të tmerrshëm e bënë ujë në djersë dhe, mendoja për shën Antonin me faqet ngjyrë trëndafili, që ai kishte pikturuar gjatë gjithë ditës. Më pushtoi një dëshirë djallëzore për t'i thënë; - shko, puno, fatkeq, sepse nuk je për asgjë. Një kore dhjami, zakonesh e vesesh mbështjellin shpirtin; atje në fund të

burgut të tij ai ka shumë dëshira dhe janë të tjera ato që formojnë dhjamin, zakonet dhe vesin! Unë nuk fola. Nuk fola me keqdashje.

Në mbrëmje kur u shtrimë për të fjetur, ia rrëfeva mikut tim.

- Ti e bëre këtë për mirësjellje, - më tha për të më qetësuar dhe jo me keqdashje: për mëshirë, për të mos i shkaktuar mundime një njeriu të zotë; ndofta se ti ishe i bindur që do të flisje kot.

- Jo, - protestoja unë, - edhe pse ti mendon kështu, duhet që ne të triumfojmë mbi virtytet e vogla për të cilat ti flet, kortezinë, mëshirën, oportunizmin; unë më shumë kam frikë virtytet e vogla se sa veset e mëdha, sepse ato kanë një fytyrë tërheqëse dhe të gënjejnë lehtë. Por unë dua t'i jap interpretimin më të keq dhe po të them: Unë e bëra nga ligësia, për të turpëruar shpirtin tim dhe, ta ndal që të fillojë.

Të nesërmen në mëngjes, nën verandën e xhamtë, midis pikturave të shenjtorëve me faqe të fryra nga shëndeti dhe të virgjëreshës topolake, ne pimë qumshtin së bashku me dhjetë piktorë të veshur me rraso, duke kërcitur bukën e grurtë të thekur dhe duke shijuar ëmbëlsirat e shumta që e shoqëronin. Nga dritaret e mëdha depërtonte dielli i bukur dimëror dhe era e mjaltit të pishave. Ne flisnim, qeshnim, a ishte ai Mali Athos? Krishti ishte ringjallur dhe qeshte së bashku me ne. Murgjërit na tregonin mrekullitë e shenjtorëve dhe sytë u ndriçonin, sa shumë u besonin, ose nuk u besonin dhe fytyrat u rrezatonin nga një dritë e largët.

Piktori më i ri, At Agapios, që kishte një mjekër të vogël të zezë e të ndritshme, buzë të kuqe, shtriu dorën dhe na tregoi një nga pikturat e tij të varura në mur përballë nesh:

- Është asketi i madh Arsen, - thotë duke shikuar me krenari veprën e tij; - ndërsa gruaja që ju shikoni në gjunjë përpara këmbëve të tij është një patrice romake që kishte kaluar malet dhe detet për të ardhur tek ai, për t'u lutur përpara tij. Por, asketi, shikoni, tregon detin me dorë, ngrys vetullat. "Unë dua ta paraqes të nxehur - dhe e ndjek: "Ik, - i thotë, dhe mos i thuaj askujt se më ke parë mua; përndryshe deti do të bëhet rrugë dhe gratë do të më shqetësojnë në vetminë time. - Lutu për mua, At - i lutet gruaja. - Grua, unë do t'i lutem Zotit që të të harroj! - iu përgjigj asketi.

Piktori u kthye nga ne duke na parë me një sy hileqar. Kë të ha-

roj? - na pyeti. Ne nuk dinim se çfarë kishte në kokë murgu, dhe heshtnim.

- Do të thotë se asketi qe goditur nga bukuria e gruas, dhe prandaj i kërkoi Zotit që të bënte ta harronte! - Dhe ai e harroi? - thotë miku im duke i shkelur syrin murgut. - A mund të harrohen gjëra të tilla? Përgjigjet tjetri, por duke parë plakun Habacuc që i hodhi një shikim të rreptë, atij i erdhi keq që lëshoi një fjalë të tillë dhe kafshoi buzët e tij të mëdha të kuqe.

Manastiri i Shën Polit. - Një udhëtim i mrekullueshëm me barkë deri në manastirin e shën polit. Mijëra ngjyra mbi det, kaltëroshe, të gjelbra ose ngjyrë sedefi, shkëmbinj ngjyrë plumbi, të kuq si gjak, gropa të zeza, pëllumba të egër, dhe befas ranishte të gjera, të bardha.

Miku im sot ishte në humor dhe gjithë barka dridhej nga të qeshurat e tij të forta. I thosha të tregohej i nxehur ose të fliste kinezçe dhe, përnjëherë me një gatishmëri e shpejtësi të çuditshme, ai filloi të shkarkojë me shpejtësi një përrua fjalësh imagjinare kineze. Unë isha shumë i shqetësuar, barka po bëhej shumë e ngushtë për mua.

- Tani, një varg dashurie, në gjuhën negre, i thashë, dhe ai me një pasion të shfrenuar, filloi të deklarojë dashurinë e tij me një negre të padukshme. Kështu ndaj të gdhirë mbërritëm në portin Shën Pol dhe filluam të ngjitnim të përpjetën e ashpër që të shpie në manastir.

Portieri ishte nga Qefalonia, plak, i djallëzuar, por shumë hokatar; rrinte ulur gjithë ditën, prapa portës, e me një biçak në dorë gdhendte në dru, me sa dukej, Krisht të vegjël, shenjtorë të vegjël, djajë të vegjël; shkurt kalonte kohën. Na pa mirë dhe filloi të qeshë: - Përse erdhët këtu, ç'do të bëni, do të kaloni kohën, apo si shumë kaqola që vijnë shpesh, do të shisni kastraveca? - pyeti ai

- Vijmë për devocionin tonë, plakush.

- Devocionin tuaj? Përse? Jeni të sëmurë?

- Në manastir!

- Çfarë manastiri? Nuk ka më manastir, mbaroi! Manastir është gjithë bota; dëgjoni një këshillë: kthehuni në botë.

Ne e shikonim pa hapur gojën; atëherë sikur na mëshiroi:

- Po bëj shaka, - thotë, - hyni... mirë se erdhët.

Hymë dhe pamë rreth oborrit kamaret e shumta. Murgu shtriu dorën:

- Ja, kosherja e Zotit, thotë me të tallur; ja kamaret. Dikur aty kishte bletë, që bënin mjaltë; tani ka arrëza që kanë vetëm një thumb, zoti na ruajt!

Ai shpërtheu në të qeshur.

Ne nuk folëm asnjë fjalë, por zemra na u mblodh, manastiri i shenjtë pra ishte boshatisur nga përmbajtja e tij e shenjtë, dhomat e murgjërve ishin kthyer në fshikëza bosh, ku vërdallosej flutura e shenjtë!

Ngjitëm me kujdes shkallën e gurtë që të çonte në dhomat e miqve; miku im më kapi për krahu me dashuri:

- Kujdes, - më tha, - mos u mërzit; shpirtrat tanë, duhet të rezistojnë shumë, ata nuk duhet të bien; sepse po të bien disa shpirtra në botë ajo do të rrëzohet; janë ata kolonat që e mbajnë. Këta janë të paktë, por hëpërhë, mjaftojnë.

Ai më tundi fort: - Mbahu, Misologj i gjorë! - më tha dhe shpërtheu me të qeshura.

Hymë ne ndërtesën e rezervuar për miqtë; pesë gjashtë burra shtatlartë, epitropët, rrinin ulur në formë rrethi, me duart kryqëzuar mbi bark; në mes, me mjekër të zezë të dredhur, me fytyrë fëminore, duar të bardha, me një kapele mëndafshi të zi, ishte ulur mbi fron igumeni. Na pyeti se ç'bëhej në botë dhe nëse kishim sjellë revista.

- Ç'bën Anglia? Pyeti një nga asistentët, ç'bën Gjermania? Ju mendoni se do të kemi luftë?

- Sikur të bëhej me të vërtetë! Thotë një tjetër duke i shkelur syrin atij që kishte pranë; Gjermanisë do t'i thyhen turinjtë.

Duke dëgjuar këtë fjalë, një kolos prej dyzet kudësh i bëshëm, u hodh me një kërcim nga karrigia.

- Gjermania një kafshatë i ka të gjitha, Angli, Francë, Rusi, dhe mua të më presësh hundën po gënjeva! Gjermania është Mesia: ajo do ta shpëtojë botën!

- Ulu ti, gjerman! - thotë igumeni, dhe vuri dorën e bardhë mbi buzë për të mbajtur të qeshurën.

U kthye nga ne: mos e dëgjoni, na tha; ai quhet Germanos, prandaj është bërë gjermanofil dhe vëllezërit e ngacmojnë.

Por në kohën që biseda nisi përsëri, porta u shty me sup dhe ne pamë të vërsulet brenda një djall i madh kockanjar me kokë të dërrmuar, gjaku i rridhte mbi mjekër dhe mbi dollomanë e grisur.

- Igumen i shenjtë, thërriti, shiko, antikrishtët më vranë, sepse unë votova për ty pardje kur u bënë zgjedhjet...

Igumeni u ngrit i zbehtë. - Përjashta! - i bërtiti; - nuk e shikon? Ne kemi vizitorë.

Por murgu nuk donte të largohej, hoqi kapuçin që ishte bërë leckë e pikonte gjak.

- Unë do ta vendos tek ikona e Shën Polit, që ai ta shohë se ç'është bërë manastiri i tij.

Asistentët u ngritën të turbulluar dhe filluan ta marrin me të mirë; ai rezistonte, por me kujdes ata e tërhoqën jashtë. Ndërkohë ne depërtuam midis murgjëve dhe dolëm jashtë nga ndërtesa e miqve.

Zbritëm në oborr dhe bëmë rreth njëqind hapa pa folur. Portieri na pa, e kuptoi, braktisi shenjtët dhe djajtë e tij të vegjël dhe na takoi i gëzuar.

- Mos u shqetësoni, fëmijë, - thotë, - ju e patë Atë Inoçentin? Unë ja bëra kokën copë, por nuk ka gjë, do t'i ngjitet; nuk është hera e parë.

- Ndodhin shpesh këto gjëra në manastir? - pyeti miku im. - Ngatërrestari, pra, hyn deri këtu?

- Po ku do ti që të hyjë në qoftë se nuk hyn këtu, kalorësi im? Çfarëdo që të bësh ai do të hyjë. Dikur, thonë ka qenë një manastir që kishte treqind e gjashtëdhjetë e pesë murgjër. Secili murg kishte tre palë pajime dhe tre kuaj: një të bardhë, një të kuq, e një të zi. I binin përreth manastirit tre herë për të penguar ngatërrestarin të hynte; në mëngjes me kal të bardhë, në drekë me kal të kuq, dhe në darkë me kal të zi.

- Atëherë, - ndërhyri miku im, - hyri ngatërrestari?

Murgu djallëzor qeshi: - Ti po tallesh?

Ndërsa murgjit shëtisnin hipur mbi kuajt, ngatërrestari qëndronte brenda, ulur mbi fronin e igumenit. Ishte igumeni.

- Po ti portier i shenjtë, a e ke parë ngatërrestarin? - pyeti miku im.

- Sigurisht, e kam parë.

- Si është?

- Pa mjekër, i shëndoshë, delikat, ka dymbëdhjetë vjet. Heshti, na shikoi ne dhe na shkeli syrin. - E patë igumenin tonë të shenjtë? Si e gjetët? Urimet e mira ju shoqëruan! Pushoi së qeshuri dhe shkoi të strehohet prapa portës së tij.

Pesë gjashtë murgjër na rrethuan dhe u përpoqën të na bënin të harronim kokën e dërrmuar të Inoçentit. Na shoqëruan për të bërë devocionet relikeve të shenjta, eshtrave dhe dhuratave të Mbretërve Magjistarë, ar e temjan, të ruajtura me kujdes në një relikier argjendi. Na thanë të përkulemi për t'u marrë erë; çudi që edhe pas kaq shekujsh ato kundërmojnë akoma, na thoshin, kjo është një mrekulli e madhe!

Kur dolëm në oborr dhe ngelëm vetëm, portieri na bëri shenjë e ne u afruam.

- Mbajnë erë, hë? - na tha duke qeshur tërë shkulm e forcë, - është një mrekulli e madhe! Në qoftë se u hedh kolonjë ato do të mbajnë erë kolonjë, në rast se u hedh esencë bimësh ato do të mbajnë po atë erë. Është një mrekulli e madhe, thoshin ata. Çfarë ere mbante sot?

- Erë trëndafili.

- Mirë, pra, ata kanë hedhur esencë trëndafili.

U përkul mbi shkopin që gdhendte dhe vazhdonte të qeshte.

- Ikni tani, që të mos shohin se unë po flas me ju sepse do të futesha në telashe. Ata më mbajnë për budalla. Unë i quaj sharlatanë, dreqi do të na marrë të gjithëve!

Manastiri Shën-Dionis. Në mëngjes, hipëm në një varkë dhe u nisëm drejt manastirit të Shën-Dionisit. Kuvendi më i rreptë i malit Athos, na thoshte At Benoja, varkëtari ynë. Edhe me humor të mirë sikur të jesh atje nuk mund të qeshësh, mund të pish verë të mirë në këtë manastir por nuk mund të dehesh, se kanë mbjellë një dafinë në oborr dhe mbi çdo gjethe në qoftë se sheh mirë shikon Krishtin të kryqëzuar.

Me ne ishte edhe një peshkop që shkonte në portin e Dafnit për të ikur.

- Gjithë universi, - thotë Atë Benoja, - është një kryq mbi të cilin është kryqëzuar Krishti. Jo vetëm gjethet e dafinës, por ti, unë, gurët.

Unë nuk mund të qëndroja më: - Unë, më fal, zoti peshkop, shikoj kudo Krishtin të ringjallur.

Peshkopi tundi kokën.

Nxitohesh, biri im, m'u përgjigj; ne do ta shohim Krishtin të ringjallur, por vetëm pas vdekjes sonë; tani, aq sa jetojmë ne kalojmë vetëm kryqëzimin.

Shumë pranë nesh, një delfin, u hodh përpjetë në mes të detit të qetë; shpina e fortë e përkulur e plot forcë i ndriti nga dielli. U zhyt përsëri, u duk, hidhej i gëzuar, gjithë deti i përkiste atij. Një delfin tjetër, u duk së largu, pas pak u bashkuan të dy, luajtën dhe pastaj me bishtin përpjetë u larguan njëri pranë tjetrit duke kërcyer.

Isha shumë i gëzuar; shtriva dorën , duke treguar dy delfinët.

- Është i kryqëzuar apo i ringjallur? - them triumfues. - Ç'na tregojnë dy delfinët?

Por tashmë kishim arritur në manastir dhe peshkopi nuk kish kohë të përgjigjej.

Sapo hymë në oborr, ndalemi të tmerruar. Na u duk se hymë në burgun e errët e të lagësht të të dënuarëve rëndë; rreth e rrotull kolona të ulëta të zeza dhe ndërmjet tyre, kube të lyera me ngjyrë portokalli të thellë; gjithë muret ishin mbuluar me piktura të egra të frymëzuara nga apokalipsi - nga djajtë, zjarret e ferrit, nga laviret, mbi gjokset e të cilave derdheshin lumenj gjaku, nga dragojtë e tmerrshëm me brirë... Gjithë dëshira sadiste e kishës për ta trembur njeriun dhe për ta çuar në parajsë jo nëpërmjet dashurisë por me anë të tmerrit.

Erdhi Ati Mikpritës dhe na pa që ne po shikonim të tmerruar pikturat. Buzët e tij të holla e të verdha u hapën; na shikonte të veshur mirë, të shëndetshëm, në lule të rinisë dhe e pushtoi urrejtja për ne. Me një pamje grindaveci hapi buzët dhe na foli:

Hapni sytë e mos u ngërdheshni, shikoni! Trupi i njeriut është plot zjarr, djajë e putana.

Ndyrësitë që shikoni nuk janë të ferrit por janë në trupin e njeriut.

- Njeriu u bë sipas fytyrës së Zotit, - kundërshtoi miku im; - nuk ka vetëm këto ndyrësi, ka edhe tjetër gjë.

- Ishte, - hungëriti murgu, - ishte, por nuk është më; shpirti në bo-

tën ku ju jetoni është bërë mish, mëkati qëndron brenda njeriut dhe e mëkon.

- Çfarë duhet bërë atëherë, plak? - i thashë. - Nuk ka rrugë shpëtimi?

- Po ka një rrugë; por ajo është e ngushtë, e vështirë dhe e rrezikshme; aty nuk kalon lehtë.

- Cila është ajo?- Ja! Shtriu dorën dhe na tregoi portën e manastirit.

- Ne nuk jemi akoma gati, - thotë miku im, të cilin e kishin nervozuar fjalët e murgut; - më vonë kur të plakemi; edhe mishin zoti e ka bërë.

Një buzëqeshje plot vrer çau buzët e murgut.

- Mishin e ka krijuar djalli, - hunguriti përsëri murgu, - vetëm shpirtin ka krijuar Zoti, ta dini, pastaj ua dha njerëzve!

U mblodh nën dollomanë e tij sikur trembej të na prekte dhe u zhduk nën një galeri portokallishteje.

Ne ngelëm vetëm në mes të oborrit.

- Shkojmë, - më thotë miku im; - Krishti nuk rri këtu, ti e shikon fare mirë.

U hapën dy-tri kamare dhe u dukën disa murgjër skeletik, na panë ne, pëshpëritën diçka dhe mbyllën portat.

- Këtu nuk ka dashuri, përsëriti miku im; - ikim prej këtej.

- Ty nuk të pëlqejnë? - i them. - Çfarë thua, sikur të qëndrojmë disa ditë këtu për të predikuar Krishtin e vërtetë.

- Me këta njerëz është e pamundur. Do të ishte mundim i kotë.

- Nuk është kurrë mundim i kotë. Në qoftë se nuk do të shpëtohen ata, do të shpëtojmë ne, duke ndërrmarrë të pamundurën.

- Seriozisht e ke? - më thotë miku dhe më pa duke më ndërprerë.

- Ah, sikur ta dija! - u përgjigja dhe përnjëherë më pushtoi një trishtim i madh. - Ah, sikur të mundja! Zemra më thotë: Në qoftë se ti, je me të vërtetë njeri, qëndro këtu, hyr në luftë! Por, ah, shpirti, Satanai, nuk më lë.

Dy murgjërit, morën zemër, erdhën dhe na grishën për të vizituar manastirin. Pamë një afresk që paraqiste gjigandin shën Kristofor me një kokë derri të egër, që na tregonte dhëmbin e tij të madh. Na treguan dorën e djathtë të shën Joan-Baptistit. Në sallën e ngrënies,

dy engjëj me krahë të kuq, si flaka, me këmbë të bardha, mbështetur mbi tokën e gjelbër që mbanin nga një heshtë në çdo dorë. Në të majtë mbi mur, një virgjëreshë ulur midis dy engjëjve; nga të dy anët pemë të gjelbëra me zogj që qëndronin mbi degët e tyre, prapa çdo engjëlli një selvi e hollë.

Lart në kupolë Pantokratori; nga goja i dilte një kaftan dhe mbi kaftan, shkronja të mëdha të kuqe. Murgjit ngritën dorën dhe na treguan Pantokratorin.

- I kuptoni ju se çfarë thonë ato shkronja? Duajini të tjerët. Po t'ia thoni këto fjalë një dege të thatë, ajo do të çelë gjethe, por në qoftë se këto ia thoni një njeriu ai nuk do të çelë. Ne të gjithë do të shkojmë në ferr.

Varreza ishte e thjeshtë, e këndshme, qëndronte si ballkon mbi det; pesë gjashtë kryqe të drunjtë, të brejtura nga era dhe kripa.

Papritur një tufë pëllumbash të bardhë kaloi mbi ne dhe u drejtua nga deti; murgu ngriti instinktivisht dorën sikur donte t'i kapte; sytë i kishte plot uri dhe dëshirë për vrasje.

- Gjah i mirë, sikur të kisha një pushkë! - pëshpëriti dhe dhëmbët i kërcitën nga uria e madhe që kishte.

Pelegrinazhit tonë po i vinte fundi. Gjatë ditëve përpara nisjes sonë unë u ngjita fare i vetëm, në mal për të parë ermitazhet e egra, ndërmjet shkëmbinjve.

Shumë lart mbi det, në Karulia, brenda shpellave, jetojnë dhe luten për mëkatet e botës, larg nga njëri tjetri, duke mos pasur as dëshirën më të vogël të shohin një qënie njerëzore, më të egrit, më të shenjtët asketë të malit Athos. Herë pas here lëshojnë mbi det një shportë të varur me litar dhe varkat që kalojnë andej u hedhin nga pak bukë, ullinj e çfarë të ketë, për të mos i lënë asketët të vdesin nga uria.

Disa nga këta asketë çmënden; besojnë se u kanë dalë krahët, fluturojnë mbi gremina dhe bien. Poshtë bregu është i mbushur me eshtra.

Midis këtyre eremitëve, jetonte në ato kohë, i famshmi për shenjtërinë e tij, Makarios. Për të parë atë po shkoja; që prej çastit kur

vura këmbën në malin e shenjtë, unë mora vendimin të shkoja ta shihja, të përulesha përpara tij, t'i puthja dorën, dhe t'i rrëfehesha jo për mëkatet e mija - unë deri atëherë besoja se nuk kisha të tilla si shumë të tjerë - por për mendjemadhësinë të frymëzuar nga Luçiferri që më shtynte shpesh të flisja pa kujdes për shtatë të fshehtat e dhjetë urdhërat dhe dëshiroja të gdhendte një dekalog tek unë.

Rreth mesditës arrita në ermitazh; vrima të zeza në muret e humnerave, kryqe të hekurt ngulur mbi shkëmbinjtë, një skelet dukej në hyrjen e një shpelle. Unë u tremba. Gjyqi i fundit dukej se bëhej aty, ky skelet të krijonte përshtypjen sikur sapo kishte dalë nga dheu dhe nuk kishte pasur kohë të mbushej me mish. Më pushtoi frika dhe neveria, por në të njëjtën kohë edhe një admirim i patreguar e i fshehtë. Nuk guxoja t'i afrohesha, e pyeta nga larg; ai shtriu dorën e thatë, pa thënë asnjë fjalë, dhe më tregoi një shpellë të zezë shumë lart, në buzë të greminës.

Vazhdova të ngjisja shkëmbinjtë, majat e tyre më gërvishtnin, kështu arrita tek shpella. U përkula për të parë brenda; një erë dheu dhe temjani përziheshin, një errësirë e thellë; pas pak dallova një kotruve në të majtë, në një të çarë shkëmbi, pamja dukej aq e shenjtëruar, saqë nuk guxoja ta prishja; zëri i njeriut këtu më dukej një gabim, një sakrilegj.

Ndërsa sytë po më mësoheshin me errësirën dhe unë përpiqesha për të shikuar, një fosforeshencë delikate, një fytyrë e zbehtë, dy duar skelet lëvizën në fund të shpellës, u dëgjua një zë i qetë, gati duke vdekur:

- Mirë se erdhe!

U inkurajova, hyra në shpellë, eca në drejtim të zërit. Ashtu i mbledhur lëmsh mbi tokë asketi ngriti kokën dhe unë dallova në gjysmëerrësirë fytyrën e tij të lëmuar, të tretur nga pleqëria dhe uria, me dy zgavra të thella që ndriçonin në një lumturi të pashprehur. Flokët i kishin rënë, koka i ndrinte si kafkë të vdekuri.

- Më beso, at, - i them dhe u përkula t'i puthja dorën e tharë.

Për një kohë ngeli ashtu i heshtur; unë e shikoja pa u ngopur atë shpirt që kishte mohuar trupin e tij; ai ia rëndonte krahët dhe e pengonte të shihte në qiell. Shpirti që beson është një bishë e pamëshirshme, që ha njerëzit; mishin, sytë; barkun, të gjitha ia kishte ngrënë.

Unë nuk dija ç'të thosha e nga t'ia filloja. Trupi i rrënuar që kisha përpara më dukej si i ardhur pas një masakre të tmerrshme; mbi të dalloja gërvishtjet dhe kafshimet e tunduesit.

Më në fund mora zemër.

- Ti lufton akoma me djallin, At Makarios? - e pyeta.

- Kam mbaruar, biri im, tashmë jam plakur, por edhe ai është plakur si unë. Unë luftoj me Zotin.

- Me Zotin! - thashë i habitur. - Dhe ti beson se do ta mposhtësh?

- Besoj se jam mposhtur, biri im; më kanë ngelur vetëm kockat; janë ato që rezistojnë.

- Jeta jote është mjaft e fortë, e paepur, plak; edhe unë dua të shpëtoj; nuk ka rrugë tjetër?

- Një rrugë më të qetë? - thotë asketi dhe qeshi me dhembshuri.

- Më njerëzore, plak.

- Nuk ka veç një rrugë.

- Cila është ajo?

- Ngjitja. Të ngjitësh shkallët një nga një; nga ngopja në uri, nga gryka e lagur ne etje, nga gëzimi në vuajtje; në majë qëndron demoni. Zgjidh.

- Unë akoma jam i ri; toka është e bukur, kam kohë të zgjedh.

- Zgjohu, bir, zgjohu, përpara se Vdekja të të ketë vënë në gjumë.

U drodha. - Unë jam i ri - përsërisja për të marrë guxim.

- Vdekja pëlqen të rinjtë, ferri të rinjtë, jeta është një qiri i ndezur, që shuhet lehtë, kujdes, zgjohu!

Heshti, pastaj pas një çasti: - Ti a je gati?

Mua më pushtoi mërzia dhe dëshpërimin: - Jo! - thërrita.

- Guximi i tepruar i rinisë! - thirre me zë të lartë, - dhe për këtë je krenar, nuk ke frikë?

- Kush nuk ka frikë? Unë kam. Po ti at i shenjtë nuk ke frikë? Ti ke uri dhe etje, ti ke vuajtur, ti je gati në majë të shkallëve, nga duket porta e parajsës. Por a do të hapet kjo portë për të hyrë ti? Do të hapet? Je i sigurtë për këtë?

Dy pika loti i rrodhën nga zgavrat e syve, psherëtiu pastaj pas një çasti: - Unë jam i sigurt në mëshirën e Zotit; vetëm ai mund të falë mëkatet e njerëzve.

- Edhe unë jam i sigurt në këtë mëshirë të Zotit; ai pra mund të

BIBLIOTEKA GANESHA
AKROPOLITI

falë edhe atë guximin e tepëruar të rinisë.

- Qielli na mbron, që kjo të varet vetëm nga mëshira e Zotit; vesi dhe virtyti atëherë do të hynin të dy në parajsë.

- Ti nuk beson, plak, që mëshira e Zotit të jetë aq e madhe?

Mundohesha t'i thosha se, si nga një dritë, shpirti im është përshkuar nga kjo ide, ndofta si një sakrilegj, apo kushedi ndofta tri herë më e shenjtë se koha për shërbimin e fundit, për pajtimin e fundit, do të vijë. Flakët e ferrit do të shpërndahen dhe biri plangëprishës, Satana, do të ngjitet në qiell, do t'i puthë dorën Atit dhe lotët do t'i rrjedhin nga sytë. - Unë kam mëkatuar! - do të thërrasë dhe Ati do të hapë krahët: - Mirë se erdhe, mirë se erdhe bir; më fal që të kam torturuar aq shumë!

Mirëpo, nuk guxoja t'ia shfaqja atë mendim, prandaj përpiqesha të gjeja një shteg.

- Kam dëgjuar, plak, se një shenjt, nuk më kujtohet cili, nuk gjeti prehje në parajsë; Zoti dëgjoi ankesat dhe i foli: - "Çfarë ke? Pse psherëtin? Nuk je i lumtur?"

- "Si mund të jesh i lumtur, Zot? - iu përgjigj shenjti. - Në mes të parajsës ka një curril ujë që qan

- Çfarë currili uji? Ato janë lotët e të mallkuarve!

Asketi bëri kryq, duart i dridheshin.

- Kush je ti? - më thotë me një zë të mekur. Prapa, Satana!

Bëri edhe tri herë kryqin dhe pështyu në ajër.

- Prapa, Satana! - përsëriti; zëri tashmë ishte mjaft i ulët.

Preka me dorë gjurin e tij të zhveshur që ndrinte në gjysmëerrësirë, ajo m'u ftoh.

- Plak, i thashë, unë nuk kam ardhur këtu për të të tunduar, sepse unë nuk jam tunduesi; unë jam një djalë, që do të besojë me naivitet, pa pyetur se ç'besonte gjyshi im fshatar; këtë dua të arrij por nuk mundem.

- Fatkeqësia jote, fatkeqësia jote, o i pafat! Ty do të të përpijë shpirti dhe uni. Kryeengjëlli Luçiferr që ti mbron dhe do të shpëtosh, a e di ti kur ka përfunduar në ferr? Kur u kthye nga Zoti dhe tha: Unë! Po, po, dëgjo djalosh, dhe mbaje mend mirë: vetëm një gjë është e mallkuar dhe shkon në ferr, është uni, qoftë i mallkuar!

Tunda kokën, këmbëngulës:

- Por ky uni e ndan njeriun nga kafsha, At Makarios.

- Ky e ndan njeriun nga Zoti. Në fillim të gjithë ishin bashkë dhe të lumtur në gjirin e tij. Nuk kishte as unë, as ti, as ai; nuk kishte as imja, as jotja, nuk kishte dy, kishte vetëm një. Bashkimi; Njëshi. Kjo është Parajsa për të cilën të fola, jo për gjë tjetër; që këtej jemi nisur, për këtë shpirti kujtohet shpesh, digjet për t'u kthyer atje. Bekuar qoftë vdekja! Çfarë është vdekja? Është një mushkë mbi të cilën hipim dhe shkojmë së bashku.

Ndërsa fliste, fytyra i ndrinte; një buzëqeshje e ëmbël, e lumtur, shpërndahej nga buzët dhe pushtonte gjithë fytyrën e tij. Ndjehej se gjendej në parajsë.

- Përse buzëqesh plak?

- Përse të mos qesh? - m'u përgjigj; jam i lumtur, bir. Çdo ditë, çdo orë, unë dëgjoj këmbët e mushkës, dëgjoj vdekjen që afrohet.

Kisha ngjitur shkëmbinjtë për t'u rrëfyer tek ky shenjt që kishte ikur nga kjo jetë, por pashë se ishte akoma shumë herët. Jeta tek unë nuk ishte hapur akoma. Unë e doja shumë jetën e dukshme, luçiferri rrezatonte në shpirtin tim, ai akoma nuk ishte zhdukur nën dritën verbuese të Zotit. Më vonë, mendoja se kur të jem plakur, Luçiferri do të jetë akoma tek unë.

U çova. Plaku ngriti kokën.

- Po ikën? - më pyeti. - Udhë të mbarë, Zoti qoftë me ty. - Pastaj pas pak, me një ton tallës: - Të fala botës.

- Të fala qiellit, - e kundërshtova. - I thuaj Zotit se nuk është faji ynë, është i tij, që e bëri botën kaq të bukur.

Por jo të gjithë murgjit ishin të lumtur, nuk ishin të sigurt në vetvete. Më kujtohet njëri, At Ignati. Në mbrëmje kur ata shkonin të flinin, unë e miku im, ngelur vetëm, bisedonim në dhomën e miqve. Bisedonim për preokupimet tona shpirtërore, për rrugët që duhet të ndjekë njeriu për të arritur tek Zoti, përpiqeshim t'i jepnim një përmbajtje të virgjër fjalës së deformuar të priftërinjve. Një ditë, ndërsa po bisedonim, duhet të ishte mesnatë, një zë i mbytur nga emocionet doli nga një qoshe e errët.

- Zot më lër ulur gjatë gjithë jetës dhe t'ju dëgjoj juve; nuk dua

parajsë tjetër.

Ishte At Ignati, i strukur në gjysmëerrësirë, që na dëgjonte. Ai sigurisht nuk kishte kuptuar mirë çfarë po biedonim ne por kishte kuptuar fjalët Zot, dashuri, detyrë, që përsëriteshin shpesh gjatë bisedës sonë, dhe mbi të gjitha i kishte bërë përshtypje energjia, ngrohtësia e zërit tonë; ndofta edhe zbehtësia e fytyrave tona nën dritën e dobët të llambës.

Kështu u bëmë miq, prej asaj mbrëmjeje ai nuk na ndahej më; ai nuk fliste, vetëm dëgjonte; dëgjonte me etje çdo fjalë që kapërcente ato çka fliteshin midis murgjëve.

Një ditë para se të niseshim, ai më ftoi në darkë në kamaren e tij, miku im ishte i lodhur e po flinte.

- Unë dua të rrëfehem tek ti, - më thotë, - ulu.

Më dha një stol dhe unë u ula. E shihja me dritën e hënës; mjekra e tij e rrallë e bardhë ndriçonte, dollomaja e zezë që ishte kthyer në ngjyrë gri nga përdorimi, mbuluar me një shtresë të yndyrosur ngaqë ishte e palarë, fekste zbehtë. Faqet i kishte të futura brenda dhe fytyrën mbuluar me rrudha të thella, si tokë e punuar. Vetullat e trasha si furçë mbulonin sytë e thelluar dhe shumë të zinj. Mbante erë vaj kandili dhe temjani. Nga këpucët me qafa e të çara, dilte gishti i madh i këmbës së majtë.

Ndenji i heshtur për një kohë të gjatë; dukej se kishte marrë një vendim dhe tani i vinte keq.

- Për hir të Zotit, - thotë më në fund, - ki durim, dëgjomë; mos thirr, mos u ço dhe mos ik përpara se unë të kem përfunduar rrëfimin; ki mëshirë për mua.

Zëri i dridhej. - Do një kafe? - thotë, sikur donte ta vononte çastin e vështirë. Por papritur përgjigjen u ul mbi krevatin e tij të varfër dhe shtrëngoi mjekrën e hollë, mendueshëm dhe i pavëndosur.

Unë kam mëshirë për ty. - At Ignat, i them, mos hezito; unë jam njeri i durueshëm dhe i kuptoj vuajtjet e njeriut; - fol lirisht, fol për t'u çliruar.

- Nuk është vuajtje, më thotë, dhe përnjëherë zëri i tij i dobët u forcua, nuk është vuajtje, është gëzim. Gëzim i mallkuar? I bekuar? Prej vitesh jam përpjekur ta ndriçoj, por nuk mundem; prandaj të kam thirrur, kërkoj ndihmë; më kupton?

Sapo nxori këto fjalë zemra e tij u çlirua, ai nuk hezitonte më, u përqendrua, pa më parë, me shikimin të fiksuar mbi llambën që digjej përballë tij, pranë ikonës së Krishtit të kryqëzuar, filloi:

- Prej shumë vitesh, mor bir, kam kërkuar të shoh Zotin por nuk kam arritur; gjatë shumë viteve jam përkulur, hesht, shiko duart e mia, ato janë plot kallo, gjatë shumë viteve unë kam thirrur "Mirë, unë jam i padenjë për të, s'ka gjë pse nuk e shoh Zotin, por të paktën mund të ndiejë praninë e Tij të padukshme, për të qenë i lumtur, për të kuptuar që jam i krishterë, dhe që gjithë vitet e mia të kaluara në manastir kanë kaluar kot." Thërrisja, qaja, rrija pa ngrënë por më kot, më kot! Zemra ime nuk hapej që të hynte Zoti; Satanai e kishte mbyllur dhe çelësat i mbante vetë.

U kthye nga unë, më pa; ngriti vetullat për të më shikuar më mirë.

- Përse t'i them ty gjithë këto? - foli, si për të më qortuar. - Kush je ti? Nga vjen? Përse vjen në Malin Athos? Përse kam besim tek ti dhe doja të thosha ato që ti dëgjove dhe që unë nuk i kam pohuar kurrë, as priftit ku rrëfehem, këtë gjë që më dërrmon dhe më dërgon në fund të ferrit? Përse? Përse?

Më hodhi një shikim të dyfishtë; priste përgjigje.

- Ndoshta është vullneti i Zotit, - u përgjigja. - Ndoshta Ai, më dërgoi në malin Athos, që të të dëgjoja ty. Si mendon ti At Ignat, shpirti i njeriut, duhet t'i dijë ato çfarë bën Zoti për të të çliruar nga pesha e atyre për të cilat më fole?

Murgu uli kokën, u zhyt për një çast në mendimet e tij.

- Ndoshta... ndoshta... - tha më në fund; mori guxim dhe vazhdoi pa lëvizur;

- Qënka kështu pra që gjatë viteve unë jam torturuar; unë mendoja se jeta ime kishte humbur. Lutja nuk më bënte asgjë, as të pangrënët, as vetmia. Nuk ishte ajo rruga që do të më çonte te Zoti, filloja të dyshoja i tmerruar, ajo nuk ishte rruga që do të më çonte te Zoti. Ishte tjetër rrugë ajo që do të më çonte atje, por cila? Një ditë igumeni i shenjtë më dërgoi të shoh në një fermë pranë Selanikut ku gjendej një manastir. Ishte verë, koha e të korrave dhe unë duhej të ndaloja murgjit të vidhnin.

Kishte njëzet e një vjet që nuk kisha dalë nga manastiri, që nuk kisha parë qenie njerëzore me fëmijë, që nuk kisha dëgjuar të qeshu-

ra, që nuk kisha parë gra. Në fushë bënte shumë vapë dhe unë nuk duhej të isha më shumë se dyzet vjeç atëherë. I burgosur njëzet e një vjet, më ishin hapur portat dhe unë thithja ajrin e pastër të fushës. Kisha harruar fëmijët që rrokulliseshin përtokë duke luajtur, femrat me shtëmba në supe që shkojnë për ujë në krua dhe të rinjtë që me nga një degë borzilok në vesh pijnë nëpër taverna. Një grua, përpara portës së fermës, mbante të porsalindurin në duar dhe i jepte për të pirë. Një çast, Zoti më faltë, unë besova se ishte virgjërësha Marie dhe u përkula duke e admiruar. Të thashë, kisha njëzet e një vjet që nuk kisha parë grua, koka më ziente. Ajo, duke më parë, mbërtheu jelekun, mbuloi gjoksin dhe u përkul për të më puthur dorën.

- Mirë se erdhe At Ignat, - tha, - na jep bekimin.

Por unë, nuk e di përse, u mërzita, dhe e tërhoqa dorën.

- Mos e nxirr gjoksin përpara burrave, - i bërtita.

Ajo u skuq, tërhoqi shaminë e kokës, mbuloi kokën dhe buzët. Pa thënë asnjë fjalë, u fut brenda e tmerruar.

Murgu mbylli sytë, sigurisht për të parë pragun e portës, gruan, dhe jelekun e saj të zbërthyer.

- Atëherë? - i them duke parë murgun që po rrinte për një kohë të gjatë i heshtur.

- Këtu fillon ngjitja, thotë murgu; dua të them, zbritja. Ti më dëgjove, u tregove i durueshëm, nuk do të bërtasësh, nuk do të çohesh e të ikësh. Nuk është faji im është i Satanait; nuk është as i tij, të gjitha vijnë nga Zoti. Në qoftë se një gjethe bie nga pema, e rrëzon ai, thonë shkrimet. Për më shumë arsye një shpirt... Unë e them këtë për të ngushëlluar ndërgjegjen por kjo nuk e ngushëllon. Ditën ajo hesht, ndërsa natën ngrihet e më thotë se qënka faji im!

Të fola për gruan që ishte ulur mbi pragun e portës dhe që i jepte fëmijës të pinte. Nga çasti kur unë pashë gjoksin e saj, nuk kam mundur të gjej prehje. Një asket i madh, shën Antoni thotë: Në qoftë se ti je në qetësi dhe dëgjon këngën e një zogu, zemra jote nuk ka më qetësinë e parë. Atëherë, në qoftë se kënga e një zogu, trondit zemrën tonë, çfarë mund të bëjë gjoksi i zbuluar i një gruaje? Dhe mos harro, unë kisha hyrë në manastir fare i ri, dhe nuk kisha njohur femër. Çfarë them unë, njohur? Unë nuk kisha prekur kurrë. Ç'të bëj? Si ta largoj Satanain? U hodha në të pangrënët e në lutje. Mora

[illegible]stenin që shpojnë qetë kur punojnë dhe shpoja vehten; Gjithë [illegible]upi m'u bë plagë. Më kot! Më kot! Në qoftë se llamba ul flakën [illegible]në shikoj në gjysmëerrësirë të ndrijë një gjoks i bardhë. Një natë [illegible]pashë një ëndërr të frikshme, më kujtohet akoma dhe më bën të [illegible]rridhem.

Gjuha i ishte trashur, buzët i ishin tharë. Por unë vijova pa mëshirë.

- Çfarë ëndrre?

Fshiu djersët nga balli dhe mori frymë thellë.

- Kam parë në ëndërr një gji të bardhë, jo një trup, jo të një gruaje; një errësirë të thellë dhe brenda saj një gji të bardhë, ndërsa unë, ngjitur pas tij, me dollomanë veshur, me kapuçin në kokë, me mjekër të zezë e thithja...

Shfryu si ka dhe heshti.

- Pastaj? Po pastaj? - e pyeta pa mëshirë. Etja për të dëgjuar kish [illegible]te mposhtur tek unë mirësinë. Nuk ishte nga kureshtja, ishte dhembshuria e thellë për njeriun fatkeq që do, që do por nuk mundet.

- Përse këmbëngul? Ti nuk ke mëshirë për mua? - thotë murgu dhe më pa me një sy lutës.

- Jo, - iu përgjigja, - por befas, më erdhi keq. - Po - i thashë, - prandaj dhe po këmbëngul; ti do ta shikosh, sapo ta kesh thënë do të ndjehesh i lehtësuar.

- Ke të drejtë... Po, sapo ta kem thënë, unë do të ndjehem i lehtësuar. Dëgjo pra; gruaja që pashë mbi prag, më sillte çdo mbrëmje një pjatë ushqim dhe një gotë verë. Por ditët e fundit unë nuk e prekja. Ajo vinte në mëngjes dhe e merrte. Hezitonte për një çast, sikur donte të më pyeste përse nuk haja, por nuk guxonte. Megjithatë një mbrëmje, ishte e diel, ajo nuk ishte lodhur me punët e fushës; kishte larë flokët dhe ishte veshur me rrobat e së dielës, një fund, më kujtohet me qëndisje të kuqe. Bënte vapë dhe ajo kishte zbërthyer pak bluzën dhe i dukej gusha. Flokët i kishte bërë me vaj dafine, siç i bëjnë zakonisht gratë e fshatit, mbante erë të mirë. Nuk e di përse ajo më kujtoi kishën, ditën e pashkëve, kur ne e zbukurojmë me degë mersine dhe nëpër tokë shpërndahen gjethe dafine; ajri mban erë dafine dhe ringjalljeje.

Ajo vendosi pjatën dhe verën mbi tavolinë dhe, e di përse? Sepse ishte e porsalarë? Sepse ishte e çlodhur? - Banja, parfumi dhe një

kopsë e zbërthyer mund ta ndihmonin tunduesin të sundonte një burrë! Ajo mori zemër; atë mbrëmje ajo nuk iku, qëndroi.

- Ke disa ditë që nuk ke ngrënë At Ignat, përse? - më thotë dhe zëri i saj ishte i shqetësuar, plot dhembshuri, sikur djali i saj nuk pinte prej disa ditësh, dhe ajo shqetësohej se mos ai ishte i sëmurë.

Unë nuk iu përgjigja; ajo nuk po ikte. Ajo nuk po ikte e di ti përse? Ti je akoma i ri dhe nuk e di; sepse djalli në barkun e femrës nuk fle; ai punon.

- Ti je dobësuar At Ignat, më tha përsëri; trupin e ka bërë Zoti dhe ne atij duhet t'i japim për të ngrënë.

- Largohu, Satana! Pështpërita me vete dhe nuk i ngrita sytë për të parë gruan. Papritur lëshova një klithmë sikur po mbytesha: - Ik!

Gruaja u tmerrua dhe nxitoi drejt hyrjes. Por kur e pashë që po afrohej tek hyrja, u tremba, u tremba se mos më ikte. E arrita dhe e kapa për flokësh. I fryva llambës që i kryqëzuari të mos na shikonte, ajo u fik, errësira është banesa e Satanait; e mbajtur ashtu për flokësh, e hodha në shesh. Unë hungërija si dem, ajo heshtte. Shtrëngova shallin e saj të kokës dhe me një të tundur i zbërtheva njëherazi gjithë jelekun.

Sa vite kanë kaluar që atëherë? Tridhjetë? Dyzet? Hiç s'ka kaluar; koha është ndalur. Ke parë ti kohë të ndalur? Unë kam parë. Ka tridhjetë vjet që unë i zbërthej jelekun dhe ai akoma nuk është zbërthyer i tëri.

E mbajta deri në agim, nuk e lashë të ikte. Çfarë kënaqësie që ishte, o Zot, çfarë lehtësimi, çfarë ringjallje! Gjatë gjithë jetës sime unë kisha qenë i kryqëzuar, atë natë u ringjalla. Dhe ka akoma një gjë më të tmerrshme: dhe unë besoj që është ky pikërisht, mëkati im dhe për këtë të kam thirrur në kamaren time, që ti të ma qartësosh, ka edhe më të tmerrshme akoma; për herë të parë unë pashë Zotin që të jetë pranë meje me krahë hapur. Çfarë mirënjohje nga ana ime, çfarë nate lutjesh ka qenë ajo natë, deri në agim, si u hap zemra ime dhe Zoti hyri brenda saj! Për të parën herë unë kuptova, shkrimet e thonë, por ato nuk janë veç fjalë, përherë të parë nga jeta ime e privuar prej të qeshurave jo njerëzore, unë kuptova në çfarë pike Zoti është shumë i mirë dhe i do njerëzit; në çfarë pike ai duhet të ketë mëshirë për ta, që ka krijuar femrën dhe i ka dhënë

një hir të tillë, që ajo të na çojë në rrugën më të shkurtër dhe më të sigurt drejt parajsës. Femra është më e fortë se lutjet, se të pangrënët dhe, Zoti më faltë, sesa vetë virtyti.

Ai u ndal; ishte i trembur nga fjalët që po thoshte. I hodhi një shikim të trembur Krishtit mbi kryq dhe dy pika lot i rrëshqitën nga sytë e tij të vegjël të zhytur prapa vetullave të trasha.

- Krisht, unë kam bërë mëkat! Ulëriti dhe mbylli sytë për të mos parë ikonën.

Pas pak e mori veten, hapi sytë e më pa. Unë hapa gojën për të folur, por nuk dija ç'të thosha, por ama, edhe qetësinë nuk e duroja dot, ndërsa lotët që rridhnin nga sytë e plakut më lemerisnin. Unë nuk pata kohë të them asnjë fjalë, ai shtriu dorën sikur donte të më mbyllte gojën. - Nuk kam mbaruar, - më tha, - prit.

Kur u gdhi, gruaja u ngrit ngadalë, u vesh, hapi lehtë portën dhe iku. Shtrirë me shpinë për tokë, unë mbylla sytë dhe fillova të qaj. Por këta lot nuk u ngjajnë atyre që unë derdhja në kamaren time dhe që ishin të hidhur si helm; ata kishin një ëmbëlsi të pashpjegueshme. Unë e ndieja se Zoti kishte hyrë në dhomën time dhe ishte mbështetur mbi jastëkun tim; isha i sigurt, se, në qoftë se do të shtrija dorën, do ta prekja, por unë nuk isha i pabesueshmi Thoma, unë nuk kisha nevojë të shtrija dorën për ta prekur. Është femra, femra dhe jo lutja, jo mosngrënia, unë e përsëris, që më ka dhënë sigurinë dhe më solli Zotin në dhomën time.

Prej asaj nate, që prej tridhjetë apo dyzet vjetësh, unë rri e pyes veten; mëkati a është në shërbim të Zotit? Unë e di, e di, që do të më thoni atë që thonë të gjithë. Sigurisht mjafton që të pendohesh. Por unë nuk pendohem; unë e them hapur, më rëntë rrufeja e Zotit dhe më përvëloftë, unë nuk pendohem! Dhe në qoftë se do të kisha mundësi ta bëja përsëri, përsëri do ta bëja. Hoqi kapuçin, kruajti kokën, flokët e bardhë u shpërndanë dhe i mbuluan fytyrën. Qëndroi për një çast mendueshëm; unë e kuptova se ai hezitonte të vazhdonte. Por më në fund vendosi. - Po si, ajo që bëra, nuk është mëkat? Dhe në qoftë se ky nuk ishte mëkat, çfarë duan të thonë mëkatet e origjinës, gjarpëri, molla e ndaluar?

Unë nuk e kuptoj. Prandaj të kam thirrur. Nuk dua të vdes, do të zvarritem ashtu me kockat që më kanë mbetur, nuk dua të vdes

përpara se të arrij ta kuptoj.

Çfarë t'i thosha? Që mëkati i shërben Zotit? Ishte hera e parë që kjo pyetje më torturonte. A ekzistonte, paralelisht me rrugën e virtytit, një rrugë tjetër, më e gjerë, më e përbashkët, rruga e mëkatit, që mund të na çojë te Zoti?

- At Ignat, iu përgjigja, unë jam akoma mjaft i ri, e nuk kam patur kohë të mëkatoj shumë, të vuaj shumë, prandaj nuk mund të të përgjigjem. Nuk mund ta marr shpirtin tim për gjyqtar, nuk kam besim tek ai; as në zemrën time, tek ajo akoma më shumë nuk kam besim. Njeri i dënon të gjithë, tjetra i fal të gjitha. Si mund të jetë fundi? Shpirti thotë: është shumë e këndshme, e rehatshme, At Ignat, rruga e mëkatit që siç the se të çon te Zoti, unë nuk e pranoj. Zemra paraprin e thotë: nuk është e mundur që Zoti të jetë aq mizor dhe i padrejtë për të dashur martirizimin, urinë dhe vuajtjet e njeriut; a mund të hyjmë pra te Zoti të marrosur e të shkatërruar? Unë nuk e pranoj.

Çfarë përfundimi pra mund të nxjerrim, At Ignat, kur unë besoj se të dy kanë të drejtë?

Ndërsa flisja, në thellësi mendoja por pa e thënë: një Dekalog të ri! Një Dekalog të ri! Por ky Dekalog i ri si do t'i klasifikonte virtytin dhe vesin? Nuk arrija ta konceptoja. Kënaqesha vetëm duke thënë e rithënë me vehten time: Një Dekalog i ri! Duhet absolutisht. Cili do të na e japë?

Hapësira e kamares filloi të ndriçohet dalëngadalë; në oborrin e manastirit u dëgjuan timgujt melodioz që thërrisnin murgjit në takimin e mëngjesit. At Ignati pa hapësirën e kamares, u habit:

Paska rënë drita, pëshpëriti, paska rënë drita... U tërhoq në një qoshe, u përkul me ngadalë duke rënkuar, sepse i dhimbnin veshkat, mori një sapllake të vogël, u afrua te kandili para Krishtit, që po shuhej dhe i hodhi vaj. Flaka u gjallërua, dhe ndriçoi fytyrën e verdhë të Krishtit, të dobët, me një çurgë gjaku që i rridhte midis kurorës me gjemba, mbi ballë e mbi faqe.

Murgu, për një kohë të gjatë, fiksoi sytë mbi të pastaj psherëtiu. U kthye nga unë: - Pra ti nuk më përgjigjesh dot? Fare? M'u duk se zëri i tij ishte tallës. U çova nga stoli ku isha ulur dhe qëndroja në këmbë pranë murgut duke parë të kryqëzuarin. Isha i lodhur, më

vinte gjumë - Fare, iu përgjigja.

- Është e kotë, - tha murgu, dhe mori shkopin, në një cep të kamares, për të shkuar në takimin e mengjesit. Ndaloi përsëri përpara ikonës për ta parë, fytyra e tij e fishkur, e dërrmuar, ndriçonte nën dritën e kandilit. Ngriti gishtin, më tregoi Krishtin mbi kryq, e më tha:

- Ai është përgjigjur.

Në këtë kohë, trokitën në portë. - At Ignat... - tha një zë.

- Erdha, igumen i shenjtë, - u përgjigj murgu dhe tërhoqi llozin e derës.

Shfletoj fletoren e zverdhur me shënimet e udhëtimit. Asgjë nuk ka vdekur, gjithçka fle brenda meje; tashti, sikur zgjohet dhe ngjitet nga faqet e zverdhura gjysmë e dukshme dhe shndërrohet në manastire, murgjër, piktura, det! Miku im ngrihet nga toka, i bukur si atëherë, në lulen e rinisë, me të qeshurën e tij homerike, syrin e shqiponjës, ngjyrë blu, me gjoksin mbushur me poema! Ai u ka dhënë njerëzve aq shumë sa ata mund ta merrnin, u ka kërkuar aq shumë sa ata mund t'ia jepnin; ai vdiq i trishtuar e i braktisur; ai ruajti vetëm të qeshurën e hidhur të shpirtit krenar e të plagosur.

Si një meteor, ai mposhti për një çast errësirat dhe u zhduk. Kështu do të zhdukemi të gjithë, kështu do të zhduket toka, por nuk ka asnjë ngushëllim, bile, as për atë që na krijon dhe na vret, asnjë falje.

Për dyzet ditë brodhëm në Malin Athos dhe, kur duke mbyllur rrethin, më në fund, u kthyem për vit të ri, në Dafni, për të ikur, na priste mrekullia më e papritur, më vendimtare: në zemër të dimrit, në një kopsht të varfër, një bajame e lulëzuar!

Shtrëngova mikun për krahu, i tregova pemën plot me lule.

- Shumë pyetje torturuese, Angjellos, kanë shqetësuar zemrat tona gjatë gjithë pelegrinazhit; tani ato marrin përgjigje!

Miku im nguli shikimin mbi bajamen e lulëzuar; qëndroi i heshtur si përpara një ikone mrekullie, pastaj, me ngadalë:

- Një poemë po ngjitet tek buzët e mia; një poemë fare e vogël.

Shikoi përsëri bajamen.

- I thashë bajames unë:
- Motër, për Zotin më fol.
Bajamja ka çelur.

Kur ngela vetëm dhe mbylla sytë: ç'kishte ngelur nga mali Athos?

Nga aq shumë emocione e gëzime, nga aq shumë pyetje që na shqetësonin, mua dhe mikun tim, ç'kishte ngelur tek unë?

Çfarë kërkoja unë në malin Athos, çfarë gjeta?

Plagosjet e vjetra të adoleshencës sime, kur u mësuan dy të fshehtat më të tmerrshme, se toka nuk ishte qëndra e gjithësisë, dhe se njeriu nuk ishte një krijesë e privilegjuar, dalë direkt nga duart e Zotit, këto plagosje të vjetra, që ishin mbyllur për shumë vite, u hapën përsëri në Malin Athos.

Ishin këto dy ankthe metafizike: nga vijmë e ku shkojmë! Krishti kishte dhënë një përgjigje, një balsam, kishte shëruar shumë plagë; ky balsam a do t'i shëronte të miat? Për një farë kohe zilja, takimet e mëngjesit, psalmet, pikturat, ritmet hyjnore të jetës asketike kishin fashitur ankthin tim; jetoja shumë pranë përpjekjeve të Krishtit dhe kështu përpjekja ime merrte kurajë, forcohej, shpresonte. Por shumë shpejt magjia prishej dhe shpirti im gjendej vetëm. Përse, çfarë i mungonte atij? Cili i mungonte? Çfarë, pra, kërkonte shpirti im në Malin Athos, të cilën nuk e kishte gjetur dot.

Koha kaloi, pak nga pak unë fillova të dyshoja për to. Unë kisha shkuar në Malin Athos për të kërkuar atë që kisha kërkuar gjatë gjithë jetës sime, një mik të madh, një armik të madh, jo sa trupi im por më të madh, për t'u futur në luftë me të. Jo një grua. Asnjë ide. Diçka tjetër. Dikë tjetër. Kjo i mungonte shpritit tim, ai i mungonte shpirtit tim, ja pse atij i zihej fryma.

Dhe atë - për aq kohë sa qëndrova në malin Athos, unë nuk e kuptova veç më vonë. - Atë unë nuk e gjeta. Pra a gjendej atje fruti i gjithë bredhjeve të mia nëpër Athos?

Unë nuk gjeta, duke bredhur nëpër Athos, veç një luftëtar antik. Kështu m'u duk në fillim - që u shtrinte duart e tij të plagosura, murgjëve që kalonin pranë, këmbët e të cilit ishin me gjak. Faqet i kishte të futura brenda nga uria dhe midis zheleve i dukej trupi skeletik. Kishte ftohtë dhe sytë të mbushur me lot. Trokiste nëpër porta, askush s'e dëgjonte, kalonte nga manastiri në manastir dhe qentë kapeshin pas zheleve të tij. E pashë një mbrëmje ulur mbi një shkëmb, duke parë detin e shkretë. U fsheha prapa një pishe dhe po e përgjoja. Qëndroi ashtu për një kohë të gjatë i heshtur pastaj papritur duke mos mundur më, thirri: "- Edhe dhelprat kanë një strehë ku

flenë, ndërsa unë nuk kam ku të vë kokën!" Një dritë përshkoi shpirtin tim, unë e njoha, vrapova për t'i puthur dorën; prej fëmijërisë sime të hershme e kisha dashur atë, gjithmonë e kisha dashur. E kërkoja kudo, ai ishte i padukshëm. U ula mbi shkëmbin ku ishte ulur ai dhe fillova të vajtoj. Ah! Sikur të mundja të hapja zemrën time që të hynte ai, të strehohej dhe të mos kishte ftohtë! Fillova të mendoja për filozofin *Proklus*, në vitet ku, njerëzit kishin filluar të mos u besonin zotërve të Olimpit. *Proklus*, flinte në një shtëpi të dëmtuar në këmbët e Akropolit dhe papritur, në mesnatë, ai dëgjoi që trokisnin në portën e tij, u hodh nga shtrati dhe vrapoi ta hapte: te pragu, qëndronte në këmbë Athinaja e armatosur.

- *Proklus* - i thotë, - më ndjekin kudo, dhe unë erdha të pushoj mbi ballin tënd!

Ah! Sikur Krishti të mundej të strehohej kështu në zemrën time!

Unë kuptova për herë të parë duke u kthyer nga Mali Athos, se Krishti bredh, i pa strehë, i uritur, gjendet në rrezik dhe se është radha e njeriut ta shpëtojë atë.

Më pushtoi një hidhërim dhe dhembshuri e madhe; nuk doja të kthehesha në jetën e qetë e në mirëqënie, vazhdova rrugën, udhëtova ditë të tëra në malet e Maqedonisë. Gjeta një fshat të vogël tepër të varfër, të errët, kasolle të lyera me bajga, një tufë derrash dhe fëmijësh zhgërryheshin në baltë. Njerëzit më shikonin me një pamje të zymtë, unë i përshëndesja ndërsa ata nuk më përgjigjeshin, gratë që më shikonin mbyllnin portat.

- Këtu jam mirë, mendoja, ky fshat është mizor, njerëzit janë mizorë, këtu, ti shpirti im, do të tregosh në qoftë se mund të rezistosh.

Doja të përdorja forcën ndaj trupit tim, luftëtari i plagosur nuk më hiqej nga shpirti; vendosa të kaloj dimrin në këtë fshat.

Pas disa përpjekjesh arrita të bind një plak, një bari, që unë nuk isha keqbërës, as frankmason, as i marrë dhe ai pranoi të më jepte një qoshe të kasolles së tij për të fjetur dhe një copë bukë e qumësht për të ngrënë. Dru kishte me bollëk, unë qëndroja ulur pranë zjarrit. Me vete nuk kisha gjë tjetër veç ungjillit dhe Homerit, dhe, herë lexoja fjalët e dashurisë dhe të miqësisë të Krishtit, herë vargjet e pavdekshme të patriarkut të Greqisë. Ji i mirë, paqësor, i nënshtruar;

kur të godisin në një faqe, kthe faqen tjetër që të të godasin. Kjo jetë mbi tokë nuk ka vlerë, jeta e vërtetë është në qiell, përsëriste njëri. Të jesh i fortë, të duash verën, gratë dhe luftën; duhet të vrasësh dhe të të vrasin, për të mbajtur lart dinjitetin dhe krenarinë e njeriut; të duash jetën mbi këtë tokë, më mirë skllav i gjallë se sa mbret i vdekur, përsëriste tjetri, gjyshi i Greqisë.

Akenët ngjiten në majë të shpirtit tim, me hundën e tyre të madhe, muskujt e fuqishëm të këmbëve, këmbët e mëdha, me lëkurë të fortë, kofshët leshtore, mjekrat me majë, flokët e gjatë e të pakrehur, ata mbanin erë verë e hudhër. Helena shëtiste mbi bedena e pacënuar, e pavdekshme; ajo shkëlqente e papërlyer midis dritës dhe vetëm këmbët e saj të harkuara ishin të zhytura në gjak. Lart në re, Zotat rrinin ulur mbi frone, të qetë dhe kalonin kohën duke parë njerëzit që vriteshin me njëri-tjetrin.

Unë mbaja vesh këtu në vetminë time, dhe dëgjoja ato dy sirena. I dëgjoja, të dyja të kapura pas meje, ato më magjepsnin thellë, por unë nuk e dija në hijen e cilës sirenë duhej të lija kufomën time.

Jashtë binte borë, nga dritarja e ngushtë shikoja flokët që binin dhe mbulonin shëmtimin e fshatit. Çdo mëngjes kur kalonin bagëtitë më zgjonin me tingëllimat e zileve, çohesha me një kërcim, kaloja së bashku me to shtigjet e mbuluara me borë, këmbeja disa fjalë me bariun për varfërinë, të ftohtit, bagëtitë që dobësoheshin. Kurrë nuk dëgjova nga goja e tij një fjalë të gëzuar; ata flisnin vetëm për varfërinë, për të ftohtit, për bagëtinë që dobësohej.

Një ditë, kur gjithçka ishte mbuluar nga bora, fshatarët qëndronin mbyllur në shtëpitë e tyre, herëpashere një zile mushke çante ajrin e palëvizshëm. Kambana e fshatit filloi të binte përzishëm; dikush duhej të kishte vdekur. Nga baxhaja shikoja se si vinin vërdallë në ajër një tufë korbash të uritur. Kisha ndezur zjarrin në vatër, ngrohtësia përkëdhelte këndshëm si nënë, trupin tim. Isha i lumtur. Përnjëherë një ngashërim u ngrit nga thellësia ime, kjo lumturi, m'u duk si një tradhëti dhe një mëkat i madh. Një ngashërim i qetë, i butë, i pashpresë, si i një nëne që përkund djalin e saj të vdekur.

Nuk ishte hera e parë që ndieja ngashërim të tillë; kur isha i trishtuar, ajo qetësohej pak, e dëgjoja si gjëmim të largët vetëtime; por kur isha i gëzuar ajo shpërthente, e papërballueshme. Kush pra

qante brenda meje? - thërrisja duke u trembur. - Përse qante ai? Përse jam fajtor?

Kishte rënë nata; rrija, shikoja zjarrin, zemra duronte, kundër--shtonte për të vajtuar; përse të vajtoja? Asnjë trishtim nuk rëndonte në shpirtin tim. Qetësi, ngrohtësi, ajri fshatarak mbante erë sherebele e ftoi, unë rrija ulur përpara vatrës dhe lexoja Homerin, isha i lumtur. Jam i lumtur, thërrisja, çfarë më mungon? Asgjë. Kush pra qan tek unë? Çfarë do ai? Çfarë do nga unë?

Për një çast m'u duk se trokitën në portë, u çova. Qielli ishte shumë i pastër dhe yjet ndrinin si thëngjij të ndezur; dola përgjysmë nga porta, kërkova mbi rrugën e mbuluar me borë, nën dritën e yjeve, se mos dalloja gjurmë njeriu; asgjë. Mbajta vesh; një qen, në krye të fshatit i lehte vdekjes; duhet të kishte parë vdekjen shtrirë mbi borë. Një bari plak tepër i fortë, saqë e besonin të pavdekshëm kishte rënë në të ngrysur në një gropë, gjithë natën kishte qenë në agoni, dhe gjithë fshati gjëmonte nga grahma e tij buçitëse. Tani ai kishte heshtur; vetëm qeni i tij lehte e ulërinte një këngë funebre.

Vdekja më acaron nervat, ngushëllimet që bëhen për gjyqin e fundit dhe jetën e ardhme nuk kishin arritur akoma të më gënjenin; por akoma nuk kisha forcë të ndeshesha me vdekjen pa u tmerruar.

U zhyta tek Homeri, sikur kërkoja të pushoja në prehrin e gjyshit, vargjet e pavdekshme kalonin si dallgë dhe koka më gumëzhinte prej tyre. Nga thellësitë e shekujve, më vinte mbytur zhurma e zotave dhe e njerëzve që luftonin me eshta, shikoja Helenën që ecte me hap të lehtë mbi muret e Trojës, midis pleqsh, dhe përpiqesha, duke e parë, ta harroja, por shpirti im ishte tek vdekja. Ah! Mendoja,sikur zemra e njeriut të mund të ishte aq e fortë sa të luftonte me vdekjen! Sikur ai të ishte si Marie-Madalen, Marie-Madalenë putana, që ngjalli të dashurin e vdekur!

M'u shtrëngua zemra. Ah! Si mund ta ringjall, për t'u lehtësuar! Unë e shoh se ai qëndron akoma i vdekur, në thellësinë time; është ai që qan. Ai përpiqet të ringjallet, por nuk arrin pa ndihmën e njeriut; dhe ankohet me hidhërim tek unë. Si mund ta shpëtojë atë, për të shpëtuar veten time?

Gjyshi im do të ishte ngjitur mbi anijen e tij të piratit, do të kishte kaluar çdo ngushticë dhe do të shkatërronte vaporët turq, apo të

çifutëve, xhelatë të Krishtit. Kështu ai do ta kishte shkarkuar vrerin dhe të ishte lehtësuar. Babai im do të kishte shaluar pelën dhe do të hidhej mbi të pafetë, dhe në mbrëmje, kur të kthehej nga lufta, do të kishte vendosur përpara ikonostasit të shtëpisë sonë, nën ikonën e kryqëzimit, tyrbet e gjakosura të armiqve të të krishterëve; kështu do të ishte qetësuar ai dhe do ta kishte ndjerë Krishtin të ringjallur në zemrën e tij.

Babai im ishte një luftëtar sipas mënyrës së tij, dhe lufta ishte rruga që ai ndiqte për të lehtësuar dhe për t'u lehtësuar.

Çfarë do të kisha bërë, unë, mbeturina e fisit të tyre? Në Kretë, mbi malet e lartë, ndoshta rrallë ndodh, që në një familje gjigandësh të lind një krijesë e dobët. Gjyshi i vjetër e peshon, e peshon gjatë me shikim, dhe nuk arrin të kuptojë si dreqin ka mundur të dalë nga trupi i tyre kjo mbeturinë. Ai mbledh në një kuvend gjithë gjigandët, djemtë e tij, për të parë se ç'mund të bëjnë.

- Ai turpëron racën tonë, thotë i skuqur plaku, çfarë do të bëjmë me të? Bari, jo, ai nuk është i fuqishëm për të vjedhur në kopetë e tjera. Luftëtar, jo se jo, ai ka frikë të vdesë. Ai turpëron racën tonë! Prandaj e bëjmë mësues.

Unë, hej dreq! Unë isha mësuesi i familjes sime. Përse kundërshtoj? Unë nuk kisha ç'të bëja, veç të merrja pjesën time. Stërgjyshërit e mi do më kishin vlerësuar, unë kisha armët e mia, do të luftoja.

Binte borë. Zoti mëshirëmadh, mbulon me borën e tij shëmtinë e botës. Leckat që vareshin mbi gjerdhet e kasolles maqedonase, ku unë banoja, ishin shndërruar në gëzofë të bardhë dhe gjithë gjembaçët kishin çelur. Në ndonjë çast dëgjoheshin të qarat e një të porsalinduri, lehjet e një qeni, një zë njeriu, por, befas, çdo gjë heshtte dhe nuk dëgjohej gjë tjetër veç zërit të Zotit, qetësia.

Hodha në zjarr një kërcu dhe një krahë degë dafine që të mbante erën e saj, u përkula sërish mbi Homerin, por shpirti tashmë i kishte lënë trojanët, akenët dhe perënditë e Olimpit, vegimi i mbytur në rrezet e diellit, lëkundej para meje dhe pastaj zhdukej. Unë përsëri dëgjova veten time të qajë.

Ai qëndronte i shtrirë në varr, thërriste dishepujt që të vraponin, t'i hiqnin gurin e rëndë, të përkuleshin mbi errësirë e të thërrisnin drejt tij; atëherë ai do të ngjitej përsëri mbi tokë. Por askush nuk vi-

nte, ai filloi të ankohej, ai qante.

Shikoja flakët që shuheshin në vatër, shikoja apostujt që mblidheshin të tmerruar nën një shkallare: - Ai ka vdekur, Rabini, ka vdekur! Duhet pritur nata që të lëmë Jerusalemin dhe të shpërndahemi. Vetëm një grua u ngrit e vetme dhe këmbënguli; ajo nuk e pranoi vdekjen dhe Krishti ishte ngjalluar në zemrën e saj. Këmbëzbathur, e pakrehur, gjysmë e zhveshur, vrapoi në të gdhirë drejt varrit. Ajo ishte e sigurt se do ta shikonte Krishtin dhe e pa, ajo ishte e sigurt se Krishti do të ringjallej dhe ai u ringjall.

- Rabini! - thërriti ajo.

Rabini dëgjoi zërin e saj benda varrit, u ngrit dhe u shfaq në dritën e mjegullt të mëngjesit, duke ecur mbi lëndinën pranverore. Koka m'u mbush me këtë vizion të ringjalljes, një afsh i nxehtë, shumë i ëmbël, më rëndoi qepallat, gjaku filloi të më rrahë me forcë në tëmtha. Dhe po ashtu, siç bëhen retë, kur fryn ndonjë erë e fuqishme, që marrin trajtat e njeriut, të kafshëve, të anijeve, ashtu bëheshin vizionet e mia, tek rrija përkulur pranë zjarrit me shpirtin që gufonte, bëheshin fytyra njerëzish, mbuluar nga pasioni dhe era. Por menjëherë këto fytyra bëheshin më të imta, rralloheshin si tym në kokën time, në fillim të dobëta dhe të pasigurta por gjithnjë e më shumë të vrullshme dhe të sigurta, fjalë që përforconin atë që nuk arrinte të përforcohej. Unë e kuptova. Era fekonduese që kishte fryrë në qënien time kishte sjellë frutat e saj, një embrion ishte formuar, dhe tani përpiqej të dilte në dritë. Mora penën e fillova të shkruaj, të lehtësohem, të krijoj.

Nuk nisa nga fillimi; është Madalena që u shfaq e para, e padueshme, me flokë lëshuar. Larë në lotë. Ajo ishte zgjuar duke brofur, para se të gdhihej, e kishte parë Rabinin në ëndërr dhe si një gjahtar zogjsh që i magjeps ata, filloi të thërresë:

Oh! Ç'është kjo lumturi dhe unë nuk mundem
të zgjohem, aq e madhe është butësia e erës!
Çohu ti, zemra ime dhe godite tokën që ajo të hapet!
Supet e tokës sime dridhen si krahë zogu.
Por jam i lodhur! Trupi im është i rëndë dhe dita vonë po zgjohet!
Mos u ngut, shpirti im, më jep kohë të vishem e të shkoj:

ja unë vishem si një dhëndërr dhe më duket se po mbaj
mollën në duart e mia, zgavrën e këmbëve të mia me këna dhe
sytë e mi
me pak khol që bashkojnë qerpikët e mi me farën e bukurisë.
Si godet tokën dhe qiellin e madh dashuria
me ngadalë godet gjirin tim dhe e mban varur
në lotë, në gëzim, Fjala si një burrë
Dhe kur më në fund do të arrija të ndieja lulëzimin
në varrin e saj të dashur, si grua
e lënë nga burri i saj, unë përqafoja
gjunjtë e tu të zbehtë, o Krisht, për të mos shitur...
Unë do të flisja e do t'i qetësoja gjunjtë e tu...
Veçse ata të bëjnë hasha krejt, o Krisht, ti nuk do të vdesësh më:
Se unë ruaj në gjirin tim unë Përtëritjeje
dhe të jap për të pirë dhe ti do të ngrihesh mbi tokë
dhe do të ecësh me mua nëpër fusha.
Unë do të cicëroj si zog i dashuruar
mbi degën e një bajameje që lulëzon nëpër dëborë
dhe të këndoj si ai në ekstazë me sqepin lart ngritur
drejt qiellit, derisa të lulëzoj krejt dega!

Nuk mund të flija më, isha ngritur: doja megjithatë që fytyrat të fikësoheshin një çast, të kisha kohën e duhur që ta mbyllja me fjalë themelie-apostujt, Madalena, krishti: mjegulla që mbështjell një trup, gënjeshtra që bëhet e vërtetë, shpirti që ka qëdnruar mbi më të lartën degë të shpresës dhe që këndon...

Në krye të disa ditëve dhe të disa netëve, dorëshkrimi i tragjedisë ishte i tëri mbi gjunjët e mi dhe unë e mbaja shtrënguar, si mban nëna birin e saj të porsalindur në prehër.

PRANVERË PLOT HIJESHI

Kishim hyrë në Kreshmët dhe Pashkët po afroheshin. Unë shëtisja nëpër fusha, bota ishte kthyer në një Kopsht, toka ishte mbuluar me ngjyrë të gjelbër, borërat e Olimpit vezullonin nën rrezet e diellit. Dallëndyshet po ktheheshin nga shtegëtimi dhe, si sovajkat e një tezgjahu, thurnin në ajër pranverën; lule të egra të vogla, të bardha, të verdha, ngrinin dheun përjetë me kokën e tyre të brishtë, dilnin në dritën e diellit për të parë edhe ato tokën nga lart. Dikush duhej të ngrinte mbi to rrasën e varrit prej dheu dhe ato të ringjalleshin. Dikush; kush pra? Sigurisht Zoti, fytyrat e të cilit ishin të panumërta, herë lule, herë zogj, herë sytha hardhie, e herë kalli gruri.

Shëtisja në fushat e lulëzuara dhe një shastisje e këndshme shpaloste rreth meje kohën dhe hapësirën; nuk është Greqia, mendoja, unë po shëtis në Palestinë, dalloj gjurmët akoma të freskëta që kanë lënë hapat e Krishtit, mbi tokën e butë pranverore dhe rreth meje ngriheshin malet e shenjtë, Kameli, Gelboa, Tabori. Nuk është grurë, ai që ka gufuar tokën dhe që ka lartësinë e njeriut, nuk janë lulëkuqe ato; ai është Krishti që ka dalë nga varri dhe ato janë gjaku i tij.

Një ditë pyeta *rabinin** Nahman: - A mund të na thuash, se kur dëshiron ti të shkojmë në Palestinë? Palestina duhet të jetë një ide, një ideal i largët që duhet të arrijnë një ditë shpirtrat çifutë. Nahmani zemërohet, nguli shkopin në tokë:

- Jo, jo, - thirri; kur unë them Palestinë, dëgjoj gurët e saj, barërat, tokat e Palestinës. Palestina nuk është një ide, janë gurët, barërat, tokat; atje duhet të shkojmë!

- Atje më duhet të shkoj! Të shoh e të prek trupin e ngrohtë të Palestinës, jo të kënaqem me të në imagjinatë, duke shëtitur malet dhe tokat e Greqisë. Të thith ajrin, të shkel tokën, të prek gurët, që

** kryetari i komunitetit fetar çifut*

ka thithur, ka shkelur e ka prekur Krishti. Të ndjek gjurmët e gjakut që kanë shoqëruar kalimin e tij midis njerëzve. Të nisem! Ndofta atje do të gjej atë që kam kërkuar më kot në Malin Athos.

Era e nisjes fryu përsëri në shpirtin tim. Gjer kur do të fryjë kjo erë në shpirtin tim? Falë Zotit që ajo po fryn deri në vdekjen time. Të gëzohesha për t'u ndarë nga toka e fortë e të ikja. Të prisja litarin që ne na lidhte e të ikja! Të shihja prapa dhe të shikoja sesi do t'më largoheshin njerëzit dhe malet që aq shumë i doja!

Java e Pasionit afrohej, tek të gjithë të krishterët Krishti do të kryqëzohet, pesë plagët e pavdekshme do të hapen dhe Marie-Madalena do të vejë të luftojë me vdekjen. Çfarë lumturie të zbulosh se zemra jote është akoma si një zemër fëmije dhe të vuash këto ditë, duke mos ngrënë, duke mos fjetur, të shkosh në darkën e kryqëzimit dhe të ndjesh të rrjedhin lotët duke parë mbi kryq të përpëlitet trupi i Zotit tënd, mbuluar me lule limoni. Të gjesh dritaret e kishës të hapura, duke lënë të hyjë pranvera; të duash një vajzë, dashurinë tënde të parë, dhe t'i premtosh të takohesh me të pranë kryqit të madh, për të admiruar së bashku, në mesditë, të premten e shenjtë; të dridhesh, sepse duke qenë shumë të rinj, ju besonit se është mëkat të bashkoni buzët tuaja me ato të vajzës përpara trupit të Zotit...

Mbylla Homerin, putha dorën e gjyshit të pavdekshëm, por nuk guxova të ngre kokën e ta shoh në sy; kisha turp përpara tij, kisha frikë nga ai, sepse e dija se këtë çast po e tradhëtoja: unë e braktisa dhe mora me vete armikun e tij të madh Biblën.

Qielli nuk ishte zgjuar akoma, as toka; vetëm mbi një çati një gjel zgjaste qafën drejt diellit dhe thërriste fort, nata kishte zgjatur shumë.

Hapa portën me kujdes si hajdut, sikur kisha frikë se mos gjyshi i madh më dëgjonte dhe mora rrugën drejt portit, për të ikur. Grupe grash dhe burrash kishin zbritur nga fshatrat, për të hipur në anije e të shkonin në Palestinë në pelegrinazhin e varrit të shenjtë. Kurrë nuk do ta harroj atë mbrëmje; çfarë kënaqësie, çfarë ngrohtësie kishte, çfarë dhembshurie! Binte një shi i imët, i qetë, dhe në qoftë se do të ngrije kokën për të parë qiellin, do të shihje fytyrën e Zotit larë në lot...

Mbi anije, mbi urë, ishin vendosur qilima shumëngjyrësh të llan-

gosur me baltë, një grumbulll grashë të vjetra kishin hapur shportat e bukës dhe mbllaçiteshin, mbante erë qepë gjithandej. Në mes, një plak me faqe te kuqe, me flokë të gjatë e të thinjur, lexonte me zë të lartë e psalte, duke lëkundur trupin, historinë e Krishtit, jetën e tij, pasionin, si ishte ngjitur në Jeruzalem, pastaj sesi dishepujt kishin ngrënë ushqimin e hidhur të drekës mistike, sesi dishepulli tradhëtar kishte ikur me nxitim dhe sesi Krishti ishte ngjitur në malin e Ullinjve, ku djersa i rridhte mbi ballë "si gjak i mpiksur..."

Plakat e rrëgjuara, me shamitë e zeza në kokë dëgjonin me dhimbshuri, tundnin kokat, psherëtinin dhe nuk pushonin së mbllaçituri qetësisht, pa zhurmë, si dele. Zoti bëhej njeri, ishte kryqëzuar sërish në zemrat e tyre naive dhe shpëtonte përsëri njerëzit. Një bari fare i ri, duke iu kthyer shpinën grave, dëgjonte i përkulur, gdhendte me biçak në majë të shkopit, një kokë zogu.

Befas, kur u tha nga etja e padurueshme, krishti thërret: "Kam etje!" Një grua e re dhe e shëndoshë, u hodh e ekzaltuar dhe nxori një klithmë: "Fëmija im!" U trondita kur dëgjova thirrjen e thellë prej nëne, të kësaj gruaje që e quante Zotin fëmijën e saj.

Lamë prapa detin Egje, po hynim në lindje. Nga e djathta jonë, e padukshme, Afrika; në të majtë ndërmjet qiellit dhe detit Qiproja. Deti shkëlqente, dy flutura të përqafuara erdhën vërdallë mbi litarët; një zog i uritur që na ndiqte i sulmoi dhe hëngri njërën prej fluturave. Një vajzë e zbehtë dhe e brishtë, filloi të thërrasë, dikush tha: - Lëreni, ashtu duhet, për çfarë e merrni ju Zotin? Për një femër të dobët?"

I afrohemi vendeve të përvëluara nga dielli, ku një ditë, në kohët e vjetra, në një kasolle të thjeshtë në Nazaret, shpërtheu flaka që dogji dhe rinoi zemrat e njerëzve. Sot, ashtu si përpara dymijë vjetëve, jeta ndodhet në një gjendje shkatërrimi; por problemet që sot prishin ekuilibrin e shpirtit dhe të zemrës janë më komplekse, ndërsa zgjidhja e tyre mjaft e vështirë dhe e përgjakshme. Atëherë është ngritur një zë shumë i ngrohtë dhe mbi tokë, si pranverë, ka rënë përshëndetja e tij. Nuk ka patur fjalë më të thjeshtë e të ngrohtë. Kush e di? Ndofta ajo do të na shpëtojë përsëri. Prandaj shkojmë në Jeruzalem, për të dëgjuar zërin e djalit të Marisë.

Kishte rënë nata, unë u shtriva për të fjetur, por poshtë në hambar

kishte shpërthyer një diskutim i fortë, e unë mbaja vesh. Një burrë që me zërin e tij të fortë dukej i ri, denonconte me pasion poshtërsinë dhe padrejtësinë e jetës ekonomike e sociale aktuale: populli ka uri, të pasurit shtojnë paratë, gratë shiten, priftërinjtë nuk kanë besë; këtu, mbi këtë tokë, janë Ferri dhe Parajsa, këtu duhet të gjejmë drejtësinë dhe lumturinë, nuk ka tjetër. U ngritën disa zëra:

- Po, po, ai ka të drejtë! Zjarr dhe shpatë, vetëm një burrë që unë e njoha nga zëri, dhjaku që udhëtonte me ne, u përpoq të kundërshtonte, por zëri i tij humbi në mes të thirrjeve dhe të qeshurave.

U ngrita i mërzitur nga krevati të dëgjoja më me vëmendje; ai hambar anijeje më dukej si një katakomb i ri, ku skllevërit e kohës sonë ishin mbledhur dhe komplotonin për të tronditur botën. U tremba. Ne shkonim për të adhuruar fytyrën e ëmbël dhe të afërt të Zotit, plot mirësi, vuajtje dhe shpresa; gratë mbartnin me vete bukën e bekuar, qirinj, lotë dhe lutje; ata që nuk besonin, lart në klasin e parë, të kujdesshëm, flisnin për politikën ose flinin; ndërsa poshtë në fund të hambarit, ne transportojmë dhuratën e tmerrshme, farën e një *kozmogonie* të re, akoma inorganike, të rrezikshme Një botë e shenjtë, e dashur, është në rrezik; një tjetër, e ashpër, plot baltë dhe zjarr, e plot jetë, ngrihet nga toka dhe nga zemra e njeriut; ajo hipën mbi gjithë anijet dhe udhëton e ngjeshur në fund të hambareve.

Të nesërmen, filloi të duket nga larg nën mjegullën e lehtë, Toka e premtuar. Në fillim një vijë e drejtë midis qiellit dhe detit, pastaj malet e ulët të vendit të çifutëve, në fillim bojë hiri, pastaj blu të çelët; më në fund u zhdukën të mbytura nën dritën e fortë të ditës. Plakat u ngritën, mblodhën bohçat, shtrënguan shamitë e zeza rreth kokës dhe filluan të bëjnë kryq e të qajnë.

Një plazh, kopshte, femra të zeshkëta, të papastra, fiq, hurma... automobilat nxitojnë për t'u ngjitur në qytetin e shenjtë. Zemrat rrahin me nxitim; mure të trashë, bedena, porta të fortifikuara, aromë erëzash, duhani dhe frutash të pjekura, zëra me grykë, të ashpër, fantazmat ngrihen nga toka, gjithë profetët e vrarë; gurët përgjaken, bëhen të gjithë bashkë dhe thërrasin: Jeruzalem.

Unë nuk dua, nuk dua ta kujtoj në shpirtin tim këtë Javë të Pasionit. Shpresa, dashuria, tradhëtia, sakrifica, klithma: Zot, o Zot, përse më ke braktisur? Aventura tragjike e njeriut u bë e shndritshme ato shtatë ditë. Nuk ishte Krishti, ishte njeriu, çdo njeri i drejtë, çdo njeri i pastër, që qe tradhëtuar, që qe fshikulluar, që qe frymëzuar, derisa Zoti i shtriu dorën për ta ndihmuar. Dhe në qoftë se nuk do të kishte qenë zemra e ngrohtë e një gruaje, ai do ta kishte lënë të shtrirë në varr, përjetësisht. Shpëtimi i njeriut qëndron në një fill, në një klithmë dashurie.

Netët kaluan njëra pas tjetrës dhe unë mbërrita në agimin e shenjtë të Pashkës. Tempulli i ringjalljes, zhurmonte si një koshere gjigande. Era e qirinjve prej dylli blete mbushte gjithë tempullin, me të përzihej era e djersës njerëzore, e sqetullave të bardha, të zeshkëta apo të zeza. Nën hapësirën e tempullit, burra dhe gra kishin fjetur natën, duke pritur çastin kozmogonik kur do të ndrinte nga varri i Krishtit, drita e shenjtë. Xhezvetë e kafesë ziejnë nën ikona, nënat zbulonin gjokset dhe ushqenin të vegjëlit. Një ajër i rëndë, erë që të mbyste, qiriri dhe vaji mbushte ajrin e tempullit. Zezaket kishin lyer flokët me sallo, që shkrinte nga nxehtësia dhe lëshonte erë dhije; zezakët lëshonin një erë të tmerrshme cjapi.

Pelegrinët vinin valë-valë; tempulli nuk nxinte më, disa ngjiteshin nëpër kolona, të tjerë kalëronin fronat, disa vareshin te tribuna e grave. Shikimet ishin përqendruar në mes të kishës mbi perden e vogël prej nga do të shpërthente drita e shenjtë. Zezakë me festet e tyre, të mbështjellë me pëlhurat shumëngjyrëshe, me sy të zjarrtë; beduinët, abisinasit, gjithë racat njerëzore, thërrisnin, qeshnin, psherëtinin; një burri të ri i ra të fikët, e ngritën si një copë druri dhe e nxorën në oborr. Një prift, i vjetër e i dobët, i veshur me një raso të bardhë e rrip të kuq, bie mbi pllakat e dyshemesë duke shkumëzuar.

Befas, turma heshti; sytë që digjnin mbushën sallën. U duk patriarku, i veshur i gjithë me ar, pa folur, u përkul dhe hyri i vetëm nën perden e vogël në mes të kishës. Nënat hipën fëmijët mbi supe që të shihnin, fshatarët egjiptianë ngelën gojëhapur; sekondat binin si pika të ngjeshura mbi kokat e njerëzve; ajri tendoset e dridhet si lëkurë tamburi. Dhe ja një dritë u shfaq tek perdja e shenjtë, ndërsa duket patriarku, me një buqetë qirinjsh të bardhë të ndezur. Nga

një dritë e vetme, tempulli u mbush me flakë. Të gjithë, duke mbajtur në dorë qirinj të bardhë, u drejtuan për tek patriarku për të marrë dritën; vendosnin dorën tek flaka dhe fërkonin fytyrën dhe gjoksin. Burrat filluan të kërcenin, gratë të bërtisnin. Të gjithë, duke bërtitur, u drejtuan nga porta për t'u larguar.

Tempulli është boshatisur; gjithë ajo zhurmë e frikshme, turma e papërmbajtur, mbuluar me rroba shumëngjyrëshe, m'u duk si një ëndërr fantastike; por duke ecur mbi pllakat e kishës, u sigurova se gjithë ky vizion oriental ishte i vërtetë, sepse unë pashë në tokë mbi pllaka, mbetjet e shumta të ekstazës: lëkurë portokallesh, fara ullinjsh, shishe të thyera.

Dola në oborr, në ajër të pastër, për të marrë frymë.

Doja të ikja së andejmi, digjesha nga dëshira të gjendesha në malet e zhveshur, të shkretë, që ishin përballë meje, të ecja, të ecja, të mos shihja gjë tjetër veç diellit, hënës, dhe gurëve, sepse, ndërsa rreth meje shpërthente dehja kolektive dhe besnikët vegimtarë këmbëngulnin duke thirrur, duke kërkuar patjetër që Krishti të dilte nga varri, unë mbahesha dhe nuk e lëshoja zemrën të dehej; shpirti, ashtu si trupi, kishte turp dhe nuk pranonte të zhvishej përpara turmës. Mirëpo, sapo ngela vetëm, duhet të ikja, të ikja, të thërrisja, të hyja në shkretëtirë, atje Zoti fryn si erë përvëluese, atje do të zhvishem dhe ai do të më djegë.

- "Shpirt, thotë Zoti, mos ik, qëndro! - Çfarë do prej meje, o Perëndi? - Shpirt, unë dua që ti të zhvishesh. - Zot, si mund të ma kërkosh një gjë të tillë? Kam turp. - shpirt, asgjë nuk duhet të ketë midis nesh që të na ndajë, bile asnjë rrobë e lehtë, pra duhet, që ti të zhvishesh. - Ja, Zot, unë u zhvesha; më merr!"

Këndoja me veten ato fjalë të përjetshme të një shpirti të dashuruar me Zotin dhe mora rrugën që të çon në Detin e Vdekur. Digjesha nga dëshira të shihja gropën që kishin formuar dy qytetet mëkatare të mbytyra. Shkëmbinjtë gri, të verdhë, të kuq, një diell kompakt e i ashpër, derdhej mbi to, ata pinin duhan; herëpashere frynte një erë përvëluese dhe më mbushte gojën dhe shpirtin me rërë. Gurët rrinin të ngërthyer me njëri-tjetrin, asnjë lule, asnjë pikë uji, asnjë këngë zogu që të përshëndeste kalimtarin. Vetëm Zoti rrinte mbi kokën time si shpatë.

"Nuk është Krishti, mendoja duke u dridhur, nuk është djali i Maries me fjalën e ngrohtë; është Jehovai i tmerrshëm, ngrënës i njerëzve; unë nuk gjeta atë që kërkoja. Si mund të shpëtoj nga rrathët e errët e të pakapërcyeshëm të qetësisë së tij?"

Koka më përvëlohej sa më shumë futesha në shkretëtirë, ajo i thërriste Zotit të dukej, të më fliste. A nuk ishte ai që më bëri njeri? Njeriu a nuk është një kafshë që pyet? E, mirë! Unë do ta pyesja, mbase më përgjigjej.

- Zot, - i lutesha me zë të ulët, nën pështjellimin e erës, - Zot, po kaloj një çast të vështirë, ç'të bëj?

Vendos mbi buzët e mia një thëngjill të ndezur, një fjalë; fjalën e shenjtë që lehtëson. Prandaj kam zbritur nga drita e madhe, këtu në këtë gropë të errët për të të takuar; Shfaqu!

Prita, prita, askush nuk u përgjigj.

SODOMA E GOMORREJA

Që në fëmijëri, kur lexoja në oborrin e shtëpisë prindërore legjendën e shkëlqyer të shenjtorëve, digjesha nga dëshira të shkelja këto toka që po shkelja tani, gurët që kishte shkelur Krishti dhe të dëgjoja zërin e tij. Gjithmonë kisha diçka për t'i thënë atij, akoma kisha diçka për t'i thënë, nuk do t'më mishëronte ai mua? Po, a do të përgjigjet! Bota rrotullohet dhe ndryshon nga pyetjet, nga ankthet, nga djajtë; Krishti ndoshta kishte një fjalë të re për të thënë, për të shëruar plagët e reja; për t'i dhënë dashurisë një fytyrë të re më burrërore.

Unë ecja dhe flisja me vehte; thithja ajrin e shkretëtirës, përbërë nga flakët dhe rëra të cilën e kanë thithur dhe futur në trupin e tyre edhe profetët. Papritur, kur arrita ne fund të gropës, pashë të shkëlqente, gri, i palëvizshëm, si plumb i shkrirë, me ujë të ngjeshur e të trashë, si rrëshirë viskoze, Detin e Vdekur; në mes të luginës, ndërmjet kallamave dhe marinave, vraponte Jordani, shumë i gjelbër.

Dukeshin grupe njerëzish, që mbanin bluza të gjata; një hoxhë, ulur mbi breg, këndonte faljet, ndërsa njerëzit e tij zhyteshin në ujërat e shenjtëruara dhe bëheshin haxhinj.

Mbi breg ishte ngritur me kallama një tavernë; një fonograf i vjetër duke u rrotulluar mjaullinte amanete arabe, ndërsa tavernieri i shëndoshë, mbuluar me një përparëse të pistë, përcëllonte në zjarr shpendët e rrjepur dhe belbëzonte fjalë që shoqëronin gramafonin.

Nxitova hapat, arrita bregun e helmët të Detit të Vdekur, hyra në shkretëtirë. Shikimi im aq shumë i ngacmuar, duke u dridhur, u fiksua mbi ujërat e vdekura, sikur përpiqej të dallonte në fund të tyre qytetet binjake të mbytura.

Ndërsa shikoja përpara, një dritë e verdhë e përshkoi shpirtin tim dhe unë pashë se një këmbë e fuqishme dhe e mërzitur, kishte kaluar atje dhe kishte shtypur të dy qytetet, Sodomën dhe Gomorenë dhe i kishte mbytur të dy. M'u shtrëngua zemra; një këmbë shumë e fuqishme do të dërrmojë një ditë Sodomet dhe Gomorret tona dhe kjo botë që qesh, feston, harron se Zoti do ta bëjë të gjithën një det të vdekur. Kështu, në çdo ndalesë, këmba e Zotit shkel dhe dërrmon qytete shumë të ngopur e shumë inteligjentë.

U tremba sa s'ka më. Më duket se bota sot është Sodomë e Gomorre, pak kohë përpara se Zoti të kalojë mbi të. Besoj se e dëgjoj që tani hapin e tij të tmerrshëm që afrohet.

U ndala mbi një dunë të ulët, qëndrova ashtu për një kohë të gjatë duke parë ujrat e mallkuar; u përpoqa të nxjerr nga gjoksi i tyre i ngjeshur qytetet e këndshëm mëkatarë, t'i nxjerr sa të ndrijnë për një çast nën rrezet e diellit, që unë të kem kohë t'i shoh, që qepallat e mia të përplasen një herë pastaj qytetet le të zhduken.

Sodoma dhe Gomorreja shtriheshin në breg të lumit si dy putana dhe përqafoheshin; burrat bashkoheshin me burrat, gratë me gratë, burrat me pelat, gratë me demat. Hanin me tepëri frutat e Pemës së Njohjes. Ata kishin thyer statusin e tyre të shenjtë dhe panë befas, se nuk ishin veç drurë dhe gurë. Kishin thyer idetë dhe panë se gjendeshin midis erës së fortë. I qenë afruar Zotit dhe i kishin thënë: "Ky Zot është bir i Frikës dhe jo Babai i Frikës"; kështu e humbën frikën. Shkruajtën me gërma të mëdha të verdha mbi katër portat e fortifikuara të qytetit të tyre: *KËTU NUK KA ZOT! KËTU NUK KA ZOT!* - Zot, ç'do të thotë kjo? Nuk mund t'u vësh kapistër instinkteve tona. Nuk ka as virtyt, as turp, as drejtësi, ne jemi ujqër dhe ulkonja në afsh.

Zoti u zemërua, thirri Abrahamin: - Abraham! - Urdhëro, Perëndi! - Abraham, merr bagëtitë e tua, devetë e tua, qentë, skllevërit burra dhe gra, gruan tënde, djalin tënd dhe ik! Ik! Unë e kam marrë vendimin. - Perëndi, në gojën tënde kjo do të thotë: do t'i vras! - Zemra e tyre ka qenë shumë e gëzuar, shpirti i tyre është bërë shumë i fortë, barku i tyre si tepër i ngopur, unë nuk mund ta duroj këtë! Ata i ndërtojnë banesat e tyre me gurë dhe hekur, që të jenë të pavdekshme; ndërtojnë furra, bëjnë zjarre të fortë, shkrijnë metale. Unë shpërndava mbi fytyrën e tokës lebrën, shkretëtirën, sepse kështu duhej. Njerëzit atje poshtë në Sodomë e në Gomorre, ujisin, pijnë duhan, shndërrojnë shkretëtirën dhe e bëjnë atë kopsht... Uji, hekuri, gurët, zjarri, këta elementë të pavdekshëm, janë bërë skllevërit e tyre.

Unë nuk i duroj dot më këto! Ata kanë ngrënë nga frutat e Pemës së Njohjes, ata do të vdesin! - Të gjithë, Zot? - Të gjithë! A nuk jam unë i gjithëfuqishmi? - Jo, ti nuk je i gjithëfuqishmi, Perëndi, sepse ti je i drejtë. Ti nuk mund të fillosh padrejtësinë, as poshtërsinë e as absurditetin - Çfarë është drejtësia apo padrejtësia, ç'është ndershmëria dhe poshtërsia, arsyeja ose absurditeti, çfarë mund të dini ju të tjerët, krimba të fortë të tokës, ushqyer nga toka, që përsëri do të bëheni tokë? Vullneti im është absolut. Në qoftë se do të gjendeshit përballë tij do t'ju kapte tmerri. - Ti je Zot i tokës dhe i qiellit, ti mban jetën dhe vdekjen në të njëjtën dorë dhe ti zgjedh; unë jam një krimb toke; unë jam ndërtuar nga balta dhe uji, por ti më dhe frymë, dhe nga balta e uji shpërtheu shpirti, unë do të flas! Mijëra shpirtra, hanë, pinë, qeshin dhe përqeshin, lyhen e zbukurohen, në Sodomë e Gomorre; mijëra shpirtra janë fryrë si gjarpërinj dhe dërgojnë në helmin drejt qiellit dhe vërshëllejnë. Por, në qoftë se gjenden midis tyre, Perëndi, dyzet të drejtë, do t'i djegësh? - Dua emrat! Cilët janë këta dyzetë? - Në qoftë se gjenden njëzet, njëzet të drejtë, Perëndi? - Dua emrat! Hap gishtërinjtë dhe numëro. - Në qoftë se gjenden pesë? - Abraham, mbylle atë gojë të paturpshme. - Perëndi, mëshirë! Ti nuk je vetëm i drejtë, ti je edhe i mirë, o Zot, prandaj ndërtesa e botës mund të qëndrojë akoma në këmbë në hapësirë. - Nuk të gjunjëzohem, mos i shtrij duart për të më shtrënguar gjunjtë; unë nuk kam gjunjë! Mos fillo të më përkëdhelësh për të më prekur! Unë jam një bllok graniti i zi, asnjë dorë nuk mund të gdhendë gjë mbi mua; unë e kam marrë vendimin: Do ta djeg Sodomën e Gomorrenë!

- Mos u nxito, Perëndi; përse të nxitohesh kur ti do t'i vrasësh? Unë e gjeta! Çfarë gjete, krimb, duke gërvishtur tokën? - Një të drejtë. - Cilin, pra? Djali i vëllait tim Haran, Lotin.

I palëvizur mbi dunë, ndieja se po më çaheshin tëmthat. Brenda vetes sime dëgjoja zërin e Zotit dhe të njeriut që luftonin me njëritjetrin. Për një çast m'u duk se ajri u bë i ngjeshur dhe përpara meje ngrihej, i egër, këmbëzbathur me një mjekër lumi dhe me një flakë të madhe mbi ballë, Loti. Jo Loti i Testamentit të Vjetër, por një Lot imi, rebel, që nuk i bindej Zotit, që nuk do të ikte për të shpëtuar, por do të kishte mëshirë për qytetin e hijshëm mëkatar që do të hi-

dhej me dëshirë në zjarr, do të digjej, për t'u zhdukur së bashku me ta.

- Thuaj atij, - i thërriste Abrahamit, - se unë nuk iki! Thuaji se unë jam Sodoma e Gomorreja, unë nuk largohem! A nuk thotë ai se unë jam i lirë? A nuk thotë ai duke u krekosur, se më ka krijuar për të qenë të lirë? E po mirë! Unë bëj ç'të dua, unë nuk largohem.

- Unë po i laj e përsëri po i laj duart prej tij, rebel, unë po iki. - Udhë të mbarë plak i virtytshëm; udhë të mbarë, dash i Zotit! Dhe thuaji mësuesit tënd: Ke shumë të fala nga Loti yt i vjetër! Dhe thuaj atij edhe këtë: ai nuk ka të drejtë. Ai nuk është as i drejtë dhe as i mirë; ai është i gjithëfuqishëm dhe vetëm i gjithfuqishëm, kaq!

Dielli kishte rënë, drita ishte pakësuar, koka më ishte trashur. Sikur dilja nga një luftë e pashpresë, mora frymë thellë dhe pashë pas meje; u tmerrova: Si mundi të ngjitej në trupin tim një rebel i tillë? Ku ishte fshehur, në thellësinë time, pas Zotit, ky shpirt i egër e i pabindur? Unë që me patriarkun Abraham isha i bindur dhe i devotshëm, si mund ta lija tani, të shkelja me këmbë Shkrimet e Shenjta, të krijoja një Lot të tillë, dhe të bëhesha një me të?

Në thellësi të qënies time ishte fshehur demoni dhe priste që të qetësohesha pak, që shpirti im të linte çelësat e ai të hapte kapakun e të dilte jashtë; dhe të ngrihej kundër kundërshtarit të përjetshëm, Zotit.

Duhej të pastroja thellësinë e qënies sime, të largoja nga vetja demonët. - Ujqër, derra, majmunë, femra, virtyte të vogla, gëzime të vogla, kënaqësi; - tek unë të ngelet vetëm një flakë e drejtuar drejt qiellit. Atë që kisha dëshiruar kur isha fëmijë, në oborrin e shtëpisë prindërore, vetëm atë! Pikërisht atë do ta realizoja tani që isha burrë. Njeriu lind vetëm një herë, nuk do të kisha rast tjetër.

Kishte rënë nata kur unë u ktheva në Jeruzalem; yjet më dukeshin si mijëra lëmshenj të zjarrtë që qëndronin varur mbi njerëzit; por askush në rrugët e shenjtëruara të Jeruzalemit nuk i kishte ngritur sytë për t'i parë nga frika e një tmerri. Pasionet e përditshme, ndodhitë e vogla, portofolet, të ngrënët, gratë, triumfonin mbi llahtarinë e madhe dhe njerëzit kështu mundnin të harronin dhe të ecnin.

"Ka ardhur koha të vendos, mendoja, duke u rrotulluar mbi shtratin tim të fortë, ka ardhur koha të kryej atë që mendoja kur isha fëmijë dhe e lexoja mbi buzët e Zotit."

Në Malin Athos një murg më mori dorën për të lexuar në vijat e saj dhe për të më treguar të ardhmen time. Në të vërtetë ai kishte një fytyrë cigani, të zezë, buzë të trasha si buzë cjapi, sytë i lëshonin xixa.

- Unë nuk besoj në magjinë tënde, i thashë duke qeshur.

- S'ka gjë, besoj unë, kjo mjafton.

Ai i pa vijat e dorës sime, yjet, kryqet, rrudhat.

- Nuk të përzihet, - tha pas një studimi të gjatë. - Ti nuk je bërë për veprim, qëndro larg. Ti nuk mund të luftosh me njerëzit; gjatë kohës që ti lufton, mendon se mos armiku yt ka të drejtë dhe çfarëdo që të bëjë ai ti e fal më në fund. Kuptove?

- Gabon! - i thashë, por, në të njëjtën kohë, u trondita ca, sepse po konstatoja që ky murg, i cili më shihte për herë të parë, kishte të drejtë.

Më pa përsëri dorën me vëmendje:

- Ke shumë shqetësime, je shumë kërkues, ti shtron shumë pyetje që të hanë zemrën; por dëgjo një këshillë: mos u mundo të gjesh përgjigjen, mos e kërko; kjo do të vijë vetë! Dëgjo, po të përsëris atë që më ka thënë dikur, babai im: një murg gjatë gjithë jetës së tij kërkonte Zotin dhe kur ai ishte në agoni kuptoi se ishte Zoti që e kërkonte atë.

- Ti, - më tha, - kur të plakesh, do të bëhesh murg. Mos qesh; ti do të bëhesh murg.

Mund të ndodhë që një profeci e kotë të bëhet e vërtetë, mjafton ta besosh. Më kujtohet, profecia e mamisë kur linda unë, kur më kishte parë në dritë kishte thënë: "Ky fëmijë do të bëhet peshkop!" Unë kisha pasur frikë.

- Nuk dua! - thirra dhe tërhoqa dorën, sikur ndjeva një rrezik.

Kishte kaluar një kohë e gjatë dhe unë pothuajse kisha harruar, nuk i besoja fjalët e murgut; atë mbrëmje, fare papritur, ato u kthyen përsëri në shpirtin tim. U përpoqa të qesh, por nuk munda. Ndofta fshehtas ato më kishin përpunuar gjatë gjithë asaj kohe dhe më kishin shtyrë atje ku unë nuk doja të shkoja? Unë nuk mundja të qeshja më.

Mbylla sytë, që të më kapte gjumi, për të mbaruar me ato që më shqetësonin.

Pashë në ëndërr sikur se unë isha rrebel; më ndiqnin në rrugët e një qyteti të madh; më kapën, më gjykuan, më dënuan me vdekje. Xhelati më shtrëngoi, duke iu marrë frymë. - Më shtype, - i thashë, - më shtype. Sapo i thashë se një erë e ngrohtë filloi të fryjë, u zhduk. U përpoqa të ec më tej, nuk munda, përpara meje ishte ngritur një mal i madh, me gurë, me stërrall, që më priste rrugën. Në majë të malit ishte ngritur një flamur i kuq i madh. Them me vete: Duhet të ngjitem atje që të eci më tej. Në emër të qiellit! - i them vetes sime dhe fillova të ngjitem; por këpucët e mia të rënda ishin me gozhdë dhe duke u fërkuar me stërrallin lëshonin shkëndija.

Ngjitesha e ngjitesha, rrëshqisja, rrëzohesha, merrja përsëri vrull, ngjitesha përsëri. Sa më shumë i afrohesha majës, shihja se ai nuk ishte flamur, por flakë. Ngjitesha dhe sytë i mbaja të fiksuar në majë; jo nuk ishte flakë, e shihja qartë tashmë, ishte Zoti por jo Babai, ishte tjetri, Jehovai i tmerrshëm, që më priste.

Këmbët dhe duart i kisha të këputura; për një çast pata dëshirë të kthehesha por më erdhi turp. - Tashmë ç'ishte për t'u bërë u bë. Ec! - Nuk ke frikë? Më thotë një zë femre brenda meje. Kam frikë! Klitha aq fort dhe me një sëkëlldi aq të madhe sa u zgjova.

U ula mbi krevat, ëndrra qëndronte akoma nën qerpikët e mi; e studjova, e studjova dhe nuk arrita të gjej drejtimin e saj. Përse rebel? Përse xhelat? Përse flamur, flakë, përse Zoti? Tunda kokën: Përgjigjja, ajo do të më qetësojë, mendoja, përgjigjja do të vijë kur të mbarojnë pyetjet; kur pyetja zbret nga shpirti llafazan e shtrëngon zemrën.

"O burim i ëmbël që shuan etjen! Ti je i mbyllur për atë që flet, e hapesh për atë që hesht; ai që hesht erdhi, o burim, ai të gjeti dhe po pi." Fjalë antike, të përjetshme që buzët e mia pështërisnin atë natë plot mirënjohje.

Nën dritaren time kaloi një procesion; muzika dhe era e temjanit mbushën ajrin; një vendim i fshehtë po piqej tek unë, në hije, të cilit akoma nuk ia shikoja fytyrën, por kisha besim.

U çova, u vesha, hapa dritaren; qielli kishte marrë zjarr, poshtë rrugët ishin të mbushura plot me njerëz të të gjithë llojeve, që shtypeshin; mbante erë frutash të pjekura, temjani, dhe një erë njerëzish, e rëndë, e neveritshme. Një zezake e shëndoshë mbante në ekuilibër

mbi kokën e saj një shportë me misra të pjekur, thërriste me zë të lartë, ndërsa dhëmbët i shkëlqenin nga dielli. Çifutët me leshra të vajosur, rrëshqisnin gjatë mureve, hunda e tyre si kërrabë ishte helmuese. Priftërinjtë katolikë, ortodoksë e armenë, këmbëheshin pa u përshëndetur. Krishti ishte kthyer për ta në një shkak urrejtjeje.

Zbrita në rrugë dhe shëtita ca aty rrotull: Gjithçka e shikoja përherë të fundit. Në një vitrinë pashë një gravurë të vjetër të Malit Sinai. Në mes Shën Katerina, me kurorën mbretërore mbi kokë; në të dy anët e saj ngjitur me supet, dy male, Sinai dhe Shën-Sapien, që ngjanin si dy krahë të mëdhenj. Në njërën dorë ajo mbante një penë, me tjetrën prekte me një farë përkëdhelie rrugën ku qe martirizuar. Poshtë tyre me një gjuhë tepër të vjetër: "Përse vleni ju malet e tjerë? Përse mburreni për mbulesën tuaj të gjelbër e plot me drurë, qumësht dhe kos? Ka vetëm një mal të madh, të shëndetshëm, të dashur, kompakt, të shenjtë, të nderuar, virtuoz, të pastër, qiellor, me shpirt, engjëllor e hyjnor, ky është Sinai, shtëpia e Zotit."

Për një kohë të gjatë nuk munda ta shkëpusja shikimin nga kjo ikonë. Sa më shumë e shikoja, aq më shumë sigurohesha: në qoftë se ëndrra do të kishte vazhduar akoma, në qoftë se nuk do të kisha thirrur: kam frikë! - që më zgjoi, mali të cilin ngjisja do të ishte bërë me krahë. Sepse ai mal stërralli, që lëshonte shkëndija, ishte ngjitja e luftës sime, dhe unë duhej të isha bashkuar me atë që ndrin mbi majë, që mund të jetë një flamur i kuq, një flakë ose vetë Zoti.

Dëshira fëmijërore, profeci delirante, ëndrra, të gjitha ngatërrohen tani me këtë ikonë të Sinait që qëndronte përpara meje reale. Vendimi më i fshehtë, që piqej brenda meje mori një fytyrë. Kjo është rruga, thashë me zë të lartë, ja se ç'do të bëj, e gjeta: Do të shkoj në malin Sinai. Atje do të shihemi!

Prej vitesh, Sinai, mali ku zbriste Zoti, rrezatonte në shpirtin tim si një majë e paarritshme. Deti i Kuq, Arabia e Gurtë, porti i vogël i Raito-s, kalimi i shkretëtirës mbi shpinë të devesë, rrugë e vështirë midis maleve të tmerrshëm jo mikpritës, ku hebrejtë kanë kaluar vite duke gulçuar, dhe në fund manastiri i famshëm, ndërtuar mbi gëmusha, "që digjej pa harxhuar gjë prej gjëje".

Galilea, me bukurinë idilike, malet e saj të harmonizuar, detin blu, liqenin e vogël e të këndshëm, shtrihet prapa shpinës së Jezusit, qesh e i ngjan atij, ashtu si nëna i ngjan fëmijës së vet. Galilea është një shënim i thjeshtë e i shndritshëm për tekstin e Testamentit të Ri; Zoti aty tregohet paqësor, pak ekzigjent, mikpritës si një njeri i mirë.

Por Testamenti i Vjetër më trondiste gjithmonë dhe kishte në shpirtin tim një tingëllim shumë më të thellë. Sa herë që lexoja atë bibël mizore, plot rrufe e hakmarrje, e njëjtë me malin ku zbriste Zoti, digjesha nga dëshira të shkoja e ta shihja me sytë e mi, të prekja me duart e mia malet jo mikpritëse ku ai kishte lindur.

Nuk do ta harroj kurrë një bisedë të vogël që kisha patur një ditë, në kopsht, me një vajzë. Unë thosha: - Nuk më pëlqejnë poemat, arti, librat. Gjithë kjo më dukej bosh në thelb, si një kuti kartoni. Kjo është njëlloj si të kesh uri dhe në vend që të të japin bukë, verë e mish, ju japin menunë dhe ti fillon ta hash si dhi.

Nuk kuptoja ç'më kishte kapur, isha i mërzitur, ndoshta nga që vajza që ishte para meje më pëlqente por unë nuk mund t'i afrohesha.

Vajza ishte e zbehtë, me mollëza të kërcyera dhe gojë të madhe si fshatare ruse. Sa më shumë e shikoja, aq më shumë më ngacmonte. Në dorë mbaja një trëndafil të cilit i hiqja fletët ngadalë.

- Ja se si e shuajnë urinë shpirtrat tanë të vuajtur, si dhi!

Vajza uli sytë me ndrojtje dhe m'u përgjigj duke qeshur: - Ju më folët me humor, por unë nuk jam dakord me ju. Nuk ka veç një libër që nuk është bërë me letër por pikon gjak, dhe që është mbrujtur prej mishi dhe kocke. Testamenti i Vjetër; Ungjilli është për mua një histori sentimentale për naivët dhe të sëmurët me rrufë, Jezusi ishte me të vërtetë një qengj që e therën mbi barin e gjelbër, për Pashkë, dhe ai nuk rezistoi fare; ai vetëm blegërinte. Por Jehovai është Zoti im: i tmerrshëm, i veshur me lëkurën e bishës, që ka vrarë si një barbar që vjen nga shkretëtira, me një shpatë në rrip, me këtë shpatë Jehovai hap zemrën time dhe hyn brenda.

Heshti, faqet iu skuqën; por flaka akoma nuk dukej. Ajo vazhdoi: - Ju kujtohet se si u flet ai njerëzve? E keni parë sesi njerëz e male shkrihen në duart e tij? Sesi mbretërit bien nën këmbët e tij? Njeriu thërret, qan, psherëtin, përpëlitet midis shkëmbinjve, zbret nëpër

gropa, shpreson të largohet, por Jehovai është ngulur në zemrën e tij si thikë.

Vajza heshti përsëri; unë gjithashtu heshtja, por në thellësinë e zemrës sime ndjeja thikën e ngulur. Prej asaj dite një dëshirë e zjarrtë lindi tek unë të shoh e të prek, rrugën që Zoti kishte hapur në shkretëtirë dhe të hyja atje siç mund të hyhet në folenë e luanit.

Dhe ja, lavdi Zotit, erdhi ora që unë të shuaja etjen.

Si një ëndërr e zjarrtë, e magjepsëse, m'u duk udhëtimi nga Jeruzalemi në Suez dhe nga Suezi në Portin e Arabisë së Gurtë, Raito, prej nga do të nisesha për në Sinai. Një port mjaft i shtrirë, det gjelbër, disa kasolle mbi breg dhe në fund të portit ca kaike, m ngjyra të kuqe, të verdha e të zeza. Një qetësi e madhe, malet në blu të çelët: Dy deve hynë në mol, kthyen për një çast kokën nga deti, qëndruan pak, pastaj me hapa të mëdhenj e ritmik, u zhdukën midis shtëpive.

Një barkë me vela të bardha, mbi të cilën gjendej një murg i ri po më kërkonte, murgjit e urdhërit të Sinait që banonin në Kairo kishin lajmëruar mbritjen time.

Vura këmbën mbi rërën e ashpër dhe më rrahu zemra me forcë; mos vallë ishte ëndërr? Bregu ishte i mbuluar me guaska të mëdha. Nga deti i koraleve dhe i sfungjerëve të fosilizuar, i yjeve të detit dhe i guaskave të mëdha, dilnin shtëpitë e ndërtuara me drurë. Mbi skelë qëndronin disa fshatarë arabë, me lëkurë të shndritshme, të zeshkët, veshur me dolloma të bardha. Një vajzë e vogël ngjyrë çokollatë, veshur me një fustan po të shndritshëm, luante mbi rërë. Më larg, disa shtëpi evropiane, prej druri, me veranda e me çadra dielli të mëdha e shumëngjyrëshe përpara, me kopshte të vegjël dhe rreth e rrotull kuti konservash të boshatisura të hedhura gjithandej. Mbi një ballkon të gjelbër, dy angleze, që në këtë shkretëtirë të nxehtë ishin krejt të zbehta e dukeshin si të zalisura.

Murgu i ri që kishte ardhur të më kërkonte, më shpjegoi se këtu në Raito, qëndronin në karantinë myslimanët që ktheheshin nga Meka! Atëherë bregu mbushej me mijëra haxhilerë, që bënin një zallamahi të madhe me tamburinot e tyre, hoxhallarët që uleshin mbi rërë e lexonin me zë të lartë në kor, Kuranin.

Arritëm në fermën e manastirit të Sinait. Atje do të merrnim

devetë që do të na shpinin në malin e Zotit. Një oborr i madh, përreth disa kamare, dhomat e miqve, dy shkolla, për djemtë dhe për vajzat,depot, kuzhinat, tryeza dhe në mes të oborrit kisha. Mbi të gjithë, mrekullia më e madhe në këtë shkretëtirë: igumeni i fermës, arkimandriti Theodhos, me zemër njeriu, i ngrohtë e plot dashuri.

Krallëherë vijnë grekë në këtë shkretëtirë; arkimandriti Theodhos, i madh, grek i zjarrtë, i lindur në Cesme në Azinë e vogël, më priti sikur priti gjithë Greqinë.

Rituali hyjnor, i miqësisë së shenjtë për mua qe shumë familjar: tasat me reçel, uji i freskët, kafeja e tavolina me mbulesë të bardhë të parfumuar; fytyrat e atyre që shërbenin shkëlqenin nga gëzimi.

Nga dritarja dukej sesi shkëlqente deti i Kuq, larg vizatoheshin, plot dritë, malet e Tebedit. Unë bisedoja me igumenin për "shtatëdhjetë trungjet e palmave" që sipas shkrimeve, hebrejtë gjetën në këtë fshat, kur kaluan Detin e Kuq. E pyeta për "dymbëdhjetë burimet e ujit" sikur të ishte fjala për prindërit që kishin ikur në dhè të huaj. Kur ai m'u përgjigj se trungjet e palmave ekzistonin akoma dhe se burimet e ujit rridhnin akoma, unë u gëzova shumë.

Në jetën time kisha shijuar shpesh herë gëzime të tilla; një gotë uji të freskët pas një marrshimi të gjatë, një çati mikpritëse, një zemër e ngrohtë njerëzore, që jetonte e panjohur në një vend të errët të tokës që priste një të huaj. Kur i huaji dukej në krye të rrugës, sa shumë dridhej dhe gëzohej zemra, sepse kishte gjetur një njeri! Në miqësi, si në dashuri, ai që jep është më i lumtur se ai që merr.

Në tavolinën e përzemërt të mikpritjes, unë dhe arkimandriti Theodhos hanim e bisedonim si dy miq të vjetër të lumtur që takohen përsëri. Mikut tim në shkretëtirë i kishin lindur një mori pyetjesh, dhe ai ishte i etur të dëgjonte përgjigjet nga goja ime. I flisja për qytetet e mëdha, për mosbesimin aktual dhe për brengat e njerëzve, për paturpësinë e të pasurve, për vuajtjen e të varfërve, për pamundësinë e njerëzve të ndershëm, pastaj për përmbysjen e madhe që u bë në Rusi.

- Ata, moskovitët, besojnë te Zoti? Pyeti i shqetësuar igumeni.
- Jo, ata besojnë tek njeriu.
- Te ky krimb toke? - pyeti ai me përçmim.
- Te ky krimb toke, at Theodhos, e kundërshtova me kokëfortësi,

dhe ndërkohë provoja se duhej ta mbroja këtë krimb toke. Tek unë po ngjitej një dëshirë e frymëzuar nga luçiferri, gjarpëri ishte ngjitur mbi Pemën e Njohjes dhe vërshëllente. Murgu dëgjonte, i pangopur.

Kështu, duke e shtyrë në mëkat zemrën e eremitit të qetë, duke transformuar qetësinë në shqetësim, unë i ktheva, në mënyrën më fisnike, mikpritjen.

Erdhën Taena, Mansour dhe Auno, devexhinjtë që do të më shoqëronin gjatë tre ditëve nga ndonjë rrezik. Ata ishin mbuluar me pëlhura shumëngjyrëshe, çallma prej lesh deveje mbi kokë dhe një jatagan të gjatë. Ishin beduinë të thjeshtë me këmbë të holla me sy shqiponje. "Ata shikojnë, - thotë një kronikë e vjetër, dy herë më larg se ç'shikon syri ynë; e ndiejnë erën e tymit tre mijë hapa larg dhe e kuptojmë çfarë druri digjet; dallojnë mbi rërë gjurmët e hapave të burrave nga ato të grave dhe njohin nëse gruaja është e martuar, vajzë apo shtatzënë..." ata përshëndetën pa folur, duke vënë dorën mbi gjoks, mbi buzë, mbi ballë.

Prapa tyre, në oborr u dukën tre devetë ngarkuar me ushqime, një tendë, dhe mbulesa për udhëtimin. Gjatë këtyre kohëve unë kisha mësuar disa fjalë arabisht, më të domosdoshmet për të jetuar tri ditë me beduinët: fjalët bukë, ujë, zjarr dhe Zot.

Devetë u shtrinë; sytë pa formë dhe pa shprehje iu ndrinin;

- Jepu ndonjë hurmë deveve, urdhëroi igumeni; murgu i vogël u përkul me dorën plot hurma.

Arkimandriti dhe unë ramë në krahët e njëri-tjetrit, sytë tanë ishin gati të shpërthenin në lot.

U nisëm. Pak larg fermës së manastirit, fillonte shkretëtira, gri, e paprekur. Lëkundjet ritmike të deveve merrnin me vehte dhe trupin, ndërsa gjaku nis ritmin e kësaj lëkundjeje por në të njëjtën kohë me gjakun edhe shpirti. Koha është çliruar nga nëndarjet gjeometrike, ku mendimi perëndimor, shumë i thatë, e ka mbyllur dhe zhvlerësuar; këtu me lëkundjet e "anijes së shkretëtirës" koha është shkarkuar nga kufijtë e ngurtë matematikë, ajo bëhet një substancë e rrjedhshme dhe e padukshme, një marramendje e lehtë dehëse që transformon pasqyrimin në ëndërrim dhe muzikë.

Pasi u mësova gjatë disa orëve me këtë ritëm, unë kuptova përse orientalët e lexojnë Kuranin duke u lëkundur përpara e prapa sikur

të jenë ulur mbi deve. Kështu ata i transmetojnë shpirtit të tyre lëvizjen monotone dhe dehëse,që në shkretëtirën e madhe misterioze ata i kalon në ekstazë.

Përpara nesh shpalosej deri tani një hapësirë rozë, shqetësuese; që dukej si det. Të tre beduinët u bashkuan me njëri-tjetrin, këmbyen disa fjalë dhe u ndanë përsëri. Nuk ishte det; ishte shkretëtira, të cilën një erë e tmerrshme e turbullonte dhe ngjyroste kështu retë e rërës përvëluese. Sapo hymë në stuhinë e rërës ndaluam frymëmarrjen, Taema ndaloi këngën, beduinët u mbështollën në pelerinat e tyre dhe mbuluan menjëherë hundën dhe gojën.

Rëra ngrihej lart, godiste fytyrat dhe duart tona. Devetë nuk mund të mbanin më ekuilibrin dhe rrotulloheshin në vend. Kjo torturë zgjati tre orë; por unë isha i gëzuar, që munda të jetoja stuhinë e tmerrshme të shkretëtirës.

Dielli po perëndonte, ne kishim dalë nga stuhia; po u afroheshim maleve. Shkretëtira pak nga pak po bëhej ngjyrë vjollcë dhe po mbulohej nga hijet. Taema që ecte në krye, ndalet. Ai lajmëroi me zë të çjerrë për t'u ulur dhe devetë, pa u mërzitur, u ulën në këmbët e para, pastaj në ato të pasmet me një zhurmë bubullime, sikur shembeshin shtëpitë.

Shkarkuam devetë; së bashku ngritëm tëndat. Auno solli shkarpat që kishte mbledhur me kujdes rrugës dhe ndezi zjarrin. Mansour mori nga një çantë bezeje kusitë, gjalpin, orizin, dhe filloi të gatuajë. Taema përziente me ujë pak miell misri dhe përgatiste me gishtërinjtë e tij të hollë një lloj brumi. Megjithatë orizi lëshonte një aromë të mirë: mbledhur rreth zjarrit, hanim, pinim çaj, pinim duhan; disa shikonin zjarrin që fikej, të tjerët shikonin yjet, të mëdhenj, shqetësues; që qëndronin varur mbi kokat tona.

Një lumturi e panjohur pushtonte trupin dhe shpirtin tim; por unë përpiqesha të disiplinoja këtë romantizëm, shkretëtira, Arabia, beduinët - dhe tallesha me zemrën që rrihte me forcë, e tronditur.

U shtriva në tendën time, mbylla sytë, dhe pëshpërima e ëmbël dhe e pandërprerë e shkretëtirës u derdh në thellësinë time. Jashtë, devetë përtypeshin ndërsa unë dëgjoja nofullat e tyre që punonin; gjithë shkretëtira përtypej si një deve.

Të nesërmen në agim filloi udhëtimi në malet e shkreta, të ashpra,

që e urrejnë njeriun dhe e shtyjnë tej. Ndonjëherë në gropat e errëta të shkëmbinjve ndonjë thëllëzë përplaste krahët me një zhurmë metalike. Ndonjë korb kalonte mbi ne duke u rrotulluar sikur i mbante erë gjahut, duke parë se mos kishim filluar të mbanim erë kufome, për t'u sulur mbi ne.

Gjatë gjithë ditës, isha nën ritmin e deveve, nën këngën depërtuese dhe monotone të Taemas, nën diellin që binte mbi ne si zjarr, dhe nën ajrin që dridhej mbi gurët dhe kokat tona...

Ndiqnim po atë rrugë që kishin përshkuar tremijë vjet më parë, hebrejtë, duke u larguar nga Egjipti i pasur. Kjo shkretëtirë që kalonim ne kishte qenë gropa e tmerrshme ku midis vuajtjes u farkëtua e uritur dhe e etur rraca Izraelite. Me një sy të pangopur, shikoja shkëmbenjtë një nga një, hyja në grykat e përdredhura, sillja në shpirtin tim vargjet e maleve të përqafuar. Më kujtohet se një ditë pranë një bregu grek, eca për orë të tëra në një shpellë plot stalaktite të rënda, trungje gjigandë të gurta të shkëlqenin, shumë të kuq, nën dritën e pishtarëve. Ishte shpella e një lumi të madh, që kishte mbetur e tillë, pasi lumi kishte ndërruar shtratin gjatë rrjedhës së tij në shekuj. Kështu shkëlqeu nën rrezet e diellit në shpirtin tim në këtë gryka ku kaloja. Jehovai, Zoti i pamposhtur kishte prerë këto vargmale për të hapur një rrugë kalimi. Përpara se të kalonte këtë shkretëtirë, Jehovai akoma nuk e kishte fiksuar fytyrën e vet, sepse edhe populli i tij akoma nuk kishte ndërtuar të tijën. Eloimset të shpërndara në hapësirë, ishin shpirtra të panumërt, të panjohur, të padukshëm. Ata i jepnin frymë jetës së një shpirti mbi tokë, krijonin, frymëzonin gratë, vrisnin, dukeshin si vetëtima e si bubullima, zbrisnin mbi tokë si rrufe. Ata nuk kishin atdhe, nuk i përkisnin askujt, asnjë tribuje.

Por pak nga pak ata mishërohen, bëhen të dukshëm, pëlqejnë vende të lartë, shkëmbinj të mëdhenj. Njerëzit lyenin me sallo shkëmbinjtë, aty bënin flijime e i spërkatnin me gjak. Me këta shkëmbinj njeri ishte tepër i lidhur dhe për të marrë bekimet e Zotit atij i duhej të sakrifikonte djalin e tij të madh, djalin e tij të vetëm.

Dalëngadalë, gjatë shekujve, së bashku me mirëqënien, raca zbutet, qytetërohet; Zoti gjithashtu ishte zbutur, qytetëruar. Atij nuk i thernin më duke i bërë fli njerëz, por kafshë; Kishin filluar t'i jepnin dhurata Zotit sende të vlefshme, - viça të artë, sfinks me krahë,

gjarpërinj, gjeraqina. Kështu që në Egjiptin e pasur, Zoti i hebrenjve e humbi ashpërsinë. Atëherë fare papritur mbërritën faraonët a ashpër që shkulën hebrenjtë nga fushat pjellore dhe i hodhën në shkretëtirën Arabe. Për ata filloi uria, etja, rënkimet, revoltat. Në një nga këto ditë të urisë e të etjes ata ndalën duke thirrur: - Zot, më mirë do të kishte qenë të na vrisje atje në Egjipt, kur ne qëndronim ulur pranë kazanëve me mish, kur hanim bukë e barku ishte plot! Moisiu, i pashpresë, ngrinte krahët dhe i thërriste Zotit:

- Ç'të bëj me këtë popull fatkeq? Ata do të më vrasin me gur!

Zoti qëndronte mbi popullin e tij dhe dëgjonte; herë pas here iu dërgonte ushqime për të ngrënë, herë-herë iu dërgonte një shpatë dhe i korrte. Çdo ditë, sa më shumë që ata përparonin në shkretëtirë, fytyra e tij bëhej më agresive, çdo ditë ai afrohej më i egër me popullin e tij. Natën bëhej zjarr që ecte përpara tyre, ditën ata që e shoqëronin e mbanin me tmerr, ndërsa dora që e prekte bëhej hi.

Fytyra vazhdonte t'i merrte trajtat e plota, bëhej më e ashpër, përcaktonte pamjen e Izraelit. Nuk ishin më shpirtra anonimë, pa kombësi, të padukshëm, të shpërndarë në erë. Nuk ishte më Zot i gjithë tokës. Ishte Jehovai, Zoti i një race të vetme, racës së hebrenjve, të fortë, hakmarrës, gjakatarë.

Duke kaluar momente të vështira, atyre iu duhej të ishin të ashpër, hakmarrës e gjakatarë, sepse luftonin me të këqiat, me urinë, me shkretëtirën. U duhej, që, duke vuajtur, duke bërë dredhi e hile, duke vrarë, të triumfonin dhe të shpëtonin.

Kjo grykë pa pemë, pa ujë, jonjerëzore, ku kaloja, ishte këllëfi i tmerrshëm i Jehovait; këtu kishte kaluar ai duke ulëritur.

Si mund ta kuptosh racën hebreje pa kaluar, pa jetuar në këtë shkretëtirë të tmerrshme? Gjatë tri ditëve të pafundme që kaluam mbi shpinën e deveve; etja na thante grykën, koka lëkundej, shpirti mbështillej duke ndjekur, si gjarpër, grykën torturuese e të ndezur flakë. Si mund të vdesë një racë që u farkëtua gjatë dyzet vjetëve në këtë kazan metalshkrirës? Isha tepër i gëzuar duke parë gurët e tmerrshëm ku kishin lindur virtytet e tyre: vullneti, këmbëngulja, kokëfortësia, qëndresa dhe mbi të gjitha një Zot, mishi i mishit të tyre, flaka e flakës së tyre të cilit i thërrisnin: - Na jep për të ngrënë! Vriti armiqtë tanë! Na ço në tokën e premtuar.

Në këtë shkretëtirë duhet të jetojnë çifutët, me virtytet dhe ves
e tyre dhe të sundojnë botën. Sot, në periudhën tranzitore të zemër
mit, të hakmarrjes dhe të dhunës që kalojmë, çifutët janë sërish p
pulli i zgjedhur i Zotit të tmerrshëm, Zotit të zhdukjes.

Në mesditë ne kemi arritur më në fund në manastirin e Sinait. U
ngjitëm në rrafshnaltën Madian, më shumë se 1500 metra. Natën
kaluam në një varrezë myslimane dhe tendat i vendosëm përpara
varrit të sheikut. U zgjuam në agim; bënte një i ftohtë i hidhur, ten
dat i kishte mbuluar dëbora, rrafshnalta e bardhë shpalosej përpara
nesh. Shkulëm çatinë e një kasolleje të rrënuar e ndezëm zjarr. Gju
hët e flakëve u ngritën lart, ndërsa ne të katër ulur përreth zjarrit u
ngrohëm. U afruan edhe devetë dhe shtrinë qafat mbi kokat tona.
Pimë raki palme, bëmë çaj, beduiët shtrinë mbi dëborë nga një pece
të të vogël, u ulën në gjunjë dhe filluan të falen, fytyra e tyre e ho
llë, e përvëluar nga dielli ishte kthyer nga Meka.

Fytyra e tyre rrezatonte, ata ranë në ekstazë. Unë i shihja me
respekt ata tre trupa të munduar e të uritur dhe gëzohesha e ngope
sha. Mansouri, Taema dhe Aona jetonin ngjitjen e tyre: Për ta ishte
hapur Parajsa dhe kishin hyrë atje. Parajsa e tyre, e myslimanëve, e
beduinëve: dielli, një fushë e blertë, deve të bardha dhe dele që lë
viznin nëpër fushë, tenda shumëngjyrëshe; gra me unaza të argjendta
në gishta, flokë të lyer me këna, me rruaza dhe vathë të bukur, që
rrinë ulur këmbëkryq me gjinjtë ngritur, përpara tendave e qeshin.
Ndihet aroma e ushqimeve, e orizit, qumshtit, hurmave, bukës së
bardhë. Një shtëmbë me ujë të ftohtë qëndron aty pranë. Aty gjen
den tre tenda më të mëdha se të tjerat, tridhjetë e tre deve që janë
më të shpejta. Treqind e tridhjetë e tre gra që janë më të bukurat,
tendat, devetë, gratë e Taemës, të Mansourit dhe të Aonës...

Lutja mbaroi, Parajsa u mbyll, beduinët kanë zbritur mbi rraf
shnaltën e Madianit, u afrun tek zjarri dhe filluan punët e tyre të za
konshme tokësore të qetë e buzagaz. Sa kohë do të zgjaste kjo jetë?
Më pas do të vinte Parajsa; duhej durim.

I zgjata dorën Taemës, që ishte ulur në të majtën time, dhe i tha
shë në arabisht fjalën e shenjtë të myslimanëve: Nuk ka veç një
Zot dhe Muhameti është profeti i tij. Ai u drodh, i befasuar, sikur
unë kisha zbuluar të fshehtën e tij; ai më pa, duke rrezatuar nga gë

i dhe më shtrëngoi dorën.

U nisëm. Unë ecja në këmbë, nuk mund të duroja ritmin e deve
Në të djathtë dhe në të majtën tonë, male graniti të kuq dhe je
l. Ngandonjëherë kalonte ndonjë zog i vogël, i zi, me një kapuç
bardhë në kokë si xhokei. Një varg devesh u duk në fund të rru
s, beduinët lëshuan një klithmë gëzimi, ndalëm. "Selam alekum",
qja qoftë me ju, na thirrën dy devexhinjtë që u afruan; shtrënguan
art me njëri tjetrin, u përkulën njëri ndaj tjetrit, duke takuar faqet.
përshëndetën gjatë më një zë të dobët, nanurisës. Nisën një dia
g, mbase më i thjeshtë dhe më i përjetshmi: - Si shkon? Janë femrat
tua, devetë e tua? Prej nga vjen? Ku shkon? Fjalët selam, paqe,
llah, përsëriteshin pa pushim mbi buzët e tyre dhe ky takim në
hkretëtirë merrte kuptimin sublim e të shenjtë që duhej të merrte
jithnjë një takim i qënieve njerëzore.

Soditja me emocion fëmijët e shkretëtirës. Si jetojnë ata! Me di
a hurma, një grusht misër dhe një tas kafe. Trupi i tyre është i për
kulshëm, pulpët të holla si të një dhie, syri i një petriti; janë njerëzit
më të varfër dhe më mikpritës në botë; ato kanë uri dhe nuk hanë
kurrë që të ngopen, për të patur gjithmonë pak kafe, pak sheqer, një
grusht hurma për të huajtë.

Në Raitho, igumeni më pati treguar sesi një beduine e vogël,
qëndronte përpara një ekskursionisti anglez që kishte hapur kutitë
e konservave dhe hante; anglezi i dha asaj një copë për të ngrënë,
por vajza, nga krenaria, nuk e pranoi dhe përnjëherë u shtri për tokë
e zalisur nga të pangrënët.

Dashuria e madhe e beduinëve është gamilja e tij. Këtë e shihja
tek Taema, Mansuri dhe Aona, sesi u lëviznin veshët, të shqetësuar,
kur dëgjonin shfryrjen më të vogël të kafshëve.

Ndalonin, rregullonin shalën, u preknin barkun, këmbët, këpus
nin ç'mund të gjenin nga bari i tharë e ua jepnin për të ngrënë. Në
mbrëmje, i shkarkonin, i mbulonin me një mbulesë, të leshtë, hapnin
një çantë në tokë dhe u pastronin me kujdes ushqimin.

Një këngë e vjetër arabe ngre lart shokun e dashur të beduinëve:
"Deveja ecën nëpër shkretëtirë. Ajo është e fortë si dërrasat e një
arkivoli; kofshët e saj janë të forta si një portë e lartë e fortifikuar.
Gjurmët e litarit mbi brinjët e saj i ngjajnë një liqeni të thatë mbuluar

me gurë; e prek dhe të duket se prek një limë. Ajo i ngjan një ujësjellësi të ndërtuar nga arkitekti grek dhe që është mbuluar me tulla!"

Ngjitim me nxitim malin duke u djegur nga dëshira të gjendemi sa më shpejt përpara manastirit. Pak ujë në një vaskë, disa hurma të mbjella, një kasolle e gurtë; pak më larg një kryq i hekurt i ngulur mbi shkëmb. Afrohemi. Përnjëherë Taema ngriti dorën; Der!- thirri, - manastiri!

Mbi një pllajë, ndërmjet dy maleve, rrethuar nga mure të lartë, u duk manastiri i famshëm i Sinait. E kisha dëshiruar me forcë këtë çast, dhe tani që mbaja në duar frutin e mundimit të madh, provoja një gëzim të qetë, pa klithmë dhe nuk nxitohesha.

Një shkrepëtimë, një shtytje: të mos kthehesha prapa. Provova gëzimin mizor të moskorrjes, të mosgëzimit të frutave të të korrave, por përnjëherë fryn një fllad i ngrohtë, ngarkuar me aromën e pemëve në lulëzim; njeriu triumfoi tek unë, unë eca përpara.

Tani, dalloja pikërisht manastirin, muret, kullat, kishën, një selvi. Arritëm në kopsht, jashtë bedenave; u ngjita mbi mur dhe pashë: në mes të shkretëtirës, nën rrezet e diellit, ndrinin ullinjtë, portokallet, arrat, fiqtë, bajamet hyjnore, shumë të mëdha. Një ngrohtësi e këndshme, parfum, zukatje e insekteve të vegjël, Parajsa.

U gëzova shumë që pashë këtë fytyrë të Zotit, duke qeshur, mik i njerëzve, bërë nga toka, nga uji dhe nga djersa njerëzore. Kjo ndodhte pas tre ditësh që kisha parë gjë tjetër, fytyrën e tij të tmerrshme prej graniti, pa një lule. Thosha: Ja Zoti i vërtetë, zjarri që nuk djeg, graniti që nuk dërrmon dëshirat e njerëzve. Dhe tashmë, duke u përkulur mbi murin e këtij kopshti të lulëzuar, unë kujtoja me emocion fjalët e asketit: - Zoti është një drithërimë dhe një lot i ngrohtë.

- Ka dy lloje mrekullish, - thotë Buda; ato të trupit dhe të shpirtit. Unë, nuk u besoja të parave, u besoja të dytave! Manastiri i Sinait është një nga këto mrekulli të shpirtit. Në mes të shkretëtirës jonjerëzore, rrethuar me tribu plaçkitëse, që kanë një fe tjetër, një gjuhë tjetër, ja përse prej katërmbëdhjetë shekujsh ky manastir ngrihet si një kështjellë rreth një burim uji, dhe u reziston forcave natyrore dhe njerëzore që e rrethojnë. Këtu, mendoja me krenari, jeton një vetëdije njerëzore në shkallën më të lartë, këtu virtyti i njeriut triumfon mbi shkretëtirën.

Arrija, por, jo plotësisht, të sundoja gëzimin tim. Gjendesha midis maleve biblikë, mbi pllajën e lartë të Testamentit të Vjetër. Në lindje mali i Shën-Sapiensit, ku Moisiu kishte mbërthyer gjarpërin e bronxtë; prapa, malet Amorite. Në veri shtrihet shkretëtira Moab. Në jug maja Faran dhe deti i Kuq. Më në fund në perëndim vargmali i Sinait, Maja e shenjtë, ku Zoti i kishte folur Moisiut, dhe pak më tej shën-Katerina.

Manastiri rrezatonte si diell, midis diellit të madh dhe dëborës. Ullinjtë zhurmonin qetësisht, portokallet ndrinin nën gjethet e tyre të errëta. Selvitë ngriheshin të zeza, asketike, ngadaltë, ritmike, si frymëmarrja e Zotit, ngrihej aroma e bajameve të lulëzuara, duke mbështjellë hundën dhe shpirtin tonë.

Në të vërtetë, si ka mundur kuvendi, kjo kështjellë, t'u rezistojë erërave magjepsëse të pranverës? Si, gjatë shekujve, ka arritur të mos mbytet në një ditë pranvere. Fjalët e asketit të egër, Shën Andonit, trondisnin zemrën time prej vitesh me trishtimin e thellë njerëzor: "Në qoftë se je në shkretëtirë dhe zemra të jetë duke u çlodhur, ndërsa ti dëgjon papritur, këngën e një trumcaku, zemra jote nuk ka më prehjen e mëparshme."

Në manastir hyra nga porta e lartë. Një oborr i madh, në mes një kishë dhe pranë saj një xhami e vogël me minarenë e ngritur lart. Këtu, kryqi dhe drapëri ishin bashkuar. Përreth, mbuluar nga dëbora, rrezatonin nga bardhësia kamaret, dhomat e miqve, depot; tre murgjër rrinin ulur e ngroheshin në diell; në qetësinë e madhe, fjalët e tyre dëgjoheshin shumë. Qëndrova për një kohë të gjatë pa lëvizur e mbajta vesh. Secili fliste shpejt për t'u çliruar; njëri tregonte mrekullitë që kishte parë në Amerikë-vaporë, gratacielë, drita të natës, femra, një tjetër sesi i piqnin qengjat në vendin e tij, dhe i treti mrekullitë e Shën-Katerinës, sesi engjëjt e kishin marrë në Aleksandri dhe e kishin çuar në atë faqe mali, ku duken akoma shenja të trupit të saj mbi shkëmbinjtë.

U ngjita në kullë për të parë përreth. Një murg i ri më pa dhe vrapoi për të më uruar mirëseardhjen. Si tha vetë, ishte krenar dhe ishte vetëm tetëmbëdhjetë vjeç; pushi i dendur dhe i dredhur i faqeve të tij, që përshkohej nga rrezet e diellit kishte një reflekс gështenje të çelët. Ndërsa ne flisnim, për atdheun e largët, vjen duke dihatur

një plak që duhej të ishte rreth tetëdhjetë vjeç. Nuk kishte forcë të më uronte as mirë as keq; thellësia e qënies së tij ishte e tillë siç e donte Buda, bosh.

U ulëm të tre në diell, mbi një stol të drunjtë. Djaloshi nxori nga këmisha më dha një grusht hurma, të ngrohta nga nxehtësia e trupit të tij. Plaku vendosi dorën mbi gjurin tim dhe filloi të më tregojë sesi qe ndërtuar manastiri dhe sesi kishte luftuar nëpër shekuj. Ashtu siç isha i ulur në diell, midis maleve legjendarë, historia e manastirit m'u duk e thjeshtë dhe e vërtetë si një tregim.

Rreth pusit ku vajzat e Ioterit çonin delet për t'ju dhënë ujë dhe pikërisht në vendin ku ishte gëmusha "që digjej e nuk mbaronte kurrë" u ndërtua manastiri nga perandori Justinian. Ai dërgoi dyqind familje nga Ponti dhe Egjipti, i vendosi pranë manastirit, si skllevër të tij, t'i shërbenin e ta mbronin. Kaloi një shekull dhe erdhi Muhameti e kaloi mbi Malin Sinai. Akoma ruhen edhe sot mbi një copë graniti të kuq gjurmët e devesë së tij. Murgjit e pritën me gjithë nderimet, ndërsa Muhameti - e shtyn djallin në varrin e tij dhe e torturon! - qe i kënaqur dhe i akordoi manastirit, shkruajtur me gërma arabike mbi një lëkurë cjapi, privilegje të mëdha; firmosi duke vendosur mollëzën e gishtit - ai nuk dinte të shkruante. Privilegjet ishin: "Në qoftë se një murg i Sinait mërgohet në një mal, në një pllajë, në një shpellë, ose në shkretëtirë, unë do të jem atje, me të, dhe, do ta mbroj nga çdo e keqe. Unë do të mbroj murgjit e Sinait kudo që të ndodhen, mbi tokë e mbi det, në lindje, në perëndim, në jug, në veri. Ata nuk do të paguajnë taksa mbi të korrat, nuk do të thirren në ushtri dhe nuk do të paguajnë taksën për frymë. Krahu i mëshirës ndrin mbi kokat e tyre."

Plaku flistë dhe ky zë që vinte nga sipër botës bënte që të përjetoheshin muret e lartë bizantine, malet e lartë që na rrethonin, ndërsa pamja mbushej me shenjtorë e martirë.

Kretani adoleshent, pranë meje, dëgjonte, i zhytur në ekstazë, gojëhapur, legjendën e shkëlqyer. Poshtë në oborr, murgjit kishin dalë nga kamaret dhe peshonin me dorë misrin që kishin sjellë beduinët. Nga porta e hapur e kuzhinës dallova një tavolinë të gjatë mbushur më karkalecë deti të mëdhenj e të kuq. Një murg i zbehtë, mbështjellë me një pelerinë ngjyrë kafe, krihte një guackë deti të

madhe.

- Është At Pakom, bijtë e mi, na thotë plaku duke qeshur; është gjysmë i marrë i gjori, ai pikturon.

- Edhe Apostulli shën Luk, piktor ishte, - i them, duke dashur të mbroj piktorët.

- Është një tundim i madh, biri im, Zoti të ruajt. Duhet të jesh apostull që t'i rezistosh.

Ai kishte të drejtë, unë heshta. U ngrita, zbrita në oborr, murgjit të mbledhur, gëzonin si fëmijët, ishin të gëzuar që shihnin se kishte rënë dëborë dhe do të mbinte bari edhe në shkretëtirë; dhentë e dhitë do të kishin ç'të kullosnin, njerëzit do të hanin në urinë e tyre.

Kishin ardhur disa bujkrobër dhe qëndronin ulur në hyrje të manastirit; pinin duhan, diskutonin me zë të lartë, me gjeste. Midis tyre kishte gra këmbëzbathura, mbështjellë me pelerina të zeza; fytyrat e tyre nga hunda e poshtë ishte mbuluar me zinxhira kapur nëpër fundet me sumbulla të vogla argjendi dhe guacka; flokët u formonin mbi ballë një topuz, si një kokë bastuni. Ato hapën pelerinat dhe nxorën prej andej nga një të porsalindur dhe e vendosën përpara vetes mbi gurë. Këta njerëz prisnin që të vinin murgjit mbi bedenat dhe t'ju hidhnin nga lart, ushqimin e tyre të përditshëm: Tri bukë të vogla, të rrumbullakta për çdo burrë e dy për çdo grua e fëmijë. Rregulli ishte që të vinte vetë për ta marrë; ata linin tendat disa orë përpara për të arritur në momentin e duhur; por këto copa buke nuk e shuanin urinë e tyre; rrugës ata mblidhnin karkalecë, i thanin, i zienin, i ngjishnin dhe me ta bënin bukë.

Shikoja me emocion ata vëllezër të largët; prej shekujsh ata enden përreth këtyre mureve bizantine, ndërsa manastiri iu hedh atyre si gurë ato copa buke plot tinguj, ata jetojnë e vdesin duke kërcënuar manastirin. Sot, si në kohët e Iotorit, vetëm vajzat i çojnë dhentë për të kullotur; askush nuk i shqetëson. Kur dy të rinj duhen, nisen fshehtas dhe e kalojnë natën në mal. Djali luan me fyell, vajza këndon, në asnjë rast ata nuk afrohen. Djali zbret për të kërkuar vajzën; për ta blerë ulet përpara tendës së vjehërrit të tij. Më pas vjen vajza, ai hedh mbi të pelerinën e vet dhe e mbulon; pastaj vjen babai i djalit, si sheik. Të dy vjehërrit marrin një fletë palme dhe e ndajnë. Babai i vajzës thotë: - Unë dua për vajzën njëmijë livra! - Njëmijë lira!

- thotë sheiku; por vajza jote vlen dy mijë lira dhe burri është gati t'ia japë por pa kënaqësi. Jepi, atij pesëqind - Për kënaqësi të sheikut, përgjigjet vjehrri unë do t'ia jap pesëqind lira. Atëherë ngrihen prindërit e tjerë që kanë mbërritur pak nga pak dhe ulen këmbëkryq brenda në tendë. - Për të më kënaqur jepi atij peshqesh edhe njëqind. - edhe njëqind të tjera. - Edhe pesëdhjetë të tjera. - Akoma edhe njëzet e pesë... deri sa shuma zbret në një lirë. Atëherë gratë që shkoqin misër në një qoshe fillojnë të kakarisin: - lulu-lulu... vjehrri ngrihet. - Për kënaqësi të grave që shkoqin misër, - thotë, unë e jap vajzën për gjysmë lire.

Hanë, pinë, kërcejnë, shpenzojnë të gjitha lekët që kanë gjatë natës së martesës. Kështu, të pandryshueshëm, jetojnë prej mijëra vjetësh zakonet e shkretëtirës.

Erdhi djaloshi kretan: - Etërit e shenjtë të presin në dhomën e miqve, - më thotë, - eja.

Rreth njëzet murgj, ulur në sallën e madhe ku presin të huajt, kanë fiksuar mbi mua shikimet kureshtare. U bëra gati t'u puthja dorën me radhë, por ata ishin shumë dhe unë ndryshova mendje; i putha dorën vetëm igumenit që qëndronte ulur në mes, i ashpër, eshtak, i heshtur. Pastaj u shërbyen kafe, tasat me reçel, një gotë verë hurmash, dhe fjalët e dashura: Prej nga vjen? Kush je? Mirë se erdhe!

Igumeni, lisi i vjetër i prerë dhe i karbonizuar nga rrufetë e Zotit, më shihte, por unë isha i sigurtë se ai nuk më shikonte; sytë e tij kishin filluar të shuhen dhe nuk mund të shikonin në gjërat e dukshme. Ai më shihte prapa meje shikonte qytete të mëdha, botën që rrokullisej në kotësi, mëkatin, paturpësinë, vdekjen.

U thashë se unë kaloja një krizë dhe kërkoja leje të kaloja disa ditë në manastir, që shpirti im të mund të përqendrohej dhe të merrte një vendim.

- Ti kërkon Zotin? - më thotë igumeni, dhe, unë kuptova se ai për herë të parë po më shikonte.

- Unë dua të dëgjoj zërin e tij, atë kërkoj, - u përgjigja, që të më thotë çfarë rruge të marr, dhe vetëm këtu në shkretëtirë mund ta dëgjoj.

- Këtu, në shkretëtirë, thotë Igumeni, dëgjohen gjithë zërat, por

mbi të gjithë ai i Zotit dhe i tunduesit, dhe është e vështirë ti dallosh, kujdes bir.

Në dhomën e miqve hynë dy murgjër për të parë e përshëndetur pelegrinin e ri. Njëri prej tyre i shëndetshëm me dy sy blu të qeshur, me mjekër të përdredhur, ishte ati mikpritës që merrej me të ftuarit; tjetri, i madh, me një buzëqeshje ironike e të lodhur, me mjekër, mustaqe, vetulla të bardha si borë, duar të bardha e gishtërinj të gjatë. Ai nuk më foli, më pa fare thjeshtë, ndërsa sytë i xixëllonin e i qeshnin. Qeshnin apo talleshin? Në fillim unë nuk i kuptova, por pas disa ditësh po.

Igumeni u ngrit dhe më zgjati dorën.

- Zoti të ndihmoftë që ti të gjesh atë që ke kërkuar më kot nëpër botë, - më thotë. Një murg vrapoi, hapi portën dhe u zhduk, duke ecur me hap të lehtë.

Ati që priste miqtë u afrua pranë meje:

Tani është drekë, - më thotë, - eja shkojmë në sallën e ngrënies.

- Murgjit, ishin ulur në një tavolinë mjaft të gjatë, igumeni qëndronte në krye. Murgu që shërbente solli ushqimin - karkaleca deti me zarzavate, bukë, një gotë verë për secilin. Etërit filluan të hanë, askush nuk fliste. Lektori u ngjit në një platformë të vogël dhe filloi të lexojë, duke psaltur ungjillin.

Kisha jetuar, shpesh, në shumë manastire këtë ritëm liturgjik të tavolinës. Kështu ushqimi merr kuptimin e tij të madh mistik. Një rabin ka thënë: - Njeriu i virtytshëm që ha, liron Zotin që gjendet në bukë.

Lektori bënte vokale për djalin plangprishës - sesi vuante dhe turpërohej larg shtëpisë prindërore, sesi hante çiçibanoze, si derrat, dhe sesi një ditë duke mos e duruar më këtë jetë kthehet pranë babait të tij...

Unë midis këtij serioziteti të krishterë mendoja: "Në një manastir tjetër, i mësuar më mirë me shqetësimin dhe revoltën aktuale të shpirtit, do të lexonte suplementin shpërthyes të një shqetësimi bashkëkohor, që i është shtuar parabolës së Djalit plangprishës: Djali kthehet i lodhur, i thyer në shtëpinë prindërore; në mbrëmje, kur

shtrihet në krevat, për të fjetur, hapet dera ngadalë dhe hyn vëllai i vogël. - Unë do të iki, shtëpia e babait është shumë e ngushtë për mua, - thotë. Vëllai që ishte kthyer atë mbrëmje i lodhur, u gëzua që e dëgjoi, e mori në krahë dhe filloi ta këshillojë, t'i thotë se ç'duhet të bëjë, ku të shkonte; përpiqej ta bindte që të tregohej më trim se ai vetë, më krenar, e të mos kthehej në stallën prindërore: kështu e quante ai shtëpinë e babait. E shoqëroi deri te porta, i shtrëngoi dorën. "Ai ndofta do të jetë më i fortë se unë, e nuk do të kthehet", mendonte.

Si mund të harroj natën e parë që kam kaluar në kështjellën e Zotit të shkretëtirës? Ishte një qetësi me xhinde; ajo ngrihej rreth meje në mënyrë të tillë sa mua më dukej se kisha rënë në një gropë të thellë e të errët. Papritur qetësia u bë e zëshme dhe mua filloi të më dridhet shpirti: - Çfarë bën këtu në shtëpinë time? Ti nuk je i pastër, nuk je njeri i ndershëm, syri yt rrotullohet nga e majta dhe nga e djathta, unë nuk kam besim tek ti. Në çdo kohë ti je gati të na tradhëtosh. Ti nuk e di se në krye të çdo rruge Zoti është ulur e pret. Por ti do të shtyhesh vazhdimisht; do të zalisesh në mes të rrugës dhe do të kthehesh andej nga ke ardhur, për të marrë një rrugë tjetër. Populli i thjeshtë nuk shikon sirena, nuk dëgjon këngë në hapësirën që e rrethon; i verbër, shurdh, ai vozit, përkulet, mbi hambaret e tokës; qëniet e zgjedhura, kapedanët, dëgjojnë sirenat pa i dëgjuar të tjerët, dëgjojnë shpirtin e tyre dhe me trimëri ndjekin zërin e tyre. Çfarë vlere tjetër, mendon ti se mund të ketë jeta? Por kapedanët mjaftohen me dëgjimin e një sirene dhe nuk e besojnë atë. Ata tërhiqen prapa kujdesit dhe paburrërisë dhe e kalojnë gjithë jetën e tyre duke peshuar po-në dhe kundrën mbi një grackë. Dhe Zoti duke mos ditur ku t'i hedhë, duke mos dashur të zbukurojë ferrin, as të shëmtojë parajsën, urdhëron të varen në gjysmë rrugën e shkatërrimit me kokë poshtë.

Zëri heshti; unë vazhdoj të pres, faqet më ishin skuqur nga turpi dhe nga nervat.

Atëherë kush më dha forcë të ngre kokën dhe të kundërshtoj? - Mos vallë vetë shkretëtira?

- Unë kam arritur në krye; dhe në krye të çdo rruge kam gjetur greminën.

- Ti ke gjetur greminën se ishe i padenjë të shkoje më larg. Greminë quhet ajo ku nuk mund të ngresh dot urë. Nuk ka greminë, nuk ka kufi; ka vetëm shpirt njeriu, kjo u jep emër gjithë gjërave, si do që të jetë e shëmtuar apo e guximshme. Krishti, Buda, Moisiu gjetën përpara tyre humnerë; por ata hodhën një urë dhe kaluan. Prapa tyre, gjatë shekujve, kaluan shumë njerëz.

- Është një gjë të jesh hero nga një dhuratë e Zotit, është tjetër gjë të jesh në luftë me të. Unë po luftoj.

Një e qeshur e frikshme shpërtheu nga e majta ime, nga e djathta dhe tek unë vetë.

Një hero? Por heroizëm do të thotë bindje tek një ritëm superior i individit. Ndërsa ti, ti je akoma plot shqetësim dhe rebelim. Ti nuk do të arrish të sundosh kaosin që ke brenda vetes tënde dhe të krijosh një zë të pastër; ndërsa ti justifikohesh duke qarë: "Kornizat e vjetra janë shumë të ngushta për mua." Por duke shkuar më larg në mendim dhe ne veprim, ti mund të arrish kufijtë heroikë ku qëndrojnë të rehatshëm e veprojnë dhjetra shpirtra si të tutë. Duke përdorur si trampolinë simbolet e njohura të nje feje, duke e krahasuar me eksperiencat e tua hyjnore, ti mund të arrish pa e kuptuar në atë që kërkoje: një formë moderne të pasioneve të përjetshme të Zotit e të njerëzve.

- Ti do të më dëgjosh gjithmonë, në secilën nga arratitë e tua.

- Unë nuk jam arratisur kurrë; kudo unë eci përpara duke braktisur gjithçka kam dashur, dhe nga kjo më është copëtuar zemra.

- Deri kur?

- Deri sa unë të arrij kulmin tim; atje do të çlodhem.

- Nuk ka kulme; ka vetëm lartësi; nuk ka çlodhje; ka vetëm luftë. Përse i hap sytë i çuditur? Ti nuk më ke njohur akoma? Beson se unë jam zëri i Zotit?

Jo unë jam vetëm zëri yt. Unë udhëtoj vazhdimisht me ty, e nuk të ndahem; qielli më shtyn të të lë vetëm! Një ditë kur unë isha i mbytur nga mërzia, ti nga thellësia e qënies tënde, më dhe një emër, dhe unë e ruaj; ai më pëlqen: shoqja ime Tigreshë.

Ajo heshti. Unë e njoha dhe zemra m'u forcua. Përse t'i ndruhem.

Ne vazhdimisht udhëtojmë së bashku; gjithçka e kemi parë dhe e kemi gëzuar së bashku. Ne hamë e pimë bashkë në tryezën e syrgjynosjes, kemi vuajtur së bashku, kemi gëzuar së bashku qytetet, femrat, idetë. Dhe kur, ngarkuar me plaçka, mbuluar me plagë, ne mbërrinim në kamaren tonë të qetë, kjo tigreshë ngjitej qetësisht mbi kokën time, atje është shpella e saj. Ajo shtrihet përreth kafkës, ngul kthetrat në trurin tim dhe të dy së bashku, pa folur sjellim përsëri ndërmend ato që kemi parë, dhe digjemi nga dëshira për të parë ato që na ngelen.

Jemi të gëzuar që shohim se gjithë bota e dukshme dhe e padukshme, është një mister i thellë, i padepërtueshëm. I thellë, i pakuptueshëm, përtej inteligjencës, dëshirës, bindjes.

Ne diskutojmë dhe qeshim kur shohim se jemi aq mizor, aq të butë, aq të pangopur; qeshim me këtë pangopësi, pak ka rëndësi që ne e dimë mirë se një mbrëmje, kjo është fare e sigurtë, ne do të hamë për darkë një grusht dhe do të jemi të ngopur.

Çfarë gëzimi, o shpirt i njeriut, o zonjushaTigreshë, të jetosh, të duash tokën, të shohësh vdekjen dhe të mos kesh frikë!

Në agim u çova, nxitova që të ecja nëpër shkretëtirë në mëngjes. Ylli i mëngjesit ndrinte akoma, kreshtat i ndrinte akoma një dritë e dobët, thëllëzat ishin zgjuar dhe gjithë maja e shenjtë, ku kish zbritur Jehovai, kakariste. Qielli ishte pastruar, poshtë dëborërat kishin shkrirë, i kishte gllabëruar rëra, por majat e maleve kishin filluar të përflakeshin nga rrezet e para të diellit. Asnjë zog, asnjë zë; asnjë pikë uji, asnjë fije bari, një shkretëtirë jonjerëzore, mbrujtur nga rëra dhe Zoti.

Sigurisht vetëm dy lloje njerëzish mund të durojnë që të jetojnë në një shkretëtirë të tillë: Të marrët dhe profetët. Këtu, shpirti lëkundet, jo nga frika, por nga tmerri i shenjtë, dhe ndonjëherë ai bie më poshtë se ekuilibri njerëzor, herë të tjera hov dhe hyn në qiell, shikon Zotin ballë për ballë, prek pa u djegur thekët e veshjes së tij, dëgjon ç'thotë ai, merr fjalët e tij dhe ua hedh njerëzve. Vetëm në shkretëtirë lindin shpirtra të egër dhe të pashtruar që rebelohen kundër Zotit, që i rrinë në këmbë përpara, pa u trembur, shpirti i të cilëve rrezaton

gati i barabartë me Zotin. Zoti i shikon dhe i admiron, sepse fryma e tij nuk është përhapur tek ata dhe nuk do të përhapet deri sa ai të bëhet njeri.

Dy profetë udhëtonin në shkretëtirë dhe diskutonin. Njëri thoshte se Zoti është zjarr, tjetri thoshte se është pite mjalti, por asnjeri nuk arrinte të bindte tjetrin. Më në fund i pari, i indinjuar, shtriu dorën në drejtim të malit që ishte përballë. - Në qoftë se unë them të vërtetën, mali do të dridhet. - Kjo nuk është provë! - përgjigjet i dyti me përçmim. - Në qoftë se unë them të vërtetën, një ëngjëll do të zbresë nga qielli dhe do të më lajë këmbët. - Dhe akoma pa mbaruar ai fjalën një ëngjëll zbret nga qielli, përkulet dhe fillon t'i lajë këmbët. Por tjetri tund supet. - Kjo nuk është provë thotë. Në qoftë se unë them të vërtetën, Zoti do të thërresë: "Është e vërtetë!" Dhe akoma pa përfunduar ai fjalën dëgjohet një zë që thërret: - është e vërtetë, - por përsëri profeti i dytë tund kokën. - Kjo nuk është provë, - thotë ai. Dhe pikërisht në këtë çast, Elia që kalonte në qiell pa Zotin që po qeshte dhe iu afrua: - Përse qesh, o Zot? - e pyeti. - Jam i kënaqur Eli, u përgjigj Zoti; - shoh sesi atje poshtë në tokë bisedojnë dy nga djemtë e mi të vërtetë.

Vazhdoja të udhëtoja, përfytyroja me admirim dy profetët e egër, dhe më dukej se shikoja mbi rërë gjurmët e tyre. Baba i lumtur, mendoja, që gëzohesh nga të tillë fëmijë; shkretëtirë e lumtur që ke parë të udhëtojnë luanë të tillë të xhunglës.

At Agapiosi, At Pakomi, piktori dhe unë u ngjitëm një ditë në "Majën e Shenjtë", fortesa vertikale ku Moisiu kishte parë Zotin ballë për ballë dhe foli me të. Nga larg, maja e malit, shumë e thepisur, dukej si krifa e një derri të egër. - Çfarë mendoni ju, - thotë shkrimtari, - se mund të ishte si gjithë malet e tjerë, mbuluar me bar, me bagëti dhe me djathë? Ka vetëm një mal të vërtetë, Sinai, ku ka zbritur dhe banon Zoti."

Këtu mbi këtë Olimp të hebrenjve, qëndron Jehovai, sheiku i tmerrshëm i Izraelit; ai rri në majë si zjarr dhe mali lëshon tym; askush nuk duhet ta prek as ta shikojë ballë për ballë: ai që e sheh vdes. Jehovai identifikohet me zjarrin. Atë që hebrenjtë e hidhnin në zjarr, e gllabëronte Jehovai; ai më shumë donte të hante fëmijët e tij.

Kemi ngjitur tre mijë këmbë që të çojnë nga këmbët e malit në majë të tij. Kaluam një portë të ulët hapur në shkëmb në formë kubeje, atje ku njerëzit dridheshin të preknin majën, një rrëfyes ulej dhe i rrëfente; ai që ngjitej në malin e Zotit duhej të kishte duart të pastra dhe zemrën të pastruar; përndryshe maja do ta vriste. Sot porta është e shkretë, duart e pista dhe zemrat mëkatare mund të kalojnë pa u trembur. Maja nuk vret më. Ne kaluam.

Më lart gjendet shpella ku profeti Elia pati vizionin e madh. Ai hyri në shpellë dhe zëri i Perëndisë filloi të sokëllijë: - Nesër, dil këtej dhe rri në këmbë përpara Zotit. Mbi ty do të fryjë një erë dhe mali do të thërmohet, gurët do të treten, por Zoti nuk do të jetë atje. Do të ndizet një zjarr i madh por Zoti nuk do të jetë atje. Pas zjarrit do të ngrihet një puhizë e qetë dhe e freskët. Atje do të jetë Zoti. Kështu erdhi shpirti. Pas erës, dridhjes së tokës dhe zjarrit, një puhizë e ëmbël dhe e freskët; kështu vjen edhe sot. Ne kaluam periudhën e dridhjes së tokës, mbërritjen e zjarrit; më vonë, po kur pra? Pas sa brezash do të fryjë puhiza e ëmbël dhe e freskët?

Më lart akoma, Pakomi ndaloi dhe na tregoi një shkëmb: - Këtu rrinte Moisiu, ditën kur hebrenjtë luftonin kundër fatkeqësisë. Për aq kohë sa ai i mbante duart lart, hebrenjtë dilnin fitimtarë; kur ai lodhej dhe ulte krahët, hebrenjtë shpartalloheshin. Atëherë dy priftërinj Aaron dhe Hoar ia mbajtën duart lart drejt qiellit deri sa gjithë armiqtë kaluan në shpatë!

Në shpirtin e padjallëzuar të Pakomit, të gjitha këto legjenda merrnin një kuptim real, ai mbyllte sytë me admirim, sikur fliste për përbindëshat e shenjtë, për dinosaurët që bredhin akoma nëpër male dhe që shikojnë atë që ka zemër të pastër.

At Agapiosi, i hollë, i thatë, me një zhdërvjelltësi rinore, ecte në krye dhe nuk fliste; bisedat e Pakomit, nuk duhej t'i pëlqenin, dhe ai nxitonte të arrinte majën.

Kur ne vendosëm këmbë mbi majën e shenjtë, zemra ime u drodh; kurrë sytë e mi nuk ishin gëzuar nga një spektakël aq tragjik e aq i këndshëm. Poshtë Arabia, e mbrujtur me malet blu të thellë, më tej vargmalet e kaltëruara të Arabisë së lumtur dhe deti i gjelbër, që vezullonte si gur i çmuar. Në perëndim shkretëtira tymoste nën diell, ndërsa prapa, shumë larg malet e Afrikës. Këtu, mendoja,

shpirti i një njeriu krenar ose të dëshpëruar, mund të gjejë lumturinë më të madhe.

Hymë në kishëzën e vogël të majës. Pakomi, gërvishte muret me thua, për të zbuluar afresket e vjetra, tregonte triumfalisht kolonetat e vogla bizantine të dritareve; më thirri plot admirim, për të parë dy pëllumba bizantinë që kishin bashkuar sqepat, të cilët simbolizonin shpirtin e shenjtë. Ai përpiqej të zbulonte, të rindërtonte jetën e vjetër. Mbi atë majë ku kishte zbritur Zoti si një flakë e pashuar, ai shpirt arkeologu më ngacmonte. U ktheva nga murgu:

- At Pakom, - i thashë, - si e imagjinon Zotin ti?

Ai ndaloi, më pa, pasi u mendua një çast më tha:

- Si një baba që i do fëmijët e tij, - më tha.

- Nuk ke turp? - thirra, - mbi malin Sinai, t'i guxon të flasësh në këtë mënyrë për Zotin? Pra ti nuk i ke lexuar shkrimet e shenjta? Zoti është "një zjarr që djeg."

- Përse më thua kështu?

- Që ti t'i lësh gjithë këto gjëra, të kaluarën, të lësh Zotin t'i djegë. Ndiq, Pakom, zjarrin e Zotit dhe mos kërko të mbledhësh hirin.

- Një këshillë: Mos gërmo të mësosh se ç'është Zoti, - thotë At Agapiosi. - Mos e prek zjarrin, sepse do të të djegë; në qoftë se do të shikosh Zotin do të verbohesh.

Hapi çantën që mbante mbi shpinë, nxori prej andej dy pëllumba, dy karkaleca deti, arra, hurma, një shishezë me raki palme dhe një bukë gruri:

- Eja të hamë!

U kujtuam se kishim uri; përdorëm për tryezë një gur të madh ku dukej akoma siç thonë, vendi ku Moisiu kishte vendosur këmbën - një e thelluar e madhe si një arkivol fëmije. Pakomi i harroi pëllumbat e gurtë që ishin përqafuar dhe u hodh me oreks të madh mbi pëllumbat e skuqur; rrallë kisha parë një njeri që të hante me aq babëzi, duke vënë në veprim sytë, duart, dhëmbët; gjithë kockat e vogla që ngelnin ai i grumbullonte përpara tij dhe i gërryente përsëri.

- Pëllumbat u ngjallën, At Pakom, - i thashë duke qeshur. Hyr në kishë dhe do të shohësh se nuk janë më aty.

- Përse qesh? - më tha Pakomi. - Gjithçka është e mundur.

- E di, në qoftë se shpirti i shenjtë do të kishte qenë pëllumb, ti

do ta haje! - thotë Agapios, të cilit nuk i pëlqente grykësia e shokut të tij.

At Agapiosi heshti, pa shkretëtirën, psherëtiu.

- Përse psherëtin, At Agapios? - e pyeta dhe kisha një kureshtje të madhe të dija se ç'ishte ky murg i ashpër që, megjithëse aq i vjetër, e ngjiste malin me aq lehtësi.

- Si do ti, bir, të mos psherëtij? - m'u përgjigj. - Duart dhe këmbët e mia janë plot me baltë. Zemra po ashtu. Po vjen koha që unë të paraqitem përpara Zotit. Me çfarë duar, me çfarë këmbë, me çfarë balli? Duart e mia janë plot gjak, këmbët janë plot baltë. Kush do të m'i pastrojë?

- Krishti, At Agapios, - thotë Pakomi për ta ngushëlluar, - Krishti. Përndryshe, përse do të zbriste ai në tokë? Duhet t'i thuash: Krisht, ja duart e mia, këmbët e mia; laji ato!

Unë fillova të qesh. Pra qënkej detyrë e Zotit të na lante duart?

- Përse qesh? - më pyet Pakomi i prekur.

- Nëse ti më lejon, At Pakom, - i thashë, - unë do të të përgjigjem me një anektodë. Dikur, në Arabi ishte një mbret shumë i keq; çdo mëngjes, përpara se të gdhinte, ai mblidhte skllevërit e tij dhe nuk i lejonte të dilnin në punë, përpara se ai të urdhëronte diellin të lindte. Një ditë një plak, i ditur, iu afrua dhe i tha: - Nuk e di ti mbret se dielli nuk lind me urdhërin tënd? - E di, plak i urtë, e di, por më thuaj, çfarë lloj Zoti do të jetë ai që nuk mund të bëhet instrumenti im. Ti e kupton besoj, At Pakom.

Por gjatë kohës që unë flisja, Pakomi kishte gjetur një kockë me pak mish, po e kafshonte e nuk m'u përgjigj.

U ktheva nga Agapiosi, për të ndërruar bisedë.

- Si u bëre murg, At Agapios?

- Si u bëra murg? Unë nuk doja, por e donte Zoti këtë. Kur isha njëzet vjeç, më pushtoi dëshira të bëhesha murg, por djalli vinte pengesa. Çfarë pengesash? - do të më thuash ti. Epo mirë, punët më ecnin dhe fitoja lekë. Ç'do të thotë të fitosh lekë? Kjo do të thotë të harrosh Zotin. Isha sipërmarrës, ndërtoja ura, shtëpi, rrugë; fitoja para me lopatë. Me vete thosha: sapo të kem mbaruar lekët do të shkoj të bëhem murg. Zoti më mëshiroi. Luajta në bursë dhe humba deri në qindarkën e fundit. Lavdi Zotit, unë e preva litarin dhe

u nisa, si ai që pret litarin e një balone dhe ngjitet drejt qiellit. Kështu unë e lashë botën.

Fytyra e tij e zbehtë mori ngjyrë; ai u kujtua se ishte liruar nga bota, dhe për këtë ishte mjaft i gëzuar.

- Kështu unë erdha këtu. Nuk e dija ku shkoja, por Zoti më mori për dore dhe më solli këtu; është e madhe shpirtgjerësia e tij. Erdha, por isha akoma shumë i fortë; mos më shih sot, që jam plak e jam konsumuar, i fishkur si rrush i thatë; atëherë më ziente gjaku, e nuk mund të rrija duarkryq; lutjet nuk më qetësonin, fillova të punoj. Ndërtoja rrugë. Rrugët mbi të cilat kaluam janë ndërtuar nga unë. Unë ndërtoj rrugë, ajo është puna ime, për këtë kam lindur. Në qoftë se unë shkoj në Parajsë, do të shkoj për rrugët që kam bërë.

Ai filloi të qeshë, duke dashur të tallej me shpresën e tij:

- Pff! Parajsa! Kështu hyhet në Parajsë?

Pakomi, që ishte mbështjellë me një mbulesë dhe flinte i rënduar nga ushqimi i tepërt, dëgjoi fjalët e fundit të Agapiosit dhe hapi sytë: - Ti, Agapiosi, atje do të hysh, - thotë me zë të qetë, - atje do të hysh... Mos u shqetëso.

Agapios shpërtheu në të qeshura.

- Ti sigurisht, e ke më mirë, mos ki frikë. Ti ke një furçë të vogël, ngjyra, pikturon parajsën dhe hyn atje. Kurse për mua është tjetër gjë. Unë, në punë! Unë duhet të ndërtoj një rrugë të madhe deri te porta e Parajsës, përndryshe nuk mund të hyj. Secili me veprën e tij.

U kthye nga unë; - Po ti? - më pyeti.

- Unë, u përgjigja, unë kam hyrë tashmë. Parajsa më paraqitet si një mal i lartë, me një kishëzë në majë; përpara kishëzës, një tryezë e gurtë, mbi tavolinë, pëllumba të pjekur, arra, hurma, një shishezë me raki palme, dy njerëz të zotë që më bëjnë shoqëri, me të cilët bisedoj për Parajsën.

Pakomi fërgëllinte, u mbështoll mirë në mbulesën e tij dhe u çua; buzët i ishin bërë blu; u përkul, mori botilen, kishte ngelur edhe pak raki, e piu.

- Për hir të Zotit, ikim që këtej, këtu do të ngrijmë. Ai filloi të zbresë.

Natën, i vetëm në kamaren time, duke ruajtur vizionin e shkretëti-

rës thellë në mendje dhe shpirt, shfletoja Testamentin e Vjetër. Sigurisht, shkretëtira nuk është banuar nga askush, veç nga Një dhe ky Një nuk fal, nuk qesh, nuk ka mëshirë. Mjeshtri i shkretëtirës nuk është as tmerri, as uria, as etja, as luani i uritur, as vdekja. Është Zoti.

Shfletoja kaçuben që digjej e nuk mbaronte, Testamentin e vjetër, dhe më dukej se hyja përsëri në grykën e tmerrshme, që kishte hapur ne mal Jehovai, për të kaluar. Bibla më dukej si një vargmal me shumë maja ku ulërijnë profetët, që zbresin, të lidhur me litar e të mbështjellë me zhele.

Dhe ndërsa i përkulur shfetoja Biblën, duke kaluar nga maja në majë, kujtoja vajzën që më kishte folur një ditë me aq pasion për adoleshentin "kuqalash me sy të bukur" që Zoti e kishte zgjedhur midis njerëzve, për ta bërë mbret. Samueli, që rezistonte duke u munduar në duart e Zotit, më mbushi zemrën me një brengë të madhe. Për t'u qetësuar, mora një letër dhe fillova të shkruaj. Kështu veproja gjithmonë, me këtë mënyrë të shëmtuar, për të larguar brengat e mia.

- Samuel!

Profeti i vjetër me rrip lëkure dhe zhele me ngjyra të ndryshme shikonte qytetin nën këmbët e tij dhe nuk dëgjonte thirrjen e Zotit. Dielli ishte ngritur rreth një këmbë në qiell, ndërsa poshtë, nga Gala mëkatare, tulatur mbi shkëmbinjtë e kuq të Karmelit, me palmat me gjethe me majë si gjilpëra dhe fiqtë me gjemba të Barbarisë të pjekur shumë ngrihej një zhurmë. - Samuel! - thirri përsëri Zoti. Samuel, shërbëtori im besnik, u plake, nuk më dëgjon?

Samueli fërgëllonte, vetullat e trasha iu ngrysën, mjekra e gjatë dhe e dendur i dridhej, veshët i kumbonin si guaska deti. Mallkimi, pelë e lëshuar, hingëllinte në thellësitë e qënies së tij: - mallkim ulërinte ai, duke e shtrirë krahun skeletik mbi qytetin që qeshte, këndonte e zukaste si një tufë grerëzash, - mallkim mbi njerëzit që qeshin, mallkim grave që përplasin këpucët mbi kalldrëmin e rrugëve!

Zot, o Zot, mos vallë rrufeja që qëndron nën kupolën tënde të bronxtë, është shuar? Mbi trupin e mbretit tonë ti ke hedhur sëmundjen e shenjtë, ai shtrihet mbi tokë, shkumëzon si kërmill dhe shfryn

si breshkë. Përse? Përse? Çfarë të ka bërë? Po të pyes, përgjigju! Lësho murtajën pra mbi të gjithë njerëzit në qoftë se je i drejtë, shkule farën nga trupi i burrave dhe mbille mbi shkëmbinjtë!

Samuel, - ulëriti për herë të tretë Zoti. - Samuel, pusho, dëgjo zërin tim.

Trupi i profetit filloi të dridhet dhe, ndërsa qe mbështetur mbi shkëmbinjtë e përgjakur ku thereshin viktimat e Zotit, dëgjoi në të njëjtën kohë tre thirrjet e Zotit. Ai ngriti krahët drejt qiellit:

- Zot, i thirri, - më shiko!

- Samuel, mbush kotruven me vajin profetik dhe shko në Betlehem.

- Është shumë larg; këmbët e mia prej njëqind vjetësh janë dërrmuar duke rrahur tokën, për të të shërbyer ty, zgjidh dikë tjetër, unë nuk mundem më.

- Unë nuk flas për mishin, atë e urrej, nuk e prek, unë i flas Samuelit.

- Fol, Zot, ja ku jam.

- Samuel, mbush kotruven me vajin profetik dhe shko në Betlehem. Gojën mbaje mbyllur, mos merr asnjë që të të shoqërojë dhe trokit në portën e Ikait.

- Unë nuk kam shkuar kurrë në Betlehem, si mund ta gjej shtëpinë e Ikait?

- E kam bërë me një njollë gjaku; shko trokit në portë. Zgjidh një nga shtatë fëmijët e tij.

- Cilin, Zot? Sytë e mi janë veshur e unë nuk shoh mirë.

- Kur do ta takosh, zemra jote do të bulurijë si viç; atë do të zgjedhësh. Hapi flokët, zbuloi majën e kokës dhe bëji mirosjen me vaj si mbret të çifutëve.

- Por Sauli do ta marrë vesh, në kthim ai do të më vrasë.

- Ç'rëndësi ka? Unë e vlerësoj jetën e shërbëtorëve të mi. shko!

- Unë nuk shkoj!

- Fshije djersën nga balli, mbërtheji mëngët që ato të mos dridhen më dhe fol me Zotin. Ti bëlbëzon, Samuel. Fol më qartë.

- Unë nuk belbëzoj; por po të them: nuk shkoj!

- Fol më qetë; ti thërret sikur ke frikë. Përse nuk shkon? Përse nuk përgjigjesh, ke frikë?

- Nuk kam frikë; është dashuria që nuk më lejon. Sauli, që unë i dhashë vajin mbretëror, jam unë. Unë e dua më shumë se fëmijët e mi, atij i kam dhënë shpirtin tim, midis buzëve të tij të zbehta; shpirtin e profetit, ai e ka mbuluar me lavdi. Ai është mishi dhe shpirti im; unë nuk e tradhëtoj kurrë!

- Përse s'e ruan qetësinë? Zemra e Samuelit a është e zbrazët tani?

- Ti je i gjithëfuqishëm, Zot, mos luaj me mua; më mirë më vrit! Ti nuk mund të bësh gjë tjetër; më vrit!

Sytë e Samuelit ishin plot gjak, u ngjit në shkëmb, priste.

- Më vrit! - thërriste nga brenda zemra, më vrit!

- Samuel! Zëri i Zotit tani ishte i ngrohtë, sikur i lutej.

Por profeti plak acarohej gjithnjë e më shumë.

- Më vrit, ti nuk mund të bësh gjë tjetër; më vrit!

Askush nuk u përgjigj. Kaloi mesdita, dielli po ulej, u duk një djalë zeshkan, këmbëzbathur; ai ngjiste shtegun dhe afrohej tek profeti me tmerr, sikur afrohej në buzë të greminës. Vendosi në fund të shkëmbit, ushqimin e profetit, hurma, mjaltë, bukë dhe një kotruve uji, iku me nxitim, duke mbajtur frymën, zbriti në qytet dhe shkoi në kasollen prindërore. Nëna e mori në krah.

- Akoma? - e pyeti ajo, ndërsa zëri i dridhej, akoma?

- Akoma, - u përgjigj fëmija; ai lufton akoma me Zotin.

Dielli kaloi prapa malit, ylli i mbrëmjes varej mbi qytetin mëkatar, si një farë e zjarrtë. Një grua e zbehtë e pa dhe gjithë zili thirri:

- Tani ai do të bjerë dhe do të djegë botën!

Yjet ranë mbi flokët e gjatë të profetit; ata tunden, shkëlqejnë dhe kërcejnë rreth kokës së tij, duke iu bindur një rruge të padukshme; profeti qëndronte në këmbë midis tyre dhe dridhej. Yjet hynë në flokët e tij, godisnin tëmthat si breshër. - Zot... Zot... pëshpëriti afër agimit; asnjë fjalë tjetër nuk mund të dilte nga goja e tij. Hoqi kotruven dhe e mbushi me vaj profetik, shtrëngoi bastunin e drunjtë dhe filloi të zbresë. Sikur fluturonte, ndërsa mbi mjekrën e bardhë, pikat e vesës ndriçonin si yje. Dy fëmijë, që luanin te pragu i shtëpisë së parë, sapo dalluan zhelet me ngjyra të Profetit, u nisën me vrap duke thirrur: - Erdhi! Erdhi!

Qentë, me bishtin në shalë u futën nëpër qoshe, një mëshqerrë e shtriu qafën për tokë. Qytetin e përshkoi një erë e fuqishme; portat

u mbyllën, nënat thirrën fëmijët që luanin nëpër rrugë dhe i futën brenda. Samueli, godiste gurët e rrugës me bastun dhe ecte me hapa të gjatë për të kaluar qytetin sa më shpejt.

- Sikur jam lufta mbi kokën e njerëzve, - pëshpëriti, - sikur jam murtaja. Sikur jam Zoti!

Dy barinj, me nga një kërrabë në dorë, që po kalonin një shteg sapo panë profetin u shtrinë për tokë.

- Zot, më jep urdhër të shkoj t'u thyej kokën, Zot, foli zemrës sime, unë jam gati, por asnjë zë nuk e turbulloi shpirtin e tij, dhe ai e përshkoi rrugën duke mallkuar me forcë racën njerëzore.

Dielli përvëlonte, pluhuri i ngritur nga këmbët, e mbështillte si një engjëll. Ai kishte etje.

- Zot, - thirri, - më jep të pi!

- Pi, - u përgjigj një zë pranë tij, i qetë si pëshpërimë uji.

U kthye dhe pa, se nga e çara e një shkëmbi rridhte uji dhe binte mbi një vaskë. U përkul, hapi mjekrën dhe vendosi buzët mbi ujë. Freskia zbriti tek këmbët dhe kockat e tij të vjetra kërcitën.

Nisi përsëri rrugën; dielli perëndoi. U shtri pranë një palme duke vendosur njërën dorë nën faqe dhe e zuri gjumi. Çakejtë, që ndjenë erën e tij u grumbulluan përreth por u larguan të tmerruar. Mbi kokën e tij yjet vareshin si mijëra shpata. U zgjua në agim dhe nisi përsëri udhëtimin e tij të gjatë. Ditën e tretë, mali hapet, tej duket fusha, ndërsa në mes, Jordani si një gjarpër i ngopur rrëshqiste ngadalë, në shpinë i shkëlqenin luspat e gjelbra. Kaluan tri ditë dhe fare papritur, prapa hurmave, shkëlqyen shtëpitë e bardha të Betlehemit. Një tufë pëllumbash kaloi mbi kokën e profetit, qëndruan pak çaste duke ardhur përreth dhe pastaj u zhdukën me të shpejtë, të trembur, drejt Beltlehemit.

Në portën e madhe të fortifikuar të anës veriore, nën erën e fortë të bagëtive, midis të verbërve dhe lebrozëve, pleqtë rrinin në këmbë duke pritur profetin; ata dridheshin dhe këmbenin fjalë ndërmjet njëri-tjetrit me zë të ulët:

- Mbi vendin tonë po bie lebra! Zoti nuk zbret mbi tokë veç për të dërrmuar krijesat e tij.

Më i vjetri mori guximin dhe eci një hap përpara.

- Unë, do të shkoj t'i flas, - tha.

Profeti mbërriti midis një reje pluhuri, ndërsa rrobat i valëviteshin si flamur i grisur në luftë.

- Paqe apo masakër? Çfarë na ke sjellë?

- Paqen! - përgjigjet profeti duke shtrirë duart përpara. - Kthehuni në shtëpitë tuaja, lëreni rrugën të lirë. Dua të shkoj vetëm!

Rrugët u boshatisën, portat u siguruan. Samueli i ra fshatit kryq e tërthor, duke prekur çdo portë. Në krye të fshatit, në shtëpinë e fundit ai dalloi gjurmën e gjaktë të gishtit. Trokiti. Gjithë shtëpia u trondit dhe Ikai plak çohet i tmerruar për të hapur portën.

- Paqe mbi shtëpinë tënde Ikai plak, shëndet për shtatë djemtë e tu, që nuset të bëjnë vetëm djem; Zoti qoftë me ty!

- U bëftë vullneti yt! - përgjigjet Ikai ndërsa nofulla i dridhej.

Në derë u duk një njeri që me trupin e tij e bllokoi të gjithë. Samueli kthehet, e pa dhe sytë iu mbushën me gëzim. Ishte një gjigand, me flokë të zinj kaçurrel, me gjoks të gjerë leshtor, këmbë të forta si kolona bronxi.

Ikai, gjithë krenari, tha: - Djali im i madh, Eliab.

Samueli heshti dhe priste që zemra e tij të bulurinte.

- Ai duhet të jetë, - thoshte shpirti i tij, - sigurisht ai duhet të jetë! Zot, përse nuk flet?

Priti gjatë; por përnjëherë brenda tij shpërtheu zëri i tmerrshëm.

- Çfarë ke që pështpërit? Shpirti yt të ka dërguar tek ai? Unë nuk dua! Unë i vrojtoj zemrën, kontrolloj veshkat, peshoj palcën në kocka. Unë nuk dua atë!

- Dërgo djalin tënd të dytë, urdhëroi Samueli; buzët iu bënë dyllë të verdha.

Erdhi djali i dytë, por zemra e profetit qëndroi e heshtur.

- Nuk është ai! Nuk është ai! Nuk është ai! - pëlliste zemra e tij, duke ndjekur njerin pas tjetrit gjashtë djemtë, duke fiksuar sytë mbi ballin, vetullat, buzët e tyre, duke kontrolluar shpinat, gjunjtë, shtatin sikur ishin deshë. I lodhur, ai doli tek pragu.

- Zot, - thirri i nxehur, ti më gënjeve! Gjithmonë je treguar mashtrues dhe i pamëshirshëm, nuk ke mëshirë për njerëzit. Dil, jam unë Samueli që të flas. Përse nuk flet?

Ikai i tronditur, i afrohet.

- Ka ngelur më i vogli, - thotë - Davidi. Ai ruan dhentë.

- Thërrite!

- Eliab, - thotë babai, shko kërko tët vëlla.

Eliabi, rrudhi vetullat, plaku u tremb dhe i tha djalit të dytë;

- Aminadab, shko kërko tët vëlla. Por edhe ai e kundërshtoi, të gjithë e kundërshtonin. Samueli ngrihet mbi prag:

- Hape portën; do të shkoj vetë!

- A do që të të përshkruaj trupin e tij që ti ta njohësh? - thotë plaku.

- Jo. Unë e njoh përpara se ta njihte i ati dhe e ëma!

U ngjit në mal duke u betuar, duke u përplasur pas shkëmbinjve, thërriste: Unë nuk dua! Nuk dua! Por gjithmonë duke ecur.

Sapo dalloi, midis dhënve, një fëmijë kokëqethur që rrinte në këmbë, Samueli ndaloi. Zemra palli si viç.

- David! - thërriti me një zë urdhërues, eja këtu!

- Eja ti, - i tha Davidi; unë nuk mund t'i lë dhentë.

- Ai është, ai është! - thirri Samueli, duke u afruar i nxehur.

Afrohet, e shtrëngoi nga supet, i pa shpinën, i pa kokën.

- Kush je ti? Pse më kontrollon? Fëmija e kundërshtonte duke tundur kokën.

- Unë jam Samueli, shërbëtori i Zotit; ai më tha: - shko dhe unë erdha, ai më tha: thirr dhe unë thirra. Unë jam këmba, goja, krahu, hija e tij mbi tokë. Përkulu!

Mbi majën e kokës i hodhi vajin e shenjtë.

- Unë nuk dua aspak, nuk të dua ty, është një tjetër që gëzon dashurinë time. Por era e Zotit kalon mbi kokën time dhe unë pa e dëshiruar këtë, ngre dorën dhe hedh mbi kokën tënde vajin profetik. Unë e shenjtëroj Davidin mbret të çifutëve! Unë shenjtëroj Davidin mbret të çifutëve! Unë shenjtëroj Davidin mbret të çifutëve.

Hodhi kotruven tej, e cila u thye nëpër gur.

- Kështu e theve ti zemrën time, Zot! Unë nuk dua të jetoj më!

Nga lartësitë e qiellit zbritën shtatë korba dhe i silleshin rrotull duke pritur. Profeti rrotullohet dhe shtriu qefinin për tokë, xhybenë e tij të gjelbër. Korbat iu afruan. Ai mbuloi fytyrën me zhelet pa ngjyrë dhe nuk lëvizi më.

Me këtë vizion të njeriut që i rezistoi më kot Zotit, më zuri gjumi dhe unë u dorëzova pa qëndresë në duar të padukshme. Kështu kaloi nata, një natë e qetë, pa ëndrra dhe mund të them e këndshme.

U zgjova në agim dhe zbrita në oborr, ku murgjit pasi më përshëndesnin nën vagëllimën e mëngjesit, zhdukeshin njëri-pas tjetrit në kishë. Hyra edhe unë.

Çfarë lumturie, mendoja, çfarë vetmie, larg botës që lëviz e pëllet! Përse ta lë këtë krah të Krishtit që më strehon, përse të humbas në ndodhitë dhe gëzimet e vogla? Këtu është guaska që mban brenda perlën e madhe. Do ta mposhtë trupin dhe shpirtin, do të zhduk gjithë bisqet që gllabërojnë forcën e majës dhe nuk do të ngelet tek unë veç maja dhe unë do ta ngjis... Unë kam një luftëtar të madh përpara meje, atë do të ndjek; Ai ngjit një të përpjetë të tmerrshme, unë do ta ngjis tok me të.

Nën dritën e dobët të kandilit, shikoja formën asketike dhe burrërore të Krishtit, dalloja duart e tij të holla që shtrëngonin fort botën dhe nuk e lejonin të binte në kaos, dhe e dija se mbi tokë, sado që ne të jetojmë, ajo nuk është porti i mbërritjes por porti i nisjes; ne jetojmë mbi një det të egër e të tmerrshëm dhe gjatë gjithë jetës përpiqemi të kapim spirancën te Zoti. Krishti nuk është fundi, por fillimi, ai nuk është "Mirë se erdhe!" por, është "Rruga e mbarë!". Ai nuk rri i shtrirë, duke u shlodhur, mbi retë e buta, por ndeshet me stuhinë së bashku me ne, me sy të fiksuar në qiell mbi yllin polar. Prandaj më pëlqente të shkoja me të. Ajo që më shumë më inkurajonte, ishte se njeriu që gjëndej brenda Krishtit ishte nisur, me të vetmen forcë e përpjekje, me të vetmen shpresë, për të arritur te Zoti, për t'u bashkuar e bërë një me të, për t'u bërë një e të pandashëm. Nuk ka rrugë tjetër për të arritur tek Zoti; është vetëm kjo: Duke ndjekur gjurmët e përgjakura të Krishtit, për të transformuar njeriun në thellësinë e tij, për ta bërë shpirt, për ta bërë që ai të bashkohet me Zotin.

Kjo substancë e dyfishtë e Krishtit ka qenë për mua vazhdimisht një mister i thellë i padepërtueshëm: Dëshira pasionante e njerëve, njerëzorë ose jonjerëzorë, të arrijnë deri te Zoti - ose, më saktësisht të kthehen nga Zoti dhe të identifikohen me të. Kjo nostalgji, kaq misterioze dhe reale në të njëjtën kohë, hapte tek unë plagë të mëdha dhe burime të mëdha.

Që në rininë time, brengat e mia të para, burimi i gjithë gëzimeve dhe hidhërimeve, ka qenë kjo; lufta e pandërprerë dhe e pamëshirsh-

me ndërmjet mishit dhe shpirtit. Tek unë gjendeshin forcat e errëta të së keqes, të hershme, të vjetra madje më të vjetra se njeriu, forca dritëdhënëse e Zotit, e herëshme, e vjetër, madje më e vjetër se njeriu. Shpirti im ishte fusha e betejës ku ndesheshin dhe luftonin këto dy armë.

Ishte një brengë e madhe. E doja trupin tim dhe nuk doja ta shihja të humbiste. E doja shpirtin tim dhe nuk doja ta shihja të çvlerësohej. Luftoja për t'i bashkuar këto dy forca kozmike antagoniste, për t'i bindur ato se nuk janë armike midis tyre, por në të kundërtën janë bashkëudhëtare, për t'i bërë të gëzohen, dhe bashkë me to të gëzohem dhe unë në harmoninë e tyre.

Çdo njeri është njëherësh Zot, mish e shpirt. Ja përse misteri i Krishtit nuk është vetëm misteri i një kulti të veçantë, por prek gjithë njerëzit. Tek çdo njeri shpërthen lufta e Zotit dhe e Njeriut, e pandashme nga dëshira e vjetër e pajtimit. Më shpesh kjo luftë është e pavetëdijshme dhe e ashpër, një shpirt i dobët ka frikë t'i rezistojë mishit për një kohë të gjatë. Ai rëndohet, bëhet mish edhe ai, dhe lufta këtu merr fund. Por te njerëzit e përgjegjshëm, që ditë e natë i mbajnë sytë te Detyra Supreme, kjo luftë ndërmjet mishit dhe shpirtit shpërthen pa mëshirë dhe mund të zgjasë deri në vdekje. Sa më të fuqishëm janë shpirti dhe mishi, aq më pjellore bëhet lufta dhe më e pasur harmonia finale. Zoti nuk i do shpirtrat e dobët as mishrat pa rezistencë. Shpirti dëshiron të luftojë me një mish të fuqishëm, plot rezistencë. Shpirti është një zog mishngrënës që gjithmonë ka uri, që gllabëron mishin dhe e zhduk duke e asimiluar.

Lufta ndërmjet mishit dhe shpirtit, rebelimi dhe rezistenca, pajtimi, mposhtja dhe në fund, ajo që është qëllimi suprem i luftës, bashkimi me Zotin - Ja rruga e përpjetë që ka marrë Krishti, i cili na lutet edhe neve që të marrim atë rrugë dhe të ndjekim gjurmët e tij të gjakosura.

Si do të mundim për të arritur edhe ne në atë majë supreme ku ka arritur Krishti? - Ja detyra më e lartë e njeriut që lufton.

Duhet pra, për ta ndjekur atë rrugë, që ne të kemi një njohje të thellë të asaj lufte, që të jetojmë ankthin dhe brengën e saj, si i mposhti graskat e lulëzuara të tokës, si i sakrifikoi ai gëzimet e mëdha dhe të vogla të njeriut dhe si u ngjit nga sakrifica në sakrificë,

nga trimëria në trimëri deri në majën e provës së tij, te kryqi.

Unë nuk kam ndjekur kurrë me ritëm aq të lartë ecjen e tij të përgjakshme drejt Golgotës, nuk kam jetuar kurrë me aq dashuri dhe kuptim jetën dhe pasionin e Krishtit, veç ditëve dhe netëve që jetova në Jeruzalem, në bregun e Detit të Vdekur në Galile. Kurrë s'kisha ndjerë me të tillë ngrohtësi, me të tillë vuajtje, gjakun e Krishtit që binte pikë-pikë në zemrën time.

Sepse Krishti, për t'u ngjitur në majë të sakrificës, mbi kryq, në majë të jomateriales, te Zoti, ka kaluar nëpër gjithë provat e njeriut që lufton. Të gjitha, dhe pikërisht për këtë arsye, vuajtja e tij na është kaq e afërt, prandaj ne vuajmë së bashku me të, prandaj fitorja e tij përfundimtare na duket si fitorja jonë e ardhshme. Gjithçka njerëzore që kishte Krishti ne na ndihmon të kuptojmë, të duam dhe të ndjekim pasionin e tij, sikur të ishte yni. Në qoftë se ai nuk do të kishte patur ngrohtësinë e këtij elementi njerëzor, nuk mund të prekte kurrë zemrën tonë me aq bindje dhe dhimbje; dhe nuk do të ishte bërë një model për jetën tonë. Ne luftojmë, e shohim atë sesi lufton si ne dhe marrim zemër. Ne shohim se nuk jemi vetëm në këtë botë dhe se ai lufton pranë nesh.

Çdo moment i jetës së Krishtit është një luftë dhe një fitore. Ai ka triumfuar mbi ngasjet e parezistueshme të gëzimeve të thjeshta të jetës njerëzore; i ka rezistuar gjithë tundimeve; Ai transformonte vazhdimisht mishin në shpirt dhe vazhdonte ngjitjen. Çdo pengesë në marshimin e tij kthehej në një mundësi për fitore. Ne kemi sot përpara një shembull që na hap rrugën dhe na jep guxim.

Ai shpërndan në qiell dhe mbi tokë, në zemrën tonë dhe në zemrën e çdo njeriu, një frymë me përmasa universale që quhet Zot. Një klithmë të madhe. Filizat duan të jenë të qetë, pranë ujërave të ndenjura; por del fuqishëm klithma dhe tund rrënjët e tyre: - Ik, lëre tokën, ec! Në qoftë se pema do të mundej të fliste, do t'i kishte thënë: - Nuk dua! Ku po më çon? Ti kërkon të pamundurën!

Por klithma, e pamposhtëshme tund rrënjët, thërret: - Ik, lëre tokën, ec!

Gjatë mijëra vjetëve ai ka ngritur fuqishëm britmën e tij, dhe ja me gjithë forcën dhe dëshirën për luftë, jeta e ka lënë pemën të palëvizshme dhe ajo e çliruar thotë: - Jam mirë këtu. Kam qetësi dhe

siguri. Nuk do të lëviz!

Por klithma e tmerrshme është ngulur, e pamposhtëshme në trungun e saj - Lëre baltën, ngrihu mbi këmbët e tua, bëju më e madhe se ç'je.

- Nuk dua, nuk mundem!

- Ti nuk mundesh, por mundem unë. Çohu!

Kjo ka zgjatur mijëra shekuj dhe ja, duket duke u dredhur mbi këmbët akoma të pamësuara, njeriu.

Bota është një centaur, këmbët e saj si të kalit janë ngulur mbi tokë, por trupi, nga gjoksi në kokë, është torturuar dhe punuar nga klithma e pamposhtur. Ajo është përpjeur shumë gjatë mijëra vitesh, të dalë, si një shpatë nga këllëfi i kafshës. Ai përpiqet, dhe kjo është lufta e saj e re, tashmë të dalë nga këllëfi i njeriut.

- Ku të shkoj? - thërret i pashpresë njeriu, - unë arrita në majë; nga ana tjetër shtrihet kaosi.

- Jam unë nga ana tjetër; çohu!

Çdo gjë është një centaur; në qoftë se nuk do të ishte kështu bota do të kalbej, pa jetë dhe e shterpët.

Për orë të tëra eca rreth manastirit, në shkretëtirë, dhe pak nga pak, Zoti filloi të çlirohet nga priftërinjtë. Zoti për mua u bë kjo klithmë.

A DO TË BËHESHA MURG?

Sa më shumë kalonin ditët në këtë qetësi të Zotit, aq më shumë qetësohej zemra ime, sikur mbushej me përgjigjet e pyetjeve të saj; unë nuk pyesja më, isha i sigurtë. Nga vijmë, ku shkojmë, cili është qëllimi ynë mbi tokë, gjithçka në këtë vetmi hyjnore më dukej shumë e thjeshtë dhe e sigurtë. Pak nga pak gjaku im po merrte ritmin e Zotit. Shërbesa e mëngjesit, mesha, shërbesa e mbrëmjes, psalmoditë, dielli që ngrihej në mëngjes, dielli që perëndonte në mbrëmje, yllësitë, shandanet që rrinin varur gjithë natën mbi manastir, të gjitha këto ndryshonin, duke iu bindur ligjeve të përjetshme dhe hynin në të njëjtin ritëm duke qetësuar gjakun e njeriut. Bota më dukej si një pemë, si një plep gjigand. Unë isha një gjethe e gjelbër, mbajtur në një degë në kërcellin tim. Era e Zotit frynte, unë fërgëlloja dhe kërceja së bashku me pemën.

I flisja shpirtit tim dhe e pyesja me ankth:

- Çfarë dëshiroja? T'i bindesha një ritmi të ashpër, të rekrutohesha në një ushtri për shpresën më të lartë. Të hipja kur të më vinte radha në Argon Kretane, bashkë me heronjtë që agjëronin, leckamanët, virgjëreshat - që hapnin velën e kuqe e cila kërciste në direkun e madh, rrënja mistike e kungimit e të lundronim si piratë për të hequr nga supet e Zotit, Bashkën e Artë të pavdekësisë.

Të mposhtja gjithashtu vogëlsinë, kënaqësinë, vdekjen. Çdo ditë për shumë orë endesha në shkretëtirë dhe ndieja të vdiste ngadalë tek unë një vendim i fshehtë që nuk guxonte akoma të quhej me emrin e vërtetë. Në mbrëmje kthehesha në manastir; murgjit dilnin nga qelitë, nxehtësia e ditës kishte rënë dhe ata merrnin frymë të lehtësuar, në freskinë e mbrëmjes që binte.

Vetmia sjell vdekjen e të gjithë shpirtrave që nuk digjen nga një pasion i madh; në qoftë se murgu, në vetminë e tij nuk e do Zotin deri në vetmohim, atëherë është i humbur. Disa prej murgjëve u kishte ikur nga pak mendja. Ata mbyllnin sytë përgjysmë, nuk kishin asgjë se çfarë të mendonin dhe të dëshironin. Uleshin në radhë në oborr dhe prisnin çastin për të hyrë në kishë, në mensë, në kamare; kjo ishte e gjitha. Kujtesën e kishin të turbulluar, dhëmbët të rënë dhe u dhimbnin veshkat. Nuk ishin as njerëz, as kafshë dhe akoma nuk ishin bërë engjëj. Të zhytur në një lloj limontie, ata prisnin vdekjen duarkryq, ashtu si presin pemët pranverën.

Njëri prej tyre sillte ndër mend femrën dhe pështynte pa pushim; një tjetër ruante në këmishë një fletore dhe një kuti të vogël me lapsa ngjyra-ngjyra dhe bënte gjithmonë të njëjtin vizatim; Krishtin me gjinj duke ushqyer Nënën e tij, një tjetër pasi zgjohej çdo mëngjes, zbriste te burimi në oborr, kruhej me forcë për të hequr nga trupi pisllëkun e ëndrrave të natës. Në oborr gjithmonë në të njëjtin vend, duke mbajtur mbi gjunjë një libër të mbyllur, qëndronte ulur murgu i çuditshëm që kishte ardhur ditën e parë në banesën e "stjuardesave" me Atin mikpritës; ai nuk fliste kurrë me asnjë dhe kur unë hyja në oborr ai ngrinte sytë, më vëzhgonte dhe vinte buzën në gaz, nganjëherë me dashamirësi, nganjëherë me tallje. Një ditë, kur po kaloja pranë tij, ai drejtoi trupin; u bë gati të fliste, por ndryshoi vetëm pozicionin dhe buzëqeshja iu zhduk nga buzët. Gjatë shtatë ditëve unë shijova vetminë hyjnore; ditën e shtatë, Ati mikpritës, duke buzëqeshur erdhi në kamaren time.

- Më dërgoi igumeni i shenjtë - tha ai, - për të pyetur ku është shpirti yt dhe çfarë vendimi ke marrë.

- Unë i puth dorën - iu përgjigja; - para se të përgjigjem, do të doja të rrëfehesha.

Ati mikpritës, pas një çasti tha:

- Ti do të doje të rrije me ne?

- Do të doja të qëndroja me Zotin dhe këtu në shkretëtirë unë e ndiej më pranë vetes. Kam frikë se jo të gjitha rrënjët që më mbajnë lidhur me botën janë shkulur. Do të rrëfehem tek igumeni, ai do të vendosë.

- Igumeni i shenjtë kërkon shumë prej njerëzve. Ki kujdes!

- Edhe unë kërkoj shumë nga vetja; prandaj e kam me mëdyshje.

Në çastin kur po hapte portën për t'u larguar, ndaloi.

- At Joakimi më kërkoi të të thosha se donte të të shikonte.

- At Joakimi?

- Plaku që erdhi me mua ditën e parë për të uruar mirëseardhjen. U gëzova shumë; më në fund do merrja vesh se kush ishte ky murg i heshtur dhe i çuditshëm.

- Kur pra?

- Sonte, në kamaren e tij.

- Thuaji që do të shkoj.

- Ai ka qenë një person i rëndësishëm. Nuk frekuenton askënd dhe nuk flet veçse me Zotin. Emrin tënd e di dhe do të të shoh; foli me respekt, hë?

Dhe pa pritur përgjigjen time, kapërceu pragun.

Prita derisa nata ra plotësisht dhe murgjit fjetën. Një nga një dritat e kamareve u fikën, përshkova në majë të gishtave koridorin e gjatë dhe arrita në kamaren e At Joakimit. Ndalova për t'u shlodhër, po më merrej fryma sikur kisha vrapuar; drita ishte e ndezur. Mbështeta veshin pas portës për të dëgjuar. Asnjë zhurmë. Në çastin kur zgjata dorën për të trokitur, dera u hap dhe u duk Joakimi, këmbëzbathur, pa kësulë, me flokët e bardhë të derdhura mbi supe, të lidhura me një litar me nyje.

- Je i mirëpritur, - tha. Shpresoj mos të të ketë parë askush. Muret ishin të zhveshur, në cep ndodhej një krevat i ngushtë me kashtë i vendosur mbi këmbë hekuri, një tryezë e vogël, dy stola; në një të thelluar të murit ishte një shtëmbë; mbi tryezë një libër i madh i lidhur, pa dyshim Ungjilli, dhe në mur, përballë meje, një kryq i madh dërrase ku paraqitej jo kryqëzimi por Ringjallja.

Vargje me mollë ishin varur nëpër trarë dhe gjithë kamarja vinte era mollë të kalbura.

Ai shtriu krahët; kamarja ishte e ngushtë, dhe ata pothuajse preknin muret:

- Ja fshikëza ime, - tha ai duke buzëqeshur. Unë jam mbyllur këtu si vemje, duke pritur ditën që do të dal si flutur.

Ai tundi kokën: qëndronte në këmbë, pranë dritës që ndriçonte fytyrën e tij të gjatë, të fishkur. Kafshonte buzët e holla, zërin e kishte plot ironi dhe hidhërim.

- Për çfarë mendon ti se ëndërron vemja e shkretë?

- Për krahë!

Ai u kthye nga unë, më pa me ironi në fytyrë, shikimi i tij dukej sikur kërkonte ndihmë.

- Si thua, nga naiviteti ëndërron të ketë krahë? Nga mendjemadhësia? Apo në të vërtetë ajo ndien ngacmime në shpinë dhe krahët duan të dalin?

Bëri një veprim me krahë, sikur mbante një sfungjer dhe fshinte diçka: - Mos të shkojmë më tutje! - tha. - Kaq mjafton. Merr një stol dhe ulu. Doja të të flisja për diçka tjetër prandaj të solla këtu... Ulu pra; mos më shih mua, unë nuk mund të ulem...

Nisi të qeshte.

- Ti e di, - më tha. - Ka një herezi që quhet: "Gjithmonë në këmbë." Unë i përkas këtij sekti, që prej vitesh, që nga fëmijëria.

- Unë jam ithtar i një herezie tjetër: "Gjithmonë i shqetësuar."

Luftoj që nga fëmijëria ime.

- Me kë lufton?

Hezitova. Papritur, brenda meje u shfaq frika.

- Me kë? - përsëriti murgu.

Uli zërin dhe u përkul: - Me Zotin?

- Po.

Plaku hodhi shikimin mbi mua dhe nuk foli.

- Mund të jetë një sëmundje? Si të shërohem?

- Mos u shërofsh kurrë! Ai ngriti dorën, sikur më bekonte, sikur më mallkonte. - Fatkeqësi për ty në qoftë se do të luftoje me një të barabartë ose me një inferior, fatkeqësi për ty në qoftë se shërohesh ndonjëherë nga kjo sëmundje.

Heshti për një çast; - Këtu në shkretëtirë, - tha, - na vijnë shpesh shumë tundime;

Një mbrëmje, më erdhi në gjumë një tundim i çuditshëm. Ëndërroja sikur isha njeri i mençur në Jeruzalem; shëroja shumë sëmundje, por mbi të gjithë largoja djallin nga njerëzit. Vinin nga të gjitha anët për të sjellë të sëmurët. Atëherë, një ditë erdhi nga Nazareti, Maria, gruaja e Josifit, që sillte me vete Jezusin i cili ishte dymbëdhjetë vjeç. Ajo ra në këmbët e mia: - Ki mëshirë për mua, o plak i nderuar - thërriste duke qarë. - Kujdesu për tim bir. Ai ka shumë djaj në tru-

pin e tij.

I nxora përjashta të afërmit dhe mbeta vetëm me Jezusin. - Çfarë ke biro? - e pyeta duke i përkëdhelur dorën. - Ku të dhëmb? - Këtu, këtu... - m'u përgjigj duke treguar zemrën.

- Çfarë ke? - Unë nuk mund të fle, nuk mund të ha, as të punoj. Bredh rrugëve dhe luftoj. - Me kë lufton?

- Me kë tjetër, përveç se me Zotin.

E mbajta një muaj pranë meje; i flisja butësisht, i jepja qetësues për ta vënë në gjumë; e çova në shtëpinë e një karpentieri që të mësonte zanatin, dilnim shëtitje së bashku, i flisja për Zotin sikur të ishte shoku ynë, apo komshi që vinte në muzg, ulej me ne te porta dhe bisedonim. Nuk flisnim për gjëra shumë të komplikuara, flisnim për motin, për fushat, vreshtat, vajzat që shkonin te burimi...

Në krye të muajit Jezusi ishte shëruar plotësisht; nuk luftonte më me Zotin, ishte bërë burrë si gjithë të tjerët. U nis për ne Galile dhe shumë kohë më vonë, mësova se ishte bërë karpentier i zoti, më i miri në Nazaret. Murgu më vështroi: - E kuptove? - më tha. Ishte shëruar Jezusi, nuk kishte shëruar ai botën, ai ishte bërë karpentieri më i mirë i Nazaretit. - Ç'do të thotë kjo sëmundje? Ç'do të thotë kjo, shenjtëri?

- Lëre më mirë! Ndërrojmë bisedë! Më dukesh i lodhur, ulu.

U ula mbi një stol nën ikonë dhe shikoja mbi pllaka, këmbët e zbathura të murgut; kishte kockë të hollë, kavilje të zhdërvjellta, gishta të gjatë.

Drita ia ndriçonte si mermeret antikë nën shkëlqimin e diellit. Ai bëri dy hapa, u kthye, ndaloi para meje dhe kryqëzoi duart:

- Ngriji sytë, - tha me një zë përkëdhelës, sikur i fliste një fëmije.

- Shikomë mirë; nuk të kujtohem?

- Unë s'të kam takuar asnjëherë o plak, - iu përgjigja i hutuar.

- Asgjë nuk shlyhet nga shpirti i një fëmije. Sigurisht në brendësi të kujtesës tënde gjendet pamja ime. Jo kjo që kam tani, e plakur, e rrudhur, por një tjetër, e bukur, e fuqishme, burrërore. Dëgjo: një verë, ti duhet të ishe rreth pesë vjeç, unë ndodhesha në Kretë. Isha tregtar i madh, tregëtoja qitro, çiçibanoz, rrush të thatë; një nga ndërmjetësit që kisha ishte babai yt. Jeton akoma?

- Jeton, por është plakur, është kërrusur, i kanë rënë dhëmbët.

Qëndron gjithë ditën i ulur në kanape dhe lexon libra fetarë.

- Çfarë padrejtësie! Çfarë padrejtësie! - thirri plaku duke ngritur krahët drejt qiellit. Trupa të tillë nuk duhet ta humbasin fuqinë; duhet që vdekja t'u vijë papritur, ndërkohë që janë duke ecur dhe toka kërcet nën këmët e tyre. Ç'është vdekja? Është vepër e Zotit; çasti kur Zoti prek njeriun quhet vdekje. Por humbja e fuqisë dhe e prestigjit është një vepër e poshtër, e pabesë, është vepër e Satanait. Pra kapedan Mihali, është plakur, i kanë rënë fuqitë.

Heshti një çast, shikimi iu bë i egër, por pasi u mbush me frymë vazhdoi:

- Babai yt blinte për llogarinë time rrush të thatë, qitro, çiçibanoz, unë i ngarkoja në anije dhe i dërgoja në Trieste. Fitoja shumë, shpenzoja shumë, isha si një bishë që nuk lodhej së ngrëni, së piri, së shkuari me femra. Ia kisha shitur shpirtin Djallit, trupi im kishte mbetur pa Zot, kishte mbetur i lirë, tallesha me Zotin dhe e quaja gogol, dordolec që nuk ishte veçse për të trembur zogjtë budallenj dhe t'i pengonte që të mos hynin nëpër kopshte. Në mbrëmje pasi mbaroja punën, bëja ahengje të paturpshme deri në agim.

Kështu një mëngjes, përpiqu të kujtohesh, ti ishe në këmbë përpara magazinës së babait tënd, papritur dëgjove këngë, të qeshura dhe një karrocë me katër kuaj që ecte si e marrë. Ti u ktheve dhe po shikoje. Në karrocë ishin nja pesë e gjashtë gra koketa, të dehura komplet, që bërtisnin e qeshnin me zë të lartë dhe gjuanin me arra dhe fiq kalimtarët. Karrocieri kishte vënë një kapele të ndritshme dhe godiste kuajt me kamxhik; kuajt të nxehur, hingëllinin dhe ecnin me galop. Atëherë ti u frikësove, kujtove se do të të godisnin kuajt, lëshove një klithmë dhe vrapove të fshiheshe nën përparësen e babait tënd. Të erdhi kujtesa? Të kujtohet? Karrocieri i dehur isha unë; kisha një kapele të lartë, një qyngj sobe dhe për të të ngacmuar e ktheva kamxhikun nga ty dhe e kërcita në ajër... Po tani nuk të kujtohet? Ai u përkul dhe më shkundi nga shpatullat; - Hë të kujtohet? Kisha mbyllur sytë duke u përpjekur të largoja kujtimet që ishin vendosur mbi vitet e fëmijërisë. Hija u ndriçua pak nga pak dhe papritur nga fundi i kujtesës dolën katër kuaj, gratë e dehura, kapelja e tmerrshme dhe kërcitja e kamxhikut mbi kokën time.

- Po, po, - thirra, më kujtohet! Ti ishe, ti plak?

Por ai, pa ma vënë veshin, ishte mbështetur pas muri dhe kishte

mbyllur sytë. Ashtu, me qepalla të ulura, vazhdoi: - Një mëngjes të bukur më erdhi në majë të hundës. Mishi nuk është shumë i rëndësishëm, ai është thjesht kalimtar. Kur ti ke ngrënë, ke pirë, ke puthur, dhe prapë ke ngrënë, ke pirë, ke puthur, nuk mund të shkosh larg. Më në fund pra më erdhi në majë të hundës. U kujtova për shpirtin tim, i hipa një karroce dhe u nisa për në një manastir në Malin Athos. Ndenja atje tre muaj; lutja, agjërimi, shërbesa e mëngjesit, mesha, punët e lodhshme, buka e elbit, ullinjtë me erë të rëndë, fasulet... U mërzita; dërgova të vinte karrocieri të më merrte. Po çfarë mund të bëja tashmë në botë? Ajo nuk mund të më ofronte më asnjë gëzim, asnjë mëkat të cilin nuk e kisha shijuar. U ktheva në manastir por porosita karrocierin që të mos largohej por të qëndronte në fshatin më të afërt, të ishte gati nëse do të kisha nevojë për të.

Dhe nuk vonova të kisha prapë nevojë për të, u largova sërish nga manastiri.

Jeta më ishte bërë e padurueshme; sillesha vërdallë pa asnjë lidhje, mes qiellit dhe tokës, i dëbuar nga qielli e nga toka.

Shkova të takoja një asket të vjetër, që jetonte larg nga manastiret në një guvë thikë mbi det. U rrëfeva tek ai.

- Çfarë të bëj, o at i shenjtë? - Më jep një këshillë. - Asketi i vjetër vuri dorën mbi kokë: - Ki durim, biri im, - tha, - mos u nxito; nxitimi është një kurth i të keqit. Prit qetësisht, me besim. - Deri kur? - Derisa shpëtimi të ketë vdekur brenda teje; jepi zogut kohën që të ndërtojë folenë e tij. - Dhe si ta kuptoj që zogu e ndërroi folenë. - Një mëngjes të bukur ti do të zgjohesh dhe bota do të ketë ndryshuar. Por nuk do të jetë bota biri im, je ti që do të kesh ndryshuar, shpëtimi do të ketë vdekur. Jepiu Zotit dhe nuk ke për ta tradhëtuar kurrë.

Dhe ja, një mëngjes hapa dritaren, dita po agonte; ylli i mëngjesit ndriçonte akoma në qiell, deti ishte i qetë dhe dallgëzonte ngadalë e butësisht në breg. Përpara dritares time, një pemë mushmolle, kishte lulëzuar në zemër të dimrit; era e saj ishte e ëmbël si mjalti: kishte rënë shi gjatë gjithë natës, gjethet pikonin akoma dhe gjithë bota shkëlqente e gëzuar.

- Zoti im, - mërmërita. - Ç'është kjo mrekulli?

Atëherë e kuptova: shpëtimi kishte ardhur. Atëherë erdha këtu në shkretëtirë, në këtë qelë, me këtë krevat të varfër, me shtëmbën

me ujë, me këto dy stola dhe u struka. Dhe pres. Çfarë? Zoti më falte, por nuk e di mirë se çfarë. Por nuk shqetësohem, nuk ka rëndësi se çfarë do të vij, unë do ta mirëpres. Besoj se çfarëdo që të ndodhë, unë do të dal fitimtar. Në qoftë se ekziston një jetë tjetër, unë pata kohë që të pendohem në çastin e fundit. A nuk ka dhënë fjalën Krishti që në rast se pendohemi qoftë dhe një sekondë para se të vdesim, atëherë jemi të shpëtuar. Nga ana tjetër në rast se nuk ekziston jeta tjetër, të paktën kam shijuar këtë; e shtrydha dhe e hodha pas krahëve si lëkurë limoni... E kuptove? Për çfarë po mendon?

- Po pyes veten, - iu përgjigja, - përse më solle sonte në kamaren tënde? Sigurisht doje të më thoshe diçka tjetër.

Ai anoi shtëmbën, mbushi një gotë ujë dhe piu një gllënjkë; gryka duhet t'i ishte tharë sepse ishte çmësuar kaq vjet pa folur.

- Sigurisht që doja të të thosha diçka tjetër, por duhej që në fillim ti të dije se çfarë kam qenë, për të kuptuar atë që dua të them. Që ta dish, unë kam të drejtë të ta them.

Heshti, pastaj zuri të fliste duke i peshuar fjalët.

- Dhe detyra! - shtoi, zërin e kishte të emocionuar. Ngrita sytë dhe e vështrova; ai vazhdonte të qëndronte në këmbë, i ngrirë si kolonë në mes të kamares. Unë e shikoja dhe admiroja se me sa gëzim dhe turp e kishte shijuar jetën, me sa guxim ishte rebeluar kundër Zotit, megjithëse tani kishte hyrë në shkretëtirë, ai nuk e pranonte harresën, linte me burrëri që karvani i mëkateve ta ndiqte dhe të ecte në krah të tij, me besim drejt Zotit.

Ai heshtte; dukej sikur përpiqej të nxirrte në dritë atë që donte të thoshte, duke gjetur mënyrën që të mos më lëndonte; ai më shikonte që unë lëvizja mbi stol i nervozuar;

- Duhet të dish, - tha ai më në fund, - që një prej gëzimeve të tokës - Dhe ajo zotëron shumë, mallkuar qoftë! - që unë e respektoj në kulm, është rinia. Kur shikoj një të ri në rrezik, më duket sikur jeta, sikur pararoja e Zotit është në rrezik, dhe vrapoj ta ndihmoj me sa mundem rininë që ajo të mos humbasë, - dua të them të mos gabohet, që lulet e saj të mos fishken, që të mos plaket para kohe. Pikërisht për këtë të thirra sonte në kamaren time.

U drodha. - Çfarë? Jam në rrezik? - i thashë pa e ditur nëse duhet të qeshja apo të mërzitesha.

Plaku tundi lehtë dorën për të më qetësuar.

- Mërzitu, qesh, shkarkoje zemrën, por hapi veshët mirë, unë që të flas jam djegur një herë, prandaj duhet të më dëgjosh. Ka shtatë ditë që të shoh të rrotullohesh rreth flakës së Zotit, si një flutur nate. Nuk dua të lë që të digjesh, jo ty, e përsëris, jo ty, por rininë. Më vjen keq për faqet e tua që janë akoma me push, për buzët e tua që nuk kanë puthur e nuk kanë thënë blasfemi, për shpirtin tënd të pastër, i cili kudo që shikon një rreze drite vrapon e digjet. Po nuk do të lë ta bësh: ti je në buzë të greminës, dhe unë nuk të lë të biesh.

- Të kujt gremine?

- Të Zotit!

Mezi e shqiptoi atë fjalë të tmerrshme dhe kamarja kërciti, diçka e padukshme kishte hyrë. Asnjëherë ajo fjalë, që e shqiptoja aq shpesh dhe në mënyrë aq profane, nuk kishte shkaktuar tek unë aq frikë. Ndieja se rijetoja brenda meje, tmerrin që provoja në fëmijëri kur dëgjoja që shqiptohej, sikur dilte nga një shpellë e zhurmshme dhe e errët, fjalën "Jehova". Ishte e njëjta frikë që ndjeja që prej fëmijërisë nga fjala "masakër".

U ngrita nga stoli dhe shkova e u mblodha kruspull në një qoshe.

- O Plak, - mërmërita, mos ndalo, të dëgjoj.

- Një preokupim i madh gjendet në shpirtin tënd dhe të bren; e shikoj në sytë e tu që digjen, në qepallat e tua që lëvizin parreshtur, në duart e tua që prekin zbrazëtinë, sikur ti të ishe i verbër, ose sikur ajri të ishte një trup që ti e prek. Ky preokupim mund të të çojë ose në marrëzi ose në përsosmëri.

Ndjeja vështrimin e tij që hynte brenda meje e kërkonte në thellësi.

- Çfarë preokupimi? Nuk e di për çfarë preokupimi flet.

- Preokupimi i shenjtërisë. Mos u frikëso: ti as vetë nuk di si ta shohësh. Po ta them që të dish se çfarë rruge ke marrë, drejt kujt po shkon, që të mos gabohesh. Ti u nise për ngjitjen më të vështirë, por u nxitove të mbërrije në majë, para se të kaloje këmbën e malit, sikur të ishe shqiponjë me krahë. Por ti je njeri, mos e harro, njeri, as më shumë e as më pak, ti ke këmbë e jo krahë. Po, unë e di, dëshira më e madhe e njeriut është që të bëhet shenjtor. Mirëpo më parë duhet të kalojë përmes dëshirave më të ulta - dëshira e mishit, dhe pastaj t'i neveritet, etja për pushtet, për para, për luftë. Dua të them që njeriu duhet ta jetojë deri në fund rininë dhe të gjitha pasionet, të hapë barkun e të gjithë idhujve dhe të shikojë se si janë të mbushur me kashtë dhe erë, të zbrazet, të pastrohet, të mos tundohet që të shohë prapa dhe vetëm atëherë të paraqitet para Zotit. Pikërisht kështu duhet të jetë një luftëtar.

- Unë nuk mundem ta pushoj luftën kundër Zotit - iu përgjigja, - edhe në momentin e fundit kur të gjendem përpara tij, do të luftoj. Besoj se ky është fati im. Jo që të arrij, nuk do të arrija kurrë, por që të luftoj.

Ai u afrua nga unë, më goditi lehtë në shpatull:

- Mos pusho asnjëherë së luftuari kundër Zotit: nuk ka ushtrim më të mirë. Por nuk besoj se për të luftuar më i sigurtë, duhet të shkulësh rrënjët më të errëta që janë brenda teje, instinktet. Ti sheh një grua dhe frikësohesh; thua: është tundim, spraps Satanain! Po, ajo është tundim, por në qoftë se do ta mundësh, nuk ka veçse një mënyrë; duhet ta marrësh mes krahëve, ta prekësh derisa të të vështiret, dhe ajo nuk do të jetë më tundim për ty. Përndryshe, dhe sikur të jetosh njëqind vjet, në qoftë se nuk i ke shijuar gratë, ato do të të shfaqen në gjumë dhe do të ndotin ëndërrat dhe shpirtin. E them dhe e përsëris: ai që shkul instinktin, shkul forcën e tij: sepse me kalimin e kohës, me ngopjen, me ushtrimet, ky material i errët kthehet në shpirt.

Hodhi një shikim rreth vetes, shkoi te dritarja, sikur të kishte frikë mos e dëgjonin. U afrua dhe uli zërin:

- Po të flas meqë jemi vetëm e nuk na dëgjon njeri.

- Na dëgjon Zoti - i thashë.

- Nuk kam frikë nga Zoti, ai e kupton dhe fal; nga njerëzit frikësohem; ata nuk kuptojnë e nuk falin. Nuk dua në asnjë mënyrë që të humbas qetësinë që kam fituar këtu në shkretëtirë. Më dëgjo dhe ruaje në shpirt këtë që do të them: jam i sigurtë se do të të bëjë mirë. Heshti një çast, mbylli sytë përgjysmë, më pa mes qepallave sikur të më peshonte:

- A mund ta durosh - mërmëriti.

- Mundem, mundem, - iu përgjigja me padurim, - fol lirisht o plak.

Ai e uli akoma më shumë zërin.

- Ëngjëlli nuk është gjë tjetër, më dëgjon? Nuk është gjë tjetër veçse një demon i përpunuar. Do të vijë dita, oh! Sikur të arrija ta shihja, kur njerëzit do ta kuptojnë dhe atëherë...

U përkul te veshi im; për herë të parë iu drodh zëri.

- Atëherë besimi i krishterë do të bëjë një hap përpara mbi tokë. ai do ta përfshijë njeriun të tërin, të tërin dhe jo si tani që përfshin vetëm shpirtin.

Mëshira e Zotit do të shpaloset, ajo do të përqafojë dhe shenjtëro- jë shpirtin dhe trupin; ajo do të vijë dhe do të shpallë se trupi dhe shpirti nuk janë armiq por bashkëpunëtorë. Pra, çfarë po ndodh? Ne i shitemi djallit dhe ai na shtyn të mohojmë shpirtin tonë; i shi- temi Zotit dhe ai na shtyn të mohojmë trupin. Kur pra, zemra e Krishtit, do të shpaloset më shumë e do të ketë mëshirë jo vetëm për shpirtin por edhe për trupin, dhe do t'i pajtojë këto dy bisha?

Isha thellësisht i prekur.

- Të falenderoj o plak për dhuratën e çmuar që po më bën - i thashë.

- Deri në këtë moment unë kam kërkuar një të ri që t'i hapja ze- mrën para se të vdisja dhe tani falënderoj Zotin që ti erdhe; merre, është frut i të gjitha përpjekjeve të mia të shpirtit e të trupit.

- Ti po vë në duart e mia, flakën e gjithë jetës tënde. A do të mu- nd ta çoj më larg? A do të mund ta kthej në dritë?

- Nuk duhet të pyesësh veten nëse mundësh apo jo; nuk është kjo më e rëndësishme; gjëja e vetme që ka rëndësi është të luftosh e ta çosh më përpara. E vetmja gjë të cilën ka parasysh Zoti, është sulmi; nëse do të jemi ngadhënjimtarë, kjo është punë e tij dhe jo e jona.

Ndenjëm disa çaste në qetësi; përpara baxhës së vogël të kamares, kalonte nata e shkretëtirës me zhurmat e panumërta shqe- tësuese; së largu, dëgjoheshin ulërimat e çakejve, të munduar dhe ata nga dëshira dhe uria.

- Është shkretëtira, - mërmëriti plaku, - janë zogjtë e natës, çakej- të, akoma më larg luanët dhe në manastir murgjit që flenë dhe ëndë- rrojnë. Në lartësi, në qiell janë yjet dhe gjithkund gjendet Zoti.

Më zgjati dorën. - Kjo ishte gjithçka që kisha për të të thënë, bi- ri im - më tha.

U ktheva në kamaren time. Ecja ime ishte e lehtë, shpirti i kulluar, zemra më rrihte qetësisht. Fjalët e At Johakimit ishin një gotë me ujë dhe unë kisha etje. Freskia e tyre shpërndahej deri në palcën e kockave të mia. Mblodha plaçkat, bëra një pako, e hodha në shpinë

dhe hapa portën. Ishte pothuajse agim sepse qielli ishte ngjyrë qum- shti dhe yjet e vegjël kishin nisur të shuheshin; poshtë në grykë një thellëzë kishte nisur të kakariste.

Mora frymë thellë në atë agim të shenjtë. Bëra kryqin; Në emër të qiellit! - mërmërita.

U futa në korridor, në kamaren e plakut, drita ishte akoma nde- zur. Trokita. Dëgjova këmbët e zbathura që shkelnin mbi pllakëza. Dera u hap. Ai më pa; vuri re pakon në shpinën time dhe buzëqeshi.

- Po iki o plak, - i thashë dhe u përkula për t'i puthur dorën; - Më jep bekimin.

Ai vuri dorën mbi flokët e mi.

- Ke bekimin tim - tha. Shko! Zoti qoftë me ty!

KTHIMI NË KRETË

Isha i lodhur. Isha i ri dhe panginjësia e rinisë është e tmerrshme. Ajo nuk pranon kufizime te njeriu, ajo do shumë dhe nuk kënaqet me pak. Kisha luftuar për t'ia dalë mbanë por isha lodhur së luftuari. U ktheva në tokën e prindërve të mi, për t'u gjendur përballë me malet tona, për të riparë udhëheqësit e vjetër të luftës me kësulat e mëdha të varura mbi veshë, me buzëqeshjet e tyre, për të dëgjuar akoma të flitej për lirinë dhe luftrat, për të rimarë forcë duke vendosur këmbët mbi tokën e nënës.

- Prej nga vjen? - më pyeti babai. - Prej shumë larg - iu përgjigja, duke mos i thënë asnjë fjalë për aventurën time në Malin Sinai ku doja të bëhesha murg. Ishte e dyta herë që dështoja në tentativën për t'u shenjtëruar; Hera e parë që më kujtohet, ishte gjatë fëmijërisë time, kur zbrita në port duke vrapuar e gjeta një anije që po ngrinte spirancën. Iu luta të zotit të anijes që të më çonte në Malin Athos për t'u bërë murg. Pronari i anijes u shkul së qeshuri: "Në shtëpi! Në shtëpi!" - më bërtiti dhe përplasi duart sikur po trembte një zog. Dhe tani përsëri...

"Kthehu në botë," - më kishte thënë At Joakimi; "ai është sot manastiri i vërtetë; aty do të shenjtërohesh."

U ktheva në tokën e prindërve të mi për të rimarë vrull. Përshkova fshatrat, hëngra, piva me barinjtë, bujqit, dhe më vinte turp tek shikoja sesi luftonte e gjithë Kreta, sa kundër përmbytjeve dhe thatësirës, aq edhe kundër varfërisë, sëmundjeve dhe turqve, në kundërshtim me jetën e plogët e hipokrite të manastirit. Kurse unë, doja ta kundërshtoja vullnetin e saj, ta tradhëtoja e të bëhesha murg! At Joakimi kishte të drejtë, manastir është bota jonë dhe murg i vërtetë është ai që jeton me njerëzit dhe bashkëpunon me Zotin dhe tokën. Zoti nuk është ulur në një fron përmbi ne; ai lufton mbi tokë së bashku me ne. Nuk është vetmia, rruga e njeriut që lufton, as lutja e vërtetë që shkon drejt dhe hyn në shtëpinë e Zotit, është veprim

bujar; kështu lutet sot një luftëtar i vërtetë.

Një kretan më ka thënë: - Kur të shkosh përpara portës së parasjës, në qoftë se ajo nuk hapet, mos trokit; hiqe pushkën nga supi dhe godit një herë. - Ti mendon - i thashë, se Zoti do të frikësohet dhe do të vijë ta hapë? - Po jo, mor djalë, ai nuk do të frikësohet, por do të hapi portën, sepse do ta kuptojë që vjen nga lufta.

Kurrë nuk kam dëgjuar nga goja e një njeriu, fjalë aq të thella si ato që thonë fshatarët, pleqtë që kanë mbaruar së luftuari, të cilëve iu janë shuar pasionet, dhe tashmë qëndrojnë në këmbë në prag të vdekjes dhe hedhin pas tyre një shikim të fundit, të fikur, me dhembshuri.

Një ditë, në mesditë, mbi një mal, takova një plak, të thatë, të dobët, i cili i kishte flokët krejt të bardhë, me rroba të arnuara, çizme të shpuara; sipas zakoneve të barinjve kretianë ai e kishte kaluar shkopin pas shpatullave; hidhej ngadalë nga guri në gur, ndalonte në çdo çast dhe shikonte malet përreth, fushën, ndërsa nga një hapësirë midis shkëmbenjve shikonte një fashë deti.

- Mirëdita gjysh! - i thirra prej së largu; - Çfarë vjen të bësh këtu i vetëm?

- Po them mirupafshim, mor bir, po them mirupafshim.

- Kujt po i thua mirupafshim në shkretëtirë? Unë nuk shoh askënd.

Plaku u zemërua, dhe tundi kokën me nervozitet.

- Çfarë shkretëtire? Nuk i shikon malet? Nuk e shikon detin? Përse na i ka dhënë Zoti sytë? Nuk i dëgjon zogjtë mbi kokën tënde? Këta janë miqtë e mi: unë u flas dhe ata më flasin, unë u thërras dhe ata më përgjigjen; kam qenë bari dhe ata më kanë shoqëruar për dy breza. Erdhi momenti të ndahemi. Mbrëmja po bie...

Mendova se i ishin errësuar sytë për shkak të pleqërisë.

- Po është akoma mesditë gjysh, nuk është mbrëmje.

Ai tundi kokën: - Unë e di çfarë them. Mbrëmja ka rënë, mirë e thashë, mbrëmja ka rënë. Lamtumirë!

- Po ti gjysh, do të jesh më i fortë se vdekja, - i thashë për ta inkurajuar, - ti do ta mundësh...

Ai nisi të qeshë.

- Sigurisht, mos u shqetëso - u përgjigj. - Unë jam tashmë më i fortë se ajo, sepse nuk e besoj. Lamtumirë, qofsh dhe ti më i fortë se ajo. Uratat e mia të shoqërofshin.

Nuk mund ta lija të ikte.

- Më thuaj emrin tënd o gjysh, që të të kujtoj.

- Ja, përkulu, merr një gur dhe pyete. Ai do të të thotë është pla-
ku Manuso Kavroshori. Kështu do të përgjigjet, shko tani. Më fal
po nxitoj. Ti më kupton. Shko dhe Zoti të bekoftë.

Në fakt, vdekjen nuk mund ta mundim por frikën po. Ky malësor
plak e përballonte vdekjen me qetësi; malet i kishin forcuar shpirtin;
ai nuk pranonte të përulej përpara saj. Nuk i kërkonte veçse pak
kohë, disa ditë, sa për të përshëndetur shokët e tij të vjetër - ajrin e
pastër, zogjtë, gurët.

Më poshtë në fushën pjellore të Mesaras, pranë Phaetos, një di-
të pashë të kalonte andej një plak njëqind vjeçar, i ulur në prag të
shtëpizës së tij, duke u ngrohur në diell; sytë i kishte si dy plagë të
kuqe, hundët i rridhnin, pështyma i lagte buzët; vinte erë duhan
dhe urinë. Kur hyra në fshat, njëri prej nipërve të tij më kishte folur
për gjyshin duke qarë. Ai është bërë si fëmijë - më thoshte. Shko
shikoje. Me sa duket, ai rrinte çdo mbrëmje pranë burimit të fshatit
dhe priste që vajzat të mbushnin shtambat me ujë. Dëgjonte nallanet
e tyre, dhe zgjaste kokën. Ishte gjysmë i verbër dhe nuk mund t'i
shikonte mirë.

- Hej ti, kush je? - thërriste. Eja bija ime, paç bekimin tim. Afrohu
të të shoh.

Vajza qeshte dhe i afrohej; plaku vinte duart mbi fytyrën e vajzës,
e përkëdhelte si i babëzitur, sikur të donte ta përpinte, prekte i pango-
pur hundën, gojën, mjekrën, duke dashur të zbriste tek qafa por
vajza lëshonte një klithmë dhe nuk e linte të vazhdonte më dhe lar-
gohej duke u shkulur gazit. Plaku qëndronte me gojën hapur dhe
psherëtinte.

- Duhet ta dëgjosh - më thoshte i nipi. - Duhet ta dëgjosh se si
psherëtin, si buall.

Një ditë e pyeta: - Po pse psherëtin mor gjysh? Çfarë ke?

- E ç'të kem, - më tha dhe lotët nisën ti rridhnin. - Pse s'ke sy të
shohësh? Unë do të futem në tokë dhe do të lë pas vajza kaq të bu-
kura... Sikur të isha mbret, do t'i kisha vrarë e do t'i kisha marrë
me vete!

Shpesh, bëhej melankonik dhe ia niste një melodie, që e këndonte
gjithmonë:

Sa keq, koha po kalon, sa keq, koha po kalon
Sa keq që nuk kthehet të paktën hija e një dite të vetme.

Dëgjoja nipin që më fliste, dhe nxitoja të shkoja të admiroja li-
sin njëqindvjeçar. Ma treguan kasollen e tij dhe e pashë ulur në di-
ell duke u ngrohur. Iu afrova:

- Hej gjysh - i thash. Më kanë thënë që je njëqind vjeç. Më thuaj
si të është dukur jeta në këto njëqind vjet?

Ai ngriti sytë e tij të vegjël pa qerpikë:

- Si një gotë uji i freskët - mor bir.

- Dhe ke akoma etje gjysh?

Ai ngriti dorën nga qielli sikur po mallkonte:

- Në djall vaft ai që pushon së pasuri etje! - tha.

Qëndrova tri ditë në një manastir duke eleminuar detin e Libues.
Gjithmonë e kam dashur jetën anakronike të manastirit, ritmin antik
që rregullon gjithçka, murgjit me sytë e tyre tinëzarë ose të përgju-
mur, ca barkalecë e ca të tjerë me barkun bosh, duart e tyre të më-
dha që ndonjëherë mbanin gërshërë ose bel dhe ndonjëherë kupën
e shenjtë ose librin e lutjeve. Më pëlqente aroma e temjanit, vokalicat
në agim në kishë, dhe pastaj tek shihja të gjithë murgjit që sëbashku
drejtoheshin drejt grazhdit që shërbente si mensë dhe vinte era thar-
tirë e vaj. Në mbrëmje bisedat me zë të ulët mbi tarracën e manas-
tirit, dhe heshtjet e rënda të mbushura me oshëtimat e botës së lar-
gët. Ne flisnim rrallë për Krishtin; ai ishte si një mësues i rreptë por
që mungonte, ai ishte ngjitur në qiell dhe kishte lënë shërbëtorët e
tij, vetëm, në kështjellë; të cilët hapnin në mënyrë të paturpshme
qilarët, zbrisnin nëpër bodrume, shtriheshin mbi krevatet e butë;
macja kishte ikur, minjtë kërcenin. Ah! Sikur ai të shfaqej në prag,
si do të përmbyseshin tryezat, çfarë ulërimash do të lëshonin preten-
dentët për priftërinj, dhe si do të fshikullonte harku i Zotit. Një ditë
kur isha ulur mbi tarracën e manastirit me një murg, e çova bisedën
mbi shenjtorin që dua shumë, shën Frankis Asia. Ishte hera e parë
që murgu dëgjonte emrin e tij. Ishte një shenjt katolik, heretik dhe
murgu u ngrys; por kurioziteti doli sipër tij.

- E po fol, ne do të dëgjojmë - tha.

Kryqëzoi duart mbi bark, gati për të dënuar gjithçka që do t'i thosha.

Unë nisa të flisja.

- Ky shenjtor, i thoshte Zotit në lutje: O Zot, si mund ta gëzoj Parajsën, kur unë e di që ekziston Ferri? Zot, ose ki mëshirë për të dënuarit dhe lëri të hyjnë dhe ata në Parajsë, ose më lër mua të zbres në Ferr që t'i ngushëlloj. Unë do të krijoja një rregull sipas të cilit në fillim duhet të zbresin në Ferr ata që do të ngushëllojnë të dënuarit; dhe nëse nuk arrijnë t'u lehtësojnë vuajtjet, do të qëndrojnë në Ferr për të vuajtur me ta.

Murgu shpërtheu me të qeshura:

- E kam unë radhën të të tregoj një histori, - tha. Një ditë një pasha ftoi një të varfër që të hante në shtëpinë e tij. Vuri përpara tij një pjatë më ullinj dhe një pjatë me havjar të zi; i varfri nuk i hodhi syte fare nga ullinjtë dhe u hodh mbi kaviarin me kokën ulur. - Ha dhe ullinj - i tha pashai. - Haviari nuk është i keq, pasha efendi - u përgjigj tjetri. - E kuptove? Parajsa është haviari i zi. Më duket se miku yt qënka idiot, më fal.

Ditën kur do të ikja, shkova që pa gdhirë në meshën e mëngjesit, digjesha nga dëshira për të dëgjuar vokalicat monotone e melodioze që murgjit i drejtonin Zotit, fjalët e pasionuara plot pendesë, që besimtarët e vjetër kishin gjetur për të përshëndetur Zotin në mëngjes, para lindjes së diellit: *"Zot o Zot, unë vij në mëngjes përpara teje. Shpirti im ka etje për ty, trupi im mbi këtë tokë të shkretë, është pa jetë...*

Qëndrova në këmbë në një garazh, pranë dritares ku shihja detin e Libisë, që zbardhonte nën mjegullën e mëngjesit, i pafund, i shkretë, që shtrihej deri në rërat e nxehta të Afrikës.

Zogjtë që edhe ata ishin zgjuar me murgjit, kishin nisur të bënin vokalica dhe të përshëndesnin dritën, maja e qiparizit në mes të oborrit ishte ndriçuar tashmë dhe gjethet e portokallit pranë saj ishin zhytur në një ngjyrë të gjelbër të errët. Kambanari, kishte zgjuar në çdo kamare, gjithë murgjit dhe tani duke hyrë në kishën gjysmë të errët, po varte kësulën dhe vendoste në cep të portës flugën prej druri.

Qëndronte në këmbë te pragu. Drita që i binte i ndriçonte mjek-

ën e dredhur, të zezë dhe flokët kaçurrela përmbi supe. Trupmadh, me një pamje serioze, ai ishte në kulmin e rinisë. Sa keq që një trup i tillë nuk ishte bashkuar me një grua për të patur fëmijë. Vajzat dhe djemtë e tij do të kishin zbukuruar botën.

E ndërkohë që ëndërroja për atë ku humbiste bota por edhe Zoti, një grua e druajtur, u shfaq te porta, me kokën të mbështjellë me një shall të zi që mbante në krahë një bebe. Një natë më parë, igumeni më kishte thënë me një buzëqeshje dinake që të mos skandalizohesha kur të shihja të nesërmen që të vinte nga një fshat aty afër, një grua të re e të martuar, që do të kërkonte t'i thuhej një lutje për fëmijën e saj të vogël për të mos e ngrënë me sy; sepse mesa duket ai është shumë i bukur.

Ajo kishte ndalur pranë portës, me kokën ulur, duke pritur që të mbaronte mesha dhe igumeni të afrohej me spërkatoren e ujit të bekuar. Ajri sikur u transformua, era e fortë e murgjëve u përzie me frymën e gruas, kisha vinte era qumësht dhe vaj dafine nga flokët e sapo larë të gruas së re.

Zëri i përgjumur i igumenit mori jetë dhe në atë çast nisi të psaltte: *"Është Zoti, ai që u shfaq tek ne, qoftë bekuar ai që vjen në emër të Zotit..."*

Murgjit mbi stolat ndërruan pozicion, u kthyen, panë me cep të syrit nga porta dhe dy-tre prej tyre zunë të kolliteshin. Kambanari iu afrua gruas, i foli në vesh dhe ajo pa e ngritur kokën bëri dy hapa dhe shkoi e u ul në stolin e fundit pranë portës. Dukej se shpirtrat e kishin humbur qetësinë dhe tashmë të gjithë murgjit dhe unë bashkë me ta, mezi prisnim të mbaronte mesha.

Doli dielli, oborri u mbush me dritë, rrezet e pjerrëta hynë në kishë dhe ndriçuan ikonat, fytyrat dhe duart e murgjëve. Zoti qoftë lëvduar, pëshpëritën të gjithë; mesha kishte mbaruar. Igumeni la petrahilin dhe mori spërkatoren: pas tij kambanari mbante kovën me ujë të bekuar.

Gruaja qëndroi te shkallëza e portës, ndriçonte e tëra: kishte hequr shallin e zi dhe gjithë fytyra i qe zbuluar. Ajo ngriti sytë dhe vështroi igumenin që kishte nisur të thoshte lutjen, duke mbajtur dorën mbi kokën e fëmijës; pastaj i nguli sytë e saj të mëdhenj, të zinj e të trishtuar, mbi kambanoren; ata sy kishin një ëmbëlsi të pashpjegueshme, që më kujtonin sytë e virgjëreshës Portoritista në manastirin

e Ivronit; e njëjta ëmbëlsi, i njëjti ankth si ai i nënës për fëmijën.

Papritur bebja nisi të lëviste këmbët dhe të qante; e ëma për ta qetësuar zbërtheu jelekun, nxori gjirin, vogëlushi e kapi me babëzi dhe pushoi. Asnjëherë ky çast nuk do të shkulet prej shpirtit tim: gjiri i rrumbullaktë, i bardhë si borë, i gruas së re shkëlqente; në ajër u ndie akoma më shumë aroma e qumështit dhe një erë shpuese djerse. Pas shpinës së gruas, dëgjohej deti i Libisë që atë çast qe kre dhur në një blu të ashpër. Një çast igumeni nisi të dërdëlliste, por me të shpejtë, Zoti e solli në vete dhe ai mbaroi lutjen pa u turpëruar. Në oborr iu afrova kambanarit; Ngasësi më shtynte t'i flisja por nuk dija çfarë t'i thosha...

- At Nikodeme... - nisa; por ai nxitoi dhe u fut në kamare. Një orë më vonë, në këmbë, ashtu si më pëlqente, u nisa për udhë. Sa vjet kaluan? Dyzet? Pesëdhjetë? Manastiri u fshi nga shpirti im dhe në vendin e tij shkëlqente i vetëm, i bardhë, i rrumbullaktë, i pavdekshëm, përmbi detin e Libisë, gjiri i nënës. Të nesërmen nata më zuri jo larg nga fshati; kisha uri, isha lodhur duke shëtitur gjithë ditën nëpër shkëmbinjtë e thepisur; nuk njihja askënd prej atij vendi, madje nuk i dija as emrin. Por isha i qetë; e dija se në çdo portë që të trokasësh në një fshat të Kretës, do ta hapin, do të shtrojnë tryezën dhe do të shërbejnë, do të të vënë për të fjetur në çarçafët më të mirë të shtëpisë. I huaji në Kretë është akoma si Zoti i panjohur; përpara tij hapen të gjitha portat dhe zemrat.

Kisha hyrë në fshat; nata kishte rënë, portat ishin mbyllur, qentë nëpër oborre kishin ndier të huajin dhe nisën të lehin. Ku të shkoja? Në çfarë porte të trokisja? Atje ku strehoheshin të gjithë të huajt, në shtëpinë e priftit. Priftërinjtë në fshatrat tona nuk janë shumë të ditur, janë pak të shkolluar dhe nuk mund të përballojnë diskutimet mbi dogmat e kristianizmit; por Krishti jeton në zemrat e tyre, dhe nganjëherë ata e shohin me sytë e tyre sa mbi jastëkun e një të plagosuri të luftës, aq dhe në pranverë i ulur mbi një bajame të lulëzuar.

U hap një portë, u shfaq një plakë trupvogël me një llambë në duar, për të parë se kush ishte ky i huaj që vinte në një orë të tillë në fshat. Ndalova.

- Jetë të gjatë, - i thashë, duke ëmbëlsuar zërin që të mos e trembja. Jam i huaj dhe nuk kam se ku fle. Jini kaq i sjellshëm sa të më tregoni se ku është shtëpia e priftit.

- Me kënaqësi mor bir. Po të sjell një llambë që të mos pengohesh. Zoti qoftë bekuar, u ka dhënë cave tokën, të tjerëve gurët; ne kemi gurët. Shiko përtokë ku ecën dhe më ndiq mua. Ajo u nis përpara me llambë në dorë, u kthyem në një cep rruge dhe arritëm përpara një porte të shtrembër. Atje ishte varur një fener.

- Jà shtëpia e priftit - tha plaka.

Ngriti llampën dhe më hodhi dritën mbi fytyrë.

Papritur psherëtiu, donte të më thoshte diçka por ndërroi mendje.

- Faleminderit, - i thashë - dhe më fal. Natën e mirë.

Ajo më vështroi dhe nuk u largua.

- Në qoftë se dëshiron, eja të qëndrosh në shtëpinë time të varfër.

Por tashmë i kisha rënë portës së priftit. Dëgjova hapa të rëndë në oborr, porta u hap dhe pashë të shfaqej një plak, me flokë të lëshuara mbi supe dhe me mjekër të zbardhur. Pa më pyetur se kush isha dhe çfarë doja, ai më zgjati dorën.

- Mirë se vjen - tha. - I huaj je? Hyr.

Hyra brenda. Dëgjova zëra, porta që hapeshin, disa gra u dukën në dhomën pranë dhe u zhdukën menjëherë. Prifti më uli mbi një kanape.

- Do ta falni gruan time - më tha, - por ajo është pak e pamundur. Unë do të gatuaj, do të të shtroj për të ngrënë dhe do të përgatis shtratin për të fjetur.

Zëri i tij ishte i trashë dhe i trishtuar. E vështrova; ishte shumë i zbehtë dhe sytë i kishte të enjtur e të skuqur sikur kishte qarë. Nuk mendova se mund të kishte ndodhur ndonjë fatkeqësi, hëngra, fjeta gjumë dhe të nesërmen në mëngjes prifti më solli në një tabaka, bukë, djathë dhe qumësht. I zgjata dorën, e falënderova dhe u ndava prej tij.

- Shko dhe Zoti të bekoftë, biri im, - më tha, - Krishti qoftë me ty. U nisa. Në fillim të fshatit pashë një plak; ai më vuri dorën në shpinë dhe më përshëndeti.

- Ku e kalove natën mor bir? - më pyeti.

- Në shtëpinë e priftit, - iu përgjigja.

Plaku psherëtiu.

- Ah! I shkreti - tha. Dhe nuk vure re asgjë?

- Çfarë duhej të vija re?

- Djali i tij, djali i tij i vetëm vdiq dje në mëngjes; ti nuk i dëgjove

gratë që vajtonin?

- Nuk dëgjova asgjë, asgjë.

- Ai ishte në dhomën e fundit dhe ato duhej të vajtonin me zë të ulët, që ti të mos i dëgjoje dhe të hidhëroheshe. Lamtumirë, udhë të mbarë!

Sytë e mi ishin përlotur.

- Përse qan? - më tha plaku i çuditur. Ti je i ri dhe nuk je mësuar akoma me vdekjen, lamtumirë.

Kreta është e mirë, por vetëm për të dëgjuar vrullin e saj; në krye të disa muajve ajo ishte bërë shumë e ngushtë për mua, rrugët ishin ngushtuar, shtëpia e prindërve ishte zvogëluar, borzilokët dhe karafilat e Indisë në oborr kishin humbur aromën. Shikoja miqtë e mi të vjetër sesi ishin rregulluar dhe më zinte frika. U betova: Kurrë nuk do të mbyllesha mes katër mureve, as brenda një kafeneje; asnjëherë nuk do të pajtohesha me mirëqënien, asnjëherë nuk do të nënshkruaja që jam dakord me të pashmangshmen. Zbrisja në port, shikoja detin, ai ishte për mua porta e lirisë; ah! Sikur ta hapja e të ikja...

Babai më shikonte që shkoja e vija pa folur, pa qeshur, dhe përplaste qerpikët. Një ditë e dëgjova tek i thoshte nënës: - Çfarë lloj njeriu është yt bir? Çfarë e brengos? Ai nuk shikon përpara që të marrë atë që mund të marrë; ai shikon, më larg, atë që nuk mund ta kapë. Qofsha gabim, por djali ynë ngjan me të marrët për të cilët flasin përrallat. Ata nisen nëpër botë nën pretekstin që të gjejnë ujin e jetës.

Ai këtë gjendje nuk mund ta duronte; priste të hapja një zyrë, që të njihja miq të rinj të cilët do të më zgjidhnin deputet, të shkruaja artikuj në gazetën lokale, të shkruaja një broshurë që do të tregonte se vendi po shkonte drejt shkatërrimit dhe njerëz të rinj duhet ta drejtonin.

Një ditë ai nuk u përmbajt më:

- Përse vjen vërdallë pa bërë asgjë? Çfarë pret që të hapësh një zyrë e t'i vihesh punës?

- Nuk jam gati.

- Çfarë të mungon?

Asgjë nuk më mungonte dhe gjithçka më mungonte; guximi

pangopësia e rinisë më brengosnin. Brenda meje punonin, punonakoma asketët e Tebaide-së me etjen e tyre absolute, udhëtarët mëdhenj të cilët duke udhëtuar kishin zmadhuar tokën.

Mora guxim:

- Nuk jam akoma gati, - i përsërita. Universiteti i Athinës nuk mjaftón; duhet të bëj studime shtesë.

- Domethënë?

Po hezitoja. Babai ishte ulur në vendin e tij të zakonshëm mbi kanape, pranë dritares. Ai nuk po mbaronte së dredhuri cigaren dhe nuk po më shihte më. Ishte e diel pasdite, dielli hynte nga dritarja dhe ndriçonte fytyrën e rreptë e të nxirë nga dielli si dhe mustaqet e mëdha të tim eti. Dielli ndriçonte edhe një shenjë që duhej ta kishte nga ndonjë shpatë turku.

- Domethënë? - përsëriti. Ngriti kokën dhe më pa. Do të shkosh më larg?

- Po.

- Ku pra?

M'u duk se i dridhej zëri.

- Në Paris, - iu përgjigja.

Babai ngeli një çast pa folur.

- Mirë, shko, - tha më në fund.

Babai ishte i egër, pa shkollë por kur bëhej fjalë për ngritjen time intelektuale ai nuk refuzonte asgjë; një ditë e dëgjova tek i thoshte njërit prej miqve të tij: - Mund t'i shkatërroj të gjitha rrënjët e hardhive, rrushin e thatë, vajin, të gjithë të vjelat mund t'i bëj bojë dhe letër për tim bir; kam besim!

Ai bënte të gjitha sakrificat, sikur t'i kishte mbështetur tek unë të gjitha shpresat; të më shikonte të shpëtuar, të shpëtohej edhe ai dhe të shikonte të shpëtuar bashkë me mua të gjithë fisin.

Një ditë kur isha fëmijë i kisha thënë babait se doja të mësoja hebraishten për të lexuar Testamentin e Vjetër në origjiinal. Ne kishim atëherë një lagje çifutësh në Megalo Kastro; babai thirri rabinin dhe ranë dakord që të shkoja tri herë në javë në shtëpinë e tij që të më jepte mësime hebraishte.

Kur e morën vesh të afërmit dhe miqtë e mi, iu ngritën qimet e kokës përpjetë dhe vrapuan të takonin babanë.

- Ç'është kjo? - i bërtisnin; - Nuk të vjen keq për djalin? Apo

nuk e di, që të Premten e Shenjtë vrasësit e Krishtit i vënë kretanwt e vegjël në një koritë të mbushur me gozhdë dhe u pijnë gjakun?

Babai, i lodhur nga thirrjet e tyre dhe të qarat e nënës, tha: - Kjo po na sjell shumë telashe; lëre fare hebraishten, do ta mësosh kur të rritesh. Kur i thashë se doja të mësoja një gjuhë të huaj, ai nuk ngurroi.

- Dakord - më tha, - mësoje, por me një kusht; do të veshësh një fanellë tjetër. Isha i dobët dhe ai kishte merak për mua. Kështu pra, kur isha ende në Kretë, mësova tri gjuhë të huaja dhe isha i detyruar të vishja dhe tre fanella; kur u nisa për në Athinë për të studiuar, i zhvesha.

- Mirë, ik, - më tha babai.

Nuk arrita ta mbaja gëzimin; u përkula për t'i puthur dorën por ai e tërhoqi shpejt:

- Unë nuk jam prift, - më tha:

Të nesërmen i putha dorën nënës, ajo u përkul, më dha bekimin dhe më porositi në emër të qiellit që të mos bëhesha katolik. Më vuri në qafë një hajmali prej drurit të kryqit të vërtetë që e mbante vetë.

E kishte mbajtur babai në luftë dhe plumbat nuk e kishin kapur. Im atë më shoqëroi deri në port; më shikonte vëngër, me merak dhe kureshtje. Ai nuk arrinte të kuptonte se çfarë isha, çfarë dëshiroja, pse lëkundesha sa majtas djathtas, pa mundur të gjeja ekuilibrin në Kretë.

- Mua më duket se ti i gjan gjyshit tënd, - më tha papritur kur arritëm në port; jo babait të nënës por babait tim, piratit. Heshti një çast, pastaj tha:

- Por ai sulmonte anije, vriste, plaçkiste, mblidhte plaçka. Ndërsa ti? Çfarë mbledh?

Mbërritëm në port dhe ai më shtrëngoi dorën: - Shko, rrugë të mbarë dhe hap sytë! - Dhe tundi kokën i pakënaqur fare nga djali i tij i vetëm.

Vërtetë: Po shkoja, por çfarë do të mblidhja?

PARIS: NIÇE, DËSHMORI I MADH

Po agonte dhe binte një shi i hollë. Me fytyrën ngjeshur pas xhamit të karrocës, unë dalloja pas perdes transparente të shiut, Parisin që lëvizte, që buzëqeshte mes lotëve dhe më priste mua. Shikoja tek kalonin urat, shtëpitë shumëkatëshe të njollosura, parqet, kishat, gështenjat e zhveshura nga gjethet, njerëzit që ecnin nxitimthi në rrugët e gjera e të ndritshme... Fytyrën e këndshme dhe të gëzuar të Parisit e shikoja përmes fijeve të varura të shiut, e shikoja tek qeshte përmes një drite ngjyrë vjollcë, ashtu siç shihet përmes fijeve të avlëmendit fytyra e punëtores që end.

"Çfarë mund të më presë në këtë qytet të dëshiruar prej kohësh? - mendoja dhe më vinte inat që shpirti njerëzor nuk ishte në gjendje të parashikonte të ardhmen, qoftë edhe një orë më përpara por i duhet të presë, në errësirë dhe i pafuqishëm siç është trupi, për të ndodhur ajo që nuk ka ndodhur ende. A do ta gjeja në këtë qytet të madh atë që po kërkoja? Po çfarë kërkoja? Çfarë doja të gjeja? Nuk më mjaftonte pra prijësi mbi kokën e të cilit qëndronte kurora me gjemba, i ngulur si një sinjal mbi malin e mbrujtur me gjak dhe gurë e që më tregonte rrugën? Apo At Joakimi kishte të drejtë që më nxiste të përshkoja Ferrin dhe Purgatorin e tokës, nëse doja të arrija në Parajsë? Duhej të gëzohesha, të vuaja, të mëkatoja, pastaj ta kapërceja gëzimin, vuajtjen dhe mëkatin, nëse doja të shpëtoja?"

Drita ishte pak më e fortë, një diell i ndritshëm u duk në qiellin e huaj, i cili ishte mbushur me melankoli, me mjegull dhe me një dashuri të pashpjegueshme.

Sa i zhveshur dukej këtu në tokën e mërgimit, Paetoni i Greqisë me flokajën e gjatë. Atje në atdheun e tij, ai zhvishej i tëri që të mbulohej sërisht me dritë, dhe shpirti rrezatonte pa asnjë të fshehtë, i dukshëm si trupi; demonët dilnin nga skutat e tyre të errëta, drita i kishte përshkuar deri në palcën e tyre të zezë dhe bëheshin edhe ata të thjeshtë e të pajisur me një zë të butë si njerëzit. Por këtu die-

lli kishte ndryshuar dhe bashkë me të kishte ndryshuar edhe pamja e tokës dhe e shpirtit; duhej të mësoheshe të doje ballin e zhytur në gjysmëhije, buzëqeshjen e tronditur dhe ndjenjën e fshehur të bukurisë.

"Është pamja e re e Zotit, - mendoja duke vështruar i pangopur pemët, shtëpitë, gratë me tualet, kishat e errëta; u përkula dhe e adhurova këtë bukuri!"

Kontakti i parë me këtë pamje të re të tokës ishte si një dehje; ajo zgjati ditë dhe javë. Lëviznin përpara shpirtit tim të zhytur në ekstazë, rrugët, parqet, bibliotekat, muzeumet, kishat e stilit gotik, burrat dhe gratë nëpër teatro, nëpër rrugë, dëbora e hollë që kishte filluar të binte, lëviznin përpara shpirtit tim të zhytur në ekstazë, dhe e dehnin. Më pas dehja u largua, bota u forcua sërish dhe ngeli e palëvizur.

Një ditë, ndërkohë që lexoja, me kokën zhytur në libër, në Bibliotekën Shën-Zhenevievë, m'u afrua një vajzë e re dhe u përkul mbi mua. Ajo mbante një libër të hapur, kishte vënë dorën mbi fotografinë e një burri që gjendej në libër, për të fshehur emrin e tij dhe më shihte me habi të madhe.

- Kush është? - më pyeti duke më treguar fotografinë.

- Si mund ta di? - i thashë.

- Po, jeni ju, - tha vajza, - jeni tamam ju. Shikoni ballin, qerpikët, sytë e futur brenda; vetëm se ky ka mustaqe të mëdha, kurse ju jo.

E pashë i çuditur.

- Po kush është pra? - i thashë duke u përpjekur që të largoja dorën e vajzës për të parë emrin.

- Nuk e njihni? Është hera e parë që e shihni? Është Niçe! Niçe! Emrin ia kisha dëgjuar por nuk kisha lexuar asgjë të tij.

- Nuk e keni dëgjuar *Origjinën e Tragjedisë*, *"Kështu foli Zarathustra"*? Tekstet për *Kthimin e përjetshëm* dhe për *Mbinjeriun*.

- Asgjë, asgjë, - iu përgjigja me turp.

- Prisni! - tha vajza dhe u largua me vrull. Nuk u vonua dhe erdhi e më solli *Zarathutrën*.

- Ja! - tha, duke qeshur. - Një ushqim luani për shpirtin tuaj - në qoftë se keni shpirt dhe në qoftë se shpirti yt ka uri. Ai çast ishte një prej më vendimtarëve të jetës sime. Atje në Bibliotekën Shën-Zhenevievë përmes një studenteje të panjohur fati më kishte ngritur një grackë; atje më priste, përvëlues, luftëtari i madh, i mbuluar me

gjak, Antikrishti.

Në fillim ai më trembi; nuk i mungonte asgjë; paturpësia dhe vetëbesimi, një shpirt i papërmbajtshëm, tërbimi i shkatërrimit, sarkazma, cinizmi, e qeshura e pafe, kthetrat, dhëmbët dhe krahët e Luciferit. Po, zemërimi dhe krenaria e tij më kishin rrëmbyer, rreziku më kishte dehur, unë zhytesha në veprën e tij me pasion dhe tmerr, sikur hyja në një xhungël të zhurmshme plot me egërsira të uritura dhe me arkivole me aromë dehëse.

Prisja me padurim të binte mbrëmja dhe qiradhënësi im të ndizte zjarrin në vatër; atëherë hapja librat që stivoseshin mbi tavolinë dhe nisja luftën me të. Pak nga pak po mësohesha me zërin e tij, me frymën e tij gulçuese, me thirrjet e tij të dhimbëshme. Unë nuk e dija dhe pikërisht tani po e mësoja se Antikrishti lufton dhe vuan si Krishti dhe ndonjëherë në çaste vuajtjesh, fytyrat e tyre ngjajnë.

Në ato shkrime, unë shikoja blasfemi të pafe, ndërsa tek Mbinjeriu shikoja vrasësin e Zotit. Megjithatë ky rebel kishte një sekret të magjishëm, fjalët e tij kishin një forcë magjepsëse që të trulloste, që dehte shpirtin tim dhe e bënte të hovte. Vërtetë mendimi i tij ishte si një vallëzim, si një himn që ngrihej lart triumfues, momenti më i dëshpëruar i tragjedisë njerëzore dhe mbinjerëzore. Admiroja pa dashur trishtimin e tij, burrërinë, pastërtinë dhe pikat e gjakut që i spërkatnin ballin sepse dhe Antikrishti mbante një kurorë me gjemba.

Pak nga pak, në shpirtin tim, të dy figurat, Krishti dhe Antikrishti u përzien. Pra ata nuk ishin armiq të përjetshëm, Luciferri nuk ishte kundërshtari i Zotit dhe e keqja nganjëherë mund të vihej në shërbim të së Mirës dhe të bashkëpunonte me të!

Sa më shumë e studioja veprën e profetit, armik të Zotit, aq më shumë arrija në një përfundim të guximshëm mistik: E mira dhe e keqja bashkëpunojnë, ja shkalla e dytë e mësimit, E Mira dhe e Keqja janë një! Ja shkalla më e lartë në të cilën nuk kisha arritur akoma. Në këtë shkollë unë ndaloja duke u dridhur; një dyshim i tmerrshëm më gërryente shpirtin; ky shenjtor blasfemues më shtynte edhe mua të mallkoja?

Gjithë dimrin e shtyva në këtë luftë; sa më shumë kalonte koha, aq më e ashpër dhe më e vendosur bëhej lufta, ndërsa unë, merrja frymë gjithmonë e më afër frymëmarrjes së mundimshme të kundërshtarit, gulçima kishte filluar të ndryshonte, një metamorfozë dhe

pa e kuptuar as vetë lufta kthehej në një përqafim. Asnjëherë nuk kisha ndjerë në mënyrë aq të prekshme dhe të çuditshme se si urrejtja, duke kaluar vazhdimisht përmes mirëkuptimit, mëshirës dhe simpatisë, mund të kthehej në dashuri. Kështu ndodh, mendoja, kur luftojnë e Mira dhe e Keqja; duket sikur kanë qenë të bashkuara dhe janë ndarë dhe se në një çast luftojnë sërish për t'u bashkuar; por ora e pajtimit të plotë nuk kishte ardhur akoma. Megjithatë nuk dua të gjykoj sipas eksperiencës sime, sigurisht do të vijë dita e pajtimit të plotë, domethënë e njohjes së kundërshtarit dhe e pjesëmarrjes së tij të lirë në këtë konstruksion të madh që e quajnë univers, gjë që do të thotë harmoni.

Ajo që më trondiste më shumë, o Martir i Madh, ishte jeta jote tragjike. Armikja jote më e madhe, mikja jote më e madhe - e vetmja që të qëndroi besnike deri në vdekje - ishte sëmundja. Ajo nuk të linte asnjëherë të qetë, nuk të linte të thoshe: Jam mirë këtu, nuk po shkoj më larg! Ti ishe flakë, digjeshe, konsumoheshe, pas vetes lije vetëm hi, dhe largoheshe.

- Po unë e di nga vij; i pangopur si flaka, unë digjem dhe tretem. Çfarë prek kthehet në dritë dhe ajo që lë bëhet karbon.

Pa dyshim unë jam flakë.

Kur erdhi pranvera dhe koha u ngroh pak, u nisa në pelegrinazh për të gjetur dhe ndjekur gjurmët akoma të ngrohta të gjakut tënd mbi të tatëpjetat e luftës dhe të heroizmit tënd.

Në fshatin ku ti kishe lindur, një mëngjes shiu, përshkoja nëpër mjegull rrugët e ngushta e të baltosura duke të kërkuar.

Më vonë, shumë afër qytetit të vogël me kishën gotike, gjeta shtëpinë e nënës tënde, ku gjatë etheve të tua, ti shkoje atje për t'u qetësuar duke u bërë sërish fëmijë. Pastaj rrugët hyjnore të bregdetit në Genes, ku ti aq shumë ke shijuar detin, ëmbëlsinë e qiellit, njerëzit e thjeshtë... Ti ishe në jetë aq i ëmbël, aq i varfër, aq i qeshur, sa që gratë e thjeshta të lagjes të quanin shenjtor. Ti bëje plane - të kujtohet - për të filluar një jetë shumë të thjeshtë dhe shumë të qetë: Të jem i pavarur por pavarësia ime të mos bezdisë askënd. Të kem një krenari të fshehur që shprehet ëmbëlsisht. Të fle lehtë, të mos pi alkool, të përgatis vetë vaktet e mia të varfëra, të mos kem miq të fuqishëm, të mos kem gra, të mos lexoj gazeta, të mos pranoj ndere, të mos frekuentoj veçse njerëz të zgjedhur; dhe nëse nuk gjej

Me çfarë emocioni kërkova në Engadinë, nën diellin pranveror, mes Sils-Maria dhe Silvaplanës, shkëmbin piramidal ku për herë të parë të është shfaqur vizioni i kthimit të përjetshëm, ku ti thirre duke qarë me ngashërim: *Sado e vogël dhe e padurueshme që është jeta ime, qoftë e bekuar, ajo do të vijë e rivijë pafundësisht.*

Sepse ti provoje shumë gëzim pranë heroit, saqë shpirtrave meskinë u dukeshe martir; ti shikoje një greminë para teje por ecje përpara pa frikë.

Malet rreth meje lëshonin tym, dukeshin të zbehtë nën dritën e diellit; dëgjova një zhurmë prej së largu dhe pashë një mal prej dëbore të shembej; m'u kujtua ajo që të shkruante një miku yt: *Në librat e tu më duket sikur dëgjoj zhurmën e largët të një ujvare.*

Kur hyra në Sil-Maria, në momentin kur po kapërceja pasarelën e vogël, pranë varrezave, u ktheva djathtas duke u dridhur.

Sepse ashtu si ti që kishe ndier papritur Zarathustrën në krahun tënd, pashë dhe unë duke parë përtokë se hija ime nga një u bë dy - ishe ti që ecje krah meje.

Të gjitha provat e tua të vështira o Martir i Madh, hynin në shpirtin tim. I ri, i zjarrtë, duke pyetur të gjithë heronjtë për të gjetur atë që do të pushtonte shpirtin tënd, ti takove një ditë Shopenhauerin. Duke u ulur në këmbët e tij zbulove vizionin heroik dhe të dëshpëruar të jetës; bota është krijimi i shpirtit tonë; të gjitha gjërat, të dukshme ose jo, nuk janë gjë tjetër veçse një ëndërr mikluese. Nuk ekziston veçse një vullnet, i verbër, pa fillim dhe pa fund, pa kufi, indiferent, as i arsyeshëm dhe as i paarsyeshëm; jashtë arsyes, i pafund. I mbyllur në kohë dhe në hapësirë, ai thërmohet në një numër të pafund aspektesh, që i zhdukte, i krijonte, i copëtonte sërish e kështu në pafundësi. Nuk ka asnjë progres, asnjë arsye nuk udhëheq fatin, besimet, moralet, idetë e mëdha janë ngushëllim i padenjë, të cilat janë të mira veç për frikacakët dhe budallenjtë. Njeriu i fortë që e di këtë, e përballon me qetësi fantazmagorinë pa fund të botës dhe e gjen gëzimin duke shpërthyer vellon jetëshkurtër dhe farfuritëse te Maias.

Ajo që kishe parandjerë, o profet i adhshëm i mbinjeriut, organizohet në një teori të rreptë dhe koherente, duke u shfaqur në një vizion heroik; poeti, filozofi dhe luftëtari që kishin luftuar në zemrën tënde bëheshin vëllezër. Asketi i ri, në vetmi, në muzikë, në shëtitje

të largëta, jetoi ca kohë mirë.

Një ditë, kur të kishte zënë furtuna në mal, ti shkruajte: *Ç'më duhen moralizimet mua? Bëj këtë, mos bëj këtë. Sa të fuqishme janë këto forca që mendimi nuk i turbullon!*

Shpirti yt shpërtheu me një hidhërim heroik, kur një ditë, në lulen e rinisë tënde ti takove njeriun e fatit, udhërrëfyesin e dytë pas Shopenhauerit, që të dha gëzimin më të pangopshëm të jetës sate: Vagnerin.

DIONISI I KRYQËZUAR

Ishte një çast i madhërishëm. Ti ishe 25 vjeç, ishe i zjarrtë, i qetë, silleshe ëmbël dhe sytë i kishe të thellë e të ndritshëm.

Vagneri, në moshën pesëdhjetë e nëntë vjeçare, ishte në kulmin e tij, plot me ëndërra, si një forcë e natyrës që shpërthente mbi kokat e njerëzve të rinj. - Ejani - u thërriste ai, - unë dua një teatër ku të mundem të krijoj lirisht; ma jepni! Unë dua një popull që të më kuptojë; Krijo, populli im! Ndihmomëni, e keni për detyrë; Unë do t'ju mbuloj me lavdi!

Arti është i vetmi lehtësim. "Arti, i shkruante Vagneri Luigjit II, duke e treguar jetën si lojë, i transformon në imazhe të bukura spektaklet e dhimbshme të jetës, duke na ngritur moralin e duke na ngushëlluar".

Ti dëgjoji, dhe transformoji në mish dhe në gjak fjalët e mësuesit duke luftuar krah tij. Hidhje sytë mbi filozofët presokristianë dhe papritur para teje shfaqej një epokë heroike, plot me drita të mrekullueshme, me legjenda të çuditshme, me mendime tragjike, me shpirtra tragjikë që kapërcenin honin e legjendave buzagaz, duke triumfuar. Nuk ishte më imazhi idilik i Greqisë që na jepnin mësuesit e shkollës, i ekuilibruar, i shkujdesur, që përballonte me një qetësi të çiltër dhe duke buzëqeshur, jetën dhe vdekjen. Kjo qetësi erdhi në fund; ishte frut i një peme të zjarrtë kur filloi të thahej. Para kësaj qetësie, në kraharorin e Greqisë rënkonte kaosi. Një Zot i shfrenuar udhëhiqte vallet e trallisura të burrave dhe të grave nëpër male dhe shpella, dhe gjithë Greqia kërcente si një *Menadë**...

Me ethet e urtësisë tragjike ti përpiqesh të japësh përfytyrimin tënd bashkëkohor. Apolloni ëndërron dhe sodit qetësisht harmoninë dhe bukurinë e botës; në mes të detit të trazuar të dukjeve, i tërhequr në individualitetin e tij, ai qëndron në këmbë, i qetë, i sigurtë, i pa-

** - Priftëreshë në lashtësi*

lëvizur, i kënaqur nga stuhia e ëndrrave.

Shikimi i tij ka vetëm dritë, edhe kur e pushton zemërimi ose trishtimi e ngërthen, ato nuk mund të prishin ekuilibrin hyjnor.

Dionisi shpërtheu individualitetin, u hodh në detin e aparencave duke ndjekur vorbullat e tmerrshme. Njerëzit dhe egërsirat u bënë vëllezër, vdekja është një pjesë e jetës, pëlhura laramane e iluzionit çirret dhe ne e shohim ballë për ballë të vërtetën. Çfarë të vërtete? Ne jemi një; të gjithë së bashku krijojmë Zotin. Zoti nuk është stërgjysh, ai është pasardhësi i njeriut.

Grekët, të tërhequr në fortesën e Apollonit, përpiqeshin në fillim të ngrinin një barrierë kundër këtyre forcave të papërmbajtshme, që vinin nga të gjitha anët, nga toka dhe nga deti dhe që vërsuleshin mbi Greqinë; por ata nuk arritën ta nënshtronin plotësisht Dionisin. Të dy Zotat luftuan, asnjëri nga të dy nuk e mundi tjetrin, ata nuk u pajtuan dhe krijuan tragjedinë.

Orgjitë Dionisike u lehtësuan nga kafshëria dhe rrezatonin në ëmbëlsinë e ëndrrës. Por megjithatë tragjedia nuk kishte veçse një hero; Dionisin, të gjithë heronjtë dhe heroinat e tragjedisë nuk janë veçse maska të Zotit - buzëqeshje dhe lot që shkëlqejnë, të fashitura nën vullnetin e Apollonit.

Por tragjedia greke papritur u zhduk; analiza racionale e vrau. Sokrati me dialektikën e tij vrau thjeshtësinë apolloniane si dhe dehjen dionisike; tragjedia bëhet në shtëpinë e Euripidit, një pasion njerëzor, një ligjëratë sofistike që bën propagandë për idetë e reja; ajo humbi substancën tragjike, ajo vdiq.

Por dehja dionisike mbijetoi dhe u përjetësua në misteret dhe në çastet e mëdha të ekstazës së njeriut. Do të mundet ajo që të jetë akoma trupi hyjnor i artit? Shpirti Sokratik, pra shkenca, do të vazhdojë të mbajë gjithmonë Dionisin të lidhur me zinxhirë?

Apo tani që arsyeja njerëzore njeh kufijtë e saj, do të vijë një civilizim i ri, simboli i të cilit do të jetë Sokrati, duke mësuar më në fund muzikën?

Deri tani ideali i qytetërimit tonë ishte Aleksandri i ditur; por kurora nisi të lëkundej mbi kokën e shkencës; shpirti dionisik po zgjohej gjithnjë e më shumë; muzika gjermane nga Bahu tek Vagneri; shpall ardhjen e tij. Është agimi i një *qytetërimi tragjik*, tragjedia u ripërtëri. Ashtu si bota gënjeshtare, shkretëtira e errët e Shopenha-

uerit, metamorfozohet! Sa shumë, ai që ka vdekur dhe është i palëvizshëm, turbullon në rrymat e kritikës gjermane! - Po, miqtë e mi, - shpall profeti i ri, - besoni ashtu si besoj unë në jetën dionisike dhe në ringjalljen e tragjedisë dionisike. Epoka e Sokratit ka kaluar! Merreni shkopin në duar, kurorëzohuni, kini guximin të bëheni njerëz tragjikë, përgatituni për luftra të mëdha dhe kini besim tek Zoti juaj Dionis!

Të tilla shpresa kozmogonike, ke vendosur ti o Niçe, në bazë të veprës së Vagnerit. Qytetërimi i ri tragjik do të shfaqet nga Gjermania, Eskili i ri është nën sytë tanë; ai lufton, krijon, kërkon ndihmën tonë.

Megjithatë profecitë e tij mbeten pa jehonë, dijetarët e përbuzin, njerëzit e rinj nuk preken. Ti je i dërrmuar, të lindin mëdyshje dhe nis të pyesësh. A është e mundur të fisnikërosh njeriun e sotëm? U sëmure dhe nxënësit e tu në Universitet të braktisën.

Të pikëllon ankthi. Poeti që gjendet tek ti mbulon humnerën me lulet e artit; por filozofi përpiqet të njohë, me çfarëdo sakrifice, duke përbuzur çdo ngushëllim, madje dhe artin vetë. I pari krijon dhe zbutet, i dyti analizon, dekompozon, dëshpërohet. Shpirti kritik shkatërron idhujt. Sa vlen arti i Vagnerit? - pyet veten ti. Ai është pa formë, pa besim, pa frymë, i ngjeshur me retorika, pa dehje të shenjta dhe fisnikëri. Kështu është dhe arti i Euripidit. Ai është i mirë për gratë histerike, aktorët e këqinj, të sëmurët. Gjysmë-Zoti yt është bërë tani një aktor i keq; ai të ka gënjyer, nuk e ka mbajtur fjalën. Tani ai punon mbi temat kretane.

Heroi u mund, ai u shëmb te këmbët e kryqit.

Ai që na kishte premtuar të krijonte mite të reja dhe të mbrehte në qerren e tij dionisike leopardin e arsyes!

Arti, - bërtet ti, - tani mbulon me pamje të bukura, të vërtetën e lemerishme; ky pra është një ngushëllim për frikacakët. Le të zbulojmë ne të tjerët të vërtetën! Ja thirrja jote e re që kundërshton të parën. Kritika, tek ti, e mundi poetin, e vërteta mundi bukurinë. Por Shopenhaueri nuk i kënaqte më nevojat e acaruara të shpirtit tënd; jeta nuk është vetëm dëshira për të jetuar, ajo është diçka më e thellë; është dëshira për të dominuar. Jeta nuk kënaqet duke u konservuar, ajo dëshiron të shtrihet dhe të pushojë.

Arti nuk është më qëllimi i jetës, ai është si një pushim i shkurtër

në luftë. Përmbi poezinë, është ndjenja, Sokrati është më i madh se Eskili, e vërteta megjithëse mund të na bëjë të vdesim, është superiore ndaj gënjeshtrës, më brilante dhe më e frytshme.

Ti luftoje, shkoje nga njëri vend në tjetrin, nxehtësia të paralizonte, era të dërrmonte, dëbora të vriste sytë. Nuk mund të flije dhe merre ilaçe gjumi; jetoje i varfër, pa komoditet, nëpër dhoma pa ngrohje. Por, i sëmuri, - thoje me krenari, - nuk ka të drejtë të mallkojë jetën. Në mes të vuajtjeve të tua ngrihej i pastër dhe i palëkundur, himni i gëzimit dhe i shëndetit.

Ti ndieje se brenda teje, vdiste dhe të gllabëronte një farë. Një ditë kur ti po shëtisje në Engadinë, ndalove papritur, i tmerruar. Koha, - mendove, - është e pafund, por lënda është e fundme; patjetër do të vijë çasti që të gjithë kombinimet e lëndës të jenë të njëjta me ato të mëparshmet. Pas mijëra shekujve një njeri si unë, unë vetë do të jem në këmbë në këtë shkëmbin këtu dhe do të zbuloj sërish të njëjtën ide. Dhe jo vetëm një herë, por një numër të pafundëm herësh. Nuk ka pra asnjë shpëtim; gjithmonë të njëjtë, të pandryshueshëm do të kthehemi në rrugën e kohës. Gjërat më kalimtare bëhen kaq të përjetshme dhe ato më të parëndësishmet marrin një rëndësi të padiskutueshme. Ti ishe në një ekstazë të ankthshme. Vuajtja jote nuk do të kishte fund dhe vuajtja e botës do të ishte e pashëruesheme, megjithatë me një krenari prej asketi ti prisje me gëzim vuajtjet e mëdha.

Duhej që ti të krijoje një vepër të re; unë kam për detyrë të krijoj, - ëndërroje, - që t'i predikoj njerëzimit Ungjillin e ri. Në çfarë forme? Një sistem filozofik? Jo, mendimi duhej të derdhej me liri-zëm. Një epope? Profeci? Dhe papritur shkëlqeu në shpirtin tënd, figura e Zarathustrës.

Në mes këtij gëzimi dhe ankthi të gjeti Lu Salome, skllavja e zjarrtë me shpirtin therës, plot me entuziazëm dhe kureshtje, që përkulej, e pangopur, dhe të dëgjonte o Martir i Madh. Ti i derdhje shpirtin pa kursim dhe ajo e shtrydhte siç shtrydhim një frut dhe buzëqeshte e pangopur. Prej aq e aq vitesh, ti nuk e kishe hapur zemrën tënde me aq besim, nuk kishe shijuar emocionin, shqetësimin, që na sjell një femër. Ti ndjeje në grumbullin e armëve të luftëtarit sesi shkrihej zemra jote e ndjeshme. Atë natë hyre në qelinë tënde të asketit dhe për herë të parë ti ndjeve në ajrin ku jetoje një

gruaje.

fërgëllimi aq i ëmbël të ndoqi në malet ku u strehove dhe
je me gëzim o Asket, letrën e gruas. Një ditë ajo të dërgoi te-
gje, zemra jote rrahu si ajo e një njëzet vjeçari dhe ti i lexove
të lartë nën bredhat e vetmuar.

Ah, kush do të mundej të ikte
Dhe të harronte sytë e tu të thellë, pasi të ka pushtuar?
Po, ti më ke pushtuar dhe unë nuk dua të largohem;
Unë e di që ti jeton në krijesat e kësaj bote,
Dhe asgjë në këtë botë nuk të largohet.
Pa ty jeta do të ishte e bukur,
Megjithatë unë e jetoj me ty!

Menjëherë pas kësaj erdhën ditët e vështira të ndarjes. Ti e kishe tmerruar gruan, sikur të ishe një pyll i errët. Vuajtjet e tua nisën sërish, në sëmundje, në braktisje dhe vetmi. Ti ndieje sikur ishe një pemë që përkulej nën peshën e fryteve të saj dhe dëshiroje me zjarr që dikush të vinte e të bënte vjeljen. Qëndroje më këmbë në fillim të rrugës, shkelje me këmbët e tua qytetet e njerëzve por askush nuk të vinte pas. Nuk do të gjendet ndonjë që të më dojë? - thërrisje në shkretëtirën tënde, - dikush që të më fyejë, të tallet me mua? Çfarë bën kisha, pse nuk hedh mbi mua mallkimin? Çfarë bën pushteti, pse nuk ma pret kokën? Unë thërras, thërras, ju nuk më dëgjoni?

KTHIMI I PËRJETSHËM

Ah, vetmia - ëndërroje, - ndarja me njeriun e dashur! Jo, kurrë, kurrë nuk dua t'i rijetoj ato kohë! Duhet të hap një portë shpëtimi në qarkun e mbyllur të kthimit të përjetshëm.

Një shpresë e re lindi brenda teje, fara e re, Mbinjeriu. Është fara e tokës dhe mban mes duarve të saj lindjen, ajo është përgjigjja e pyetjes tënde të vjetër. A mund të fisnikërohet njeriu i sotëm? Po, është e mundur. Dhe jo nga Krishti, si e predikon në veprën e tij të re Vagneri, por nga njeriu vetë, nga virtytet dhe përpjekjet e një aristokracie të re. Njeriu mund të krijojë Mbinjeriun. Kthimi i përjetshëm të mbyste; Mbinjeriu ishte ideja e re që do të shmangte tmerret e jetës. Nuk ishte më çështje arti por veprimi; Don Kishot, ti e kishe marrë Zotin për mulli me erë dhe e kishe rrëzuar.

Zoti ka vdekur - thoshe me zë të lartë, duke na shtyrë në buzë të greminës; nuk na ngelej veçse një shpresë e vetme; që njeriu të tejkalonte natyrën e tij, të krijonte Mbinjeriun. Drejtimi i botës do t'i binte atij atëherë dhe do të kishte forcën të ngarkohej me barrën e kësaj përgjegjësie. Zoti kishte vdekur dhe froni kishte mbetur bosh. Ne kishim mbetur në botë vetëm? Zoti kishte vdekur? Më mirë kështu: tashti ne do të punonim, jo sepse na komandonte ai, jo sepse kishim frikë ose shpresonim por sepse ishte ajo që ne donim.

Kthimi i Përjetshëm është pa shpresë, Mbinjeriu është një shpresë e madhe; si mund të harmonizoheshin këto dy vizione kaq kontradiktore të botës?

Ishte një ankth i tmerrshëm. Shpirti yt fluturonte mbi humnerën e çmendurisë. Nga Zarathustra nuk kishte ngelur veçse një thirrje. Ti e braktise në gjysmë të punës këtë poemë tragjike dhe u përpoqe të tregoje shkencërisht se substanca e jetës është vullneti i fuqisë.

Evropa humbi, duhet t'i nënshtrohet disiplinës së rreptë të shefave. Morali që mbretëron sot është një vepër e skllevërve, është betimi i thurur nga të dobëtit kundër të fortëve, nga delet kundër bariut.

Skllevërit përmbysën vlerat sipas interesave të tyre; i forti është i keq, i sëmuri dhe i dobëti janë të mirë. Ata nuk iu qëndrojnë dot vuajtjeve, janë filantropë, kretianë, socialistë. Vetëm Mbinjeriu, i cili tregohet i rreptë kundrejt vetvetes, mund të gdhendë urdhëra të reja dhe t'i japë masës qëllime të reja edhe më të larta.

Cilat janë këto qëllime, cili është organizimi i të zgjedhurve dhe i turmës, cili është roli i luftës në këtë periudhë të re tragjike të Evropës? Ja pra problemet që të shqetësuan në vitet e fundit të qartësisë mendore. Ti nuk mund t'u përgjigjeshe, shpirti yt lëkundej. Ti u ktheve sërish në këngët e vjetra dionisike, dhe me një parandjenjë shumë të hidhur, këndove këngën e mjelmës: *"Dielli po fle; së shpejti ti do t'i shuash etjen - zemrës tënde që po digjet. - Ajri filloi të freskohet; - ndiej hukamën e gojëve të panjohura - i ftohti i madh po zbret!*

Ajri është i qetë dhe i pastër; - këtë mbrëmje - a nuk më ka hedhur ajo një shikim të vëngër - dhe të magjishëm? - rezisto ashtu e mbyllur, o zemra ime fisnike! - Mos pyet përse, o muzg i jetës sime. Dielli po fle!"

Ti kishe parë atë që nuk i lejohet njeriut ta shohë, dhe ishe i verbuar; kishe kërcyer më shumë seç mund të kërcejë një njeri buzë greminës dhe u hodhe matanë.

Errësira erdhi shpejt në shpirtin tënd dhe vazhdoi për 12 vjet gjer në vdekjen tënde. Ndonjëherë ti merrje një libër në duar dhe pyesje: - A nuk kam shkruar dhe unë libra të bukur? Dhe kur të treguan një portret të Vagnerit ti the: - Këtë njeri e kam dashur shumë!

Asnjëherë, edhe kur isha ende fëmijë e lexoja Legjendën e Artë të Shenjtorëve, nuk e kam jetuar jetën e një shenjtori me aq intensitet; asnjëherë nuk ka dalë nga shpirti i njeriut, një klithmë aq pikëlluese.

Kur pelegrinazhi im në Golgotën e re mori fund dhe u ktheva në Paris, unë besoj, se, më shumë se shpirti, kishte ndryshuar zemra ime. Kisha jetuar aq shumë me ankthin e këtij Martiri të Madh ateist, plagët e mia të vjetra ishin rihapur për të ndjekur gjurmët e tij të përgjakura, saqë pata turp nga jeta ime e mefshtë dhe e rregullt e cila nuk guxonte t'i shkëpuste të gjitha urat me të shkuarën dhe të hynte e vetme në trimërinë dhe trishtimin ekstrem.

Si kishte vepruar ky profet? Kush ishte drejtimi i tij suprem? Të refuzonte të gjitha ngushëllimet, - Zotat, atdheun, të vërtetat, të qëndronte vetëm dhe të krijonte vetë, me forcën e tij një botë që të mos e poshtëronte zemrën e tij. Ku është rreziku më i madh? Unë atë dua. Ku është gremina? Drejt saj dua të drejtohem. Kush është gëzimi më i madh burrëror? Është ai që të marrësh përsipër të gjitha përgjegjësitë.

Ndonjëherë, duke shëtitur nën gështenjat e Parisit, ose mbi brigjet e lumit të famshëm, unë ndieja papritur hijen e tij të heshtur në krahë të diellit. Frymëmarrja e tij ishte e shkurtër, gulçuese dhe vinte era squfur; ai duhet të vijë nga Ferri - mendoja, - dhe frymëmarrja ime bëhej gulçuese. Por ne nuk luftonim më, ishim pajtuar; ai më shihte dhe unë dalloja në bebet e syve të tij, fytyrën time. Ankthi është i ngjitshëm, ai më kishte komunikuar të gjitha ankthet e tij; bashkë me të kisha nisur të luftoja për të pajtuar të papajtueshmet, për të pajtuar shpresën ekstreme me dëshpërimin ekstrem, dhe të hapja një portë tej arsyes dhe bindjes.

Një mbrëmje, ndërkohë që dielli po perëndonte dhe po bëheshim gati të ndaheshim, ai u kthye. Ai që nuk fliste asnjëherë foli: - Jam unë që ndjek Dionisin e kryqëzuar, - më tha, - jam unë dhe jo ai! Zëri i tij ishte plot xhelozi, urrejtje dhe dashuri. Kur të nesërmen, shkova të dëgjoja zërin magjik të Bergsonit, zemra ime u qetësua; fjalët e tij ishin magjike, një portë e vogël hapej në fund të fatalitetit dhe hynte drita. Por atij i mungonte plaga, gjaku, psherëtima e mahe, që joshnin rininë; dhe kthehesha sërish nën gështenja për t'u takuar përsëri me njëri - tjetrin, me atë që plagoste.

Por plagosja nuk hynte atëherë aq thellë tek unë; isha i plagosur edhe unë por shumë pak dhe ndërkohë që profeti i egër kishte një plagë që rridhte gjak, unë si shën Françesku, isha i shënuar me shenja, dhe mishi im kënaqej duke u mavijosur. Më vonë, kur ëngjëjt e Apokalipsit për të cilët ai kishte pasur një përfytyrim, u sulën mbi njerëzit, atëherë dhe plagët e mia nisën të hapeshin. Më kujtohet, vite më vonë në Londër, ishte akoma vjeshtë dhe isha ulur në një stol në park.

Ajri ishte mbushur me kërcënime; Mbinjeriu kishte lindur diku, një tigër i etur për gjak kishte besuar se ishte Mbinjeriu, ai nuk mund të përmbahej në çmendurinë e tij, e kishte pushtuar tërbimi i

mundimit. Xhenghis Khani mbante një unazë hekuri ku ishin gdhendhur këto dy fjalë: *Rasti-Rousti* -Forcë e Djathtë.

Epoka jonë gjithashtu mban këtë unazë të hekurt. Demoni i kohëve tona ngjan me mbretin e legjendës së Afrikës. Ai ishte shumë i shëndoshë, i gjatë rreth 20 kude, leshtor; kishte hipur në kullën më të lartë me dymbëdhjetë gra, dymbëdhjetë këngëtarë dhe njëzet e katër shakuj me verë. I gjithë qyteti tundej nga këngët dhe vallet; barakat më të vjetra u shembën. Në fillim mbreti kërceu, pastaj u lodh, shkoi të ulej mbi një gur dhe nisi të qeshte; kur u lodh së qeshuri, nisi të gogësinte dhe për të shtyrë kohën hodhi që nga lart të dymbëdhjetë gratë, pastaj këngëtarët dhe më pas shakujt bosh. Por zemra e tij nuk u lehtësua dhe nisi të qante për vuajtjen e pangushëllueshme të mbretërve.

Një shitës gazetash kaloi duke thirrur për informacionet e fund të luftës; njerëzit ndalonin papritur në rrugë sikur t'u zihej fryma; të tjerët ua mbathnin me vrap drejt shtëpive sikur donin të shikonin nëse fëmijët e tyre ishin ende gjallë.

Një hije erdhi e u ul krah meje në stol; u ktheva dhe u drodha; ishte ai. Kush e kishte shpallur se thelbi i jetës është dëshira për t'u shtrirë dhe dominuar dhe që vetëm forca është e denjë për të pasur të drejtat e saj? Kush pra e kishte profetizuar Mbinjeriun dhe duke e profetizuar e kishte sjellë? Mbinjeriu kishte mbërritur dhe profeti i tij i mbledhur kruspull, përpiqej të fshihej nën një pemë vjeshte.

Asnjëherë nuk kisha provuar për atë, një keqardhje aq tragjike, sepse unë shikoja për herë të parë me aq qartësi se ne jemi fyelli dhe kallami i një bariu të padukshëm dhe luajmë ajrin që ai fryn tek ne dhe jo ajrin që duam të luajmë.

Vështrova sytë e tij të futur thellë, ballin e vrazhdë dhe mustaqet e varura.

- Mbinjeriu erdhi, - i mërmërita; a nuk doje pikërisht këtë? Ai u mblodh kruspull akoma më shumë, si një kafshë e plagosur që e ndjekin ndërsa ajo do të fshihet. Zëri i tij erdhi i largët, krenar dhe i trishtuar: - Pikërisht këtë!

Ndjeva që zemra e tij ishte e plagosur.

- Ti mbolle, dhe tani shiko frutin. Të pëlqen?

Dhe gjithmonë ai zë i largët, lëshoi një thirrje të dëshpëruar dhe të plagosur: - Më pëlqen!

Kur u ngrita i vetmuar nga stoli për t'u larguar, një bombardues kalonte duke gumëzhitur përmbi qytetin e zhytur në errësirë. Avioni që Leonardo e kishte imagjinuar si një zog të parrezikshëm artificial i cili, në verë do të transportonte nga majat e larta të maleve dëborë për të freskuar qytetet, tani kalonte i ngarkuar me bomba.

"Kështu fluturojnë, - mendoja, - duke patur gjithmonë në shpirt profetin paqësor të luftës, kështu fluturojnë mendimet nga shpirti i njeriut, si laureshat në agim; por kur shikimi lakmues i njeriut bie mbi to, ato transformohen në zogj gjahu mishngrënës dhe të uritur. Babai i tyre i mallkuar kundërshton i dëshpëruar: "Unë nuk doja këtë! Nuk doja këtë!" por zogjtë gjahtarë kalojnë mbi kokën e tij duke klithur.

Nicja më kishte dhënë një ushqim luani në momentin më të rëndësishëm, më të uritur të rinisë time; kisha marrë forcë, njeriu bashkëkohor, ashtu si ishte bërë, ishte tepër i ngushtë për mua. Krishti gjithashtu, dhe akoma më shumë ajo që kishte bërë ai. Ah! - thërrisja i indinjuar, - besim dinak që shtyn shpërblimet dhe ndëshkimet në një jetë të ardhme, për të ngushëlluar skllevërit, frikacakët, të shtypurit, që ata të mund të durojnë pa rënkuar këtë jetë tokësore, dhe të përkulin me durim kokën përpara zotërinjve! Çfarë tavoline loje është besimi, ku të jepet një grosh në jetën tokësore për të marrë milionat e përjetshëm në jetën tjetër!

Ç'djallëzi, ç'djallëzi, ç'punë fajdexhiu. Jo, njeriu nuk mund të jetë i lirë duke shpresuar parajsën, duke iu druajtur ferrit. Është turp që sot e tutje të dehesh në tavernat e shpresës. Si kisha qëndruar kaq vjet pa kuptuar?; dhe u desh të vinte ky profet i egër që të më hapte sytë!

Deri në atë çast, ia kishim besuar Zotit qeverisjen e botës; a kishte ardhur çasti të merrnim përgjegjësinë? Le të krijojmë një botë, botën tonë, me djersën e ballit. Një erë vetëbesimi, e një vetbesimi të denjë për Luciferrin, kishte fryrë mes tëmthave të mi; çasti ka ardhur, - thosha me paturpësi, - ka ardhur çasti që njeriu të marrë në zemrën e tij gjithë luftrat dhe të gjitha shpresat, dhe pa pritur asgjë nga Zoti, të vendosë vetë rregull në këtë kaos, pra të transformojë kaosin, në botë. Ruaje të palëkundur pavarësinë tënde personale, që të gjendesh në këmbë kur të vijë, në mes të çmendurisë së botës, çasti për të transformuar thirrjet e pakuptimta në një fjalë të thjeshtë

të drejtë, në "Mirëseerdhe Botë e Re".

Këtë urim e dëgjoj brenda meje si këngën e largët të një zogu, si filladet e para të pranverës. Zemra ime ngjan me një bajame që, edhe pse rrotull saj mbretëron dimri, dhe sipër saj qielli është i errët, ajo i ka kuptuar shenjat e fshehta të pranverës, dhe papritur e shohim në janar që dridhet në erën e ftohtë, krejt e mbuluar me lule. Një erë e fortë mund t'ia shkundë petalet; pak rëndësi ka; ajo e ka bërë detyrën e saj, ka lëshuar një klithmë, ka klithur se ka parë pranverën.

ZEMRA E NJERIUT

Një natë pashë një ëndërr; gjatë gjithë jetës sime, ëndrrat kanë qenë për mua udhërrëfyese të pagabueshme. Gjithçka që deri në mbrëmje torturonte shpirtin tim, përzihej e sigurt, ndriçohej në ëndërrat e mia, flakte tej atë që ishte e kotë dhe prej saj ngelej vetëm substanca fare e thjeshtë, e çliruar nga gjithçka e tepërt.

Gjatë gjithë kësaj periudhe, unë isha si shën Sebastiani, i përshkuar nga shkëndiat që më kishte hedhur profeti tragjik i Ndryshimit të përjetshëm, dhe më kotë përpiqesha me shpirtin tim të gjeja, në mes të arrësirave që e rrethonin dhe i zinin frymën, cila ishte detyra e njeriut. Pikërisht atëherë, një natë pashë këtë ëndërr. M'u bë se isha në një bregdet dhe shikoja: Deti, ishte i tërë i zi, i llahtarshëm, dhe vlonte; sipër qielli, i tëri i zi, ishte bashkuar me detin. Asnjë frymë ere, bota ishte si e vdekur, mizore. Nuk merrja dot frymë, po mbytesha. Fare papritur në të çarën e ngushtë që formohej midis detit dhe qiellit shkëlqen një velë e bardhë e plot dritë. Ishte një barkë fare e vogël, që mbartte dritën dhe që frynte velat në bunacën mbytëse, ajo ecte shumë shpejt, nxitonte, ndërmjet dy masave të errëta. Unë shtriva duart drejt saj dhe thirra:

- Oh, zemra ime! Dhe u zgjova.

Kjo ëndërr ka qenë një ndihmë e madhe për pjesën tjetër të jetës sime. Sa keq më erdhi që nuk munda të vrapoja pranë babait të dëshpëruar të shpresës, dhe t'i tregoja atij shenjën e fshehtë që më solli gjumi, mos ishte zgjidhja për gjithë brengën time?

Zhytur në një dëshpërim të skajshëm, a nuk e kishte thirrur ai atë varkë trime që lundronte, shtyrë nga një erë që ajo vetë e krijonte, ndriçohej nga një dritë që vetë e lëshonte, dhe nuk kishte nevojë për njeri?

Në momentet e vështira, gjithçka errësohej rreth meje, miqtë e mi më të shtrenjtë, shpresat e mia më të forta më braktisnin; sa herë i kam mbyllur sytë atëherë dhe kam parë ndërmjet qepallave atë

barkë, që i jepte guxim zemrës sime, ajo shfaqet: - Ngri velën dhe mos ki frikë! - më thërriste duke çarë errësirat.

Plagë të thella dhe të bekuara si ato që Niçja ka hapur tek unë, dhe që bimët misterioze të Bergsonit, nuk kanë mundur t'i shërojnë, i qetësojnë për një kohë por ato hapen përsëri dhe rrjedhin gjak. Sepse, në thellësi të qënies sime, ajo që kam dëshiruar, aq sa ka zgjatur rinia ime, nuk ka qenë shërimi por plagosja.

Më pas ka filluar, por tashmë i vetëdijshëm dhe pa mëshirë, luftа ime me të padukshmen.

Më kujtohet se në ato vite të rinisë më kishte pushtuar indinjata dhe nuk mund të duroja fishekzjarret e jetës, që ndizen për një çast, shpërthejnë në ajër me mijëra ngjyra dhe reflekse dhe zhduken përnjëherë. Kush i ndez pra? Kush u jep pra gjithë atë bukuri dhe përnjëherë i shuan pa mëshirë? Unë nuk e pranoj, klithja, nuk e nënshkruaj, unë do ta gjej mënyrën që ti pengoj të shuhen. Mëshiroja shpirtin e njeriut, admiroja mrekullitë e tij. Si mundej ky krimb i thjeshtë mëndafshi të mund të thurte me organizmin e tij një mëndafsh kaq hyjnor? Krimbi i mandafshit është krimbi më ambicioz; ai zvarritet, nuk ka veç gojë dhe bark, ha, ndyn, ha akoma, gërryen një tunel në atë që ndyn dhe ja fare papritur ajo që ha bëhet mëndafsh.

Kështu është bërë njeriu. Qielli dhe toka shkëlqejnë, idetë shkëlqejnë, shkëlqejnë rrobat prej mëndafshi të çmueshëm që ai ka veshur; dhe brutalisht një këmbë e madhe kalon andej dhe dërrmon krimbin e mrekulleshëm.

Lehtëbesimi dhe lumturia e padjallëzuar e fëmijës kishin shkuar përgjithmonë; Unë e dija tani se qielli ishte një kaos i zi plot qetësi dhe indiferencë; kisha parë se ç'bëhet bukuria dhe rinia kur ato zbresin brenda në dhe. Shpirti im nuk pranonte më të ngushëllohej me shpresa të vakëta dhe të rehatshme.

Pak nga pak, me hap të pasigurt, unë i afrohem greminës; por syri im ishte akoma i pastërvitur, dhe nuk guxoja ta shikoja ballë për ballë. Shpirti im ziente akoma, i paaftë të qetësohej dhe hërë-herë, me ashpërsinë e luanit të rinisë së tij, sfidonte fatin njerëzor, herë-herë rrëgjohej, dërrmuar prej melankonie romantike. Më vonë, shumë më vonë, unë munda të rrija më këmbë, pa m'u përthyer

gjunjtë, në buzë të greminës, dhe ta shihja atë pa frikë dhe pa mburr

Mbrëmje hyjnore, që asgjë s'i turbullon, në dhomën e vogël
tokën e arratisë! Ndonjëherë thirrje dhe të qeshura poshtë në rrug
këngë dashurie në mesnatë, ndonjëherë mbi çatitë dëborë e qet
bardhë...

Drita përgjonte, zjarri në vatër rrinte ndezur dhe unë përkul
mbi libra, rijetoja trimëritë intelektuale të njeriut.

Kështu, në këto preokupime, aq shumë rinore, por edhe aq shum
pleqërie, kaluan vitet e jetës sime në Paris. Qiradhënësja filloi t
dyshojë dhe të shqetësohet. Më shikonte me bisht të syrit dhe m
fliste me majë të buzës, por një ditë nuk u përmbajt më.

- Sa do të zgjasë kjo situatë, zotëri, në fund të fundit?

- Cila situatë?

- Cila situatë? Të mbyllesh brenda aq herët çdo mbrëmje, t
mos pranosh kurrë vizita, as të burrave dhe as të grave, të mbash
dritën dezur deri pas mesnate, ju e quani këtë normale?

- Por gjatë ditës unë jam në universitet, natën studioj dhe shkruaj.
Kjo nuk lejohet?

- Jo, nuk lejohet. Qiraxhinjtë e tjerë më kanë bërë vërejtje; ju di-
çka fshihni. Gjithë ky rregull, gjithë kjo vetmi dhe kjo qetësi, asnjë
femër, asnjë mik, ju duhet të jeni i sëmurë, ose kurdisni ndonjë gjë.
Më falni por kështu nuk mund të vazhdoni.

Në çastin e parë u pezmatova, por shpejt e kuptova se qiradhënës-
ja ime kishte të drejtë. Në një shoqëri pa rregulla, imorale, të zhurm-
shme, një njeri i rregullt, i qetë, që nuk pranon në dhomën e vet as
burrë e as grua, thyen rregullat e lojës; nuk është, nuk mund të jetë
e tolerueshme. Unë këtë e kam vërejtur gjatë gjithë ekzistencës si-
me; sepse jeta ime gjithnjë ka qenë shumë e thjeshtë, ajo gjithnjë
është dukur rrezikshmërisht e komplikuar. Gjithçka mund të bëja
ose të thosha, të tjerët i jepnin një kuptim të kundërt. Përpiqeshin
të zbulonin se çfarë fshihej prapa të papohueshmes.

Më vonë edhe miku im më i mirë vetë nuk besonte lehtë; kur e
besonte nuk e duronte. Një mbrëmje isha ulur në oborr dhe shikoja
yjet. Qielli i yjëzuar për mua ka qenë gjithmonë shfaqja më pikëllue-
se dhe më tronditëse. Ajo nuk më jepte asnjë gëzim, vetëm frikë.
Nuk mund ta shikoja pa më pushtuar zemrën paniku. Në kopsht

edhe miku im. - Ç'bën këtu? - më pyeti befasisht. Nuk përgji-
Pse s'përgjigjesh?

afrua, u përkul mbi mua; pika të mëdha loti u rrokullisën nga
e mi. ai shpërtheu në të qeshura.

Gënjeshtar! - më tha, hipokrit! Tashmë, ti do të më thuash se
qan se po shikon yjet dhe kjo të ka prekur! Por ti nuk mund të
gënjesh, hipokrit! Ti je duke menduar për një nga zogëzat që të
në vërdallë.

Një herë tjetër, më vonë kur njoha Panai Istratin në Rusi dhe
hymë të dy së bashku në Greqi, gjatë gjithë udhëtimit Panai
shihte, më analizonte dhe nuk dinte çfarë të gjykonte për mua,
uk më përcaktonte dot. Në Athinë pyeti një gazetar.

- Çfarë do ti që të them? - iu përgjigj gazetari, ai nuk është i na-
yrshëm.

- Çfarë bën ai pra? - pyeti i shqetësuar Panai i gjorë.

- Në fakt asgjë. As duhan nuk pi.

E tillë ka qenë jeta ime në Paris, gjatë tre vjetëve që qëndrova
atje; asnjë aventurë të veçantë; pa dashurinë e studentit, pa dehjen
e studentit, pa komplote politike apo intelektuale. Më në fund, qira-
dhënësja ime u mësua me mua, besonte se ishte futur në të fshehtën
time dhe më falte pastërtinë dhe rregullin e jetës që bëja, edhe pse
për të ishin të pakuptueshme.

- Në atdheun e tij, duhet t'i përkasë ndonjë sekti fetar, - dëgjova
të thotë pas shpinës sime, njërin prej fqinjëve që më shikonte çdo
mëngjes e mbrëmje me një sy të shqetësuar. - Do të dëshironte, fat-
keqi, do të dëshironte, por nuk i lejohet, - thotë tjetri.

- Atëherë përse nuk heq dorë nga një rregull i tillë? - thotë fqinji
i nervozuar.

- Epo, ç'ju duhet juve, ajo është punë e tij... përgjigjet qiradhënësja
ime me shpirtgjerësi.

Kur unë bëra gati valixhet për të ikur, ajo hyri në dhomën time
me të bijën, Suzanën.

- Përqafoje pra vajzën time, tani që po ikni! - thotë nëna duke u
djegur nga dëshira të më tundonte.

- Por jo në ballë! - kundërshtoi vajza duke parë se unë po i afro-
sha; jo në ballë!
- Po ku pra?
- Nuk ka rëndësi se në ç'vend tjetër, miku im!
- Në buzë, o rrotë, në buzë! - thirri nëna duke qeshur.
U përkula dhe e putha në faqe.

NË BUZË TË GREMINËS

Përpara se të lija Parisin, një mbrëmje shkova të përshëndetem
me Notre-Damë. Për gjithë jetën do t'i jem mirënjohës për emocio-
net që më dha kur e pashë për herë të parë. Kupola e kishave tona
duket sikur është një pajtim i fundit me pafundësinë, i njeriut me
Zotin. Tempulli ngrihet drejt lartësive, sikur dëshiron të arrijë qiellin,
dhe përnjëherë, me një nënshtrim të përshpirtshëm, ai ia nënshtron
vullin e tij forcës së shenjtë, përkulet dhe kërruset përpara pafundësi-
së së paarritshme, bëhet kupolë dhe lejon të zbresë në majën e saj i
Gjithëfuqishmi.

Ambicia e guximshme e katedrales gotike më dukej shumë më krenare. Ajo ngre nga toka, mobilizueshëm, besueshëm, të gjithë gurët e tokës, për t'i disiplinuar, dhe detyruar që të formojnë një shigjetë që ngrihet me majë drejt qiellit, trimërisht, si rrufepritëse. Në këtë arkitekturë të shenjtë e gjithë katedralja merr formën e një kulmi, e gjithë bëhet një shigjetë. Nuk është më logjika drejtvizore, katrore, e stilit grek, që tregon rregullin njerëzor mbi kaosin, duke realizuar ekuilibrin e së bukurës dhe të nevojshmes duke vendosur një mirëkuptim të arsyeshëm ndërmjet njeriut dhe Zotit. Por është diçka e trallisur, në kllapi, një zemërim hyjnor që i merr papritur njerëzit dhe i shtyn te hidhen në sulmin e vetmisë së rrezikshme kaltëroshe, për të bërë të mundur të zbresë në tokë Rrufeja e madhe, Zoti.

Kush e di, ndoshta kështu është lutja, ose shpirti i njeriut, duke mobilizuar shpresat, tmerret njerëzore dhe duke i hedhur si shigjetë drejt lartësive të paarritshme e mbinjerëzore; një vrull dhe krenari, një klithmë në heshtjen e padurueshme prej varri, një ushtë e ngritur, e pathyeshme, që nuk e lë qiellin të bjerë mbi kokat tona...

Sa më shumë shikoja atë shigjetë të ngjitej pa frikë drejt qiellit, aq më shumë ndieja të më forcohej shpirti, të shtrihej dhe të bëhej shigjetë edhe ai.

Fare papritur, nxora një klithmë gëzimi; nuk ka qenë e tillë thirrja

e Niçes? A nuk ishte edhe ajo një shigjetë që vërsulej drejt qiellit? Një rrufepritëse e ngritur për të kapur Zotin dhe për ta zbritur nga froni i tij?

Gëzohesha shumë të ecja kështu nën kubetë gotike, ndërsa diellit perëndonte, në mes të këtij shpirti të Zarathustrës, bërë nga gurë, hekur dhe xhama shumëngjyrësh plot dritë, të jehonës së një organoje të padukshme, i ngazëllyer në ekstazë hyjnore.

Kështu, dalëngadalë, me zemrën plot pyetje, shpresa dhe pashpresa të trallisura, u ndava nga Parisi.

Çfarë dhimbshurie: shiu i fundit i Parisit, mjegulla e lehtë, gështenjat në lule, bishtalecat e verdha!

Lashë Parisin dhe zemra ime kishte humbur sigurinë dhe qetësinë. Cili ishte gjuetari që thoshte: Ti pushon dhe zemra jote është e qetë por po qe se ti dëgjon këngën e një zogu, zemra jote nuk është më e qetë? Po unë që kisha dëgjuar klithmën e mprehtë të një gjeraqine të egër! Lashë Parisin dhe të gjitha plagët e kryqëzimit , në këmbë, në duar, në brinjë, ishin mbyllur përsëri, por shpirti brenda meje përpëlitej, i përgjakur dhe rebel dhe më bënte të vuaja shumë.

Sa herë arrija një farë bindje, prehja dhe siguria zgjatnin shumë pak dhe menjëherë nga kjo bindje, vërshonin dyshime të reja, shqetësime të reja, dhe unë isha i detyruar të nisja një luftë të re, për t'u çliruar nga bindja e vjetër dhe të gjeja një luftë të re; deri sa ajo të piqej dhe të bëhej pabindje... Ç'është pabindja? Është nëna e një bindjeje të re.

Niçe më ka mësuar të sfidoj gjithë teoritë optimiste; unë e dija, se zemra femërore e njeriut, ka nevojë për ngushëllim dhe se shpirti, sofist i rafinuar, është gjithmonë i gatshëm t'ia bëjë këtë shërbim. Çdo fe që i premton njeriut atë që ai dëshiron ka filluar të duket një strehë për frikacakët, të padenja për një njeri të vërtetë.

A është rruga e Krishtit, mendoja, ajo që çon në shërbim të njeriut? Apo më mirë është një përrallë, e organizuar mirë, me shumë mençuri, me një shkathtësi të veçantë që premton parajsën dhe pavdekësinë, në mënyrë të tillë që besnikët nuk mundin kurrë të

kuptojnë se Parajsa është një gjë tjetër nga reflekset e etjes sonë; se, vetëm pas vdekjes ata mund ta gjykojnë, dhe se askush nuk është kthyer dhe nuk do të kthehet pas vdekjes të na i thotë.

Zgjedhim pra vizionin e botës më të pashpresë e në qoftë se kuptojmë se gënjehemi dhe se ekziston një shpresë, kjo do të jetë aq më mirë; në çdo rast të kësaj mënyre shpirti ynë nuk do të vihet në lojë dhe askush, as Zoti, as djalli, nuk do të mund të tallet me të, duke thënë se ai është i dehur si një pirës hashashi dhe ka krijuar, nga pafajësia dhe ligësia, Parajsat imagjinare për të fshehur greminën. Teja më e pashpresë më është dukur ndoshta jo si më e drejta, por si më burrërorja dhe shpresa metafizike si një karrem, ose si një njeri i vërtetë, që nuk kundërshton të kafshojë. Ç'është më e vështirë, a dëgjoj unë prej andej më të denjin e njeriut që nuk qaravitet, nuk psherëtin, nuk lyp? Kjo është ajo që dua unë. Që Niçe, vrasësi i Zotit, të falënderohet; është ai që më ka dhënë guximin të them: Kjo është ajo që dua!

Përnjëherë kisha e Krishtit, ose të paktën ato që kanë bërë mbajtësit e dollomave, më është dukur një vathë ku blegërijnë ditë e natë, mbështetur pas njëri-tjetrit, më të mirat e dhenëve të pushtuar nga një panik i tmerrshëm, që shtrijnë qafën dhe lëpijnë dorën dhe thikën që i therin. Të tjerët nga frika se mos kalojnë në hell dhe përpihen nga flakët e përjetshme, të tjerët nxitojnë të theren për të kullotur ndër shekuj barin e pavdekshëm pranveror.

Por qënia njerëzore e vërtetë nuk është dele, as qen, as stan, as ujk, as bari; ajo është mbret që mbart me vete mbretërinë e tij dhe shkon, kushedi se ku, që arrin në buzë të greminës, heq nga koka dhe flak kurorën prej letre, zhvishet nga mbretëria e tij dhe si një zhytës, i zhveshur, bashkon këmbët dhe duart dhe hidhet me kokë në kaos dhe zhduket. A do të më jepet mundësia të përballem me greminën, me këtë sy të qetë, të patrembur.

A keni dëgjuar ndonjëherë të ngrihet nga toka një klithmë aq krenare sa të përçmojë shpresën? Vetë Niçja është trembur një çast, ka parë ndryshimin e përjetshëm, një martirizim pa fund dhe ka ndërtuar me frikën e tij një shpresë të madhe, një shpëtimtar të ardhshëm, mbinjeriun, shfaqej atëherë një parajsë, një refleks i aftë të gënjente njeriun fatkeq dhe të ndihmonte atë të duronte jetën dhe vdekjen.

I SËMURË NË VJENË

Trupin e kisha shumë të lodhur, shpirti ishte në një gjendje të ti
llë të mbingarkuar, sa në vagonin ku udhëtoja kisha mbyllur syte
dhe nuk ngrija as qepallat për të parë vendet ku kaloja. Harku ishte
tendosur aq fort sa unë dëgjoja tashmë brenda meje nga njëri tëmth
tek tjetri, një tel që kërciste aq fort sa gati këputej.

Tëmthat më buçisnin, venat në qafë rrihnin me forcë, ndieja
forcën time të derdhej nga trutë, nga veshkat, nga kyçet dhe të
humbiste. Ja vdekja, pra, mendoja: i qetë, shumë zemërdhemshur,
sikur futesh në një banjë të ngrohtë dhe të hapen venat... Një g.ua,
me një të porsalindur në krahë, hapi portën për të hyrë në komparti-
ment ku unë isha shtrirë fare i vetëm; më pa dhe përnjëherë mbylli
derën e trembur dhe iku. - Koka ime tashmë duhet të jetë bërë kaf-
kë - thashë, kjo e ka trembur atë grua; ajo është akoma e lumtur që
vdekja nuk më ka goditur shpirtin, si të ka goditur ty, mësuesi im...

Kur arritëm në Vjenë, mblodha gjithë forcat për të zbritur nga
treni e shkova tek një kioskë, përballë meje, për të blerë një gazetë.
Por rrëshqita, u përplasa tek një shtyllë hekuri dhe u shtriva përtokë
i zalisur.

Nuk më kujtohet më asgjë; kur hapa sytë, gjendesha në një sallë
me një radhë krevatesh; ishte natë dhe një dritë e vogël blu rrinte
ndezur mbi mua; kokën e kisha të mbështjellë me pambuk dhe fa-
sho. Një hije blu kaloi qetësisht ndërmjet krevateve, me dy krahë
të mëdhenj të bardhë rreth tëmthave. U afrua, vendosi dorën e fres-
kët, delikate, mbi puls, buzëqeshi: Fli, më tha ëmbëlsisht. Mbylla
sytë dhe më kapi gjumi. Një gjumë i thellë, i trashë e i ngjeshur; më
dukej se isha zhytur në plumb të shkrirë, të ngrohtë; këmbët dhe
duart më ishin rënduar dhe nuk mund t'i lëvizja, sikur krahët e
shpirtit tim ishin ngjitur.

Gjithë koha që kalova në krevatin e sëmundjes sime, m'u duk si
një gjumë i thellë; gjatë disa ditëve unë nuk pranova të hapja gojën

hqja. Ishte e pamundur të çohesha, të lëvizja, e ndieja se fundose-
gjithnjë e më shumë, në fillim deri në mes, pastaj deri në gjoks,
në grykë, në një baltë të butë, të ngrohtë, që mbante erë gjethesh
kalbura. Kjo duhet të jetë vdekja.

Herë pas here ngrija kokën nga fundi i humnerës, shpirti ndriçohej
rish, thërrisja infermieren; ajo vinte me vrap, me krahët e bardhë
tëmthat, dhe sillte letër dhe laps për të shkruar. Shpirti punonte,
zistonte për të mos u zhytur në baltë dhe unë e kisha bërë zakon
thërrisja infermieren, t'i thosha ndonjë fjalë, atë që ngrihej nga
osi, një hai-kai dhe ajo e shkruante. Shumë nga këto hai-kai kanë
humbur, më vonë kam vendosur të tjera në shkrime, kur dilja nga
balta e vdekjes, motra më merrte dorën, buzëqeshte: - Jam gati! -
thoshte, vendoste letrën mbi gjunjë, më kujtohen duart e saj elegante
e të bardha, dhe shkruante. Unë mbyllja sytë dhe diktoja:

"Përshëndetje njeri, gjel i vogël me pupla, që qëndron mbi dy
putrat e tua! Është e vërtetë pa ty nuk të besojnë: në qoftë se ti nuk
këndon në mëngjes, dielli nuk del".

Infermierja qeshte: - Këto i shpikni kur jeni në ethe! - thoshte.

- Shkruaj! "Në zemrën e Zotit fle një krimb që ëndërron se nuk
ka Zot".

Shkruaj! "Në qoftë se hap zemrën time do të gjesh aty një mal
të thepisur dhe një njeri të vetëm që e ngjit!"

- Akoma edhe këtë tjetrën.

"Në qoftë se ti lulëzon në dimër, bajame pa tru, do të të përvëlojë
dëbora. - S'ke ç'i bën ajo më djeg çdo pranverë! - i përgjigjet bajamja ".

- Mjafton, mjafton për sot, më thoshte motra duke më parë të
zbehem.

- Jo, jo, akoma edhe këtë:

"Më pëlqen, të shoh shpirtin të trokasë në qiell e të lypë, dhe
Zoti të mos ia hapë portën për t'i dhënë një copë bukë".

- Mjafton! Mjafton! - këmbëngulte infermierja.

- Jo, jo, akoma edhe këtë, që ta mësojnë atje në Greqi, në rast se
unë vdes: "Kudo ku shkoj, kudo ku ndalem, mbaj me dhëmbë, si
një gjethe dafine, Greqinë".

Mbyllja sytë, tëmthat më ishin zbrasur krejt.

- Jam i lodhur, motër, pëshpërisja dhe bija në baltë.

Gëzimet dhe aventurat e jetës sime, qëniet që kisha dashur, ven-

det që kisha parë, kalonin si imazhe në shpirtin tim, ndaleshin [illegible] çast, rralloheshin dhe zhdukeshin, imazhe të tjera ngjiteshin, ndonjë herë nga tëmthi im i majtë, pastaj nga tëmthi i djathtë sipas erës që frynte...

Një ditë, në ethe, m'u kujtua virgjëresha Krisoskalitisa, virgjëresha me Hapa të Artë, manastiri kretan që zotëron detin e Libisë. Çfarë ditë e mrekullueshme, çfarë diell i ngrohtë pranveror, sa shumë shkëlqente deti që shtrihej në Barbari! Igumeni i fortë, i shkurtër e topolak, me mjekrën e bardhë, mustaqet të shtrira si të luftëtarëve, ishte plot humor, shpirti i shkëlqente. Na shëtiste dhe tregonte në qimitiron e manastirit, varret e murgjëve.

Unë nuk doja më të shëtisja nëpër varre, bëra një veprim sikur po kthehesha; igumeni më kapi për krahu dhe më shtrëngoi sa më dhembi.

- Eja, gazmori im i vogël, më tha duke qeshur, mos ki frikë. Ai gjithmonë thotë se njeriu është një kafshë që mendon për vdekjen. Ndërkaq unë them jo: Njeriu është kafsha që mendon për pavdekësinë. Eja ta shikosh!

Ai ndalet, mos kini frikë, fëmijë, afrohuni; ai është akoma bosh por do të mbushet. Qeshi me të madhe; e kishte hapur vetë me kazmë, në shkëmb, madje kishte përgatitur edhe gurin e varrit.

- Shikoni, atë që kam gdhendur sipër, na thirri. Përkuluni pak, mos kini frikë, lexoni. U përkul, fshiu dheun nga shkronjat dhe lexoi: "Hej! Vdekje, unë nuk kam frikë prej teje!" na pa dhe qeshi fort:

- Përse të kem frikë nga pleqëria e fshehur? Është një mushkë, të cilën do ta shaloj që të më shpjerë tek Zoti.

Unë besoj se orët e etheve janë ndoshta ndër orët më të pasura të njeriut, midis më të lirave; ato janë të pangarkuara me konceptin e kohës, të hapësirës, dhe të arsyes.

Kur dola nga spitali dhe pashë përsëri dritën, ishte muaji maj. Nëpër parqe kishin çelur jargavanët, gratë kishin veshur fustane me lule, të tejdukshme, të rinjtë, djemtë e vajzat flisnin me zë të ulët, sikur thoshnin sekrete të mëdha, nën pemët që kishin çelur gjethe të reja. Atë mbrëmje që dola, frynte një puhizë e lehtë, që më sillte pranë parfumin e flokëve të grave dhe të fytyrave të tyre të pudrosura. - Ja toka, - i thosha vetes, ja bota e parë nga lart, është kënaqësi e madhe të jetosh dhe të kuptosh se pesë shqisat funksionojnë mirë,

portat nga të cilat hyn bota, e të thuash: Toka është e bukur, më pëlqen.

Provoja emocion të madh dhe kënaqësi të rrallë për botën e lame diell; sikur po lindja me mundim në atë botë: Kisha zbritur çast në botën e të vdekurve, kisha parë tmerrin e saj, isha ngritur nervozizëm, kisha hapur sytë, dhe duke gjetur dritën familjare të dashur, ecja nën pemë dhe dëgjoja të qeshurat dhe bisedat e rezve.

Ecja ngadalë, gjunjët më dridheshin akoma, një trullosje e ëmbël, mjegull mëngjesore, plot ngjyra, e butë, më mbështillte shpirtin; prapa kësaj mjegulle unë shihja botën, të pjesshme, si në ëndërr. M'u kujtua një ikonë që kisha parë një ditë, nuk di në ç'kishë. Piktura shte ndarë në dy kate: Poshtë shën Gjergji, flokëverdhë, i fuqishëm, hipur mbi kal të bardhë, i papërmbajtur, që ngulte ushtën mbi bishën e tmerrshme e cila rrotullohej përqak vetes, shkumëzonte, hapte gojën gjak të kuqe për ta kafshuar. Edhe lart zhvillohej e njëjta luftë por shën Gjergji, kali dhe kafsha ishin bërë njësh nën një re të lehtë, gati për t'u shpërndarë e humbur në erë. Ishte pikërisht ky kat i sipërm i pikturës së botës që unë shihja prapa mjegullës duke ecur, me gjunjë të këputur, nëpër parqet dhe rrugët e Vjenës. Trembesha se mos nuk frynte erë dhe nuk do ta shpërndante.

Si mund ta merrja me mend se disa ditë më vonë kjo erë do të frynte dhe do ta shpërndante!

Vjena është qytet i këndshëm dhe i magjishëm, për të kujtohesh si për një gura të dashur. E bukur, mendjelehtë, koketë, që di të vishet, të shkëlqejë, të jepet, të jetë besnike, pa urrejtje, pa dashuri. Ajo nuk ecën, por vallëzon, ajo nuk thërret por këndon, shtrirë mbi brigjet e Danubit, ajo ka të pranishme shiun, borën, ngrohet në diell; gjatë ditëve të para të kthimit tim në jetë, unë u dëfreva me këtë qytet gazmor dhe së bashku me të, edhe me dritën, me parfumin e tokës dhe bisedat e njerëzve; me ujin e freskët, me bukën e shijshme, me frutat... Mbylla sytë, mbi ballkonin e dhomës sime, dhe dëgjoja zhurmën e botës; më ngjante me një koshere plot bletë punëtore, arrëza dhe mjaltë; era pranverore, si një dorë e butë dhe e freskët mbi ballin tim.

Por pak nga pak, sa më shumë që trupi më shëndoshej dhe shpirti merrte frerët, gjithë ai gëzim më dukej i sipërfaqshëm, shumë i ko-

të dhe në kundërshtim me kërkesat e mia të thella. Më dukej se dikush i guduliste dhe gjithë burrat e gratë i bënte për të qeshur. Atëherë mendoja se njeriu është një kafshë metafizike dhe të qeshurit, moskokëçarja, këngëza, ishte një tradhëti dhe paturpësi. I ngjaja babait i cili, pa e ditur përse, e konsideronte të qeshurën një paturpësi; megjithatë, unë e dija shkakun, ishte i vetmi hap që djali kishte bërë më tej se babai.

Tek unë filloi të tingëllonte gjithmonë më i pastër, zëri i ashpër, i pamposhtshëm, i profetit tragjik që e doja shumë: "Ti nuk ke turp, - pëlliste brenda meje ai zë, - ja truri i luanit që të kam dhënë për të ngrënë. Nuk të kam urdhëruar të mos e pranosh ngushëllimin! Vetëm sklevërit dhe frikacakët shpresojnë, fute mirë në kokë, bota është një grackë e djallit, një grackë e Zotit, mos prano të kapesh nga lakmia; më mirë vdis nga uria!" Dhe shtonte me zë të ulët, në konfidencë: - Unë nuk munda, u zhduka pa lënë gjurmë, përpiqu të jesh i aftë për atë!

SHFAQJA E BUDËS

Në kohë të tjera, ky zë ngrihej si një vërshëllimë plot ironi: Çfarë ke që fryesh si gjel dhe shpall se kush është më e vështirë? Këtë dua! Kush është feja që nuk pranon ngushëllimin? Me këtë puqem! Ndërsa ti, frikacak, shkon e dehesh fshehtas në tavernat e shpresës, nëpër kisha; përkulesh dhe admiron Nazaretë, shtrin dorën dhe lyp: - Zot, më shpëto! Qëndro i vetëm në rrugën tënde, ec, shko deri në fund; në fund do të gjesh greminën, shikoje. Është e vetmja gjë që të kërkoj. Shikoje greminën pa u pushtuar nga paniku. Nuk të kërkoj asgjë tjetër. Këtë kam bërë unë, shpirti m'u lëkund; por ti mbaje shpirtin të palëkundur, kalomë mua!

Zemra e njeriut është një mister i errët, e pamundur të sundohet. Ajo është një shtëmbë e shpuar, me grykën gjithmonë hapur, dhe sikur gjithë lumenjtë e tokës do të hidhen në të, ajo do të ngelet akoma bosh dhe e etur. Shpresa më e madhe nuk e ka mbushur, a do ta mbushë dëshpërimi më i madh?

Drejt kësaj më shtynte zëri i pamposhtshëm. E parandjeja se të kujt ishin gjurmët që, ai përpiqej, të më bindte të ndiqja. Ishin ato të një njeriu që ecte me hap të vendosur, pa u ngutur me një ritëm konstant drejt greminës. - Ai është, - më thoshte zëri, - ai është Shëlbyesi i fundit; Ai e çliron njeriun nga shpresa, nga frika, nga zotët; ndiq atë! Unë nuk kam mundur, nuk kam patur kohë. Erdhi Mbinjeriu, unë u sundova nga një shpresë e madhe dhe u gënjeva. Tani nuk më ka mbetur shumë kohë për ta larguar.

Por ti largoje Mbinjeriun, Nazaretin, mbërri atje ku unë nuk kam patur kohë të mbërrij - në lirinë ekstreme!

Kështu, ai zë më shtynte pa mëshirë, në këmbëngulje. Pak nga pak, pa shumë zhurmë, ngjitej tek profeti i shëlbimit total, fundi i qënies sime po bëhej *zambak** ai ishte ulur mbi këtë lotus, nën kë-

---

* *simbol i hinduizmit*

mbët e gdhendura dy rrota mistike, me gishtat e duarve kryqëzuar, me një shakullor të zi si një sy i tretë, ndërmjet dy vetullave; buzëqeshja mikluese, e shqetësuar, shtrihej nga buzët e holla deri tek veshët e mëdhenj, e te balli dhe nga kjo shkëmbishte e lartë rrëshqiste, si mjaltë, i mbështillte gjithë trupin dhe arrinte deri te këmbët. Dy rrotullat nën këmbë rrotulloheshin sikur donin të shkëputeshin.

Buda! Buda! Kishte disa vjet që kisha lexuar doktrinën e tij kreinare dhe të dëshpëruar, por e kisha harruar. Besoj, se akoma nuk isha pjekur, dhe nuk i kisha kushtuar vëmendje. Më dukej si një zë magjik si një magjistar që vinte nga thellësitë e Azisë, nga një pyll i errët, plot gjarpërinj dhe orkide, me aromë dehëse; por nuk kishte arritur të më trulloste. Një zë tjetër familjar dhe plot ngrohtësi më thërriste dhe unë ecja me bindje ta takoja... Por tashmë, ka tingëlluar përsëri, midis shpërthimeve të të qeshurave të këtij qyteti, flauti magjik, magjistari! Mbyllja sytë për ta parë përsëri, më familjar tashmë, sikur nuk kishte vdekur kurrë tek unë, por që ishte mbuluar nga trofeja kristiane e Gjyqit të fundit!

Ushqimi i luanit, i profetit dishepull, i Luciferit, sigurisht më kishte fortifikuar. Kisha filluar të kisha turp që isha përpjekur të mbuloja greminën me një vello laramane; nuk guxoja ta shihja ballas, ashtu siç ishte, lakuriq e të shëmtuar. Krishti qëndronte ndërmjet greminës dhe meje, kishte shtrirë krahët, plot mëshirë, dhe nuk më linte ta shihja nga frika se mos trembesha.

Unë provokoja, torturoja shpirtin; ai donte të përzihej me mishin, të kishte edhe ai duar për të prekur e buzë për të puthur botën, nuk e shikonte më si armik trupin që e mbështillte, por pajtohej me të, udhëtonte bashkë me të, dorë për dore për të mos u ndarë veç në varr. Shpirti e donte, e donte shumë, por unë nuk e lejoja. Dhe kur them unë, kush ishte pra në të vërtetë? Një demon brenda meje, një demon i ri, Buda - Dëshira, - klithte ai, - është një flakë; dashuria është një flakë; virtyti, shpresa, vdekja, Parajsa, Ferri janë flakë; vetëm një gjë është dritë: heqja dorë nga flaka. Prej flakëve që të djegin, bëj dritë; pastaj fryji dhe shuaj dritën.

Kur punët e ditës kanë mbaruar, dhe hijet bien mbi rrugicat e fshatit hindù, mbi çatitë e shtëpive dhe mbi gjokset e njerëzve, një yshtës plak, del nga kasollja, bredh gjithë fshatin, shkon portë më portë, duke luajtur një melodi të ëmbël si një këngë djepi, si një

melhem që shëron shpirtrat; është *melodia e tigrit* siç e quajnë, që mjekon plagët e ditës. Për ta dëgjuar më qartë atë melodi unë u mbylla në dhomë; përkulur ditë e natë, mbi libra të mëdhenj, studioja fjalët dhe mësimet e Budës.

"Në lulen e moshës, me flokët e zes e kaçurrela, me një gëzim të madh të rinisë së lumtur, me krenarinë e parë të forcës së burrit, rruajta kokën, dhe vesha dollomanë e verdhë, hapa derën e shtëpisë sime dhe hyra në shkretëtirë..."

Lufta e asketit filloi: "Krahët më janë bërë si kallama të thatë, ditë e natë, ushqehesha vetëm me oriz, dhe mos mendoni se ai ka qenë më i madh se orizi i sotëm. Ai ishte i njëjtë me atë që është sot. Beli im ish holluar si këmbë deveje, kockat më kërcisnin si drurët e një shtëpie të kalbur, sytë shkëlqenin si ujërat në fund të pusit. Koka më ishte bërë si kungull që thahet në diell e kërcet.

Megjithatë, me këtë rrugë të ashpër të ngjitjes nuk arrihej lehtësimi. Buda zbret në fshat, ha e pi, ulet nën një pemë, i qetë, as i trishtuar as i gëzuar dhe thotë: "Nuk do të ngrihem prej këtej, nuk do të ngrihem prej këtej po nuk gjeta lehtësimin. Me shikim të qartë e shpirt të pastër, ai pa qëniet që ngriheshin nga toka dhe zhdukeshin, pa kotësinë, pa zotët që shpërndaheshin si retë në qiell, pa gjithë ciklin e gjërave dhe u mbështet pas pemës: sapo u mbështet, lulet e pemës filluan t'i binin mbi kokë dhe mbi gjunjë - ndërsa mbi shpirtin e tij lajmi i madh.

U kthye në të majtë, u kthye në të djathtë, prapa; Ishte ai që bulurinte, brenda kafshëve, brenda njerëzve, brenda zotëve. Atë e pushton dashuria, dashuria dhe mëshira për veten e tij, që shpërndahet dhe lufton nëpër botë; gjithë vuajtja e tokës, gjithë vuajtja e qiellit ishin hidhërimet e tij.

"Si mund të jesh i lumtur brenda këtij trupi të vajtueshëm. - Një kufomë gjaku, kocke, mishi, fare, djerse, lotësh dhe papastërtish? Si mund të jesh i lumtur brenda këtij trupi ku qeverisin dehja, urrejtja, gënjeshtra, frika, ankthi, uria, etja, sëmundja, pleqëria dhe vdekja? Gjithçka shkon drejt shkatërrimit, barërat, insektet, kafshët, njerëzit: shiko prapa teje ata që nuk ekzistojnë më; shiko përpara teje ata që nuk ekzistojnë akoma. Njerëzit thërmohen ngadalë, ylli polar lëkundet dhe perënditë zhduken..."

Mëshira, mëshira, ja udhëheqësja e sigurt e marshimit Budist.

Me mëshirën, ne lirohemi nga trupi ynë, shëmbim trarët e çatisë bashkohemi me hiçin. Kështu bëhemi të gjithë njësh, dhe kjo është një vuajtje, ne duhet ta lehtësojmë atë. Edhe në qoftë se është një pikë shiu që vuan, unë vuaj bashkë me të.

Në shpirtin tim ngrihen të katër *shenjtët e mëdhenj të vërtetë*. Kjo botë është një rrjetë, ku ne jemi kapur, vdekja e së cilës nuk na lë, sepse ne do të rilindim. Triumfojmë mbi etjen, çrrënjosim dëshirën, zbrazim fundin e qënies sonë! Mos thoni: "dua të vdes. Nuk dua të vdes." Thoni: "unë nuk dua asgjë." Ngrini shpirtin tuaj mbi dëshirën dhe shpresën - dhe atëherë ju mund të hyni, akoma të gjallë, në prehjen e inekzistencës, dhe me krahun tuaj do të ndaloni rrotën e lindjeve.

Kurrë fytyra e Budës nuk ishte ngritur përpara meje me një dritë aq të madhe.

Kohë më parë, kur identifikoja *nirvanën** me pavdekësinë, unë shikoja Budën, kryerendësin e shpresës, që udhëhiqte ushtrinë e tij kundër lëvizjes së botës. Atëherë unë kuptova të vërtetën: Buda e shtyn njeriun të pajtohet me vdekjen, të dojë të pashmangshmen, ta vendosë zemrën e tij në harmoni me rrjedhjen e përgjithshme, ta shohë lëndën dhe shpirtin në vazhdimësi, të bashkohet, të krijojë, të zhduket, dhe të thotë:

"Kjo është ajo që dua!"

Nga të gjithë njerëzit që ka krijuar toka, Buda shkëlqen në majë, shpirtkulluar. Pa frikë e trishtim, plot mëshirë e arsye, ai ka shtrirë dorën, me një buzëqeshje të thellë, dhe hap rrugën e shpëtimit. Ata që vijnë pas, rrokullisen, i nënshtrohen lirshëm të pashmangshmes, duke u hedhur si dhitë që shkojnë të pijnë. Jo vetëm njerëzit, por gjithë qëniet, njerëzit, kafshët, pemët... Ai nuk zgjedh, si Krishti, vetëm njerëzit: Buda ka mëshirë për të gjithë dhe i shpëton të gjithë.

I vetëm, pa ndihmën e fuqive të padukshme, ai ndjen në zemrën e tij botën të krijohet dhe të zhduket. Në kafkën e djegur nga dielli, eteri u kondensua, u bë mjegullnajë, mjegullnaja u bë yll, ylli u bë farë e formoi një lëvozhgë e ju dha lindjen, pemëve, kafshëve, njerëzve, zotëve, pastaj në kokën e tij u fut zjarri dhe gjithçka u largua në formë tymi dhe u zhduk.

---

*- *shuarje e dëshirës për lindjet - tek budistët*

Gjatë shumë ditëve dhe javëve unë jetova i zhytur në këtë aventurë të re. Çfarë gremine, si zemra e njeriut! Sikur shpërthen, gëzohet dhe merr rrugë të papritur! Gjithë ajo dëshirë përvëluese, gjithë ai vrull drejt pavdekësisë, mos më çuan në vdekjen e kryer? Apo vdekja dhe pavdekësia nuk ishin veç një?

Pas shtatë vjet lufte për të gjetur lehtësimin, Buda u ngrit që po-
shtë pemës, shkoi mbi sheshin e një qyteti të madh, u ul këmbëkryq
dhe filloi të predikojë atë që kishte gjetur, ata që nuk besonin, treg-
tarë, luftëtarë, zotërinj, që e rrethonin dhe talleshin me të, ndjenë
pak nga pak se thellësia e qënies së tyre po zbrazej; ata kështu po
pastroheshin pakuptuar nga dëshirat e tyre, pakuptuar e dhe rrobat
e festës që kishin veshur, të bardha, blu, të kuqe, bëheshin pakuptuar
fundi i qënies sime dhe shpirti po vishej me një dolloma të verdhë
të verdha si dollomaja e Budës. Unë e ndieja se kështu po zbrazej

Një natë kur dola për të shëtitur në një park vjenez, në Prater,
një vajzë, një motër e stolisur, m'u afrua nën pemë. Pata frikë. Ajo
lëshonte një aromë të fortë vjollce dhe nën ndriçimin e llambave
unë dallova sytë e saj blu, buzët e lyera, gjoksin gjysmë mbuluar.

- Eja me mua... - pëshpëriti duke ma bërë me sy.

- Jo! Jo! - thirra, sikur isha në rrezik. - Përse? - më tha dhe më lë-
shoi krahun.

- Nuk kam kohë, motra ime, - iu përgjigja, - më fal!

- Ti je budalla? - tha vajza dhe më pa me një shikim plot mëshirë.

- Ti je murg? Askush nuk na shikon.

Gati iu përgjigja: "Na shikon Buda" por u përmbajta. Ndërkohë,
vajza kishte dalluar një tjetër të vetmuar dhe vrapoi ta kapë. Mora
frymë thellë, sikur kisha shpëtuar nga një rrezik dhe nxitova për në
dhomën time.

Isha përpirë nga Buda. Shpirti më ishe bërë *heliotrop*i* verdhë.
Buda ishte dielli dhe unë ndiqja ngritjen e tij, kalimin midis qiellit
dhe zhdukjen... Ujërat flenë por shpirtrat jo, më ka thënë një ditë
një plak nga Rumelia; megjithatë më dukej se gjatë atyre ditëve
shpirti im po flinte i qetë në gjakftohtësinë budiste. Si ajo që sheh

**lloj bime*

ndërr, e mirë apo e keqe, e nuk të jep as gëzim, as trishtim, sep-
e di që është ëndërr dhe kur të zgjohesh gjithçka do të zhduket,
shtu e shikoja fantazmagorinë e botës që kalonte para syve të
pa gëzim, pa frikë, gjakftohtë.

Për të penguar vizionin që të shpërndahej, për të forcuar me fja-
lehtësimin e përkryer, që shpirti im e ndjente në mënyrë të duk-
hme, unë nisa të shkruaj një dialog ndërmjet Budës dhe dishepullit
tij të dashur Ananda.

Barbarët kishin zbritur nga malet dhe kishin bllokuar qytetin.
Buda ishte ulur këmbëkryq nën një pemë me lule dhe buzëqeshte:
Ananda kishte mbështetur kokën mbi gjunjtë e Budës dhe kishte
mbyllur sytë që fantazmagoritë e botës të mos i turbullonin mendi-
min; rreth tyre një turmë e madhe që donin të bëheshin dishepuj,
qëndronin në këmbë dhe dëgjonin fjalë shpëtimtare. Por kur mësuan
se barbarët kishin nisur luftën u alarmuan.

Thërrisnin: - Çohu, vendosu në kryen tonë, dhe shkojmë të luftoj-
më barbarët, pastaj na trego të fshehtat e lehtësimit.

Buda tundi kokën: - Jo, - tha, - nuk shkoj.

- Mos je i lodhur? - thirrën të mërzitur; apo ke frikë?

- Unë përfundova, - i përgjigjet Buda, dhe zëri i tij pluskonte pe-
zull përtej lodhjes e frikës. Përtej atdheut.

- Shkojmë atëherë me të tjerët të mbrojmë tokat e Prindërve ta-
në! - thërrisnin ata dhe u kthyen drejt qytetit.

- Ju keni bekimin tim! - thotë Buda, dhe ngriti dorën e i bekoi.
Unë jam atje ku jeni ju, unë atje isha dhe u ktheva. Këtu nën këtë
pemë të lulëzuar do të jem e do të pres kthimin tuaj. Vetëm atëherë,
kur ne të gjithë të jemi të ulur nën të njëjtën pemë të lulëzuar, çdo
fjalë që do të them, çdo fjalë që ju do të thoni do të ketë për të gji-
thë të njëjtin kuptim; tani është akoma herët. Por po ju them edhe
një gjë tjetër, të cilën duhet ta kuptoni, ne nuk flasim të njëjtën gju-
hë. Udhë të mbarë, pra, do të jem i lumtur t'ju shoh përsëri!

- Nuk po kuptoj asgjë, - thotë Sariputi; - ti akoma na flet me nën-
kuptime.

- Do ta kuptoni kur të ktheheni, Sariput. Ju thashë, tani është
shumë herët. Ka disa vjet që unë shikoj jetën dhe vuajtjen e njeriut,

disa vjet që e bluaj këtë. Kurrë ndonjëherë nuk kam arritur, shoku, në një liri kaq të madhe. Përse? Sepse unë kam marrë një vendim të madh.

- Një vendim të madh - mjeshtër? - thotë Ananda, dhe ngriti kokën. U përkul, puthi këmbën e shenjtë të Budës; - çfarë vendimi?

- Unë nuk dua t'ia shes shpirtin tim Zotit, atij që ju të gjithë e quani Zot, nuk dua t'ia shes shpirtin tim Tunduesit; Unë nuk dua t'i shitem askujt. Unë jam i lirë! Është i lumtur ai që i shpëton kthetrave të Zotit dhe të Tunduesit, ai dhe vetëm ai është I lehtësuar.

- Ai është i lehtësuar, nga se? - thotë Sariputi, dhe ballin e tij e mbuluan djersët; - është lehtësuar nga se? Mbi buzët e tua ngeli një fjalë dhe ajo po të përvëlon.

- Ajo nuk më djeg, Sariput, por më freskon; nuk e di, më falni, nëse ju keni aq forcë, sa ta dëgjoni pa u tmerruar.

- Mjeshtër, - thotë Sariputi, ne po nisemi në luftë, ndoshta nuk do të kthehemi më; ndoshta nuk do të të shikojmë më; na i shpjego këtë fjalë të fundit; ai është lehtësuar nga se?

Ngadalë, rëndë, si një trup që bie në greminë, ranë nga buzët e shtrënguara të Budës fjalët:

- Nga lehtësimi.

- Nga lehtësimi? - ai është lehtësuar nga lehtësimi? - thirri Sariputi. - Mjeshtër nuk po kuptoj asgjë!

- Më mirë kështu, Sariput, më mirë kështu. Në qoftë se do ta kuptoje do të ishe tmerruar. Megjithatë, dije, shok, atje është liria ime. Unë jam lehtësuar nga lehtësimi!

Ai heshti; por tashmë nuk mund të përmbahej:

- Dijeni, çdo liri tjetër është skllavëri; në qoftë se unë do të rilindja, do të luftoja për këtë liri të madhe: për lehtësimin e lehtësimit. Por kaq është e mjaftueshme; është akoma herët, për këtë do të flasim kur ju të ktheheni nga lufta, në qoftë se do të ktheheni. Lamtumirë!

Mori frymë thellë, pa nxënësit e tij që hezitonin dhe buzëqeshi.

- Përse qëndroni këtu? - thotë; detyra juaj është të luftoni akoma. Shkoni në luftë. Lamtumirë!

- Ne shpresojmë të shihemi, mjeshtër, - thotë Sariputi; shkojmë, Zoti na ndihmoftë!

Ananda qëndronte pa lëvizur; Buda e fiksoi me shikim, i kënaqur.

- Unë do të qëndroj me ty, mjeshtër, - i thotë, dhe u bë flakë i kuq.

dashur Ananda, - thotë Buda, e ke nga frika?

- Nga dashuria, mjeshtër.

- Dashuria nuk mjafton më, shoku im besnik, nuk mjafton më.

- E di mjeshtër; gjatë kohës që flisje unë pashë një zjarr që lëpinte uzët e tua.

- Nuk ishte zjarr, ishte Fjala. Ti e kupton, miku im besnik, këtë fjalë mbinjerëzore?

- E kuptoj, besoj; prandaj qëndrova pranë teje.

- Cfarë ke kuptuar?

- Ai që thotë se ekziston një lehtësim është skllav; sepse në çdo ast ai peshon çdo fjalë, çdo veprim të tij dhe dridhet. A do të shpëtoj? Apo nuk do të shpëtoj? A do të shkoj në qiell? Apo do të shkoj në Ferr? Si mund të jetë i lirë një shpirt që shpreson? Ai që shpreson, trembet nga kjo jetë, e tremb jeta tjetër, qëndron pezull në ajër dhe pret fatin, ose mëshirën e Zotit.

Buda vendosi dorën mbi flokët e zinj të Anandës.

- Qëndro, - i thotë.

Qëndruan ashtu të heshtur për një kohë të gjatë, nën pemën e lulëzuar. Buda përkëdheli ngadalë, me dashuri, flokët e dishepullit të tij të dashur.

- Shpëtim do të thotë: të shpëtosh nga gjithë shpëtimtarët; është liria supreme, më e larta, ku njeriu merr frymë i lehtësuar. Ti mund ta durosh?

Ananda kishte ulur kokën dhe nuk fliste.

- E kupton tani cili është çlirimtari i përkryer?

Heshti pak, pastaj pas një çasti, duke luajtur midis gishtave, me një lule që kishte rënë nga pema tha:

- Është ai që do ta lehtësojë njeriun nga lehtësimi.

Me gërmat e Alfabetit unë kisha shtruar kalldrëmin-jo më me gurë dhe gëlqere-rrugën e re që çonte tek lehtësimi. Tashmë e dija. Unë e dija, dhe botën e shihja pa frikë, me qetësi, sepse nuk mund të gënjehesha më. U përkula mbi dritare, shikoja burrat, gratë, veturat, magazinat, mbushur me ushqime, fruta dhe libra dhe buzëqeshja; Gjithë kjo nuk ishte veç një re e përhime, një fllad i lehtë ngrihej dhe e shpërndante. Fuqia e Tunduesit i kishte krijuar, uria dhe etja

e njeriut i ruante, një orë, dy orë, aq sa të mundnin, përpara se t'i shpërndante.

Dola në rrugë, u përzieva me një turmë njerëzish që vraponin. Vrapoja dhe unë me ata, nuk më trembte më asgjë; janë pika të vogla vese, mendoja, një mjegull vese, përse t'u trembem? Shko më ta për të parë se ç'do të bëhen... Arritëm përpara një kinemaje, plot drita të kuqe, blu, të gjelbra. Hymë brenda. U ulëm në ca kolltuqe të kadifenjta, në fund gjendej një çarçaf i ndritshëm mbi të cilin kalonin me nxitim hije të shqetësuara. Ç'bënin ata? Ata vrisnin, vritesha me njëri-tjetrin, ringjalleshin. Pranë meje ishte ulur një vajzë, unë ndjeja gjoksin e saj që ngrihej dhe ulej, kur merrte frymë ndjehej një aromë kanelle, herë pas here, gjuri i saj prekte gjurin tim; dridhesha por gjurin nuk e largoja. Një çast ajo u kthye nga unë, më pa, dhe në gjysmëhijen e sallës m'u duk se më buzëqeshi. Kam patur shumë hije për të parë, prandaj çohem për të dalë; edhe vajza gjithashtu u çua. Tek porta ajo u kthye nga unë dhe më buzëqeshi. Nisëm të bisedojmë, hëna qëndronte sipër nesh, ne u drejtuam nga parku. Ishte verë, nata ishte e ëmbël si mjaltë; jargavanët lëshonin erë, disa çifte kalonin qetë e qetë, të tjerët shtrirë mbi lëndinë plekseshin. Një bilbil, mbi kokat tona, tulatur në jargavanë, filloi të këndojë, dhe zemra ime ndaloi. Nuk ishte zog, duhej të ishte një shpirt i keq.

Më dukej se e kisha dëgjuar atë zë, një ditë, duke u ngjitur në Psiloroti, në Kretë, dhe e dija se ç'thoshte... Shtriva dorën dhe e vendosa mbi flokët e vajzës. - Si të quajnë? - e pyeta. - Frida, - u përgjigj ajo duke qeshur. - Çfarë pyetje! Mua më quajnë femër.

Atëherë nga goja ime doli një fjalë e tmerrshme; ajo nuk vinte nga unë, ajo duhej të vinte nga stërgjyshërit e mi; jo nga babai, që femrat i neveriste, por nga ndonjë tjetër. Sapo e shqiptova më zuri tmerri, por ishte shumë vonë: - Frida, ti do të rrish sonte me mua?

Ndërsa vajza qetësisht:

- Jo sonte; nuk mundem; nesër mbrëma.

U çlirova; u ngrita shpejt, u ndamë. Me nxitim, mora rrugën e shtëpisë.

Atëherë ndodhi diçka e pabesueshme, por tani, unë nuk mund ta kujtoj pa u dridhur. Me të vërtetë shpirti i njeriut është plot fisnikëri, i pakorruptueshëm dhe mban në krahët e tij një trup që kalbet çdo ditë. Ndërsa hyja në shtëpi, dëgjoja gjakun që ngjitej në kokë,

shpirti më ishte kreshpëruar, ai e ndjente se trupi ishte gati të binte në mëkat, ishte ngritur me nervozizëm, plot përçmim dhe kundërshtonte me forcë duke mos e lejuar. Gjaku nuk pushonte së ngjituri e grumbullohej në fytyrë, dhe pak nga pak unë po kuptoja se buzët, faqet, balli po më enjteshin. Sytë më ishin mbyllur e veshur sa unë nuk mund të shihja. Shpejtova hapat, vrapova, u pengova, nxitova të arrija në shtëpi, të shihesha në pasqyrë, të dija se si isha bërë...

Kur, më në fund, mbërrita, ndeza dritën e u pashë në pasqyrë, lëshova një klithmë tmerri. Gjithë fytyra më ishte enjtur, isha shpërfytyruar frikshëm, sytë mezi shikonin ndërmjet masave të fryra të mishit të kuq. Goja ishte shndërruar në një vrimë dhe nuk mund të hapej. Përnjëherë mendova për vajzën. Frida; si mund ta takoj nesër në këtë gjendje? - përpilova një telegram: "Nesër nuk mundem, do të vi pasnesër", dhe u shtriva në krevat, i dëshpëruar. Çfarë është kjo sëmundje, mos vallë është lebra? Kur isha fëmijë, në Kretë, shikoja shumë lebrozë me fytyra të enjtura, të kuqe, që iu binin flokët dhe m'u kujtua tmerri që më shkaktonin ata, që më kish detyruar të thosha një ditë: "Në qoftë se do të isha mbret, do t'u varja nga një gur në qafë gjithë lebrozëve dhe do t'i hidhja në fund të detit." Ndërsa sot, i padukshmi, i vetmi i padukshëm, është kujtuar për fjalën time jonjerëzore dhe më ka dërguar, për t'më torturuar, sëmundjen e frikëshme?

Nuk mbylla sy gjithë natën, prisja me ankth që të lindte dita, duke menduar se deri të nesërmen në mëngjez do të isha shëruar, dhe herë pas here prekja fytyrën për të parë në se ulej apo jo. Në agim u hodha nga krevati, vrapova tek pasqyra. Një mbulesë e shëmtuar mishi ishte ngjitur mbi fytyrën time, lëkura kishte filluar të plasaritej dhe të lëshonte një lëng të verdhë; unë nuk isha më njeri, por një demon.

Thirra shërbëtoren për t'i dhënë telegramin; sapo hapi derën e më pa, lëshoi një klithmë dhe mbuloi fytyrën me duar; nuk guxonte të më afrohej. Mori telegramin dhe u largua. Kaloi një ditë, dy, tre; një javë, dy javë, dhe çdo ditë unë dërgoja të njëjtin telegram nga frika se mos vinte në shtëpi dhe më shihte.

"Sot nuk mundem, do të vij nesër". Nuk vuaja, por nuk mund të hapja as gojën për të ngrënë, vetëm pija qumësht, limonadë. Më në fund nuk mund të duroja më, kisha lexuar disa vepra të psiko-

analistit të famshëm, dishepullit të Frojdit, Vilhem Stekel, shkova ta gjeja, e merrja me mend, nuk e di përse, se këtë sëmundje, ishte shpirti im që ma jepte, se ishte ai fajtori.

Mësuesi i ditur pranoi të më rrëfejë. I tregova atij jetën time, i thashë se që nga adoleshenca ime kërkoja rrugën e lehtësimit, se si gjatë shumë viteve kisha ndjekur rrugën e Krishtit, porse kohët e fundit kulti i tij më dukej shumë i çiltër, shumë optimist, dhe se unë e kisha braktisur për të ndjekur rrugën e Budës...

Profesori qeshi. - Të kërkosh të gjesh parimin dhe fundin e botës është një sëmundje, më thotë. Njeriu normal jeton, është i gëzuar apo i trishtuar, lufton, martohet, bën fëmijë, pa humbur kohën duke pyetur prej nga, ku dhe përse... Por ju nuk i keni thënë të gjitha; diçka fshihni, zbrazini të gjitha.

I tregova se kisha takuar Fridën dhe se si ishim takuar. Profesori shpërtheu në një të qeshur të lehtë tallëse, e pashë i nervozuar. Fillova ta urrej atë njeri, sepse ai përpiqej të thyente në thellësinë time gjithë portat e fortifikuara, dhe të studionte të fshehtat e mia me një mënyrë të pasjellshme.

- Mjafton, mjafton! - më tha dhe filloi përsëri të zgërdhihet me një pamje qesëndisëse. Për aq kohë sa do të jeni në Vjenë kjo maskë do t'ju ngelet mbi fytyrë. Sëmundja juaj është sëmundja e asketëve, kështu e quajmë ne atë. Është shumë e rrallë në epokën tonë. Sepse sot, ku gjendet një trup që i bindet shpirtit? A e keni lexuar ju ndonjëherë Legjendën e praruar të shenjtorëve? Asketi linte shkretëtirën Tebaide dhe vraponte drejt qytetit më të afërt,sepse, demoni i epshit po e pushtonte dhe ai dëshironte të flinte me një femër. Ai vraponte, vraponte, por në portën e qytetit, në çastin kur po kalonte pragun, shikon i tmerruar se trupi i tij ishte mbuluar nga lebra. Ajo nuk ishte lebra, ishte pikërisht kjo sëmundje, e jotja. Si mund të takohej me një femër me atë fytyrë? Cila femër do të pranonte ta prekte atë? Kthehet duke vrapuar dhe shkon përsëri në vendin e tij në shkretëtirë duke ju lutur Zotit t'i falte mëkatin.

Dhe Zoti, thotë libri i shenjtorëve, e fali dhe ia hoqi lebrën nga fytyra. E kuptoni tani? Shpirti juaj - ai që ju i thoni shpirt i zhytur në vizionin e botës Budiste, e konsideron mëkat të madh, të flesh me një femër. Ajo nuk e lejon trupin të kryejë mëkat. Në epokën tonë, shpirtra të tillë, që përpiqen t'i imponohen mishit, janë të

rrallë. Në karrierën time shkencore unë kam takuar vetëm një rast të ngjashëm. Një vjeneze shumë e ndershme, shumë e devotshme, e donte shumë burrin; por ai ishte në luftë. Ndodhi që kjo zonjë njeh një burrë dhe bie në dashuri me të. Një natë ajo ishte gati t'i jepej atij; por papritur, shpirti i saj u revoltua, rezistoi, fytyra e gruas u ënjt e u bë si e jotja tani. E dëshpëruar, më gjeti mua; unë e sigurova: - Ju do të shëroheni kur të vij burri nga lufta.

Dhe kur, sapo burri iu kthye nga lufta, domethënë sapo u largua rreziku i mëkatit, fytyra e saj mori bukurinë e mëparshme. E njëjta gjë ndodh edhe me ju: Ju do të shëroheni kur do të lini pas Vjenën dhe Fridën.

Unë nuk e besova; u largova kokëfortë. "Këto janë tregimet blu të dijetarit, - thoshja me vehte, unë do të rri në Vjenë, do të rri dhe do të shërohem. Kështu qëndrova akoma edhe një muaj; maska nuk po më hiqej, ndërsa unë çdo ditë vazhdoja t'i dërgoja Fridës të njëtin telegram: "Sot nuk mundem, do të vij nesër." Por kjo e nesërme nuk po vinte kurrë, unë isha i mërzitur. Një mëngjes u ngrita, kisha marrë një vendim: do shkoja! Mora valixhen, zbrita shkallët, dola në rrugë dhe u drejtova drejt stacionit. Ishte mëngjes, frynte një erë e lehtë e freskët, punëtorë e punëtore vraponin në grupe drejt punës së tyre, duke qeshur, e duke ngrënë akoma nga një copë bukë. Dielli akoma nuk kishte zbritur, ecja me hap të lehtë, isha në humor, po zgjohesha bashkë me qytetin, dhe sa më shumë përparoja, ndjeja fytyrën të më lehtësohej, sytë të më liroheshin, të më hapeshin, buzët të më çënjteshin, fillova të vërshëllej si fëmijë. Era e freskët më rrihte fytyrën, si një dorë e dhembshur, si një përkëdhelje. Kur mbërrita në stacion e nxora nga xhepi një pasqyrë të vogël e u pashë në të, çfarë gëzimi, çfarë lumturie! Fytyra ime ishte çenjtur e tërë, kisha marrë pamjen e mëparshme. Demoni ishte larguar, isha kthyer një qënie njerëzore.

Prej asaj dite unë kuptova se shpirti i njeriut është një sustë e tmerrshme dhe e rrezikshme; një forcë e madhe shpërthyese që ne bartim me vehte, mbështjellë në mishin dhe në dhjamin tonë, pa e ditur. Më e keqja është se ne nuk duam ta dimë. Prandaj grykësia, paburrëria, gënjeshtra, janë të pafalshme: nuk mund të fshihemi

prapa mjerimit, - pas të ashtëquajturës pafuqi e njeriut. Në qoftë se ne jemi të padenjë, të keq, gënjeshtarë, është faji ynë; sepse ne kemi në vetvete një forcë të jashtëzakonshme dhe nuk guxojmë ta përdorim, sepse trembemi se mos na djeg. Ne e lëmë, dhe kjo është më e rehatshme, të freskohet pak nga pak dhe të bëhet mish e dhjam. Sa e tmerrshme është që ne nuk e dimë; në qoftë se do ta dinim do të admironim shpirtin njerëzor. Mbi tokë e në qiell nuk ka asgjë që t'i ngjajë Zotit sa shpirti i njeriut.

NJË ÇIFUTE NË BERLIN

Nga Vjena vërsulem në Berlin. Buda kishte shuar tek unë shumë nga etjet, por nuk kishte mundur të shuante etjen të shihja pjesën më të mundëshme të tokave e të deteve. Ai më kishte dhënë atë që ai vetë e quan "syri i elefantit" - që t'i shohë gjithë gjërat sikur shihen për herë të parë dhe t'i pranojë, t'i shohë gjërat sikur shihen për herë të fundit dhe të ndahem prej tyre.

Bota është një mjegull, thoshja me vete, njerëzit janë pika vese, fëmijët jetëshkurtër të vesës. Dielli i zi, Buda, ngrihet dhe ato avullojnë. Mëshira kishte pushtuar shpirtin tim, mëshira dhe dashuria, sikur të mundja për një çast akoma ti mbaja ato mjegulla nën shi kimin tim dhe të mos i lija të avullohen! E ndjeja se zemra ime akoma nuk ishte mbështjellë e gjitha nga dollomaja e verdhë; mbetej akoma një zemër e brejtur, që rrihte me ngulm, dhe nuk e lejonte Budën të më zotëronte. Brenda meje qëndronte një kretian që rebelohej dhe kundërshtonte i qetë, t'i jepte ngadhënjimtarit bukën dhe kripën, këto dy simbole të miqësisë. Këtë e kuptova në Berlin. Mbyll sytë dhe kujtoj mëkatet e rënda, sipas Budës, që unë kam bërë në atë qytet mosmirënjohës por kujtesa mbytet nga mbrëmjet e ngrohta, nga fjalët përvëluese e të qeshurat, nga gështenjat e qershitë me lule, nga shikimet e çifutëve të pangopur, nga era e mprehtë e sqetullave të grave dhe unë nuk arrij t'i sistemoj dot ato kujtime.

Shfletoj fletoret e zverdhura për të kujtuar atë që ka ndodhur më përpara, atë që ka ndodhur më pas, çfarë betime kemi bërë dhe si ka ndodhur ndarja... Çfarë force kanë në të vërtetë shkronjat, këta njëzet e gjashtë ushtarë që qëndrojnë në këmbë në buzë të honit dhe mbrojnë zemrën e njeriut dhe që, për një kohë kaq të gjatë, e pengojnë të bjerë dhe të mbytet në syrin e zi e pa fund të Budës!

2 shtator. -Prej tre ditësh, në Berlin, endem rrugëve të pafundta e monotone, gështenjat janë plot gjethe, fryn një erë e akullt e zemra më ka ngrirë. Mbi një portë të lartë, sot pashë, të shkruajtur me gër-

ma të mëdha: "Kongresi i reformatorëve të edukimit". Binte borë, unë kisha ftohtë, ndaj hyra brenda.

Kishte shumë njerëz, profesorë burra dhe gra, kërkoja me sy një vend bosh. Papritur një jelek ngjyrë portokalli feksi midis xhaketave gri e të zeza. Si insekt që tërhiqet nga ngjyra e lules, unë u drejtova drejt vajzës me jelek ngjyrë portokalli; pranë saj gjendej një vend i lirë. U ula. Një prefosor fliste me pasion, pushonte, pinte ujë, qetësohej pak dhe përsëri merrte vrull - si mund të ndryshojmë programet shkollore, si mund të krijojmë një gjeneratë gjermane të re, indiferente ndaj jetës e vdekjes. Paskësh akoma një shpëtimtar, që përpiqej të shpëtonte botën, duke e mposhtur atë.

U ktheva nga fqinja ime, flokët e saj ishin të zinj me reflekse blu të zënë, sytë të mëdhenj po ashtu të zinj, si hurmë, hunda pak e kërrusur, mbi fytyrë kishte pika të lehta të kuqërremta, ndërsa mishi i saj ishte brun si qelibar i vjetër. U përkula pak nga ana e saj dhe i thashë: Nga cili vend besoni ju se jam? Nga vendi i diellit, m'u përgjigj dhe u bë flakë e kuqe. - Po, nga vendi i diellit; këtu po më zihet fryma. Dalim të shëtisim pak?

- Dalim.

Në rrugë ajo hidhej, qeshte, lëshonte klithma, si një fëmijë që i kanë dhënë një lodër të re.

- Më quajnë Sariat, jam çifute dhe shkruaj poema.

Hymë në një park, gjethet e zverdhura që kishin rënë kërcisnin nën këmbët tona, i hodha dorën mbi flokët e ngrohtë e të butë si mëndafsh. Vajza ndaloi, e heshtur, dhe e afroi kokën pranë meje.

- Nga dora jote derdhet një forcë, më thotë; më duket sikur jam një qyp që shkon në burim e mbushet me ujë.

Po vinte dreka. - Shkojmë të hamë, - i them. - Një supë do të na ngrohë.

- Ne çifutët nuk hamë sot, mbajmë kreshëm, ky do të ishte mëkat, më përgjigjet. Por sidoqoftë unë kam uri, kam ftohtë, por ama është një mëkat.

- Mëkatojmë pra, që të mund të pendohemi më vonë, dhe Jehovai i tmerrshëm të na falë.

Ajo duhet të ketë qenë prekur kur më dëgjoi të flasë ashtu për Zotin e saj.

- Cili është Zoti juaj?

U turbullova. Për një çast mendova se edhe unë po mëkatoja

ndër Zotit tim; Gjatë gjithë atyre orëve kisha harruar se ata sy e flokë, ajo lëkurë mermeri, ishin një mjegull, dhe unë u fryja, uk doja t'u fryja për t'i shpërndarë.

- Dionisi? - thotë vajza duke qeshur, - pijaneci i madh?

- Jo, jo, është një tjetër, më i tmerrshëm se Jehovai juaj... Mos më pyesni!

Atë çast duhej të ikja, por pata mëshirë për trupin tim, për trupin saj, qëndrova.

- Më thoni një nga poezitë tuaja, i thashë - për ta argëtuar. Fytyra ndriçoi, zëri ishte tepër ledhatues i dhimbshëm:

Të syrgjynosur që nuk kanë kuptuar akoma
Se toka e syrgjynosjes është gjithashtu një atdhe
dhe kur, nëpër qytetet e rinj ecim krah për krahë
në të majtë, si një vëlla ecën atdheu.
Të syrgjynosur që akoma nuk kanë kuptuar
Që në qoftë se dikush ne na buzëqesh,
Në zemrën tonë syrgjyn
Ngrihet himni i himneve.

Sytë i ishin mbushur me lot, u përkula mbi të dhe e pyeta: - po qan?

- Kudo që ta prekësh një çifut, do të gjesh një plagë.

3 tetor. - Ah! Sikur njeriu të mund ta ruante dalldinë, sikur Dionisi të ishte një Zot i plotfuqishëm! Por përnjëherë dalldia largohet, shpirti ndriçohet dhe mishrat e ngrohtë, të fortë, bëhen pika vese. Të nesërmen shpirti im, u ngrit, më pa me përçmim dhe m'u ndërkrye:

- I pabesë, i shthurur, tradhëtar, - më bërtiti, - unë kam turp të jetoj e të udhëtoj me ty! Buda të faltë se unë nuk mundem. Mos bjer më në grackën ngjyrë portokalli.

Megjithatë që në mëngjes unë mora të njëjtën rrugë, për në Kongres. Pashë gjithandej. Ngjyra portokalli, nuk ishte në asnjë vend, doja të gëzohesha, por nuk munda. Dëgjova përsëri fjalët e mëdha; njerëzit kishin uri dhe hanin patate, të tjerët ishin përkulur, nuk dëgjonin fare fjalët dhe shkruanin. Përnjëherë, ndjeva turbull, prapa meje, si një frymë të ngrohtë, dikë që më kërkonte dhe kishte ngulur

sytë mbi mua. U ktheva dhe e pashë në fund të sallës; ajo kishte hedhur një shall ngjyrë ulliri, kishte ngritur jakën me gëzof, sepse bënte ftohtë. Më buzëqeshi, fytyra i ndriçoi si një kokë mermeri në diell.

Nuk u ktheva më për ta parë; u nisa për të dalë, por ajo më kapi në koridor. Më dha një libër me poezitë e saj; ajo buzëqeshte, vallëzonte, kënaqësia e mbrëmjes nuk i qe larguar akoma. Unë nxitova të ndaheshë shpejt dhe të shkoja. Në çastin kur po i jepja dorën, pashë sytë e saj të më shikonin, sikur pyesnin, me një frikë të lehtë. Trupi i saj m'u duk më i holluar e i rregjuar; zemra m'u copëtua nga dhembshuria. E shtrëngova nga shpina, i shtrëngova supet e saj të hollë, - klithi nga kënaqësia e dhimbja, u përpoq të më largohej.

- Përse më sëmur?

- Sepse ti je bërë nga një tokë tjetër, ke një tjetër Zot dhe se gjithë natën kam menduar për ty. Doja të të pyesja dhe ti duhet të më thuash të vërtetën.

Përse mos të ta them? Ajo nuk më tremb, unë jam çifute.

- Çfarë të urdhëron Zoti yt? Çfarë detyre të jep ai, përpara se të shkosh më larg? Këto dua të di.

- Urrejtje, urrejtje, urrejtje. - Ja detyra e parë. Je i kënaqur? Fytyra e saj u transformua përnjëherë; buzët e trasha iu mbyllën por akoma dridheshin. Në fytyrën e bukur, brune u dalluan nofullat e tendosura të tigreshës dhe sytë e verdhë laramanë.

- Je i kënaqur? - vërshëlleu përsëri, provokuese.

M'u kujtua fjala e Budës: Në qoftë se i përgjigjemi urrejtjes me urrejtje, urrejtja nuk do të zhdukej kurrë nga bota.

- Urrejtja, - iu përgjigja, është skllavi, që ecën përpara dhe fshin rrugën ku do të kalojë zotëria.

- Kush është zotëria?

- Dëshira, dashuria.

Çifutja ia dha një të qeshure sarkastike:

- Këtë blegërin Krishti juaj; ndërsa neve, Jehovai na urdhëron: në qoftë se dikush të shkul një dhëmb, shkuli atij gjithë nofullën. Ti je një qëngj, unë një ulkonjë e plagosur, ne nuk mund të jemi në një mendje, nuk mund të bashkohemi; duhet të jemi të lumtur që këtë e kuptojmë përpara se buzët tona të bashkohen.

- Çfarë të ka bërë bota? Përse dëshiron ta shkatërrosh?

- Ti kurrë nuk ke patur uri, ti, besoj se nuk ke fjetur kurrë nën

ura; nuk të kanë vrarë nënën në ndonjë pogrom; prandaj ti nuk ke të drejtë të shtrosh pyetje. Kjo botë, bota jote, është e padrejtë, e pauritur, por zemra jonë nuk është e tillë; dhe unë dua të më ndihmojnë shokët e mi ta shkatërroj atë, për të krijuar një të re, që nuk do ta turpërojë zemrën tonë.

Ecim nën pemët e zhveshura; disa gjethe qëndronin akoma në majat e tyre, frynte një erë e ftohtë, që i rrëzonte dhe ato binin mbi kokat dhe supet tanë. Jeleku i saj ishte prej pambuku, dorezat ishin me brima, çifutka dridhej. Këpucët e saj të vogla të ngrëna nga fundi ishin gati të hapura. Në një çast, e pashë përballë fytyrës dhe u tremba kur vura re sytë e saj përvëlues, plot urrejtje, që ishin ngulur mbi mua.

"Sa duhet të ketë vuajtur kjo vajzë, mendova, që flet me aq urrejtje, kush e di përse, për një çast, sa shumë e ka trembur ideja se do të shkonte të bënte dashuri me një burrë nga kampi armik!"

Buzët i ishin mavijosur nga të ftohtit, dhëmbët i kërcisnin fort. Më vinte turp. Hoqa shpejt pallton time të gëzoftë, dhe përpara se ajo të shmangej për të mos e pranuar, ia hodha mbi supet; kërkoi falje, e nxehur, u përpoq ta hiqte, por unë e shtrëngoja fort duke e mbështjellë me krahë.

Ndaloi sikur i pushoi fryma; nuk rezistonte më. Fytyra, dalëngadalë i mori bukurinë e vërtetë. E ndjeja se ngrohtësia e trupit tim, linte pallton dhe hynte ngadalë, thellë në trupin e saj; buzët po i bëheshin të kuqe. Mbështeti krahun mbi mua, gjunjët duhet t'i kishin ngrirë.

- Ngrohtësia është e artë, pështëriti, ajo është e mirë; ajo e ndryshon jetën.

"Pak ngrohtësi, mendoja, ndërsa sytë po më mbyteshin me lot, pak bukë, një çati, një fjalë e ëmbël, dhe urrejtja zhduket..."

Kishim arritur përpara shtëpisë së saj. - Kur do të shihemi? - e pyeta.

- Merre pallton,- më tha, tani unë e kuptova përse ata që kanë gëzof flasin siç flet ti; merre atë sepse po më shuhet zemra.

- Jo zemra jote, Sarita, por urrejtja.

- Ato janë një. Bekuar qofshin uria dhe të ftohtit; pa ato do të isha ndryshe; domethënë e rregulluar. Lamtumirë!

Ajo nuk më dha as dorën për t'u përshëndetur; nxori çelësin nga

çanta, për të hapur portën.

- Kur do të shihemi përsëri? - e pyeta prapë.

Por fytyra e saj ishte shndërruar përsëri në maskë të verdhë, ajo nuk u përgjigj. Hapi portën, hyri në errësirë dhe u zhduk.

Nuk e kam parë kurrë më.

I BETOHEM BUDËS ME FJALË

U mbylla në dhomën time, zemra më ishte bërë një fshikëz me vemje. Kjo botë, ishte bërë përnjëherë prej mishi dhe kocke. Ajo dukej me të vërtetë si për herë të parë, pesë etjet kishin zënë vend në trupin tim dhe unë i thërrisja Budës të vinte e të pengonte Tunduesin. Një shenjt i madh kishte jetuar si asket për dyzet vjet, dhe gjatë të dyzet vjetëve ai nuk kishte mundur të arrinte deri te Zoti; diçka brenda tij atë e pengonte. Në fund të dyzet vjetëve, ai kuptoi: Ishte një shtëmbë e vogël që ai e donte shumë sepse e mbante ujin të ftohtë, me të cilën ai pinte dhe ashtu freskohej. Kur e theu shtëmbën, menjëherë u bashkua me Zotin.

Unë e dija; shtëmba ime e vogël ishte trupi i njomë e i papërmbajtur i çifutes. Në qoftë se unë doja të bashkohesha me Zotin, duhej të zhdukej ky trup që qëndronte midis nesh. Kur një grerëz, hyn në koshere për të vjedhur mjaltë, bletët punëtore vërsulen mbi të, e mbulojnë trupin e saj me dyll aromantik dhe e mbysin; dylli im janë fjalët, vargjet, ritmi; në këtë savan të shenjtë do ta mbuloja Saritën, për të shpëtuar vjedhjen e mjaltit tim.

Gjaku filloi të më rrihte në tëmtha, thirra shpirtin që ishte shumë i turbulluar nga çdo anë; u përpoqa të mbledh gjithë forcën time në një trup, në një zë, në dy sy të pamposhtur - për t'i betuar; ishin ata që më ndanin nga Buda.

Mobilizova fjalët, u vendosa në krye të tyre dhe u nisa për luftë. Shkruaja, por sa më shumë shkruaja, aq më shumë zhvendosej qëllimi, dëshirat e mia bëheshin më të gjera, Sarita qëndronte gjithmonë e më prapa, hollohej, hollohej, humbiste dhe unë shikoja të ndriçonte përpara meje një brinjë zallishteje, një vijë e kuqe dhe një njeri që ngjitej: Hieroglifi ishte i thjeshtë, në vijën e zhveshur që unë e njoha - ishte jeta ime. Unë e dëshifrova, dhe shikoja sesi isha nisur, me

çfarë padjallëzie, me sa shpresa, në çfarë stacione kisha ndaluar një çast për të marrë frymë, dhe për të nisur përsëri me vrull të paktën, për racën, për njeriun për Zotin - dhe sesi përnjëherë kisha parë si-për meje, majën supreme, Qetësinë, Budën. Tek unë zbriste dëshira që të shkarkohesha njëherë e mirë nga gjithë gabimet e tokës e të qiellit e të arrija atë majë të vetmuar e të pabanuar. Mblodha në to-kë gjithë fletët e shkruara, i lexova dhe u tremba: Unë doja të shkru-aja një formulë të ekzorcizmit për të zhdukur Saritën, ndërsa kisha shkruajtur një të tillë për të zhdukur botën. Buda, rrinte ulur, pa lë-vizur, në majë, më shihte duke luftuar aty poshtë pranë brinjës dhe buzëqeshte me dashamirësi, plot siguri.

Kisha vënë rregull tashmë në pikëpyetjet e mija të vjetra, gjeja fjalët dhe forcoja përgjigjen, isha qetësuar. U çova, dola në rrugë për të shmpirë trupin, mbyllur prej disa ditësh. Kishte rënë nata, njerëzit duhej të kishin ngrënë, nuk binte shi, nuk binte borë, ata ishin shpërndarë nëpër rrugë. Mbi një hyrje të madhe dritash, pashë lajmërime shumëngjyrëshe: *"vallëzime zhavaneze"**; dëgjova një muzikë të thellë, plot pasion; hynin burra dhe gra, hyra dhe unë.

Vallëzimi dhe qielli i yjëzuar kanë qenë gjithmonë shfaqjet më të bukura dhe më të larta, që kanë gëzuar shpirtin tim; kurrë vera, kurrë një grua, as një ide nuk kanë tronditur gjithë qënien time, mi-shin, mendjen, shpirtin, aq sa vallëzimi dhe qielli plot yje. Isha shu-më i gëzuar të mendoja që pas aq ditëve të një asketiku të ri, të shkoja të shmpihesha dhe të gëzoja atë mbrëmje jo vetëm shpirtin, por edhe trupin e mendjen - të tre shokët e rrugës.

Kur hyra në sallë, vallja kishte filluar; dritat ishin fikur; ndërsa skena ishte e ndriçuar me një dritë misterioze blu të gjelbër që dukej si fundi i një deti të largët oriental. Një djalosh i zeshkët, me trup të shkurtër, që mbante bizhuteri me ngjyra të ndezura dhe me rroba jeshile të praruara, i ngjashëm me një insekt mashkull në orët e da-shurisë së afshtë të verës, vallëzonte përpara një femre të vogël, një zeshkaneje të bukur, me trup të hollë, që qëndronte e pa lëvizur. In-sekti vallëzonte, vallëzonte, i tregonte vajzës sa i shkathët ishte, sa i fortë e sa i hijshëm. Dhe se vetëm ai meritonte, dhe askush tjetër, të zgjidhej prej saj, që ata të bashkoheshin dhe të kishin një djalë.

* *lloj vallëzimi*

Që virtytet e tij, shkathtësia, forca, hijeshia, të mos humbisnin kurrë, por të kalonin te fëmijët. Vajza qëndronte më këmbë, e palëvizur, e shikonte, e peshonte, përpara se ta vendoste. Fare papritur ajo e vendosi, filloi të vallëzojë me të. Burri u tremb, ndaloi; ishte ai që qëndronte në këmbë, i palëvizur, dhe e shikonte. Vajza vallëzonte, vallëzonte përpara burrit të terrorizuar, hapi krahët, hapi velin që e mbulonte; trupi i saj blu në të gjelbër, herë fshihej e herë rrezatonte; ajo afrohej te djali, bënte sikur do të binte në krahët e tij, djali lë-shonte një klithmë triumfi, hapte krahët, ndërsa vajza shpëtonte duke rrëshqitur dhe shkonte vallëzonte më tej...

Në çdo rrotullim të valles, kafshët, zogjtë, njerëzit, flakin maskat e tyre të përkohshme dhe atëherë, zbulohet, prapa gjithë maskave, gjithmonë të ngjashme me njëra-tjetrën, fytyra e vërtetë e dashurisë... Një vallëzim tjetër, mendoja duke parë çiftin e Zhavanesë, një vallë-zim tjetër mbi dashurinë, të themi vallja e Zotit, do të mundej që me rrotullimin e saj të mund të hidhte edhe këtë maskë dashurie dhe çfarë fytyrë e frikëshme do të shfaqej atëherë? Përpiqesha të kapja atë fytyrë të fundit, që do të shfaqej prapa gjithë maskave, por nuk arrija dot. A do të ishte era, fytyra e Budës? Megjithatë të dy valltarët, djali dhe vajza, ishin bashkuar, ata vallëzonin tashmë të përqafuar në ekstazë, hidheshin në ajër, binin, kërcenin përsëri shumë lart, përpiqeshin, në një dihatje dashurie, duke kaluar kufijtë e njeriut.

Dola, eca nëpër rrugë deri pas mesnate. Flokë të mëdhenj bore filluan të binin, unë i pranoja duke ndjerë një farë lehtësimi, mbi buzët e mia që përvëlonin dhe freskohesha. Pyetje të reja ngriheshin brenda meje, vallëzimi i asaj mbrëmjeje kishte hapur tek unë buri-met e vjetra, të cilat i mendoja të shterura dhe ndjeja se fundi i që-nies së një kretani nuk boshatiset kurrë aq lehtë. Stërgjyshërit e tmerrshëm, brenda meje, që nuk e kishin ngrënë gjithë mishin, që nuk e kishin pirë gjithë verën që ata donin, që nuk kishin përqafuar gjithë gratë që dëshironin, shfaqeshin tani, të papërmbajtur, dhe nuk më linin të vdisja pa vdekur ata vetë. Dhe është e vërtetë, çfarë mund të bëjë, çfarë mund të shpresojë Buda në Kretë?

Shihja rreth dritës së fenerëve të rrugës, flokët e borës që vinin

vërdallë, ato më bënin që të mendoja zhavanezët e asaj mbërmjeje, burrin dhe gruan, që vazhdonin të luftonin, të dëshironin të vallë zonin dhe fytyrën e fundit të vallëzimit, të bashkohen për të sjellë në botë një djalë, që të mos vdesë. Etja e pavdekshmërisë është më e pakundërshtueshme se etja e vdekjes.

I dërrmuar nga lodhja, u shtriva për të fjetur, dhe ndodhi, siç më ndodh shpesh, kur në mbrëmje shpirti më torturohet nga pyetje dhe duke mos gjetur përgjigje, më kap gjumi dhe i thjeshton, duke i kthyer në një përrallë. Është forma që merr e vërteta e thatë, kur ajo lulëzon.

Pashë në ëndërr se ngjitesha në një mal, se kisha hedhur shkopin pas supeve, siç bëjnë barinjtë në Kretë dhe këndoja. Më kujtohet ishte kënga popullore që aq shumë e doja:

Mbi buzët e Margaros, unë mbolla një farë piperi,
Fara e piperit mbiu dhe u bë pemë e madhe,
grekët e korrin dhe turqit e transportojnë
Margaro shtyp farën, hipur mbi kalin e saj.

Fare papritur një plak doli nga një shpellë, me mëngët të grisura dhe duart gjithë baltë. Vuri gishtin mbi buzë për të më thënë hesht dhe, me një zë të ashpër: - Mos këndo! Më urdhëroi; dua qetësi, nuk e shikon? Dhe më tregonte duart. Unë po punoj.

- Çfarë po përgatit? - e pyeta.

- Nuk e shikon? Këtu në shpellë po përgatis lehtësimin.

- Lehtësimin? Ç'është ky lehtësimi? - thirra, ndërsa plagët e vjetra u hapën përsëri tek unë.

- Ai që pajton, do dhe jeton së bashku me universin - përgjigjet plaku, dhe u fut me të shpejtë në shpellë.

"Ai që pajton, do dhe jeton së bashku me universin"...

Gjatë gjithë ditës së nesërme, përsërisja fjalët e ëndrrës dhe nuk ngopesha. Mos ishte fjala e Zotit, të cilën mund ta dëgjosh vetëm natën kur shpirti llafazan mbyll gojën? Gjithmonë kam besuar tek këshillat që na jep nata; ajo sigurisht është më e thellë dhe më e shenjtë se ajo çamarrokja ditë, dhe mëshiron njerëzit.

Shumë ditë kanë rrjedhur. Sa shpesh kanë ardhur në jetën time, dy demonët që përplaseshin brenda meje. Sa herë që unë gjeja një

përgjigje për pyetjet që më torturonin, e pranoja me shqetësim, se- pse e dija se nga ajo përgjigje do të lindnin fatalisht pyetje të tjera dhe kështu tek unë përplasja e dy demonëve nuk do të mbaronte kurrë. Më duket se çdo përgjigje fsheh, mbështjell me sigurinë e saj të përkohshme, pyetjet e ardhëshme; prandaj unë i shoh gjithmonë të arrijnë jo me lehtësim, por me një shqetësim të fshehtë.

Krishti fsheh brenda tij, shumë thellë, farën e Budës; çfarë mund të fshehë Buda në thellësi pas dollomasë së tij të verdhë?

I BETOHEM BUDËS ME TRUPIN

Një të diel shiu, në një muze, shëtisja ngadalë, shikoja maskat e egra afrikane, bërë prej druri, prej lëkure, prej kafkash njerëzish, dhe përpiqesha të ndriçoja të fshehtën e maskave. Atje është, mendoja, fytyra jonë e vërtetë, ato monstra jemi ne, me gojë të përgjakura, me buzë të trasha, me sy të frikshëm. Prapa fytyrës së bukur të grua-as që duam ulërin një maskë e shëmtuar, prapa botës së dukshme, kaosi, prapa fytyrës së ëmbël të Krishtit, Buda. Ndonjëherë, në çastet e tmerrshme të dashurisë, të urrejtjes ose të vdekjes, magjia gënjeshtare zhduket, dhe ne shikojmë spektaklin e tmerrshëm të së vërtetës. Kujtohem duke u dridhur për irlandezen në kishëzën e malit kretian. Sapo buzët e saj prekën buzët e mija, fytyra e saj m'u duk e prishur, e shëmtuar si fytyra e frikëshme e majmunes, e zalisur; më pushtoi neveria dhe frika. Pas asaj dite, përpiqesha të hiqja maskën e fytyrës së qënieve njerëzore, sepse atëherë dashuria, mirëkuptimi, kortezia zhduken. Unë bëj sikur e besoj fytyrën e tyre, sepse vetëm kështu unë mund të jetoj me njerëzit.

Çdo mëngjes përpara se të lindte dita, primitivët, të cilët kanë krijuar maskat, ngjiteshin duke vrapuar mbi kodrina, thërrisnin, i luteshin diellit të lindte; dridheshin se mos nuk vinte përsëri. Shirat ishin plot me shpirtra mashkullorë që duke hyrë në tokë e mbarsnin atë; vetëtimat ishin shikimet e zemëruara të kryerendësit të padukshëm. Gjethet e pemëve flisnin si buzët njerëzore dhe vetëm disa të moshuar i kuptonin se ç'thoshnin. Lumenjtë, kur i kalonin, i tërhiqnin për t'i mbytur, dhe ata merrnin vrull, i kapërcenin me nxitim dhe, kur arrinin në bregun tjetër, shpërthenin në të qeshura sepse kishin shpëtuar.

Të gjitha gjërat flisnin, kishin uri, kishin një seks, çiftoseshin; ajri ishte i ngjeshur, mbushur me shpirtrat e të vdekurve, dhe kur njerëzit ecnin, ata hapnin krahët dhe i lëviznin sikur bënin not për t'i larguar, prandaj prapa asaj që dukej, ata shikonin qartë substancën, dhe zbulo-

nin prapa fytyrave jetëshkurtra, maskat e përjetshme.

Erdhi një vajzë, ndaloi pranë meje; ajo shikonte gjithashtu maskat. Për një çast, bëra një lëvizje për të ikur; gjithmonë kur jam vetëm dhe shoh diçka me emocion, mërzitem shumë kur vjen dikush tjetër dhe shikon bashkë me mua. E vogël, buçkane, kishte një gjoks të ngjeshur, mjekër të fortë, hundë të kërrusur, sy të mbuluar nga qerpikë të mëdhenj. U kthye nga unë, më hodhi një shikim të gjatë, ngulmues, duke më vrejtur, sikur të isha një maskë.

- Afrikan? - më pyeti ajo.

Unë qesha. - Jo i tëri, iu përgjigja; vetëm zemrën.

- Po fytyrën, më tha; duart. Unë jam çifute.

- Është një racë e tmerrshme, - i thashë për ta tallur, - e rrezikshme: i duket sikur do të shpëtojë botën. Ju e prisni akoma Messinë?

- Ne nuk e presim më; ai ka ardhur.

- Messia?

- Messia.

Fillova të qesh: - Kur? Ku? Si quhet?

- Lenin.

Përnjëherë zëri i saj u bë më i rëndë. Sytë iu errësuan.

Lenin! Për një çast m'u duk se të gjitha maskat përpara meje lëvizën, se nofullat e tyre të trasha luajtën. Vajza shikonte nga dritarja qiellin e zi dhe heshti.

Është një shpëtimtar i ri, mendoja, janë uritë, shtypjet, skllevërit që e kanë krijuar, për të duruar urinë, padrejtësinë dhe skllavërinë. Edhe kjo, është një maskë tjetër e dëshpërimit, dhe e shpresës së njerëzve.

- Unë njoh një tjetër Messi që liron njerëzit nga uria, nga të velurit, nga padrejtësia e drejtësia që është më i rëndësishmi nga gjithë Messitë.

- Dhe si quhet ai?

- Buda.

Bëri një buzëqeshje përçmuese; zëri i tingëlloi me nervozizëm:

- Kam dëgjuar të flitet për të, është një hije. Por ky imi është prej mishi.

Kishte marrë zjarr; nga pjesa e hapur e jelekut dilte një erë e fortë djerse; një çast shikimi m'u turbullua; e kapa për krahu.

- Nuk ju mërzis, - i thashë, - ju jeni femër, unë jam burrë, ne mund ta dëgjojmë njëri-tjetrin.

Mbylli sytë përgjysmë, më pa; përpoqi qepallat.

- Këtu është një varrezë, - tha, duke parë maskat përreth, - zotër prej druri, mbulesa fantastike; është një varrezë, po më zihet fryma. Jashtë bie shi, dalim të lagemi!

U lagëm për disa orë, duke ecur nën pemët e parkut të madh.

Ajo sapo kishte ardhur nga Rusia, nga Parajsa; ajo ishte tymi i një dashurie dhe urrejtjeje të egër. Quhej Itka.

Unë e dëgjoja, në fillim e kundërshtoja, por shpejt e kuptova se besimi mbretëron në një shkallë shumë të lartë mbi kokën e njeriut, se arsyeja nuk mund ta presë. E lashë pra të fliste, të shkatërronte dhe të rindërtonte botën.

Po binte mbrëmja; kalimtarët bëheshin më të rrallë, papritur, duke u mbytur midis shiut të shndritshëm, u shfaqën shtëpitë, pemët, njerëzit.

- Shkojmë në dhomën time, - tha vajza dhe u mbështet në krahun tim; - unë jam e lodhur.

Dolëm nga parku, duke kaluar nëpër rrugicat e ngushta; sonte do të pimë çaj së bashku me shoqet e mia. Njëra prej tyre është piktore, ajo lufton me ngjyrat, krijon, gris, kërkon; çfarë kërkon? As ajo vetë nuk e di. - "Sapo ta kem gjetur, - thotë, - do ta di se çfarë kërkoj". Ajo quhet Dina, është çifute.

Tjetra është komediane; edhe ajo kërkon; ajo hyn në çdo personazh që luan dhe kur del prej tij hidhërohet. Ajo quhet Lia, edhe ajo është çifute. E treta është shumë e bukur, nazeqare, fëmijë i përkëdhelur; babai i saj është i pasur, i jep para vazhdimisht, ajo blen tualete, parfume, zgjedh burrat dhe fle me ta. Ajo nuk është çifute; quhet Roza, është vieneze. Unë e dua, nuk e di përse...

Heshti, pastaj, pas pak:

- Kush e di? - pëshpëriti; mbase do të dëshiroja t'i ngjaja.

Bëja sikur në vete isha shumë i lumtur, që shihja se mbi idetë, mbi përmbysjet e mëdha të botës dhe të kozmogonisë, lartësohej i pavdekshëm zëri i femrës.

Mikeshat, tashmë, kishin ardhur, Roza kishte sjellë reçelra dhe fruta, ato kishin përgatitur tavolinën dhe po prisnin. Roza, shtrirë mbi divan, bënte buzët me të kuq, ndërsa dy të tjerat kishin hapur një revistë dhe lexonin me zë. Shpirtrat ishin tronditur edhe një herë, bota kishte shfaqur sërish krenarinë.

"Unë duhet të falënderoj fatin, mendoja, duke parë ato katër shpirtra të egër rreth meje; duhet ta falënderoj atë që vazhdimisht më hedh midis shpirtrave çifutë; mundet që ato të merren vesh më mirë me mua se shpirtrat kristianë."

Kur hymë ne, të trija vajzat lëshuan një klithmë, ato nuk e prisnin një burrë.

- Unë nuk e di si quhet, tha Itka duke qeshur; është një maskë, e gjeta në muzeun etnologjik.

Frymë të ngrohta, një rini e përmbajtur - Roza u ngrit aroma e saj dhe kundërmoi. Mes aq gjokseve femërorë, aq syve të pangopur, dhe buzëve të lyera, unë u turbullova, u pushtova, nuk e di përse, nga frika dhe ndrojtja, dhe doja të ikja, por çaji kishte ardhur, ne u ulëm për tokë mbi qilim, gjunjtë tanë prekeshin... Pas kaq vitesh, nga gjithë ajo mbrëmje, që rëndon aq shumë në jetën time, më kujtohet vetëm Itka që fliste me zjarr për kryeqytetin e kuq të botës, Moskën, ndërsa Roza qeshte dhe, pasi pinte çajin, vendoste përsëri të kuq mbi buzë, dy të tjerat kishin hapur sytë dhe dëgjonin.

Ishte natë vonë, të trija vajzat çohen për të ikur, unë u ngrita së bashku me to; por Itka më shtrëngoi krahun dhe më bëri shenjë: Qëndro. Unë qëndrova. Atë natë Buda filloi të zverdhë brenda meje. Atë natë unë pashë se bota nuk është një mjegull, se trupi i femrës është i ngrohtë, i fortë, plot ujë përtëritjeje dhe se vdekja nuk ekziston.

Me atë qëndrova disa netë; ajo nuk foli kurrë për dashurinë, zemra jonë nuk guxonte të prishte, me psherëtima dhe betime, ndeshjet tona të shenjta prej atletësh. Luftonim me gjithë trupin, si kafshët, dhe pastaj rrokulliseshim në gjumë të raskapitur e të gëzuar. Buda, mendoja, Buda... dhe qeshja.

Ç'lehtësim kur shpirti nuk ndodhet më i burgosur në rrjetën e preokupimeve intelektuale, por qëndron mbi tokë, i pacënuar, i pastër, si një kafshë! Kristianizmi, duke fshikur në emër të mëkatit bashkimin e burrit me gruan, e ka poshtëruar, edhe pse përpara tij qëndron një veprim i shenjtë, një nënshtrim i gëzueshëm ndaj vullnetit të Zotit, e ajo është kthyer në shpirtin e terrorizuar të kristianëve, në një mëkat. Dashuria, përpara Krishtit ishte një mollë flakë e kuqe. Erdhi Krishti, brenda në mollë hyri një krimb dhe e gërreu.

Duke iu afruar trupit të Itkës, unë hyja në racën çifute, nëpër rrugën më të shkurtër dhe të pagabueshme; është një kaçube që digjet

dhe nuk konsumohet kurrë. Kjo racë nuk merakoset për bukurinë, pasioni i saj suprem nuk është liria, por drejtësia.

E shikoja atë çifute përvëluese me admirim. Gjatë gjithë natës, ajo shndërrohej në një bishë të pangopshme, ngrënëse burrash, gjithë shpirti i saj bëhej mish; Ndërsa gjatë gjithë ditës ishte flaka më e pastër. Ajo më kujtonte një femër të admirueshme, me trup dhe shpirt si të saj, të shenjtën Terezë. Një ditë, motrat e kuvendit të saj e panë të hante duke u mbytur një thëllëzë të pjekur; motrat e shenjta të padjallëzuara u skandalizuan, ndërsa Tereza qeshi. - Një thëllëzë, thotë, është një thëllëzë; lutja është lutje! Ajo jepej me mish e shpirt në çdo veprim; ushqente me të njëjtën grykësi trupin dhe shpirtin.

Gjithë natën çifutja luante me mua; por ditën rrudhte vetullat dhe më shikonte me urrejtje.

- Ti nuk ke turp, - më thoshte, - të jetosh rehat, të mos kesh uri, të të mos thajë dimri, të mos ecësh me këpucë të grisura? Ti nuk ke turp të shëtisësh nëpër rrugë dhe të thuash: bota është e bukur, ajo më pëlqen?

- Unë nuk them: bota është e bukur, ajo më pëlqen, unë them: bota është një fantazmagori; uria, të ftohtit dhe këpucët, të shqyera ose jo, janë fantazmagori; do të fryjë një fllad i lehtë dhe do t'i shpërndajë. Ja çfarë them unë!

Në këtë çast, ajo më vërsulej, jashtë natyrës së saj, dhe më mbyllte gojën me dorë:

- Hesht, hesht, nuk dua të të dëgjoj! Ju pra, ju të tjerët që jeni rehat, nuk keni zemër për t'u qarë hallin të tjerëve? Nuk keni sy për të parë? Eja shih!

Më merrte, më çonte nëpër lagjet proletare, hynte nëpër shtëpitë e varfëra, të gjithë e njihnin, më tregonte fëmijët e uritur, nënat që qanin, burrat që rrinin pa punë, që kafshonin buzët dhe nuk flisnin. Unë i pyesja, ata më shikonin nga koka te këmbët dhe kthenin fytyrat nga ana tjetër.

- Përse nuk flasin? - pyesja Itkën.

Ata nuk flasin? Ata ulërijnë, por ti nuk i dëgjon! Por mos u shqetëso, një ditë do t'i dëgjosh.

Ngulte shikimin mbi mua, duke shpresuar se vuajtja e njerëzve do të më kishte prekur, por unë tallesha me të.

- Më vjen keq, i thosha, që nuk marr dhe unë një karamele për të ëmbëlsuar gojën. - Atdheun, Zotin, ose siç thua ti, Karl Marksin - një nga specialistët më të mirë të ëmbëlsirës njerëzore. Një ditë unë u njoha me njeriun më të lumtur të botës; me atë që pranonte dy bombone, Krishtin dhe Karl Marksin; ky ishte një kristian fanatik por edhe një komunist fanatik; kështu ai kishte zgjidhur gjithë problemet, të tokës dhe të qiellit.

Kisha filluar të qeshja, por sa më shumë që flisja, aq më shumë mëshira, dhembshuria dhe hidhërimi më dërrmonin zemrën. Megjithatë, nga sedra, nuk doja ta njihja. Unë vazhdoja të rezistoja dhe të krekosesha sepse nuk gjeja ngushëllim duke thithur bombonet.

- Ngushëllime të tilla, unë nuk dua. Një besim që premton shpërblimin dhe lumturinë, më duket një ngushëllim i keq, i mirë për pleqtë, për të dobtit dhe vegjetarianët.

- Unë nuk jam as plakë, as e dobët, as vegjetariane, - m'u përgjigj shoqja ime e nxehur. - Ti mos luaj shumë. Zoti, Buda yt, është po ashtu një bombone. Dhe, dije, unë nuk dua më të të dëgjoj, bile as të të shoh!

Tundi me nervozizëm kokën, më lëshoi krahun, mori rrugën e parë që iu paraqit dhe më la.

Por në mbrëmje buzët e trasha të çifutes buzëqeshnin:

- Ajo që thamë ditën, - tha duke qeshur, - humbi si tymi; tani ka ardhur nata.

Në mëngjes ndahemi; ajo shkon në uzinë ku punon, ndërsa mua m'u bë zakon të endem nëpër lagjet e varfra fare i vetëm. Nuk doja të shkoja atje me Itkën; me të duroja nga sedra, por zemrën e mbaja të mbyllur. Kur ngelesha vetëm, vuajtja e njerëzve nuk ishte më një fantazmagori, nuk ishte më një hije, ishte një trup i vërtetë, që kishte uri dhe prej tij rridhte gjak.

"O Zot, mos i dërgo njeriut gjithçka që ai mund ta durojë." Unë nuk e dija se kishte aq shumë vuajtje në botë; akoma nuk kisha ndeshur aq pranë atë fytyrë të egër të së pashmangshmes. Atje ekzistojnë të tjera ligje që qeverisin, dhe urrejtja është detyra e parë. Atje, dekalogu duhet të ndryshojë, ai tashmë ka ndryshuar; dashuria, urrejtja, lufta, morali, marrin një kuptim të ri. Shtrirë mbi trotuar pashë një femër të re, skeletike, fustani i ishte ngritur dhe lejonte të shihej lakuriqësia e saj. Pata mëshirë për të, ndalova për t'i thënë të

ulë fustanin. - Të duket mishi, i thashë. Ajo tundi supet, një e qeshur sarkastike ndau buzët e saj:

-Unë kam uri, më tha, ndërsa ti më flet për lakuriqësinë... turpi është për të pasurit.

Nuk mund ta duroja gjithë atë tmerr; faqet e thara nga uria, fëmijët e vegjël që gërmonin në plehra për të gjetur diçka për të ngrënë. Barku i tyre ishte jeshil dhe i fryrë, pulpët kocka të veshura me një lëkurë të zbehtë; të tjerë mbështeteshin mbi paterica sepse këmbët nuk i mbanin dot më...

Nuk mundesha dot më, ktheja sytë për të mos i parë sepse kisha turp.

ZVICRA

Më kujtohet fare qartë; përpara se të provoja mëshirë për njerëzit, e ndjeja se më vinte turp. Kisha turp të shihja vuajtjen e njerëzve dhe veten time në një spektakël të përkohshëm dhe të kotë, duke u përpjekur të transformoja gjithë këtë tmerr. Thosha me vete se: "kjo nuk ishte e vërtetë, se nuk duhej të tërhiqesha prej saj, si naivët, dhe pastaj duhej të besoja se uria dhe ngopja, gëzimi dhe vuajtja, e gjithë kjo nuk ishte gjë tjetër veçse një mjegull!" Unë e thithja, e përsërisja, por kur shikoja fëmijët që kishin uri dhe qanin, gratë me faqe të thara dhe sy plot urrejtje dhe vuajtje, zemra ime pak nga pak shkrihej. Ndiqja me emocion ndryshimin e papritur brenda meje. Në fillim, ishte turpi që rrihte në zemrën time, pastaj dhembshuria; fillova ta ndieja vuajtjen e të tjerëve sikur ajo të ishte vuajtja ime. Pastaj erdhi indinjata, më tej, etja për drejtësi. Dhe mbi të gjitha përgjegjësia. "Unë jam fajtor, - i thoshja vetes, - për gjithë urinë që ka në botë, për gjithë padrejtësinë. Jam unë që mbaj përgjegjësi për të."

Ç'duhet bërë? Shikoja se si shpalosej detyra ime; bota zgjerohej, nevoja shpërthente. Kuptova se detyra qëndronte e burgosur në një trup, në një shpirt, dhe mbytej. Ç'duhet të bëj? Ku të drejtohem? Thellë në zemrën time, e dija se ç'duhej të bëja, por nuk guxoja ta vija në jetë. Ajo rrugë më dukej e kundërt me natyrën time dhe unë isha i sigurt se njeriu, mundet, me forcën e dashurisë, me forcën e luftës, të kalojë natyralen e tij. A do të ketë, njeriu mendoja, një forcë të tillë krijuese? Dhe në qoftë se e ka, nuk mund t'i falet aspak në qoftë se ai nuk i lë të shpërthejnë, në çastet kritike, kufijtë e saj.

Gjatë atyre ditëve të vështira, kur unë përpiqesha, duke shkuar kundër natyrës sime, të kapërceja urrejtjen dhe të luftoja për të lehtësuar vuajtjet e njerëzve, shpirti im u përshkua nga një figurë shumë fisnike e sakrificës dhe e dashurisë. Më dukej se ajo donte të më tregonte rrugën dhe më kujtohet një fjalë që ajo më ka thënë një ditë: "Duhet të dëgjosh gjithmonë thirrjen e njeriut që klith: "Ndihmë."

Kur një mbrëmje, gjatë pelegrinazhit tim në Itali, kisha hyrë nëpër rrugicat e ngushta të Assizës dhe dëgjoja këmbanat që tingëllonin gëzueshëm nëpër kambanaret e Varfëra të kishave dhe në manastirin e shën Klerit, provoja një lumturi të pashprehur.

Qëndrova shumë muaj në atë qytet të shenjtë, në shtëpinë mbretërore të konteshës së plakur Eriketa dhe nuk doja të largohesha më. Tani, në këto ditë të vështira ku shpirti im përpiqet të ngjitet pak më lart, zemra ime është hapur dhe prej saj duket Assiza. Shoh të dalë në dritë, në këto ditë kritike, djalin e Bernadonës; ai fillon të ecë përpara meje, veshur me qillota, dhe me shenjë më tregon rrugën. Nuk ishte rrugë, ishte një e përpjetë e thepisur, gjithë gurë. Por ajri kundërmonte shenjtëri.

Më kujtohet ajo ditë me re kur unë kisha ngjitur në Avernë, malin e martirizimit e të lavdisë të shën Françeskut. Frynte një erë e fortë e akullt, gurët bojëhiri ishin të zverdhur, pa një fije bari, pemët e shterpëta të zeza; peizazhi torturues e i ashpër rënkonte, nuk dinte të qeshte. Varfëri, lakuriqësi, shkretim; një dritë e mugët, po binte nata dhe maja ishte akoma larg. Përpiqesha më kot të përqendroja dëshirën time, t'i thërrisja forcës sime; e ndieja se po më pushtonte paniku. - Trupi im i ngrirë, i uritur, i zhytur në natën e shkretëtirës së akullt. Por fare papritur ndodhi mrekullia. Peizazhi jonjerëzor që më rrethonte, i privuar nga lulet, kishte filluar të zhvendosej, të ndryshonte, në mënyrë misterioze, dhe unë arrita të kuptoj se atje ishte varfëria françeskane, e rëndë për trupin, e pamëshirshme për zakonet e rehatshme dhe gëzimet e plogëta që zvogëlojnë njeriun.

Ishte ky shenjt që torturonte trupin e tij, që nuk pranonte kënaqësitë e pesë shqisave, hidhte hi në ushqimin e tij, kur kuptonte se demoni i babëzisë lëpihej; në palcë të dimrit ai hidhej në përruan e akullt, rrinte pa gjumë, kishte uri dhe ftohtë; aq shumë e kishte torturuar trupin e tij të argjiltë sa në çastin e vdekjes ndjeu mëshirë për të dhe i tha: "Më fal, vëlla, gomar i vogël, të kam bërë të vuash shumë."

Kjo varfëri ishte françeskane, domethënë e sigurt për pasurinë e saj, për pranverën mistike që ajo përgatiste, për verën e ngrohtë ngarkuar me fruta që ajo fshihte,. Përnjëherë atë mbrëmje, mali i Avernës, i zhveshur tërësisht, u ngrit në shpirtin tim i mbuluar me gjelbërim, plot aroma të këndshme, plot flutura dhe bletë - pejzazhi i mrekullueshëm i Parajsës që qëndron brenda nesh. Unë fillova të

ngjis malin e shndërruar e të thërras: "Bekuar qofsh, motra ime Avernë, motra ime varfëri!"

Kishte ardhur pranvera. Si mund të nisesha? Unë isha i lumtur në banesën princërore të gruas së vjetër, plot gëzim e mirësi françeskane, konteshës Eriketa, përballë manastirit të vogël të shën Klerit. Kurrë nuk e kisha përjetuar aq thellë identifikimin e shën Françeskut me pranverën. Sepse asnjë nga tre urdhërat françeskane - Varfëria, Bindja, Virgjëria nuk është në harmoni aq të përsosur me shpirtin e pastruar, të ri vazhdimisht, të shën Françeskut, si urdhëri i madh pranveror i virgjërisë. Në vende të tjera, pranvera do të evokonte në shpirtin nostalgjik dhe të boshatisur të njeriut, rininë, një femër që ka dashur, ose motrën e tij vajzë të re, dhe do të bënte të lindte tek ai keqardhja: Përse, në qoftë se natyra përtërihet, njeriu nuk mund të gjejë përsëri rininë? Dhe ai do të bëhej xheloz për malet dhe fushat, sepse:

"Ata nuk e durojnë vdekjen, dhe nuk kanë pleqëri."

Por këtu, në Assizë, pranvera merr detyrimisht, duke buzëqeshur, fytyrën e shën Françeskut. Kjo tokë, që ka patur lumturinë të lind një frut të tillë, bëhet më e gjerë, më e pasur, dhe jep një pranverë të dyfishtë, të trefishtë; çdo lule këtu, pa humbur fatin e saj të lumtur, rritet e behët simboli i shenjtë i lulëzimit të shpirtit njerëzor.

Shën Françesku ishte një nga të parët, lulja e parë e përsosur që u ngrit mbi ugaret, mbi hidhërimet e dimrit mesjetar. Zemra e tij ishte e thjeshtë, gazmore, e virgjër;

Sytë e tij si të një poeti të madh e të një fëmije, shikonin botën për herë të parë. Shën Françesku ka dashur vazhdimisht të shohë një lule të thjeshtë, një burim uji, një insekt, dhe sytë e tij të mbusheshin me lot. Ç'është kjo mrekulli, mendonte ai, ç'është kjo lumturi, çfarë misteri hyjnor;; lulja, uji, insekti! Për të parën herë pas aq shekujsh, shën Françesku e pa botën me sy të virgjër. Gjithë makina skolastike e Mesjetës, e rëndë, pa jetë, binte dhe ngelej vetëm trupi i zhveshur, shpirti i zhveshur, i braktisur nga gjithë dridhjet e pranverës.

Pas disa muajsh, unë nuk mund të qëndroja më atje, kalova përsëri nëpër Assizë. Ecja nëpër fushën e Umbries, ngarkuar me fruta, mbuluar me ullinj, me fiq e vreshta. Këtë herë ecja fare i vetëm, shkoja nga njëri fshat në tjetrin, gëzohesha ashtu qetë, pa folur, kur shihja atë tokë ngarkuar me fruta, atë tokë të shenjtë pjellore, që qe

punuar, gërryer, që kishte vuajtur me një durim të qetë, dhe që tani, e shtrirë, e kënaqur, shlodhej, me tryezën mbushur me fruta. Dukej që ishte e lumtur dhe e qetë, sepse ajo e kishte bërë detyrën e saj. Nënshtruar ligjeve të përjetshme, duke kaluar me durim e bindje gjithë stadet e prehjes dhe të vuajtjes, ajo kishte arritur në këtë lëmë të pasur vjeshtor me frytet e virtytit të saj.

Dhe fare papritur, pa asnjë përpjekje të vetëdijshme, unë kisha përjetuar ndjenjën e thellë të urdhërit të tretë themelor të shën Françeskut; Bindjen. Të bindesh është e rëndë, t'jua lëshosh veten me besim, forcave të dukshme e të padukshme që janë brenda dhe rreth jush, me bindjen e pakundërshtueshme se ato dinë gjithçka, ndërsa ti nuk di asgjë. - Ja rruga, e vetmja rrugë e prodhimtarisë. Çdo rrugë tjetër është e shterpët dhe gënjeshtare, sepse ajo nuk të shpie në asnjë krah.

Kështu, shën Françesku, ishte ngritur përsëri përpara meje, nga kjo tokë që ai e donte, ku unë e kisha parë të shtrirë, sikur ai gjendej atje atë agim, në hapësirën e shën e Klerit, duke psaltur lëvdatat për diellin, për zjarrin dhe ujin, për vdekjen.

Ishte i lumtur; ai u ishte nënshtruar ligjeve të përjetshme, kishte mbushur duart me fruta dhe kthehej si një punëtor i mirë te zotëria.

Më kujtohet, unë përpiqesha, gjatë atyre muajve, duke u rënë kryq e tërthor tokave dhe rrugicave të ngushta të Assizës, duke parë pikturat në banesën e madhe princërore, të jetoja sa të mundesha, një pranverë e një vjeshtë të atillë. Vite të pangopshëm, të papërmbajtshëm të rinisë; shëtisja që në agim, i lumtur dhe i pashpresë, atë pejzazh të shenjtë. Provoja atë që duhet të ketë provuar Spartiati i ri, i cili mbante në duart e tij një lëkurë dhelpre, që, edhe pse drithej i tëri, nuk fliste, nuk thërriste, vuante, por ishte krenar që kishte mundur të sundonte vuajtjen e tij.

Megjithatë, pa dashur as vetë, fytyra ime duhej të shprehte luftë dhe vuajtje; sepse një mëngjes, duke dalë nga porta e fortifikuar e shën Klerit, takova një burrë të hollë, shtatlartë, flokët e verdhë të cilit kishin filluar të zbardheshin. E shikoja shpesh të bridhte nëpër ato vende që mbanin shumë pelegrinë, por asnjëherë nuk kishim këmbyer ndonjë fjalë; vetëm i buzëqeshnim njëri-tjetrit kur takoheshim, kalonim rrugën pa folur, duke ecur gati-gati me një hap më të lehtë, sikur asnjeri nga ne të dy nuk donte të turbullonte qetësinë

dhe vetminë e tjetrit.

Por një mëngjes i panjohuri ndalet, më shikon, heziton për një çast.

- Dëshiron të ecim pak bashkë? - më tha.

- Po, dua.

Pas disa hapash: - Unë jam grek, - i thashë, - kam ardhur në Asizë dhe kam filluar të dua shën Françeskun.

- Unë, - u përgjigj i panjohuri, - vij nga ana tjetër e Evropës, nga Danimarka; edhe unë e dua shën Françeskun, unë jetoj në Assizë prej disa vitësh, dhe nuk dua të largohem prej këtej. Më quajnë Jorgensen.

U drodha. - Ju jeni ai që keni shkruajtur tre librat e bukur për shenjtin?

Jorgenseni buzëqeshi me hidhërim; tundi kokën.

- Kush mund të flasë për shenjtin ashtu siç e meriton ai? As vetë Dante. E njihni ju këngën e njëmbëdhjetë të Parajsës?

Ajo më ka gëzuar shumë. Në atë kohë e doja shumë dhe shpesh, duke ecur i vetëm nëpër fushë ose nëpër rrugët e Assizës, pëshpërisja vargjet e para të saj:

O merake të kota të njerëzve!
Çfarë mendime të gabuara ju bëjnë
të përplasni krahët mbi tokë!"

Dhe të dy së bashku filluam të recitojmë tekstin e mrekullueshëm në italisht, duke u bërë vellezër menjëherë nën krahun e madh të poezisë. Morëm rrugën e lartë që sundon luginën e ngushtë të mbjellë me ullinj e vreshta. Dielli ishte ngjitur mjaft në qiell dhe mbulonte botën me dritë dhe hije të zgjatura. Qëndruam për një kohë të gjatë pa folur. Më në fund shoku im u kthye nga unë.

- Përse e doni shën Françeskun? - më pyeti, por përnjëherë ndërroi mendim:

- Më falni, - më tha, - u tregova i pasjellshëm.

- Unë e dua, - iu përgjigja, - për dy arsye. E para se është poet; një nga poetët më të mëdhenj të kohëve të para të rilindjes. Ai është përkulur dhe ka dëgjuar në krijesat e pakuptimta të Zotit, atë që ata kanë të pavdekshme: melodinë.

- Po tjetër? - thotë Jorgensen, tjetër?

- Tjetër, e dua sepse shpirti i tij, me forcën e durimit dhe të da
shurisë ka mposhtur realitetin - atë që njerëzit e privuar nga krahë
e quajnë realitet - urinë, të ftohtit, sëmundjen, përçmimin, padrejtë
sinë, shëmtimin - dhe ka arritur ta transformojë atë, në një ëndër
të gëzuar, të prekshme, më e vërtetë se vetë e vërteta. Shën Frances
ku kishte gjetur sekretin që alkimistët e Mesjetës më kot luftonin
ta gjenin: sekretin për të transformuar metalin më të pavlerë në ar
të pastër. Sepse "Guri filozofik" nuk ishte për shën Françeskun di
çka e papranueshme, dhe e parëndësishme. Për ta gjetur, nuk duhet
të përmbysësh ligjet natyrore; guri filozofik, ishte pikërisht zemra e
tij. Kështu, me këtë mrekulli të alkimisë mistike, ai mposhti realite
tin, liroi njeriun nga fataliteti dhe transformoi tek ai mishin në shpirt
Shën Françesku është për sytë e mi gjenerali i madh që çon trupat
njerëzore në fitoren absolute.

- Kaq?

- Unë e di se ç'doni të thoni, - ju përgjigja; - kaq. Gjeneral, poet,
dhe kaq.

Heshtëm pak të dy, pastaj pas një çasti:

- Nuk është e mjaftueshme, - thotë Jorgenseni, dhe bëri sikur do
të më prekte supin me dorë dhe të qetësonte reagimin tim përpara
frazës së tij të ashpër; por i ngeli dora pezull dhe ai përsëriti me një
ton më të vendosur:

- Jo, nuk është e mjaftueshme.

Isha gati duke iu përgjigjur; por pata frikë të flisja shkurt dhe u
përmbajta.

Ndërsa Jorgenseni, sikur vazhdonte një refleksion të pazëshëm:

- Prandaj fytyra juaj është kaq e shqetësuar, - më thotë. - Ju luf-
toni akoma, ju akoma nuk keni arritur lehtësimin; kjo luftë e përdit-
shme ju dërrmon. Prandaj ju ndalova këtë mëngjëz e ju fola.

- Ndofta ju më ndihmoni në luftën time, - i thashë, ndërsa zëri-
im ishte nervoz dhe ironik. Më erdhi turp; shpesh herë ne flasim në
mënyrë të tillë se shpirti nuk ka kohë t'i imponohet trupit.

- Mos u zemëroni, - thotë Jorgenseni. - Jo unë nuk mundem.
Duhet secili të gjejë rrugën e tij dhe të shpëtojë. Të shpëtojë nga se?
Nga e përkohshmja; të shpëtojë nga e përkohshmja dhe të gjejë të
përjetshmen.

- Ju, - i thashë, dhe isha këmbëngulës në atë që thosha, - në qoftë

...ërt ju gjykoj nga fytyra juaj e qetë, nga hapi juaj i ngadaltë e i si-
...nga toni gjithmonë i qetë i zërit tuaj, keni gjetur rrugën e sigurtë.
...në qoftë se ne luftojmë akoma, ju na shikoni me mëshirë, ndo-
...dhe me përçmim. Mbase keni lindur të privilegjuar, me vullnete
...ekuilibruara dhe nuk e keni njohur luftën.

...Jorgenseni ndaloi, më pa një çast, zgjati dorën, i vendosur këtë
...dhë, sikur ia zgjaste dikujt që është i mërzitur dhe më shtrëngoi
...krahët.

- Ju jeni akoma i ri, më tha; - edhe unë kam qenë si ju dhe e di.
...nuk keni durim, nuk keni akoma modestinë dhe nuk keni thirrur
...akoma: Ndihmë! Më lini të flas. Jo, unë nuk kam lindur i privilegjuar
...dhe e di shumë mirë se ç'është brenga, lufta, vetë besimi i tepëruar.
...Kur isha i ri edhe unë kisha ambicje të mëdha të frymëzuara nga
...Luçiferri. Shkruaja romane plot sensualitet, ironi e pasion; në vazh-
...dim arti u bë tepër i ngushtë për mua dhe unë u hodha në shkencë,
...u bëra një fanatik i sistemit të Darvinit dhe të të gjitha ideve
...antikristiane; doja të thyeja gjithë kufizimet, fetë, shtetin, moralin,
...dhe të vendosja veten në qendër të jetës: "Luftë armikut të vjetër!"
...shpallja unë; armiku i vjetër, kështu e quaja Zotin. Shkruaja, kudo
...fallesha, në duar mbaja një flamur dhe vrapoja. Papritur heshta,
...ndalova. Një shqetësim i papritur, i pashpjegueshëm, më tronditi
...zemrën; nuk e kuptoja sesi dhe prej nga më vinte - apo kishte ekzis-
...tuar gjithmonë tek unë dhe priste çatin e tij? U largova nga atdheu,
...për t'u liruar nga miqtë dhe zakonet e mia, udhëtova në Gjermani,
...zbrita në Itali, hyra në Assizë.

Qeshi. - Kanë kaluar tridhjetë vjet prej atëherë. Unë jetoj në Assizë prej tridhjetë vjetësh, nën hijen e Shën Françeskut; lavdi Zotit.

- E po mirë? I them. Unë nuk kam lexuar asnjë libër tjetër tuajin përveç atij për shën Françeskun.

- Aq më mirë. Kam publikuar një *Itinerar* ku thosha, ose më mirë përpiqesha të thosha, se çfarë emocioni kisha provuar duke parë qytetet e vjetra, kështjellat, kishat, pikturat... Shkova në një manastir për t'u bekuar, por u tremba, u largova menjëherë, të nesërmen në mëngjes. Sa e qetë dhe gazmore m'u duk jeta e atij komuniteti, në krahasim me jetën që kisha bërë. Për herë të parë unë pashë se cila është rruga që të shpie në lumturi - por unë hezitoja ta merrja...

Jorgenseni u kthye, më tregoi me një gëzim plot emocion, Assizën e shenjtë, me ndërtesat e vjetra dhe akropolin e rrënuar, Roka Grande, që mban si një kështjellë, kishën e madhe me tre kate të shën Françeskut.

- Kthehemi ta shohim? - më thotë.

Morëm rrugën e kthimit; rrugës kalonin fshatarë të hollë, me sy përvëlues, ndërsa përpara tyre duke u lëkundur, ecnin me hap të rëndë, me brirët e kthyer, qetë e famshëm të Umbries. Një fshatare e re, me flokë të zinj pis na përshëndeti gëzueshëm me një zë tingëllues.

- *Paqe dhe qetësi,* - iu përgjigj Jorgenseni, duke i kthyer përshëndetjen françeskanes. Më tregoi në këmbë të Assizës kishën e madhe, ku gjendej e mbyllur kisha e vogël e shën Françeskut, Porciunkola.

- Atje, - më thotë, - brenda në Porciunkola, unë për herë të parë pa dashur, palosa gjunjët duke parë shenjtin e plagosur në pesë vende të trupit. Por më erdhi turp, u mërzita, u ngrita e shkova. Çfarë më kapi? - pyesja veten i mërzitur, - përse u gjunjëzova? Por në të njëjtën kohë, në thellësi të qënies time, shpërndahej një qetësi e pashpjegueshme. Përse? Përse? - pyesja veten akoma, përse të provoj një lehtësim të tillë? Dhe ishe e vërtetë, kurrë deri atëherë nuk kisha provuar një lumturi si ajo. Megjithatë, dikush brenda meje nuk donte ta besonte. Ai përçmonte gjithçka që ishte e mbinatyrshme dhe nuk kishte besim veç tek një gjë: tek inteligjença njerëzore. Fjala e saj ishte ligj. Në portën e zemrës sime, qëndronte ai dikushi, që rezistonte dhe nuk lejonte të hynte mrekullia.

- Epo mirë? Pastaj si erdhi lehtësimi tek ju? - pyeta me padurim duke parë se shoku im heshti përsëri.

- Qetësisht, pa shpërthim, siç vjen gati gjithmonë. Si fruti që piqet dhe fryhet nga lëngu, kështu u poq zemra ime. Përnjëherë gjithçka m'u duk e thjeshtë, e sigurt. Ankthet, hezitimet, luftërat pushuan. U ula tek këmbët e shën Françeskut, hyra në Parajsë. Shën Françesku është vëllai portier që më hapi portën.

I afrohemi Assizës. Dielli ndriçonte kështjellën e saj ngjyrë gjaku, gjysmë të rrënuar, kambana e vogël e shën Klerit, kambana me zë të argjendtë, filloi të tingëllojë, e gëzuar, si kakarisja e thëllënzës.

- Më fal, - tha Jorgenseni, - unë fola shumë për vete; merre këtë si një rrëfim. Unë jam më i madh se ju dhe dua t'ju rrëfehem atyre që janë më të rinj se unë. Sepse, ndoshta, vetëm rrëfimi mund të je-

të i nevojshëm për më të rinjtë.

Ndërsa unë për të fshehur emocionin: - Ah! Sikur shën Françesku të mund të ishte portëhapësi i Parajsës, - thashë duke qeshur, çfarë lumturie! Ai do të lejonte të hynin mëkatarë e të virtytshëm, besimtarë dhe jobesimtarë, bile dhe të pasurit. Bile edhe kafshët më të pështira, - minjtë, krimbat, hienat.

- Do të ishte anarki, u përgjigj Jorgenseni pa qeshur; jo vetëm anarki, por edhe padrejtësi.

Kaluam portën e fortifikuar; në të majtë ishte manastiri i shën Klerit, në të djathtë shtëpia ku banoja unë.

- Edhe unë do të ngjitem për të përshëndetur konteshën e vjetër, - më thotë shoku im. - Më kujtohet, kur erdha për herë të parë këtu; ishte zonja më e bukur e Assizës. Ishte e re atëherë, dhe nuk u martua. Hipur mbi një kalë të bardhë ajo vizitonte tokat e saj - ullishtat, vreshtat. Sikur ajo të kishte jetuar në të njëjtën kohë me shën Françeskun, ajo do të ishte bërë shën Kleri i tij.

- Të njëjtën fe si ju ka ajo? - e pyeta.

- Nuk e keni parë fytyrën e saj? Ajo rrezaton! - u përgjigj ai.

U ngjitëm. Në pallatin e madh e të shkretë bënte freskët, në vatrën e dhomës së konteshës ishte ndezur zjarri. Shërbëtorja e saj, Ermelinda, po rregullonte tavolinën e ulët dhe sillte kafenë, qumshtin dhe bukën për zonjën. Duke na parë ne ajo solli edhe tasë të tjerë, ne u ulëm. Ishte e vërtetë, fytyra e vjetër rrezatonte, sytë e mëdhenj të kadifenjtë, shumë të zinj, nuk ishin shuar nga koha. Porta e kopshtit ishte e hapur; një trëndafil me lule, shkëlqente nga dielli.

- Ku ishit duke shkuar, që në mëngjes? - pyeti kontesha, jam e sigurt se ju po flisni për shën Françeskun.

- Si e dini këtë, konteshë? - thotë Jorgenseni, dhe më pa duke buzëqeshur.

Kontesha filloi të qeshë: - Në të vërtetë, duke dalë në kopsht, unë ju pashë nga larg tek vinit dhe se ishit të mbuluar të dy nga flakët.

Sa të qarta, vinin tek unë ato ditë të Assizës, deri në detaje, sikur shën Françesku, pa ja kërkuar ndihmën, vrapoi për të më treguar rrugën! Sikur të ishte e mundur! Unë shikoja nga larg shenjtin se si përqafonte lebrozët dhe më kishte pushtuar tmerri; e shikoja tek

bridhte këmbëzbathur e predikonte, trokiste, godiste, ndërsa fytyra i ndriçonte nga lumturia. E shikoja dhe zemra rezistonte. Kjo, kurrë! Thosha, i sfilitur deri në vdekje nga një martirizim i menjëhershëm.

Kontakti direkt me njerëzit gjithmonë ka shkaktuar tek unë një shqetësim. Me zemër të madhe, me një gëzim të madh, unë isha gati të ndihmoja nga larg aq sa të mundja; i doja dhe dëgjoja ankesat e tyre por nga larg; kur u afrohesha, nuk mund t'i duroja gjatë; ata jo më pak mund të më duronin, kështu ne ndaheshim. Unë e dua me pasion vetminë, qetësinë, duke parë për disa orë zjarrin, detin, pa patur nevojë për shoqëri. Zjarri dhe Deti kanë qenë shokët e mi më besnikë dhe më të dashur; dhe sa herë kam dashur një femër ose një ide, kjo ka ndodhur sepse kam gjetur në ta trajtat thelbësore të zjarrit ose të detit.

Dhe pastaj, thosha për të justifikuar paaftësinë time për të ndjekur ngjitjen e shën Françeskut, në periudhën e Mamonit dhe të Mollokut që ne kalojmë, si do të ishte e mundur që të shfaqet në tokë një si i Varfëri i Assizës? Aq pafajësi, aq shenjtëri e dashuri? Një don Kishot i tillë i qiellit?

Unë e thosha, e përsërisja, për t'u ngushëlluar; unë nuk e dija akoma se tashmë ishte shfaqur mbi tokë një i varfër i Assizës, rrethuar nga lebrozë të zinj. Në qoftë se do ta kisha njohur në Berlin, gjatë ditëve të krizës e të tranzicionit, ku ndjehesha i detyruar të braktisja paveprimin budist, për aktivitetin revolucionar, do të isha skuqur akoma më shumë nga paburrëria ime. Unë nuk e kam njohur veç shumë vonë, shumë më vonë; kur jeta ime nuk mundej më - dhe ndoshta nuk duhej më - të ndryshonte; kur unë kisha marrë tashmë një rrugë krejt të ndryshme për të plotësuar detyrën time.

Atë ditë të gushtit, kur unë, në mesditë, kisha marrë rrugën e vogël të fshatit Gunsbah, në mes të pyjeve të Alzasës, kur trokita në portën e shën Françeskut tonë bashkëkohës, isha shumë i mallëngjyer. Ai erdhi ta hapë vetë e më shtriu dorën; zëri i tij ishte i fortë e i qetë, buzëqeshte nën mustaqet bojëhiri dhe më shikonte. Kisha parë luftëtarë kretianë të ngjashëm me këtë: plot dashamirësi dhe vullnet të pathyeshëm.

Ky qe një çast i favorshëm i jetës sime, ku hapen zemrat. Qëndro-

va me të deri sa u bë natë; folëm për Krishtin, për Homerin, për Afrikën, për lebrozët dhe për Bahun. Në mbrëmje shkuam në kishën e vogël të fshatit. - Mos flisni më tha rrugës, dhe mbi fytyrën e tij të vrazhdë ishte shpërndarë një emocion i thellë. Ai po luante Bahun. Ishte ulur pranë organos; ajo ditë ka qenë për mua një nga më të lumturat e jetës sime.

Kur po ktheheshim, në krye të rrugës, pashë një lule të egër; u përkula për ta këputur.

- Jo! - më tha, dhe më mbajti dorën; - edhe ajo është një qënie e gjallë, duhet ta respektojmë jetën.

Një milingonë e vogël, me mundim po ecte mbrapsht; ai e kapi me kujdes dhe e vendosi mënjanë që të mos e shtypte. Nuk tha asgjë, por mbi buzët e tij kaluan fjalët e urta të gjyshit të Assizës: "Motra ime, milingona e vogël..."

Në mbrëmje u ndamë; unë u ktheva në vetminë time por kurrë ajo ditë gushti nuk ka patur muzg në shpirtin tim. Unë nuk isha vetëm; pranë meje me hap të fortë e burrëror, ky luftëtar ndiqte rrugën e tij, që për mua ishte një ngushëllim i madh dhe një mësim i rreptë duke e parë gjithnjë në po atë rrugë duke u ngjitur me besim e këmbëngulje. Prej asaj dite unë u binda se jeta e shën Françeskut nuk ishte legjendë, isha i sigurt se njeriu mundej të zbriste në tokë mrekullinë. Unë e kisha parë, e kisha prekur me duart e mia, kisha folur me të, kishim qeshur dhe heshtur së bashku.

Prej asaj kohe unë nuk kam mundur më të ndaj në zemrën time këto dy figura magjepsëse, aq të ndara nëpër kohë dhe aq të bashkuara në përjetësi, dua të them në gjirin e Zotit. Ata ngjajnë si dy vëllezër: shën Françesku i Assizës dhe Albert Shvaicer.

E njëjta dashuri për natyrën, e butë dhe e ashpër; në zemrën e tyre tingëllon, ditë e natë, himni për vëllanë tonë Diell, për motrën tonë Hënën, për Detin, për Zjarrin. Ata mbajnë të dy me majat e gishtave një gjethe peme dhe duke e ngritur në drejtim të rrezeve, shohin mrekullinë e krijimit të gjithësisë.

I njëjti emocion, i qetë, plot respekt, për gjithçka që gjendet përreth, që jeton e merr frymë: për njeriun, gjarpërin, milingonën. Për të dy jeta është e shenjtë; përkulur mbi sytë e çdo qënieje të gjallë, ata dridhen nga gëzimi duke parë të reflektohet aty Krijuesi. Duke parë milingonën, gjarpërin, njeriun, ata zbulojnë, mbushur me lum-

turi, se ne jemi të gjithë vëllezër. E njëjta dhembshuri dhe e njëjta dashamirësi për gjithçka që vuan. Njeri ka zgjedhur lebrozët e bardhë, tjetri lebrozët e Afrikës - çmimi më i egër i mjerimit dhe i vuajtjes. Unë thashë dhembshuri dhe dashamirësi, por duhet thënë Meta. Vetëm kjo fjalë hinduse mund të shprehë tamam, ndjenjën që lind, tek këta dy vëllezër, vuajtja njerëzore. Te dhembshuria dhe dashamirësia ka dy qënie: ai që vuan dhe ai që ka mëshirë për atë që vuan; te Meta ka njëjtësi absolute: duke parë një lebroz, unë ndjej se jam unë që jam lebroz. Sari-al-Sakadi, besimtari mysliman i shekullit IX, e ka shprehur rigorozisht: *Dy qënie nuk duhen në perfeksion në qoftë se njëra nuk i thërret tjetrës: O vetja ime!*

E njëjta kllapi hyjnore: të heqësh dorë nga gëzimet e jetës, të sakrifikosh perlat e vogla për të arritur perlën e madhe; të lësh rrugën e sheshtë që të çon tek lumturia e zakonshme, dhe të marrësh rrugën e përpjetë, të ashpër, që midis dy greminash të çon tek kllapia hyjnore. Të zgjedhësh, me dëshirën tënde, të pamundurën.

I njëjti humor i padjallëzuar: e qeshura që buron nga thellësitë dashamirëse të zemrës, gëzimi, bijë e dashur e shpirtit të pasur, forca për të parë dhe pranuar me durim dhe kuptim fytyrën e realitetit të përditshëm. Spartanët që nuk qeshnin kurrë, i kishin ngritur një altar Zotit të të qeshurit; serioziteti i tyre ekstrem, gjithmonë i ka bërë thirrje të qeshurës, sepse është e vetmja mënyrë që mund të ndihmojë një shpirt të thellë të durojë jetën. Zoti u ka dhënë këtyre dy vëllezërve një zemër të gëzueshme, prandaj ata udhëtojnë të gëzuar drejt majës së luftës së tyre, drejt Zotit.

E njëjta dashuri, plot pasion, për muzikën. Ajo që Tomas Kelano ka thënë për njërin aplikohet në mënyrë të plotë për tjetrin: - Një ndarëse mjaft e hollë ndante vëlla Françeskun nga përjetësia; ja përse ai dëgjonte melodinë hyjnore nëpërmjet kësaj ndarjeje të hollë. Kënaqësia që provonin ata duke dëgjuar atë melodi i çonte në ekstazë. - "Në qoftë se ëngjëjt që luanin në violinë në ëndërrën time do të kishin kaluar edhe njëherë harkun mbi kordat, shpirti im do të ishte ndarë nga trupi, aq e papërballueshme ishte kënaqësia." - thoshte njëri; unë jam i sigurt se edhe tjetri provonte të njëjtën kënaqësi duke luajtur Bahun.

Të dy zotëronin gurin filosofik, që transformon në ar, metalin më të pavlefshëm, dhe arin në shpirt. Realitetin më të ashpër, së-

mundjen, urinë, të ftohtit, padrejtësinë, poshtërsinë, ata e shndërrojnë në një realitet më real, ku fryn shpirti; ose, jo shpirti, por, dashuria.

Gjithë kjo erdhi shumë vonë. Unë nuk e dija gjatë ditëve vendimtare të Berlinit, dhe kur pashë mrekullinë njerëzore në fshatin e vogël të Alzaës, tashmë i kisha gishtat të llangosur me bojë, isha përfshirë nga mania e keqe; isha bërë, nuk e di sesi, një shkresaxhi. Më ishte shfaqur ajo që përçmoja më shumë: e shuaja urinë, si dhi, me letra.

Ata të Varfër të Assizës më kishin dhënë një ndihmë të çmueshme: më kishin provuar se njeriu është i aftë dhe ka detyrë, të arrijë deri në fund të rrugës që ka zgjedhur. Kush e di, ndoshta në krye të rrugës, të gjithë luftëtarët do të takohen. Prandaj ata kanë qenë për mua një shembull sublim i këmbënguljes, durimit, e shpresës. Qofshin bekuar ata dy atletë që më mësuan se vetëm me forcën e shpresës mund të arrihet e pashpresuara.

I inkurajuar prej tyre, bëra një tentativë për të mposhtur të natyrshmen time dhe mora, për një kohë mjaft të gjatë, rrugën ku më çonin dhembshuria, indinjata dhe fjalët kafshuese të Itkës. Për të nuk jam menduar më. Kur u ktheva përsëri në rrugën time natyrore, e kuptova se zemra ime ishte mbushur me vuajtje njerëzore. Dhe se nuk ka veç një mënyrë për ta shëndoshur atë, e cila është të shpëtosh, ose më mirë, të luftosh për të shpëtuar. Edhe këtë akoma; se bota nuk është një fantazmë, por është e vërtetë, dhe se shpirti njerëzor nuk është, si ma shpjegonte Buda, veshur me erë, por është e veshur me mish.

Por kur përpiqesha të merrja vendim, shpirti im rezistonte fort; ai ishte i mbështjellë akoma në dollomanë e verdhë të Budës. - Ajo që ti ke ndërmend të bësh, - i thoshte ai zemrës sime, - është e kotë; bota që ti e dëshiron me pasion, një botë ku të mos ketë as uri, as të ftohtë, ku askush të mos shtypet, nuk ekziston e nuk do të ekzistojë kurrë. - Por zemra ime, unë e dëgjoja në thellësinë time që i përgjigjej: - Ajo nuk ekziston, por do të ekzistojë, sepse unë atë dua; në çdo të rrahur timen, unë e dëshiroj dhe e dua. Unë besoj në një botë që nuk ekziston; por duke i besuar asaj unë e krijoj. Atë e quan inekzistente ai që nuk ka shumë dëshirë.

Ajo përgjigje e zemrës sime më tronditi shumë; në qoftë se ajo

që thoshte ishte e vërtetë, çfarë përgjegjësie të tmerrshme kishte njeriu në të gjitha padrejtësitë dhe turpet e botës!

Pas pak ditësh, ritmi u shtua, ndoshta ngaqë shpirti im qe gati ngjarjet vinin njëra pas tjetrës, dhe më shtynin; ndoshta në një kohë tjetër unë do t'i kisha quajtur spektakël, ndërsa tani i konsideroja mishin e mishit tim.

Një mëngjes, ne nuk ishim zgjuar akoma, dëgjuam poshtë në rrugë një zhurmë të mbytur dhe pa mbarim, një oshëtimë që vinte nga larg; dukej sikur, shumë larg, një kope demash që shkonte në thertore, kishin ndjerë litarët e kuq rreth qafës dhe pëllisnin.

Itka u hodh nga krevati, u mbështoll me pallton e saj të grisur, dhe, pa parë nga unë, zbriti shkallët. Zhurma nuk pushonte, afrohej, unë dola në dritare dhe e hapa; binte një borë e lehtë, në Greqi malet dhe brigjet duhej të ndriçonin nga dielli mëngjesor, ndërsa këtu një dritë e baltosur dhe e sëmurë zvarritej mbi asfaltin e mbuluar nga bora.

Rruga ishte e shkretë, asnjë këmbë njeriu, asnjë qen; ndërsa më larg, duke mbushur gjithë ajrin, oshëtima e rëndë që afrohej. Unë prisja; pak nga pak rruga u ndriçua; dy korba qëndruan mbi një pemë mbuluar me brymë, pa asnjë thirrje: edhe ata prisnin.

Papritur në krye të rrugës u shfaq një grua shtatmadhe me flokë të lëshuar; ajo nuk ecte, por hidhej, gati vallëzonte, ndërsa mbi kokë tundte një flamur të zi. Prapa saj, pashë të vendosur në kolona të rregullta, për katër, një ushtri burrash, grash, fëmijësh, që ecnin përpara duke llapushitur nëpër borë; drita e baltosur binte mbi ta, dukeshin vetëm fytyrat e zbehta e të ashpra, sytë e tyre që s'ishin veçse vrima të zeza; më dukeshin sikur kishin dalë nga varret, të verbër, ngrënë nga krimbat, rreshta të formuar nga një ushtri kafkash.

Drita u bë më e fortë dhe unë shihja tani më qartë. Disa tregtarë përballë, nxirrnin çelësat për të hapur dyqanet. Por sapo panë ushtrinë e egërsuar, futën çelësat në xhepa dhe u ngjeshën pas mureve. Gruaja i pa, u ngjit në trotuar, iu afrua, tundi mbi kokat e tyre flamurin e zi, dhe një thirrje e çjarrë çau ajrin: - Ne kemi uri!

Në këtë kohë gruaja ngriti sytë drejt dritares ku isha unë, hapi gojën, unë u tremba duke dëgjuar atë që po më thoshte, dhe pa e ditur seç thosha fillova të thërras: Pusho! Pusho!

Mbylla menjëherë dritaren dhe u ngjita pas murit të dhomës si-

më si tregtarët.

- Ata kanë uri... kanë uri..., - pëshpërisja, i tronditur, - është ushtria e Urisë...

Unë nuk munda, nuk guxova të dal gjatë gjithë ditës: kisha frikë mos takoja në rrugë gruan që mbante në duar flamurin e urisë; atje, ajo do të kishte mundësi të më thoshte fjalën e tmerrshme, të padurueshme. E dija se cila do të ishte ajo fjalë, prandaj kisha frikë, prandaj kisha turp.

Rreth mesditës, erdhi Itka, e zbehtë, duke gulçuar, hodhi në tokë pallton e grisur, dhe filloi të ecë nëpër dhomën e ngushtë, unë dëgjoja frymëmarrjen e saj të dobët, i mbledhur kruspull në një qoshe dhe prisja. Papritur ajo u kthye nga unë dhe shtriu dorën drejt meje.

- Është faji yt, klithi, është faji yt! Është faji i ju të gjithëve, njerëz me qëllime, të ngopur, indiferentë. Unë do të dëshiroja që ti të kishe uri, që ti të kishe fëmijë që të kishin uri, që ti të kishe ftohtë, dhe ata të kishin ftohtë, që të doje të punoje dhe askush të mos të të jepte punë. Ndërsa ti shëtit nga qyteti në qytet, viziton muzetë dhe kishat e vjetra, qan duke parë yjet, sepse ata të duken të bukur ose të tmerrshëm. Por uli sytë, miku im i gjorë, shiko tek këmbët e tua një fëmijë që vdes!

Ajo heshti pastaj, pas pak: - Ti shkruan poezi, flet, ti ke një hapësirë të tërë të flasësh për varfërinë, padrejtësinë, dhe urinë, ti ndërton bukuri me vuajtjen tonë e cila ikën, avullon. Mallkuar qoftë bukuria, në qoftë se ajo bën që njeriu të harrojë vuajtjen e njerëzve!

Dy pika lot rrodhën nga sytë e saj; unë ju afrova për ta prekur, për t'i vendosur dorën mbi flokë, për ta qetësuar; por ajo kërkoi falje, më shtyu dhe thirri:

- Mos më prek!

Më hodhi një shikim jo vetëm plot përçmim, por edhe plot urrejtje.

Gjaku më vërshoi në kokë, u zemëróva: - Çfarë do ti që të bëj? Çfarë mund të bëj? Më lër të qetë!

- Unë nuk do të të lë të qetë; ti do të doje që unë ta bëja për t'u lehtësuar, por jo, unë nuk do të të lë të qetë! Ti nuk mund të urresh, unë do të të mësoj; ti nuk mund të luftosh, unë do të të mësoj!

Ajo vizatoi një qeshje, fytyra i ndryshoi; nuk ishte e qeshur, ishte një konvulsion i padurueshëm i mishit. U afrua pranë meje: - Ti e njeh proverbin oriental: "Kush hipën mbi një tigër nuk mund të vë-

rë më këmbën në tokë!

Hapi një dollap të vogël, nxori prej andej bukën, pak djathë, disa mollë; ndezi furnellën, përgatiti çajin. Nuk flisnim asnjë fjalë; ulëm mbi dy stola, aq sa ishin në atë dhomë, afruam tryezën e vogël dhe filluam të hamë. Shikoja vetullat e saj që lëviznin, kur po merrte tasin për të pirë, dora e saj, pa e kuptuar mbeti pezull; ajo e kishte shpirtin tek tjetër gjë, një ide e torturonte; unë haja, përkulur përpara, i turpëruar, sepse unë e ndjeja dhe skuqesha prej saj, se ajo femër ishte më e fortë se unë.

Përfunduam së ngrëni; ajo ngriti kokën, më pa; sytë e saj tashmë shkëlqenin, buzët e saj ishin përsëri të kuqe.

- Më falni, - tha, - të fola ashpër; por unë sapo erdha nga ushtria e urisë.

U ngrit, shkoi te dritarja, hapi perden e çngjyrosur; një dritë e këndshme u shpërnda nëpër dhomë. Mënjanoi tryezën e vogël, për të bërë vend. Shkoi te divani, hapi mbulesën. Unë e shikoja me cep të syrit dhe kur ajo shkopsiti jelekun u kthye nga unë dhe më pa:

- Ty të vjen gjumë? - i thashë, dhe qesha.

- Jo, m'u përgjigj, zëri i saj qe zbutur; jo eja!

Të nesërmen ajo u ngrit përpara se të gdhihej, përgatiti me nxitim valixhen e saj të vogël, u afrua tek divani, më zgjoi:

- Unë po iki, më tha.

Unë u drodha. - Ti po ikën? Ku?

- Larg, mos bëj pyetje. Shpresoj të shihemi.

- Kur?

Ajo tundi supet. Mbështolli fort flokët në një sharp të gjelbër, u përkul dhe mori valixhen. Më pa; sytë e saj blu të thellë, të thatë, buzët e trasha qeshën.

- Të falënderoj për gjithë netët, - më tha; - ne e kemi plotësuar detyrën tonë ndaj trupit. Ne kemi pështëritur Budën! Përse më shikon ashtu? Të vjen keq?

Unë nuk iu përgjigja; në thellësinë time ishte grumbulluar një ëmbëlsi e hidhur; gjithë ato netë e ditë trazoheshin tek unë dhe më mbushnin qenien me shqetësim.

- Ty të vjen keq? - pyeti ajo përsëri. - U afrua te porta për ta hapur.

- Po, - iu përgjigja, - më vjen keq. Ti më shkatërrove Budën, zemra ime mbeti bosh.

- Ti ke nevojë për një mësues? Ajo qeshi me ironi.

- Po; një mësues është më i mirë se anarkia. Buda i jepte ritëm, i jepte qëllim jetës sime; ai frenonte demonët që gjenden brenda meje; dhe...

Ajo ngrysi vetullat; nuk qeshi më.

- Shok, - tha (ishte hera e parë që ajo më fliste shok) shok, zemra jote është zbrazur, pastroje, ajo është gati. Këtë doja. Unë kam besim, mos u vërë re fjalëve të mia kur jam e nxehur, ti je njeri i ndershëm, unë kam besim tek ti...

në çast reflektoi.

- Jo tek ti, por te klithma e kohës sonë; mbaj qetësi dhe do ta dëgjosh. Lamtumirë.

Ajo hapi portën, unë dëgjoja hapat e saj të shpejtë duke zbritur shkallët.

"Mbaj qetësi dhe do ta dëgjosh!" ; ato fjalë të Itkës më ndoqën shumë ditë e netë. Rrija i heshtur, mbaja vesh se mos e dëgjoja. Shkoja në kuvendet që bënin miqtë e Rusisë, lexoja librat dhe broshurat e tyre, kaloja netët në lagjet punëtore të Berlinit, shikoja varfërinë dhe skamjen, dëgjoja diskutimet e mjegullta, thithja një ajër ngarkuar me pezmatim.

Në fillim isha pushtuar nga trishtimi dhe dhimbshuria, pastaj nga mërzia, pastaj nga bindja e hidhur për përgjegjësinë time "sa të drejtë kishte ajo, çifutja e zjarrtë, është faji im! Sepse unë nuk ngrihem për të thirrur, sepse, të shoh ty dhe të përkrah por menjëherë harroj; sepse në mbrëmje unë shtrihem në një krevat të ngrohtë e fle, dhe nuk mendoj për ata që s'kanë strehë!"

Një natë një dishepull i shën Françeskut, e gjeti mësuesin e tij duke ecur i zhveshur, në zemër të dimrit, duke u dridhur. - At Françesk, - i tha atij i habitur, - përse rri lakuriq në këtë të ftohtë?

- Sepse mijëra dhe mijëra nga vëllezërit dhe motrat e mia në këtë çast kanë ftohtë, vëllai im; unë nuk kam rroba për t'u dhënë atyre që të ngrohen, atëherë më mbetet veç të kem ftohtë si ata.

Sillja ndër mend ato fjalë të të Varfërit të Assizës, por nuk mjaftonte, vetëm tashti e ndjej se nuk mjafton që të kesh ftohtë me të tjerët. Duhet të lëshosh një klithmë: të gjithë ju që keni uri, që keni ftohtë, përpara, rrëmbeni rrobat që janë me shumicë, mbuloni me to lakuriqësinë tuaj!

Pak nga pak, unë po filloja të dyshoja në rëndësinë që kishte për gjithë njerëzit, eksperienca e përgjaktë, në vendet e mëdha, në shpirtin e madh të Rusisë. Fjalët e shoqatave revolucionare, që më parë më dukeshin shumë naive, shumë utopike, shpirti im tani i pranonte, i rishikonte. Shikoja fytyrat e uritura, buzët e thara, grushtat e shtrënguar, dhe po filloja të kuptoja privilegjin hyjnor të njeriut: Me forcën e besimit, vullnetit, lotëve që ju rrjedhin, të djersës e gjakut të tyre, lotët vetëm nuk mjaftojnë, as djersa, as gjaku, njerëzit transformojnë një Mit në realitet.

U tremba; për herë të parë po shikoja se sa krijuese është ndërhyrja e njeriut, dhe sa e madhe është përgjegjësia e tij.

Në qoftë se realiteti nuk merr fytyrën që ne duam, është faji ynë; ajo që ne nuk e kemi dëshiruar shumë, është ajo që ne e quajmë inekzistente: dëshirojeni atë, vaditeni me gjakun tuaj, me djersën dhe lotët tuaj, dhe ajo do të bëhet e prekshme. Realiteti nuk është gjë tjetër veçse iluzioni i nënshtruar dëshirës dhe vuajtjes sonë.

Zemra ime filloi të rrahë për njerëzit që kanë uri dhe shtypen, të cilën nuk e durojnë dot më dhe sulmojnë. Gjaku im kretan po nuhaste revolucionin dhe kishte filluar të ziente; Unë pashë sërisht përpara meje kundërshtarët e perjetshëm, Lirinë dhe Skllavërinë, dhe Kreta brenda meje u drodh, lëshoi një klithmë.

Mos vallë ajo ishte thirrja që unë prisja? Ndoshta. Në momentet më të vështira të jetës sime, Kreta gjithmonë është derdhur brenda meje dhe ka nisur të klith.

Një mbrëmje i lodhur nga spektaklet mizore të ditës, përkulur mbi tavolinën time, shfletoja një libër për artin e Rilindjes, për të harruar ç'kisha parë, dëgjuar e vuajtur duke ecur nga mëngjesi. Më mirë se vera dhe dashuria, më pakuptuar se vetë mendimi, arti mund të joshë njeriun dhe ta bëjë të harrojë. Ai zhvendos detyrën, përpiqet të transformojë të përkohshmen në të përjetshme, dhe të ndërtojë bukurinë me vuajtjen e njeriut. Çfarë rëndësie ka që Troja u përvëlua nga flakët, dhe se Priami dhe bijtë e tij u vranë? Çfarë do të fitonte bota - sa do të ishte varfëruar shpirti i njeriut - në qoftë se Troja do të vazhdonte të jetonte, e lumtur, dhe në qoftë se Homeri nuk do të kishte transformuar masakrën në dymbëdhjetë rrokshin e pavdekshëm.

Një statujë, një varg, një tragjedi, një tavolinë, ja trofetë më të

ra që njeriu ngriti mbi tokë.

Më të shquarat dhe më të rrezikshmet për vuajtjen e përditshme njeriut. Ai nënvleftëson proekupimet e përditshme, mbijetesë dhe drejtësi dhe harron se ato janë rrënjët që ushqejnë lulen e pavdekshme.

Kristianët e parë kishin të drejtë që nuk donin t'i jepnin Virgjëreshës një fytyrë të bukur, sepse, të tërhequr nga bukuria e saj, do të harronin se ajo ishte nëna e Zotit.

Papritur trokasin në portë, unë e hapa; një telegram nga Moska! E lexova, e rilexova, fërkova sytë. E nxora në dritë; e vëreja me vëmendje, sikur fshihte një sekret të rrezikshëm, që doja ta vlerësoja përpara se të merrja një vendim. Kjo copë letër, mendoja, mund të jetë një shenjë që më dërgon Fati, për të ndryshuar Jetën time. Për të mirën apo të keqen time? Kush mund të ketë besim tek fati? Ai nuk është i verbër, ai verbon.

Të shkoj apo të mos shkoj? Telegrami më ftonte të shkoja në Moskë për të përfaqësuar intelektualët grekë për festimet e mëdha të dhjetëvjetorit të revolucionit. Pelegrinë të shumtë vraponin nga të katër anët e botës në Moskën e Kuqe. Kush mund ta kish dhënë emrin tim për të më bërë ftesë? Përse duhej të isha unë që të më zgjidhnin? Pas tre ditësh e kuptova; mora nga Moska një fjalë të shkurtër nga Itka, që tallej me mua dhe më ftonte:

- Aristokrat, budist i gabuar me barkun plot, diletant i vuajtjes, mirëmëngjes!

"Deri tani ti ke kërkuar fytyrën e Zotit dhe nuk ke pushuar së bredhuri, duke kaluar nga një Zot i rremë në një tjetër Zot të rremë; eja pra këtu, miku im i gjorë, ti do të gjesh fytyrën e Zotit të vërtetë, fytyrën e Njeriut. Eja, në qoftë se do të shpëtosh. Bota që po ndërtojmë është akoma një kantier, ndërto edhe ti me të tjerët, vendos një gur! Buda është i mirë, shumë i mirë, por vetëm për të vjetrit."

Kishte rënë nata. U çova, hapa dritaren; nuk binte më borë, kudo qetësi; ora e një kambanareje tingëlloi ëmbël në ajrin e akullt; poshtë në rrugë, shkëlqenin pemët e mbuluara me brymë. Dhe ndërsa syri im humbiste në mjegullën e natës, Rusia shfaqej përpara meje, mbuluar me borë, e pafundme, me izbat e saj të ngrohta, plot dritë, sajat duke rrëshqitur mbi borë; nga hundët e kuajve ngrihej avulli dhe unë tashmë dëgjoja trokthin e gëzuar të patkonjëve të

tyre. Ndërsa larg, në hapësirën mbuluar me borë, shkëlqenin kupola të praruara që në vend të kryqit, në majë, kishin një flamur të kuq si shkëndijë. M'u kujtua një murg në malin Athos gjysmë i marrë "Çdo njeri, më thoshte, çdo gjë ka një gjuhë flake sipër; në qoftë se këto flakë shuhen njeriu dhe sendi zhduken." Ai kishte të drejtë: Rusia, mendoja, ka gjithashtu një gjuhë flake në majë; në qoftë se këto flakë shuhen, Rusia është e humbur.

Mbylla dritaren me nxitim; kisha marrë vendim të nisesha për në Moskë.

Mrekullia shtyn realitetin, krijon një të çarë dhe hyn... Kur viti kishte rrjedhur, Lenini mblodhi rreckat e tij të varfëra, bëri një pako të madhe me dorëshkrimet e tij, mbështolli gjithçka kishte në një baule, u përshëndet me qiradhënësin, mballomatarin, që i kishte dhënë me qera një dhomë në shtëpinë e tij në Zvicër.

- Ku shkon Nikollaj Iliç? - i tha ai, duke i mbajtur dorën dhe e shikonte me dhembshuri. - Ku shkon Nikollaj Iliç, ç'marrëzi të ka kapur të kthehesh në atdheun tënd, ç'do të bësh atje? A do të gjesh një dhomë? A do të gjesh punë? Qëndro këtu i qetë, Nikollaj Iliç; po të këshilloj mirë.

- Duhet, duhet të iki, - i përgjigjej tjetri.

- Ai të kërkon? Përse të kërkon?

- Ai më kërkon, - përgjigjet qetësisht Lenini.

- Por ti ke paguar gjithë qeranë dhe muaji nuk ka mbaruar; ta dish unë nuk do ta kthej diferencën.

- S'ka gjë, s'ka gjë, - thoshte tjetri; - mbaje, duhet të iki.

Dhe shkoi. Ai vuri këmbën mbi tokën ruse, me kasketën e vogël, këmishën e pastër, rrobat e vjetëruara, i shkurtër, i zbehtë, i paarmatosur. Përballë tij, toka e pafund ruse, muzhikët e vrenjtur, të budallallepsur, aristokratët e gëzuar, klerikët e gjithëpushtetshëm, garnizonet, pallatet, burgjet, kazermat, ligjet e vjetra, moralet e vjetra, dhe kërbaçi: arma e perandorisë së tmerrshme. Ndërsa ai, me kasketën e vogël, sytë e vegjël të mongolezit fiksuar në hapësirë, ndjente brenda vetes së tij një demon që vallëzonte, fërshëllente, shtrëngonte dhëmbët dhe i fliste: "Gjithë kjo Iliç është jotja; po ta jap, po ta bëj dhuratë! Ti vetëm një fjalë thuaj, fjalën magjike, që unë të pështëris

prej vitesh: proletarë të të gjithë vendeve bashkohuni! Thuaj atë, dhe carët, fisnikët të mbuluar me ar, priftërinjtë e veshur mirë, të ushqyer mirë, barkshpuar - ti veç t'ju frysh atyre dhe do të bien përmbys. Kapërce kufomat e tyre dhe ngjitu e ngul flamurin e kuq mbi Kremlin; me çekan thyeju kokat, preju grykën me drapër!"

- Kush je ti? - e pyeti Lenini, ndërsa dëgjonte me grushtat shtrënguar, demonin që qëndronte brenda tij. - Më thuaj emrin, se dua ta di, kush je ti?

- Unë jam Mrekullia, - u përgjigj demoni, dhe shtynte Rusinë me brirë.

Pak njerëz deri këtu, kanë mundur, që me një shikim të pastër e të plotë, të shohin tërësisht fytyrën e kompozuar, plot hije e dritë të Rusisë. Ka një humnerë të madhe ndërmjet shpirtit sllav dhe shpirtit evropian. Rusi mund t'i japë vetes privime që ngelen të pakonceptueshme për arsyen evropiane. Evropiani vendos mbi të gjitha inteligjencën e kulluar, mohon në shkallë racionale vlerat; rusi vendos mbi gjithçka shpirtin, forcën e errët, të pasur, komplekse, kontradiktore që shtyn njeriun mbi arsyen, në pasionin e dhunshëm dhe të pa peshuar. Forcat e verbëra krijuese, nuk janë kristalizuar akoma tek ai në formën e një jerarkie irracionale. Rusi edhe më akoma, bëhet një trup me tokën, ai është plot tokë dhe errësirë kozmogonike.

Unë vlerësoja figurën plot zjarr e flakë të Leninit; përpara meje shikoja, muzhikun që e pengonte atë shpirt këmbëngulës të punonte. Unë gjithmonë e më shumë dëshiroja t'i shihja të dy të përjetëshmit së bashku - shpirtin dhe lëndën - të luftonin në palestrën e përgjaktë dhe të mbyllur të Kremlinit.

Bora binte furishëm, gjithë fusha e punuar ishte mbuluar prej saj dhe nën të ushqehej gruri i porsambjellë; muzhikët lëviznin ngadalë, pa u nxituar sikur ishin të përjetshëm; herë pas here, sipër çative të njerëzve, fluturonte duke kërkuar ushqim një korb i heshtur, i zi. Unë në një stacion prisja trenin për udhëtime të gjata. Rrotull meje figura mongole, me sy të vegjël, mjekra mbushur me fara pjepri; dy gra nxirrnin kartat, një muzhik i vjetër derdhte çajin në një çanak dhe e rrufiste me zhurmë e më një kënaqësi kafshe; disa kinezë nën mbulesat me pupla, mbanin të porsalindurit mbi shpinë ose mbi qafë, si kangurët. Masë e madhe njerëzish që djersinte nga vapa, dhe gjithë ajri kishte një erë stalle; ndoshta erën e stallës së Betlehemit.

Erdhi mesdita, pastaj mbrëmja, ne prisnim. Fytyrat rreth meje ishin të rënda, të qeta, askush nuk dilte jashtë për të parë në se vinte treni. Të gjithë, ishin të sigurt, se treni do të vinte patjetër atë ditë, ose të nesërmen. Ata nuk i llogarisnin orët me sahat; ata e dinin se koha ishte një zotëri, një dukë i madh dhe trembeshin ta kundërshtonin.

Afër agimit, u dëgjua së largu, fërshëllima e trenit; të gjithë u ngritën, pa u nxituar, duke mbledhur rraqet. Një burrë me mjekër të thinjur që ishte shtrirë pranë meje dhe kishte gërhitur gjithë natën, më pa dhe më shkeli syrin, me një pamje triumfuese si për të më thënë: Pse mërziteshe, kur e shihje se treni nuk po vinte, duke mos mbyllur sytë gjithë natën? Ja tek erdhi!

Binte borë përsëri, kisha të vogla me kupola me majë, të gjelbëra, tymi i palëvizshëm mbi çatitë; përsëri korba, qielli i ulët. Unë shikoja, shikoja, kisha dalluar thellësinë blu të largët që kanë sytë e njerëzve në fushat pa fund. Unë vazhdoja të shihja dhe ja, përnjëherë, rreth mesditës, u dukën nga larg, turbull, nën qiellin e hirtë, kupolat e rrumbullakta e të praruara.

Më në fund u afruam, po mbërrinim në Jeruzalemin e Zotit tonë, Punëtorit, në zemër të Rusisë; ndoshta në zemrën e botës së sotme, në Moskë.

Në stacion më priste Itka. Kur më pa ajo filloi të qeshë:

- Ke rënë në grackë, - më tha, - mos ki frikë. Ajo është e gjerë, sado larg që të shkosh nuk do të gjesh pengesa; kjo është liria. Mirë se erdhe.

MOSKA

Ecja gjithë ditën, nuk ngopesha duke parë atë kaos shumëngjyrësh plot farëra, Moskën. Gjithë Lindja ishte derdhur mbi dëborë. Tregtarë, shitës orientalë, veshur me turbane të rëndë, kinezë të zeshkët si majmunë, që shisnin rripa lëkure, zbukurime të vogla druri dhe letre; mbi gjithë trotuaret dëngje burrash dhe grash, shisnin duke thërritur me zë të lartë, fruta, peshk të tymosur, grykëse për të porsalindur, pula të gjalla, statuja të vogla të Leninit. Disa fëmijë thërrisnin për gazetat e tyre, me një cigare në buzë, kalonin punëtorë, me shami të kuqe mbi kokë; Kishte atje femra të mëdha në trup, me mollëza dhe sy mongolezë. Fëmijë gjysmë të zhveshur, që mbanin në kokë kapuçe të vegjël astrakani, sakatë që zvarriteshin nëpër trotuare, me dorë të shtrirë e që përkuleshin përpara çdo kalimtari... Kalonin muzhikë veshur me lëkurë lope me ngjyrë të kuqerremtë, me mjekra të ashpra xhufka misri dhe gjithë ajri ruante erën e tyre, sikur të kalonte një kope lopësh.

Kishat, me kupola të gjelbëra ose të praruara, grataçielët, mbishkrimet nëpër rrugë, mbi kisha, mbi tramvaje: "Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!" ndërsa mbi muret e një kishe të madhe, me ngjyrë të kuqe: "Feja është opium për popullin" - dhe fare papritur, afër mbrëmjes, mbi gjithë këtë zhurmë të tmerrshme e të çrregullt, tingëllonte shumë ëmbël zëri i mprehtë i kambanave ruse, për shërbesat e darkës, që vazhdonte të mbijetonte. Kaosi - ja përshtypja ime e parë nga Moska.

E dyta ka qenë frika. Në asnjë qytet tjetër të botës, nuk mund të shohësh ato fytyra të ashpra, të vendosura, që nuk e njohin të qeshurën. Ata sy përvëlues, ato buzë të shtrënguara, ai tension, ajo krenari e dhunshme.

Dukej sikur lëvizje në një qytet të zymtë mesjetar, plot qarkullim; armiqtë afrohen dhe luftëtarët armatosen prapa portave të mbyllura. Atmosfera është plot përgatitje mizore luftarake. Mbi kokat e të

gjithëve qëndron një kërcënim i madh dhe një shpresë e madhe. Këtu, diçka është duke u mprehur që të mbush me tmerr; një *Kerubin** i zjarrtë - edhe sy, edhe shpatë me dy presa - qëndron i palëvizshëm mbi kullat e Kremlinit, si një iluzion mesjetar, në një këmbanare gotike, që rri zgjuar mbi Moskë, për mijëra sy, për mijëra shpata.

Në qoshe të rrugës u duk një njësi e ushtrisë së kuqe duke kënduar këngë të egra të luftës. Rruga shungulloi prej tyre, kalimtarët u shpërndanë duke vrapuar, një grua e re, e shëndoshë, që mbante në dorë një shportë me mollë, ulëriu nga frika dhe mollët u shpërndanë duke u rrokullisur ashtu të kuqe mbi borë. Ata ecnin me hap të rëndë, mbanin kapuça me majë si mongolët, kapota bojëhiri që u vinin deri te këmbët; fytyrat e tyre ishin të egra dhe të dehura. Oficeri ecte në krye dhe intononte këngën. Kur ai kaloi pranë meje, unë pashë: goja e tij lëshonte konvulsione epileptike, venat e qafës i ishin fryrë sikur do t'i pëlcisnin, djersa i rridhte mbi faqe; për një çast ai këndonte i vetëm dhe duke e parë tek ecte do të besoje se ai kërcente, por, ishte ritmi i trupit të tij. Ai këndonte i vetëm dhe menjëherë ushtarët përsëritnin këngën dhe gjithë rruga e akullt bëhej e zjarrtë dhe kumbonte si një kamp. Një dridhje e lehtë kaloi mbi shpinën time; si një vetëtimë realiteti të ardhshëm. - Kush e di? - mbase kaloi në shpirtin tim: Rusët kishin ardhur dhe plaçkisnin një qytet të madh si Londrën ose Parisin.

Unë isha me Itkën. Ajo gëzohej tek shihte frikën time. - Kush është bisha më mishëngrënëse? Është besimi i vjetëruar. Tashmë ne kishim hyrë në grykën e besimit të ri.

Po atë mbrëmje unë njoha poetin muzhik më fetar dhe më të këndshëm Nikolaj Klioniev. Një mjekër e verdhë dhe e rrallë, duhej të ishte dyzet vjeç, por dukej shtatëdhjetë; fliste me një zë të trashë, shumë përkëdhelës, me një krenari të fshehtë. - Unë nuk bëj pjesë te Rusët që bëjnë politikë dhe topa; unë i përkas fijes së artë për të cilën thuren legjendat dhe ikonat. Nga ne varet Rusia e vërtetë.

Heshti, sikur i erdhi keq që zbuloi mendimet e tij; por krenaria e sundoi, ai nuk mund të tërhiqej më.

- Demat dhe arinjtë nuk mund të thyejnë portën e fatit; por zemra

---

*engjëll

e një pëllumbi e thyen.

Mbushi gotën e vogël prej qelqi me vodkë dhe filloi të pijë me gllënjka të shkurtëra e të përplasë gjuhën, i kënaqur. Edhe njëherë u përpoq të flasë; mbylli përgjysmë sytë, e më shikoi.

- Mos dëgjo se ç'them unë, unë nuk e di ç'them; unë jam poet.

Ishte vigjilja e ditës së madhe; Revolucioni Rus festonte përvjetorin e lindjes së tij të përgjakshme. Kishin ardhur pelegrinë nga e gjithë bota, të bardhë, të zesë, të verdhë. Në kohë tjetër kështu do të kishin shkuar në Mekë racat ezmere të lindjes, të verdhët. Qendra e tokës zhvendoset; sot, miq e armiq, me urrejtje ose dashuri, me dashje ose pa dashje, gjithë bota i ka fiksuar sytë mbi Moskë.

VARRI I SHENJTË I KUQ

Varri i shenjtë i kohës sonë, i Jeruzalemit të ri, në mesin e Sheshit të Kuq, kishte vënë kapuç bore. Mijëra pelegrinë, me rreshta shtrënguar, të heshtur, prisnin që të hapej porta e ulët. Burra, gra, fëmijë të porsalindur kishin ardhur nga fundi i botës, për të parë e adhuruar carin e kuq që ishte shtrirë nën tokë si i gjallë. Edhe unë kisha ardhur me ta. Askush nuk fliste. Kaluam mbi varrin e shenjtë. Papritur një masë e rëndë lëvizi përpara portës së ulët, roja e kuqe e hapi.

Ngadalë, pa folur, turma futej brenda, katror pas katrori, në hyrjen e zezë dhe zhdukej. U zhduka edhe unë së bashku me ta. Zbritëm ngadalë nën tokë; ajri ishte i rëndë nga frymët e njerëzve dhe nga ambjenti i mbyllur. Papritur fytyrat pa shprehje, të qenve, të dy muzhikëve që ecnin përpara meje u ndrinë, sikur një diell nëntokësor ra mbi ta. Unë zgjata kokën: poshtë, shumë poshtë, u duk më në fund kristali i madh që mbulonte të zhveshurin e shenjtë: Koka tullace e Leninit vezullonte.

Ai qëndronte i shtrirë, i gjallë, i veshur me bluzën gri të punëtorit, mbuluar nga shtati deri poshtë, nga një flamur i kuq, me grushtin e djathtë lart, dorën e majtë, të hapur, vendosur mbi gjoks. Fytyra e tij ishte ngjyrë trëndafili, e qeshur, mjekra e vogël shumë e verdhë, një erë prehjeje mbushte kristalin e lartë. Turmat ruse, e shikonin, në gjendje ekstaze, po ashtu siç shikonin vite më parë fytyrën ngjyrë trëndafili e të verdhë të Jezusit, mbi ikonostazet e praruara.

Edhe ky është një Krisht, një Krisht i kuq. Substanca është e njëjtë, substanca është e njëjtë, substanca dhe frika. Vetëm emrat ndryshojnë.

Dola mbi sheshin e mbuluar nga bora, mendueshëm. Sa kishte luftuar ai njeri, e shikoja me admirim, sa kishte vuajtur në mërgim nga varfëria, nga tradhëtitë e shpifjet, sa ishin trembur miqtë e tij më të shtrenjtë, nga feja dhe këmbëngulja e tij dhe e kishin braktisur! Mbi ballin tullac që pashë nën kristal, dhe prapa syve të vegjël, ta-

shmë të fikur, Rusia me qytetet dhe fshatrat, me fushat pa fund dhe lumenjtë e gjerë, me tundrat dhe shkretëtirat, thërriste dhe kërkonte lirinë.

Ai besonte, sepse ishte shpirti më i fortë, më i përgjegjshëm i Rusisë, ajo atë kishte thirrur, dhe i kishte vënë detyrë ta shpëtonte. Përse e kishte krijuar, ajo, me luftërat e saj, lotët dhe gjakun e saj, shpirtin më të fortë, në qoftë se jo për ta ngarkuar me provën e tmerrshme, që shkakton vdekjen?

Dhe ndërsa kisha bërë rreth njëqind hapa i menduar, mbi Sheshin e Kuq, Itka, që më kishin dhënë si udhëheqëse, po më fliste, unë admiroja rininë dhe besimin e saj; sa fillonte të fliste, gjithë trupi i saj shndërrohej në flakë si ai i shenjtëve të El Grekos.

- Përse më bën pyetje për Leninin? Çfarë të them? Nga ta filloj? Ai nuk është më një njeri, është simbol grumbullimi. Ai i ka humbur trajtat njerëzore, ka hyrë në legjendë. Fëmijët që kanë lindur në vitet e revolucionit, quhen fëmijë të Leninit. Plaku misterioz që vjen për vitin e ri, ngarkuar me dhurata, që ai ua shpërndan fëmijëve, nuk është më shën Nikolla, as shën Bazil, është Lenini; çdo muzhik, çdo femër e popullit, kanë nevojë për një ngushëllues, për një mbrojtës mbinjerëzor; nëpër ikonostazet e tyre të reja ata vendosin fytyrën e shenjtëruar të Leninit dhe ndezin kandila përpara tij. Në fshatrat më të largët të Rusisë, prej Oqeanit të ngrirë Arktik, deri në pyjet tropikale të Azisë qendrore, njerëzit e thjeshtë, peshkatarë, punëtorë, barinj, gdhendin në mbrëmjet e tyre, duke folur, duke qeshur, duke psherëtirë, fytyrën e Leninit. Gratë qëndisin me mëndafsh shumëngjyrësh, njerëzit e gdhendin në drurë, fëmijët e vizatojnë mbi mure me një copë qymyr. Një ditë nga një fshat i vogël i Ukrainës, i kanë dërguar portretin e tij: një mozaik me kokrra gruri, ndërsa buzët i kishin bërë me piper të kuq.

"Për të gjithë ne, të mësuar apo të pamësuar, Lenini është bërë një parrullë. Njeriu i madh, për ne nuk qëndron në ajër, sipër popullit që e krijoi, ai del nga trupi i popullit të tij; vetëm se atë që populli e shpreh me fjalë të paartikuluara, ai e shpreh me një formulim të saktë. Dhe që kur ai e ka formuluar, ajo nuk mund të shpërndahet më e të huPasë, ajo është bërë parrullë. Ç'do të thotë parrullë? Veprim!

- Po Stalini? - e pyeta. Unë digjesha të dëgjoja të flitej për atë mustaqe egër, me trup të fortë, të rëndë, me sy dinak, lëvizje të ma-

tura; çfarë lloj monstre e shenjtë është pra Stalini?

Itka heshti për pak; dukej se i maste fjalët dhe nuk do
shpëtonte një fjalë më shumë; dukej se kishte hyrë në një zo
ndaluar. Më në fund e gjeti atë që duhej të thoshte:

- Lenini është Drita, Trocki është Flaka, por Stalini është
toka e rëndë ruse. Ai ka marrë farën, mund të mos ketë borë
mund të ngelet gjatë pa rënë shi ose borë, ai do ta ruajë atë
nuk do ta braktisë, për aq kohë sa ajo nuk do të ketë mbirë. Ai
të i durueshëm, këmbëngulës, i sigurt në veten e tij. Ai ka një rezis
që të paimagjinueshme. Do të tregoj vetëm një aventurë të rinis
tij, kur ishte punëtor në Tfilis, dhe ti do ta kuptosh.

"Ishte epoka, tani kjo në duket një legjendë, kur në Rusi duk
mëdhenj, kur deheshin, vendosnin muzhikët në rresht në parqet
tyre dhe ushtroheshin duke qëlluar me pistoletë mbi ta. Por pun
torët kishin filluar të organizoheshin, dhe policia e carit arresto
në çdo kohë udhëheqësit e punëtorëve, i fuste në burg, i syrgjyn
në Siberi, i vriste. Një ditë, punëtorët që shkarkonin vagonat në Ti
lis, deklaruan grevë: ose na përmirësoni kushtet e jetesës, ose nuk
punojmë më. Mbi ta u hodh policia, arrestoi rreth pesëdhjetë pre
tyre, i dërgoi në një kamp jashtë Tfilisit; ushtarët e carit u vunë në
rresht dhe secili mbante nga një shkop mbushur me gozhdë në majë

"Punëtorët kalonin një nga një të zhveshur përpara rreshtit të
ushtarëve. Çdo ushtar, godiste me forcë me shkopin me gozhdë
mbi shpinat e tyre. Gjaku rridhte, vuajtja ishte e papërballueshme,
disa nuk mundën të shkonin deri në fund të rreshtit; dikush ra i
vdekur.

"Erdhi radha e udhëheqësit të punëtorëve; ai hoqi bluzën, dhe
përpara se të fillonte martirizimin, u përkul, këputi një fije bari, dhe
e mbajti me dhëmbë; filloi të ecë ngadalë, pa u përkulur, përpara
çdo ushtari. Shkopinjtë binin me radhë mbi shpinën e tij, nga plagët
rridhte gjak, por ai mbante buzët shtrënguar dhe nuk nxirrte asnjë
klithmë nga goja. Ushtarët filluan ta godisnin në kokë, ai nuk fliste.
Kaloi gjithë rreshtin e ushtarëve dhe kur arriti në fund, nxori nga
dhëmbët fijen e barit dhe ia dha ushtarit të fundit:

"Merre, i tha, si kujtim nga unë; shikoje, unë nuk e kam kafshuar.
Mua më quajnë Stalin."

Itka më pa dhe qeshi:

fije bari, - tha, ne e ruajmë ndërmjet dhëmbëve tanë, gji-
dhe mundohemi të mos e kafshojmë. E kupton tani?
kuptoj, - ju përgjigja duke u dredhur; - Jeta është e vështirë...
shpirti i njeriut, është më i fortë akoma, - më tha, dhe më
krahun, sikur donte të më jepte kurajë.
goja tek fliste mbi mua fryma e largët dhe e rrëmbyeshme e
një erë e ardhur nga lindja, ngarkuar me rrënoja dhe krijim,
temthat e mi të rrihnin.
që më trondiste më në thellësi, dhe çdo ditë e më shumë
kjo. Në zhurmën e qyteteve dhe fushat e mbuluara me borë
sisë, natyrisht të dukshme, unë shikoja për herë të parë, të pa-
hmën. Dhe kur them të padukshmen, jo ndonjë Zot të priftë-
as ndonjë vetëdije metafizike, as ndonjë Qënie të përsosur;
Forcën misterioze që ne na duhet, ne njerëzve - dhe përpara
kafshëve, bimëve, lëndës, - si punëtorë, si kafshë pune, që
hohet sikur ka një Qëllim e ndjej në rrugë, diku atje poshtë, rre-
nga forca të verbëra që krijojnë syrin dhe dritën.
Mbi arsyen dhe diskutimet e dijetarëve, mbi nevojat ekonomike
programet politike, sipër Sovjetëve dhe komisarëve, lëviz dhe
eteron, shpirti i epokës sonë, i errët, i dehur, i pamposhtur. Nga
uzhiku me kafshë deri te figura e shenjtë e Leninit, njerëzit, të
tëdijshëm ose jo, janë të gjithë bashkëpunëtorët e tij.
Ky shpirt është më i lartë se programet, se shefat, më i lartë se
Rusia. Ai fryn mbi ta; i lë prapa dhe mobilizon botën.
Kur unë arrita në këtë furrë të tmerrshme, shtrova çështje filozofi-
ke për besnikët që ndërtojnë Rusinë e re: unë akoma isha i sunduar
nga preokupimet e kota aristoktratike të borgjezisë që ka ngrënë,
që është e ngopur dhe ka të drejtë të diskutojë dhe të luajë; nuk shi-
koja botën e dukshme, mundohesha të shikoja të padukshmen. Unë
vija nga lëndina e Zambakëve të Budës.
Thonë se një mëngjes Sokrati, i plakur, shëtiste në qytet dhe pri-
ste adoleshentin e parë të kalonte për të biseduar me të dhe të gëzonte
shpirtin e tij. Por, në vend të adoleshentit, ai pa atë mëngjes, një
plakë të mençur, hindu që vinte nga Lindja. Ai ishte nisur më këmbë,
disa vite më parë, për të takuar Sokratin. Sapo e pa, iu hodh tek kë-
mbët, i mbështolli gjunjët me duar dhe i tha:

- Buda, o i ditur, i çliruar nga problemet tokësore, ngadhnjimtari i

jetës e i ndryshimit, mësues i Zotëve, elefant i bardhë që ecën e çan rrjetën mashtruese të kotësisë, o trup që je mbi syrin dhe veshin, mbi nuhatjen, mbi shijen dhe prekjen, përkule çanakun e lëmoshës tënde që mban në dorë dhe më hidh pak mua, që jam një pikë uji në oqeanin e mosekzistencës. Zot, shtrije dorën tënde dhe tregomë mua rrugën e humbjes së përjetshme!

Dhe Sokrati, duke fshehur buzëqeshjen ironike që shkaktuan fjalët barbare, iu përgjigj:

- Po unë të kam kuptuar, o i huaj, ti fole për zotër dhe përjetësi. Unë do të dërgoj pranë njërit prej miqve të mi në Elenais. Ai e di si është krijuar bota, nga vijmë e ku shkojmë dhe si është e mundur që yjet janë më të mëdhenj se Peloponezi. Ai di gjithashtu se Zoti është një vezë që ndrin në Erebe dhe do të tregojë për qiparizin e bardhë...

Unë, më fal, merrem vetëm me këtë tokë dhe me njeriun.

"Sa do të kishte qeshur Stalini, mendoja, në qoftë se unë do të hyja nesër në Kremlin dhe t'i bëja pyetjen e plakut hindu!"

Shpesh herë kritikoja komunistët dhe Itka më mbyllte gojën.

- Pusho!

- Mos jam në rrezik?

Ajo qeshte:

- Ndoshta jam unë rreziku, Nikollaj Mihajlloviç. Mos më thuaj asnjë fjalë të keqe për Rusinë. Këtu, nuk kanë veshë vetëm muret, por edhe ajri.

FESTA E MADHE E KUQE

Dita po ngrihej. Unë dola në dritare; konstelacione të panjohura, drapër e çekan, yje të kuq shkëlqenin me dritën e tyre elektrike shumëgjyrëshe në atë agim të zymtë, në çdo anë shiheshin mbishkrime me ngjyrë të kuqe, unë përpiqesha të dalloja fjalët; drita shtohej pak nga pak, unë lexoja gërmë për gërmë: Proletar... në orën shtatë... Lenini... Revolucioni i përgjithshëm..."

U vesha me nxitim. Në korridoret e hotelit, takoja duke kaluar në kate të ndryshme gjithë racat; një turmë të ftuarish, punëtorë të zakonshëm, intelektualë. Takova dhe përshëndeta shumë poshtë shkrimtarët japonezë, të dërguarit e Persisë dhe të Afganistanit, dy priftërinj myslimanë të Arabisë, tre studentë të rinj hindus, dhe dy indiane të këndshme veshur me kashmir ngjyrë portokalli. Në katin e parë dy mongolë gjigandë dhe tre gjeneralë kinezë, shumë të shkurtër; ne u përshëndetëm shpejt dhe unë ndjeva në fjalët dhe shikimet e tyre vlimin e rrezikshëm të Azisë.

Vrapuam, që të mos mungonim në fillimin e ceremonisë. Një i ftohtë therës, qielli gri, nga goja dhe hundët dilte avull. Sheshi i Kuq tashmë ishte mbushur plot. Mbi Varrin e shenjtë të Leninit, zyrtarë të rreshtuar; përballë, mbi tribunat në formë gjysmë rrethi, të ftuarit nga gjithë bota; ushtria ishte rreshtuar, prapa saj, populli. Dëgjohej një zhurmë e mbytur, sikur larg tronditeshin thellësitë e tokës; dukej sikur toka dridhej nën këmbët e tyre. Në fund, metropoli i Ivanit të Tmerrshëm, që e dua aq shumë, me të gjitha kupolat, gjithë ngjyrat, shfaqej si një fantazmë e mjergullës mëngjesore. Rreth meje ngjisheshin gjeneralët e shkurtër kinezë, me dekoratat në gjoks, hindutë dhe hindutkat, intelektualët japonezë dhe një trupmadhe e zezë me një vëth floriri në vesh. Ne shiheshim me dashuri, qeshnim dhe shprehnim dashurinë tonë pa folur. Një poet japonez më shtrëngoi dorën; unë dija vetëm një fjalë japoneze "kokoro" që do të thotë zemër. Vendosa dorën mbi zemër, u përkula tek veshi i tij dhe i

thashë: Kokoro! Ai lëshoi një klithmë gëzimi dhe u hodh në krahët e mi. Papritur tingëlluan trompetat luftarake; të gjithë u drodhën, fytyrat morën flakë. U dukën të vijnë me galop kalorësit kirkizianë, kaukazianë, mongolë, kalmukë; komandanti ecte në krye, vringëllinte një shpatë të zhveshur; kalorësit e ndiqnin, me kostume kombëtare, me ushtat dhe flamurët shumëngjyrësh të krahinave nga vinin, përshëndesnin varrin e Leninit dhe zhdukeshin. Si dallgë e ngjeshur papushim, vinin këmbësoria, artileria, marinarët e Balltikut dhe nga Deti i Zi, aviatorët, Garda e Moskës, punëtorët me bluza lëkure, pushkët e shkurtëra, punëtorët me shamitë e kuqe në kokë, me pushkët në sup. Pastaj, ky qe parakalimi më i çuditshëm, i pambarimtë i popullit: Nga të tre anët e sheshit gjigand derdheshin tre lumenj të kuq, me rrjedhje të shpejtë; shiheshin të kalonin studentë, pionierë, rinia komuniste, fshatarë, aziatikë sipër deveve, kinezë me një dragua të madh prej bezeje që hapte e mbyllte nofullat. Mbi një shtrat kalonte një glob i madh tokësor, rrethuar nga zinxhirë të cilët i godiste një fëmijë me çekiç dhe i thyente, pastaj një parakalim kamionësh, që transportonte invalidët e luftës të cilët tundnin patericat në ajër, duke thirrur urra, pastaj nënat me fëmijët në krah. Orët kalonin. Dielli e shpërndau mjegullën; me mijëra fytyra filluan të ndrijnë, sytë shkëlqenin. Gjithë sheshi troditej nga urratë, dhe hapat e fuqishme të turmës. Indianët para meje hoqën kashmirin e verdhë dhe e palosën.

Hodha një shikim përreth, të gjithë qanin; pashë edhe një herë, nuk pashë më asgjë; sytë më ishin veshur.

Unë u hodha mbi gjeneralin kinez që ishte pranë meje, e shtrëgova aq fort sa munda, qanim të dy. I ziu, u vërsul dhe na mori të dyve në krahët e tij, ai qante dhe qeshte njëkohësisht... Sa orë zgjati kjo dehje hyjnore, sa shekuj? Kjo ditë ishte dita e dytë e madhe, më e madhja e jetës sime; e para ka qenë ajo kur princi Gjergj i Greqisë, vuri këmbë në tokën e Kretës. Unë shtrëngoja gjeneralin kinez në krahët e mi, i ziu na shtrëngonte në të tijët dhe unë kuptoja se kufijtë fshiheshin, se emrat, vendet, qeshnin, shtrëngonin gjokset e njëritjetrit, një dritë kishte ndezur shpirtin e njerëzve, ata shikonin se ishin të gjithë vëllezër.

Unë gjithashtu kuptova se zemra ime e gjorë thërriste si Rusia e madhe. U betova t'i jap jetës sime një kuptim, të lirohesha nga skllavëritë, të mposhtja frikën dhe iluzionin, dhe të ndihmoja të tje-

rët të lirohen nga frika dhe iluzioni, të mos pranoja që disa njerëz të shtypnin të tjerët; u betova t'i jepja gjithë fëmijëve të botës, lodra dhe libra, grave lirinë dhe qetësinë, burrit mirësinë dhe mirësjelljen; një kokërr gruri bishtatundësit, zemër njeriut.

"Ja klithma e Rusisë", i thoshja vehtes; dhe betohesha ta ndiqja deri në fund.

Betim dashurie. Unë thoshja të vërtetën, isha i vendosur t'i jepja jetën time. Ishte hera e parë që kuptoja se çfarë gëzimi duhet të ndjejnë ata që janë qëlluar me gurë, përvëluar e kryqëzuar për një ide. Për atë që do të thotë vëllazërim, atë që do të thotë se gjithë bota është një. Ishte hera e parë që e jetoja aq thellësisht. Unë kuptoja se ekziston një fuqi superiore në jetë dhe një forcë që triumfon mbi vdekjen.

Itka më vërentë fshehtas, më përgjonte për të ditur sesi i merrja idetë e saj. Unë nuk e tradhëtoja, edhe pse Çeka përgjonte. Një ditë, kuptoi se dikush kishte fiksuar shikimin mbi të; ajo u drodh.

- Cili është ai që po të shikon?

- Një mik, ikim. Më kapi nga krahët, më tërhoqi me forcë.

Pastaj erdhi ndarja tragjike. Ajo konsiderohej e dyshimtë. Çeka e kishte zhdukur...

Kaloja ditë e netë duke bredhur rrugëve, kurrë nuk e kisha ndjerë Itkën aq pranë meje, aq të bashkuar me mua. Përpiqesha të kujtoja çfarë fjalë të bukura i kisha thënë asaj; unë i kisha harruar, nuk më kujtoheshin veç fjalë të tharta, të ashpra, që e kishin plagosur shpesh. Çfarë vuajtje! Do të duhej, që sa herë ne shikojmë e takojmë një njeri që duam, të mendojmë për vdekjen, për të qenë të mirë me të; por kurrë shpirti im nuk kishte menduar se një ditë ajo vajzë do të vdiste. Në qoftë se do të ndodhte që ne të shiheshim, do të kisha rënë në krahët e saj, dhe oh! Sa fjalë të bukura do t'i kisha thënë, unë që mezi flas!

Kur shtrihesha, shumë i lodhur, dhe më kapte gjumi, e shihja të vinte, e dija që ishte ëndërr, por bëja sikur nuk e dija dhe hapja krahët. Një natë u gënjeva. Ajo ishte kthyer, me pallton e saj të grisur,

shaminë e kuqe në kokë dhe flokët që ishin mbushur me borë, me një borë të trashë, të bardhë. Unë zgjata dorën: ajo u mbush me borë, ngriu. Mora Itkën në krahët e mi.

- A është e vërtetë? - thërrisja, - ti nuk ke vdekur, Itka, është e vërtetë, në flokët e tu ka borë, merre, shikoje: dora ime ngriu!

Por çastet më të egra të vuajtjes, ishin ato kur, në mbrëmje, mbyllja sytë dhe shikoja trupin e saj të dekompozohej pak nga pak në tokë. Shikoja sesi ishte ditën e parë, të dytën, të tretën, shikoja sesi me kalimin e ditëve, ajo merrte ngjyrë të gjelbër, zverdhej, çahej... e ndjeja që shpirti më lëkundej. Ndonjëherë kur isha vetëm klithja sikur kërkoja ndihmë. Kujt? "Çfarë ke që thërret, i thosha shpirtit, kujt i thërret? Ti nuk e ke kuptuar akoma mënxyrën, vetminë e njeriut?

Por sa më shumë ditë kalonin, aq më tepër mësohesha me mjerimin më të dhimbshëm të njeriut: me kalimin e kohës, unë po mësohesha, vuajtja bëhej gjithmonë e më e dobët, Itka po zhdukej dhe një ditë, kur takova një spanjolle, të njohur, papritur qesha. Mbylla gojën, m'u duk e pështirë.

"Çfarë turpi, mendoja, shpirti i njeriut është pra kaq i keq sa nuk mund të ruajë gjithmonë të paprekur vuajtjen e tij?"

Dhe pikërisht në çastin më mizor, unë bëra një njohje të re të paparashikuar, që ndryshoi rrjedhën e mendimeve të mia; dukej se jeta komplotonte për t'më tërhequr përsëri pranë vetes.

Unë i kisha lexuar tregimet plot humor oriental të Istrati Panait dhe e njihja jetën heroike të martirit; por akoma nuk e kisha njohur. Një ditë mora një copë letër të zhubrosur, zhgarravitur shpejt me një shkrim të madh "Eja më shiko, babai im ishte grek, nëna rumune, unë jam Istrati Panai."

Kur trokita në portën e dhomës së tij, në hotelin "NDRYSHIMI" të Moskës, isha me të vërtetë i lumtur që do të shihja një luftëtar; në këtë rast, kisha triumfuar mbi pabesueshmërinë që më pushtonte sa herë më duhej të njihja ndonjë mik të ri dhe shkoja plot besim të takoja Istrati Panain. Ai ishte në shtrat, i sëmurë; sapo më pa, u ngrit me shkathtësi dhe më foli në greqisht i gëzuar: Ah ja, mirë se erdhe! Ah aja, mirë se erdhe, dreqi e mori!

Kontakti i parë, përcaktues, ishte i përzemërt; shikonim njëri-tjetrin, sikur secili përpiqej të merrte me mend; ne ishim si dy milingona, që preknin me antenat e tyre. Fytyra e Istratit ishte e hollë, me rrudha të thella, shenja të vuajtjeve të shumta; flokët e gjatë gri të ndritshëm, i binin vazhdimisht mbi ballë, si fokët e një fëmije; sytë e tij kishin një dritë të fortë, plot dinamizëm e butësi ndërsa buzët e trasha si të cjapit, vareshin plot epsh.

- Unë e lexova, më tha, fjalimin që ti mbajte pardje përpara Kongresit; më pëlqen. Ti e ngule mirë gozhdën. Evropian idiotë! Ata mendojnë se me ironinë e bishtave të penave të tyre mund të evitojnë luftën; ose në qoftë se ajo do të fillojë, punëtorët do të ngrihen dhe do të hedhin armët. Dokrra! Dokrra! Punëtorët, unë i njoh! Ata do të zvarriten më shumë te dyqanet e mishit dhe do të vdesin. Ti e ke ngulur mirë gozhdën, unë mund të them: Duam apo nuk duam, një luftë botërore do të shpërthejë, duhet të jemi gati.

Më pa drejt e në sy; zgjati dorën eshtake dhe më shtrëngoi gjurin, filloi të qeshë.

- Më kishin thënë se ti ishe fetar; por unë e shoh se ti di të hapësh mirë syrin dhe se nuk jeton me ajër të pastër e ujë të freskët. A nuk mjafton kaq për të qenë fetar, hë? Megjithatë unë nuk di asgjë. Fjalë, fjalë! Më jep dorën.

I shtrënguam dorën njëri-tjetrit duke qeshur e me një kërcim ai u hodh nga krevati. Ai njeri pati diçka të përbashkët me macen e egër, në lëvizjet e shpejta dhe të mprehta të syrit të tij lakmitar, në gëzimin e egër. Ndezi furnellën dhe vendosi mbi të një kusi - Dhe një kafe, një! - thirri me zë tjetër, si kamarierët.

Kur iu kujtua Greqia, gjaku i tij qefalonian filloi të zierë, filloi të këndojë një këngë të vjetër që kishte dëgjuar në lagjen greke të Brailës.

Ah, sikur të isha flutur
Unë do të isha duke fluturuar pranë teje...

Në thellësinë e qënies së tij po ngrihej Greqia, djali plangëprishës tani digjej nga dëshira të kthehej në tokën prindërore. Papritur, plot pasion, ai vendosi: - Unë do të kthehem në Greqi!

Ishte i lodhur, kollitej; u shtri përsëri, piu kafenë.

U ul përsëri në krevat, filloi të ndezë cigaren dhe të flasë, me pa-

sion, për Rusinë, pastaj për veprën e tij, për heroin e tij kryesor, Adrian Zografi, që vuajti se e kaloi gjithë jetën duke kërkuar një mik dhe nuk e gjeti dot; dëshirat e tij janë të padisiplinuara, zemra e tij rebele, shpirti i tij i paaftë t'i japë ritëm kaosit.

Unë e shikoja me shumë dashuri e dhembshuri. E kuptoja se ai gjendej në çast kritik ku jeta duhej t'i ndryshonte, por nuk kishte vendosur ende, në vetvete se ç'rrugë duhej të merrte. Më shikonte me sytë e vegjël që i digjeshin, sikur me kërkonte ndihmë.

- Ti je vetë Adriani, heroi i librave të tua, i thashë duke qeshur.

Ti nuk je, siç e beson, një revolucionar, ti je një njeri në revolucion. Revolucionari ka një sistem, rregull, koherencë në veprimet e tij, fre në zemër; ti je rebel; ti e ke të vështirë t'i ngelesh besnik një ideje. Megjithatë, tani që ke hyrë në Rusi, duhet që të vesh rregull në veten tënde. Të marrësh një vendim; ti ke një përgjegjësi.

- Më ler, thirri, sikur e kisha kapur për fyti. Pastaj, pas një çasti: - Ti je i sigurt për atë? - më pyeti me shqetësim.

- Rumuni Adrian Zografi ka vdekur, i thashë dhe shtrëngova krahun skeletik të Istratit, sikur doja ta ngushëlloja; rroftë rusi Adrian Zografi! Lëri tani, Panai, lagjet e ngushta të Brailës, shqetësimi dhe shpresa e botës janë shtrirë më shumë, Adriani gjithashtu është shumuar; ritmi personal e anarkik i jetës së tij ngatërrohet me ritmin personal të Rusisë, dhe ai mund të arrijë më në fund të bëj të tijën koherencën dhe besimin. Ekuilibri superior që për aq vjet Adriani, dhe Panai, kanë kërkuar më kot, tani mund të realizohet; sepse ai tashmë mund të bazohet jo më mbi fatin pa lidhje të një individi të pabindur, por mbi masat kompakte të një populli të tërë që lufton.

- Mjaft, - thirri Istrati, i nervozuar; - mjaft! Kush dreqin të ka dërguar këtu? Ato që thua ti, unë i mendoj ditë e natë në këtë krevat ku rri shtrirë, por ti nuk më pyet në mund ta bëj. Ti vetëm ecën vazhdimisht, do ta shohim deri ku mund të arrish. Por kujdes, kjo nuk është lojë; si mund të flasësh kështu? Është një çështje për jetë a vdekje.

- Jeta dhe vdekja janë një lojë, - i them, dhe u ngrita. - Një lojë, dhe në një çast të tillë varet nëse do ta fitojmë ose do ta humbasim.

- Përse u ngrite?

- Duhet të shkoj, kam frikë se ju lodha.

- Ti nuk do të shkosh në asnjë vend. Do të rrish këtu, ne do të

hamë bashkë dhe sot pasdite, do të shkojmë diku të dy bashkë...

- Ku pra?

- Të shohim Gorkin. Ai më ka shkruar se më pret. Unë do ta shkoj për herë të parë sot atë Istratin e famshëm të Evropës! - më tho-të, ndërsa zëri i hidhur tregonte një xhelozi fëmijërore ndaj të mëdhenjve.

U hodh nga krevati, u vesh, dolëm. Ai më mbante fort për krahu.

- Ne po bëhemi miq, - më thoshte, - ne po bëhemi miq, sepse unë tani po provoj nevojën të të godis me grusht në fytyrë. Sepse ka një gjë që ti duhet ta dish: unë nuk mund të provoj miqësinë pa një goditje me grusht. Duhet që kohë pas kohe, ne të grindemi, që t'i dërmojmë fytyrën njëri-tjetrin, dëgjon? Kjo është dhembshuria.

Hymë në një restorant, u ulëm. Hoqi nga qafa ku e kishte varur si medalion, një shishe të vogël me vaj, dhe i hodhi gjellës; pastaj nxori nga xhepi i jelekut një kuti të vogël piperi dhe i hodhi pak supës me mish.

- Vaj dhe piper! - tha duke u lëpirë; - si në Braila.

Hëngrëm me kënaqësi; Istrati gjente greqishten e tij dhe sa herë që një fjalë i vinte ndër mend, përplaste duart si fëmijë.

- O mik i vjetër! - thërriste në çdo fjalë të tijën greqisht; - O mik i vjetër! Ç'bën ti?

Megjithatë ishte i kujdesshëm; shikonte shpesh sahatin; përnjëherë u ngrit:

- Vajti ora, - tha, - shkojmë!

Thirr kamarjerin! Mori katër shishe me verë të mirë Armenie, mbushi xhepat e palltos me paketa të vogla me ushqime, mbushi kutinë me cigare, u nisëm.

Istrati ishte i emocionuar. Ai për herë të parë do të shikonte Gorkin e madh. Sigurisht ai priste përqafime, tryeza shërbimi, lot, të qeshura, diskutim pas diskutimi dhe përsëri përqafime.

- Panai, i thashë, - ti je i emocionuar.

Ai nuk u përgjigj; shpejtoi këmbët i nervozuar.

Mbërritëm pranë një ndërtese të madhe, ngjitëm shkallët. Shikoja me bisht të syrit shokun tim dhe gëzohesha teksa vija re trupin e madh e të hollë, duart e punëtorit që kishin punuar shumë, sytë e pangopur.

- Shiko, i thashë kur të shohësh Gorkin mund të ndrydhesh dhe mund të mos fillosh përqafimet dhe thirrjet!

- Jo! - u përgjigj me humor, jo! Unë nuk jam anglez; unë jam grek nga Qefalonia, sa herë duhet ta them? Unë thërres, përqafoj, jap. Ti je i lirë të luash anglezin... dhe më dëgjo, shtoi një sekondë më pas, unë do të doja të isha vetëm; shoqëria jote më nervozon.

Ai akoma nuk kishte mbaruar së foluri dhe në derë, u duk Gorki, me një bisht cigareje ngjitur në buzë. Shtatëlartë, me një trup të lidhur mirë, faqe të futura, mollëza të kërcyera, sy të vegjël blu, të trishtuar e plot shqetësim dhe mbi buzë një hidhërim të patreguar.

Unë nuk kisha parë kurrë aq hidhërim mbi buzët e njeriut.

Unë nuk kisha parë kurrë aq hidhërim mbi buzët e njeriut.

Istrati, sapo e pa, ngjiti shkallët katër nga katër dhe i shtrëngoi dorën.

- Istrati Panai! - thirri, gati duke rënë mbi supet e gjerë të Gorkit.

Gorki zgjati qetë dorën dhe pa Istratin. Fytyra e tij nuk shprehu as gëzim, as kuriozitet; ai e pa atë me vëmendje, pa i folur.

Pas një çasti: - Hyjmë, tha.

Ai, me hap të qetë, hyri i pari. Istrati e ndoqi, nervoz, ndërsa nga xhepat e palltos dukeshin katër shishet e verës dhe qeskat me ushqime.

U ulëm në një zyrë të vogël plot me njerëz. Gorki dinte vetëm rusisht, biseda ecte me vështirësi. Istrati filloi të flasë ashtu, jo mirë rusisht, plot emocion. Nuk më kujtohet se çfarë tha, por nuk do të harroj kurrë zjarrin e dikutimeve të tij, ngarkesën e zërit të tij, gjestet e shumta dhe shikimin e ndezur.

Gorki përgjigjej qetë, me fjalë të pakta, me një zë të butë, duke ndezur cigare njëri pas tjetrit. Buzëqeshja e tij e hidhur, i jepte fjalëve të qeta një thellësi tragjike, të përqendruar.

Tek ai shihej një njeri që kishte vuajtur shumë dhe që akoma vuante shumë, një njeri që kishte parë pamje aq mizore, të cilat nuk i fshinin dot, as festat sovjetike dhe urratë, as lavdia dhe nderimet. Prapa syve të tij blu shihej turbull një trishtim i qetë dhe i pashërueshëm.

- Mësuesi im i madh, thoshte, ka qenë Balzaku. Më kujtohet se kur e lexoja, e ngrija fletën drejt diellit, e shihja dhe thosha i trullosur: "Po ku dreqin gjendet gjithë kjo forcë, gjthë kjo jetë?" Ku gjendet sekreti i madh?"

- Po, Dostojevski, Gogoli, e pyeta.

- Jo, jo, midis rusëve vetëm një, Leskov.

Heshti, pastaj, Pas një çasti:

- Por mbi të gjithë, jeta. Unë kam vuajtur shumë, mua më dhimbset shumë njeriu që vuan; kjo është e gjithë. Heshti, duke ndjekur, ndërmjet qepallave gjysmë të mbyllura, tymin blu të cigares së tij.

- Panai nxori nga xhepi shishet dhe i vendosi mbi tavolinë. Nxori ushqimet, me qeska të mëdha e të vogla. Por nuk pati kurajo t'i hapte; e kishte kuptuar se nuk ishte moment i përshtatshëm. Klima që ai shpresonte nuk ishte krijuar akoma. Ai priste gjë tjetër; vetëm dy atletët filluan të pijnë e të thërresin, të flasin me zë të lartë, të këndojnë, të vallëzojnë, sa dridhej toka. Por Gorki ishte akoma i

zhytur në mjerimin e jetës së tij dhe gati i privuar nga shpresa.

U çua. E kishin thirrur disa të rinj, ai u mbyll me ta në një zyrë pranë. Ne ngelëm vetëm.

- Panai, - i thashë, - çfarë mendon për mjeshtrin?

Me një lëvizje shpërthyese ai hapi një shishe:

- Nuk kemi gota, tha, ti mund të pish me shishe?

- Po.

Mora shishen.

- Për shëndetin tënd Panai, - i thashë; - njeriu është një bishë e shkretëtirës; rreth secilit prej nesh gjendet një greminë dhe asnjë urë. Mos u hidhëro, Panai im i vogël, ti nuk e dije?

- Shpejto të pish! - tha, me një pamje të mërzitur; sepse do të pi edhe unë, se kam etje.

Ai fshiu buzët.

- Unë e dija, - u përgjigj, - por e harroj vazhdimisht.

- Ajo është merita jote e madhe, Panai. Çfarë fatkeqësie, në qoftë se nuk do ta dije: Ti do të ishe idiot. Çfarë fatkeqësie në qoftë se ti e dije dhe nuk do ta harroje: Ti do të ishe i ftohtë dhe i pandjeshëm. Ndërsa kështu ti je një njeri i vërtetë - i ngrohtë, plot absurditete, një lëmsh shpresash e deziluzionesh - deri në vdekje.

- Tani, ne kemi parë Gorkin; kjo mjafton! - tha.

Vendosi përsëri shishet në xhep, mblodhi paketat e ushqimeve, u nisëm.

Duke udhëtuar, më tha:

- Gorki m'u duk tepër i ftohtë: po ty?

- Mua m'u duk shumë i hidhëruar, i pangushëllueshëm.

- Ai duhet të bërtasë, të pijë, të qajë, për t'u lehtësuar! - pëlliti i indinjuar Panai.

- Një mysliman, - u përgjigja unë, - që kishte humbur familjen në luftë, u kishte dhënë këtë urdhër njerëzve të tribusë së tij: "Mos qani, mos bërtisni, që të mos lehtësoni dhimbjen tuaj!" ja Panai, disiplina krenare që një njeri mund t'i imponojë vehtes së vet. Prandaj mua më pëlqeu shumë Gorki.

DO TË NGJALLET AI PËRSËRI?
DERI KUR DO TË JETË I KRYQËZUAR?

Të nesërmen kalova përpara Metropolit të madh të Moskës dhe hyra brenda. Anija gjigande, krenaria e Rusisë së carëve, ishte bosh, pa drita, pa ngrohje, proçesionet e shenjtorëve shumëngjyrësh, me aureolat e arta, të vetmuar mes errësirës dimërore, kishin ngrirë. Fryma që dilte si avull nga goja dhe hundët e një plaku të shkurtër, që mbante mbi një tufë veprash një tabaka bosh, pa asnjë su, nuk mjaftonte për të ngrohur turmën e shenjtë që drithëronte.

Papritur, dëgjova nga lart te tribuna e grave, zëra të qetë, burrash e grash që psaltnin. Me mundim gjeta shkallën e mermertë në formë spiraleje dhe fillova të ngjitem. Përpara meje dallova në gjysmëerrësirë dy tre pleq e plaka, me kokë mbuluar që ngjiteshin duke iu marrë fryma.

Mbërrita në krye të shkallëve dhe u gjenda në një kënd të ngrohtë, një kishëzë e praruar, e ndriçuar nga qirinjtë, njerëz të gjunjëzuar, priftërinj, prelatë veshur me rroba të mëndafshta, të qendisura me ar...

Nuk do ta harroj kurrë, ngrohtësinë, ëmbëlsinë e këndit. Burrat ishin në pjesën më të madhe pleq me favorite, zotërinj të vjetër pa dyshim, ose portierë të vjetër të shtëpive të të pasurve. Gratë kishin mbuluar kokët me napa të bardha. Mbi ikonostaz, vezullonte Krishti, i ngopur, me ngjyrë trëndafili, gjoksin mbuluar me dekorata, - duar, këmbë, sy e zemra njerëzish të arta ose të argjendta.

Unë qëndroja në këmbë në mes të masës së përgjunjur dhe nuk mundja të përmbaja emocionet. Gjithë ai grumbullim më dukej si një përshëndetje lamtumire, për një njeri të dashur që do të largohej për udhëtim të rrezikshëm ndërsa miqtë po e përcillnin...

Besnikët e fundit ndahen me trishtim të madh nga fytyra e dashur e Zotit të tyre; besnikët e parë të fytyrës së Misterit të tmerrshëm hidhen pa mëshirë për të thyer idhujt e vjetër të pafuqishëm. Ne jetojmë në çastin vendimtar e të pathyeshëm ku një fe e vjetër vdes

dhe ku lind, në gjak, një fe e re.

Kohët që kalojmë, dhe ajo që është më e tmerrshme akoma, kohët që do të kalojnë fëmijët dhe nipërit tanë do të jenë kohë të vështira. Por vështirësia ka qenë gjithmonë nxitësi më i madh që zgjon dhe shtyn vrullet tona, të mirë e të këqinj, për të na bërë ne të ngrihemi mbi pengesën e vënë befas para nesh. Kështu, duke mobilizuar gjithë forcat tona, që pa këtë do të kishin ngelur në gjumë ose do të kishin vepruar dobët dhe të shpërndara, ne do të arrijmë shpesh herë shumë më larg se ç'shpresojmë. Sepse forcat e mobilizuara, nuk janë vetëm forcat tona personale, as vetëm forcat njerëzore. Në vrullin që ne marrim për t'u hedhur brenda vetes sonë, çlirohen forca të tre natyrave: forca personale, forca të natyrës së njeriut, forca më të hershme se vetë njeriu. Në momentin kur njeriu hidhet si sustë për të realizuar sulmin, gjithë jeta e planetit tendoset gjithashtu brenda tij dhe merr vrull. Ne ndiejmë atëherë pikërisht atë të vërtetë aq të thjeshtë, të cilën e harrojmë në çastet e rehatisë dhe të shterpëta të jetës së thjeshtë: që njeriu nuk është i pavdekshëm, porse ai është në shërbim të Diçkaje ose të dikujt të pavdekshëm.

Kur devocioni kishte përfunduar dhe besnikët e fundit filluan të zbresin ngadalë shkallën e mermertë, m'u afrua një burrë i ri; kishte mjekër të verdhë, sy blu të lodhur, ishte i dobët, i zeshkët e kollitej:

- Ai m'u drejtua me fjalët:

- Edhe ju jeni me ne? më pyeti i emocionuar; ju nuk e keni tradhëtuar Krishtin?

- Në qoftë se ai nuk më tradhëton, unë nuk do ta tradhëtoj kurrë.

- Krishti nuk tradhëton kurrë, atë e kanë tradhëtuar. Por, ejani, bën ftohtë, shkojmë në shtëpinë time, pijmë nga një gotë çaj të ngrohtë.

Babai i tij ishte një zotëri i vjetër, kishte një shtëpi të madhe që tani e kishte ndarë në dy pjesë; pjesa tjetër ishte mbushur me familje punëtorësh; ai meqë nuk kishte fëmijë, kishte marrë pjesën pa diell, dhe meqë punëtorët kishin shumë fëmijë ata duhej të ngroheshin në diell. Burri i ri, për të jetuar punonte në një uzinë, por ai ishte poet dhe, kur i ngelej pak kohë, ai shkruante poezi.

- Tani unë po shkruaj, më tha, një poemë të madhe, një dialog. Krishti dhe një punëtor që bisedojnë. Është mëngjes, sirenat e uzinave ulërijnë, bën ftohtë. Punëtorë dhe punëtore vrapojnë duke u

dridhur, me trupat përkulur drejt punës, drejt fabrikave. Punëtori im e merr Krishtin për krahu, dhe i tregon uzinat duke shkuar nëpër rrugët e tyre, duke i treguar minierat e qymyrit, portet. Krishti psherëtin:

- Ç'kanë me ata? - pyeti, - çfarë kanë bërë?

- Nuk e di, i përgjigjet punëtori; duhet të ma thuash ti, pastaj e çon në shtëpinë e tij të varfër, plot lagështi, me vatrën pa zjarr, tek fëmijët që kanë uri dhe qajnë. Punëtori mbyll portën, shtrëngon Krishtin nga krahu dhe thërret: - Rabin, si duhet të sillem unë me Çezarin? Ma thuaj se ç'është e jona dhe duhet ta ruajmë. Burri i ri ndalet, shfryn pak; tundi duart me nervozizëm, i shqetësuar.

- Atëherë, - e pyeta, - si t'u përgjigj Krishti?

- Unë nuk e di, - u përgjigj besniku i fundit, dhe hodhi përreth një shikim të frikësuar; - unë nuk e di akoma, ose më mirë, unë nuk e di më.

U zhyt në një kolltuk pranë dritares dhe mbuloi fytyrën me duar - Përse? Përse? - pëshpëriti.

"Edhe ky shtron të njëjtat pyetje, mendoja, ai shtron pyetje dhe nuk gjen përgjigje. A mund t'i përgjigjet Krishti? Përse nuk pyet Leninin?"

- Përse nuk ja shtron këto pyetje Leninit? - e pyeta dhe, pa dashur, ngrita zërin.

- Ia kam bërë.

- Dhe si të është përgjigjur?

- Proletarë të të gjithë vendeve bashkohuni! Unë u drodha i inatosur; por unë pyes për shpirtin, Nikollaj Iliç, për Zotin, për Përjetësinë. Ai tundi supet dhe filloi të qeshë.

- Borgjez... pëshpëriti dhe shtypi me takën e çizmeve cigaren.

"Pylli është i gjerë, era e favorshme. - përpara, Be-Kou, merre hakun tënd! - Andej, këtej, andej, këtej! - Një derr! Kush do ta vrasë pra derrin? I gjori Be-Ko! O Be-Ko! Por kush do ta hajë? I gjori Be-Ko. Hardi ndaje; ti do të hash abatët.

"Bam! Një elefant u rrokullis për tokë! Cili e vrau pra? O Be-Ko! Cili do të marrë pjesën e mirë? I gjori Be-Ko, - kujdes, Be-Ko! Ty do të të japim bishtin!"

Sa më shumë ditë kalonin, aq më shumë ndieja se magjia misterioze e Rusisë po më pushtonte. Nuk ishte vetëm spektakli ekzotik i dimrit të mbingarkuar me borë, as jeta sllave që më rrethonte, të cilat më parë i vlerësoja - njerëzit, pallatet, kishat, trojkat, balalajkat dhe vallet - më magjepsnin.

Ishte diçka tjetër, më misterioze dhe më e thellë: atje, mbi tokën ruse, unë ndjeja dy forcat kozmogonike primitive që përplaseshin, të qarta, gati të dukshme. Klima e luftës që të rrethon, hyn deri në fund të qënies tënde dhe hyn në luftë, mirë apo keq, në njërën ose në tjetrën anë të këtyre forcave kozmogonike, dhe lufton. Ajo që kisha provuar me aq furi, në ekzistencën time mikroskopike, unë e shihja të shpalosej këtu, e tmerrshme, e paepur, në trupin gjigand të Rusisë. Ishte e njëjta luftë, identike, dy armiq të përjetshëm: Drita dhe Errësira. Dhe kështu pak nga pak, lufta ime arrinte të bëhej një me luftën e Rusisë, lehtësimi i Rusisë, ishte lehtësimi im. Sepse drita është një dhe e pandashme, dhe ashtu si ajo triumfon ose thyhet në çdo vend, po ashtu ajo triumfon ose thyhet tek ne.

Nisur nga çasti kur ky identitet u fiksua mbi mua, fati i Rusisë, u bë fati im. Unë luftoja dhe ruaja si ajo. Moska ishte bërë shumë e ngushtë për mua, ndaj u nisa të shoh nga afër ketë fushë të gjerë ku luftonin armiqtë e vjetër, aleatët e vjetër - nga Leningradi në Vladivostok, nga Murmansku në bregun e Oqeanit të ngrirë Arktik deri në Buhara dhe Samarkandë.

Gjithë njerëzit, gjithë populli ngarkon kryqin e tij mbi supe; pjesa më e madhe e mbajnë deri në vdekje dhe nuk gjendet askush për t'u kryqëzuar. Lumturi për atë që është kryqëzuar. Sepse duke udhëtuar nëpër qytetet dhe fshatrat e saj, unë dridhesha, më pushtonte një tmerr i shenjtë. Kurrë nuk kisha parë aq luftë, aq vuajtje mbi kryq, aq shpresa. Unë kuptova për herë të parë sesa i ka kushtuar njeriut për të bërë një hap përpara, për të triumfuar mbi dashurinë e tij të vjetër, mbi Zotin e tij të vjetër, mbi zakonet e tij të vjetra. Gjithçka që dikur ishte shpirt dhe e shtynte në ngjitjen e tij më tej, bëhet një material i rëndë, ngulet në mes të rrugës dhe nuk lë asgjë të kalojë, nuk kuptojnë, nuk duan të shpëtojnë. Miliona muzhikë rezistojnë, nuk kuptojnë, nuk duan të shpëtojnë, ata mbajnë gozhdë në duar dhe gozhdojnë Nënën. Gjeneratë pas gjenerate ata punojnë tokën, ata janë bërë tokë, e urrejnë flakën. Dhe punëtorët, të uritur,

të dërrmuar, që nuk janë veç flakë, shtyjnë masën e fortë, herë me të mirë e herë me dhunë, për ta bërë të hyjë në rrugën e lirimit.

Bota, bota e kujdesshme, e ngopur, i vjen rrotull mejdanit rus ku luftojnë Drita me Errësirën dhe qesh me të madhe. "Kjo u bë, Rusia humbi!" sepse të kujdeshmit, të ngopurit, nuk mund të kuptojnë forcat e padukshme, të ringjalljes pas pagëzimit. Por si ka thënë Krishti, fara e grurit, për të mbirë, duhet të hidhet në tokë e të vdesë. Kjo ka ardhur në Rusi; ajo është si një farë gruri, si një ide e madhe.

Një ungjill i dyshimtë tregon se Jani, dishepulli i dashur, ndërsa qante, duke qëndruar në këmbë përpara të kryqëzuarit, pati një vizion të çuditshëm, nuk ishte kryqëzuar një njeri i vetëm por shumë burra, gra dhe fëmijë, që vuanin dhe vdisnin. Dishepulli i dashur dridhej; dhe nuk mund të fiksonte asnjë fytyrë; gjithë fytyrat, të panumërta, transformoheshin, treteshin, zhdukeshin dhe të tjera vinin në vend të tyre. Papritur zhduken të gjitha dhe mbi kryq ngeli vetëm një klithmë e dhimbshme.

Ai vizion fërgëllon sot përpara nesh; veçse shëlbyesi nuk është më tani një njeri i vetëm, por një popull i tërë. Gjithë Rusia, miliona burra, gra, fëmijë, vuajnë pasionin e janë kryqëzuar. Ata humbasin, përzihen dhe nuk dallohet asnjë fytyrë e përcaktuar; por midis atyre të vdekshmëve të panumërt, do të ngelet sigurisht, klithma.

Ai vuan; kështu bota shpëtohet edhe një herë. Çdo të thotë të jesh i shpëtuar? Të gjesh një arsye të re për të jetuar, sepse e vjetra është lodhur dhe nuk mund të mbajë ndërtesën njerëzore. Sa i lumtur është ai që dëgjon klithmën e epokës së tij - sepse çdo epokë ka klithmën e saj - dhe bashkëpunon me të; sepse vetëm ajo është shpëtuar.

Ne jetojmë epokën tonë, prandaj nuk e shikojmë; por në qoftë se me të vërtetë ideja e re, që sot është e kryqëzuar, duhet të përqafojë dhe të përtërijë botën, ne kemi hyrë tashmë në rrethin e parë të zjarrit. Ndoshta, për disa shekuj, epoka jonë nuk do të quhet Rilindje por Mesjetë. Mesjetë do të thotë periudha midis dy mbretërimesh: Një qytetërim shteron, sjell një klasë të re njerëzish, lufton me dashuri, me ashpërsi, me besim, për të krijuar prej saj një të ri.

Krijimi i këtij qytetërimi të ri nuk është i sigurt - asgjë nuk është siguruar përnjëherë në gjithë krijimin - e ardhmja mund të jetë një katastrofë totale, mund të jetë një kompromis i paguximshëm; por

fryma e re krijuese, mund të triumfojë - dhe atëherë atë epokë kalim-
tare e jeton në dhimbjet e tmerrshme të fëmijërisë së një qytetërimi.

Asgjë nuk është e qartë; prandaj përgjegjësia e çdo populli, e çdo individi në epokën e paformë, të paqartë, është më e rëndë se kurrë. Sepse në epoka të tilla të paqarta, plot mundësira, kontributi i popullit dhe i individit mund të ketë një vlerë të padyshimtë. Cila është, pra, detyra jonë? Të gjykojmë çastin historik që jetojmë, dhe të vendosim me bindje, në një fushë të përcaktuar, veprimin tonë të dobët. Shumë janë përshtatur me rrjedhjet e reja dhe ndihmojnë ngjitjen e vështirë plot rreziqe e pasiguri, për shpëtimin e njeriut.

BUHARA: EPAFOS ËSHTË ZOTI IM

Kur pelegrinazhi im mbaroi, qëndrova disa ditë në Buhara për t'u shlodhur. Pas ditëve të ngrira jomikpritëse të Siberisë, ndjeva të më bjerë dielli i dashur që më ngrohu kockat e shpirtin. Kisha mbërritur pak para mesditës, bënte shumë vapë edhe pse rrugët ishin lagur dhe ajri mbante erë jasemini. Disa myslimanë, me çallma shumëngjyrëshe rrinin ulur nën tendat mbuluar me kashtë dhe gjerbnin lëngje freskuese. Ca fëmijë të shëndetshëm, këndonin irate orientale. Bleva një pjepër, u ula në hijen e xhamisë së famshme Kok-Kuba, e vura pjeprin mbi gjunjë; kisha shumë uri e shumë etje, e preva thela-thela dhe fillova ta ha, aroma e tij, embëlsia, arrinin deri në palcën e kockave të mia. Isha si një trëndafil i fishkur; zhytur në freskinë e pjeprit dhe u ringjalla.

Kaloi një vajzë e vogël, rreth shtatë vjeçe; shpina e saj ishte mbuluar nga një tufë gërsheta shumë të vegjël dhe në çdo gërshet i varej një guaskë, një gurë mavi, ose një gjysmëhëne e bronxtë për të larguar syrin e keq dhe ndërsa ajo kalonte para meje, ijet i tundeshin si të një femre të rritur, ndërsa ajri mbante erë myshku.

Në mesditë, hoxha hipi në minarenë përballë; kishte mjekër të bardhë dhe një çallmë jeshile. Vuri pëllëmbët mbi veshë dhe duke parë qiellin filloi të ftonte besnikët të luteshin me zë të kumbueshëm dhe të ëmbël; dhe ndërsa ai thërriste, një lejlek po rrinte pezull në ajrin e ndezur dhe pastaj u ul me një këmbë në majën e minaresë.

Po dëgjoja me veshët pipëz dhe po shikoja me sytë katër. Shijoja frutin shumë të ëmbël, aromatik; isha i lumtur. Mbylla sytë; por u tremba se mos më zinte gjumi dhe humbisja gjithë atë lumturi, pastaj i hapa përsëri. Përpara meje shtrihej sheshi i famshëm i Buharasë, Rexhistani i boshatisur.

Një ditë, shumë kohë më parë, në pranverë, vinin këtu, nga të gjitha vendet myslimane, pelegrinë të shumtë, që vajtonin mbi varret e dy djemve të Aliut, vrarë pabesisht, Hasanin dhe Hysenin. Karvanë

mbushur me ushqime, me mollë, me hurma dhe putana. Djem hipur mbi kuaj të bardhë, me koka të rruara, që mbanin nga një pëllumb të egër në dorë, pudrosur me hi dhe mbushur me fije të bardha, besnikët, në gjendje ekstaze që godisnin kokën me jataganët e tyre dhe gjaku rridhte mbi mustaqet e mëdha, mjekrat dhe dollomatë e bardha. Gjatë dyzet ditëve e netëve ata vajtonin duke buluruar: Hasan! Hysen! Hasan! Hysen! Pastaj shtriheshin nën pemët e lulëzuara, bashkoheshin dhe rënkonin të gjakosur me putanat e shenjta.

Dhe tani, sheshi i famshëm Rexhistani, i shkretë, xhamia e bukur shumëgjyrëshe, gjysmë e rrënuar, nuk ishin veç fantazma; gjeli kishte kënduar dhe gjithçka ishte zhdukur.

Përse gjithë kjo marrëzi hyjnore, gjithë kjo rrëmujë dhe vajtime njerëzish? Çfarë shpresojnë ata?

Hidhërimi e mbante pushtuar shpirtin tim, isha i lodhur për të ringjallur të vdekurit, mbylla sytë për të fjetur, për të shpëtuar. Pashë një ëndërr. Dy buzë që fërgëllonin, dy buzë femre, qëndronin pezull, pa fytyrë; ato lëvizën, dëgjova një zë: - Kush është Zoti yt? - Buda! - u përgjigja pa hezitim; por buzët lëvizën përsëri: - Jo, jo, është Epafos!

U zgjova i tromaksur; gjithë puna e fshehtë që kisha bërë gjatë tre muajve në nëntokën e shpirtit tim po zbulohej; në fund të qënies sime ishte hapur qepeni, unë shikoja. Isha torturuar, përplasur, gjatë gjithë kësaj kohe kisha luftuar brenda gjembave, si gjarpri kur ndërron lëkurën, për të sajuar një tjetër; unë vuaja dhe nuk e dija përse. Ëndrra ishte e qartë: Buda ishte lëkura e vjetër, Epafos ishte e reja, zoti i të prekurit, i cili preferon mishin në hije e që, si ujku, nuk ngopet kurrë me shërbëtore të reja. Ai nuk kënaqet as me syrin e as me veshin; ai vetëm do të prekë, të shtrëngojë me dorën e tij tokën dhe njeriun, të ndiejë ngrohtësinë e tyre që të njëjtësohet me të tijën. Të krijojë nga shpirti i tij një trup, që tek e fundit mund ta prekë. Zoti im është ai më i sigurti, më i zoti në punë, që i ka këmbët në tokë dhe e do atë, por që krijon sipas imagjinatës së tij, të ngjajshëm me veten.

Pa pikën e fjalës, pa fijen e zhurmës, Rusia e kishte kryer mrekullinë e saj. Si gjarpëri, lëkura e të cilit nuk është forcuar akoma, që ka ftohtë dhe zvarritet në diell për t'u ngrohur, shpirti im zvarritej nën diellin e ri. Unë isha zgjuar dhe nuk isha më ai që kisha qenë: Më parë nuk e dija, ndërsa tani e di. "Por si është e mundur, mendoja,

që një ëndërr të ndryshojë jetën e një njeriu?

- Ajo nuk do ta ndryshojë, - u përgjigja, - nuk do ta ndryshojë, ajo vetëm lajmëron se ka ndryshuar."

- Pyesja: Përse duhet, gjithë kjo luftë e marrë, që pushton njeriun? Kush është qëllimi i saj? Më parë do të isha përgjigjur me një buzëqeshje të lumtur.

- Fantazmagori. Bota nuk ekziston, padrejtësia, lufta, uria, gëzimi dhe trishtimi, nuk ekzistojnë; ato s'janë veç fantazma; kur të fryjë, ato do të zhduken.

Por ja, unë u hodha i tramaksur, befas isha lehtësuar. Mbrëmja kishte filluar të binte mbi Rexhistan, unë ngrita kokën. - Kush është qëllimi? Mos pyet, askush nuk e di, as vetë Zoti; sepse ai ecën së bashku me ne, duke u përpjekur, duke luftuar, i ekspozuar ndaj rrezikut. Ka uri, padrejtësi, shumë errësirë në zemrën e njeriut; ato që shikon ti nuk janë fantazma, sado të frysh ti, ato nuk do të zhduken, ato janë bërë nga mishi e kocka, preki, ato ekzistojnë. A nuk dëgjon ti një klithmë në erë? Ato thërresin. Çfarë thërresin? - Ndihmë! Kë thërresin? Ty! - Ty, çdo njeri!

- Çohu. Detyra jonë nuk është të pyesim por të kapemi të gjithë për dore dhe të ngjitim të përpjetën.

A ËSHTË POMPEI I LASHTË? AI ËSHTË MODERN

Kur, pas tre muajsh, duke u kthyer në Greqi, kalova nga Berlini, pastaj nga Vjena, bota kishte ndryshuar. Ose më mirë kishin ndryshuar sytë e mi. Ajo që më parë më dukej e huaj dhe e mërzitshme - vallëzimet e paturpëshme, barbaritë e muzikës moderne, femrat e stolisura, burrat e stolisur, buzëqeshjet ironike dhe të papërcaktuara, tërbimi i arit dhe i të puthurave - tani shkaktonin tek unë të vjella dhe një ndjenjë tmerri, të cilat unë i shihja si pararendëse të fundit të asaj bote. Në ajër kishte një kundërmim të keq, sikur piqej bota. Ishte era që duhet të ketë patur Sodoma e Gomorreja. Ishte era që duhet të ketë patur Pompei, përpara se të përvëlohej.

Një natë, duke u endur nëpër rrugët e ndritshme të Vjenës, plot të qeshura dhe gra, unë ndjeva të më ngrihej në shpirt qyteti i mallkuar, qyteti i kënaqësive. Herën e parë që e kisha vizituar, isha shumë i ri dhe nuk kisha mundur të zbuloja - as kisha kërkuar ta zbuloja - kobin e frikshëm që na kumton; shpirti im atëherë nuk kishte ëndërruar se fati i tij mund të ishte edhe fati ynë; bota akoma qëndronte e ulur fort mbi supet e Krishtit. Por... unë vendosa të bëja një udhëtim tjetër për të parë Pompein.

Qielli ishte gati i gjithë me re, barërat pranverorë kishin mbuluar hyrjet te portat dhe oborret, rrugët ishin ashtu si i dija unë, të shkreta, dhe unë brodha i vetëm në qytetin e zbrazur, duke fërshëllyer.

Shtëpitë ishin të hapura, pa porta, pa zotër, tavernat, tempujt, teatrot, banjat, gjithçka e shkretë; mbi mure qëndronin akoma, të shpëlara, dashuritë e vogla, idiote, vallëtarët e xhveshur, gjelat, qentë, çiftosjet e paturpshme të njerëzve me kafshët.

Pranë veshit tim tingëlloi një zë: "E bëftë Zoti që të mundem të ecë kështu edhe në Paris, edhe në Londër dhe të flas rusisht, me shokët e mi! "U drodha, një ndjenjë e tmerrshme përshkoi vertebrat e mia.

Bodrumet e Pompeit ishin plot gra të paturpshme, të porsalara e sterile; burrat ishin po ata që nuk zënë besë lehtë, ironikë e të lodhur.

NË QOFTË SE TI DIGJESH NË KËMBË, TI KE SHPËTUAR; NË QOFTË SE TI NUK DIGJESH SEPSE TI KE MBETUR I SHTRIRË PËRTOKË TI KE HUMBUR

Gjithë Zotët-grekë, afrikanë, aziatikë, - ishin atje, grumbulluar në një kope të vajtueshme demokratike, ateistë, frikacakë që ndanin ndërmjet tyre me buzëqeshje dinake, dhuratat dhe shpirtrat. Gjithë qyteti ishte shtrirë përmbys në këmbët e Vezuvit dhe qeshte me të madhe, i shkujdesur.

U ngjita në një lartësi, po shikoja; pas aq vjetësh, pas aq luftrash, arrita më në fund të kuptoj. Bekuar qoftë ky qytet mëkatar, që na jep ne këtë lajm: Gjithë bota është një Pompei, përpara erupsionit. Përse duhet një tokë e tillë, me gra të paturpshme, dhe njerëzit që nuk besojnë në asgjë, me uritë e saj, padrejtësitë dhe sëmundjet? Përse jetojnë gjithë këta tregtarë mashtrues, priftërinjë që shesin Zotin fshehtas, gjithë ata kodoshë e sakatë? Përse rriten, gjithë këta fëmijë dhe zënë vendet e prindërve të tyre, nëpër taverna, nëpër uzina, nëpër shtëpitë publike? Gjithë kjo lëndë e pengon shpirtin të kalojë. Gjithë shpirti që ajo kishte e shpenzoi për të krijuar një qytetërim të shndritshëm: Ide, fe, art e teknika, shkencë, veprim. Tani ajo është e zbuluar. Që barbarët pra të vijnë e të pastrojnë rrugët e zëna, të hapin një shtrat të ri ku mund të rrjedhin përrenjtë e shpirtit? Unë shikoj turmat e shtypura dhe të uritura të përfundojnë përpara tryezave të ngritura ku mësuesit rrinë ulur, të topitur nga ushqimi i tepërt dhe pijet.

Fytyrat që urdhërojnë sulmin i kap iluzioni. Disa, ata që rrinë ulur, papritur dëgjojnë zhurmë, dhe kthehen andej nga erdhi zhurma; ata fillojnë të qeshin, pastaj zbehen përkulen, të shqetësuar për të parë te këmbët e tyre dhe shohin skllevërit e tyre, burra e gra, gjysmatarët, punëtorët, këmbëzbathurit, të ngjiten lart. Çasti i shenjtë! Më të guximshmit e mendimit, të artit, të veprimit, janë bashkuar

në këtë ngjitje të furishme të njeriut.

Mësuesit mblidhen për t'u bërë ballë, dhe rezistojnë. Por kundër tyre derdhet gjithë vrulli i epokës sonë: - ata kanë ngrënë e kanë pirë, kanë krijuar një qytetërim dhe janë raskapitur, fytyra e fundit e detyrës së tyre ka ardhur: Zhdukja.

Sapo të ngrihen tryezat e reja, të tjerët do të fillojnë të majmen e të bien në plogështi. Të tjera turma të tiranizuara, do të ngrihen nga toka, nga uria dhe nga iluzioni, ato dy forca që komandojnë shpirtrat do të vendosen përsëri në kokat e tyre, kështu, përjetësisht, sipas një ritmi të pandërprerë.

Ï tillë është ligji, vetëm kështu mund të përtërihet dhe të mbrohet jeta. Çdo organizëm i gjallë - provon në fund të qënies së tij, nevojën e papërballueshme, ose më saktë detyrimin, të shtrëngojë e të asimilojë gjithçka që ai mund të arrijë rreth vetes së vet, ta përvetësojë, të sundojë botën po qe e mundur.

Nuk ka bishë më të uritur dhe më lakmitare se një ide e re.

Por në të njëjtën kohë ligji i pamëshirshëm hyn vetë në veprim: sa më shumë që organizmi i gjallë plotëson detyrën e vet të të zgjeruarit dhe të të sunduarit, aq më shumë i afrohet - shkatërrimit të tij. "Tepërimi" është ndoshta mëkati i vetëm që harmonia universale e konsideron të vdekshëm dhe nuk e fal. Çasti kur forca e një organizmi arrin pikën e saj kulmore, shkakton fatalisht humbjen e tij.

Dhe në këtë gjë të pakonceptueshme duhet shtuar diçka: pikërisht sepse ky organizëm i gjallë ka plotësuar detyrën e tij është shfarosur. Në qoftë se ai nuk do ta kishte plotësuar, do të jetonte dhe do të gjallonte, pa shqetësuar njeri dhe shumë më gjatë, pa u shqetësuar as vetë.

Duket sikur kjo detyrë e kobshme është ngulitur në zemrën e këtij organizmi për ta ndihmuar, meqë ai e ka plotësuar misionin e tij, është bërë gjigand dhe ka sunduar, duhet të zhduket, që të mos bëhet pengesë për një tjetër organizëm të gjallë që fillon të ngrihet kundër tij dhe që dëshiron të sundojë botën. Mund të thuhet se ekziston një forcë tjetër shpërthyese në çdo pjesë të jetës, sikur gjithë vrulli i jetës të jetë përqendruar atje, gati për të shpërthyer në përplasjen më të vogël. Kështu i çliron jeta, pasionet që ekzistojnë në të, dhe ecën përpara.

Në pamje të parë, ky ligj na duket i padrejtë dhe na acaron; por

në qoftë se përkulemi dhe shohim më thellë, ne dehemi nga admirimi; falë këtij ligji forca barbare humbet gjithë pushtetin; i fuqishmi nuk duhet të fryhet deri në përmasa gjigande, me guxim të tepëruar e mburrje, sepse ky ligj i harmonisë edhe pse e shtyn të shtrijë forcën deri në ekstrem, ndërkohë i kujton atij, se çdo çast që kalon, në shërbim të të gjithëve, e çon në asgjësimin personal.

Këtë, shefat bolshevikë nuk e dinë, dhe nuk duan ta dinë; fati u zë sytë, i pengon të shohin se ku shkojnë; në qoftë se do ta shikonin, vrulli i tyre do të ulej.

Unë luftoj, për të përqafuar, aq sa të jetë e mundur, gjithë fushat e aktivitetit të njerëzve dhe për t'u bërë era që shtyn gjithë këto dallgë njerëzore drejt lartësive. Përkulem mbi harkun e paperceptueshëm të rrethit gjigand, mbi epokën ku jetojmë dhe përpiqem të dalloj qartë detyrën bashkëkohore. Vetëm kështu ndoshta njeriu do të mund, në iluzionin e gjatë të jetës së tij, të realizojë diçka të pavdekshme, sepse ai punon në akord me ritmin e pavdekësisë.

Unë ndiej shumë thellë, se një njeri që lufton, ngrihet nga lëndë bruto, te bimët, pastaj te kafshët, nga kafshët te njerëzit, dhe lufton për liri. Në çdo epokë kritike njeriu që lufton merr një fytyrë të re; sot fytyra e tij është kjo: ai është shefi i proletarëve që ngjiten. Ai thërret, jep urdhëra: drejtësi, lumturi, liri, dhe inkurajon shokët e tij. Askush nuk e njeh të fshehtën e tmerrshme: drejtësia, lumturia, liria largoheshin gjithnjë e më tej.

Megjithatë është e drejtë dhe e nevojshme se të gjithë ata që luftojnë për një ideal besojnë se do ta arrijnë atë, dhe sapo ta kenë arritur mbi botë do të bjerë lumturia. Kështu mendja është ngrohur dhe merr guxim për ngjitje pa fund. Karrocierët nuk bëjnë gjë tjetër, veç vendosnin përpara turirit të kalit të tyre, mbrehur në një karrocë të rëndë, një dorë tagji; kali zgjat qafën, përpiqet ta kapë, tagjia largohet, kali e ndjek, përpiqet ta kapë dhe kështu ai ecën dhe ngjit brinjën.

Unë sundohem nga një ndjenjë respekti. Mes këtyre masave të errëta, unë dalloj qartë klithmën e së padukshmes që shtyn botën, që edhe ajo të ngjitet po ashtu. Në qoftë se do të kisha jetuar në shekuj të tjerë, unë do të kisha dalluar klithmën midis masës së fi-

snikëve, borgjezëve, industrialistëve, tregtarëve që atëherë edhe ata ngjiteshin, dhe do të kisha luftuar përkrah tyre. Një sulm i përjetshëm, më i madh se njeriu, i merr njerëzit, i shtyn drejt lartësive, dhe kur më në fund ata lodhen, i abandonon dhe përplaset mbi një tjetër material, të papërpunuar, që zotëron energji.

Këtë sulm të përjetshëm, në epokën tonë, ne kemi detyrë ta ndjekim, ta ndihmojmë e të bashkëpunojmë me të. Sot ai ka pushtuar turmat që punojnë dhe janë të uritura. Këto masa janë sot material i papërpunuar. Këtë sulm të pamposhtshëm, masat mund ta dallojnë, ato i japin emra të ndryshëm që ta bëjnë të pranueshëm për mendjen e tyre kërkuese dhe të këndshëm për jetën e tyre të përditshme.

Ato quhen lumturi, drejtësi, paqe. Por luftëtari i padukshëm, duke i lënë këto lakmi të nxitin masat, përpiqet, fort e i paepur, të përshkojë shpirtrat dhe mishrat dhe të krijojë, me gjithë klithmat e bashkëkohësve të mërzitjes dhe urisë një fjalë lirie.

Është shumë e rrezikshme të përkulesh për të parë; tmerri mund të të kapë edhe ty; sepse ti zbulon një të fshehtë të neveritshme: luftëtari nuk interesohet për njeriun, ai interesohet për flakën që djeg njeriun. Rruga e tij është një vijë e kuqe; vetëm ajo i intereson në botë, që ta ndiej t'i përshkojë kafkën, ta shpojë tejpërtej e ta thyejë. Unë pranoj lirshëm, të pashmangshmen.

Po rrimë brenda kufijve njerëzorë, vetëm atje ne mund të punojmë e të bëjmë detyrën tonë; të mos shkojmë andej, mos shkojmë deri në fund; sepse aty hapet humnera, që mund të na presë këmbë e duar. Atje rri Buda me buzëqeshje të hidhur, prestigjitatori i madh që fryn dhe bën të zhduket bota. Por ne të tjerët, nuk duam që bota të zhduket, as që Krishti ta ngarkojë mbi supet e tij dhe ta çojë në qiell. Ne duam që të jetojë e të luftojë me ne, ne duam ta dojë si poçari argjilën. Ne nuk kemi material tjetër për të punuar, as fushë tjetër të fortë mbi kaos për të mbjellë e për të korrur.

JO MË ME IDE POR ME NJERËZ

Unë isha akoma në Itali kur mora nga Athina, nga ministria e mbrojtjes sociale, një telegram që më kërkonte nëqoftë se unë pranoja të më ngarkonin detyrën e Drejtimit të përgjithshëm të Ministrisë, me mision të veçantë të shkoja në Kaukaz, ku më shumë se njëqind mijë grekë, ishin në rrezik, dhe të përpiqesha të gjeja një mënyrë për t'i nisur në Greqi, për t'i shpëtuar.

Ishte hera e parë në jetën time që më paraqitej rasti për të hyrë në veprim e të mos luftoja më me teori, me ide, me krishtër e me budë, por me njerëz të gjallë, bërë prej mishi e prej kockash. Isha i gëzuar; isha lodhur së luftuari me hijet duke shkuar shesh më shesh, duke marrë me vete pyetje të cilave u kërkoja përgjigje. Pyetjet nuk pushonin së ngrituri kokën dhe përgjigja zhvendosej; pyetjet vendoseshin njëra mbi tjetrën, si gjarpërinjtë dhe më zinin frymën. Momenti ishte i favorshëm për të provuar veprimin e të shihja nëse ai ishte vetë i aftë t'u përgjigjej, duke prerë me shpatë nyjet e pazgjidhshme të spekullimit.

Unë e pranova edhe për një arsye tjetër: unë kisha mëshirë për racën time, përjetësisht e kryqëzuar, që ishte akoma në rrezik mbi malin e Prometeut, në Kaukaz. Nuk ishte më Prometeu, ishte kryqi i tij - dhe ai thërriste. Ai nuk thërriste zotët, por njerëzit, fëmijët e tyre që ta shpëtonin kështu, duke bashkuar vuajtjet e sotme me telashet e përjetshme të Greqisë, duke e ngritur në simbol aventurën tragjike të tashme, unë pranova. Lashë Italinë, u nisa për Athinë, ku mora me vete nja dhjetë bashkëpunëtorë të zgjedhur, pjesa më e madhe kretianë, dhe u nisa për në Kaukaz, për të parë në vend se si mund t'i shpëtoja ato mijëra jetë njerëzore. Ardhur nga jugu, kurdët vepronin si kafshë me grekët që u binin në dorë, ndërsa nga veriu, zbrisnin bolshevikët me zjarr e hekur. Në mes qëndronin grekët e Batumit, të Suhumit, të Tfilisit, të Karskut; nyja e lidhur vazhdonte të shtrëngohej rreth qafës dhe ata të zhveshur, të uritur, të sëmurë,

prisnin vdekjen. Edhe njëherë akoma, nga njëra anë pushteti, nga ana tjetër dhuna: aleatët e përjetshëm.

Është gëzim i madh të nisesh drejt një qëllimi të vështirë dhe rreth vetes të kesh bashkëpunëtorë të guximshëm, njerëz të nderuar. Lamë prapa brigjet e Greqisë dhe një mëngjes, midis qiellit dhe detit të mjergullt u duk Kostandinopoli.

Binte një shi i imët, minaretë shumë të bardha dhe qiparizët e zinj shponin mjergullën, si direkët e një anijeje të mbytur. Shën Sofia, pallatet, ndërtesat bizantine, gjysmë të rrënuara humbisnin nën shiun e qetë e të mërzitshëm. Ne u mblodhëm të gjithë mbi bashin e anijës, përpiqeshim të depërtonim shikimin ndërmjet mjegullës së dendur, për të parë.

Njëri nga shokët e mi shau:

- Kurvë e mallkuar, që shtrihesh me një turk! - dhe sytë iu mbushën me lot.

- *"Për shekuj dhe vite, ajo përsëri do të jetë e jona"*... pëshpëriti një tjetër.

Unë e ndjeja zemrën të qetë. Në qoftë se do të kisha kaluar ato ujëra legjendare, në kohë të tjera, shpirti do të më ishte mbushur me legjenda dhe këngë popullore, me dëshira të dhunshme dhe do të kisha ndjerë mbi duart e mia, të ngrohtë e të rëndë, lotët e ikonës së virgjëreshës, por atje, si një refleks shumë i largët, shumë i pamundshëm nga hidhërimi, ai qytet legjendë, më dukej si një krijesë e bërë nga mjegulla dhe iluzioni.

Gjatë dy ditëve ne shikonim Kostandinopolin e largët, duke pritur që të qetësohej deti për t'u nisur. Unë isha i gëzuar sepse shtrëmbalu-qet e mëdha të rojeve turke, nuk na linin të zbrisnim dhe të shkelnim tokën e shenjtë robëruar nga turqit. Gjithë kjo përputhej me gjendjen time shpirtërore të hidhur, të dërrmuar; me zemrën time plot krenari, që nuk donte të zbulonte vuajtjen e saj.

Binte shi. Kostandinopoli po mbytej; deti dalëngadalë po bëhej i gjelbër dhe pak nga pak dallgët po zvogëloheshin; ditën e tretë, në mëngjes, u nisëm. Kishim kaluar Bosforin, kopshtet e mbushur plot shtoheshin gjithnjë e më shumë, shtëpitë ishin më të pakta, në të majtë e në të djathtë brigjet e Azisë dhe të Evropës bëheshin më të egër; Kishim hyrë në Detin e Zi të tmerrshëm. Përsëri një erë e fuqishme, era e kripur e detit; dallgët ngriheshin lart, përkuleshin duke

shkumëzuar e hingëllirë si kuajt e bardhë të Homerit. Të mbledhur në kabinën time, flisnim për Greqinë e persekutuar mijëra herë, mijëra herë të plagosur, për Greqinë e pavdekshme, për përgjegjësinë tonë, që atje ku shkonim, të tregoheshim të denjë.

KAUKAZI; PROMETEU I RI

Unë nuk do të tregoj këtu peripecitë e misionit tim; gjatë një muaji bashkë me shokët e mi u ramë kryq e tërthor qyteteve dhe fshatrave ku ishin ngulur grekët; kaluan Gjeorgjinë, hymë në Armeni. Ato ditë në portat e Karskut, kurdët përsëri kishin kapur tre grekë dhe i kishin mbathur si mushkat; ata kishin arritur pranë Karskut dhe ne dëgjonim ditë e natë të shtënat e tyre.

- Duhet që njëri nga ne, të rrijë në Karsk, të mbledhë gjithë grekët, burra, gra e fëmijë, kafshët dhe plaçkat e tyre që mund t'i transportojnë me krah dhe ti çojë në portin e Batumit. Unë ndërkaq e kisha mbaruar raportin tim dhe kërkoja të vinin vaporët, ngarkuar me ushqime, me veshje dhe medikamente dhe pastaj të merrnin ngarkesën njerëzore. Kush dëshiron të rrijë në Karsk? Misioni i tij është i rrezikshëm ta dijë mirë!

Grekët më të shquar të Karskut ishin mbledhur rreth nesh dhe na dëgjonin; ata rrinin varur tek buzët tona.

Dhjetë shokët e mi u hodhën menjëherë; ata të gjithë dëshironin të rrinin. Unë zgjodha atë me trup më të madh, plagosur në luftrat e mëparshme, shokun e vjetër të klasës që e doja shumë; Ishte i zoti, moskokëçarës, dhe me humor; e gëzonte ideja se mund të luante me rrezikun.

- Do të rrish ti, Herakles, - i them, - zoti i Greqisë qoftë me ty.

I shtrënguam dorën, e lamë atje. Disa javë më vonë Herakles, mbërriti në Batum mbuluar nga pluhuri, i leckosur, i nxirë. Ai ecte në krye ndërsa prapa tij vinte turma e grekëve të Karskut, me qetë, kuajt, plaçkat, dhe në mes prifti duke mbajtur në dorë ungjillin e argjendtë të kishës, pleqtë që mbanin në krahë ikonat. Ata ishin çrrënjosur dhe tani shkonin drejt Greqisë së lirë, që të hidhnin rrënjë të reja. Ndërkohë ne kishim mbledhur grekët e Gjeorgjisë, dhe një mëngjes unë dëgjoja britma, shpërthime gëzimi, të shtëna pushkësh, vrapova në port - Ishin dukur vaporët e parë grekë që vinin t'i merr-

rim. Ishte një luftë e vështirë, ne ishim të dërrmuar nga lodhja, nga pagjumësia nga shqetësimi. Herë pas here, hidhja një shikim të shpejtë mbi malet e egër legjendarë mbi fushat e qeta, mbi racën e mrekullueshme të njerëzve të atyre vendeve, me sy të mëdhenj orientalë, ëmbëlsisë së parezistueshme të shpirtit të tyre të shkujdesur e të qeshur; ata pinin, kërcenin, vriteshin me njëri-tjetrin me një vullnet plot mirësjellje si insekte shumëngjyrësh. Unë nuk kisha kohë, dhe nuk pranoja, ta shmangia shpirtin tim nga detyra e rëndë që më kishte çuar atje. Shihja rreth vetes burra, gra, fëmijë të vegjël që ngjishin me njëri-tjetrin, të uritur, të dëshpëruar, që më shikonin në sy dhe prisnin nga unë shpëtimin; si mund t'i tradhtoja ata? - Unë do të shpëtoj ose do të zhdukem me ju, - u thosha; mos u trembni, vëllezër, të gjithë bashkë! Atëherë u flisja akoma për racën tonë të persekutuar, që lufton prej shekujsh për të shkatërruar barbarët, urinë, varfërinë, dridhjet e tokës, përçarjen; por ajo është e pavdekëshme dhe ja, pas mijëra shekujsh, jeton e përparon! Kështu, duke menduar gjithmonë Greqinë ata kanë mundur të qëndrojnë.

Vetëm një mbrëmje, më kujtohet dhe për këto më vjen turp, unë i tradhtova. Një mbrëmje, në një kopsht të mbyllur të Batumit, në breg të detit shtruar me zaje të bardhë, rrethuar nga të gjitha anët me xunkthe indie që ishin mbuluar me lule flakë të kuqe. Ato ditë një shqetësim i padurueshëm më torturonte: asnjë vapor tjetër nuk po dukej, do të vinte apo nuk do të vinte tjetër? A do të arrinin të shpëtoheshin gjithë ato jetë njerëzish përgjegjësinë e të cilëve e kisha unë? Disa ditë më parë unë kisha njohur gjeorgjanen Barbara Nikollajevna dhe atë mbrëmje ajo më ftoi në atë kopsht të mbyllur, sepse ajo më kishte parë të shqetësuar dhe kishte patur mëshirë për mua. Kurrë nuk kisha parë femër më të bukur; dy sy të gjelbër, magjistarë e të rrezikshëm si ata të gjarpërit, një zë pak të ngjirur, plot premtime, kundërshtime e ëmbëlsi. Unë ia shihja dhe shpirti më turbullohej, gjëmime më të vjetra se njeriu ngriheshin nga thellësitë e qënies sime, tek unë po hapeshin guvat e vjetra të zeza, dhe prej andej dilnin stërgjyshërit e vjetër, me lesh, që skuqeshin duke parë Barbara Nikollajevën.

E shikoja dhe mendoja: ky çast nuk kthet kurrë; kjo femër nuk gjendet kurrë. Gjatë miliona vjetëve, një turmë e panumërt dhe e tallazitur rastësish dhe fatesh kanë punuar që të lindin këtë femër e

këtë burrë që ata të bashkohen mbi breg të Kaukazit, në këtë kopsht me xunkthe të lulëzuar Indie. Do ta lëmë këtë çast hyjnor të na ikë?

Femra u kthye nga unë, mbylli sytë përgjysmë.

- Nikollaj Mihajlloviç, - më tha, - dëshiron ti të vish me mua? Unë u tremba; atë që më përvëlonte e që unë nuk guxoja ta thosha, e kishte thënë ajo.

- Nisemi? - e pyeta. - Ku do të shkojmë?

- Larg prej këtej; burri im s'është më për mua, këtu të zihet fry- ma, unë po fishkem, për trupin tim kam mëshirë, Nikollaj Mihaj- lloviç, kam mëshirë për të, eja, ikim prej këtej.

U mbërtheva fort pas karriges, kisha frikë të ngrihesha menjëherë se mos e merrja me vete - një kaike po hidhte spirancën para nesh - të hyj bashkë me të në kaike e të nisem, ndërkaq po rezistoja.

- Po detyra, Barbara Nikollajevna, dhe ato mijëra jetë njerëzore që presin prej meje shpëtimin?

Gruaja, me një lëvizje nervoze, hoqi shallin e mëndafshtë që i mbështillte kokën, flokët ngjyrë gruri iu shpërndanë mbi supe. Rru- dhi buzët, këmbëngulëse.

- Detyra! - përsëriti. - Ka vetëm një detyrë, mësoje nga goja ime, ka vetëm një të tillë: të mos e lësh lumturinë të të ikë, ta kapësh për flokësh. Kap flokët e mi, Nikollaj Mihajlloviç, askush nuk na shikon.

Unë vëreja detin; brenda meje luftonin gjithë demonët; asnjë engjëll. Fati qëndronte në këmbë përpara dhe priste. Kaloi një kohë e gjatë; papritur, femra, me çehre të prerë, kërceu nga karrigia.

- Kaq, - tha. - Ti nuk pranove menjëherë, nuk më kape për flokësh, ti peshove fitimet dhe humbjet, mbaroi! Tani, edhe në qoftë se ti pranon, kundërshtoj unë. Shëndeti yt, Nikollaj Mihajlloviç, bravo, ti je një njeri i vogël, i ndershëm, që quhen shtylla të shoqërisë, qo- fsh shëndoshë!

Boshatisi gotën e saj me verë të athët Armenie. Pas mijëra vje- tësh, midis lashtësisë mosmirënjohëse, unë mbylla sytë, xungthet e Indisë shlodheshin, Deti i Zi rrihte tëmthat e mi, Barbara Nikolla- jevna, u ul përballë meje, jo mbi karrige, por këmbëkryq mbi zajet e bardhë. unë e shikoja, e shikoja, dhe mendoja: Bëra mirë që nuk shtrëngova flokët e saj në çastin hyjnor?

Psherëtij dhe përgjigjem: unë nuk mendohem më!

Dy javë më vonë, unë lashë brigjet e Kaukazit; ditët e fundit ki- shin qenë shumë mizore. Ishte e vërtetë, vaporët kishin filluar të ni- seshin, ngarkuar me jetë njerëzore, unë shikoja se ndërhyrja ime në fushën e veprimit i kishte dhënë frutet e veta, tashmë shihja ata grekë punëtorë të mëdhenj, të hidhnin rrënjë në Maqedoni e në Thrakë, të mbulonin me grurë, me duhan dhe me grekë të vegjël, tokat tona të vjetra të shkatëruara që kishin qenë pre e barbarëve; do të kisha dashur të isha i kënaqur. Megjithatë një krimb i fshehtë punonte tek unë dhe më shponte zemrën; unë nuk arrija akoma ta dalloja qartë fytyrën e shqetësimit tim të ri, ndieja vetëm hidhërimin e tij.

Kur bëhesha gati për të hipur në vapor, më afrohet një plak.

- Më thanë, se ti je me shkollë. Me lejen tënde do të dëshiroja të bëja një pyetje: Lidienët që luftuan në luftën e Trojës, grekë ishin? Ngela pa lëvizur; nuk më kishte ardhur asnjëherë në shpirt se kjo mund të përbënte një problem që mund të torturonte një njeri.

- Grekë? - u përgjigja; - aspak, ishin lidienë, lindorë.

Plaku tundi kokën.

- Atëherë ai ka patur të drejtë kur më tha se ti ke mohuar traditat atërore. Lamtumirë.

Ajo ishte fjala e fundit që dëgjova në Kaukaz.

Më vonë, e kujtova vazhdimisht atë plak të Pontit. Dhe pak nga pak fillova të kuptoj se ka pak rëndësi të dish çfarë problemi të tor- turon - qoftë i madh ose i vogël, e rëndësishme është që torturohesh; të gjesh një rast të torturohesh, domethënë të ushtrosh shpirtin, ta pengosh bindjen t'ju dërrmojë, të gjesh përpara teje një portë të mbyllur dhe të përpiqesh ta hapësh. - Unë nuk mund të jetoj pa bindje, - thotë, - njeriu që kërkon të jetë rehat, të gjejë një tokë të fo- rtë ku të vendosë këmbën, të hajë dhe të mos shikojë prapa bukës se, ndërsa ha, gojë të panumërta të hapura kanë uri. - Nuk dua, nuk mund të jetoj pa qenë i sigurt, thërret; ata nuk e kanë vetëdijen të qetë, nuk flenë pa tmerr, nuk thonë: Kjo botë është fajtore, se ajo përpiet të mos ndryshojë kurrë! Ata, qofshin të lëvduar, janë kripa e Zotit dhe pengojnë shpirtin të piqet. Unë qesha, u kollita duke dëgjuar atë plak të Pontit, me shqetësimin e tij komik; tani, në qo- ftë se do ta shihja përsëri, do të bija në krahët e tu, vëllai im, shoku im i luftës.

ZOT SHPËTOJE POPULLIN TËND.

Anija ishte plot me shpirtra që ishin shpërngulur nga toka e tyre dhe që unë do t'i çoja në Greqi.

Njerëz, kuaj, lopë, magje, djepe, mbulesa, ikona të shenjta, ungjille, lopata dhe kazma, largoheshin nga bolshevikët, nga kurdët dhe hidheshin drejt Greqisë së lirë. Nuk më vjen turp ta them se isha thellësisht i mallëngjyer; më dukej sikur isha një centaur dhe gjithë kjo turmë që mbushte anijen, ishte trupi im nga gryka deri te këmbët.

Deti i Zi dallgëzonte lehtë. Ai ishte ngjyrë blu i thellë dhe vinte era shalqi. Në të majtë bregu dhe malet e Pontit që dikur na përkisnin neve dhe në të djathtë deti xixëllues. Kaukazi ishte shfaqur në dritë por të vjetrit, duke na kthyer shpinën, qëndronin ulur në kiç duke mos mundur të shkëpusnin shikimin e tyre nga ky det dhe ky qiell kaq i dashur. Kaukazi ishte zhdukur, ishte shpërndarë si një iluzion optik, por qëndronte i palëvizur, në bebëzat e tyre, si një diell që nuk perëndon. Është e dhimbshme, shumë e dhimbshme për njeriun që të shkëputet nga atdheu i tij; male, dete, njerëz të shtrenjtë, shtëpi e dashur; shpirti është një oktapod dhe të gjitha gjërat e dashura janë krahët e tij. Unë isha ulur në bash, mbi një rrotull litarësh dhe rreth meje ishin mbledhur burra dhe gra, disa të ardhur nga Karsku, të tjerë nga Suhoumi, të tjerë akoma të ndjekur nga Taigani. Tregimet e vuajtjeve të tyre nuk mbaronin, secili nxitonte për t'ia thënë atë tjetrit që të lehtësohej. Dëgjoja dhe admiroja në mënyrë të fshehtë rezistencën e racës greke; sepse ndërsa ata ankoheshin për të afërmit që kishin humbur, për shtëpitë e djegura, për urinë dhe tmerret e jetuara, papritur ndonjëri lëshonte një shaka, kokat ngriheshin lart dhe gjithë hidhërimi zhdukej. Ndërkohë që një grua e re me fytyrë buçkane qante për burrin e vrarë, një kolos me mustaqe të mëdha, të rëna e të zeza, ngriti dorën dhe e preku në sup.

- Mos qaj Mariorica, - i tha. - Edhe sikur të ngelen dy njerëz në botë, unë dhe ti për shembull, toka greke do të mbushej sërisht me fëmijë!

Dhe hodhi shikimin rrotull.

- Hej vëllezër, - tha ai, - e dini ku gjendet shpresa e botës? Në kokë, do të thoni ju; por jo, më poshtë! Në zemër atëherë? Po jo, dreqi e marrtë, më poshtë!

Ai hodhi një shikim me cep të syrit mbi femrat:

- Ej, sikur të mos kisha turp nga femrat, do t'ju tregoja vetë se ku ndodhet shpresa e botës. Atëherë mos qani pra!

Gratë u skuqën dhe burrat qeshën.

- Ah, ti nuk e ke shokun Teodor, - i thanë ata. - Faleminderit që na bëre të qeshim.

Vetëm një burrë qëndronte ulur mënjanë dhe i heshtur. Ai nuk qeshte dhe nuk tregonte për vuajtjet e tij; sikur nuk donte të lehtësohej prej tyre. Kishte një trup të madh, me zverkun si të kaut, me duar të mëdha e të gjata që i arrinin deri te gjunjtë. Gjoksin e kishte shumë leshtor. Nuk kisha parë asnjëherë një njeri që t'i ngjante aq shumë ariut.

Kur të gjithë u shpërndanë dhe u shtrinë për të fjetur mbi lecka, ai ndenji me zverkun e përulur duke soditur detin. Iu afrova. Unë ndjeja një forcë shqetësuese që buronte nga kjo masë njerëzore e palëvizshme.

- Ti nuk ke thënë asgjë, - i thashë për të nisur bisedën.

Ai u kthye, më pa, shtriu krahët; kockat i kërcitën.

- E ç'duhet të them? Vuajtjet e mia, që të lehtësohem? Nuk dua të lehtësohem.

Heshti. U ngrit sikur donte të largohej, pastaj u ul sërish. Unë e ndjeja se ai luftonte brenda vetes, nuk donte të fliste, por zemra e tij ishte e mbushur; pastaj mbetëm vetëm; nata kishte rënë; ai u qetësua pak.

- I pe malet dhe pyjet e Kaukazit? Për vite të tëra unë i kam përshkuar krejt i vetëm, më quanin derr i egër, sepse isha i vetmuar dhe nuk rrija me asnjëri; nuk shkoja as në tavernë as në kishë. Po ta përsëris, unë përshkoja malet dhe pyjet krejt i vetëm. Gllabëroja malin krejt i vetëm gur më gur, isha prerës guri, punëtor guroreje, qymyrxhi, nuk kisha asgjë, isha i varfër, por isha i ri, i fortë si luan dhe s'kisha nevojë për askënd. Por një ditë, ndjeva forcën time që të më shtypte dhe për të mos shpërthyer ngjita malin, rrëzova pishat më të forta dhe ndërtova një shtëpi pranë një burimi. E ndërtova

me dyer, me dritare, ishte gati. Nga fshati fqinjë erdhën burra dhe gra për ta parë; ata sollën verë dhe ushqime. Unë isha ulur përballë mbi një shkëmb dhe e shikoja; erdhi një vajzë dhe u ul në krahun tim. Dhe duke parë shtëpinë ktheva kokën; të nesërmen në mëngjes u gjenda i martuar. Ai psherëtiu.

- U gjenda i martuar; trullosja iku, shpirti erdhi nga malet e larta. - Ç'do të hamë moj grua? - i thashë; Unë nuk arrij të ushqej një gojë, jo më dy. Po fëmijët?

- Mos u shqetëso, - më tha ajo, - shkojmë në kishë.

- E ç'të bëj në kishë? Unë nuk shkoj.

- Shkojmë po të them. - Shkuam. Bëmë kryqin dhe morëm guxim.

- Tani do t'i thyejmë gurët, do t'i shtypim dhe do t'i bëjmë tokë. - Shkuam atje; thyem gurët, bëmë tokë dhe e mbollëm.

- Tani shkojmë të krasitim ullinjtë, - vazhdoi gruaja.

- Po çfarë ullinjsh? Nuk ka veçse degë të thara.

- Shkojmë. - Vajtëm; Krasitëm degët e thata. Mbollëm, mblodhëm, hëngrëm bukën dhe vajin tonë. - Zoti i bekoftë eshtrat e gjyshit tim; mos ki frikë nga varfëria, nga skamja. Mjafton të kesh një grua të mirë.

Ai heshti sërish. Kapi skajin e një litari dhe nisi ta bënte fije-fije me thonj, si mace e egër; ndjeja në errësirë dhëmbët e tij që kërcisnin.

- Po, pastaj? - e pyeta i turbulluar.

- Mjaft! Ti kujton se do të të tregoj vuajtjet e mia?

- Po gruaja jote?

- Të thashë mjaft!

Ai futi kokën mes gjunjëve dhe nuk foli më.

Lotët e njerëzve mund të lëvizin të gjithë mullinjtë e ujit që ka toka, por ato të Zotit nuk lëviznin, - më tha një ditë në një fshat një maqedonas i vjetër, që rrinte galiç në pragun e shtëpisë dhe ngrohej në diell. Dashuria dhe dhembshuria janë krijesa të njeriut dhe jo të Zotit. Sa dhembje të madhe mbartte kjo anije dhe po e çonte atë në Greqi! Por për fat, ekziston koha. Ajo ka mëshirë për ne. Koha është si një sfungjer, ajo nxjerr shpejt barin e ri të pranverës që mbulon gurët e varreve, dhe jeta rimerr sërish vrullin e saj.

Qielli ishte mbushur me yje; kostelacioni i Akrepit, me bishtin spiral dhe syrin e kuq, doli nga deti, i zemëruar. Rreth meje gjendej vuajtja e njerëzve ndërsa mbi kokë, çnjerëzor, i heshtur, i mbushur

me rreziqe, gjendej dielli i yjëzuar. Sigurisht, të gjitha këto sinjale të ndritshme duhet të kishin një kuptim të fshehtë. Sigurisht ky vigjilent duhet të ruante një të fshehtë të tmerrshme; po cilin? Nuk e di; unë e ndiej se kjo e fshehtë nuk ka asnjë përgjigje në zemrat e njerëzve. Le të themi që në botë ka dy mbretëri të ndara; mbretëria e njerëzve dhe mbretëria e Zotit.

Me të tilla biseda, me të tilla mendime, kapërcyem detin e Zi dhe pamë nga larg të ndriçuar nga dielli, plot kopshte, me minare dhe gërmadha, Kostandinopojën.

Shokët e mi të udhëtimit, të mallëngjyer, u përkulën para saj. Një prej tyre u përkul në bashin e anijes.

- Guxim! - thirri, - guxim nënë!

Dhe kur u gjendëm përballë me brigjet e Greqisë, prifti i Suhumit, që udhëtonte me ne, u ngrit, kaloi petrahilin dhe ngriti duart e plakura drejt qiellit:

- Zot, Zot, - thirri me zë të lartë, që Zoti ta dëgjonte, shpëtoje popullin tënd, ndihmoje që të hedhë rrënjë në tokat e reja, që të marrë gurë e drurë për të ndërtuar kisha, dhe të mbulojë me lavdi emrin tënd në gjuhën që ti do.

Kaluam brigjet e Thrakës dhe të Maqedonisë, kaluam majën e Malit Athos dhe hymë në portin e Selanikut. Misioni im do të zgjaste njëmbëdhjetë muaj. Anije të ngarkuara me njerëz dhe kafshë, nuk pushonin së mbërrituri nga Kaukazi, gjak i ri po hynte në venat e Greqisë. Unë përshkruaja Maqedoninë dhe Thrakën, ndanim fushat dhe fshatrat që turqit kishin lënë duke ikur, të zotët e rinj po i merrnin në dorë; ata fillonin të gërmonin,të mbillnin, të ndërtonin. Një prej gëzimeve më legjitime të njeriut, unë besoj se është, të mbledhë frytet e punës së tij. Një ditë një agronom rus, na çoi mua dhe Istratin në një shkretëtirë afër me Astrahanin; shtriu krahët, dhe përqafoi triumfalisht shtrirjen e pafund të rërës:

- Kam mijëra punëtorë; ata mbjellin një lloj bari me rrënjë të gjata që thith ujin në tokë. Për disa vjet shkretëtira do të kthehet në kopsht të vërtetë.

Sytë i shkëlqenin.

- Shikoni, shikoni, atje, fushat, kopshtet, ujin?

- Ku? Ku? Nuk shikojmë asgjë - thirri Istrati.

Agronomi buzëqeshi: - Do ta shikoni pas disa vitesh, - tha duke

ngulur shkopin në tokë.

Ai kishte të drejtë. Unë e ndjeja. Unë e shikoja me sytë e mi plot njerëz, me ujëra, me kopshte, mbi tokat e shkatërruara që ndanin shokët e mi të udhëtimit; ndjeja kambanat e kishave të ardhshme, fëmijët në oborrin e shkollës që luanin dhe qeshnin; një bajame e lulëzuar ishte para meje duke zgjatur dorën mund të këpusja një degë të lulëzuar. Sepse duke besuar me pasion në diçka që nuk ekziston akoma, ne e krijojmë; ajo që nuk ekziston, është pikërisht ajo që nuk kemi dëshiruar, nuk e kemi skuqur me gjakun tonë, që ajo të marrë forca, dhe të kapërcejë pragun e errët të inekzistencës.

Kur gjithçka ishte kryer, papritur ndjeva lodhjen. Nuk mund të rrija në këmbë, të haja, të flija, të lexoja. Deri në atë pikë I kisha mobilizuar të gjitha forcat e mia, shpirti mbështeste trupin dhe nuk e lejonte të binte; por meqë luftimi kishte mbaruar, mobilizimi nuk ishte më, trupi kishte ngelur pa mbrojtje dhe ishte rrëzuar. Por kisha pasur kohë që të përmbushja misionin që më ishte besuar, isha i lirë dhe kisha dhënë dorëheqjen. Dhe menjëherë ktheva kokën drejt Kretës; doja të shkelja tokën e saj, ta prekja për të rimarrë forcat.

KTHIMI I DJALIT PLANGPRISHËS

Kur një burrë, pas vitesh lufte dhe bredhjesh në dhè të huaj kthehet në vendin e tij, mbështetet mbi gurët atërorë dhe përshkon me një shikim rreth tij të gjithë pamjen e njohur që përmbledh kujtimet e fëmijërisë dhe pasionet e adoleshencës, e mbulojnë djersë të ftohta.

Kthimi në tokën atërore turbullon zemrën tonë; duket sikur vijmë nga aventura të pathëna dhe papritur, larg tokës së mërgimit, ndjejmë një grusht në zemër. Për çfarë kemi ardhur këtu, që të hamë lëmë një grusht në zemër? Shohim pas se nga vijmë dhe psherëtijmë; na kujtohet ngrohtësia, mirëqënia, qetësia kthimi si djali plangprishës në gjirin e nënës. Ky kthim gjithmonë më ka dhënë një drithërimë të fshehtë, një parandjenjë vdekjeje, sikur vija pas dhembjeve dhe shthurjeve të jetës, në tokën e nënës kaq shumë të dëshiruar. Duket sikur forca të nëndheshme, të errëta, prej të cilave nuk mund të largohesh, të kanë caktuar një mison për të përmbushur; dhe tani që je në kthim, të pret një zë i egër që ngrihet nga gjiri i tokës:

- E bëre atë që të kisha ngarkuar? M'u përgjigj!

Toka ka një nuhatje të pagabueshme për vlerat e secilit prej fëmijëve të saj dhe sa më shumë lartësohet shpirti që ajo ka krijuar, më i vështirë bëhet misioni që ajo i ngarkon, të shpëtojë veten, racën e tij ose botën. Sipas misionit të ngarkuar ashtu është gjykuar dhe shpirti juaj.

Është e natyrshme që çdo njeri duhet ta shohë këtë ngjitje, ku shpirti ka për detyrë të angazhohet, i gdhendur gjithmonë e më shumë në tokën ku ka lindur. Këto toka që ju kanë krijuar kanë një lidhje dhe një inteligjencë të fshehtë me shpirtin tuaj; ashtu si rrënjët që i dërgojnë pemës urdhërin e fshehtë për të çelur lule dhe për të bërë fryte, për të justifikuar rrënjët që ato të presin afatet kohore, ashtu dhe toka u beson misone të vështira shpirtrave që ajo ka lindur. Duket sikur toka dhe shpirti janë të përbëra nga e njëjta substan-

cë dhe luftojnë së bashku; dhe shpirti nuk është veçse pika ekstreme e fitores.

Të mos e mohosh rininë deri në plakje, të luftosh gjithë jetën për të transformuar në një pemë të ngarkuar me fryte lulëzimin e adoleshencës, ja, unë, besoj se kjo është rruga që duhet të ndjek një njeri i plotësuar.

Shpirti e di shumë mirë se ia ka dhënë fjalën tokës atërore. Nuk them atdheut, por tokës atërore; toka atërore është diçka më e thellë, më modeste, më fjalëpakë, e bërë me kocka të lashta të thërmuara.

Është ky Betimi i Fundit, i vetmi, tokësori; ku blatohet, në brendësitë tuaja akoma të gjalla, jeta juaj. Dëgjojmë zërin e rreptë të Gjykatësit të Paanshëm që ngjitet nga toka dhe dridhemi. Si t'i përgjigjemi? Kafshojmë buzët dhe mendojmë: "Ah, sikur ta ribëja sërish jetën time!" por është shumë vonë. Një shans na është dhënë njëherë e përgjithmonë.

Kujtimet e fëmijërisë që burojnë nga të gjitha anët, janë kulmi i vuajtjeve tona. Një mburojë e hollë ka rrethuar shpirtin gufues, dhe e ka paralizuar nëpër xhunga, nëpër rrudha dhe në zakone të degraduara. Ai që digjej, në flakën e rinisë, që të dominonte botën, dhe për të cilin trupi vezullues i adoleshentit ishte shumë i ngushtë, tani i fshehur në një cep të trupit të fishkur dhe të papërshkueshëm, fërgëllon. Më kot urtësitë e vjetra dhe të reja, i përsërisin që t'i nënshtrohet me durim dhe mirëkuptim ligjit të fatalitetit; Kështu, - i thonë ato, duke u përpjekur paturpësisht që ta ngushëllonin, kështu vërsulen, triumfojnë, munden dhe bien pemët, kafshët, dhe zotat.

Por një shpirt kërkues nuk pranon ngushëllime të tilla. Si të pranojë ai? Ai lindi pikërisht, për t'i shpallur luftë këtij ligji të fatalitetit.

Kthimi në tokën atërore është vendimtar. Mburoja e rehatshme dhe e pabesë plasaritet, qepeni hapet; atëherë hovin dhe vijnë e na vrasin ndërgjegjen të gjithë ata që kemi vrarë dikur. Na vret ndërgjegja se mund të ishim bërë më të mirë por nuk u bëmë dot.

Dhe kjo vuajtje bëhet akoma më e padurueshme kur toka atërore është e egër dhe e papajtueshme. Kur malet, detet dhe shpirtrat e saj, që janë mbrujtur me këto shkëmbinj dhe këtë kripë, nuk ju lënë për asnjë çast të rrini të qetë, të zbuteni e të thoni se kaq mjafton! Kjo është Kreta. Ka diçka jonjerëzore; nuk e di nëse ajo i do fëmijët e saj dhe për këtë i torturon. Di veç një gjë: ajo i shpon deri në palcë.

Një ditë e pyetën sheikun Glailan, djalin e Harasasë: - Çfarë duhet të bëjnë arabët që të mos bien nga pozita? Dhe ai u përgjigj: - Gjithçka do të shkojë aq mirë për sa kohë ata do të mbajnë shpatën në dorë, do të mbajnë çallmën mbi kokë dhe do të kalërojnë mbi kuajt e tyre! Unë thith ajrin e Kretës, shikoj kretanwt dhe nuk di nëse ekziston ndonjë popull tjetër mbi tokë që ta ketë ndjekur më me besnikëri këtë rregull arab.

Në çastin më vendimtar të jetës, i riu, zgjedh në morinë e mundësive të tij, një të vetme, identifikon me të fatin e tij dhe hyn në moshën madhore - në atë çast të jetës sime, tentuan ta shpëtonin shpirtin tim. Ato mund të shpëtonin dhe shpirtra të tjerë. Janë shumë të thjeshta, të veshura nga një mburojë fshatareske; por kush do ta thyejë këtë mburojë mund ta shijojë me tre kafshata të mëdha.

Një bari nga Anoja, fshat i vogël me gurë dhe i egër, i vendosur në brinjë të Psiloritit, dëgjonte njerëzit e fshatit të tij që i tregonin për Megalo Kastron.

Në këtë qytet - thoshin ata, - gjenden gjithë mrekullitë e botës që nga bathët me lëkurë, deri tek merluci i kripur, sardelet dhe harengat e tymosura; ka magazina të mbushura me çizme, të tjera që shesin pushkë sa të duash, biçakë, thika dhe barut. Ka magazina të tjera që çdo mëngjes nxjerrin nga furrat bukë të bardha; dhe kur bie mbrëmja ka gra që nuk të lodhin si kretanet e reja dhe kur i prek mishi i tyre është i bardhë e i shijshëm si buka e bardhë.

Bariu dëgjonte për gjithë këto mrekulli, dhe i shkonte goja lëng. Megalo Kastro shkëlqente në imagjinatën e tij si një parajsë e mbushur me merluc, pushkë dhe gra. Ai dëgjonte, dëgjonte gjersa një mesditë nuk duroi më. Shtrëngoi fort rripin, vari në shpinë çantën më të bukur të lëkurës, atë që kishte qëndisur, kapi shkopin e bariut dhe zbriti të tatëpjetën e Psiloritit. Disa orë më vonë u gjend përpara Megalo Kastros; ishte ende ditë dhe porta e fortifikuar ishte hapur. Bariu u ndal te pragu; akoma edhe një hap dhe ai gjendej në parajsë. Por përnjëherë shpirti i tij u drodh, ai donte të dinte nëse e kishte sunduar dëshira, nëse do të bënte dot atë që donte, ndaj bëri një lëvizje tërë sedër:

- Në qoftë se unë dua, hyj, në qoftë se unë nuk dua nuk hyj, - tha. Unë nuk hyj!

I ktheu shpinën Megalo Kastros dhe u nis duke vrapuar drejt malit. Në një fshat tjetër të Kretës, në Malin e Bardhë, kishte vdekur një djalë. Katër miqtë e tij më të mirë vendosën:

- Rrimë sonte pa gjumë për të lehtësuar gratë që vajtojnë?

- Rrimë, - thanë njëzëri. - Ishte më i miri i fshatit, djalë njëzet vjeç dhe vdekja e tij kishte qenë për ta një thikë në zemër.

- Hë, miq, ç'thoni? - thotë njëri prej tyre. Sot më kanë sjellë një raki shumë të mirë, që ngjall edhe të vdekurit, të mbush një shishe që ta kemi me vete?

- Nëna ime sot poqi bukë; unë dua të marr dy-tri copë bukë elbi.

- Unë kam salçiçe derri; të marr nja dy metra?

- Unë do të sjell gotat, thotë i katërti; dhe dy-tre sallatorë për t'u freskuar.

Secili shkoi të marrë atë që duhej të sillte, i futën nën xhaketat e shkurtëra dhe, kur erdhi mbrëmja, ata hynë të katër në shtëpinë e të vdekurit.

I vdekuri, mbuluar me lule, qëndronte i shtrirë në arkivol, që ishte vendosur në dhomën më të madhe të shtëpisë me këmbë drejtuar nga dera. Gratë vajtonin përreth tij.

- Shkoni të flini, ju gratë, thanë miqtë; do të rrimë ne zgjuar.

Gratë u larguan, mbyllën portat. Miqtë afruan stolat, vendosën rakinë e mezenë pranë këmbëve dhe filluan, me sytë mbushur me lot, të shikonin të vdekurin. Nuk flisnin. Kaloi një gjysmë ore, një orë. Më në fund njëri prej tyre hoqi sytë nga i vdekuri.

- Hë! Miq, si thoni; do të pijmë një gotë?

- Po si pra! Mos kemi vdekur edhe ne? Pijmë! - u përgjigjën të gjithë.

U përkulën, morën mezetë, njëri ndezi një copë letër, ngrohu salçiçet. Mbushën gotat dhe i kapën me kujdes që të mos tingëllonin.

- Zoti e faltë; më pas është radha jonë.

- Zoti e faltë;

Ata pinë një, dy, tre gota, hëngrën, boshatisën shishen; erdhën shumë në qejf.

Pastaj filluan të shohin përsëri të vdekurin. Përnjëherë njëri prej tyre brofi në këmbë:

- Hë! Miq, si thoni? - ai tregonte me cep të syrit të vdekurin - e hedhim?

- E hedhim!

Ngritën kindat e tumaneve dhe i futën në rrip që të mos i pengonin gjatë lëvizjeve, e çuan të vdekurin tek pragu, hapën derën që të konte në oborr.

- Hop! Hop! - pështynë duart, morën vrull dhe filluan ta hidhnin të vdekurin.

Edhe kjo skenë akoma, e fundit.

Dita e Pashkës po agonte. Papu Kafatos, në malet e Kretës vraponte, nga fshati në fshat dhe ngjallte Krishtin, duke nxituar sepse fshatrat ishin të shumtë dhe ai ishte i vetmi prift, i cili duhej të kryente ceremonitë e ringjalljes në secilën prej tyre përpara se të binte dita. Me mëngë përveshur, ngarkuar me veshjet e ceremonisë dhe me ungjillin e argjendtë e të rëndë në dorë, ngjitej nëpër natën e shenjtë mbi shkëmbenjtë e thepisur, vraponte duke iu marrë fryma, mbërrinte në një fshat, ringjallte Krishtin dhe lëshohej, me një frymë, drejt një tjetri. Në fshatin e fundit, ngulur midis shkëmbenjve, fshatarët të mbledhur në kishën e vogël kishin ndezur kandilët, kishin mbledhur në shtratin e përroit degë dafinash e mersinesh dhe me to kishin zbukuruar ikonat e portën; qirinjtë nuk i kishin ndezur akoma sepse prisnin t'i ndiznin kur të vinte Fjala e Madhe.

Dhe ja në qetësinë që mbretëronte, u dëgjua një zhurmë gurësh, sikur një kalë ngjiste me galop faqen e malit dhe duke ecur rrëzonte gurët.

Të gjithë u çuan menjëherë; lindja tashmë ishte përflakur, qielli qeshte. Frynte një fllad i lehtë, qentë e barinjve lehnin të gëzuar, papritur prapa një dushku të dendur, i shkalafitur, mbuluar me djersë, i dehur nga gjithë Krishtët që kishte ngjallur, u shfaq me të zeza, me flokë të shpërndarë, papu i vjetër Kafatos. Tashmë dielli dukej mbi supet e maleve; prifti u hodh, i gjendur përpara fshatarëve, hapi krahët:

Fëmijë, Krishti u ngjall! - thirri.

Fjala e afërt endaçake e ringjalljes, atij përnjëherë iu duk e varfër, e ngushtë, meskine: ajo nuk mund të përmbante më Lajmin e Madh. Ajo Fjalë ishte përhapur shumë herë nga buzët e priftit. Ligjet linguistike kishin humbur, ishin thyer nën vrullin e shpirtit të tij dhe ishin

krijuar të tjera. Dhe pikërisht atë mëngjes, për herë të parë, kretani plak kuptoi, se duke krijuar një fjalë të re, e cila mund të ngjallte me të vërtetë, i jepte Krishtit shtat.

Dëshira për Liri: nuk mund të pranohet, as për të fituar parajsën, as për të skllavëruar shpirtin e saj; lojë zotësie, të qëndrosh mbi dashurinë dhe vuajtjen, mbi vdekjen; të thyesh format e vjetra, bile edhe ato më të shenjtat, kur ato janë bërë shumë të ngushta për ju - ja tre urdhërat e mëdhenj të Kretës.

Ajo që, në këto tre anekdota, mbush shpirtin me një gëzim shumë të pastër, është se nuk janë aspak këtu filozofë dhe moralistë që flasin dhe që , duke arritur kënaqësinë e tyre pa paguar për veten e tyre, përpunojnë dhe shpallin teori të shumta dhe përvëluese. Njerëz të thjeshtë, fshatarë kretanw, ndjekin shtysën nga thellësitë e qënies së tyre, ngjitin pa iu marrë fryma, majat më të larta ku mund të arrijë njeriu - lirinë, përçmimin e vdekjes, krijimin e një ligji të ri. Këtu zbulohet në sytë tanë, origjina e njeriut, plot fisnikëri. Sepse shihet se kafsha ka katër këmbë, duke ndjekur rrugë të tjera ndryshe nga ato të inteligjencës, ka arritur të bëhet njeri. Dhe kështu marshimi ynë drejt Golgotasë fatale të mendimit ngarkohet me më shumë përgjegjësi; sepse tani dihet, duke parë kretasit, se në qoftë se ai nuk bëhet njeri, është për faj të tij dhe vetëm të tij. Kjo specie sublime, Njeriu, ekziston, ai është dukur mbi tokë, dhe nuk ka më asnjë falje për zhvlerësimin e poshtërsinë.

Vetëm në Kretë, një shpirt që nuk pranon të gënjehet dhe të gënjejë të tjerët, gjendet më shumë se në çdo vend tjetër, përballë perëndeshës Amazonë me gjoks përvëlues, që nuk pranon asnjë kënaqësi dhe nuk ulet mbi gjunjtë e askujt, as të zotit e as të njeriut, madje as të Përgjegjësisë.

Gjatë shumë ditëve unë shëtita peizazhet e vjetra të dashura ku kishte rrjedhur rinia ime. Shëtita në breg të detit: frynte i njëjti fllad i freskët kur dita perëndonte, si ai që frynte në flokët e mi, kur ata ishin akoma të zinj, dhe kundërmonte e njëjta erë jasemini, borziloku e dorëzonje si atëherë kur unë kaloja në mbrëmje, nëpër rrugicat e ngushta e portat ishin hapur, ndërsa vajzat e shtëpive ujisnin vazot nëpër oborre.

Rinia e ajrit, e parfumit, e detit, është e pavdekshme; vetëm shtëpitë dhe miqtë e mi të vjetër, ishin plakur. Shumë prej tyre nuk i njoha,

e shumë nuk më njohën, më shikonin për një çast, u kujtoja dikë, po cilin pra? Ata nuk mundoheshin të kujtonin, vazhdonin rrugën. Vetëm njëri duke më parë, ngriti krahët, i habitur dhe ndaloi.

- Ti je, miku im i vjetër? - thirri, ti je? Si je bërë kështu?

I shëndoshë, me një cigarishte bosh në gojë për t'i marrë erë, duke gënjyer vehten se mos linte duhanin, miku im i afërt, themeluesi i tretë i Shoqërisë Miqësore, më shihte, më prekte, me merrte në krahë me një pamje mëshiruese.

- Sa i dobët je, sa je nxirë, sa të janë çarë buzët, balli të paska ngelur pa flokë, vetullat të janë bërë si hala pishe dhe sytë të lëshojnë flakë. Përse erdhe? Shko konsumohu akoma! Akoma do të bredhësh nëpër botë? Deri kur?

- Sa të jem gjallë. Kur nuk do të kem më mundësi të lëviz do të rri atje, i kënaqur, i vdekur, me një cigarishte të shuar në gojë duke u tallur me të gjallët.

- Po unë jam plakur? Unë i vdekur jam? - tha miku im me një të qeshur fërshëllyese, duke u tallur.

Unë nuk iu përgjigja. U pushtova nga trishtimi dhe indinjata për mikun tim të vjetër. Sa shumë e doja dikur! Kur, në lulëzimin krenar por edhe hyjnor të rinisë, ne bridhnim deri në agim nëpër rrugët e Megalo Kastros, me bindje dhe vrull shkatërronim botën për ta ndërtuar përsëri! Muret e qytetit tonë të vogël ishin të ngushta për ne, po ashtu edhe idetë që na kishin mësuar mësonjësit tanë. Nuk kënaqeshim me gëzimet dhe ambicjet e zakonshme të njerëzve. As ne nuk e dinim. Vetëm hapnim krahët sikur na zihej fryma.

Ndërsa tani miku im i kishte mbyllur krahët, ai merrte frymë pa mundim dhe në qoftë se i kishte ngelur akoma një ide ndëshkimi, përpiqej ta mbyste duke thithur cigarishten pa duhan.

- Çfarë bën atje, në Rusi? - më pyeti babai atë mbrëmje që u ktheva. - Ai më shikonte pjerrtas, gati i nxehur. Kishte aq vite që priste, që unë të hapja një zyrë, të shëtisja nëpër fshatra, të merrja pjesë nëpër pagëzime e të isha kumbarë, të shkoja krushk nëpër dasma, që të bëja shumë miq, pastaj të merrja pjesë në zgjedhje e të bëhesha deputet. Por ja! Ai më shikonte të vrapoja nëpër botë ndërkohë kishte dëgjuar se unë shkruaja libra.

- Por çfarë librash? - më kishte pyetur herën e fundit kur u takuam; përralla ngjyrë blu, këngë të gëzuara, këngë vajtimi? Nuk ke turp?

Vetëm eunukët dhe murgjët shkruajnë; qëndro në vendin tënd, ti je burrë dhe duhet të bësh një punë burri.

Ndërsa tani më shikonte me bisht të syrit, buzët gati i fërshëllyen:

- Jo rastësisht ti do të jesh bërë bolshevik? Nuk ke as Zot, as atdhe, as nder, shko pra, - qenër, të gjithë duheni varur!

I them vetes: ja momenti kur duhet t'i shpjegoj atij atë që ndodh në Rusi dhe se çfarë botë e re ndërtohet atje. Fillova pra t'i tregoj me fjalë shumë të thjeshta se atje nuk kishte as të pasur e as të varfër, se të gjithë punonin e të gjithë hanin, se s'kishte më zotëri e çirak, por vetëm zotër: Një njerëzim i ri, një moral më i lartë, një nder më i ndershëm, një familje e transformuar. Rusia ecte përpara dhe tregonte rrugën, dhe gjithë bota duhej ta ndiqte që mbi botë të vendosej drejtësia dhe lumturia.

Unë isha hedhur në sulm, predikoja. Babai më dëgjonte, heshtte, përdridhte cigaren, e prishte, e përdridhte përsëri dhe nuk vendoste ta ndizte. "Lavdi Zotit, mendoja, ai e kuptoi."

Papritur i nevrikosur, shtriu krahun, unë pushova. Ai tundi kokën:

- Kjo që thua ti është e mirë dhe e bukur, por a mund të ndodh, si mendon ti?

Domethënë: Fol gjithmonë, kjo nuk ka rëndësi; ato janë vetëm fjalë, marrëzi, kjo nuk i bën keq askujt; por kujdes, fatkeq, kujdes ti shndërrosh në veprim.

Ah! Në qoftë se unë do të mundja t'i shndërroja ato fjalë në veprime, veçse kisha frikë se nuk do të arrija; forca e egër e racës sime tek unë ishte raskapitur, ânija e gjyshit tim pirat ishte mbytur, veprimi nuk ishte më shumë se fjalë, gjaku nuk ishte më shumë se bojë, dhe në vend që të mbaja një shigjetë e të luftoja, mbaja një penë dhe shkruaja. Shoqërimi me njerëz më bezdiste, zvogëlonte forcën e dashurinë time; ndodhte, kur isha vetëm dhe mendoja për fatin e njerëzve që zemra ime të mbushej me dhembshuri dhe shpresë.

Megjithatë, që prej kthimit tim nga ajo furrë kozmogonike siç ishte Rusia sovjetike, unë isha bërë më i guximshëm. A mund të triumfojë njeriu, i thosha vehtes, mbi të këqiat dhe mungesat e tij? Ai mundet. Është turp të pranosh në mënyrë pasive atë që ka dhënë natyra: Unë do të rebelohem. Pikërisht në atë kohë kur unë kisha nevojë, u gjend një xhaxha i pasur, që më dha një shumë që unë të pushoja, siç më tha, së vrapuari nëpër botë si kaçak dhe të filloja

punë: të hapja një kabinet avokatie, të bëhesha deputet, një ditë ndoshta ministër për të ngritur lart emrin e familjes sime. Unë isha letrari i parë i racës sime, i pari që kishte hapur një libër dhe që kishte lexuar: unë kam një detyrim.

E rrotulloja dhe rirrotulloja çështjen në kokë; jo, akoma nuk mund të mbyllesha në një kabinet avokatie; unë do të hyja në jetën aktive nëpërmjet një rruge tjetër. Nëpërmjet cilës? Këtë nuk e dija. Në shpirt mblidhja punëtorë, punonim të gjithë së bashku në të njëjtën punë, hanim së bashku të njëjtin ushqim, vishnim rroba të njëjta, nuk kishte një pronar dhe të tjerët punëtorë, nuk ishin punëtorë por bashkëpunëtor, që gëzonin të njëjtat të drejta si unë.

Unë sapo kisha ardhur nga Rusia dhe doja ta bëja këtë tentativë të vogël për të dalë nga gjendja ime e trullosur; të punoja me njerëzit.

Atëherë - më duket se Fati ishte me mua - Unë u njoha me një punëtor të vjetër, me minatorin Zorba.

NJOHJA IME ME ALEKSIS ZORBËN

Gjatë gjithë jetës sime, mirëbërësit e mi më të mëdhenj kanë qenë udhëtimet dhe ëndrrat; nga njerëzit, të gjallë apo të vdekur, kanë qenë të paktë, ata që më kanë ndihmuar në luftën time. Në qoftë se unë do të veçoja njerëzit që kanë lënë gjurmë në shpirtin tim, do të numëroja ndoshta, Homerin, Budën, Niçen, Bergsonin dhe Zorbën. I pari ka qenë për mua syri i qetë, plot shkëlqim si disku i diellit, që ndriçon universin me shpërthimin e tij shpëtimtar; Buda, syri i paqartë dhe i paarritshëm ku bota çlirohet; Bergsoni më ka çliruar nga disa pyetje filozofike ngelur pa përgjigje që më torturonin në rininë time të parë; Niçe më ka pasuruar me brenga të reja dhe më ka mësuar të dua dhe të mos trembem nga vdekja.

Në qoftë se gjatë ekzistencës sime, do të duhej të zgjidhja një udhëheqje shpirtërore, një Guru si thonë hindutë, një të moshuar, si thonë murgjit e Malit Athos, sigurisht do të zgjidhja Zorbën. Sepse ai zotëronte atë për të cilën ka nevojë një shkresaxhi që të shpëtojë: shikimin primitiv që kap nga lart si një shigjetë, gjahun e tij; dëlirësinë krijuese, që çdo mëngjes të ri, e shikon universin si për herë të parë dhe u jep virgjëri elementëve të përjetshëm e të përditshëm - erës, detit, zjarrit, femrës, bukës; një dorë e sigurt, zemër e freskët, guxim për të kënaqur shpirtin e tij dhe në fund e qeshura shpërthyese dhe e egër, rrjedhur nga një burim i thellë, më i thellë se vetë trupi i njeriut, që vërshon shpëtimtar në çastet kritike, nga gjoksi i plakur i Zorbës: kur vërshojnë, ato mund të thyejnë, dhe në fakt thyenin, gjithë muret - morale, fetare, patriotike - që njeriu i keq e frikacak, ka ngritur rreth vetes gjatë gjithë jetës së tij për të ecur kuturu, në shurdhëri. Kur mendoj ushqimin që librat dhe mësuesit i dhanë shpirtit tim për aq vjet, dhe për palcën e luanit që Zorba më dha për disa muaj, më mbyt hidhërimi dhe mërzia. Unë nuk mund të mos ekzaltohem, kur kujtoj qëllimet që mbartte, vallet që vallëzonte, shenjtëritë që tregonte, mbi një breg të Kretës ku ne jetuam gjashtë

muaj me një grup punëtorësh, duke gërmuar tokën me shpresë se mos gjenim pak linjit. Ne e dinim mirë se ai qëllim material ishte një pretekst për t'u fshehur nga sytë e botës. Ne nxitonim që punëtorët të mbaronin shpejt me qëllim që të vendoseshim të dy në plazh, të hanim bukën e shijshme, të pinim verën e Kretës dhe të nisnim bisedimin.

Unë flisja rrallë: Çfarë mund t'i thotë një intelektual një "Gogoli"? E dëgjoja tek fliste për fshatin e tij mbi Olimp, për borën, për ujqërit, për komitët, për shën Sofinë, për linjitin, për femrat, për Zotin, për atdheun e vdekjen - dhe, kur i zihej fryma ose kur kuadri i fjalëve bëhej i ngushtë për të, ngrihej me një kërcim dhe fillonte të vallëzonte mbi zajet e bregut. I fortë, i drejtë, eshtak me kokën lart pak prapa, me sytë e vegjël të rrumbullaktë si të zogut, ai vallëzonte, ulërinte, godiste gurët me këmbën e madhe, dhe spërkaste fytyrën me ujin e kripur të detit.

Në qoftë se do të dëgjoja zërin e tij, ose më mirë klithmën e tij, jeta ime do të kishte patur një vlerë, do të jetoja me gjakun tim, me mishin tim, me kockat e mia, atë që unë tashmë e ëndërroj si mund të ëndërrosh tymin e hashashit dhe e plotësoj me letër e bojë. Por nuk guxova. Unë shihja Zorbën që vallëzonte ditë e natë duke hingëllirë, që më bënte thirrje të dilja edhe unë jashtë guackës së rehatshme të kujdesit dhe të rregullit, dhe të nisesha me të për udhëtime të mëdha pa u kthyer, ndërsa unë rrija i palëvizur, i ngrirë.

Në jetën time më ka ardhur turp shpesh, sepse konstatoja se shpirti nuk guxonte të plotësonte atë që dalldia më e lartë - vetë substanca e jetës - më thërriste të plotësoja; por asnjëherë nuk kisha patur më shumë turp për shpirtin tim se sa përpara Zorbës.

Ndërrmarja e linjitit shkoi në djall. Zorba dhe unë kishim bërë gjithçka mund të bënim, nëpërmjet të qeshurave, lojës dhe diskutimeve, për ta çuar në shkatërrim. Ne nuk gërmonim për të gjetur linjit; ky ishte një pretekst për njerëzit e thjeshtë e të arsyeshëm,"për të mos na zënë me domate" thoshte Zorba duke shpërthyer në të qeshura. - Por ne, padron (ai më quante padron dhe qeshte me të madhe), kemi të tjera qëllime, qëllime të larta. - Çfarë qëllime, Zorba? - e pyesja. Ne gërmojmë për të parë çfarë demonësh kemi fshehur brenda vehtes.

Nuk vonuam shumë për të ngrënë gjithçka më kishte dhënë xha-

xhai im fatkeq, për të hapur një kabinet; i ndoqëm punëtorët, poqëm një qëngj, mbushëm një kade me verë, u vendosëm mbi bregun ku gjendej miniera dhe filluam të hamë e të pimë. Nuk mbaj mend të kem qenë ndonjëherë me humor më të mirë: Ndërrmarja vdiq, thërrisnim, Zoti e ndjeftë shpirtin e saj, jetë të gjatë ne të tjerëve, në djall vaftë linjiti!

Të nesërmen në mëngjes u ndamë; unë mora përsëri rrugën e bojës dhe të letrave, duke marrë me vehte edhe plagën e pashëruesh-me të shigjetës së përgjakshme që, duke mos ditur si ta quajmë, ne i themi shpirt. Ai u drejtua nga veriu, për të mbërritur në Serbi, mbi një mal pranë Shkupit, ku kishte zbuluar një damar të pasur qymyri. Bleu pajisjet, mori punëtorë dhe filloi të hapë galeri. Theu shkëmbinjtë me dinamit, hapi rrugë, çoi ujë, ndërtoi një shtëpi, u martua me një vejushë të re, Ljuba dhe prej saj pati një fëmijë.

Një ditë mora një telegram: "Zbulo gurë të bukur me ngjyrë jeshile, prani e domosdoshme - Zorba." Atëherë dëgjoheshin nga larg gjëmimet e vetëtimave të stuhisë që tashmë kishte rënë mbi tokë, luftës së dytë botërore. Miliona njerëz dridheshin duke parë që po vinte uria, masakra, çmenduria. Ishin ngjallur gjithë demonët e njeriut dhe kishin etje për gjak.

Pikërisht gjatë atyre ditëve plot helm unë mora telegramin nga Zorba. U rrëmbeva që në fillim: Bota po përmbyset, jeta dhe nderi i njerëzve është në rrezik, dhe ja një telegram që ju thotë të niseni, të bëni aq rrugë që të shkoni për të parë një gur të bukur me ngjyrë të gjelbër! Në djall shkoftë bukuria, i thosha vehtes, sepse ajo nuk ka zemër dhe nuk shqetësohet për vuajtjet e njerëzve!

Por përnjëherë u tremba; inati më ishte shuar dhe unë ndjeja i tmerruar se asaj thirrjeje jonjerëzore të Zorbës i përgjigjej një thirrje tjetër jonjerëzore që qëndronte brenda meje. Një zog i egër përplaste krahët në fund të qënies sime, gati për të fluturuar. Megjithatë nuk u nisa, edhe njëherë tjetër unë nuk guxova. Nuk u nisa, nuk dëgjova thirrjen hyjnore, klithmën e kafshës së egër që dëgjoja brenda meje, nuk e kreva atë veprim fisnik e të pakuptimtë. Unë dëgjova zërin njerëzor e të akullt të arsyes, mora penën e i shkrova Zorbës një letër ku i shpjegoja...

Ai m'u përgjigj: "Ti je, më fal, padron, një shkresaxhi. Ti mund të shihje fatkeqi im i shkretë, vetëm një herë në jetë një gur të gjel-

bër të bukur dhe nuk e pe.

Vitet kalonin, vite të gjatë e të tmerrshëm, kohët ishin trullosur, pështjelluar, kufijtë gjeografikë kishin filluar të rrotulloheshin, hapeshin, mblidheshin, shtetet zhvendoseshin, hapeshin e mblidheshin si fisarmonika. Unë e Zorba, në këtë trazirë, kishim humbur njeritjetrin e nuk shiheshim; herë pas here merrja vetëm ndonjë letër të shkurtër prej tij dërguar nga Serbia: "Unë jetoj, bën një i ftohtë i tmerrshëm, prandaj m'u desh të martohem. Ktheje letrën nga ana tjetër për të parë turirin e saj të vogël; një bukuroshe e mirë. Barku i saj është pak i fryrë, sepse ajo po më përgatit një Zorba të vogël. Quhet Ljuba. Palloja e madhe që mbaj, me lëkurë dhelpre në qafë, ma ka dhënë gruaja ime; më ka sjellë gjithashtu një dosë me shtatë gica të vegjël, rracë tuafësh. Të përqafoj miqësisht, Aleksis Zorba, ish i ve."

Njëherë tjetër më dërgoi nga Serbia një qylaf malazes të qëndisur me një zile argjendi në xhufkë. "Vendose, më shkruante, vendose, padron, kur shkruan dokrrat e tua; unë e mbaj kur punoj. Njerëzit qeshin. - Zorba, ti je i marrë, më thonë, përse e mban atë zile? Unë qesh dhe nuk u përgjigjem. Vetëm ne, padron, e dimë përse i mbajmë."

Megjithatë, unë u zhyta përsëri në bojë e letër; Zorbën e kisha njohur shumë vonë, për mua nuk kishte shpëtim, isha bërë një shkresaxhi i pandreqshëm.

Fillova të shkruaj. Por gjithçka që shkruaja, poema, pjesë teatrale, romane, merrnin gjithmonë, pa e kuptuar as vetë një strukturë dramatike. Çdo krijim ishte plot forca që përplaseshin me njëra-tjetrën, të shqetësuara.; gjithë kjo nuk ishte veçse vazhdim i një ekuilibri të humbur, të mërzitjes dhe revoltës. Gjithçka ishte e mbushur me shenja paralajmëruese, me vetëtimat e stuhisë që afrohej. Unë përpiqesha shumë t'i jepja asaj që shkruaja një formë të ekuilibruar, ndërsa veprat merrnin një ritëm të shpejtë, dramatik; zëri i qetë që dëshiroja të dëgjoja bëhej megjithë përpjekjen time, një klithmë. Ja, përse, kur përfundoja një vepër, unë nuk ndjehesha i lehtësuar dhe i dëshpëruar filloja të shkruaja një tjetër. Shpresoja vazhdimisht të pajtoja forcat e errëta me ato të shndritshmet, që atëherë ishin në luftë dhe të ndërtoja harmoninë e ardhshme.

Forma dramatike i jepte krijimit mundësinë të shprehte, duke e mishëruar në heronjtë antagonsitë të veprës, shpërthimin e forcave

të kohëve tona dhe të shpirtit tonë; unë përpiqesha të jetoja, sa më besnikërisht e intensivisht që të mundja, epokën e rëndësishme ku më kishte rënë shorti të lindja.

Kinezët kanë një mallkim të çuditshëm: "Mallkuar qofsh e lindsh në një epokë të rëndësishme." Ne kemi lindur në një epokë të rëndësishme, plot përpjekje për ndryshim, për aventura e për konflikte. Këto konflikte nuk qëndrojnë vetëm , si dikur, midis virtyteve. Virtytet e vjetra filluan të humbasin forcën, nuk mund t'ju përgjigjeshin më kërkesave fetare, morale, shpirtërore, sociale, të shpirtit bashkëkohor. Dukej se shpirti i njeriut ishte rritur dhe nuk mund të qëndronte më në kallëpin e mëparshëm. Në trupin e epokës sonë, në trupin e çdo njeriu të përshtatur kësaj epoke, ka shpërthyer, me vetëdije ose jo, një luftë civile e pamëshirshme, ndërmjet miteve antike, dikur aq të fuqishme, që kanë humbur forcën por që luftojnë të dëshpëruar për t'i dhënë akoma ritëm jetës sonë, dhe një mit të ri që tenton, në një përpjekje akoma të ngathët dhe të bashkërenditur keq, për të sunduar shpirtrat tanë.

Prandaj, çdo njeri i gjallë sot është i pikëlluar për fatin dramatik të kohës sonë.

Dhe më shumë se gjithë të tjerët, krijuesi. Ekzistojnë buzë dhe gishta të ndjeshëm që, kur afrohet stuhia, ndiejnë t'u kalojnë mornica sikur i shpojnë gjilpëra; të tilla janë gishtat dhe buzët e krijuesit. Kur ai flet me aq siguri për shtrëngatën që po zbret mbi ne, nuk është imagjinata që flet, janë buzët dhe gishtat e tij, që provojnë tashmë vetëtimat e para të stuhisë. Duhet që prej saj ne të marrim heroikisht pjesën tonë: gëzimin e dobët e të pa shqetësuar, që quhet lumturi, gjithë kjo i përket epokave të tjera, të kaluara ose të ardhme, por jo tonës. Ne kemi hyrë në konstelacionin e brengës.

Megjithatë, pa e kuptuar qartë, përpiqesha, që duke e shprehur këtë brengë, ta kapërceja e të gjeja ose të krijoja - një shpëtim. Në ato që shkruaja shpesh i merrja motivet nga kohët e shkuara e nga legjendat e vjetra, por substanca ishte aktuale, e gjallë, e shkaktuar nga problemet e brengat e kohës. Por më shumë se brengat ajo që më shqetësonte e më magjepste, së cilës përpiqesha t'i fiksoja fytyrën, ishin shpresat e mëdha akoma të turbullta, që kishin ndërruar vendin - ato që na bëjnë të qëndrojmë akoma e të shohim përtej turbullimit, të ardhmen dhe fatin e njeriut me besim.

Meraku që më turbullonte nuk ishte aq shumë meraku i njeriut aktual, që dekompozohet, por i njeriut të ardhshëm, i cili është duke u krijuar dhe do të lindë. E ëndërroja: sikur krijuesi sot të shprehte rigorozisht parandjenjat më të thella që fsheh në vetvete, e të ndihmojë të lindë sa më shpejt dhe më perfekt njeriun e të ardhmes.

E merrja me mend gjithmonë e më qartë përgjegjësinë e krijuesit. Realitet i gatshëm e i përkryer pavarësisht nga ne, nuk ekziston, mendoja; ai krijohet në bashkëpunim me njeriun, ai është ekspozuesi i vlerave të njeriut. Nëse ne hapim një shtrat lumi, duke shkruar, duke punuar, realiteti do të rrjedhë; e nëse nuk ndërhyjmë, ai nuk do të dalë prej andej. Ne mbajmë, mbi të gjithë, jo thjesht përgjegjësinë, por një përgjegjësi të madhe.

Në periudha të tjera, të ekuilibruara, zanati i shkrimtarit është një lojë; sot është një detyrë e rëndë, qëllimi i tij nuk është të argëtojë shpirtin me gjepura e ta shtyjë të harrojë. Qëllimi është të shpallë mobilizimin e të gjithë forcave iluministe që mbijetojnë akoma në periudhën tonë të tranzicionit e të nxisë njeriun të kapërcejë të keqen, sa më shumë të mundet.

Ka tre lloj shkrimtarësh:

- Ata që shohin në të shkuarën - romantizëm, dëfrim, bukuri.
- Ata që shohin rreth tyre - kalbësinë, botën e shthurur të ditëve të sotme.
- Ata që shohin së largu të ardhmen, e që luftojnë për të krijuar kallëpin ku do të rrjedhë realiteti në të ardhmen.

Në tragjeditë antike greke, heronjtë nuk ishin veçse gjymtyrë të shpërndara të Dionisit që përballeshin me njëri-tjetrin. Ata ndesheshin me njëri-tjetrin, sepse ishin elementë të ndarë, ku secili nuk paraqiste veçse një fragment të hyjnores, që nuk ishin një zot i tërë. Zoti i tërë, Dionisi, ishte në këmbë, i padukshëm, në qendër të tragjedisë dhe rregullonte lindjen, zhvillimin, pastrimin e mitit. Për spektatorët e mësuar, gjymtyrët e shpërndara të Zotit që luftojnë mes tyre janë mbledhur e bashkuar tashmë në mënyrë mistike tek ai, kanë krijuar trupin e paprekur të Zotit: ato janë shndërruar në

harmoni. Gjithashtu, gjithmonë kam menduar se mes gjymtyrëve të shpërndara të heronjve që hasen në tragjeditë moderne duhet të ngremë zërin, të paprekur, përtej luftës e urrejtjes, harmoninë e ardhshme. Të arrish këtë, është e vështirë, mbase e pamundur akoma. Ne jetojmë në një kohë ku bota shkatërrohet e rindërtohet, ku përpjekjet individuale, ato më bujaret, shpesh janë dënuar të dështojnë; këto dështime janë pjellore jo për ne, por për ata që do të na ndjekin. Ato hapin rrugën e ndihmojnë të ardhmen të gjejë rrugën e saj. Unë shkruaja i ngazëllyer në ekstazë, në qetësinë e shtëpisë atërore, duke mbajtur të pranishme në shpirt këtë përgjegjësi të tmerrshme. Po vërtet, përpara veprimit, në fillim ishte Folja, djali i vetëm i Zotit. Folja, fara që krijon botën e dukshme e të padukshme.

Pak nga pak, me gëzim, unë zhytesha në rrëmujë; hije të mëdha shtypeshin rreth minierës së zemrës sime e kërkonin të pinin gjakun e ngrohtë që do t'i bënte të rilindnin. Julian Apostulli, Niqifor Fokas, Kostandin Paleologu, Prometeu. Shpirtra të mëdhenj të shqetësuar që kanë vuajtur shumë e u kanë rezistuar me guxim zotërve të fatit. Përpiqesha t'i shkulja nga ferret për të dëshmuar në sytë e njerëzve të gjallë vuajtjen, luftën e tyre, vuajtjet dhe luftën e njerëzve. Unë vetë, doja të merrja guximin. E di që kjo që shkruaj nuk do të jetë kurrë pjesë e një arti për t'u konsumuar, sepse qëllimi im është të përpiqem të tejkaloj kufijtë e artit - e kështu transformohet sbstanca e bukurisë, harmonia.

Sa më shumë shkruaja, aq më shumë ndjeja se nuk përpiqesha të krijoja bukurinë por shëlbimin. Unë nuk isha shkrimtar i madh e i vërtetë, që gjente kënaqësinë në zbukurimin e një fjalie, në kërkimin e një rime të pasur: unë isha një burrë që vuante, që luftonte e kërkonte lirinë. Doja të çlirohesha nga errësirat që kisha brenda vetes për t'u ndriçuar, të çlirohesha nga stërgjyshërit e mi të tmerrshëm që ulërinin duke i transformuar në qënie njerëzore. Për këtë arsye unë evokoja shpirtrat e mëdhenj, që kishin triumfuar mbi vështirësitë dhe provat më të vështira me guxim. Sepse e dija, e shihja: e njëjta luftë e përjetshme që shpërthente para syve të mi kur isha fëmijë, shpërthente përsëri pa ndërprerje brenda meje, ashtu si në botën përreth, e kjo luftë ishte tema e pashtershme e jetës sime.

Për këtë arsye dy luftëtarë kanë qenë gjithmonë të vetmit protagonistë të të gjithë veprës sime dhe, edhe nëse shkruaja, e bëja sepse

nuk mundja t'i ndihmoja në luftën e tyre veç se me shkrimet e mia.

Tek unë luftonin papushim Kreta dhe Turqia, E Mira dhe E Keqja, Drita dhe Errësira, dhe duke shkruar, në fillim, qëllimi im ishte i pandërgjegjshëm, më pas i ndërgjegjshëm, të ndihmoja aq sa të mundja Kretën, të Mirën, Dritën, që ato të triumfonin. Kur shkruaja, qëllimi im nuk ishte bukuria, por shpëtimi. Fati më lindi në një epokë ku kjo luftë është kaq e fuqishme dhe nevoja për ndihmë kaq e domosdoshme sa unë shumë shpejt arrita të shoh se lufta ime si individ identifikohej me luftën e madhe të botës së sotme: të dy luftojmë paralelisht për t'u çliruar: Unë nga stërgjyshërit e mi të zymtë, ai nga bota e vjetër, e ndyrë, të dy nga errësirat.

Ishte shpallur Lufta e Dytë Botërore, bota ishte në çmenduri të plotë, shihja sheshit se çdo epokë ka demonin e saj; ai udhëheq e jo ne, por demoni i kohës sonë është i dëshiruar për gjak. Gjithmonë kështu ndodh, kur duhet të zhduket demoni, bota prishet. Ngjan sikur një inteligjencë jonjerëzore, mbinjerëzore, ndihmon shpirtin të çlirohet e të zgjohet nga njerëzit e krimbur; e kur e sheh se bota i krijon pengesa, ajo dërgon demonin gjakatar të shkatërrimit për të ndërtuar e hapur rrugën, gjithmonë të gjakosur, ku do të kalojë shpirti.

Shihja atëherë rreth meje tek përmbysej bota pa pushim. Ne të gjithë e shohim të përmbyset, shpirtrat më të padjallëzuar tentojnë të rezistojnë, por demoni shfryn e ju shkul krahët. Në çastin e shpalljes së luftës, unë isha kthyer në malet e Kretës; e dija që ishte i vetmi vend ku mund të gjeja, jo qetësinë, as ngushëllimin, por krenarinë për të cilën njeriu ka nevojë në çastet e vështira për të mos rënë. "Shihe, nëse mundesh, frikën e padjallëzuar, në sy, frika do të ketë frikë e do të largohet". Kisha dëgjuar të thotë një ditë një luftëtar i vjetër ulur te kreu i shkallëve të kishës një të diel pas meshës, duke dashur që t'u ngulë në mendje të rinjve, veprimet e guximit. Tashmë kisha marrë shkopin, një çantë mbi kurriz, e kisha marrë malet. Ishte koha kur gjermanët sulmuan Norvegjinë e përpiqeshin ta skllavëronin.

Një Pasdite, teksa kaloja në këmbë të Psiloritit dëgjova sipër meje, shumë lart, një zë të fuqishëm:

- Hej, ti, aty poshtë, prit pak! Prit, dua të të pyes. Ngrita sytë dhe pashë një burrë që dilte pas një shkëmbi e nisi të nxitonte drejt meje. Ai zbriste me hapa të mëdhenj nga shkëmbi në shkëmb, gurët rrokulliseshin nën këmbët e tij, dëgjohej një gjëmim; gjithë mali dukej sikur nxitonte me të. Unë pashë qartë se ishte një bari i vjetër me përmasa të mëdha. Ndalova ta prisja. Përse mund të më dojë, mendoja, pse kaq pasion? Ai u afrua, ndaloi mbi një shkëmb, gjoksi i tij leshtor, i zbuluar, nxirrte avull.

- Hë, shok, më tha duke gulçuar, ç'ndodhi me Norvegjinë?

Kishte dëgjuar të thuhej se një vend rrezikonte të binte në skllavëri, megjithëse ai nuk e dinte mirë se ç'ishte në të vërtetë Norvegjia, ku gjendej ajo, as çfarë njerëzish jetonin atje; por ai kuptonte qartë një gjë: se liria ishte në rrezik.

- Çdo gjë shkon mirë me të, gjysh - iu përgjigja, - mos e prish gjakun; çdo gjë është mirë.

- Qoftë lëvduar Zoti, - buçiti bariu plak duke bërë kryqin.

- Do një cigare? - S'kam nevojë për asgjë. Më mjafton që Norvegjia shkon mirë. Duke thënë këto fjalë ai lëvizi shkopin dhe nisi të ngjisë të përpjetën për të rigjetur kopenë e tij.

Është e vërtetë, mendoja, ajri i Greqisë është i shenjtë, e sigurisht atje ka lindur liria. Nuk e dija nëse ndonjë fshatar tjetër ose bari në botë mund të jetonte me aq ankth e aq ineteres luftën e një vendi të largët e të panjohur që lufton për lirinë e tij. Lufta e Norvegjisë ishte shndërruar në luftën e këtij bariu grek; ai kishte ndjesinë se liria ishte vajza e tij. Kështu e kisha vendosur edhe unë detyrën time në luftë, prandaj shkruaja mes qetësisë së shtëpisë prindërore, duke u përpjekur të marr pjesë edhe unë gjithashtu në luftën e madhe. Nganjëherë braktisja Bojën e zezë dhe letrat e vihesha në rrugën që, mes vreshtave e ullinjve të shpinte në Knosos. Kur pashë për herë të parë të dilte si pranverë, nga toka e Kretës, këtë mrekulli të papritur, shkallët prej guri, kolonat, librat, afresket, më pushtoi një gëzim dhe trishtim i patreguar për këtë botë të mrekullueshme që ishte zhdukur, për fatin e çdo trimërie njerëzore, që është vetëm sa të shohë dritën, hapësirën e një shkreptime, e për t'u zhytur më pas përjetësisht në kaos.

Sa më shumë rindërtohej e ngrihej përsëri nën diellin kretas, pallati mbretëror mbi muret gjysmë të shkatërruar, merrnin jetë, garat e

demave, femrat me gjokse të mëdhenj e të zbuluar, me buzë të lyera e gërsheta të derdhura si ujëvarë, Gjyqi i Fundit, shpalosej para meje, unë shikoja të dilnin nga toka e stërgjyshërve antikë të panjohur, memecë, të qeshur, plot dinakëri, gratë e tyre të veshura me funde ku ishin vendosur yjet e qiellit e të detit dhe lulet e tokës. Në duart e tyre, vallëzonin gjarpërinjtë helmues të Zotit.

Por atje, kur mora rrugën e gjelbëruar e arrita mbi kodrën e shenjtë, Mendimi i Fundit, ndërsa shëtisja prej orësh mes mrekullive të shkatërruara, midis të gjithave, më tronditi një pikturë; më dukej se e shihja për herë të parë. Ajo patjetër përputhej me shqetësimet dhe shpresat e asaj kohe të shpirtit tim, prandaj pikërisht për këtë arsye atë ditë, atje kuptova për herë të parë kuptimin e saj të fshehur. Një tufë peshqish notonin e luanin në det, me bishtin e ngritur, të lumtur; papritur mes tyre një peshk duke fluturuar kishte hapur krahët e tij të vegjël, kishte marrë vrull dhe kishte dalë jashtë ujit, për të thithur ajër. Ai nuk mund të qëndronte akoma në kushtet e një peshku skllav, të jetonte gjithë jetën e tij në ujë, por kishte dëshiruar me pasion të kapërcente fatin e tij, të merrte ajër të pastër, të kthehej në zog. Hapësira e një shkëndije, vetëm, aq sa mund të mbajë, por kjo mjafton. Kjo shkëndijë ishte përjetësia. Kjo është përjetësia.

Shikoja atë peshk duke fluturuar, me emocion të thellë, me dhembshuri, sikur të shihja shpirtin tim të vizatuar atje, mbi murin e pallatit, që prej mijëra vjetësh.

- Ja peshku i shenjtë i Kretës, - mërmërita, - që u vërsul për të kaluar të pashmangshmen e të thithë lirinë. A nuk ishte kjo që dëshironte gjithashtu Krishti IXOYE: të kalonte fatin e njeriut e të arrinte Zotin, pra lumturinë absolute? Nuk është kjo që dëshiron me gjithë shpirt ai që lufton për të shpërthyer kufijtë e tij? Çfarë mirësie, mendoja, sikur për herë të parë, të jetë shfaqur në Kretë, ky simbol i shpirtit, që lufton e vdes për lirinë!

Ky peshk fluturues është shpirti i njeriut të pamposhtur që lufton.

E shihja peshkun fluturues të guxonte të provonte kërcimin e vdekjes jashtë ujit, shihja burrin, gruan, me trupat e tyre të vegjël, të gëzuar, të shkathët, të luanin me demin mbi fushën e shtruar me gurë, shihja luanin të flinte, i qetë mes zambakëve e përpiqesha të zbuloja kuptimin e fshehur të tyre: nga vijnë gjithë kjo burrëri e gji-

thë ky gëzim, çfarë lutje drejtojnë dhe kujt Zoti, krahët e lakuriqtë dhe triumfues të gruas ku rrotullohen gjarpërinj të zinj?

Kjo etje e pashtershme për jetë, kjo qeshje e guximshme, heroike, përballë rrezikut e vdekjes, më risjellin në mendje aktet e trimërisë njerëzore të stërgjyshërve të mi e takimet e dëshiruara prej kohësh me Vdekjen; dukej sikur demi e njeriu, shpirti dhe Vdekja ishin bashkuar e luanin një orë ose dy, aq sa zgjaste drita e diellit, të dy të zhveshur, të lyer të dy me vaj të parfumuar, si atletët.

"Këtu, mendoja i tronditur, këtu në çastin e tmerrshëm kur kretani përballet me humnerën, fshihet misteri i Kretës. Ja çfarë duhet të zbuloj."

Krishti, Buda, Lenini, ishin zbehur tek unë, toka e Kretës më kishte rrëmbyer, e nuk e ktheja më kokën pas, por ngrija sytë e shihja me tmerr e pasion një majë të padukshme, të mbështjellë mes reve. Një Sinai të çmendur nga bukuria hyjnore, të armatosur me rrufe e me urdhëra të pandryshueshëm, ku mendoja se jetonte Zoti im. Ndjeja një forcë të re të frynte venat e mia, një përgjegjësi të re. Më dukej se toka kretase ishte pasuruar, po ashtu si shpirti im; ndieja që ajo ishte mbrujtur nga një numër më i madh të qeshurash të lashta e lotësh po të lashtë. Kuptova edhe një herë më shumë, se me çfarë force e çfarë sigurie të fshehtë toka është e lidhur me shpirtin. Pikërisht kështu, lulja duhet të ndjejë baltën të ngjitet tek ajo nga fundi i rrënjëve të saj, për t'u transformuar në ngjyrë e parfum.

Shihja shpirtin të shpalosej në gjakun tim, e ngjashme kjo me një miniaturë të mistershme të Kretës: ajo kishte formën e një anijeje me tre vela, që kishin jetuar në të njëjtët shekuj, që kishin jetuar të njëjtat frikëra e gëzime, duke lundruar mes tre kontinenteve, Lindjes së shenjtë, Afrikës përvëluese, Evropës së kursyer, sulmuar nga tre erëra të mëdha pllenuese.

E kjo nevojë që kisha provuar gjatë viteve, i ndërgjegjshëm ose jo, ishte zgjuar tani tek unë akoma më e domosdoshme - të harmonizoja këto tri dëshira, këto tri nxitje me ngjyra të papajtueshme, të realizoja trimërinë më të madhe, sintezën, të arrija në një Botë të përbërë nga një substancë e trefishtë.

Simboli fetar i Trinit, i njëjtë për të gjithë njerëzit, ishte vendosur tek unë në një nivel tjetër më pak simbolik, ishte bërë një realitet përvëlues, urdhërues. Një detyrë e lartë dhe e domosdoshme. Këtë

ose asgjë! Isha betuar në vetvete në një çast ekzaltimi, këtë ose asgjë. Ky Trinitet, nuk më është dhënë nga lart i gatshëm; duhet të jem unë ai që duhet ta krijoj: kjo është detyra ime, kjo e asgjë tjetër! Jo më kot, thoshja, Kreta është vendosur në mes të tre erërave të mëdha; jo më kot shpirti im ka marrë formën dhe fatin e Kretës. Gjithë klithmat përmes shekujve, me njerëzit e malet e saj, me detet e shkumëzuar që e rrethojnë, me gjithë trupin, me gjithë shpirtin e saj, në gjumë apo e zgjuar, që Kreta ka lëshuar, është detyra ime t'i transformoj në një fjalë të përkryer. A nuk jam unë biri i saj? A nuk jam bërë unë nga toka e saj? A nuk është ajo, shfaqjen më të vjetër të shpërthimit të të cilës, unë pashë, që më urdhëron të gjej drejtimin e fshehur të luftës së saj? Të kuptoj përse ajo ka klithur gjatë shekujve, dhe çfarë mesazhi kretas ajo është përpjekur t'u dërgojë njerëzve?

U nisa për në shtëpi. Kur i kalova ullishtat, vreshtat, kur hyra në Megalo Kastro, kur arrita në shtëpi? Nuk shihja asgjë, përpara syve të mi hidhej peshku i pashpresë. Ah, sikur të mundja, mendoja, të krijoja një shpirt që të hov, dhe të thyejë kufijtë e njeriut, i cili t'i shpëtojë fatalitetit, ky nuk do të ishte veç shkreptima e një shkëndie, e cila lë prapa trishtimet dhe gëzimet, idetë dhe zotët, për të thithur një ajër të pastër, të pabanuar. Në shtëpi më priste një letër me zarf zie. Pullë Serbie, e kuptova. E shihja në dorën time që më dridhej. Përse ta hapja? E kisha kuptuar menjëherë lajmin e hidhur. Ai vdiq, mërmërisja dhe bota u errësua.

Qëndrova një çast të gjatë duke parë nga dritarja natën që po binte. Duhet të kishin ujitur vazot në oborr, ngrihej një aromë toke. Mbi degëve të ndërthurura të hardhisë, ylli i mbrëmjes, varej si një pikë ngjyrë trëndafili. Mbrëmja ishte e bukur, jeta më dukej shumë e ëmbël, për një çast e kisha harruar letrën e hidhur që mbaja në duar.

Më vinte turp. Papritur, e kuptova, se duke soditur bukuritë e botës, unë përpiqesha të harroja vdekjen. Me një lëvizje të shpejtë grisa zarfin. Në fillim gërmat vallëzonin përpara syve të mi; dalëngadalë ato u qetësuan. I shtangur, munda të lexoj:

"Unë jam mësuesi i fshatit dhe po ju shkruaj për t'ju njoftuar një lajm të trishtuar: Aleksis Zorba, që zotëronte këtu një minierë qymyri, vdiq të dielën e fundit, në orën gjashtë Pasdite. Në agoni,

ai më thërriti. - Eja këtu, mësues, - më tha. - Unë kam një mik në Greqi. Kur të kem vdekur, shkruaji se kam vdekur dhe se deri në fund e kam patur mendjen në vend, syrin hapur, dhe se mendohesha edhe për të. Çfarëdo që kam mundur të bëj, unë nuk jam penduar. I thuaj atij të mbahet, dhe se do të vijë një kohë e madhe që do të jetë e arsyeshme...

Në qoftë se do të vijë ndonjë famullitar për të më rrëfyer dhe për të më kunguar, i thuaj t'ia mbathi menjëherë. Më mirë të më mallkojë! Unë i kam bërë disa gjëra në jetë, por megjithatë nuk kam bërë asgjë. Njerëzit si unë, duhej të jetonin njëmijë vjet. Natën e mirë!"

Mbylla sytë, ndjeva se si lotët e nxehtë më rridhnin faqeve - Ai vdiq, ai vdiq... pështpërisja, Zorba vdiq. Kurrë më! E qeshura vdiq, kënga u ndërpre, forca me të cilën mbushej vallja mbi zallishten e bregut u thye, u mbush me dhè goja e pangopëshme, që e përvëluar nga etja e pashërueshme, nuk rreshtte së pyeturi, kurrë nuk do të gjendet ajo dorë aq e butë, aq e zonja që të përkëdhelë gurët e detit, bukën, gruan...

Nuk ishte hidhërimi që më kishte pushtuar, ishte mërzia. Është e padrejtë, e pa drejtë! - thërrisja, të tillë shpirtra nuk duhet të vdesin. Po tani kur pra do të munden toka, uji, zjarri, rasti të krijojnë një Zorba?

Kishte shumë muaj që nuk e dija se ç'bënte por isha i qetë. Mua më dukej se ishte i pavdekshëm, si mund të shterojë një rrjedhë e tillë uji? Si mundet që vdekja të rrëzojë një luftëtar aq të mprehtë? Nuk do të ketë patur në çastin e fundit një të qeshur, një valle, një stërkëmbësh për t'i shpëtuar asaj?

Gjatë gjithë natës nuk mbylla sy. Kujtimet ishin tronditur, ato mbulonin njëra-tjetrën me nxitim, ngjiteshin në shpirtin tim të shqetësuara duke iu marrë fryma, sikur donin të krijonin përsëri Zorbën, ta pengonin të humbiste në tokë e në erë.

Rrethanat më të parëndësishme ku ai kishte qenë përzier, shkëlqenin në kujtesën time, të qarta, të lëvizshme, të çmueshme, si peshq shumëngjyrësh në detin e kulluar të vjeshtës. Asgjë që i përkiste atij nuk kishte vdekur tek unë, gjithçka që kishte prekur Zorba qe bërë e pavdekshme.

Ç'duhej të bëja, mendoja gjithë natën, për të penguar vdekjen,

vdekjen e tij?

Në thellësinë e qënies sime ishte hapur sipari, kujtimet vërshonin jashtë, shtynin njëri-tjetrin, nxitonin, më mbështillnin zemrën e pezmatuar. Ato lëviznin buzët, më thërrisnin t'i ngjaja Zorbës,shpërndarë në tokë, në dete, në erë dhe ta ringjallja. A nuk është detyrë e zemrës kjo? A nuk e ka krijuar për këtë gjë Zoti, për të ringjallur krijesat më të dashura? Ringjalle, pra, atë!

Edhe në qoftë se është vdekja, - thosha i entuziazmuar nga dielli i gëzuar që ndriçonte luftëtarin dhe i jepte jetë, - edhe në qoftë se është vdekja, ne të tjerët duhet të bëjmë prej saj një valle. Ne të tjerët, zemra ime, duhet t'i japim gjakun tonë që ai të marrë jetë; të bëjmë gjithçka mund të bëjmë që të jetojë akoma edhe pak ky ngrënës i mrekullueshëm, ky pirës, kjo tavolinë pune, ky qejfli fustanesh, ky endacak, valltari, luftëtari. Shpirti më i gjerë, trupi më i sigurt, klithma më e lirë që unë kam njohur në jetën time...

TEK UNË MBIN FARA

Miti i Zorbës filloi të kristalizohet tek unë. Në fillim, ishte një tronditje muzikore, një ritëm i ri, sikur gjaku në arterie kishte filluar të më rridhte më shpejt. Ndjeja ethe, një farë trullosjeje, një përzierje të papërcaktuar të dëshirës dhe të neverisë, sikur një trup i huaj, i padëshirueshëm, kishte hyrë në gjakun tim. Gjithë organizmi ishte tronditur prej tij dhe ishte mobilizuar për t'u mbrojtur; por ai rezistonte, lutej, hidhte rrënjë, herë kapej në njërin vend të trupit tim, herë në një vend tjetër dhe nuk donte të largohej së andejmi. Ishte bërë farë, një farë gruri e fortë, që e ndjente se kallinjtë dhe buka, të burgosura brenda saj, ishin në rrezik dhe përpiqej mundimshëm të shmangte rrezikun se mund të humbisnin.

Dilja dhe ecja për orë të tëra nëpër fusha, notoja në det, kthehesha shpesh në Knosos. Si kali, mbi kurrizin e të cilit qëndron një mizë e uritur e ai përdridhet e përpiqet ta largojë, ashtu tundesha e lëvizja unë. Po më kot. Fara nuk pushonte së hedhuri rrënjë të reja, ajo po më zotëronte.

Atëherë, një punë e dytë e fshehtë, doli për mua - ta ushqeja këtë farë, ta ujisja me gjakun tim, sepse ajo bënte pjesë tashmë në trupin tim; kështu duke e përvetësuar, unë mund ta mposhtja, sepse nuk kishte asnjë shpresë të lirohesha prej saj. Duhej që, me atë që kishte hyrë tek unë, që kishte triumfuar dhe ishte bërë një me mua, të dy ngadhnjimtarë.

Përnjëherë fjalët, rimat, krahasimet filluan të vrapojnë drejt farës së huaj, duke e mbështjellë e ushqyer atë si një embrion. Kujtimet e zalisura morën jetë, gëzimet dhe trishtimet e gëlltitura bashkoheshin me diskutimet dhe të qeshurat tona plot jetë. Gjithë ditët që ne kishim kaluar së bashku, endeshin para meje, të bardha si pëllumba, të gëzueshme, mbushur me gugatje. Kujtimet u ngjitën një kat më lart se e vërteta, dy kate më lart se e gënjeshtërta. Zorba shndërrohej dalëngadalë dhe kthehej në legjendë. Në mbrëmje hezitoja

të shtrihesha për të fjetur, në gjumë ndjeja farën të punonte. Mes paqes së shenjtë të natës, unë ndjeja të gërvishte një si krimb mëndafshi: gërryente gjethet, në thellësi të zemrës sime për të thurur me to mëndafshin.

Bridhja natën nëpër rrugicat e ngushta të Megalo Kastros dhe në çdo qoshe rruge, brofnin kujtimet e vjetra, atje takoja veten time fëmijë, duke ecur vetëm, që nuk doja të luaja me fëmijët e tjerë, pastaj adoleshent duke shëtitur me miqtë e mi mbi gërmadhat veneciane që sundonin detin. Ishte darkë, frynte një fllad i lehtë, ngarkuar me aromën e kripës së detit dhe të vajzave që shëtisnin si ne, që qeshnin e talleshin me ne, sepse donin që ne të ktheheshim ndaj tyre dhe t'i shihnim; por ne diskutonim për Zotin e për pavdekshmërinë e shpirtit. Kur hëna e plotë ndriçonte, më pushtonte dehja magjepsëse, portat dhe çatitë e shtëpive deheshin bashkë me mua - gurë, trarë, çezma, kambanare, zhvishnin trupat e tyre të rëndë, shkarkoheshin nga peshat që i dërrmonin gjithë ditën dhe shpirti i tyre i lakuriqtë, më në fund rrezatonte nën dritën e hënës.

Kanë filluar shirat e para; qielli është ulur drejt tokës. Rrëketë marrin shpejtësi, bashkohen në përrenj. Shtëpia prindërore është shumë e ngushtë për mua, unë banoj i vetëm jashtë qytetit, në breg të detit, në shtëpinë e braktisur të njërit prej miqve të mi. Një oborr katror, i mbyllur, i rrethuar me mure të lartë; në mes dy pemë limoni, një selvi dhe disa vazo me borzilok; për të dalë duhej të tërhiqje me gjithë forcën shulin e rëndë të një porte të madhe druri, si portë fortese. Çfarë lumturie ndjeja kur e shtyja shulin dhe mbyllja portën duke qëndruar fare i vetëm, ku askush nuk e trazonte vetminë time. Kur të hyj në Parajsë, thoshja me vete, duke parë shulin me mirënjohje, do të të shtrëngoj në krahët e mi e ashtu edhe ti do të hysh në Parajsë. Dikush do të shtrëngojë veglat me të cilat punon për të nxjerrë bukën, dikush shtrëngon shigjetën me të cilën lufton, një tjetër penën me të cilën ka shkruar, dikush tjetër do të shtrëngojë njeriun e dashur, ndërsa unë do të shtrëngoja atë shul. Çfarë gëzimi të jesh vetëm, të dëgjosh para portës tënde, psherëtimën e detit, të shikosh shirat e para duke rënë mbi gjethet e limonave dhe të qipariseve të oborrit, e të ndjesh në thellësi të trupit brerjen e një fare. Zorba pushonte tek unë si një krizalidë e mbështjellë nga rrezet e diellit dhe nuk lëvizte, por unë e kuptoja se fshehtas, pa zhurmë, në

atë krizalidë memece, ai vazhdonte ditë e natë një punë të pandërprerë e plot mister; pak nga pak venat e tij të shtrira mbusheshin me gjak, mishrat e thatë zbuteshin, mbulesa kishte filluar të çahej tek supet, ndërsa krahët akoma të paformuar mirë, të zhubravitur, të pafuqishëm kishin filluar të dukeshin. Ishte një krimb i fshehur në krizalidë, një dalldi hyjnore e kishte pushtuar menjëherë dhe ai donte të bëhej flutur. Ndërsa unë dëgjoja shirat e para, dëgjoja tokën që çahej dhe priste rrebeshin, dëgjoja farërat e grurit brenda në tokë se si pinin, fryheshin e lëshonin një çengel të gjelbër, shumë të fuqishëm, që kapej fort në tokë e ngrinte atë lart dhe dilte në dritë, për t'u bërë kalli e bukë - njerëzit e hanin që të jetonin dhe të mos e linin Zotin të vdiste. Pranë çdo fijeje të gjelbër unë dalloja një shpirt që e ndihmonte të rritej dhe të plotësonte detyrën e vet mbi tokë. Atje, në vetminë time të padhunuar, unë e ndjeja se krijesa më domethënëse e Zotit, një farë gruri, një krimb, një milingonë, duke kujtuar origjinën e tyre hyjnore, është e pushtuar nga një delir i frymëzuar nga Zoti dhe dëshiron të ngjitet shkallë-shkallë deri sa ta arrijë e t'i qëndrojë pranë.

- Fara e grurit, krimbi, milingona - me ëngjëjt dhe kryeëngjëjt; sepse ato janë ëngjëj e kryeëngjëj.

Ndërsa unë që e kisha njohur Zorbën, hija e të cilit shëtiste akoma përmbi tokë, që e dija se trupi i tij nuk përmbante më, as këngën, as vallen, mendoja me pasion për bishën që do të hovte, pak më vonë, duke thyer mbështjelljen depërtuese nga rrezet e diellit, që e mbante akoma të palëvizshëm brenda trupit tim. Çfarë bishe, çfarë hidhërimi i pangopshëm, çfarë flake e pamposhtur dhe e dëshpëruar! Një vemje, thosha, një vemje që s'është asgjë dhe dëshiron të bëhet flutur; Dëshiron pra të bëhet një Zorba!

Ditë të paharrueshme të pritjes së shenjtë! Binte shi, retë treteshin, dielli dukej i porsalarë, lulet e limonit kishin lidhur kokrra, kokrra që shkëlqenin, akoma të gjelbra mbi degët. Yjet, natën ngjiteshin, rrotulloheshin mbi kokën time dhe zbrisnin drejt perëndimit; koha rridhte si uji i Juvensës, koka ime si Arka e Noes qëndronte mbi ujërat e rrebeshet, voziste me bindje e siguri, ngarkuar me gjithë farërat, kafshë, zogj, njerëz, zotër. Unë mobilizoja gjithë kujtimet e mia, rikrijoja gjithë udhëtimet, thërrisja me mendje gjithë shpirtrat e mëdhenj që kisha dashur në jetën time, shtyja gjakun tim për të

ushqyer farën që rrinte brenda meje dhe prisja. E ushqeja me mjaltin që e kisha mbledhur gjatë gjithë jetës në lulet më me erë, më të helmëta. Për herë të parë provoja se ç'është dashuria prindërore dhe çfarë sheqeri i përjetshëm është një pjellë. Ashtu si perla që është njëherësh sëmundje dhe trimëri supreme e midhjes perlëmbajtëse, unë ndjeja një tronditje dhe ethe të gjakut, por në të njëjtën kohë një lajmërim të fshehtë, ardhur nga burime të thella: Po arrija, isha duke arritur në çastin më vendimtar të jetës sime; pikërisht mbi këtë farë, mbi këtë pjellë do të gjykohej fati im.

Vjeshta kishte kaluar, kishim hyrë tamam në dimër. Shëtisja rreth skutave të mia në fushat e punuara dhe admiroja se me çfarë durimi, toka e privuar nga bari, ruante farën dhe priste me bindje pranverën; unë isha i durueshëm me të, më dukej se kisha ndërruar seksin e isha bërë si toka, një femër, që ushqeja farën - Fjalën e Zotit - Dhe prisja.

Ah, sikur të mundja, mendoja të mishëroja në atë fjalë, gjithë brengat e mia, gjithë shpresat dhe, kur të hapja portën e tokës për të shkuar, të kisha mundësi të lija pas meje një krijesë të tillë.

M'u kujtua asketi që kisha takuar një ditë në Malin Athos. Ai mbante me gishta një gjethe, e shikonte në dritë dhe lotët i rridhnin nga sytë. Unë ndalova i befasuar:

- Çfarë shikon mbi këtë gjethe, atë i nderuar? Ç'të bën të qash?

- Shikoj Krishtin e kryqëzuar, - m'u përgjigj ai. Ktheu gjethen dhe fytyra i shkëlqeu.

- Çfarë shikon tani që po gëzohesh?

- Shikoj Krishtin të ringjallur biri im.

Ah! Sikur krijuesi të mund të shihte kështu, në gjënë më të pavlerë të botës, në një insekt, në një guaskë, në një pikë uji, gjithë ankthet dhe shpresat e tij; dhe jo vetëm të tijat, por edhe ato të të gjithë botës. Të shohë njeriun e kryqëzuar, njeriun e ringjallur, në çdo rrahje të zemrës së tij, të ndjejë se milingonat, yjet, fantazmat, idetë, të gjithë kemi lindur nga e njëjta nënë, se ne të gjithë vuajmë dhe shpresojmë se do të vijë një ditë, që sytë tanë do të hapen, e ne do të shohim se të gjithë jemi një, kur ne do jemi të çliruar nga mëkati.

Nuk do t'i harroj kurrë ato muaj misteriozë të pritjes. Fëshfëritjet

e gjetheve të limonave, një bletë që fluturonte, deti që nuk pushonte së psherëtitur përpara portës sime gjatë netëve të dimrit, një korb që kalonte mbi çatinë e shtëpisë, më bënin të vuaja dhe të lëshoja një klithmë, sikur një zot më kishte rjepur lëkurën dhe trupi nuk mund të duronte as erën më të lehtë. Unë e dija prej vitesh se për mua ka vetëm një mënyrë për t'u liruar nga një vuajtje e madhe ose nga një gëzim i madh dhe për të gjetur lirinë: Ta magjepsja atë vuajtje apo gëzim me magjinë e fjalës së Zotit?

Në të gjitha vendet tropikale, një krimb si fill, qëndron në mishin e njeriut dhe e bren ngadalë; vjen magjistari dhe luan me flautin e gjatë magjik dhe krimbi fillon lëviz ngadalë, zhvendoset ngadalë dhe del. Flauti i artistit është i ngjashëm me flautin e magjistarit.

Ditët alcioniane të janarit, të lagura nga dielli, që Zoti me dëshirën e tij i kishte mbjellë në zemër të dimrit kishin ardhur që zogjtë e gjorë të detit, të mundnin për të pjellë nëpër shkëmbenj vezët e tyre. Në një nga këto ditë, një mëngjes, u zhyta në ujë, notova, u nxeha dhe dola të thahesha në diell. Rrallëherë e kisha ndjerë trupin aq të lehtë, shpirtin aq të lumtur. U ktheva në shtëpi, mora penën - Është flauti im magjik - U përkula mbi letër me nje dridhje të lehtë.

Shkruaja, prishja, nuk gjeja fjalët e përshtashme, herë-herë ato ishin opake, pa shpirt, herë të papërcaktuara, kalimtare, shpesh abstrakte, pa trup, pa ngrohtësi, plot erë. Nisja të thoshja diçka, ndërsa fjalët e pabindura, të shpenguara, më çonin diku tjetër, ideja ime e fillimit i kishte rritur përmasat, kishte dalë nga kallëpi ku e kisha vendosur unë; ajo mbulonte më shumë kohë e hapësirë, ndryshonte, transformohej, e unë nuk arrija të fiksoja fytyrën e saj; së bashku me të transformohej e ndryshonte edhe shpirti im, të cilin nuk arrija ta fiksoja dot më.

Më kot përpiqesha të gjeja gjuhën e thjeshtë, pa zbukurime farfuritëse, të cilat nuk do ta ndryshonin dhe nuk do të prishnin emocionet e mia. Një fetar myslyman që kishte etje, hodhi kovën në pus për të mbushur ujë. Kur e ngriti, kova ishte plot me ar. Ai e hodhi. Lëshoi përsëri kovën në pus dhe kur e ngriti ajo ishte mbushur me argjend; ai e hodhi përsëri. - Zot! - tha, unë e di që ti je plot thesare; por me jep mua vetëm ujë për të pirë, unë kam etje. E lëshoi përsëri kovën në pus e mbushi me ujë dhe piu. E tillë duhet të jetë gjuha, pa zbukurime

E ndërpreva shkrimin; e kuptova se nuk kishte ardhur akoma çasti. Transformimi i fshehtë i farës nuk ishte bërë akoma. M'u kujtua se një ditë unë kisha shkëputur nga trungu i ullirit një larvë të mbështjellë në mbulesën e saj të butë dhe e vendosa në të prapmen e dorës. Në lëkurën e dorës ndjeva një gjë të gjallë që lëviste; Puna e fshehtë e larvës duhej të përfundonte duke e shndërruar atë në flutur, akoma e burgosur, ajo priste duke u dredhur lehtësisht që të vinte ora e shenjtë e pastaj të dilte në diell. Larva nuk ngutej ta çante mbështjelljen; ajo kishte besim tek drita, tek ajri i ngrohtë, tek ligji i përjetshëm i Zotit, ajo priste. Unë isha nxituar. Dëshiroja të shihja të çelte përpara meje, pak më herët, mrekullia: Të dilte mishi menjëherë nga varri e nga qefini e të bëhej shpirt, flutur. Unë isha përkulur dhe fryja mbi të frymën time të ngrohtë. Dhe ja menjëherë mbi shpinën e mbështjelljes u duk një grisje, e dalëngadalë, qefini u ça nga sipër deri poshtë dhe unë pashë të duket, e lidhur fort me pejëza, me krahë të palosur, me këmbët ngjitur në bark, akoma e paformuar, një flutur tërësisht të gjelbër. Ajo dridhej lehtë dhe nën frymën time të ngrohtë gjithmonë e më shumë merrte jetë. Një krahë ishte shkëputur nga trupi i zbehtë si një gjethe e porsa dalë nga sythi, dridhej e luftonte për t'u çuar gjer lart por më kot; ai ngeli i ngritur përgjysmë e i rrudhur. Shumë shpejt, filloi edhe krahu tjetër të tundet, u përpoq të shtrihej, nuk arriti e ndaloi gjysmë i hapur duke u dridhur. Unë me padurimin e njeriut, përkulur mbi ta, iu fryja frymën time të ngrohtë; por krahët e pafuqishëm kishin rënë të fishkur.

- U trondita shumë. Me nxitimin tim, duke guxuar të shkel një ligj të përjetshëm, unë kisha vrarë fluturën; ajo që unë mbaja në dorë nuk ishte veç një kufomë. Kanë kaluar shumë vite, por kufoma e vogël e fluturës peshon akoma mbi vetëdijen time.

Njeriu nxitohet. Zoti jo; Ja përse veprat e njeriut janë të lëkundshme dhe të papërfunduara, ndërsa ato të Zotit janë të qëndrueshme dhe të paarritshme. Sytë më ishin mbushur me lot, e unë u betova të mos shkel kurrë atë ligj të përjetshëm; ta pranoja shiun dhe diellin, si një pemë, të rrëzohem nga era e të pres me bindje: orën aq shumë të dëshiruar, orën e lules e të frytit.

Por ja që tani unë po e shkel betimin tim, larva e Zorbës nuk'ka arritur akoma të piqet, unë nxitohem të hap qefinin e tij. Më vjen

turp; gris gjithë letrat që kam zhgarravitur dhe shkoj të shtrihem në breg të detit. Më kujtohet një fjalë e Zorbës: "Unë veproj gjithmonë sikur të isha i pavdekshëm," këtë metodë, që është ajo e Zotit, duhet të ndjekim ne, të vdekshmit, jo nga padurimi dhe megalomania, por për shkak të vrullit të padukshëm që çon shpirtin peshë, përpjekja për të imituar Zotin është mënyra jonë e vetme për të kapërcyer, nuk do të ishte veç për një fije floku, nuk do të ishte veç një çast - që të kujton peshkun flutur - kufijtë e njeriut. Parimet më të çmuara që ne na jep Zoti, kur gjendemi të burgosur në trup, kur jemi vetëm krizalida janë durimi, pritja dhe besimi.

Shihja diellin që perëndonte, ishullin e shkretë përballë meje që ishte lyer me ngjyrë trëndafili, plot lumturi, si faqet që i lulëzon e puthura; dëgjoja kalimtarët e vegjël që të lodhur nga këngët dhe gjuetia gjithë ditën, e ndienin se po u vinte gjumi dhe shkonin në foletë për të fjetur. Pas pak yjet filluan të ngjiteshin njëri pas tjetrit, nata ishte në rrugën e kthimit. Erdhi mesnata, pastaj agimi, doli dielli, rruga e jetës filloi të lëvizë.

Ritëm hyjnor. Yje, zogj, në tokë fara, të gjithë të bindur. Vetëm njeriu rebelohet e do të shkelë ligjin, të transformojë bindjen në liri. Ja përse, nga gjithë krijesat e Zotit, vetëm ai mëkaton. Çdo të thotë të mëkatosh? Do të thotë të shkatërrosh harmoninë.

Po mendoja të bëja një udhëtim për të provuar durimin, të prisja. Hipa mbi një kaike që shërbente për furnizimin e ishujve të hijshëm të detit Egje-Santorin, Naksos, Paros, Mikonos.

E kam thënë dhe e përsëris: Një nga gëzimet më të mëdha që mund t'i jepen njeriut në këtë botë është, të lundrosh në detin Egje në pranverë, kur fryn një erë e lehtë.

Mua nuk më është shfaqur kurrë një parajsë tjetër. Çfarë gëzimi tjetër në qiell e mbi tokë, mund të jetë më mirë në harmoni me trupin dhe zemrën e njeriut? Ai gëzim shkon deri në ekzaltim, por falë Zotit që nuk shkon më tej, kështu që, bota e dashur, e dukshme, nuk zhduket; është tjetër gjë: e padukshmja bëhet e dukshme dhe ajo që ne e quajmë Zot, përjetësi dhe bukuri ngjiten në kaiken tonë

dhe lundrojnë së bashku me ne. Në çastin e tmerrshëm të vdekjes mbyllni sytë dhe në qoftë se shikoni Santorin, Naxosin, Parosin, ose Mikonosin, ju do të hyni, pa kaluar fare nga toka, në Parajsë. Çfarë vlere kanë gjiri i Abrahamit dhe fantazmat jomateriale të Parajsës kristiane, përpara kësaj përjetësie greke, bërë nga uji, shkëmbenjtë dhe ere të freskët?

Isha i gëzuar që isha njeri, njeri dhe grek, dhe që mundja kështu pa ndërhyrje deformuese të refleksionit abstrakt, të ndjeja instiktivisht se Egjeu më përkiste edhe mua, se ai ishte trashëgimia e stërgjyshëve të mi. Udhëtoja midis ishujve duke kaluar nga lumturia në lumturi, pa dalë nga kufijtë e shpirtit tim. Ata ishuj hyjnorë, shkëlqenin, dridheshin e ndryshonin në çdo çast, si gusha pushatake e thëllëzës, në hije e dritë, herë në kafe të thellë, herë si të pudrosur me pluhur të artë, mbuluar me ngjyrën e trëndafilit të mëngjesit, të zambakut të mesditës dhe me një ngjyrë vjollce të ngrohtë kur dielli fillonte të perëndonte.

Ky lloj udhëtimi martesor zgjati pesëmbëdhjetë ditë. Kur u ktheva në shtëpinë time në bregdet, shpirtin e kisha të qetë ndërsa zemra më rrihte me një ritëm të lehtë. Krishti, Buda, Lenini, tre piratët e dashur të jetës sime, nuk ishin zhdukur, ata ndrinin me një dritë të zbehtë në gjysmëhijen e kujtesës sime, si hieroglife dekorative, kuptimi i thellë i të cilave është tejkaluar.

Asnjë shqetësim intelektual nuk më pushtoi gjatë gjithë udhëtimit. Asnjë qënie nuk erdhi për të më kujtuar në gjumë, se unë kisha brengën e krijuesit për të zgjidhur dhe se nuk mund ta zgjidhja. Shikoja, dëgjoja, merrja frymë i shkujdesur. Shpirti im ishte bërë trup, i cili po ashtu merrte frymë, shikonte dhe dëgjonte botën i lumturuar.

Dy piktorë të antikitetit, diskutonin se cili e pikturonte më realisht botën e dukshme.

- Unë do të tregoj se jam më i mirë, - thotë njëri prej tyre, - dhe i tregoi tjetrit një perde.

- Epo mirë! Tërhiqe perden, që të shikojmë tablonë, - thotë rivali i tij.

- Kjo është tabloja, - kundërshtoi piktori duke qeshur.

Gjatë gjithë udhëtimit tim në detin Egje, unë kuptova thellë se perdja është imazhi. Mjerë ai që gris perden për të parë. Ai nuk do të shoh tjetër veç kaos.

Qëndrova edhe disa ditë zhytur në qetësinë e rreptë të vetmisë.

Ishte pranverë, isha ulur në oborr nën limonin e lulëzuar dhe kujtoja me gëzim një fjalë që kisha dëgjuar në Malin Athos: "Motra ime bajame, folmë mua për Zotin. - Bajamja u mbush me lule."

Në të vërtetë, kjo perde e qëndisur me lule, me zogj e njerëz, duhet të jetë vetë Zoti; kjo botë nuk është veshja e Zotit, siç bisedoja dikur, ajo është vetë Zoti; forma dhe substanca janë një. Isha kthyer nga pelegrinazhi në detin Egje duke marrë me vete një plaçkë të çmueshme, sigurinë. Zorba e dinte, por nuk mund ta thoshte, ai e vallëzonte. Ah! Mendoja, sikur të mund të bëja me këtë valle një fjalë!

Nuk e kisha menduar më herët se mendja ime ishte mbushur me yje, por unë i pashë. Gjatë shumë viteve unë kisha kërkuar Zotin, pa parë se ai ishte përpara syve të mi, si i fejuari që beson se ka humbur unazën, dhe kërkon kudo pa e gjetur, por në fakt e ka në gisht.

Vetmia, qetësia, deti Egje bashkëpunonin fshehtas e tërë dashuri me mua. Koha, ky shok pune, kalonte mbi kokën time dhe piqte farën në trupin tim.

Nga ana ime, unë isha mprehur përsëri në rrugën e përjetshme, me yje e me zogj; për herë të parë po kuptoja, se ç'është liria e vërtetë: të vendosesh nën vullnetin e Zotit, në harmoni.

Krijimi është një gjueti magjepsëse, plot pasiguri e emocion, si dashuria. Çdo mëngjes, kur nisesha për këtë gjueti misterioze, zemra më rrihte fort nga ankthi, nga kurioziteti dhe nga një besim i pakuptuar, frymëzuar nga Luçiferri, që, nuk e dija as përse as sesi, i ngjante një nënshtrimi të thellë të papohuar. Sepse që në ditët e para unë kisha kuptuar me tmerr, absolutisht pa i menduar, kush ishte zogu i padukshëm, i paqenë, ndoshta, që unë gjuaja. Malet ishin mbushur me thëllëza, grykat plot me turtuj, liqenet mbushur me rosa të egra; por unë kaloja mospërfillës përpara tyre dhe kërkoja zogun e pakapshëm që herë pas here e dëgjoja të përplaste krahët thellë në zemrën time; ai akoma kishte vetëm krahët e unë përpiqesha t'i jepja një trup të ngjeshur, që të mundja ta kapja.

Në fillim nuk mundja t'i vija emër, ndoshta edhe nuk e doja këtë gjë. Sepse unë, e dija që emri e burgos shpirtin, e shtyp për ta detyruar të hyjë në fjalë dhe e detyron të largojë jashtë emrit të tij atë që ai ka të pashprehëshme, por që është më e çmueshmja, më e pa-

zëvendësueshmja.

Por nuk vonoi të kuptojë se ky anonimat e bën gjahun shumë më të vështirë. Nuk mund të përcaktoja se nga cila anë gjendej gjahu im dhe t'i ngrija grackë; ajo prani e padukshme planeronte kudo nëpër ajër, kudo e askund. Njeriu nuk mund të përballojë lirinë absolute, një liri e tillë e çon në kaos. Në qoftë se do të ishte e mundur të lindte një njeri i tillë i pajisur me një liri absolute, detyra e tij e parë, në qoftëse ai do të dëshironte të ishte i dobishëm mbi tokë, do të ishte ta kufizonte atë liri. Njeriu nuk e përballon dot të punojë vetëm në mjedise të përcaktuara, të kufizuara. Duhet pra, t'i nënshtrohesha kësaj dobësie njerëzore, në qoftë se doja ta kapërceja; kështu më duhej t'i jepja një emër zogut misterioz që gjuaja. Një emër që të ketë kufij aq të lëvizshëm sa të jetë e mundur, konture aq transparente sa të jetë e mundur, që ta shihja, qoftë edhe turbull, atë që ndodhte prapa dhe rreth tij.

Ajo nevojë punonte fshehtas brenda meje, ditë e natë; për fat mendja ime nuk e dinte, ajo punonte pa e kuptuar. Një mëngjes, kur u ngrita, emri i Zogut shkëlqente në ajër përpara meje, papritur, i tmershëm: Nuk ishte zog, ishte një klithmë, që dilte nga gojë të panumërta, që unë e njoha përnjëherë; ishte ajo klithmë që unë gjuaja, për të cilën torturohesha dhe luftoja: Klithma e së ardhmes. Unë kisha lindur për të dhe gjithçka, gëzimet, trishtimet dhe udhëtimet, virtytet e veset, të gjitha nuk ishin veçse marshimi im drejt asaj klithme. Krishti, Buda, Lenini nuk ishin veç stacione në rrugën time; nëpërmjet tyre do të kaloja, ata ishin orientuesit që tregonin kalimet e zogut, ata ishin ndjekësit që më kishin ndihmuar të ngrija gjuetinë.

Pra, asgjë, s'kishte humbur, udhëtimet endacake, dridhnuese, të shpirtit tim, të marrë veç e veç, ngjanin kohë të humbura, vepra të një arsyetimi jo të pjekur, anarkik; por të gjitha së bashku, si i shikoja tani, ato formonin një rrugë të drejtë, të pakthyeshme, por ai e dinte se vetëm rrugët e pjerrëta mund ta lejonin të përparonte mbi atë terren të thyer. Pabesnikëria ime ndaj ideve të mëdha, që vazhdimisht më kishin mashtruar e zhgënjyer, dhe që kisha braktisur, të gjitha së bashku përbënin një besnikëri të patundur ndaj substancës. Gjithçka kishte kaluar si rastësisht - si ta quaj? Jo Rasti, por Fati - kishte sy, një zemër të dhembshur dhe më kishte kapur nga dora për të më

udhëhequr, vetëm tani unë e kuptoj se ku më çonte dhe çfarë priste prej meje: që unë të dëgjoja klithmën e së Ardhmes, që unë të përpiqesha të kuptoja se çfarë donte, përse tingëllonte dhe drejt kujt na thërret.

Gjaku, duke pështëritur nga gëzimi, m'u ngjit në kokë; mora penën dhe shkruajta në krye të një flete letre refrenin e gëzueshëm të veprës së fundit vendimtare që po nisja:

"Përshëndetje ty, njeri, gjel i vogël, me pupla mbi dy putrat e tua! Është e vërtetë, edhe pse nuk ta besojnë: në qoftë se ti nuk këndon herët në mëngjes, dielli nuk do të lind!"

Mbi kokën time ishte ngritur një flakë, e freskët, gazmore, që unë e ndjeja se rrihte në ajër si një krah i kuq. Ishte një zog misterioz që këndonte, kaska e zjarrit magjik që shumëfishonte ashpërsinë dhe shpresën e luftëtarit. Zemra më rrihte nga padurimi, niste të merrte vrull, por shikonte përpara saj greminën - është greminë apo Zoti? - dhe hezitonte. I shkreti mish nuk kishte asnjë ëndërr aventure, ai ishte i qetë në atë shtëpi të vogël, të qetë, me limonët, detin dhe shulin e rëndë; ai turfullonte duke ulëritur. Por mbi trupin tim ngrihej një trup tjetër i padukshëm, më i lartë e më i njëmendët se trupi im i vërtetë, dhe ishte ai që komandonte. Unë isha bërë anije dhe përgatitesha të hidhesha në det; një sirenë erdhi e u vendos mbi bash, me një dorë të vendosur qetësisht mbi gjoks, tjetrën të shtrirë përpara. Nuk ishte Fitorja, ishte Britma e madhe: ndërmjet qiellit dhe detit ajo më tregonte rrugën.

Në këtë anije hyjnë gjithë fjalët, gjithë legjendat, gjithë tregimet që unë dija. Hipa gjithë miqtë e mi të afërt, trimat më të zotë të fantazisë sime, ushqime e fuçi vere, një numër të madh zotësh të vjetër, gdhendur madhërisht në dru për të kaluar kohën; ngrita velat dhe u nisëm.

Nga të drejtohem? Asgjë nuk kisha në mendje, tëmthat ishin të hapur dhe të katër erërat frynin me të njëjtën fuqi. Unë ngjeshja me gishta një copë nga toka e ashpër, të ardhmen; i jepja një formë - të një njeriu, të një Zoti, të një djalli - e prishja, duke bërë një tjetër. Format rridhnin nga gishtat, qëndronin për pak kohë në ajër dhe zhyteshin në kaos. Dukej sikur luaja me to; por unë nuk luaja, unë luftoja. Unë përpiqesha t'i jepja baltës formën e shpirtit tim.

Ishte një luftë e dobët, e pashpresë; sepse unë nuk e dija qartë

çfarë ishte, si ishte bërë, fytyra e shpirtit tim. Përpiqesha, duke mbrujtur baltën, ta gjeja atë. Nuk kisha besim tek arsyeja; ajo shikonte vetëm trupin, formën e tij të ngjeshur; ajo nuk shikon flakën lëkundëse që rrethon trupin e hidhet në majë të kokës dhe kërcet në erë si flamur: pikërisht ky është shpirti. Unë pra, lejoja vetëm forcat mistike të udhëhiqnin gishtat e mi.

Gjatë tre ditëve, si një fakir, pa lëvizur, pa folur, unë u përqendrova për të jetuar edhe njëherë jetën time. Asgjë s'kishte humbur. Detajet më të parëndësishme, një shegë në lule pranë Kallamatës, një pjepër plot aromë, një vajzë e vogël brune që shiste jasemin në Napoli, kërcitjet triumfale të këpucëve të drurit të një vejushe që vallëzonte në një martesë në oborrin e shtëpisë së saj, dy harqet e mëdhenj që vizatonin vetullat e një kaukazianeje në Moskë, gjithë kjo dilte nga gracka e kujtesës sime dhe ma mbushte qënien me lumturi.

Natën, kur shtrihesha për të fjetur, vazhdoja udhëtimet në gjumë; Vetëm natën, ato udhëtime, të lehtësuara nga pesha e së vërtetës, planeronin në ajër, përbërë nga një substancë më e lehtë dhe më e çmueshme.

A ekziston ndonjë gjë më e vërtetë se e vërteta? Po, legjenda; është ajo që i jep kuptim të pavdekshëm të vërtetës jetëshkurtër. Tani gjithë bredhërimet e mia bashkohen e harmonizohen, përqendrohen në një udhëtim të vetëm e të çmueshëm, që e dinte nga u nis, përse u nis dhe ku shkonte; cilado nga ndalesat e mia nuk ishin më një kokëkrisje e rastit, e pakuptimtë, por i korrespondonte një qëllimi të lidhur me fatin. Gjithë udhëtimet e mia ishin bërë një vijë e vetme e kuqe që nisej nga njeriu për të arritur tek Zoti - dua të them në majën më të lartë të shpresës.

Ditën e katërt, ndërsa përpiqesha të kuptoja deri ku kishte mbërritur vija e kuqe që tregonte ngjitjen time, papritur, një tmerr i shenjtë ma pushtoi gjithë qënien. Nuk ishte gjaku im që kishte vizatuar atë vijë të kuqe. Qe një tjetër, një stërgjysh gjigand, i pakrahasueshëm me mua, pirat detesh e ngjitës malesh, që ngjitej. Ishte gjaku i tij që rridhte nga plagët, e që kishte lënë gjurmë të kuqe në rrugën e tij mbi toka e dete. Unë isha vetëm hija besnike që e ndiqte. Unë nuk e shikoja; herë pas here dëgjoja vetëm psherëtimat ose të qeshurën e tij buçitëse; kthehesha dhe nuk shihja njeri, por mbi vete ndieja frymëmarrjen e tij të fuqishme.

Me praninë e tij në sytë e mi - jo sy argjile por të tjerë - u përkula mbi letër. Por fleta e bardhë nuk ishte më si më parë, një pasqyrë që reflektonte fytyrën time: Unë për herë të parë pashë fytyrën e shokut të madh të Rrugës. E njoha menjëherë: Me një kapuç marinari, ai kishte një shikim shqiponje, magjepsës si të gjarpërit, vetulla të harkuara, sikur vlerësonte me shikim në duhej të fluturonte, ose sikur të shikonte një re që ishte shfaqur papritur mbi det, ngarkuar me stuhi, ose më mirë forcën e tij dhe të pavdekëshmve, para se të vendoste në duhej të tregohej bujar apo dinak.

Forca e qetë, e palëvizur, gati për t'u hedhur, qëndronte mbi fytyrën e tij. Ishte një atlet, një njeri që respekton vdekjen dhe lufton me të me kujdes e shpejtësi, pa thirrje, pa lutje, dhe që e shikon në sy. Fërkuar me vaj, të dy të zhveshur, ata luftojnë në dritë, duke iu përmbajtur rregullave të luftimit. Shoku i madh i Rrugës e di cili është kundërshtari por nuk e pushton paniku; ai ngre sytë e shikon fytyrën e vdekjes të shformohet e të marrë pamje të panumërta - Herë të një femre mbi rërë që këndon duke mbajtur grykën me dorë, herë të një Zoti që ngre stuhi dhe do ta mbysë, herë të një tymi të lehtë mbi çatinë e shtëpisë së tij. Ndërsa ai shtrëngon buzët, kënaqet me gjithë fytyrat e vdekjes dhe lufton me to duke i përfshirë pangopshmërisht.

Ishe ti, si nuk të njoha menjëherë, ishe ti, gjysh, stërgjysh i dashur; kapedani i luftanies Greke! Me kapuçin tënd me majë, shpirtin e pangopur, që farkëton fabula dhe që gëzohet për gënjeshtrën e tij si për një vepër arti, lakmitar e kokëfortë, duke kthyer me një shpejtësi të çuditshme kujdesin e njeriut në delir hyjnor, që qëndron mbi luftanijen greke, prej, kush e di sa mijëra vjetësh e kushedi se përsa vjet akoma ti do të mbash shufrën e hekurit pa e lëshuar!

Të shoh nga çdo anë dhe shpirti më trazohet. Ndonjëherë më dukesh si plak qindravjeçar, ndonjëherë si një burrë i pjekur me flokë ngjyrë blu kaçurrel, spërkatur me vesë, ndonjëherë si fëmijë i vogël, që shtrëngon, si gjinjë, tokën dhe detin dhe pi. Të shoh nga çdo anë dhe përpiqem të të burgos në fjalët që shkruhen, për të fiksuar fytyrën tënde dhe të mund të të them: - Të kapa, e nuk mund të më shpëtosh më! Por ti e shpërthen fjalën - Si mund të të nxinte ajo? - Ti rrëshqet dhe shpëton, ndërsa unë dëgjoj nëpër ajër, mbi kokën time, të qeshurën tënde të fuqishme.

Çfarë fjalë nuk kam përdorur si grackë për të të kapur! Të kam quajtur të mallkuar, kundërshtar të Zotit, shkatërrues të Zotit, gënjeshtar, njeri me shtatë jetë, njeri me shumë shpirtra, me shpirt komplotisti, me shpirt dhelpre, me shpirt të paqëndrueshëm që kalon herë majtas, herë djathtas, mashtrues zemrash, armik zemrash, shtëpimbyllur, grabitës shpirtrash, përgjues kufijsh, endacak nëpër botë, vjelës i botës, hark të shpirtit, ndërtues fortesash e shkatërrues fortesash, pirat detesh e njeri me vullnet të dyfishtë e të trefishtë, njeri të majave, vetmitar e të përjetshëm, lundërtar të madh, direk të shpresës!

Në fillim, kur unë nuk të njihja akoma, kisha vendosur në rrugën tënde, për të të penguar të niseshe, atë që besoja se ishte gracka më e mirë, Itakën. Por ti shpërtheve në të qeshura, merrje frymë thellë, Itaka ishte bërë pluhur. Atëherë kuptova, lavdi ty, shkatërrimtar i atdheut, se Itaka nuk ekziston. Nuk ka më asgjë prej saj veç detit, një barke të vogël sa një trup njeriu, e mbi të shpirti i kapedanit. Qëndruar mbi gjymtyrë të fortë, burrë e grua, njëherësh, ai mbjell e bën fëmijë; ai pjell gëzimin e trishtimin, bukuritë, virtytet dhe aventurat, gjithë fantazmagoritë e botës. Ai rri në këmbë, i palëvizshëm, me sy të fiksuar mbi kataraktin e vdekjes që tërheq anijen e tij, lëshon pangopshmërisht si oktapod, pesë gishtat e uritur mbi tokë e mbi det. Gjithçka që ne mund të kapim, thirri, një gotë me ujë të freskët, një fllad të lehtë mbi ballë, frymën e ngrohtë të një femre, një ide, gjithçka që gjendet atje, gjithçka është e mirë për t'u marrë.

Gjithë jetën time kisha luftuar për ta shtrirë shpirtin tim deri sa ai të kërcasë, deri atje ku ai mund të jetë gati për t'u këputur, për të krijuar një mendim të madh që mund t'i japë një kuptim të ri jetës, një kuptim të ri vdekjes, e të ngushëllojë njerëzit.

Dhe ja tani, ndihmuar nga koha, vetmia dhe pema e limonit në lule, ideja ishte bërë legjendë. Ishte një gëzim i madh, ora e lumtur kishte mbërritur, larva ishte bërë flutur.

Shumë vite më parë, plaku Nahman më kishte mësuar të kuptoja se kur të ishte momenti të hapja gojën për të folur, të merrja penën për të shkruar. Ai ishte i thjeshtë, gazmor, i shenjtë; nxënësve të tij u jepte këshilla që edhe ata të bëheshin të dashur, të thjeshtë e të shenjtë. Një ditë do t'i binin te këmbët:

- Rabi i dashur - i thanë me një ton miqësor, përse nuk flet edhe ti si mësues Zadiku, përse nuk hedh edhe ti ide të mëdha, nuk ndërton teori të mëdha, që njerëzit të të dëgjojnë gojëhapur? Ti nuk flet veç me fjalë të thjeshta, si gjyshet dhe tregon histori.

Mësuesi i urtë buzëqesh. Qëndron për një çast pa u përgjigjur, pastaj fillon të flasë:

- Një ditë, - tha, - hithrat pyetën drurin e trëndafilit: Zotni trëndafil, a mund të na i mësosh edhe ne sekretin tënd? Ç'bën ti për të çelur trëndafila? Druri i trëndafilit iu përgjigj: Sekreti im është shumë i thjeshtë, motrat e mia hithra. Gjithë dimrin, me durim, bindje e dashuri unë punoj tokën dhe nuk kam veç një gjë në shpirt, trëndafilin. Më lag shiu, më rrëzon gjethet era, më zë frymën bora, por unë në shpirt kam vetëm një gjë, trëndafilin. Ja sekreti im, motrat e mia hithra.

- Mësues, thanë nxënësit, ne nuk kuptuam asgjë.

Mësuesi qeshi:

- Unë nuk kam ç't'ju them më . Edhe unë nuk e kam kuptuar menjëherë.

- Atëherë, Mësues?

- Unë doja t'ju thosha këtë: kur kam një ide, unë e përpunoj për një kohë të gjatë, pa folur, me durim, bindje e dashuri. Kur hap gojën, nxënësit e mi, ideja del në formën e një legjende.

Ai qeshi përsëri:

- Ne njerëzit, këtë e quajmë legjendë, bima e trëndafilit e quan trëndafil

VDEKJA E TIM ETI

Unë isha akoma duke luftuar dhe duke u zënë për të dominuar këta kuaj të egër që janë fjalët, kur erdhi vera. Mijëra, miliona vjet kanë kaluar nga dita e parë e njeriut e megjithatë arti i joshjes është gjithmonë i njëjti dhe rregullat e gjuetisë nuk kanë ndryshuar. Përdorim gjithmonë të njëjtat dredhi, të njëjtat lutje, ne ftojmë, kërcënojmë, rrethojmë të Padukshmen me të njëjtat dredhi të ndyra. Sepse shpirti, ashtu si është i shtypur nga trupi, nuk mund t'i hapë lirisht krahët, por detyrohet të ndjekë në këmbë rrugën e trupit.

Njerëzit e parë, në shpellat e tyre përpiqeshin të pikturonin kafshën që dëshironin të kapnin kur kishin uri.

Ata nuk kishin as më të voglin synim që të krijonin një vepër arti. Pamja e kofshës që ata gdhendnin ose pikturonin mbi shkëmb, ishte për ta një gjë magjike, një grackë misterioze që tërhiqte kafshën, që ata ta kapnin. Ja përse, ishte e domosdoshme që imazhi i kafshës të ishte sa më real, në mënyrë që preja të binte sa më parë në grackë.

Kështu edhe unë vendosja, me gjithë dinakërinë time, fjalët në vend të grackave. Me qëllim që të kapja të pakapshmen, klithmën që ecte përpara meje.

Asnjëherë nuk e kisha parë babanë tim me dhembshuri. Frika që më shkaktonte ishte kaq e madhe saqë gjithçka tjetër, dashuria, respekti, familjariteti, gjithçka zhdukej. Fjala e tij ishte e rëndë dhe akoma më e rëndë ishte heshtja e tij. Ai fliste rrallë dhe kur hapte gojën, fjalët ishin të menduara mirë, dhe nuk mund të gjeje shteg që ta kundërshtoje.

Ai kishte gjithmonë të drejtë dhe kjo dukej se e bënte të paprekshëm. Ëndërroja gjithmonë: Ah, sikur të mos kishte të drejtë, dhe unë ta kundërshtoja; por asnjëherë ai nuk ta jepte këtë mundësi, dhe unë nuk arrita kurrë ta falja për këtë. Ishte si një lis me trung të fortë, me gjethe të ashpra, me fruta të athëta dhe që nuk lulëzonte kurrë. Ai përpinte të gjithë energjinë që e rrethonte dhe nën hijen e

tij të gjitha pemët e tjera rreshkeshin, rreshkesha dhe unë nën atë hije dhe nuk pranoja të jetoja në atë atmosferë. Revolta të papërmbajtshme shpërthenin brenda meje kur isha i ri, isha gati të hidhesha në aventura të rrezikshme, por mendoja babanë tim dhe zemra më thyhej. Ja përse, në vend që të bëhesha një luftëtar i madh, një njeri aksioni, isha i detyruar të shkruaja atë që do të kisha dashur të bëja. Gjaku im ishte shndërruar në bojë.

Pas tre ditësh, kur u ktheva në shtëpinë e vogël në breg të detit, ndjeva një lehtësim të pashpjegueshëm, të pafe. Nuk e kisha më atë peshë që peshonte mbi mua, atë hije. Ishin shkëputur prangat misterioze që më mbanin të nënshtruar dhe të frikësuar; tashmë unë mund të thosha, të shkruaja, të bëja çfarë të doja, nuk duhej t'i jepja llogari askujt. Ishte larguar tutori, ishte mbyllur ai sy, i cili, ashtu si dielli, shikonte gjithçka dhe nuk falte asgjë; isha i lirë, i çliruar.

Ishte shumë vonë. Kisha nisur një rrugë, nuk e kisha zgjedhur unë, por ai, të gjitha rrugët para dhe prapa meje ishin të bllokuara, kisha zakone të papërcaktuara, në një rrjetë joshjeje dhe neverie, ishte tepër vonë që të bëja një kthim brutal dhe të ndryshoja frontin e betejës. Rrugën e nisur duhet ta vazhdoja deri në fund. Tani kisha vetëm një avantazh të madh; isha i lehtësuar dhe mund të ecja pa u trembur edhe pse më dukej sikur e dëgjoja; duke qeshur, kënduar, luajtur; nuk kisha më turp nga askush deri atëherë, nuk ia kisha frikën veçse një njeriu, tim eti; Prej kujt do të kisha frikë tani? Kur isha fëmijë, ngrija sytë, e shikoja dhe më dukej si gjigand; me kalimin e kohës,unë rritesha, çdo gjë që më rrethonte, njerëzit, pemët, shtëpitë, zvogëloheshin; vetëm ai ngelej ashtu si më ishte dukur kur isha fëmijë; gjigand. Ai ngrihej përpara meje si një kullë dhe më fshihte diellin. Më kot shmangia qëndrimin në shtëpinë e babait, në shpellën e luanit; rebelohesha, udhëtoja, hidhesha në aventura shpirtërore të rrezikshme; mes dritës dhe meje ishte gjithmonë hija e tij. Jetoja nën një eklips të përhershëm të diellit. Brenda meje ka hije të mëdha; babai im. Gjatë gjithë jetës sime kam luftuar shumë për të tranformuar këto hije në dritë, në pakëz dritë; luftë e hapur pa mëshirë, pa pushim për të marrë frymë; po i lodhur, kisha braktisur luftën një çast të vetëm, dhe kisha humbur; Dhe nëse ndonjëherë kam dalë ngadhënjimtar, çmimi ka qenë një ankth i madh dhe shumë plagë! Nuk kam lindur i pastër por përpiqem të bëhem. Virtyti për

mua është fryt i luftës sime; Zoti nuk ma ka dhënë, po përpiqem ta fitoj me tehun e shpatës. Maja e virtytit është për mua një grumbull plehu i transformuar.

Kjo luftë nuk ka marrë fund asnjëherë; deri tani nuk jam mundur asnjëherë plotësisht por edhe nuk kam dalë ngadhënjimtar plotësisht; luftoj çdo ditë e në çdo çast, ose mund të fundosem i tëri ose mund të shpëtoj plotësisht. Kaloj pa pushim mbi një greminë duke ecur në fije të perit.

U zhvesha, u hodha në det dhe notova. Atë ditë provova misterin e pagëzimit në gjithë thjeshtësinë e tij të përjetshme, kuptova pse shumë besime konsiderojnë ujin, banjën, dua të them pagëzimin, si kushtin paraprak, të domosdoshëm për fillimin e neofitit, para se të fillojë jetën e re. Freskia e ujit penetron deri në kocka, deri në tru dhe arrin shpirtin. Shpirti shikon ujin dhe si një pulëbardhë e re që rreh me gëzim krahët, lahet, gëzohet, freskohet, uji i thjeshtë, i përditshëm, transformohet, dhe bëhet ujë përtëritës që rinon. Bota nuk ka ndryshuar, ajo është gjithmonë mizore dhe e këndshme, e poshtër,e mbushur me bukuri, por tani pas pagëzimit sytë që e shihnin kishin ndryshuar.

Dola nga deti kur po perëndonte dielli; dy ishujt e shkretë përpara meje, mes qiellit dhe detit, ishin bërë të kuq. Vala e lehtë mërmëriste ëmbël mbi gurët e bardhë, bregu i vjetër buzëqeshte i gëzuar. Kaloi një varkë peshkimi; lopatat e saj shkëlqenin, kur godisnin ujin dhe e plagosnin, prej tyre rridhnin pikla të arta. Peshkatari në barkë psherëtiu thellësisht dhe në qetësinë muzgullore psherëtima e tij rezonoi plot pezmatim dashurie dhe hidhërimi. Duhet të ishte i ri e i vetmuar. Bukuria e detit, ishte aq e padurueshme, saqë vetëm "Ah"-ja që doli prej tij mund ta frenonte.

Ishujt kishin marrë ngjyrë vjollcë, deti po errësohej. Zogjtë e natës ndjenin mbi qepalla ëmbëlsinë e mbrëmjes dhe hapën sytë, kishin uri. Dy lakuriqë nate fluturuan mbi mua me sqepat e hapur; gjuanin. Dikur ata kishin qenë vasha të reja, këtë gjë shkencëtarët nuk e dinin por populli e dinte, pra dikur ata ishin vasha të reja, por një ditë në kishë ato hëngrën trupin e Krishtit dhe ai i bëri me krahë. Shikoja në atë muzg, trupat e tyre dhe admiroja edhe një herë akoma

harmoninë e fshehtë të botës; të njëjtat ligje të thjeshta mbretëronin mbi njerëzit dhe kafshët; aventura e shpirtit njerëzor është e njëjtë me atë të lakuriqit të natës; edhe ai ishte një vajzë e re, hëngri trupin e Krishtit, u kungua dhe ai i vuri krahët.

Nuk njihja kafshë më të neveritshme se miu dhe zog më të neveritshëm se lakuriqi i natës; nuk njihja asnjë bashkim mishi, qimesh dhe kockash më të shpifura se trupi njerëzor. Por sa hyjnor bëhet ky grumbull plehrash kur metamorfozohet dhe Zoti i bën me krahë!

Kur u ktheva në shtëpinë time ky mendim më ngushëlloi gjatë gjithë natës. Në agim babai më doli në ëndërr; fytyra e tij shkëlqente, e palëvizshme, plot ëmbëlsi. Qëndronte në këmbë përpara meje, i tejdukshëm sikur ishte re, mes një lëndine të gjelbër, shumë të madhe. Ndërkohë që e shikoja dhe hapja me gëzim gojën për t'i thënë fjalën e dashur që nuk ia kisha thënë kurrë gjatë kohës që ishte gjallë, fryu një puhizë e lehtë - ishte puhizë apo frymëmarrja ime - reja lëvizi, u rrallua, humbi formën njerëzore dhe u shpërnda mbi bar si brymë.

Kur u zgjova, dielli mbulonte krevatin tim dhe kur u mbështeta në bërryla, pashë nga dritarja detin që buzëqeshte dhe i gëzohej diellit.

Çdo mëngjes bota rigjen virgjërinë e saj dhe duket sikur sapo ka dalë nga duart e Zotit. Ajo nuk ka kujtesë, prandaj fytyra e saj nuk ka rrudha, asaj nuk i kujtohet për atë që ka ndodhur një ditë më parë e nuk shqetësohet për të nesërmen: ajo jeton çastin, sikur të ishte i përjetshëm. Nuk njeh tjetër kohë, përpara dhe pas çastit nuk ekziston veç Hiçi.

U ula te dritarja për ta shijuar detin plotësisht dhe u përkula mbi fletën e bardhë. Nuk ishte fletë e bardhë, ishte një pasqyrë ku shihja fytyrën time. E dija se çfarëdo që të shkruaja do të ishte një rrëfim. Ai ishte çasti vendimtar i Gjykimit të fundit. Zemra qëndron në këmbë përpara Gjykatësit të padukshëm dhe nis të thërrasë pa turp mëkatet e saj; Kam vjedhur, vrarë, gënjyer, dëshiruar gruan e tjetrit, kam krijuar një grumbull zotash, i kam adhuruar, i kam shkatërruar, kam krijuar të tjerë. Mora guximin e tepëruar dhe desha të tejkaloja njeriun dhe të bëja atë që ti nuk munde ose nuk deshe ta bëje. U bashkova me të gjitha forcat e dritës ose të errësirës që kisha në dispozicion, për të të rrëzuar nga froni, për t'u ulur në vendin tënd për të bërë që në botë të mbretërojë një rregull i ri - më pak padrejtësi dhe

uri, një fuqi me zë të ëmbël, një dashuri më luftarake.

Ndjeja brenda meje një zemër që thërriste; ajo kishte shumë qortime për t'i bërë Zotit, nuk ishte dakord me atë, kishte ardhur koha që t'i bënte një raport dhe ti thoshte pa dredhi indinjatën dhe dhimbjen e saj. Vitet kalonin, ecja dhe unë bashkë me ta, nuk duhej që toka të ma mbyllte gojën para se të flisja. Çdo njeri ka një klithmë, të cilën e lëshon para se të vdesë, Klithmën e tij; duhet nxituar që të kesh kohë ta lëshosh.

Kjo klithmë mund të shpërndahet në ajër dhe mund të mos gjendet as në tokë dhe as në qiell ndonjë vesh që ta dëgjojë. Pak rëndësi ka. Ti nuk je dash, por je njeri; dhe një njeri mund të flasë e të klithë. Klith, pra!

Mos ji frikacak, - i thosha vetes, mos mendo se meqënëse je kafshë kalimtare, nuk mund të ndërhysh në qeverisjen e botës. Sikur ti të njihje forcën tënde, do t'i kishe kapërcyer tashmë kufijtë njerëzorë.

SHIKIMI KRETAN

Gjatë kohës që krijon, provon vështirësitë e gruas që ushqen një djalë me gjoks. Unë nuk mund të shihja asnjeri, zhurma më e vogël më trondiste gjithë trupin; sikur Apoloni, më kishte rjepur lëkurën dhe nervat e ngelura të zbuluara ishin plagosur nga kontakti me ajrin.

Vargjet e zhurmshëm prej shtatëmbëdhjetë këmbësh detare, rrokulliseshin duke ndjekur njëri-tjetrin dhe vendoseshin mbi letër. Jetoja, pa lëvizur, provat dhe trimëritë e Uliksit. Ai ishte nisur për udhëtimin e madh, udhëtimin pa kthim: Ishulli i tij i vogël, gruaja, djali i vogël e plot vullnet nuk i mjaftonin më. Ai iku prej andej për gjithmonë, kaloi nëpër Spartë, çoi Helenën, së cilës i zihej fryma në ekzistencën e saj të mjerë, e çoi në Kretë, u përlesh me barbarët, dogji pallatet e rëna nga pushteti; ai vuante, ishulli i madh mbretëror ishte shumë i vogël për të, ai u nis përsëri drejt jugut. Unë kisha hipur në anijen e tij dhe udhëtoja së bashku me të si një figurë e bashit. Shpirti më ishte bërë një glob tokësor i rrumbullaktë ku unë shënoja me bojë të kuqe portet që preknim dhe ata që na ngelnin akoma për të parë së andejmi, në kufijtë e tokës. Unë dija gjithçka, shikoja gjithçka, përcillja gjithçka; udhëtimi i tmerrshëm shkëlqente brenda meje, fare qartë. Por çfarë lufte ishte bërë për të arritur që vizioni të mbyllej brenda fjalëve, që asnjë pikë të mos derdhej jashtë!

Krijuesi lufton me një substancë të ashpër, të padukshme, më e lartë se ai. Ngadhënjimtari më i madh del fitimtar nga kjo luftë. Sepse gjithmonë sekreti ynë më i thellë, i vetmi që meriton të thuhet, ngelet i pashprehur. Ai nuk i nënshtrohet kurrë kornizës materiale të artit. Ne na zihet fryma në çdo fjalë: shikojmë një pemë në lule, një erë, një femër, yllin e mëgjesit dhe thërresim: Ah! Askush tjetër nuk është i aftë të përqafojë gëzimin tonë, kur ne duam, duke e analizuar, ta transformojmë atë. Ah! Në një mendim, në një vepër arti, për t'ua komunikuar njerëzve dhe dijetarëve të rrënojës sonë. E megjithatë, sa keq, nuk ekziston asnjë mënyrë tjetër për t'u komunikuar njerëzve të vetmen gjë që brenda nesh është e pavdekëshme,

atë: Ah!... Fjalët, Fjalët! Për mua, sa keq, nuk ka shpëtim tjetër. Unë kam nën pushtetin tim vetëm njëzet e gjashtë ushtarë të vegjël plumbi, njëzet e gjashtë gërmat e alfabetit: unë do të shpall mobilizimin, do të ngre një ushtri, do të luftoj kundër vdekjes.

Unë e di mirë se nuk mund të triumfohet mbi vdekjen. Por ajo që përbën dinjitetin e njeriut, nuk është fitorja, është lufta për fitoren. Unë e di mirë çfarë është më e vështirë:

Nuk është pikërisht lufta për fitore. Gjë tjetër përbën dinjitetin e njeriut: të jetojë e të vdesë zotësisht pa pranuar asnjë shpërblim. Më në fund një parim i tretë, që është më i vështirë: bindja për të mos pranuar shpërblim, në vend që të na presë krahë e këmbë, duhet të na mbushë me gëzim, krenari e guxim.

Sa më shumë shkruaja, aq më shumë shihja se, pa e kuptuar, ndërsa përpiqesha t'i shmangia, dy fjalë dilnin vazhdimisht nën penën time dhe nuk dëshironin të zhdukeshin: fjala Zot dhe fjala Ngjitje. Ç'është Zoti? Një iluzion? Shpresa supreme? Apo pasiguria supreme? Gjatë shumë viteve unë kam luftuar pa mundur të marr vendim përfundimtar, as të gjej përgjigjen që duhej t'i jepja kësaj pyetjeje tragjike. Përgjigjja ndryshonte tek unë, sipas burrërisë, bindjes apo zhgënjimit që provonte shpirti im duke menduar për Zotin.

Nuk isha kurrë plotësisht i sigurt se në cilën nga ato sirena - Iluzionin, Shpresën, Sigurinë - unë duhej të vendosja shpirtin tim. Kënga e të trijave më magjepste njëlloj dhe kur e dëgjoja nuk dëshiroja të ecja më tej e të humbisja. Megjithatë ka një gjë për të cilën unë kam qenë i sigurt gjatë gjithë jetës: Nuk ka veç një rrugë dhe vetëm një që të çon te Zoti: Rruga e ngjitjes. Kurrë e tatëpjeta as e sheshta; shpesh kam hezituar, kam qenë i paaftë të dalloj qartë kuptimin që kishte ajo fjalë shumë endacake, shumë e fëlliqur për njerëzit, fjala Zot. Por unë kurrë nuk kam hezituar për të ditur cila rrugë të çonte drejt Zotit - dua të them drejt majës më të lartë të dëshirës pasionante të njerëzve.

Edhe diçka akoma. Janë tre krijesa të Zotit që vazhdimisht më kanë magjepsur dhe me të cilat unë kam provuar një ndjenjë të unitetit misterioz; ato më janë dukur vazhdimisht si simbole që shprehin marshimin e shpirtit tim: larva që bëhet flutur, peshku fluturues që hidhet e shkëputet nga uji, duke luftuar për të kapërcyer natyrën e tij dhe krimbi i mëndafshit që prodhon mëndafsh me tru-

pin e tij.

Unë nuk mund të them sa i gëzuar kam qenë kur pashë për herë të parë në varret e zbuluar të Mikenës një larvë gdhendur mbi një pllakë dhe mbi një tjetër një flutur; Ishin pa dyshim simbole të huazuara nga Kreta. Dëshira brengosëse e larvës për t'u bërë flutur, ka qenë gjithmonë për sytë e mi detyra më perandorake, por në të njëjtën kohë dhe më e ligjshme, e larvës dhe e njeriut. Në qoftë se Zoti ju krijon larvë, ju me luftën tuaj, bëhuni flutur.

Të njëjtin gëzim e të njëjtin emocion provova kur pashë, mbi afresket në Knosos, peshkun fluturues që kishte hapur krahët dhe fluturonte mbi det. Unë kisha provuar identitetin tim me stërgjyshërit më të largët; unë ndiqja besnikërisht gjurmët e tyre, mijëra vjet pas tyre dhe ndryshoja tokën e Kretës në krahë.

Një ditë në një ishull grek pashë - e pashë apo ëndërroja ta shihja - në një kishë të vogël fshati, një ikonë të virgjëreshës të cilën besnikët e kishin rrethuar me një kurorë gjembash ku ata kishin hedhur disa vezë krimbi mëndafshi. Vezët ishin çarë, larvat e mrekullueshme kishin dalë dhe gjatë disa ditëve ushqeheshin me gjethe mani. Ditën kur pashë ikonën, krimbat e mëndafshit e kishin përfunduar veprën e tyre, ato i kishin transformuar gjethet e manit, prej tyre kishin bërë mëndafsh dhe Virgjëresha ishte rrethuar nga fshikëza me një bardhësi verbuese. Ah, sikur të rrija përpara saj deri në pranverë, mendoja, për të parë fshikëzat të hapura dhe Nënën e Zotit të rrethuar nga fluturat e bardha e pushatake - "shpirtrat" siç i quan populli, me sytë e vegjël e të shndritshëm.

Një besimtar kristian më thoshte: - Ajo që ti ke parë nuk është ëndërr, ato nuk ishin më larva, ishim ne të tjerët, njerëzit. Kur ne të kemi përfunduar detyrën tonë mbi tokë, do të hyjmë në varr dhe do të dalim prej tij në formën e "shpirtit" që do të fluturojë përjetësisht rreth Nënës së Zotit. Zoti na ka dhënë sy për të parë, na ka dërguar larvat për të na treguar rrugën; zemra jonë turbullohet një çast duke parë ato simbole të shenjta e profetike, por ne nuk guxojmë të shkojmë më tej, të besojmë dhe të kthejmë shpresën në siguri.

Bota atë ditë lëshonte avuj dhe shkëlqente; Një stuhi e fortë shpërtheu gjatë natës dhe toka e thatë e pranoi ujin e qiellit dhe u

freskua. Në mëngjes, kur dola në dritare, qielli shkëlqente, i porsalarë, i gjithë i bardhë nën furrën diellore; toka dhe deti kundërmonin. Zemra ime, si një copë toke, u freskua dhe e pranoi si toka e thatë gjithë stuhinë e natës. Ndjeja një gëzim të madh që nuk përkulesha mbi letër për të transformuar botën atë ditë, në vargje prej shtatëmbëdhjetë këmbësh. Hapa portën e dola.

Ishte muaji gusht, më fisniku dhe më i dashuri, Zot i fortë shtëpie, ngarkuar me fruta të sheqerosura, që shëtit në kopshte e në vreshta, laturisur me llum vere, me mjekër të dyfishtë, me bark të fryrë si i shenjti Satir - na ruajtë vullneti i tij! - që qesh e mbledh përjetësisht verën e tij, Greqinë!

Ja zotët e vendit tonë, zotët tanë të vërtetë, zotët tanë të pavdekshëm. Si mundet, nën këtë dritë, përpara një deti të tillë, midis këtyre maleve, të kenë lindur e të shfaqen zotër të tjerë, zotër pa bark, pa gëzim, pa një degë hardhie mbi ballë? Si ka mundësi që djemtë dhe vajzat e Greqisë kanë besuar në një parajsë të ndryshme nga kjo parajsë e tokës?

Shëtisja nëpër vreshta; disa vajza me fytyra të mbuluara me napa të bardha, që të mos i digjte dielli, vilnin rrushin. Ato ngrinin kokën vetëm kur kalonte dikush dhe nuk mund të dalloje veç dy sy të mëdhenj, shumë të zes që shkëlqejnë në diell, mbushur me përfytyrim burrash.

E lashë trupin të shkonte nga të donte dhe gëzohesha tek shihja se nuk isha unë që e udhëhiqja por ishte ai që më udhëhiqte; unë kisha besim. Në dritën greke trupi nuk është më një lëndë e ashpër e qorre, ai përshkohet nga një shpirt i fuqishëm që e bën të ndrijë e të jetë i denjë, në qoftë se lihet i lirë, të marrë një vendim e të gjejë rrugën që duhet të ndjekë. E shpirti ndërsjelltas nuk është një ishull i padukshëm, bërë nga era: Ai ka marrë sigurinë dhe ngrohtësinë e një trupi, kënaqet me botën me një dëshirë të flaktë, sikur ajo ka gojë, hundë dhe duar për të përkëdhelur. Shpesh njeriu nuk ka forcë të ruajë të plotë anën njerëzore të tij, ai gjymtohet; ndonjëherë ai dëshiron të shkarkohet nga shpirti, ndonjëherë nga trupi; t'i bashkojë të dy menjëherë i duket e padurueshme. Por, atje, në Greqi, këto dy elemente gazmore e të përjetshme mund të shkrihen me njëri-tjetrin e të pajtohen, shpirti duke marrë diçka nga trupi, trupi duke marrë diçka nga shpirti. E, kështu, njeriu, mbi atë pamje hyjnore që ka

Greqia, mund të jetojë e të ecë i pacënuar.

Në rrugë gjendej një burim, unë ndalova atje. Një sapllak bronxi varej tek një zinxhir, unë kisha etje. Uji më freskoi deri te këmbët dhe kockat më kërcitën. U ndala një çast nën hijen e një ulliri; gjinkallat që këndonin të ngjeshura pas trungut të pemës, heshtën; Ato u trembën se panë gjinkallën gjigande. Kaluan dy fshatarë me gomerët e tyre ngarkuar me rrush. Ata vendosën dorën në gjoks e më përshëndetën: - Jetë të gjatë ty! Në mjekrën e tyre vareshin copa bërsie ndërsa rruga mbante era musht. Përballë meje shihja të ngriheshin, mbi lartësinë e mureve të zbardhur nga gëlqerja, selvi e kryqe; ishte oborri i qetë ku flinin të vdekurit, atje çlodhej babai im. Këputa një gjethe ulliri, e kalova nëpër dhëmbë, e kafshova, goja m'u mbush me hidhërim.

Lashë hijen e ullirit dhe u nisa me hap të shpejtë; atëherë pashë se ku po më çonte trupi: Drejt stërgjyshërve, me sy të mëdhenj si bajame, me buzë të trasha e sensuale, me shtat të lartë.

Unë besoj se njeriu nuk mund të provojë një tmerr të shenjtë më legjitim e as më të thellë, se ai që mund të provojë kur shkel tokën ku prehen stërgjyshërit e tij, rrënjët e tij. Këmbët tuaja, atëherë, lëshojnë rrënjë që zbresin brenda në tokë e kërkojnë të bashkohen me ta, me rrënjët e mëdha e të pavdekshme të të vdekurve tuaj. Atëherë, aroma e tokës dhe e kamomilit, që të djeg grykën, mbush trupin tuaj me ndjenjën e bindjes dhe të qetësisë ndaj ligjeve ose më mirë, në qoftëse fruti i ëmbël i vdekjes nuk është pjekur akoma tek ju, ju acaroheni, revoltoheni, nuk e pranoni të jeni të privuar aq herët nga drita, nga torturat e mëdha të jetës e të luftës. Atëherë ju ecni me nxitim, me hapa të mëdhenj mbi këtë tokë bërë nga palca e kocka e stërgjyshërve tuaj, më parë se këmbët tuaja të kenë hedhur rrënjë dhe dilni jashtë përsëri, në palestrën e shenjtë, në dritë.

Ajo ishte veçanërisht e pasur, e unë nuk arrij ta analizoj, e mbrujtur nga jeta dhe vdekja, emocioni që provoja duke shëtitur mbi tokën antike të Knososit ishte shumë i madh. Ato nuk ishin trishtimi e vdekja, as paqja. Urdhëra të ashpër dilnin nga buzët e tretura, atje thellë nën tokë, e unë ndjeja se të vdekurit vareshin si një zinxhir i gjatë te këmbët e mia, jo për të më zbritur në hijen e tyre të freskët, po për t'u kacavjerrë tek unë për të dalë në dritë e për të nisur luftën. E si një gëzim e etje e pashuar, demat e gjallë që bulurijnë nëpër ku-

llotat e botës së sipërme, aroma e barit, era e kripur e detit, të gjitha këto, që prej mijëvjeçarësh shpojnë tej për tej koren e tokës dhe nuk i lënë të vdekurit të vdesin.

Shikoja garat me dema, pikturuar mbi mure, bukurinë dhe zhdërvjelltësinë e gruas, forcën e sigurt të burrit, me çfarë syri të patrembur ndesheshin ata me demin e luanin me të. Ata nuk e vrisnin demin, si bënin në rajonet lindore, sepse i pushtonte tmerri dhe nuk e duronin dot ta shihnin të vrarë, por luanin me të me respekt, me mirëkuptim, pa urrejtje. Ndoshta me mirënjohje: sepse ajo luftë e shenjtë me demin mbrehte forcat e kretianëve, zhvillonte shkathtësinë dhe zbukuronte trupin, saktësinë e zjarrtë të veprimeve, forcimin e vullnetit e të burrërisë, aq të vështira për t'u arritur e aq të domosdoshme për tu ndeshur pa u pushtuar nga tmerri i fuqisë së kafshës. Kështu, kretasit, e kanë kthyer tmerrin në një lojë fisnike, ku virtyti i njeriut, në kontakt direkt me të gjithëfuqishmin absurd, rezistonte e triumfonte. Ai triumfonte pa mohuar demin sepse atë nuk e konsideronte si armik por si bashkëpunëtor, pa të cilin trupi i tij nuk do të ishte bërë aq i shkathët, aq i fuqishëm, e shpirti aq burrëror.

Sigurisht, për të patur forcë t'i rezistosh shikimit të kafshës e të luash atë lojë të rrezikshme, duhet një përgatitje psikike e shpirtërore; kur ta kesh arritur atë përgatitje, dhe të kesh hyrë në botën e lojës, veprimet bëhen të thjeshta, të sigurta, syri sodit pa u tmerruar nga tmerri.

Ja cila qe, mendoja, duke parë pikturat mbi mure, lufta shekullore midis njeriut e demit - që sot e quajmë Zot - Ja ç'ishte shikimi kretian.

Papritur, një përgjigje pushtoi mendjen time - por jo vetëm mendjen por edhe zemrën. Ja ç'kërkoja, ja ç'doja: Ishte ai shikim kretian që unë duhej të vendosja në sytë e Uliksit tim. Epoka jonë është mizore; Demi, forcat e errëta e nëntokësore janë çliruar, korja e tokës po çahet. Mirësjellja, harmonia, ekuilibri, kënaqësia e të jetuarit, lumturia, po aq sa gëzimet dhe virtytet të cilave ne duhet të kemi guxim t'u themi lamtumirë, ju përkasin epokave të tjera, të kaluara ose të ardhme. Çdo epokë ka fytyrën e saj; fytyra e epokës sonë është mizore, shpirtrat e thyeshëm nuk guxojnë ta shohin në sy.

Uliksi, i cili lundronte mbi vargjet që shkruaja, duhej ta sodiste me këtë sy greminën; pa u trembur, jo pa shpresë, por edhe me guxim: të qëndronte në këmbë në buzë të humnerës.

Që prej asaj dite, ditës së shikimit kretian, siç e kam quajtur

unë, jeta ime ndryshoi; shpirti im kishte kuptuar ku duhej të vendosej dhe si duhej të shikonte. Problemet mizore që më torturonin ishin qetësuar, kishin filluar të buzëqeshnin, dukej se pranvera kishte arrdhur e, si gjembat në pranverë, problemet mizore ishin mbuluar me lule. Rini e vonuar, e papritur. Unë pra isha si kinezi antik, plak i moshuar që në lindje, me një mjekër të bardhë, që sa më shumë vite kalonin ajo bëhej gri, pastaj dalëngadalë e zezë e më në fund rafare, për të lejuar të dilte mbi faqet e mia një push i butë adoleshenti.

Rinia ime kishte qenë vetëm ankth, ëndërr e keqe e pikëpyetje, mosha e burrit veç përgjigje e dështuar; shikoja yjet, njerëzit, idetë, çfarë kaosi! Çfarë ankthi të kërkoje Zotin midis tyre, zogun blu me kthetra të kuqe! Nisja një rrugë, e ndiqja deri në krye, dhe gjeja një greminë; kthehesha nga kisha shkuar i tmerruar, merrja një rrugë tjetër, për të gjetur përsëri në krye një greminë; fillonte arratia, përsëri udhëtimi, papritur shikoja, hapur përpara meje të njëjtën greminë. Gjithë rrugët e arsyes çonin te gremina. Tmerr e shpresë: ndërmjet atyre dy poleve rrotullohej në boshllëk rinia ime dhe mosha e pjekur. Por ja, në pleqëri, qëndroja në këmbë përpara greminës, i qetë, pa frikë; nuk arratisesha më, nuk mposhtesha më. Ose më mirë, jo unë, por Uliksi që krijoja. Unë krijoja një Uliks që përballej dobët me greminën, e duke krijuar atë unë përpiqesha t'i ngjaja. Unë krijoja vetveten. I besoja atij Ulisi, gjithë pasionet e mia; ai ishte midhja ku unë gërryeja që të dilte prej andej njeriu i ardhshëm. Gjithçka që kisha dëshiruar por pa e realizuar, ai do ta realizonte; ai ishte magjia që do të magjepste dhe do të kapte forcat e shndritshme ose të errëta që do të krijonin të ardhmen. Mjaftonte t'i besoje, që ai të merrte jetë. Ai ishte Modeli. Përgjegjësia e krijuesit është e madhe: Ai hap një rrugë që mund të tentojë të ardhmen e të peshojë shumë në përcaktimin e saj.

Shikoja detin kretian, dallgët e lavdishme ngriheshin lart, shkëlqenin për një çast në diell pastaj hidheshin për të vdekur në një pllaquritje mbi zallin e bregut. Unë e ndjeja se gjaku ndiqte ritmin e tyre, linte zemrën dhe shpërndahej deri në majë të gishtave, deri në rrënjë të flokëve, e unë bëhesha oqean, një udhëtim i pafund, aventura të largëta, kënga krenare dhe e pashpresë që lundronte. Në majë të këngës një kapuç marinari, nën këtë kapuç një ballë i ashpër, i përcëlluar nga dielli, dy sy të zes, dy buzë të plasaritura nga stërkalat; më po-

shtë dy duar të mëdha të zeshkëta që mbanin fort shufrën e hekurt.

Atij i zihej fryma, të dyve na zihej fryma në atdheun e tij tepër të ngushtë. Ne kishim zgjedhur shpirtrat më të pa shtruar të ishullit, kishim marrë nga shtëpitë gjithçka mundëm, i ngarkuam mbi një anije dhe u nisëm. Për ku? Do të frynte era, që do të na tregonte rrugën. Drejt Jugut! Drejt Helenës që yllëzonte mbi brigjet e Eurotasit që edhe asaj i zihej fryma, në sigurinë, virtytin e mirëqënien. Drejt ishullit të madh mbretëror, Kretës, që tretej, sepse zotërinjtë e saj nuk kishin më forca, që ngrinte krahët në mes të detit dhe thërriste barbarët që t'i jepnin fëmijë. Drejt Afrikës, drejt kufijve të tokës, drejt borërave të përjetshme, drejt vdekjes!

Në fillim zogu blu me kthetra të kuqe fluturonte përpara nesh, por shpejt u lodh, ne e lamë prapa por ngelëm pa pilot, në mes të hapësirës së zbrazët, të lirë. Herë pas here shpirtra të mëdhenj të pavdekshëm kapeshin te litarët e anijes sonë dhe këndonin për të na magjepsur, por ne shpërthenim në të qeshura, ata trëmbeshin e zhdukeshin. Herë pas here dëgjonim të dilte nga thellësitë e detit një klithmë e tmerrshme: - Ndaloni! Ku shkoni? Kaq mjafton! Ne përkuleshim mbi parmakë dhe u thërrisnim: - Jo, jo, nuk mjafton; pushoni! Një mbrëmje, duke u rrokullisur si lëmsh, erdhi në bash, një burrë, veshur si ne, me lëkurë dhelpre, me një kapuç me majë, me mjekër të bardhë, krahët dhe fytyra e të cilit kishin plagë të përthara; na buzëqeshi me qetësi - ishte vdekja. Ne po kuptonim se udhëtimit tonë po i vinte fundi.

Ishim shtrirë me shpinë mbi kuvertën e anijes, me sytë mbyllur dhe pamë: mbi tokat e mbi detet ku kishim kaluar, mbi njerëzit që kishim takuar, femrat që kishim përqafuar, mbi tokë, ujë e zjarr e mbi mish kishte një tjetër udhëtim, anija jonë ishte bërë një re e madhe, tokat, detet dhe njerëzit ishin fije mëndafshi dalë nga trupi ynë... Sipër, në katin më të lartë, anija jonë prej reje ishte zhdukur, fijet tona të mëndafshta ishin tretur, fantazmat e botës ishin zhdukur; në katin më të lartë qëndronte një diell më i zi se vetë e zeza, memec, shurdh e i palvizshëm. "Ky duhet të jetë Zoti, thamë me veten tonë, ky duhet të jetë Zoti." Tentuam të ngrinim duart për ta shpëtuar, por nuk mundeshim.

Ndërsa mbi brigjet e Kretës, unë shkruaja këtë odise, fuqitë e ferrit përgatisnin luftën e dytë të madhe, një erë çmendurie frynte

mbi racën njerëzore, themelet e tokës tronditeshin, ndërsa unë, i përkulur, dëgjoja zhurmën që bënin dallgët, njerëzit dhe fuqitë e ferrit, mbaja shpirtin me të gjitha forcat, që të mos më kapte tmerri, përpiqesha të merrja me mend e të mashtroja, përtej masakrave e lotëve, përtej majmunit bashkëkohës, njeriun. Ai nuk ishte akoma, veç një fantazmë që planeronte në ajër por unë e ndjeja se, përkulur siç isha duke shkruajtur, i shtija gjakun tim, ndërsa unë boshatisesha ai mbushej, trupi im pak nga pak forcohej.

Kisha hyrë në një ëndërr të thellë; kati i poshtëm i së vërtetës, kati i fortë që mbështetej mbi tokë, ishte zhdukur e valëvitej në ajër, si flakë mbi të cilin do të frynte një erë e fortë: kati i sipërm i së vërtetës, shpirti i njeriut.

Punoja gjithë ditën, flija gjithë natën. Gjatë gjithë jetës sime nuk kam mundur të punoj natën; Unë jam si akrepat diellorë: sine sole sileo - pa diell unë hesht. Nata, me ëndërrat, qetësinë dhe portat e errëta që hapen tek unë më përgatit punën e ditës që vjen.

Koha për mua është bërë e mira supreme. Kur shoh njerëzit që shëtisin, bredhin, duke harxhuar kohën me muhabete të kota, më kap dëshira të shtrij dorën në qoshe të rrugës si lypës:

- Më jepni një lëmoshë, njerëz të mirë, më jepni pak nga koha që ju humbisni, një orë, dy orë, sa të doni ju.

Dita po perëndonte. Unë kryqëzova krahët, mbështeta pjesën e mbrapme të kokës pas murit dhe shikoja diellin që perëndonte. Nuk ndieja as trishtim e as argëtim; vetëm një lehtësim, sikur thellësia e qënies sime ishte boshatisur, sikur gjaku im ishte derdhur, vetja më dukej si mbulesa e fortë dhe e tejdukshme që lejon të lindë gjinkalla mbi trungun e ullirit. Një barkë e vogël me vela të kuqe kthehej nga peshkimi; unë dalloja peshqit që shkëlqenin mbi kuvertë. Një ishull i vogël përballë meje ishte mbuluar me vjollca, në majë të malit kishëza e vetmuar e Krishtit me kryq, shkëlqente në bardhësinë e saj si lëvozhgë veze; drita ishte mbërthyer mbi muret e zbardhur nga gëlqerja dhe nuk donte të largohej...

Një zhurmë zalli u dëgjua në të djathtën time; dikush ecte me nxitim mbi zallin e bregut dhe afrohej për tek unë. Unë u ktheva nga vinte ai. Në muzgun ngjyrë vjollcë pashë të ndrijë një kapuç

me majë e një erë e fortë djerse njerëzore u përhap në ajër. U largova pak mbi ledhin ku isha ulur, për t'i lënë vend edhe atij të ulej pranë meje.

- Mirë se erdhe, i them, po të prisja.

Ai u përkul, mori nga zalli një algë që kishte nxjerrë deti dhe e vendosi midis buzëve.

- Faleminderit që më ke pritur.

Nata blu, magjepsëse zbriste nga qielli, ngrihej nga deti, e ndërsa prapa nesh, mbi tokë, cicërinin nëpër ullishte zogjtë e natës. Në qetësinë e errët, kumbuan të pavdekëshme, dy thirrjet e mëdha të dashurisë e të urisë. Insektet, të strukur në fund të barishteve, kishin edhe ato uri e nevojë për dashuri, një ankim i madh ngrihej nga toka.

Ne heshtnim. Të dy dëgjonim zemrat që na rrihnin qetësisht: dukej sikur gjithë pasionet e natës, gjithë ato klithma të përziera, duke kaluar nga fundi i qënies sonë, ishin bërë harmoni.

Ishte një gëzim dhe një ëmbëlsi aq e madhe sa lotët u përzien me ngjyrën e syve të mi. fjalë të vjetra ngjiteshin fshehtas nga thellësia e qënies sime dhe udhëtonin mbi buzët e mia:

Lindja dhe vdekja nuk bëjnë veç një fëmijë
vuajtja dhe kënaqësia e zemrës është,
dhe këto nuk bëjnë veç një
e zemrës është tungjatjeta dhe lamtumira!

U ktheva, në të djathtë, nga shoku im i qetë:

- Kapedan Uliks, - i thashë, - nisemi? Koha, m'u duk se ndaloi, sikur u bë përjetësi, vendi u mbështoll brenda grushtit tim si pergamen i vjetër me pamje tokash e detesh.

E lehtësimi, ajo që ne quajmë lehtësim - që ne shtrijmë duart drejt qiellit për ta kapur - u bë një fije borziloku në veshin tim... Nuk e ndjen ti kundërmimin e tij në ajër?

Ti lehtësohesh nga lehtësimi, thotë ai; zëri i tij ishte i ashpër, erërat e detit ia kishin bërë të çjerrë. Ti lehtësohesh nga lehtësimi, kjo është trimëria më e madhe e njeriut. E ke përfunduar kohën tënde të skllavërisë në shpresë e në frikë, ti je përkulur mbi greminë, ke parë imazhin e botës të përmbysur dhe nuk ke patur frikë. Ne je-mi përkulur të dy mbi greminë, shokë të mirë, e nuk kemi patur frikë. Të kujtohet?

Udhëtimi i tmerrshëm shfaqet në mendjen time, deti gjëmoi në të dy anët e kokës, kujtesa u fry dhe unë pashë, kam parë me të njëjtin gëzim se si ishim ndarë nga djemtë, nga gruaja, nga mirëqënia e atdheu, se si kemi lënë larg prapa nesh virtytin dhe të vërtetën, si kemi kaluar, pa u dëmtuar bukurinë tonë, nëpërmjet tmerreve të Zotit e kemi fituar; se si kemi vendosur urat mbi humnera.

- Ky udhëtim ishte i mirë, - i thashë duke prekur gjurin e shokut tim me emocion; tashmë ne kemi arritur.

- Kemi arritur? - thotë ai i befasuar. Ç'do të thotë kjo; Ne kemi arritur?

- E di unë. Kjo do të thotë: Tani ne nisemi.

- Po. Tani ne nisemi. Pa vaporë, pa det, pa trup.

- Të lirë.

Të lirë nga liria. Matanë. Më tej?

Ku pra? Mendja ime nuk mund ta kapë.

- Më tej lirisë, shoku im, guxim!

- Kam frikë, hezitoj të të ndjek. Forcat e mia deri këtu arrijnë; më tej unë nuk mundem.

- Mirë baba. Ti e ke kryer detyrën tënde: ti ke bërë një djalë më të madh se veten. Qëndro pra këtu si far. Unë, do të shkoj më larg.

Ai u çua, shtrëngoi rripin, hodhi shikimin tej në thellësi të natës. Një yll u shkëput e rrodhi si lot mbi fytyrën e natës. Nga toka u ngrit era dhe në mes të qetësisë, dallgët hingëllinin si kuajt kur zgjohen. Ai më zgjati dorën.

- Ik ti! - thërrisja, sikur ishte shpirti im që ikte.

Ai u përkul, puthi supin tim të djathtë, supin e majtë, pastaj dy sytë e mi. buzët e tij më mbuluan me kripë. Buzëqeshi. Zëri i tij u ngrit e ai shtoi:

- Të kujtohet asketi që për dyzet vjet kishte kërkuar Zotin pa mundur ta gjente? Një hije ngrihej midis tij dhe Zotit dhe e pengonte ta shihte. Një mëngjes ai e kuptoi: Ishte një gëzof i vjetër që ai e donte aq shumë, që e pengonte. E hodhi dhe menjëherë ai pa Zotin përpara tij. Ti je gëzofi im i vjetër, shoku im, lamtumirë!

Unë u tremba. M'u duk se fjalët e tij të fundit vinin prej së largu, nga bregu tjetër. U ngrita me një herë, kërkoja verbtazi në errësirë. Askush.

El - GREKOS

Gjysh i dashur të puth dorën, të puth shpatullën tënde të djathtë, të puth shpatullën tënde të majtë. Rrëfimi im u krye; tani jep gjykimin tënd. Nuk të kam folur për detajet e jetës së përditshme, ato janë guaska të boshatisura që ti i ke hedhur në plehra, në greminë, atje i kam hedhur dhe unë. Hidhërimet e mëdha e të vogla, gëzimet e mëdha e të vogla, jeta herë më plagoste, herë më përkëdhelte, janë incidente banale të çdo dite; gjithë-këto më kanë lënë, ne i kemi lënë gjithashtu, nuk ia vlen mundimi të shohësh pas për t'i tërhequr nga gremina. Bota nuk do të humbasë asgjë, nëse shpirtrat që kam njohur qëndrojnë në harresë. Raportet që kam ruajtur me bashkëkohësit e mi nuk kanë patur një ndikim të madh në jetën time. Nuk i kam dashur shumë, qoftë sepse nuk i kam kuptuar, qoftë sepse i kam përçmuar, mbase edhe pse fati nuk më ka njohur me shumë prej tyre që do t'ia kishte vlejtur të duheshin. Megjithatë, nuk kam urryer njeri e nëse i kam bërë keq dikujt, ka qenë pa dashur. E kisha vendosur t'i çliroja nga rutina e mediokriteti, unë i kisha shtyrë pa patur parasysh forcat e tyre; Ata ishin harabela, doja t'i bëja shqiponja, ata u raskapitën. Vetëm të vdekurit e pavdekshëm, sirenat e mëdha, Krishti, Buda, Lenini më mëgjepsën; në fëmijërinë time, u jam ulur ndër këmbë për të dëgjuar këngën e tyre joshëse, plot dashuri, e gjatë gjithë jetës sime, kam luftuar për t'u çliruar nga këto sirena pa mohuar asnjë: për t'i bashkuar këto tre zëra të veçuar e për të bërë një harmoni.

Kam dashur gra: kam qenë i lumtur për këtë, kam gjetur në rrugën time gra të mrekullueshme, kurrë burrat, nuk më kanë ndihmuar në luftën time aq sa këto gra. E më shumë se të gjitha e fundit. Por unë hedh mbi trupat e dashur pëlhurën që kanë hedhur fëmijët e Noes mbi babanë e dehur. E kam dashur, ti gjithashtu e ke dashur, gjyshi im, këtë mit të stërgjyshërve tanë që flet për erosin e psikikën. Është një turp i madh, një rrezik i madh të bësh dritë, të zhdukësh

errësirën për të parë dy trupa të përqafuar. Ti e dije, kush e fshehu në hijen hyjnore të dashurisë shoqen tënde të dashur, Jeronima de las Kuevas; bëra të njëjtën gjë me Jeronimën time, shoqen e fortë të luftës, ngushëllimin e madh, burimin e freskët në shkretëtirën jonjerëzore që përshkojmë. Varfëria, skamja, kretasit kanë të drejtë ta thonë, varfëria, skamja nuk janë asgjë, mjaft të kesh një grua të mirë. Ne që të dy kishim gra të mira, e jotja quhej Jeronima, e imja Helena. Çfarë shansi ishte ky, gjyshi im! Që atëherë, kur i pamë, a nuk kemi thënë që të dy me veten tonë: - Qoftë bekuar ora kur lindëm. Por gratë, edhe ato më të dashurat, nuk na kanë kuptuar. Ne nuk kemi ndjekur rrugën e tyre mbjellë me lule, ne i kemi marrë me vete, ose më qartë ne nuk i kemi marrë, janë ato që na kanë ndjekur me dëshirën e tyre në ngjitjen tonë, shoqet trimëresha.

Ne nuk kemi gjuajtur veçse një gjë gjatë gjithë jetës sonë, një vizion të besueshëm, gjakatar, të pashkatërrueshëm, substancën. Sa kupa hidhërimi zotët e njerëzit na kanë dhënë për të, sa gjak, djersë e lot kemi derdhur! Gjatë gjithë jetës sonë një demon - ishte një demon apo një engjëll? - Nuk na ka lënë të gjejmë një përgjigje; ai përkulej, ngjishej pas nesh e na frynte në vesh: - E kotë! E kotë! E kotë! Ai besonte se do t'na priste duar e këmbë por ne tundnim kokën, e dëbonim dhe shtrëngonim dhëmbët: - Këtë duam ne! - i përgjigjeshim; nuk punojmë për një pagë, nuk duam të marrim çmimin e dhimbjes sone, luftojmë përtej shpresës, përtej Parajsës, në boshllëk. Kjo substancë ka marrë shumë emra; sa më shumë e ndjekim, aq më shumë ajo ndryshon pamjen - herë e quajmë shpresë e madhe, herë e bërë nga shpirti i njeriut, herë mrekulli e shkretëtirës e herë zog blu e liri. E nganjëherë ajo na shfaqej si një rreth perfekt në qendër të të cilit ishte zemra e njeriut e përreth imoraliteti; e ne i japim atij arbitrarisht një emër të ngarkuar me peshën e gjithë shpresave e të gjithë lotëve të tokës: Zot.

Gjithë njerëzit kanë tek ai, në zemrën e zemrës së tij, një qendër të fshehtë, rreth të cilës, rrotullohet universi; Ky revolucion sekret i jep unitet mendimit e veprimeve tona, na ndihmon të zbulojmë ose të krijojmë harmoninë e botës. Disa kanë dashuri, të tjerët etjen e njohjes, të tjerët mirësinë ose bukurinë; ose akoma pasionin për ar ose për pushtet: gjithë këtë, ata e sjellin dhe ia nënshtrojnë këtij pasioni qendror. Mjerë njeriu që nuk ndien në thellësi të vetes një mo-

nark absolut që e drejton: jeta e tij, anarkike dhe e shthurur përhapet nga fryn era. Gjysh, qendra jonë, që sölli në vorbull gjithë botën e dukshme, përpiqet ta ngrejë në katin më të lartë të guximit e të përgjegjësisë, ja: është lufta me Zotin. Çfarë është Zoti?

Kulmi i egër, i paafrueshëm i shpirtit njerëzor që jemi gati gjithmonë të arrijmë e që na largohet pa pushim me një kërcim e ngjitet më lart.

- A është parë ndonjë të luftojë me Zotin? - më pyetën një ditë njerëzit, me ironi.

- Me kë tjetër doni ju të luftojmë? - iu përgjigja atyre.

E vërtetë, me kë tjetër?

Ja përse, gjithë jeta jonë, gjysh, ishte një ngjitje, një greminë, katastrofë shkretëtire. Ne u nisëm me shumë shokë të luftës, me shumë ide, një shpurë e madhe; por sa më shumë i ngjiteshim të përpjetës e maja zhvendosej e largohej, aq më shumë idetë, shpresat, shokët e luftës largoheshin prej nesh. Ata mezi merrnin frymë, nuk donin të ngjiteshin më lart. E ne qëndronim vetëm, sytë fiksuar mbi majën që zhvendosej. Nëse ne ngjitemi, nuk është e thënë që ne të kemi parandjenjën, as edhe naivitetin të besojmë që një ditë maja të ndalojë e që ne ta prekim; madje as që do ta gjejmë atje lart, mirësinë, përshëndetjen, Parajsën; sikur kurrë ne të mos ta prekim, ne ngjitemi sepse vetë Maja është mirësia, përshëndetja e Parajsës.

E admiroj shpirtin e njeriut; asnjë pushtet në qiell, as mbi tokë nuk është aq i madh; ne mbajmë me vete gjithë pushtetin e nuk e dimë; e shtypim, e dërrmojmë shpirtin tonë nën një grumbull mishi e dhjami pa kuptuar se prej çfarë jemi e çfarë mundim të bëjmë. Çfarë pushteti tjetër në botë mund të shohë në fytyrë, pa u verbuar, fillimin dhe fundin e botës? Në fillim, as Fjala, as Veprimi, nuk ishin si shpallje shpirtrash të shtypur nën mish e dhjam; as dora e Krijuesit plot me deltinën e jetës: në fillim ishte Zjarri, e në fund nuk është pavdekshmëria, as shpërblimi Ferr ose Parajsë: në fund është Zjarri. Është mes këtyre dy zjarreve që ne ecim të dy, gjysh i dashur; ne përpiqemi, duke ndjekur urdhërin e Zjarrit, duke punuar me të, të bëjmë nga mishi një zjarr, e bëjnë edhe nga mendimi një zjarr; gjithashtu një zjarr nga shpresa e dëshpërimi, dhe nga nderi e nga turpi, nga lavdia. Ti ecje para meje, unë të ndiqja. Ishe ti që më mësove se zjarri që është tek ne, në kundërshtim me ligjet e mishit,

mund të ngazëllehet pa pushim gjatë viteve. Ja përse të shihja e të admiroja: sa më shumë që ti refuzoje të bëheshe më i egër, sa më shumë që i afroheshe greminës zemra jote bëhej më e fortë. E ti hidhje shenjtorët, shenjtorët, zotërinjtë, murgjit, në poçin e vështrimit tënd, i formoje si metale, i pastroje nga ndryshku e stërholloje arin e pastër të shpirtit të tyre. Çfarë shpirti? Zjarrin - ti e mblidhje në furrën që na krijoi e në furrën që do na përpijë.

Të kujdesshmit na kanë akuzuar se u japim krahë të mëdhenj ëngjëjve e kemi guximin që duam të hedhim shigjetën tonë përtej kufijve të njeriut. Por nuk jemi ne që duam ta hedhim atë përtej kufijve; gjendet një demon në thellësinë tonë, që e quajmë Lucifer, që sjell dritën, dhe që na shtyn. Ishte ai që donte të kalonte kufijtë e njeriut për të shkuar ne s'e dimë ku - ne dimë veç një gjë: ne shkonim më lart. Si shën Gjergji që mbante mbi vithet e kalit të tij princeshën e vogël e donte të përpinte dragoin, ky demon, mbante jetën që donte ta përpinte, dhe që ishte në rrezik tek çdo njeri; ai donte të largohej, të ikte. Kështu majamunëve u është dashur të ndiejnë në vetvete vrullin e tërë universit që i shtynte të hiqnin dorë së ulërituri nga dhimbja, të mbaheshin mbi këmbët e tyre të fundit e të fërkonin dy copa druri, nën talljet e majmunëve të tjerë, për të nxjerrë një shkëndijë. Ja si lindi pitenkatropi, ja si lindi njeriu. Ja sesi përsëri tërë kjo forcë e pamposhtur, dhe e pamëshirshme hedh shkelma në kraharorin tonë, gjysh, për t'u çliruar nga njeriu, për të ikur përtej. Ja përse ne kemi qenë kaq të përçarë, ja përse kemi vuajtur kaq shumë mes njerëzve: nuk do të shkojnë më larg se kaq, bërtisnin ata, pritini krahët dhe mos e hidhni shigjetën tuaj aq larg; nuk e besoni ju Zotin? Nuk e dëgjoni Zotin? Nuk dëgjoni arsye? Uluni. Ndërsa ne, nuk flisnim, por punonim; punonim krahët, tendosnim harkun. Ne çirrnim thellësitë tona që të kalonte demoni.

- Unë nuk i dua shenjtët që vizaton ti, as ëngjëjt e tu, Toledas. Ata nuk ju shtyjnë të luteni por të admironi: bukuria ndërfutet si një pengesë mes Zotit e shpirtit tonë.

Ti qeshe:

- Por unë nuk dua të bëj njerëzit të luten. Kush të tha që dua t'i bëj njerëzit të luten? - mendove ti, dhe asgjë tjetër nuk the.

E një tjetër, një piktor nga miqtë e tu, kur pa "Toledon në stuhi", tundi kokën e të tha: Ti shkel ligjet, nuk është më art; ti del nga kufijtë e arsyes, ti hyn në çmenduri.

Ndërsa ti, - Si ja bëre që mos të të interesonte? - Kush ka thënë që nuk bëj vepra arti? - iu përgjigje; - unë nuk bëj vepra arti, nuk më merakos bukuria; arsyeja është shumë e ngushtë për mua, ligji gjithashtu. Si peshku fluturues unë vërsulem jashtë ujërave të qeta e hyj në ajër më të qetë, mbushur me gjethe. Ti ruajte një çast qetësinë, e pe Toledon që kishe pikturuar, mbështjellë me re të zeza, pa shkëlqim - kullotat, kishat, pallatet që ishin çliruar nga trupat e tyre prej guri, që shfaqeshin në thellësi të natës së zezë, pasqyra të mbuluara të një shkëlqimi të shqetësuar. Ti i shikoje e flegrat e hundës të regëtinin, nuhasnin një aromë squfuri. Ti heshte mendueshëm, pastaj në një çast:

- Çfarë demoni gjendet tek unë? - thirre. Kush i vuri zjarrin Toledos. Në të vërtetë unë nuhas një ajër plot çmenduri e vdekje. Dua të them mbushur me liri.

Dhe ngule dhjetë thonjtë e tu në kraharorin tënd. Ti vuaje.

Vetëm një poet, pak rëndësi ka që ai ishte murg gjithashtu, at Hortensio Felix Paraviçino, mundi të kuptonte çmendurinë tënde hyjnore. Ai shihte hijet kërcënuese, shkëlqimet e shenjta, krahët e mëdhenj; shenjtët që kishin konsumuar trupat e tyre ishin shndërruar në pishtarë e digjeshin; ai mori një ditë dorën tënde zhgarravitur nga ngjyrat dhe e puthi.

- Ti bën të digjet bora, ti tejkalove natyrën dhe shpirti qëndron i pavendosur në admirimin e tij, e nuk di, kush është më e denjë, të jetosh si krijim i Zotit ose i tij, - tha ai, e në këto fjalë të fundit zëri i tij dridhej.

Ti dëgjoje, i qetë, fyerjet e lavdërimet, e qeshje; e nëse bëje shpesh sikur të interesonte, zemërimi nuk ishte veçse një stuhi sipërfaqësore mbi fytyrën tonë, thelbi i atit tënd qëndronte i palëvizshëm. Ti nuk kishe as shpresë, as frikë, as sqimë, sepse e dije të fshehtën e madhe. Njerëzit luftojnë me kokën ulur kundër dy elementëve të mëdhenj - ose dy fytyrave të Zotit: të Mirës dhe të Keqes. Më torollakët thonë: e Mira dhe e Keqja janë armiq; të tjerët ngjiten në një shkallë më lart e thonë: e Mira dhe e Keqja janë plotësuese. E të tjerë, përqafojnë me një shikim të përgjithshëm lojën e jetës e të vdekjes mbi këtë kore të tokës, të kënaqur nga harmonia dhe thonë: e Mira dhe e Keqja nuk janë veç Një. Por ne, gjysh, ne e njohim të fshehtën

e madhe. Ne e zbulojmë, edhe sikur askush të mos e besojë, se është më mirë të mos besohet; Njeriu është i dobët, ka nevojë për ngushëllim, e nëse do ta besojë këtë të fshehtë do t'i ketë krahët e këmbët të prera. Çfarë të fshehte? Ky Një-vetë nuk ekziston.

Një ditë shkova në shtëpinë tënde në Toledo, gjysh, për të parë shenjtët e tu, apostujt dhe zotërinjtë që ke vizatuar, si i kishe lehtësuar nga pesha e mishit, e përgatitur për t'u kthyer në flakë. S'kam parë kurrë flakë më përvëluese. Kështu, mendova fiton mbi mishin dhe shpëton nga shkatërrimi, jo këto këmbë, e këto duar prej argjili, as këta flokë bjond ose të zinj, por substanca e vlefshme që lufton në këtë shekull bakri e që ca e quajnë flakë e të tjerët shpirt.

Nëse do të ishe i veshur akoma me mishin tënd, gjyshi im, do të të kisha sjellë pak djathë të freskët, mjaltë e portokalle, nga Kreta: do të kisha sjellë violinistin e shquar Karidemos, me një gjethe borziloku në vesh, për të të kënduar tre strofat që ti pëlqeje aq shumë:

Shkoni, zgjidhni rrugën tuaj e të ndodh ç'të dojë.
S'ka rëndësi se vepra jote lëkundet ose përfundon!
Kur ti mendon për një punë, shko drejt e mos ki frikë;
Jepe rininë tënde, mos e kurse të ritë.
Unë jam djalë i rrufesë e nipi i bubullimës
Po të dua, jap e ndriçoj dhe sjell dëborën e stinës.

Por tashmë ti ishe shndërruar në flakë. Ku mund të të gjeja, si mund të të shihja, çfarë dhurate mund të sillja për të të kujtuar Kretën, për të të ngritur nga varri? Vetëm flaka mund të gjejë falje para teje. Ah, sikur të shndërrohesha në flakë për t'u bashkuar me ty!

Gjatë 37 vjetëve ti qëndrove hipur mbi këtë shkëmb të Toledos; gjatë 37 vjetëve të është dashur të shfaqesh mbi këtë tarracë ku unë gjendem tani, e të shohësh Tagetin e baltosur të rrokulliset nën harkun e dyfishtë të urës Alcantara, të zbrazet e të humbasë në det. Shpirti yt rrokullisej, së bashku me të dhe jeta jote, dhe shkonte të derdhej e të humbiste në vdekje. Thirrje të dhimbshme revolte ngriheshin nga thellësia e qënies sate. S'kam bërë asgjë akoma; asgjë s'kam bërë, mendoje e shtrëngoje grushtat; ti nuk psherëtije, zemëroheshe;

unë s'kam bërë gjë, çfarë mund të bëjë shpirti me pëlhurë e ngjyra? Nuk më leverdis të qëndroj ulur këtu, në fund të botës, të trazoj bojërat, të luaj me një furçë, të pikturoj shenjtorë e Krishtë në kryq, shpirti im nuk lehtësohet nga këto pamje, bota është shumë e ngushtë, jeta dhe Zoti janë shumë të ngushtë, m'u desh të merrja zjarrin - zjarrin, detin, erërat dhe gurët e të krijoj botën, ashtu siç e dua, në masën time!

Dielli perëndoi, çatitë e shtëpive ngjanin të praruara, lumi u errësua, ylli i natës u hodh nga lartësia e malit. Dritat ishin ndezur në shtëpinë tënde, plaka Maria Gomez, shërbëtorja jote besnike, shtroi tavolinën. Shoqja jote e dashur e gjumit dhe e pleqërisë, Jeronima, u afrua e të preku dorën shumë butësisht, për mos të të trembur.

- Ra nata, - të tha, nuk ke ngrënë, gjithë ditën ke punuar. S'ke mëshirë për trupin tënd? Hajde.

Por ti kishe pushuar së menduari për krijimin e botës, e ishe vërsulur drejt Kretës, s'e kishe dëgjuar zërin e butë, e as e kishe ndjerë dorën e bardhë. Ti ecje mbi malet e Kretës, nuk ishe as 20 vjeç, ndihej erë tymi, një shami e bardhë me thekë të gjatë shtrëngonte flokët e tu të zesë, mbi vesh kishe vënë një karafil Indie, e duke kënduar tri strofat e tua të preferuara, shkoje në Vrondisse, në manastirin e njohur, për të pikturuar *Dasma e Kanës*, që të kishte urdhëruar igumeni.

Shpirti yt ishte plot me ngjyrat, blunë e qiellit, të kuqen e gjakut, të gjelbërtën, nusja e dhëndri ishin ulur në krye, mbi frone të lartë ku ishte skalitur shqiponja me dy kokë; tavolina e drekës së dasmës ishte e shtruar, të ftuarit hanin e pinin, e këndonin këngë të gjalla dasme; Krishti kishte pirë dhe u ngrit. Mollëzat i ishin skuqur e ai pozonte mbi fronin e muzikantit një pjesë të artë.

Papritur, t'u duk sikur zëri i dashur të vinte nga larg, shumë larg, por ti megjithatë e dëgjove.

- Erdha, - u përgjigje dhe ndoqe duke qeshur, gruan, që përsëri, edhe një herë, zemërdhembshur, të kthente me këmbë në tokë. Por në shpirtin tënd ishin ngazëllyer *Dasma e Kanës*, kënga e violinës kretiane të buçiste, tavolina e përditëshme të ngjante me tavolinë dasme; ti kishe ftuar dy muzikantët që ishin në shërbimin tënd për të luajtur me lyth e kitarë, kur ti, dhëndri, do të haje, derisa ky ushqim i varfër të bëhej *Dasma e Kanës*. Dreka mbaroi, u ngrite

edhe ti gjithashtu - në shpirtin tënd, kujtoje tablonë që kishe pikturuar - dhe vendosje mbi ballin e muzikantëve, me një bujari prej zotërie të madh, dy dukatë të artë. - Sepse ti jetoje si zotëri i madh. Ti ishe një zotëri i madh. Ti shpenzoje pa numëruar, gjithë argjendin që fitoje nga arti yt.

Miq e armiq të qortonin e të akuzonin.

- Për çfarë të shërbejnë, - të thoshin, - 24 dhomat e shtëpisë sate, ç'i do, gjithë ata muzikantë përse nuk i ngarkon si gjithë bota pikturat e tua mbi supe e t'i çosh te kishat e manastirit për t'i shitur?

Të trajtonin si arrogant, përbuzës, origjinal, e nëse të thoshnin ndonjë fjalë për të të kundërshtuar ti merrje zjarr, e kur të pyesnin sa dukatë doje për një nga tablotë e tua, ti shpëtheje:

- Nuk janë në shitje, - thoshe, - s'janë për t'u blerë veprat e artit si këto të miat, se e tejkalojnë mundësinë e pagesës. Jua lë vetëm si garanci, e kur të më duhen, do t'ju kthej dukatët e do të marr pëlhurat e mia.

- Nga vjen ti? Përse ke ardhur në Toledo? Kush je ti? - të pyesnin gjykatësit.

- S'jam i detyruar të përgjigjem - i kundërshtove, - nuk do të përgjigjem.

Kur nuk të detyronin, ti vizatoje emrin tënd mbi tablotë e tua, me shkronja të mëdha, e poshtë, me krenari titullin: *Kretas*. Kur mbreti Filip, gjuhënepërka, ishte tmerruar duke parë shën Morisin që kishe pikturuar ti, kafshove buzët, nuk pranove të përuleshe, as të bëje lëshime, e more me vete inatin, krenarinë e artin tënd të paepur, e iu ngjite Toledos, qytetit të rrethuar nga flakët.

Çasti ishte i madh: mbi njërën pjatë të peshores një ndërgjegje e pacënuar, mbi tjetrën një pushtet, ky ishe ti, ndërgjegja e njeriut, që dole fitimtar. Kjo ndërgjegje mund të paraqitet para Zotit në ditën e Gjyqit të Fundit, ajo do të gjykohet, por edhe do të gjykojë. Sepse dinjitetin njerëzor, pastërtinë, trimërinë, Zoti vetë i frikëson. Më fal, gjyshi im, s'u përmbajta dot. Pëlqeja aq shumë, me aq krenari, çastin plot madhështi ku, me kokën lart, ti kishe kapërcyer pragun e *Eskyrial-it** nga ishe nisur, duke lënë me neveri pas teje, të mirat e vogla e të mëdha të botës, të cilat unë kisha guxuar t'i fiksoja në

---

* *të mësimit për përdorimin e shpatës, ushtës etj*

vargje e në rima, prej nga nuk mund të dilnin më. Kështu, shkrova blatimin tim me shkronja të kuqe e të zeza dhe e vara në ajër: *Canto Greko*.

Gjatë gjithë ditës, brodha në rrugicat e Toledos; nuhasja një aromë squfuri, sikur kishte rënë rrufeja; dukej sikur një luan kishte kaluar e ajri kishte akoma erën e bishës, edhe pse më shumë se tre shekuj pas udhëtimit tënd. Çfarë tmerri, çfarë gëzimi, të ecësh e të ndiesh që një shpirt i madh rreh krahët me vrull mbi kokën tuaj.

Natën, kur u shtriva, - gjyshi im, i mbushur thellë me frymën tënde, më kapi shpejt gjumi. Ishte gjumi apo një anije me tre direkë? Ajo ngriti velat, unë hipa, dhe përpara se të pyesja kapitenin se ku po shkonim, kishim hedhur spirancën në Megalo Kastro, në Kretë. Luanët me krahë të venecianëve, merrnin në diellin e Pasdites, ngjyrë të kuqe, flamuri i shën Markut valëvitej mbi kullën e madhe, skela mbante erë vaji, vere, portokalli e qitroje. Taverna e Zheromit afër portës së portit, zukaste nga marinarët e dehur, gjenovezë e venecianë, nga gra të paturpshme. Ne të tjerët, ishim ulur në hyrje, pas një fuçie, kishim sjellë midhje e gaforre të tiganisura dhe mbushnim e zbraznim gotat, shihnim njëri-tjetrin në sy, dhe qëndronim të heshtur.

Të dy ishim të rinj, ti ishe 20 vjeç, unë 17, ne ishim miq të ndershëm, donim të njëjtën vajzë, por nuk ziheshim, këndonim natën të dy sëbashku, nën kanatat e mbyllura të dritareve. Ti kishe një kitarë, unë një lyth e duke kënduar, ne lehtësonim dhimbjen e zemrave tona. Dy zërat tanë trazoheshin, yti i rëndë, burrëror ndërsa imi i pashtruar, duke lënë vajzën pas kanatave të mbyllura të zgjidhte mes ne të dyve. Në agim, ndaheshim; ti, pa gjumë, merrje furçën të pikturoje, sipas mënyrës tënde, engjëj me krahë të mëdhenj, që fluturonin jashtë bezes, ndërsa unë, i shkatërruar nga lodhja, kthehesha të flija, për të ëndërruar që dritarja të hapej e që një mollë e kuqe të binte nga dora e saj.

E atje, në tavernë, e shihnim njëri-tjetrin pa folur, pinim për të harruar hidhërimin e ndarjes, sepse të pasnesërmen në agim, ti do të niseshe. Ishte pothuajse mesnatë kur u ngritëm për të lënë tavernën, kishim pirë verë të re nga Malvuasia e shpirti na ishte ngazëllyer, ai hidhte degët mbi botën mbarë.

- Vëllai im, - të thashë, gjithë bota na përket neve. Nisemi.

U kapëm krahë për krahë, për të mos u penguar, unë ndieja frymën tënde afër fytyrës sime. Për sa kohë akoma, mendoja, për sa kohë? Edhe disa orë e dita do zbardhë, e fryma e dashur nuk do të bjerë më mbi mua, kurrë më! Por unë isha i ri, unë i rezistoja hidhërimit e sytë e mi nuk lotonin. Kaluam portën e forcuar të portit, morëm në të djathtë, u ngjitëm mbi bedenat veneciane që rrethonin qytetin. Një hënë e trishtuar, e rrumbullaktë, varej sipër nesh, vetëm yjet më të mëdhenj kishin mundur t'i rezistonin dritës së saj e shkëlqenin në qiellin ngjyrë qumështi e memec; në të djathtën tonë buçiste deti i Kretës.

Ti ndale, shok i dashur, e zgjate dorën:

- Shiko! - më the, shiko detin, ai rrokulliset për të përlarë muret, për të përzënë venecianët.

Nuk e sheh? Shiko mirë; nuk janë valë, vëlla i vogël, janë kuaj, një kavaleri e frikshme! Nisa të qesh:

- Janë dallgë, vëlla, nuk janë kuaj.

Ti ngrite supet:

- Ti, sheh me sytë e tu të argjiltë, më the, unë shoh me të tjera gjëra; ti sheh trupin, unë shoh shpirtin.

Mbase për këtë ne jemi miq kaq të mëdhenj e nuk duam të ndahemi: shpirti, a do ai të ndahet nga trupi i tij?

Ecëm për një farë kohe nën dritën e hënës, por mendimet tona shkonin te ndarja. Ne kërkonim të dy një mënyrë për të kthyer kursin e refleksioneve tona, për të mos nisur të qanim, se kishim turp. Ne të dy kemi lexuar për jetët e shenjtorëve dhe kemi lakmuar rezistencën e tyre ndaj dhimbjes, sytë e tyre që nuk qanin, edhe kur ndaheshin përgjithnjë nga ata që donin më shumë; ne ishim betuar t'u ngjanim.

- Për çfarë mendon? - më pyete për të prishur heshtjen.

- Për asgjë, - t'u përgjigja, duke u përpjekur të fsheh emocionin tim.

- Ja sa i egër është deti i Kretës; ja përse ajo provokon vdekje, - më the, - e më more për dore, sikur të doje të më frenoje e të ndaloje të zbrisja në breg. Isha i lumtur; dora jote që shtrëngonte timen m'u duk shumë e butë, e dhimbja që provoja duke të humbur ishte shumëfishuar. Por u hoqa indiferent. Doja ta hidhja diskutimin për gjërat e përditshme, për të harruar një çast ndarjen.

- Si do të jetosh atje, në tokë të huaj, vëlla? Ti nuk njeh njeri, askush nuk të njeh, ylli yt nuk ka lindur ende. Dukatët që të ka dhënë vëllai yt Manusos janë një gjë e vogël, e unë e di që ti je bujar, ti do t'i shpenzosh menjëherë. Po më vonë? Nuk ke frikë?

- Mos u shqetëso për mua; sadopak të kem, mjaft është për mua: e megjithatë sado që të kem, prapë nuk është mjaft. E kupton, çfarë të them?

- Jo!

Ti qeshe si fëmijë: - Megjithatë kështu është.

Ti më pe që u shqetësova, e më kape nga supi:

- Mos u trondit, vëlla, - më the për të më ngushëlluar, - nuk do të të humb. Kam plane të mëdha në shpirt e një pushtet të madh në duart e mia. Në Evropë, ku po shkoj, do të luftoj me më të fuqishëm, për të detyruar shpirtin tim ose të humbasë ose të fitojë. Do ta shohësh, do ta shohësh. Që në fillim unë do të sulmohem - mos ki frikë - nga Mikelanxhelo.

Ka disa kohë, që kam parë një riprodhim të "Gjyqi i Fundit", që ai pikturon në Romë. Nën dritën e hënës, sytë e tu lëshonin flakë; zëri yt ishte bërë i ashpër. U përkule, more një gur nga toka dhe e hodhe me forcë poshtë në det. Dukeshe sikur doje të tregoje forcën tënde duke sulmuar dallgët.

- Çfarë ke që më shikon? Beson se kam pirë shumë verë e jam i dehur? Nuk jam i dehur, jo, por nuk më pëlqen më kjo gjë. Ai ngjall mishin, rimbush botën me trupa, unë këtë nuk e dua.

- Unë, do të pikturoj një tjetër "Gjyqi i Fundit". Do të ketë dy kate. Mbi katin e poshtëm, varre që hapen, nga dalin vemje të mëdha, me përmasat e njeriut, të shqetësuara, kokën ngritur, që duken sikur nuhasin ajrin; mbi katin e sipërm: Krishti fare i vetëm. Ai përkulet, fryn mbi vemjet e ajri mbushet më flutura. Ja çfarë quhet ringjallje: që vemjet të kthehen në flutura, e jo të jenë vemje, për të rilindur fare thjesht.

Ngrita kokën e të pashë në dritën magjike të hënës; ajri përreth kokës tënde të ndezur u mbush me flutura. Do të hapja gojën për të folur, se ky "Gjyqi i Fundit", më dukej shumë heretik, por ti u hodhe e shpjegove - dita shpejt do të zbardhte - për të patur kohë të më zbuloje të fshehtat e tua para se të më lije. Më ngjante se nuk më flisje më mua, por ecje duke folur vetëm me veten tënde.

Ata pikturuan *Shpirtin e Shenjtë* duke zbritur mbi kokat e apostujve në formën e një pëllumbi; nuk kanë turp? Pra nuk janë ndierë kurrë të djegur nga *Shpirti i Shenjtë?* Ku kanë shkuar ta kërkojnë këtë zog të pafajshëm e të ngrënshëm, për të na i paraqitur si Shpirt? Jo, Shpirti i Shenjtë nuk është kurrë një pëllumb, ai është zjarr, një zjarr-ngrënës i njerëzve që bashkohet në majën e kokës së shenjtëve, të martirëve e të luftëtarëve të mëdhenj dhe i kthen në hi. Janë shpirtrat mediokër që e marrin për pëllumb e që besojnë se ato flakë mund t'i rjepin e t'i hanë.

Nise të qeshësh: - Unë, në qoftë se Zoti do, do të pikturoj një dit shpirtin e shenjtë mbi kokën e Apostujve, atëherë do të shikosh.

Heshte: Lëvize me nervozizëm dorën nga lart poshtë, sikur pikturoje në ajër Rushajat.

- Nuk mund të transformosh zjarrin në dritë? - të thashë unë, por më erdhi keq, sepse pashë që ti u vrenjte në fytyrë dhe rrudhe vetullat.

- Ç'është kjo mani e dritës! M'u përgjigje dhe për një çast m'u duk se ti po më shikoje i nxehur. Përse ngutesh kaq shumë? Kjo nuk është puna jonë. Kjo është toka, nuk është re, është toka me trupat e saj bërë nga mishi, dhjami, eshtrat, prej tyre ne duhet të krijojmë flakën. Këtë ne mund ta bëjmë, por të shkojmë më larg është e pamundur, kjo majfton. Tek çdo stërgjysh i vdekur, tek çdo gjethe peme, si nën pallton më të shkëlqyer të mbretit, fle zjarri, i cili pret që ta zgjojë njeriu. Një flakë që përshkon gurët, njerëzit, engjëjt, dua të pikturoj. Unë nuk dua të pikturoj hirin, sepse unë jam piktor, e jo teolog. Dua të pikturoj çastin kur digjen krijesat e Zotit: pak më përpara se ato të shndërrohen në hi, mjaft që të kem kohë. Prandaj ti më shikon që gulçoj, që nxitoj: Duhet të kem kohë t'i pikturoj përpara se ato të jenë bërë hi.

- Hesht, - të thashë; - unë ndjeva flakët që mbështillnin trupin tënd, hesht, shoku im, unë kam frikë.

- Mos ki frikë, zjarri është Nëna virgjëreshë, nga e cila lind fëmija i pavdekshëm. Çfarë fëmije? Drita. Jeta është Purgatori ku digjemi ne. Vetëm Parajsa është drita e krijuar nga flaka që ne kemi përgatitur; atje është puna e tij.

Ti u ndale, pastaj, pas një çasti vazhdove:

- Ta dish mirë, ja bashkëpunimi i njeriut me Zotin. Për këtë më thonë heretik, le të thonë. Unë kam shkrimin tim të shenjtë, i cili

flet për atë që tjetri e ka harruar ta thotë ose nuk ka guxuar ta thotë. Unë e hap dhe lexoj Gjenezën: Zoti krijoi botën dhe ditën e shtatë pushoi. Atëherë thirri krijesën e tij të fundit, njeriun dhe i tha: "Dëgjo, bir dhe do të kesh bekimin tim. Unë e bëra botën por nuk e përfundova, e lashë përgjysmë; Je ti që do të vazhdosh krijimin: digje botën, prej saj bëj zjarr dhe dërgoma mua. Unë prej tij do të bëj dritën".

Ajri i pastër dhe diskutimi na kishin dehur. U ulëm mbi një shkëmb dhe shikonim detin. Në lindje qielli kishte marrë një ngjyrë qumshti;, deti, akoma i zymtë, uturinte te këmbët tona.

- Ti je një inkuizitor i pamëshirshëm, - të thashë; - ti torturon dhe vret trupat për t'u shpëtuar atyre shpirtrat.

- Atë që ti e quan shpirt, unë e quaj flakë, - m'u përgjigje.

- Unë i dua trupat, mishi më duket i shenjtë, edhe atë e ka krijuar Zoti. Më lejo të të them, pa u mërzitur: mishi vetë ka një reflektim shpirti, ndërsa shpirti ka diçka të mishtë; ata ekuilibrohen në mënyrë të harmonishme, jetojnë së bashku, si miq e fqinjë të mirë. Ndërsa Ti, e thyen ekuilibrin e shenjtë.

- Ekuilibër do të thotë palëvizshmëri. Palëvizshmëri do të thotë vdekje.

- Atëherë jeta është një mohim i përhershëm; ti e mohon atë që, duke realizuar ekuilibrin, ndalohet shkatërrimi. Ti e shkatërron dhe kërkon pasigurinë.

- Unë kërkoj sigurinë. Unë gris maskat, lartësoj dhe me bindje them: është e pamundur të jetë ndryshe, ekziston nën mishra diçka e pavdekshme, këtë kërkoj, këtë do të pikturoj. Gjithçka tjetër, maskat, mishrat, bukuritë, ua lë bojaxhinjëve.

- Ti kërkon t'ia kalosh Ticianit dhe Tintoretit? Mos harro fjalën e urtë kretase: Ti po e ndërton folenë tënde shumë lart, dega e brishtë mund të thyhet.

- Ti tunde kokën; - Jo, unë nuk dua t'ia kaloj askujt; unë jam i vetëm në gjininë time.

- Ti je një mendjemadh i jashtëzakonshëm, i njëjtë me Luciferin.

- Jo unë jam fare i vetëm.

- Zoti e dënon vetëbesimin e tepëruar dhe vetminë; kujdes mik i dashur.

Ti nuk u përgjigje. Hodhe një shikim të fundit mbi detin që uturinte, e shëtite për një kohë të gjatë mbi qytetin akoma të fjetur, kur

po këndonin gjelat e parë. U ngrite: - Nisemi, dita po ngrihet.

Më kape përsëri për krahu, filluam të ecim. Ti pështpërisje, buzët të dridheshin, patjetër doje të thoshe diçka, por ngurroje. Më në fund nuk u përmbajte dot: - Do të të them diçka të rëndë, vëllai im i vogël, më fal; llogarite edhe këtë si një nga marrëzitë e mia.

Unë shpërtheva në të qeshura.

- Është rasti të thuash që je i dehur, të cilën nuk guxoje ta thoshe pak më parë. Nuk flet ti, mund të thuash, është vera e Malvuasisë. Dakord.

Në mëngjesin e zbehtë, zëri yt, i trashë, i pikëlluar, u drodh: - Një natë pyeta Zotin: Zot kur do ta falësh Luciferrin? Kur të më falë ai! - u përgjigj. - E kupton shoku im i vogël? Në qoftë se do të të pyesin një ditë cili është bashkëpunëtori më i madh i Zotit ti do të përgjigjesh Luçiferri. Në qoftë se do të të pyesin cila është krijesa më e vuajtur e Zotit, përgjigju: Luçiferri. Edhe këtë akoma: Në qoftë se do të të pyesin cili është djali plangprishës, për të cilin i ati ther viçin më të mirë, duke e pritur me krahë hapur, përgjigju: Luçiferri.

"Unë të shfaqa të fshehtat më të mëdha, që t'i dish. Në qoftë se unë nuk kam kohë, në qoftë se unë nuk jam i aftë t'i realizoj gjithë sa kam në shpirt, është detyra jote të vazhdosh luftën time. Vazhdoje atë dhe mos ki frikë; mos harro kurrë mësimin mizor që kretasi i jep kretasit:

"Jepi asaj rininë tënde, mos e kurse!"

"Ja ç'do të thotë të jesh njeri, ja ç'është guximi dhe dëshira ekstreme e flakës së shenjtë."

"Ma jep fjalën? Je i fortë? Nuk do të thyhesh? Nuk do të shikosh prapa, nuk do të thuash: s'ka gjë më të mirë se rehatia, krahët e gruas dhe lavdia. Përse nuk përgjigjesh?"

- Është një urdhër tepër i rëndë që më jep. Nuk mund ta lehtësosh pak detyrën e njeriut?

- Po, por jo për ty, as për mua. Ka tre lloj shpirtrash, tre lloj lutjesh:

"Unë jam një hark në dorën tënde o Zot, tendosmë, që unë të mos kalbem."

"Mos më tendos shumë o Zot, se mund të thyhem.

"Tendosmë sa të duash o Zot e aq fort sa të thyhem.

"Zgjidh!"

U zgjova. Këmbanat binin për mëngjesin; në rrugë tingëllinin thirrjet, takat e grave godisnin mbi kalldrëme, në oborr këndoi një gjel me zë të ngjirrur: Toledua po zgjohej. Ëndrra rrinte e varur përpara qepallave të mia dhe unë akoma dëgjoja fjalën e fundit, të pamëshirshme, që më kishte mbushur me tmerr dhe më kishte zgjuar brutalisht nga gjumi: "Zgjidh!"

I dashur gjysh, sa kohë ka rrjedhur nga ajo natë kur unë fjeta në Toledo, dhe ti nuhate se kishe fqinj një kretas - që ti u ngrite nga varri dhe more formën e një ëndrre për të më gjetur mua? Shkrepja e një vetëtime, tre shekuj? Kush do të mundej, të dallonte, në atmosferën e dashur, dritën e përjetshme? Është një jetë që ka rrjedhur qysh atëherë: flokët e zinj janë zbardhur, tëmthat janë bërë gropë, sytë e kanë humbur shkëlqimin. Harku, a ka kërcitur në duart e Zotit apo në duart e Djallit unë nuk mund ta dalloja kurrë. Por unë isha i lumtur të kuptoja se një forcë më e madhe se e imja, më e pastër, më armatoste me një shigjetë dhe më tërhiqte. Gjithë copat e drurit janë copat e kryqit të vërtetë, sepse me secilën prej tyre mund të bëhet një kryq; Gjithë trupat janë të shenjtë, sepse me secilin prej tyre mund të bëhet një hark. Gjatë gjithë jetës sime, unë kam qenë një hark në duart e pamëshirshme, të pangopura. Sa herë më kanë tendosur me gjithë forcën ato duar të padukshme, sa herë kam ndier të kërcas, gati për t'u këputur! Le të këputet, klithja. Ti gjysh, më kishe urdhëruar të zgjidhja, unë zgjodha.

Unë kisha zgjedhur. Tani nata tymos mbi kodrina, hijet janë zgjatur, ajri është mbushur me vdekje. Beteja pushon. Kam trium-fuar? Jam mposhtur? Unë di vetëm një gjë: Unë jam gjithë plagë por akoma jam në këmbë.

Unë jam mbuluar me plagë dhe të gjitha janë marrë ballë për ballë. Unë gjysh, bëra ç'munda dhe ashtu si më urdhërove ti, më shumë, që të të mos turpëroja, nuk bëra. Tani që beteja mori fund, unë do të vij të shtrihem pranë teje, për t'u bërë tokë, e të dy së bashku të presim Gjykimin e Fundit.

Gjyshi im, të puth dorën, supin tënd të djathtë, supin tënd të majtë, të falemnderit që më prite.


PËRMBAJTJA

Letër El - Grekos....9
Stërgjyshërit....16
Babai....23
Nëna....26
Djali....34
Shkolla e komunës....44
Vdekja e gjyshit....55
Dëshirë për arratisje....66
Naksos....82
Liria....93
Shqetësimet e adoleshencës....97
Edhe një maskë tjetër....100
Dy plagosjet e mëdha....103
Iluminizmi....112
Irlandezja....116
Athina....121
Unë kthehem në Kretë....129
Knosos. Abati Mynier....137
Dervishët....142
Një vit udhëtim. Greqia....145
Mistra....151
Italia....161
Kthimi në Greqi....171
Miku im poet....174
Mali Athos....181
Pranverë plot hijeshi....223
Sodoma dhe Gomorreja....230
A do të bëhem murg?....270
Kthimi në Kretë....282
Paris. Niçe, dëshmori i madh....293
Dionisi i kryqëzuar....299
Kthimi i përjetshëm....304
Zemra e njeriut....310

Në buzë të greminës....315
I sëmurë në Vienë....318
Shfaqja e Budës....323
Buda....328
Një çifute në Berlin....337
I betohem Budës me fjalë....343
I betohem Budës me trupin....348
Zvicra....355
Moska....377
Varri i shenjtë i kuq....380
Festa e madhe e kuqe....385
Istrati-Gorki....392
A do të ngjallet ai përsëri? Deri kur do të jetë i kryqëzuar....395
Buhara: Epafos është Zoti im....401
A është Pompei antik? Ai është modern....404
Në qoftë se ti digjesh në këmbë, ke shpëtuar; në qoftë se nuk digjesh, sepse je i shtrirë përtokë, ti ke humbur....405
Jo më me ide, por me njerëz....409
Kaukazi: Prometeu i ri....412
Zot, shpëtoje popullin tënd....416
Kthimi i djalit plangëprishës....421
Njohja me Aleksis Zorbën....430
Tek unë mbin fara....444
Vdekja e tim eti....459
Shikimi kretan....464
El - Grekos....475

NIKOS KAZANZAQIS

Letër El Grekos



Romani autobiografik ***Letër*** është një histori intriguese e ... piktorit të madh me origjinë ... blatim ndaj grekut të madh, ... që i kushtohet ati,që i drejt... vetem atij.

Eshtë gjithashtu një testamen... i fundit, shpiegim i gjenezës ... mëdha me dometiënie filoz... dhe fetare.


Gjuha e përkryer, udhëtimet ... dashuria e mrekullueshme ... peng, ja cilat e ngacmojnë nje... hap që hedh...

Çmimi 800 LEKE

ISBN:9992

NIKOS KAZANZA

Letër El Grekos



SHTEPIA BOTUESE
UEGEN